



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AGJENCINË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE

RAPORT AUDITIMI
FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE
NË
AGJENCINË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
(AKBN)

KORRIK 2022

| Nr. | Përmbajtja | Faqe |
|-------------|--|----------------|
| I. | PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | |
| 1. | Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit..... | 3 |
| 2. | Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve..... | 3 |
| 3. | Konkluzion i përgjithshëm dhe opinion i auditimit..... | 9 |
| II. | HYRJA | 13 |
| 1 | Objekti i auditimit..... | 13 |
| 2 | Qëllimi i auditimit..... | 13 |
| 3 | Identifikimi i çështjes..... | 13 |
| 4 | Përgjegjësitë e strukturave drejtuese..... | 13 |
| 5 | Përgjegjësitë e audituesve..... | 14 |
| 6 | Kriteret e vlerësimit..... | 14 |
| 7 | Standardet e auditimit..... | 15 |
| 8 | Metoda e auditimit..... | 15 |
| 9 | Dokumentimi i auditimit | 15 |
| III. | PËRSHRIMI I AUDITIMIT..... | 16 |
| 1. | Informacion i përgjithshëm mbi subjektin | 16 |
| 2. | Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit..... | 16 |
| III.1 | Pika 1. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm..... | 17-26 |
| III.2 | Pika 2. Mbi organizimin dhe funksionimin e AKBN..... | 26-37 |
| III.3 | Pika 3. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit | 37-54 |
| III.4 | Pika 4. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare..... | 54-62 |
| III.5 | Pika 5. Mbi zbatimin e procesit të prokurimit publik..... | 62-72 |
| III.6 | Pika 6. Mbi shfrytëzimin e burimeve hidrokarbure..... | 72-110 |
| III.7 | Pika 7. Mbi shfrytëzimin e burimeve minerare..... | 110-177 |
| III.8 | Pika 8. Mbi shfrytëzimin e burimeve energjetike..... | 177-203 |
| IV. | GJETJET DHE REKOMANDIMET..... | 203-232 |
| V. | ANEKSE..... | 232-261 |

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka si objekt të veprimtarisë së saj, zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e post shfrytëzimit të tyre, në sektorin mineral, hidrokarbur dhe energjetik.

Fusha e veprimtarisë së AKBN konsiston në:

- a) Propozimin, konsultimin, dhe bashkëpunimin me strukturat përkatëse të Qeverisë për hartimin e politikave të saj dhe strategjive në fushën e minierave, hidrokarbureve dhe energjisë;
- b) Zbatimin e politikave të Qeverisë në fushën e minierave, hidrokarbureve dhe energjisë;
- c) Sigurimin brenda fushës së veprimtarisë së vet, të oponencës qeveritare për studimet dhe projektet në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe të energjisë, të paraqitura nga subjektet shtetërore a privatë, vendas ose të huaj. Për raste të veçanta mund të kërkoje asistencë të specializuar;
- d) Promovimin e burimeve minerare, hidrokarbure, hidrike dhe burimeve të rinovueshme të energjisë;
- e) Negocimin e marrëveshjeve hidrokarbure dhe minerare dhe ndjekjen e zbatimit të planeve të zhvillimit të tyre;
- f) Përgatitjen e dokumentacionit dhe praktikave të nevojshme për dhënien e lejeve, të licencave, autorizimeve, në përputhje me ligjin, të cilat mundësojnë hyrjen në marrëveshjet hidrokarbure dhe kryerjen e operacioneve hidrokarbure sipas marrëveshjeve të lidhura;
- g) Ndjekjen e zbatimit të marrëveshjeve të lidhura hidrokarbure;
- h) Mbikëqyrjen e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike;
- i) Realizimin e monitorimit të zonave të shfrytëzuara, të rrezikut mineral dhe të mbylljes së veprimtarisë minerare;
- j) Monitorimin, e kontratave konçensionare për hidrocentralet;
- k) Administrimin ekskluzivisht të të gjitha të dhënave parësore të sektorit hidrokarbur dhe të dhënat që lidhen me veprimtarinë minerare dhe postminerare;
- l) Propozimin e masave për rritjen e shfrytëzimit të energjisë në ciklin energjetik;
- m) Hartimin dhe publikimin e bilancit energjetik vjetor, në nivel kombëtar dhe rajonal, në përputhje me formatet e EUROSTAT-it dhe të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është përputhshmëria aktivitetit të subjektit për periudhën data 01.09.2018 deri më datë 31.12.2021.

Është audituar aktiviteti i Institucionit për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar realizimi i buxhetit, shpenzimet operative, realizimi i prokurimeve dhe kontratave, monitorimet e sektorit mineral, hidrokarbur dhe elektroenergjetik.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

| Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Referenca me Raportin Përfundimtar të auditimit. | Rëndësia | Rekomandimi |
|-----|--|--|----------|-------------------------|
| 1 | Referuar të dhënave dokumentare të AKBN, | Pika nr. 6 | E lartë | Të bëhen përmirësimet e |

| | | | | |
|---|---|--------|---------|---|
| | <p>konstatohet së gjatë periudhës objekt auditimi ka një rritje të sasive të kromeve të varfra dhe koncentrateve të kromit, të përpunuara në fabrikat e pasurimit, ku numri i tyre ka rritur në 17, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 impiante pasurimi për mineralin e Kromit në Bashkinë Bulqizë; - 3 impiante pasurimi për mineralin e Kromit në Bashkinë Kukës; - 2 impiante pasurimi për mineralin e Kromit në Bashkinë Has; - 1 impiant pasurimi për mineralin e Kromit në Bashkinë Librazhd; - 1 impiant pasurimi për mineralin e Kromit në Bashkinë Përrenjas; - 2 impiante pasurimi për mineralin e Bakrit në Bashkinë Fushë - Arrëz; <p>Grupi i auditimit ka konstatuar për periudhën e audituar nga KLSH rezulton së nuk janë përfshirë asnjëherë në skemën e inspektimit, monitorimin dhe kontrollit nga struktura përgjegjëse shtetërore (AKBN), të 17 impianteve të pasurimit / fabrikat e pasurimit që kanë përpunuar krome të varfra dhe koncentrate të kromit, vepruar kështu në kundërshtim me kërkesat e në përcaktimet e nenit 1 dhe nenit 2, të ligjit Nr. 10304, datë 15.7.2010 òPër sektorin minerar në RSHö, i ndryshuar janë përcaktimet e mëposhtme që,</p> <p>òKy ligj përcakton rregullat për zhvillimin e veprimtarive minerare e postminerare...ö, dhe së "Veprimtari minerare" janë veprimtaritë e kërkimit, të zbulimit, të shfrytëzimit, të përpunimit, të mbylljes, të konservimit dhe të rehabilitimit të mjedisit minerar.</p> <p>Dhe në pikën nr. 12 të nenit 2, ku cilësohet së, "Përpunim minerar" është trajtimi i mineralit/mineraleve, të nxjerra nga një minierë ose karrierë, nëpërmjet çdo procesi apo kombinimi procesesh, të cilave u nënshtrohen minerali/mineralet deri në formën e produktit të shitshëmö.</p> | | | <p>duhura në Statut-Rregulloren e funksionimit të AKBN-së për zbatimin e pikës 7, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 547, datë 09.08.2006, për të normuar detyrimin e kontrollit prej strukturës së Drejtorisë Minerare, të fabrikave të pasurimit të mineraleve, duke e shoqëruar këtë veprim me masat për rekrutimin në përbërje të Drejtorisë Minerare të inxhinierëve të pasurimit.</p> |
| 2 | <p>Mosshyerja e garancive financiare vjetore të përcaktuara për rehabilitimin mjedisor të zonës së lejuar minerare, nga subjektet me leje shfrytëzimi minerar, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat</p> | Pika 6 | E lartë | <p>Drejtoria Minerare pranë AKBN të marrë masa për shlyerjen e detyrimeve për garancitë financiare të</p> |

| | | | |
|--|--|--|--|
| <p>e ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerarò, i ndryshuar me ligjin nr. 13/2014, datë 09.10.2014 si dhe VKM nr. 741, datë 09.09.2015. Rezultojne disa subjekte me leje aktive minerare të shfrytëzimit, që në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerarò, i ndryshuar me ligjin nr. 13/2014, datë 09.10.2014 si dhe VKM nr. 741, datë 09.09.2015 <u>nuk kanë paguar në kohë garancitë financiare të përcaktuara për rehabilitimin mjedisor të zonës së lejuar minerare, sipas nenit 31, të ligjit nr. 10304/2010, neni 31, pika nr.1 që specifikojnë së,</u></p> <p>ò Garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit përlllogaritet në vlerë monetare dhe përdoret nga zotëruesi i lejes ose shteti për realizimin e planit të rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Garancia financiare depozitohet pas marrjes së lejes minerare çdo vit, në datën efektive të marrjes së lejes dhe vlera vjetore përcaktohet në bazë të vlerës së përgjithshme të garancisë financiare për realizimin e planit për rehabilitimin e mjedisit, të miratuar nga ministri, të viteve të jetëgjatësisë së lejes minerare dhe të sasisë së mineralit të programuar për t'u shfrytëzuar çdo vit, sipas planit vjetor të veprimtarisë minerare. Vlera totale e garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit, rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe realizimin e planit të aktiviteteve për mbylljen e veprimtarisë minerare vlerësohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga ministri. Ajo përfshin garancinë financiare për mbylljen e veprimtarisë minerare, mbylljen e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit.ò</p> <p>Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, duke konstatuar këto vonesa në kryerjen e pagesës së garancisë financiare për rehabilitimin, ka marrë masa duke propozuar revokimin për këto subjekte në zbatim të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerarò, neni nr. 47, pika nr.1, germa òçö. Saktësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për vitin 2019 janë kërkuar nga Drejtoria Minerare pranë AKBN-s, 15 revokime; - për vitin 2020 janë kërkuar nga Drejtoria Minerare pranë AKBN-s, 52 revokime; | | | <p>rehabilitimit nga ana e subjekteve me leje shfrytëzimi minerar. Drejtoria Minerare pranë AKBN të mbajë korespondencë të vazhdueshme me ministrinë e linjës (MIE) për revokimin e lejeve të shfrytëzimit për subjektet që nuk kryejnë pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit.</p> |
|--|--|--|--|

| | | | | |
|---|---|--------|---------|--|
| | - për vitin 2021 janë kërkuar nga Drejtoria Minerare pranë AKBN-s, 6 revokime. | | | |
| 3 | <p>Grupi i auditimit nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ka konstatuar së gjatë inspektimeve që kryen Sektori i Monitorimit të fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura pjesë e Drejtorisë Minerare pranë AKBN-së, ka problematika si më poshtë:</p> <p>-Minierat e mbyllura/braktisura shtetërore, janë mbyllur me mënyrën provizore (të përkohshme). Në vite, pothuaj të gjitha punimet e mbyllura të këtyre minierave janë hapur ose dëmtuar, duke qenë, potencialisht, rrezik serioz për jetën e njerëzve;</p> <p>-Mbyllja e puseve vertikale është kryer me metodën e mbylljes provizore.</p> <p>-Gjendja e objekteve sipërfaqësore, ndërtesave dhe ndërtimeve në të gjitha sheshet industriale të minierave është shumë e degraduar. Ato janë amortizuar dhe të dëmtuara dhe aktualisht përbejnë rrezik për jetën e banoreve përreth. Vetëm një numër shumë i vogël i këtyre ndërtesave të ish minierave janë privatizuar.</p> <p>-Shpesh-herë grupi i monitorimit është ndeshur me dalje të hinkave në sipërfaqe në shumë zona si pasojë e hapësirave të krijuara nga shfrytëzimi në vite në këto ish miniera si përmendim Miniera Rehovë, bashkia Korçë, në Minierën e Mborje Drenovës, bashkia Korçë në Minierën e Kurbneshit bashkia Mirditë, në minierën e Kripës Dhrovjan Bashkia Finiq.</p> <p>-Problematikë tjetër ndërtime mbi ish minierat siç përmendim ato të qarkut të Trianës (Valias, Mëzez, etj.....</p> <p>-Në përgjithësi, sinjalistika treguese e minierave dhe objekteve minerare, sinjalistika paralajmëruese dhe ndaluese e rreziqeve minerare mungon, është e dëmtuar ose jo në përputhje me standardet e sinjalistikës përkatëse për minierat e braktisura. Kjo e bën të vështirë dallimin e zonës të minerarës së mbyllur dhe të objekteve të saj nga banorët e zonës apo të kalimtarëve të rastit.</p> <p>-Dambat e fabrikave të pasurimit të mineralit të bakrit, që nuk janë rehabilitur, janë në gjendje jo të mirë. Mund të përmendim damba e sterileve të</p> | Pika 6 | E lartë | <p>Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, të hartojë një plan rehabilitimi për këto zona si dhe të përcaktojë listën e minierave që do të kalojnë në mbyllje të përhershme.</p> <p>Drejtoria Ekzekutive e AKBN përgatisë propozimet dhe ti dërgojë në MIE për realizimin e rehabilitimit të këtyre zonave dhe të mbylljes së përhershme të minierave të përcaktuara në listë.</p> |

| | | | | |
|---|--|--------|---------|--|
| | <p>ish fabrikës së pasurimit të bakrit Kurbneshit, në të cilën krijuar disa gropa (hinka) me diametër dhe thellësi prej disa metrash dhe janë dëmtuar (erozion nga ujërat) sipërfaqet ballore dhe anësore të dambave, kryesisht nga dëmtimi, apo mungesa, i kanaleve të ujërave të larta dhe, për pasojë, mos kontrolli i ujërave të shiut dhe të dëborës.</p> <p>Disa miniera të mbyllura si minierat e kripës D e M, të fosforiteve Gusmar e Fushëbardhë apo ish miniera e qymyrgurit G, nuk janë në administrim të asnjë prej tre shoqërive (Albm, AlbB dhe Albk), që administrojnë miniera e mbyllura/braktisura.</p> | | | |
| 4 | <p>Si rezultat i mos ndryshimit në rritje të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike nga shqyrtimi i oponencës teknike për projektet e zbatimit në kontratat koncesionare për 25 prej tyre, ka sjellë për pasojë mungesën e përfitimit nga fee koncesionare (energji elektrike pa pagesë) në vlera të konsiderueshme. Gjithashtu, mungesa e reflektimit të ndryshimit të fuqisë (në kw) së hidrocentraleve në 11 prej tyre, sipas projektit të zbatimit të vlerësuar më të ulët së kontrata nga 7 deri në 60%, rrezikon koncesionarët për penalizim në vlera të konsiderueshme për ulje të fuqisë së instaluar.</p> | Pika 7 | E lartë | <p>Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masa për të evidentuar në mënyrë të hollësishme të gjitha kontratat koncesionare, në të cilat ka rritje të prodhimit të energjisë elektrike nga oponenca teknike por që nuk është ndryshuar sasia e prodhimit në kontratë fuqia e hidrocentraleve, duke njoftuar për këtë qëllim Autoritetin kontraktor (MIE).</p> |
| 5 | <p>Gjatë monitorimit të kontratave kocesionare për ndërtimin e hidrocentraleve në vitin 2019 deri 2021, Drejtoria përkatëse në AKBN ka evidentuar parregullsi në kundërshtim me kushtet kontraktore, penalitete në vlerën 23,143,439,359 lekë, për të cilat është njoftuar autoriteti kontraktor, MIE për secilën kontratë koncesionare. Gjithashtu, mungesa e shoqërimit të ndryshimit të prodhimit të energjisë elektrike nga oponenca teknike në kontratat koncesionare sjell për pasojë mungesën e përfitimit buxhetor për 15,590,253 lekë, dhe te dyja së bashku në vlerën 23,159,029,612 lekë.</p> | Pika 7 | E lartë | <p>Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masat e nevojshme për të rritur frymën e bashkëpunimit me MIE për shkëmbimin e informacionit lidhur me ecurinë e zgjidhjes së problematikave të evidentuara gjatë monitorimit të kontratave koncesionare në fushën energjetike.</p> |
| 6 | <p>Miratimi i oponencës teknike, bëhet ndërkohë që projektet paraqiten me mangësi, veprim në kundërshtim me Rregulloren Për Funkionimit e Grupit òPër kryerjen e oponencës teknike të</p> | Pika 7 | E mesme | <p>Grupi i oponencës teknike të marrë masa për shqyrtimin me detaje të dokumentacionit teknik të</p> |

| | | | | |
|---|---|--------|---------|---|
| | projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesionë, Neni 2. Mos realizimi i oponencës teknike sipas përcaktimeve në rregullore, nuk garanton respektimin e kushteve të projektimit, shfrytëzimin optimal të burimeve ujore, si dhe ndikim sa më të ulët në mjedis. | | | projekteve, me synim garantimin e respektimit të kushteve teknike të projektimit, shfrytëzimin optimalë të burimeve ujore, si dhe realizimin e investimeve me eficiencë të lartë dhe ndikim sa më të ulët në mjedis. |
| 7 | <p>Nga monitorimi është konstatuar së disa koncesionarë nuk kanë paraqitur dokumentacionin e lejes së ndërtimit, apo leje të tjera, por nga ana e AKBN, nuk është marrë asnjë masë për sensibilizimin e organeve kompetente.</p> <p>- Nga monitorimi konstatohet së disa koncesionar kanë ndryshuar kapacitetin e prodhimit, megjithatë nga ana e AKBN nuk janë bërë llogaritjet për pasojat e veprimit në lidhje me sasinë e energjisë dhe të ardhurave që do të mungojnë nga prodhimi më i ulët i energjisë për shtetin (për rastet kur kapaciteti është më i ulët), si dhe problematika që krijohet në deformimin e skemave të miratuara dhe pasojat në funksionim.</p> <p>- Pavarësisht monitorimit kontraktorët paraqesin mangësi të theksuara të plotësimit të dokumentacionit tekniko ligjor, madje në disa raste nuk bëhet njoftim për pjesëmarrje në testim nga ana e AKBN, si proces i detyrueshëm, për evidentimin e saktësisë së realizimit të veprave, krahasuar me parashikimin.</p> <p>-Devijimet e shumta si në skema, kapacitete, ndryshime gjatë zbatimit të kontratave, mund të shoqërohen me vështirësi për realizimin e këtyre veprave dhe në ndonjë rast dështimin e tyre.</p> <p>- Vonesat në fillimin, zbatimin apo përfundimin e veprave, vë në diskutim vënien në funksion të tyre, ose në rastin më të mirë, vënie me vonesë në eficiencë të investimeve, rrjedhimisht energji elektrike më pak në rrjet dhe të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.</p> <p>- Nga ana e AKBN janë përlllogaritur penalitete si për mos fillim, fillim të vonuar, apo mos përfundim të punimeve në afat, por nuk rezulton asnjë rast i ekzekutuar. Mos ekzekutimi i penaliteteve përveç të ardhurave të munguara për</p> | Pika 7 | E mesme | <p>AKBN në bashkëpunim me MIE të marrin masa për analizimin e situatës së koncesionarëve në fushën e HEC-eve, për vështirësitë që paraqiten në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të koncesionarëve, sidomos në marrjen e lejeve përkatëse, angazhimin maksimal për reduktimin e kohës së nevojshme për miratimin e projekteve, lejeve, oponencës teknike etj., me synim realizimin e afateve të parashikuara në kontrata për realizimin e veprave dhe hyrjen në një kohë sa më të shpejtë në prodhim të tyre.</p> |

| | | | |
|---|--|--|--|
| <p>buxhetin e shtetit, nuk nxit koncesionarët për të aktivizuar burimet e tyre për realizimin e investimit sipas parashikimeve të miratuara (procesi i aplikimit të penalteteve është kompetencë e MEI).</p> <p>- Nisur nga numri i lartë i HEC-eve të miratuara, por të pa filluara, edhe për periudha të gjata të konsiderueshme të cilët konsiderohen pa shpresë realizimi, nuk është shoqëruar me njoftimet përkatëse për ndërprerjen e kontratës, për t'ia dhënë mundësinë operatorëve të tjerë për realizimin e mundshëm të këtyre investimeve.</p> | | | |
|---|--|--|--|

3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.

Nga auditimi i kryer pranë AKBN, për periudhën 01.09.2018 deri datë 31.12.2021, lidhur me përputhshmërinë, rezultoi se:

Ka likuidim faturash mbi afatin e parashikuar në 39 praktika veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014 òPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtareö neni 7.

AKBN nuk i ka kryer vullnetarisht pagesat me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbauesit privat, duke paguar tarifa përmbaimore në shumën prej 698,892 lekë.

Në lidhje me shfrytëzimin e burimeve hidrokarbure konstatohet së kontraktorët nuk respektojnë planet e zhvillimit të miratuara, kryesisht në ulje të nivelit të investimeve, i cili shoqërohet me ulje të prodhimit, duke mos arritur faktorin R mbi 1, e cila përkthehet në arritje të fitim dhe ndarje të tij, me qeverinë shqiptare.

Nga auditimet e kryera nga AKBN për kostot hidrokarbure, rezulton së përfshihen shpenzime në kundërshtim me kontratën në vlera të konsiderueshme në kundërshtim të hapur me përcaktimet kontraktore. Përfshirja e këtyre shpenzimeve padrejtësisht ndikon në uljen e faktorit R dhe rrjedhimisht mos derdhje të fitimit për llogari të qeverisë.

Konstatohen Parregullsi në fushën e zbatimit të kërkesave të ligjit minerar dhe akteve të tjera të Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë në vitet 2018- 2021, pasi konstatohet së nuk janë hartuar dhe dërguar në strukturën shtetërore përgjegjëse, informacionet tremujore dhe vjetore me treguesit mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera përrehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare dhe planin vjetor të punës.

Nuk është kryer mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive dhe aktivitetit minerar të raportuar nga subjektet e licencuara, në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore në fuqi, pasi për vitet 2018-2019 nuk i janë nënshtruar skemës së mbikëqyrjes dhe inspektimit 247 subjekte të licencuar në fushën e shfrytëzimit të pasurive minerare metalore dhe jometalore, ndërkohë që detyrimi ligjor është që duhet ti nënshtrohen monitorimit dhe inspektimit dy herë brenda një viti.

Për periudhën objekt audituar nga rezulton së nuk janë përfshirë asnjëherë në skemën e inspektimit, monitorimit dhe kontrollit nga struktura përgjegjëse shtetërore (AKBN), asnjë nga 17 impiantet e pasurimit/fabrikat e pasurimit që kanë përpunuar mineralet e kromit apo bakrit.

Konstatohet mos shlyerja e garancive financiare vjetore të përcaktuara për rehabilitimin mjedisor të zonës së lejuar minerare, nga subjektet me leje minerare shfrytëzimi.

Ka një fluks të ulët të analizave të kryera nga të tretët dhe në Laboratorin Minerar dhe të Pasurimit, pjesë e Drejtorisë Minerare pranë AKBN-së, si rrjedhojë e këtij fluksi të ulët edhe të ardhurat që vijnë nga ky laborator janë të ulëta. Shkak për këtë është edhe mos akreditimi i këtij laborator.

Grupi i punës për verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i VKM nr.822, datë 07.10.2015, nga burimet hidrike të energjisë i ngritur me Urdhrin e Ministres së MIE nr.233 datë 06.06.2019 ka evidentuar së 35 % të kontratave koncesionare janë jashtë afatit, me shkelje, si dhe në procese gjyqësore.

Mangësia e monitorimeve të njëtrajtshme në planifikim dhe zbatim, për vitin 2019 ka ndikuar në ngarkesën e punonjësve dhe cilësinë e monitorimit për shkak të intensifikimit të punës në periudha të veçanta të vitit. Kjo pasi vetëm nga raportimet e monitorimeve të tremujorit të tretë dhe të katërt 2019 rezultojnë penalitete për mosrespektim të detyrimeve kontraktore për 41 % të kontratave të monitoruara, duke shkaktuar deformim të sipërmarrjes në fushën prodhimit të energjisë elektrike nga burimet ujore, si rezultat veprimeve dhe mosveprimeve të MIE në cilësinë e Autoritetit kontraktor.

Grupi i oponencës teknike ka në shumicë ekspertë të jashtëm (5) në kundërshtim me VKM nr. 547, pika 3, pasi vendim-marrja del jashtë kompetencës saj institucionale, është kosto financiare për AKBN, duke evidentuar mungesën e rekrutimit të stafit profesional sipas fushave, si dhe shfaq mungesën e përcaktimit të kriterëve që duhet të plotësojnë ekspertët e jashtëm, si dhe e bën procedurën e kryerjes së oponencës teknike subjektive dhe me mangësi potenciale të kësaj veprimtarie etj.

Nga 30 oponenca teknike të realizuara për vitin 2020, janë audituar 5 prej tyre, nga ku ka rezultuar së në 3 oponenca ka mangësi.

Nga monitorimi është konstatuar së disa koncesionarë nuk kanë paraqitur dokumentacionin e lejes së ndërtimit, apo leje të tjera, por nga ana e AKBN, nuk është marrë asnjë masë për sensibilizimin e organeve kompetente. Mungesa e dokumentacionit si më sipër, nuk krijon mundësinë e monitorimit të ndikimit në mjedis, të problematikave që i krijohen banorëve të zonës në lidhje me përdorimin e burimeve ujore, mungesë pagesë tarifash, mungesë ta trajtimit të problematikave kur projekti shtrihet në më shumë së një bashki et., problematika të cilat nuk parandalohen, por bëhen objekt për ndërprerje të kontratave në të ardhmen, duke ulur nivelin e investimeve në këtë fushë dhe pasoja për mjedisin etj.

- Nga monitrimi konstatohet së disa koncesionar kanë ndryshuar kapacitetin e prodhimit, megjithatë nga ana e AKBN nuk janë bërë llogaritjet për pasojat e veprimit në lidhje me sasinë e energjisë dhe të ardhurave që do të mungojnë nga prodhimi më i ulët i energjisë për shtetin (për rastet kur kapaciteti është më i ulët), si dhe problematika që krijohet në deformimin e skemave të miratuara dhe pasojat në funksionim.

- Pavarësisht monitorimit kontraktorët paraqesin mangësi të theksuara të plotësimit të dokumentacionit tekniko ligjor, madje në disa raste nuk bëhet njoftim për pjesëmarrje në testim nga ana e AKBN, si proces i detyrueshëm, për evidentimin e saktësisë së realizimit të veprave, krahasuar me parashikimin.

-Devijimet e shumta si në skema, kapacitete, ndryshime gjatë zbatimit të kontratave, mund të shoqërohen me vështirësi për realizimin e këtyre veprave dhe në ndonjë rast dështimin e tyre.

- Vonesat në fillimin, zbatimin apo përfundimin e veprave, vë në diskutim vënien në funksion të tyre, ose në rastin më të mirë, vënie me vonesë në eficiencë të investimeve, rrjedhimisht energji elektrike më pak në rrjet dhe të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.
- Nga ana e AKBN janë përlogaritur penalitete si për mos fillim, fillim të vonuar, apo mos përfundim të punimeve në afat, por nuk rezultojnë asnjë rast i ekzekutuar. Mos ekzekutimi i penaliteteve përveç të ardhurave të munguara për buxhetin e shtetit, nuk nxit koncesionarët për të aktivizuar burimet e tyre për realizimin e investimit sipas parashikimeve të miratuara (procesi i aplikimit të penaliteteve është kompetencë e MEI).
- Nisur nga numri i lartë i HEC-eve të miratuara, por të pa filluara, edhe për periudha të gjata të konsiderueshme të cilët konsiderohen pa shpresë realizimi, nuk është shoqëruar me njoftimet përkatëse për ndërprerjen e kontratës, për t'ia dhënë mundësinë operatorëve të tjerë për realizimin e mundshëm të këtyre investimeve.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion për auditimin e përputhshmërisë:

Në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së AKBN, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të AKBN-së, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e AKBN-së, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë.

II. Baza për opinionin e përputhshmërisë.

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit òAgjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet ISSAI-P1, òDeklarata e Limësö; ISSAI P-10, òDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-tö, si dhe ISSAI P-12, ISSAI P-20, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 òStandardi i Auditimit të Përputhshmërisëö. Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga AKBN dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Në besojmë së dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur gjithashtu mbi gjykimin profesional të audituesit. Gjithashtu, në besojmë së dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

III. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i AKBN-së është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi. Drejtimi është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e buxhetit dhe të pasqyrave të llogaridhënies vjetore në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm efektiv, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

IV. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë *siguri të arsyeshme*, që veprimtaria e AKBN, në të gjitha aspektet, është pa gabime dhe anomali materiale. Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), Objektivi ynë lidhet me *dhënien e sigurisë së arsyeshme* mbi përputhshmërinë e aktivitetit të AKBN, me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare e administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Për këtë audituesit e KLSH, aplikojnë gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese nëpërmjet të cilës, audituesit identifikojnë çështjet më të rëndësishme që trajtohen në raportin e auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e KLSHö, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 1418/1 prot., datë 12.01.2022, nga data 13.01.2022 deri më datë 31.03.2022, në subjektin Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), për periudhën nga data 01.09.2018 deri më datë 31.12.2021, u krye auditimi përputhshmërisë nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1.A.T., Përgjegjës grupi
2. A.B., auditues
3. A.V., auditues
- 4.A.G., audituese
- 5.E.K., audituese

1. Objekti i auditimit: Raport mbi auditimin financiar dhe të Përputhshmërisë në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për periudhën e aktivitetit nga data 01.09.2018 deri më datë 31.12.2021.

2. Objektivat dhe qëllimi: Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse AKBN, në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Auditimi i përputhshmërisë ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

3. Identifikimi i çështjes: Raporti mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të AKBN për periudhën 11.09.2018- 31.12.2021, ka identifikuar sipas kriterëve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.
- Mbi organizimin dhe funksionimin e AKBN.
- Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.
- Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.
- Mbi zbatimin e procesit të prokurimit publik.
- Mbi shfrytëzimin e burimeve hidrokarbure.
- Mbi shfrytëzimin e burimeve minerare.
- Mbi shfrytëzimin e burimeve energjetike.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit,

në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësi të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Strukturat drejtuese, duhet të orientojnë strukturat e institucionit, për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.

5. Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla së si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikes me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

6. Kriteret e vlerësimit: Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 ÷Për auditimin e brendshëm në sektorin publikë i ndryshuar.

- Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 ÷Për Menaxhimin dhe Kontrollim Financiarë i ndryshuar.

- Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 ÷Për tatimin mbi të ardhuratë i ndryshuar.

- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 ÷Për sigurimet shoqërore në RSH, të ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014.

- Ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 ÷Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

- Ligji nr. 162/2020 ÷Për prokurimin publikë.

- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publikë, i ndryshuar; etj (për periudhën e zbatimit).

- Ligji nr.9663, datë 18.12.2006 ÷Për Koncesionetë, i ndryshuar.

- Ligji nr.125/2013 ÷Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privatë, i ndryshuar.

- Ligji Nr. 43/2015 ÷Për Sektorin e Energjisë Elektrike.

- Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 ÷Për taksat kombëtare, i ndryshuar.

- Ligjin nr. 7811, datë 12.04.1994 ÷Mbi sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve.

- Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 ÷Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë.

- VKM nr. 547 datë 09.08.2006 ÷Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, i ndryshuar.

- VKM Nr. 822, datë 07.10.2015 ÷Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni, i ndryshuar.

- VKM nr. 479, datë 29.06.2011 ÷Për miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera normative në zbatim të tyre; VKM nr. (për periudhën e zbatimit).

-VKM nr. 870, datë 14.12.2011 òPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit.

-VKM nr. 997, datë 10.12.2010 òPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda venditò i ndryshuar.

- Statut Rregullorja e AKBN miratuar prej Ministrit me vendimin nr.545 datë 05.07.2018.

- Rregullore e brendshme miratuar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr.7 datë 20.06.2018.

- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publikò, i ndryshuar

- Udhëzimi nr. 7/1 datë 28.02.2018 òPër përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm 2019-2021ò

- Udhëzimi plotësues nr. 7/2 datë 09.07..2018 òPër përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm 2019-2021ò

- Udhëzimi nr. 8, datë 22.02.2019 të Ministrit të Financës òPër përgatitjen e PBA-së 2020-2022ò.

- Ligjit nr. 109/2017 òPër buxhetin e vitit 2018ò

- Udhëzimi i Ministrit të Financave òPër zbatimin e buxhetit (sipas viteve)ò.

7. Standardet e auditimit: Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò;

-Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.

- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;

- ISSAI 400-Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;

- ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisëò;

- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;

- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;

- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI òPër implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisëò; si dhe në praktikat më të mira të fushës.

8. Metodot e auditimit: Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e AKBN, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me aktkonstatimetdhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt-Raporti.

9.Dokumentimi i auditimit: Është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI),për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë.

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Fusha e veprimtarisë së AKBN konsiston në:

- a) Propozimin, konsultimin, dhe bashkëpunimin me strukturat përkatëse të Qeverisë për hartimin e politikave të saj dhe strategjive në fushën e minierave, hidrokarbureve dhe energjisë;
- b) Zbatimin e politikave të Qeverisë në fushën e minierave, hidrokarbureve dhe energjisë;
- c) Sigurimin brenda fushës së veprimtarisë së vet, të oponencës qeveritare për studimet dhe projektet në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe të energjisë, të paraqitura nga subjektet shtetërorë a privatë, vendas ose të huaj. Për raste të veçanta mund të kërkoje asistencë të specializuar;
- d) Promovimin e burimeve minerare, hidrokarbure, hidrike dhe burimeve të rinovueshme të energjisë;
- e) Negocimin e marrëveshjeve hidrokarbure dhe minerare dhe ndjekjen e zbatimit të planeve të zhvillimit të tyre;
- f) Përgatitjen e dokumentacionit dhe praktikave të nevojshme për dhënien e lejeve, të licencave, autorizimeve, në përputhje me ligjin, të cilat mundësojnë hyrjen në marrëveshjet hidrokarbure dhe kryerjen e operacioneve hidrokarbure sipas marrëveshjeve të lidhura;
- g) Ndjekjen e zbatimit të marrëveshjeve të lidhura hidrokarbure;
- h) Mbikëqyrjen e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike;
- i) Realizimin e monitorimit të zonave të shfrytëzuara, të rrezikut minerar dhe të mbylljes së veprimtarisë minerare;
- j) Monitorimin, e kontratave konçensionare për hidrocentralet;
- k) Administrimin ekskluzivisht të të gjitha të dhënave parësore të sektorit hidrokarbur dhe të dhënat që lidhen me veprimtarinë minerare dhe postminerare;
- l) Propozimin e masave për rritjen e shfrytëzimit të energjisë në ciklin energjetik;
- m) Hartimin dhe publikimin e bilancit energjetik vjetor, në nivel kombëtar dhe rajonal, në përputhje me formatet e EUROSTAT-it dhe të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë.

III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur është konstatuar si më poshtë:

III.2.1. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të zbatimit rekomandimeve të lëna nga KLSH-it, pas auditimit të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, dërguar në AKBN me shkresë nr. 1442/7 prot, datë 06.08.2019, dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresë nr. 1442/8 prot, date 06.08.2019 së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit ÷Mbikëqyrja e Shfrytëzimit të Burimeve Hidroenergetike, për periudhën 01.09.2016 deri 31.07.2018.

KLSH ka rekomanduar **21 masa**¹, nga të cilat: **1 masë** për përmirësim ligjor, **12 masa** organizative, **3 masa** shpërblim dëmi, **3 masa** shpërblim dëmi deri në verifikimin e plotë të situatës, **2 masa** për eliminimin e efekteve negative të fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, masa disiplinore **nuk** janë rekomanduar pasi ato janë lënë në kompetencë të shqyrtimit nga Drejtori Ekzekutiv.

Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur nga AKBN rezultoi:

-AKBN ka dërguar në KLSH ÷Planin e Veprimito te miratuar nga Drejtori Ekzekutiv, bashkëngjitur shkresës nr. 06/33 Prot, datë 26.08.2019, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, brenda afatit 20 ditor, të përcaktuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ÷Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i ndryshuar, ka dërguar në KLSH planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në të cilin ka përcaktuar drejtorinë përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit si dhe afatin për kryerjen e detyrave.

-AKBN nuk ka informuar KLSH-në mbi ecurinë e rekomandimeve, brenda afatit 6 muor të përcaktuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ÷Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i ndryshuar, ka dërguar në KLSH informacion në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve sipas kërkesës në shkresën nr. 1442/7 prot, date 06.08.2019.

-Analizuar sipas subjekteve dhe llojit të masave të rekomanduara rezulton së:

-Për **AKBN** nga KLSH me shkresën nr. 1442/7, datë 06.08.2019 janë lënë **11 masa** nga të cilat 6 Masa organizative, 2 Masa për shpërblim dëmi, 2 Masa shpërblim dëmi deri në verifikimin e plotë të situatës dhe 1 Masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

-Për **MIE** janë lënë **10 masa** me shkresën nr. 1442/8, datë 06.08.2019 nga të cilat 1 Masë për përmirësim ligjor, 6 Masa organizative, 1 Masë për shpërblim dëmi, 1 Masë shpërblim dëmi deri në verifikimin e plotë të situatës, 1 Masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

| Nr. | Lloji i rekomandimit | AKBN | MIE | Totali masave | Pranuar (AKBN) | Pa pranuar (AKBN) |
|-----|---|------|-----|---------------|----------------|-------------------|
| 1 | Masa përmirësim ligjor | - | 1 | 1 | - | - |
| 2 | Masa organizative | 6 | 6 | 12 | 6 | - |
| 3 | Masa shpërblim dëmi | 2 | 1 | 3 | 2 | - |
| 4 | Masa shpërblim dëmi deri në verifikimin e plotë të situatës | 2 | 1 | 3 | 2 | - |

¹ Pjesë e këtij auditimi do të jetë verifikimi i zbatimit të rekomandimeve nga AKBN, si subjekt nën auditim sipas programit të auditimit nr. 1418/1 prot, date 12.01.2022, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 1442/7 prot, datë 06.08.2019.

| | | | | | | |
|---|---|----|----|----|----|---|
| 5 | Për eliminimin e efekteve negative të fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike | 1 | 1 | 2 | 1 | - |
| 6 | Masa disiplinore | - | - | - | - | - |
| | Totali | 11 | 10 | 21 | 11 | - |

Niveli i zbatimit të rekomandimeve rezulton si më poshtë vijon:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.1.Rekomandimi: Për të rritur efikasitetin e procesit të monitorimit në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, për rastet e mos raportimit periodik nga ana e shoqërive zhvilluese, MIE të marrë nismat e nevojshme për përmirësimin e bazës ligjore apo dispozitave të kontratës me sanksione penalizuese si dhe të rishikoj kompetencat e AKBN-së si institucionin zbatues të tyre.

Afati: Menjëherë

Grupi Auditimit: Rekomandim për MIE sipas shkresës së KLSH me nr. 1442/8, datë 06.08.2019.

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1.Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të bëjë vlerësimin e duhur të situatës lidhur me parregullsitë e konstatuara, si dhe të marrë masa për sjelljen e procesit brenda òkornizës ligjore. Mbi bazën e gjithë rekomandimeve të shprehura nga AKBN në vijimësi për secilën kontratë nëpërmjet raporteve tremujore të monitorimit apo shkresave të veçanta, të saktësojë penaltetet për moszbatim të kushteve të kontratës dhe të nxjerr aktet e nevojshme administrative për arkëtimin e vlerave përkatëse, një kopje e të cilave të dërgohet pranë AKBN-së.

Afati: Brenda datës 30.11.2019

Grupi Auditimit: Rekomandim për MIE sipas shkresës së KLSH me nr. 1442/8, datë 06.08.2019.

1.2. Rekomandimi: AKBN, për rastet e përmendur më lartë si edhe në të gjitha rastet e mungesës së llogaritjes së penaltetit në raportet e monitorimit apo shkresave të veçanta të llogaris penaltetet e munguara dhe ti dërgoj ato nëpërmjet një raporti të veçantë në MIE.

Brenda datës 31.10.2019

Grupi Auditimit: AKBN me shkresën Nr. 5715/1Prot., date 18.10.2019, ka dërguar në MIE data basë përmbledhëse me të gjitha sanksionet e propozuara për shoqëritë koncesionare për të gjithë periudhën e monitorimit. Shkresa përmban informacion periodik të Raporteve Periodike të Monitorimit, pjesë e të cilave janë edhe propozimet për sanksionet që rrjedhin nga kontratat koncesionare. Kjo shkresë nuk evidenton rastet e mos vendosjes së penalteteve sipas rekomandimeve të KLSH.

Statusi rekomandimit: Në proces zbatimi.

2.1. Rekomandimi: MIE, në rolin e autoritetit kontraktor, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për hartimin e një data bazë ndërvepruese me AKBN dhe plotësimin e saj me të gjitha sanksionet e vendosura sipas raporteve të monitorimit në nivel kontrate dhe HEC-i prej fillimit të veprave si dhe vlerat e arkëtuara prej tyre.

Afati: Brenda datës 30.11.2019

Grupi Auditimit: Rekomandim për MIE sipas shkresës së KLSH me nr. 1442/8, datë 06.08.2019. Por sipas dokumentacionit të paraqitur nga AKBN, rezulton së subjekti nuk ka informacion mbi penalitetet e vendosura në vite nga Autoriteti Kontraktor (MIE).

2.2 Rekomandimi: MIE, në rolin e autoritetit kontraktor dhe organit epror ti garantojë AKBN-së suportin e nevojshëm tekniko ligjor për trajtimin e kontratave, informacione periodike vjetore, të strukturuar lidhur me prodhimin për çdo HEC, si dhe Fee-të përkatëse të mbajtur nga autoritetet. Të kryhen veprimet e nevojshme administrative dhe ligjore për kufizimin e lidhjes së energjisë nga ana e operatorëve shtetërorë pa u kryer më parë testimi i veprës dhe certifikimi i investimit.

Afati: Në vijimësi

Grupi Auditimit: Rekomandim për MIE sipas shkresës së KLSH me nr. 1442/8, datë 06.08.2019.

3.1 Rekomandimi: MIE, në rolin e autoritetit kontraktor, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për lidhjen e kontratave shtesë të përmendura më lartë, por jo vetëm, sipas parametrave të projekt zbatimit të paraqitur prej Oponencës Teknike dhe vlerësuar pozitivisht prej saj.

Afati: Brenda datës 30.11.2019

Grupi Auditimit: Rekomandim për MIE sipas shkresës së KLSH me nr. 1442/8, datë 06.08.2019.

3.2 Rekomandimi: Për të gjitha kontratat me HEC-et në fazë prodhimi të cilat kanë rritje të prodhimit vjetor të energjisë në projekt zbatim, të pa finalizuar ende me kontratë shtesë, AKBN të llogaris vlerën e Fee-së të pa mbajtur dhe të përcjellë aktet përkatës drejt MIE për kontabilizimin dhe vjeljen e detyrimit.

Afati: Brenda datës 30.10.2019

Grupi Auditimit: AKBN dhe MIE kanë ndërvepruar institucionalisht me korrespondencë shkresore lidhur me rekomandimin e dhënë. Nëpërmjet Urdhrit Nr. 340, datë 16.09.2019, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, òMbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, urdhëron si në vijim citojmë: *òDrejtoria e Partneritetit Publik Privat në fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë të marrin masa për draftimin dhe lidhjen e kontratave shtesë, sipas parametrave të projekt zbatimit të vlerësuar pozitivisht prej oponencës teknike.ò* Pavarësisht korrespondencës shkresore, deri në përfundim të këtij auditimi, AKBN nuk paraqiti dokumentacion për ndryshimet me kontratë shtesë, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së.

Statusi rekomandimit: Në proces zbatimi.

4.1 Rekomandimi: Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm, për plotësimin e bazë ligjore lidhur me pagesat e anëtarëve të brendshëm të Grupit të OT-së, i cili òde jureò dhe òde factoò ushtron veprimtarinë si një organ kolegjal.

Afati: Menjëherë

Grupi Auditimit: Rekomandim për MIE sipas shkresës së KLSH me nr. 1442/8, datë 06.08.2019. Por, bazuar në rekomandimin e KLSH-së, Ministri i MIE ka lëshuar Urdhër nr. 398, datë 28.10.2019, për ndryshim në Urdhër nr. 39, datë 18.02.2015 *“Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të grupit të oponencës teknike shtetërore (OTSH) të projekteve të ndërtimit të HEC-ve me koncension në AKBN”*. Me këtë urdhër Ministri urdhëron shfuqizimin e pagesës së anëtarëve ekspert të brendshëm të grupit të Oponencës Teknike. Me daljen e shkresës AKBN nuk ka kryer pagesa për punonjës të saj, anëtarë të grupit të Oponencës Teknike

5.1 Rekomandimi: AKBN, të marrë masat për përfshirjen në raportet e vlerësimit të OT-së të vlerës së investimit dhe makineri dhe pajisjeve në të dy mënyrat, (me TVSh/pa TVSh) si dhe të sanksionohet pagesa e tarifës përpara hyrjes në oponencë.

Afati: Në vijimësi

Grupi Auditimit: AKB në vlerësimin Oponencës Teknike vlerën totale të investimit (me TVSh) sipas projektit të zbatimit dhe vlerën e zërit makineri dhe pajisje (pa TVSh), në përputhje me rekomandimin e KLSH. Ky konstatim i referohet dy praktikave të përzgjedhura në mënyrë rastësore, përkatësisht praktikës Nr. 7037 Prot., date 25.11.2019, oponencë teknike për HEC D dhe praktikës shkresore Nr. 1262/1Prot., date 11.03.2020, oponencë teknike për HEC K. Pagesa e tarifës së oponencës teknike është sanksionuar në nenin 8, pika 2 të *“Rregullores për funksionimin e grupit për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të Hec-ve me koncension, në AKBN* nr. 6453/8 prot, datë 18.10.2010, në të cilën përcaktohet së subjektet përpara kryerjesë oponencës teknike do të kryejnë në AKBN pagesën sipas tarifave përkatëse.

Statusi rekomandimit: Zbatuar plotësisht

5.2 Rekomandimi: Për tre rastet e konstatuara më sipër me llogaritje të pasaktë të tarifës në shumën 5,567,357 lekë, të kryhet rivlerësimi i tarifës në përputhje me procedurat ligjore.

Afati: Menjëherë

Grupi Auditimit:

- Me shkresë nr. 7216, datë 06.12.2019 AKBN ka njoftuar shoqërinë koncesionare “E.V.” sh.p.k. për shlyerjen e diferencës së detyrimit financiar të tarifës së oponencës teknike të projektit të zbatimit për ndërtimin e HEC-v e *“Kaskada Mesmall, 2,3 dhe Selca2”* e cila duhet të paguajë diferencën e tarifës në shumën 983.643 lekë, pagesë e cila duhet të kryhen në llogarinë bankare të AKBN. Pagesa nuk është kryer vullnetarisht, dhe AKBN ka kërkuar në rrugë gjyqësore pagesën e detyrimit, nëpërmjet kërkesë padisë së ngritur prej saj me nr. 239 prot, date 14.01.2022.

- Me shkresë nr. 7217, datë 06.12.2019 AKBN ka njoftuar shoqërinë koncesionare *“NSEö sh.p.k.”* për shlyerjen e diferencës së detyrimit financiar të tarifës së oponencës teknike të projektit të zbatimit për ndërtimin e HEC-ve *“Kaskada e Iballë 1,2,3 dhe Sapaço 1,2”* e cila duhet të paguajë diferencën e tarifës në shumën 3.575.559 lekë, pagesë e cila duhet të kryhen në llogarinë bankare të AKBN. Pagesa nuk është kryer vullnetarisht, dhe AKBN ka kërkuar në rrugë gjyqësore pagesën e detyrimit, nëpërmjet kërkesë padisë së ngritur prej saj me nr. 237 prot, date 14.01.2022

- Me shkresë nr. 7219, datë 06.12.2019 AKBN ka njoftuar shoqërinë koncesionare *“H.H.ö sh.p.k.”* për shlyerjen e diferencës së detyrimit financiar të tarifës së oponencës teknike të projektit të zbatimit për ndërtimin e HEC-v e *“Kaskada e Hotolishtitö”* e cila duhet të paguajë diferencën e tarifës në shumën 1,008,155 lekë, pagesë e cila duhet të kryhen në llogarinë bankare

të AKBN. Pagesa nuk është kryer vullnetarisht, dhe AKBN ka kërkuar në rrugë gjyqësore pagesën e detyrimit, nëpërmjet kërkesë padisë së ngritur prej saj me nr. 241 prot, date 14.01.2022.

Statusi rekomandimit: Në proces zbatimi.

6.1 Rekomandimi: MIE, të rishikojë rolin vendimmarrës të ekspertëve të jashtëm në grupin e Oponencës Teknike sipas rregullores, të plotësohen aktet e nevojshme rregullative për kontraktimin e tyre konform kritereve të duhura arsimore dhe profesionale nëpërmjet një procesi transparent dhe jo diskriminues.

Afati: Brenda datës 30.09.2019

Grupi Auditimit: Rekomandim për MIE, sipas shkresës së KLSH me nr. 1442/8 prot, date 06.08.2019. Lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimit, nga AKBN nuk paraqit asnjë masë e dalë/ndryshuar nga MIE në zbatim të këtij rekomandimi.

6.2 Rekomandimi: AKBN, të plotësojë profilet e munguara në stafin e Drejtorisë së Monitorimit të HEC-eve si dhe të përcaktojë kritere më të larta profesionale dhe eksperience për rekrutimet e reja.

Afati: Në vijimësi

Grupi Auditimit: AKBN ka vijuar me zbatimin e këtij rekomandimi duke vene kriteret e duhura për rekrutimet e reja për Drejtorinë e Monitorimit të Hec-ve. Në çdo rast kur ka patur periudha rekrutimi, Drejtoria e Monitorimit të Hec-ve, ka paraqitur zyrtarisht kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët përkatës në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës e cila me pas ka bere shpalljet për vendet e lira me kriteret e duhura, *në faqen zyrtare të AKBN*.

Në Drejtorinë e Monitorimit të HEC-ve, ka pasur lëvizje për periudhën pas auditimit të KLSH-së, por ende janë pa plotësuar 2 pozicione pune në Sektorin e Monitorimit të Kontratave Koncesionare të HEC-ve dhe një pozicion në Sektorin e Certifikimit të Investimeve.

Statusi rekomandimit: Në proces zbatimi.

6.3 Rekomandimi: AKBN, të marrë masat e nevojshme për eliminimin e vonesave në paraqitjen e projekteve dhe vlerësimin e tyre në OT duke respektuar radhën e shqyrtimit sipas modelit FIFO.

Afati: Në vijimësi

Grupi Auditimit: Grupi Oponencës Teknike ka minimizuar shqyrtimin e projekteve dhe vlerësimin e tyre duke respektuar radhën e shqyrtimit sipas modelit FIFO, me përjashtim të rasteve të mungesës së dokumentit të pagesës së tarifës së OT, deri në plotësimin kritereve ligjore nga pala e interesuar.

Statusi rekomandimit: Në proces zbatimi.

C.1 MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Rekomandimi: MIE, në rolin e autoritetit kontraktor, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative dhe ligjore për rikuperimin e vlerës së munguar në buxhet për 23 kontratat e trajtuara në vlerën rreth 22,820 mijë lekë.

Afati: Menjëherë

Grupi Auditimit: Rekomandim i drejtohet MIE-s, sipas shkresës së KLSH me nr. 1442/8 prot, date 06.08.2019.

2.1 Rekomandimi: Nga AKBN, të ndiqet rruga ligjore për arkëtimin diferencës së tarifës prej 7,020,000 lekë si dhe të merren masat e nevojshme për mos përsëritjen e problematikës në vijim.

Afati: Menjëherë

Grupi Auditimit: Nga auditimi mëparshëm është konstatuar sipëri datës 21 Mars 2017 si datë e hyrjes në fuqi për ndryshimet deri më 31 Dhjetor 2018, në 169 fatura të prera shërbim oponente teknike nuk është llogaritur TVSH e shërbimit. Vlera e munguar në buxhetin e njësisë publike nga mos llogaritja e saktë e TVSH-së kap shumën prej **7,020,000 lekë** (35,100,000 x 20%).

Në zbatim të këtij rekomandimi, për periudhën 2016-2018, nga AKBN u paraqit data basë (në Excel) të shkresave të dërguara subjekteve për 191 raste, në të cilat AKBN ka llogaritur TVSH në shumën **8,160,000 lekë** ose 1,140,000 lekë më shumë së rekomandimi lënë.

Sipas të dhënave të AKBN detyrimi është arkëtuar në shumën 3,640,000 lekë dhe rezultoi i pa arkëtuar detyrimi për TVSH në shumën 4,520,000 leke.

Statusi rekomandimit: Në proces zbatimi

3.1 Rekomandimi: Nga AKBN, të ndiqet rruga ligjore për arkëtimin vlerës së tarifave të munguara në shumën prej 1,617,463 lekë, e cila mungon në buxhetin e njësisë publike.

Afati: Menjëherë

Grupi Auditimit: Nga Drejtoria e Monitorimit të Hec-ve dhe Drejtoria Ekonomike nuk u paraqit dokumentacion lidhur me arkëtimin e shërbimit për oponente teknike në shumën **1,617,463 lekë** (me TVSh) sipas rasteve si më poshtë vijon:

1. Shoqëria E.sh.p.k., për HEC òO për arkëtimin e tarifës së oponentit teknike **240,000 leke** (me TVSh), lidhur me projekt zbatimin dt. 29.08.2016. Pagesa e tarifës rezultoi e paguar pas oponentit teknike nëC.B., datë 25.03.2019 në shumën 200.000 leke. Por AKBN nuk ka njoftuar shoqërinë për pagesën e Tvsh së pa faturuar për tarifën e shërbimit në shumën 40.000 lekë.

2. Shoqëria òI.ö sh.p.k., për HEC òK për arkëtimin e tarifës së oponentit teknike **240,000 leke** (me TVSh), lidhur me projekt zbatimin dt. 22.05.2017. Pagesa e tarifës rezultoi e paguar pas oponentit teknike nëC.B., datë 02.04.2019 në shumën 200.000 leke. Por AKBN nuk ka njoftuar shoqërinë për pagesën e Tvsh së pa faturuar për tarifën e shërbimit në shumën 40.000 lekë.

3. Shoqëria òI.ö sh.p.k., për HEC òA për arkëtimin e tarifës së oponentit teknike **240,000 leke** (me TVSh), për projekt zbatimin dt. 22.05.2017. Pagesa e tarifës rezultoi e paguar pas oponentit teknike nëS.G., datë 02.04.2019 në shumën 200.000 leke. Por AKBN nuk ka njoftuar shoqërinë për pagesën e Tvsh së pa faturuar për tarifën e shërbimit në shumën 40.000 lekë.

4. Bashkimit të përkohshëm të shoqërive òE.ö sh.p.k. dhe òS.A.ö, për HEC òP” për arkëtimin e tarifës së oponentit teknike **897,463 leke** (me TVSH). Lidhur me këto shoqëri, AKBN ka dërguar shkresë njoftuese me nr. 2633 Prot., date 11.06.2020 mbi shlyerjen e detyrimit të oponentit teknike për projektin e zbatimit të Hec-ve òP, duke kërkuar shlyerjen e detyrimit në shumën **866,808 leke** (me TVSH) ose me pak 30,655 lekë së rekomandimi, detyrime akoma të pa arkëtuara. Në kushtet e mos pagesës së detyrimit, Drejtoria e Shërbimeve Ligjore ka hapur procesin Gjyqësor me kërkesë padinë Nr. 240 Prot. Datë 14.01.2022.

Statusi rekomandimit: Në proces zbatimi.

C.1.1 MASA SHPËRBLIM DËMI DERI NË VERIFIKIMIN E PLOTË TË SITUATËS

1.1 Rekomandimi: AKBN të dërgojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve informacion të strukturuar për të gjithë shoqëritë zhvilluese me NIPT-et përkatës, të cilat nuk disponojnë leje për kryerjen e punimeve të ndërtimit apo kanë vijuar ndërtimin në tejkalim të lejes (pavarësisht fazës ku ndodhen ndërtim/prodhim) si dhe të kërkojnë informacion lidhur me shumën e TVSh-së

të përfituar padrejtësisht prej tyre. Mbi bazën e përgjigjes së DPT-së të informohet Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Afati: Brenda datës 31.08.2019

Grupi Auditimit: AKBN ka dërguar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. 06/41 prot, date 12.09.2019, në të cilën përveç të tjerash ka dërguar informacion për të gjitha shoqëritë zhvilluese, të cilat nuk disponojnë leje për kryerjen e punimeve ose kane tejkaluar lejet e punimeve të miratuara.

Statusi rekomandimit: Zbatuar plotësisht.

1.2 Rekomandimi: Të intensifikohet bashkëpunimi i AKBN-së me organet fiskale për HEC-et në fazë ndërtimi, në kuadër të marrëveshjes së lidhur, nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve apo kryerjes së kontrolleve të përbashkëta.

Afati: Në vijimësi

Grupi Auditimit: Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Nr. 9689, date 06.11.2015, neni 2, pika 2, AKBN me shkresën nr. 06/41 prot, datë 12.09.2019, ka kërkuar nga DPT informacion lidhur me shumën e TVSH-së të përfituara padrejtësisht prej këtyre shoqërive. bashkëlidhur shkresës gjendet tabela me informacion të strukturuar për të gjitha shoqëritë zhvilluese me NIPT-et përkatëse, të cilat nuk disponojnë leje për kryerjen e punimeve të ndërtimit apo kane vijuar ndërtimin në tejkallim të lejes përkatëse. Ajo i ka propozuar Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve të rakordojë dhe bashkëpunojë me AKBN lidhur me kreditimin e TVSh-së.

Statusi rekomandimit: Zbatuar plotësisht.

2.1 Rekomandimi: MIE, sipas propozimeve të rekomanduara nga AKBN të nxjerr aktet e nevojshme administrative për arkëtimin e vlerës së sanksioneve të cilat rezultojnë të pazbatuara prej rreth 2,025,281 mijë lekë, si dhe të informoj Kontrollin e Lartë të Shtetit për kontabilizimin e tyre.

Afati : Menjëherë

Grupi Auditimit: Rekomandim i drejtohet MIE-s, sipas shkresës së KLSH me nr. 1442/8 prot, date 06.08.2019, pasi në cilësinë e Autoritetit kontraktor gëzon të drejtën për aplikimin dhe vjeljen e detyrimeve.

C.2 MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1 Rekomandimi: AKBN, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative për vënien në funksion të sistemit Rev Zonë, për protokollin e brendshëm dhe veprimtarinë hidroenergjetike për të garantuar përdorimin me efektivitet dhe efencë të fondeve publike.

Afati: Brenda datës 30.09.2019

Grupi i auditimit: Në kuadër të digjitalizimit të AKBN, grupi auditimit të KLSH-së, konstaton se sistemi REV-Zone vazhdon të përdoret kryesisht nga subjekte që ushtrojnë veprimtari në sektorin minerar. Ky sistem ende nuk është bere i përdorshëm nga subjekte që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin hidrokarbur dhe energjetik, megjithëse nga Drejtoria e Monitorimit të

HEC-ve janë dërguar shkresa përkatëse për shoqëritë koncesionare me të cilat kërkon të dhëna të përgjithshme me qëllim raportimin prej tyre online në sistemin REV-Zone.

Në portalin zyrtar AKBN nga sistemi REV-ZONE nuk janë pasqyruar të dhëna mbi aktivitetin në sektorin mineral pas vitit 2020, duke mos bërë publikim i të dhënave sipas këtij sistemi.

Statusi rekomandimit: Pa zbatuar

2.1 Rekomandimi: Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, të shfuqizojë urdhrin për shpërblimin e anëtarëve të brendshëm pjesë e Oponencës Teknike i cili është në kundërshtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë kompetencën e dhënies dhe masës së shpërblimit.

Afati: Menjëherë

Grupi i auditimit: Rekomandim i drejtohet MIE-s, sipas shkresës së KLSH me nr. 1442/8 prot, date 06.08.2019. Por AKBN, bazuar në rekomandimin e KLSH-së, paraqiti Urdhrin nr. 398, datë 28.10.2019 të Ministrit të MIE, për ndryshim në Urdhrin nr. 39, datë 18.02.2015 òPër miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të grupit të oponencës teknike shtetërore (OTSH) të projekteve të ndërtimit të HEC-ve me koncesion në AKBN. Më këtë urdhër Ministri urdhëron shfuqizimin e pagesës së anëtarëve ekspert të brendshëm të grupit të Oponencës Teknike. Efektet financiare të shkresës fillojnë menjëherë, dhe pas daljes së saj AKBN nuk ka pagesa për punonjës të AKBN, anëtarë të grupit të Oponencës Teknike.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 òKodi i Punës, i ndryshuar, nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2, Statut-Rregulloren e Funkcionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, neni 26, si dhe kontratave individuale të punës, për shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Drejtorit Ekzekutiv që: òNë bazë të analizës së përgjegjësive, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, me qëllim fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore përkatëse.

Grupi i auditimit: Grupi i auditimit vlerëson së Drejtoria e Monitorimit të HEC-ve dhe Drejtoria e Administratës, nuk kanë analizuar dhe vlerësuar shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe nuk kanë zbatuar Planin e Veprimit të AKBN, miratuar për zbatim nga Drejtori Ekzekutiv.

Statusi rekomandimit: Pa zbatuar

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton së:

1. AKBN, ka kthyer përgjigje në KLSH, nëpërmjet shkresës Nr. 06/33 prot., datë 26.08.2019, duke respektuar afatin 20 ditor.
2. AKBN nuk ka informuar KLSH-në mbi ecurinë e rekomandimeve, brenda afatit 6 mujor të përcaktuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.
3. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit me shkresë nr. 1442/7 prot, datë 06.08.2019, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

| Nr. | Lloji i rekomandimit | Pranuar | Pranuar | Statusi i zbatimit | | | |
|-----|----------------------------|---------|---------|--------------------|--------------------|-------------------|------------|
| | | | | Zbatuar | Zbatuar pjesërisht | Në proces zbatimi | Pa zbatuar |
| 1 | Masa për përmirësim ligjor | - | - | - | - | - | - |

| | | | | | | | |
|---|--|----------------|----------------|---|---|----------------|---|
| 2 | Masa organizative | 6 | 6 | 1 | - | 5 | - |
| 3 | Masa shpërblim dëmi | 2 | 2 | - | - | 2 | - |
| | | 8,637,463 lekë | 8,637,463 lekë | | | 5,537,463 lekë | |
| 4 | Masa shpërblim dëmi deri në verifikimin e plotë të situatës | 1 | 1 | 1 | - | - | - |
| 5 | Për eliminimin e efekteve negative të fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike | 1 | - | - | - | - | 1 |
| 6 | Masa disiplinore | - | - | - | - | - | - |

KONKLuzion:

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresë nr. 1442/7 prot., datë 06.08.2019, nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore rezulton së nga **11** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi, 3-E, të ardhura të munguara, paligjshmëri në procedurat e prokurimit, pagesa të kryera në mënyrë jo të rregullt administrative dhe disiplinore*), nga subjekti janë pranuar **11** masa ose 100% e rekomandimeve. Nga **11** masat e pranuar subjekti ka zbatuar plotësisht **3** masa, përkatësisht **1** masë organizative dhe **2** masa shpërblim dëmi me verifikim situatë (*pa vlerë financiare*), ka në proces zbatimi **5** masa organizative dhe **2** masa shpërblim dëmi në shumën prej 5,537,463 lekë ose 64,11% të dëmit të konstatuar, nuk ka zbatuar **1** masë për eliminimin e efekteve negative të fondeve publike. Drejtoria e Monitorimit të HEC-ve dhe Drejtoria e Administratës, nuk ka analizuar dhe vlerësuar shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Nga sa shikohet niveli i realizimit plotësisht është shumë i ulët, situatë e cila tregon së Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore nuk e ka vlerësuar plotësisht dhe drejt procesin e zbatimit të rekomandimeve.

III.2.2. Mbi organizimin dhe funksionimin e AKBN.

a. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit Drejtues.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 547, datë 9.8.2006 *“Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore*”, i ndryshuar. Në zbatim të pikës 7, të VKM Nr. 547, datë 09.08.2006 është miratuar Statut-Rregullorja e AKBN me status juridik **“ent publik”** në varësi të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë. Objekti i veprimtarisë së këtij institucioni është zhvillimi dhe mbikëqyrja e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, monitorimi i postshfrytëzimit të tyre në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energji. Funksionimi, struktura organizative dhe struktura e pagave të AKBN përcaktohen në

Statut- Rregulloren e AKBN-së, të ndryshuar, ndërsa marrëdhëniet e punës së punonjësve rregullohen sipas Kodit të Punës.

Organet drejtuese të AKBN-së, bazuar në nenin 7 të Statut-Rregullores së saj, të ndryshuar, janë:

1. Këshilli Drejtues
2. Drejtori Ekzekutiv
3. Zv./Drejtori Ekzekutiv

Këshilli Drejtues (KD) është organ kolegjal vendim-marrës, për mbikëqyrjen e funksionimit dhe veprimtarisë së AKBN-së, i cili përbëhet nga 7 anëtarë dhe kryesohet nga Kryetari, që emërohen dhe lirohen nga Ministri.

Funksionimi Këshillit Drejtues bëhet nëpërmjet mbledhjes së anëtarëve të tij dhe marrjes së vendimeve. Mbledhjet e KD zhvillohen jo më pak se një herë në tre muaj, të cilat drejtohen nga Kryetari. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm dhe në raste kur numri i votave është i barabartë, vota e Kryetarit është vendimtare. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues, caktohet sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Masa për shpërblimin e anëtarëve të KD sipas Statut Rregullores së AKBN, mbështet në Vendimin nr. 5 datë 05.04.2007 të KD, miratuar me shkresë nr. 2637, datë 11.04.2007 të ish Ministrisë të ish Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Vendimi përcakton së shpërblimi bëhet çdo muaj, për Kryetarin në raportin 25% të pagës mujore të Kryetarit të AKBN-së, për anëtarët në raportin 20% të pagës mujore të Kryetarit të AKBN-së, dhe për sekretarin teknik 10% të pagës mujore të Kryetarit të AKBN-së.

Drejtori Ekzekutiv emërohet dhe lirohet nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë. Për përmbushjen e misionit, për të cilin është krijuar AKBN, drejtori ekzekutiv organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë nëpërmjet urdhrave dhe udhëzimeve, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me Statut-Rregulloren e AKBN-së.

Për shqyrtimin e projekteve të shfrytëzimit të burimeve natyrore funksion **Këshilli Teknik** në përputhje me *ōRregulloren për Funksionimin e Këshillit Teknik të AKBN*”, miratuar me Vendim nr. 3, datë 18.01.2010 të Këshillit Drejtues të AKBN-së. Këshilli Teknik është organ kolegjal, vendimmarrës, i përhershëm, me anëtarë punonjës të AKBN-së, i miratuar me Urdhër të Drejtorit Ekzekutiv.

Zv/Drejtori Ekzekutiv emërohet dhe lirohet nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së. Ai ka kompetencë të ndihmojë, Drejtorin Ekzekutiv për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të tij, bashkërendojë punën në drejtimin e fushës së veprimtarisë të AKBN-së, zëvendëson Drejtorin Ekzekutiv, në kuptim të nenit 34/1 të Kodit të Procedurës Administrative, me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv, etj.

Këshilli Drejtues ka zhvilluar mbledhje sipas kompetencave të njohura në Statut-Rregullore, neni 10, duke dokumentuar çdo mbledhje me procesverbal të nënshkruar Kryetari, Sekretari dhe anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Këshilli Drejtues ka zhvilluar veprimtarinë e tij, nëpërmjet mbledhjeve të anëtarëve dhe marrjes së **11 vendimeve** për vitin 2018, marrjes së **12 vendimeve** për vitin 2019, marrjes së **5 vendimeve** për vitin 2020 dhe **9 vendimeve** për vitin 2021, duke përmbushur detyrimin statusor të realizimit të paku një mbledhje në çdo tremujor.

Anëtarët e KD për pjesëmarrjen në mbledhje janë shpërblyer bazuar në Vendimin e KD nr. 5, datë 5.4.2007, miratuar Ministri MIE (ish-METE) me shkresën nr. 2637, datë 11.4.2007. Për periudhën objekt auditimi, shpërblimet për pjesëmarrje në mbledhje të anëtarëve të KD llogariten në listë pagesën mujore dhe pasi mbahet tatim në burim kryhet pagesa në llogaritë personale të anëtarëve të KD. Shpërblimi për Këshillin Drejtues është **përfitur çdo muaj, me përjashtim**

të pagesës të muajit Prill 2020 në shumen 222,890 leke, Maj 2020 në shumen 222,890 leke dhe Qershor 2020 në shumen 222,890 leke, te cilat bazuar në piken 6, të VKM nr. 267, datë 31.3.2020 òPër trajtimin e përkohshëm financiar mujor të disa funksionarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë shkaktuar nga Covid-19 janë arkëtuar pranë fondit COVID-19 me numër llogarie X.

Tabela nr.1: Shuma bruto për pagesat e anëtarëve e Këshillit Drejtues të AKBN

| Viti | Shuma Bruto (Lekë) |
|------------------|--------------------|
| 3-mujori IV/2018 | 891,560 |
| Viti 2019 | 2,516,500 |
| Viti 2020 | 1,876,590 |
| Viti 2021 | 2,502,120 |

Burimi: AKBN

Këshilli Drejtues me **Vendimin nr. 11, datë 27.12.2018**, ka kërkuar në MIE miratim për ndryshimin e Buxhetit të vitit 2018. Vendimi është mbështetur në proces verbalin e datës 27.12.2018 të KD, në relacionin e Drejtorit Ekzekutiv nr. 9826/2 prot, dt. 27.12.2018, shkresën nr. 9826/1, dt. 27.12.2017 të Drejtorisë së Administratës.

Ndryshimi buxhetit të vitit 2018 është miratuar me Urdhër të Ministrit të MIE nr. 897 prot, datë 27.12.2018 shoqëruar me tabelave bashkëlidhur, duke shtuar te ardhurat në zërin òTë ardhura nga marrëveshjet hidrokarbureo në shumën 40,000,000 lekë dhe duke pakësuar shpenzimet në zërin òPaga të punonjësveo në shumën 7,755,000 lekë dhe shtuar zërin òShpërblim për punonjësitò në shumën 7.650.000 lekë dhe shtuarzërin òShpërblim për Këshillin Drejtuesò në shumën 105.000 lekë.

Pas miratimit nga Ministri MIE-s të ndryshimit të zërave të buxhetit 2018, Drejtori Ekzekutiv ka lëshuar Urdhër nr. 442, date 28.12.2018, nëpërmjet të cilit ka urdhëruar shpërblimin për 7 anëtarë aktual të KD, me gjysmë page mujore nga fondi òShpërblim për Këshillin Drejtuesò. Paga për shpërblim është kryer me Urdhër Transfertë nr. 948, datë 31.12.2018, në vlerën **88,617 lekë**, pas mbajtjes dhe derdhjes së tatimit në burim në shumën 15.638 lekë.

Nga auditimi rezulton së:

1. Referuar **Vendimit nr. 11/2008 të KD**, shpërblimi anëtarëve të tij është në mospërputhje me Vendimin e KD nr. 5/2007 të AKBN, miratuar nga Ministri METE (sot MIE) me shkresën nr. 2637 prot, datë 11.04.2007, dalë në bazë të Statut Rregullore të AKBN, neni 10 pika 8. Vendimi rregullon masën e òshpërblimit mujorò të anëtarëve të KD për **pjesëmarrje në mbledhje** të Kryetarit dhe anëtarëve të KD dhe **jo për shpërblimin në fund** të vitit për performancë të KD.

Statut Rregullore AKBN

Kompetencat e Këshillit Drejtues: "Aprovon strukturën e pagave e shpërblimeve dhe ia paraqet ato, për miratim, Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë."(neni 10, pika 8)

Kjo dispozitë përcakton së KD miraton strukturën e pagave dhe shpërblimeve për punonjësit dhe jo për anëtarët e KD, pasi në të kundërt do të ndodheshim në kushtet e òKonfliktit të interesitò ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë, pasi KD si organ vendimmarrës vendos për masën e shpërblimit të punës së tij. Pra vendimmarrja KD me Vendimin nr.11, datë 27.12.2018, ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas nenit 3, pika 1 të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 òPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeo, i ndryshuar,

Në këto kushte shpenzimi kryer në fund të vitit 2018 për shpërblimin e anëtarëve të KD, gjendet në kushtet interpretimit të gabuar të akteve rregullative/Statut Rregullorja (neni 8, pika 4 dhe neni 10, pika 8) dhe konfliktit faktik të interesit (neni 3, pika 1 Ligji 9367/2005), rrethanë që ka sjellë për pasojë përdorim jo efektiv të fondeve buxhetore të AKBN në vlerën **88,617 lekë**.

Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005

“Qëllimi i këtij ligji është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta”. (neni 1)

1. "Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe te përgjegjësive të tij publike. (neni 3, pika 1)

2. "Kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësive" është mënyra e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, të materializuara në një vendimmarrje, në të cilën zyrtari vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje, në çdo rast, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit. (neni 3 pika 2)

2. Pagesat e bëra për anëtarët e Këshillit Drejtues për òshpërblim vjetorò, nuk janë në përputhje me nenin 8 pika 4 të Statut Rregullores, pasi mungon referenca ligjore që legjitimon shpërblimin e dhënë .

Statut Rregullore AKBN

Këshilli Drejtues: “1. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues, caktohet sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.” (neni 8, pika 4)

3. Proces verbali i datës 27.12.2018, për mbledhjen e KD të AKBN, në pjesën përshkruese nuk përmban propozim nga pjesëmarrësit në mbledhje për shpërblim të anëtarëve të KD. Në dokumentacionin mbështetës të shpërblimit të dhënë për KD nga Drejtori Ekzekutiv me shkresë nr. 9826/2 prot, datë 27.12.2018 është paraqitur relacion òPër ndryshim në buxhetin e vitit 2018ò, ku përveç rritjes së të ardhurave, ndryshojnë edhe zërat e shpenzimeve duke pakësuar zërin e òPaga të punonjësveò dhe shtuar zërin òShpërblim për punonjësit dhe Këshillin Drejtuesò, pa efekt në totalin e shpenzimeve, të pa trajtuara në proces verbal përpara i përket shpërblimit të anëtarëve të KD.

4. Nxjerrja nga Drejtori Ekzekutiv i Urdhrit nr. 442, datë 28.12.2018, òPër Shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të AKBN”, nuk është në përputhje me nenin 12/1 të Statut Rregullores së AKBN-së, pasi kjo dispozitë në kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv parashikon organizim dhe drejtim pune dhe nuk përmban shpërblim për anëtarët e KD, kompetencë kjo e Këshillit Drejtues (neni 10 pika 8). Funkzioni i Drejtorit Ekzekutiv është raportimi përpara Këshillit Drejtues mbi gjendjen financiare të njësisë shpenzuese, realizim buxheti sipas pasqyrave financiare, etj.. dhe administrimi fondeve në bazë të buxhetit të aprovuar nga Këshilli Drejtues (neni 12).

Konkluzion: Shpenzimet e bëra nga AKBN për shpërblim në fund viti për anëtarët e Këshillit Drejtues në shumën neto **88,617 lekë**, përbëjnë përdorim pa efektivitet fondeve te parashikuara për shpenzime gjatë vitit buxhetor. Shpenzimi i burimeve financiare të institucionit për pagesat e bonuseve/shpërblimeve për anëtarët e KD, nga njësia shpenzuese mund të përdoret në

mënyrë më të drejtë duke i kushtuar prioritet pagesave të detyrimeve të tjera, pasi dhe institucioni paraqitet në vështirësi ekonomike financiare.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me kriteret ligjore dhe nënligjore të përcaktuara në:

1.Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 òPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò, i ndryshuar, neni 1, neni 3.

2.Statut Rregullor e AKBN, neni 10, pika 8, neni 8 pika 4.

Veprimet e mësipërme janë në kompetencë të:

1.Drejtorit Ekzekutiv z. A.B. dhe

2.Këshillit Drejtues përfaqësuar nga ish-Kryetari z. G.K..

| Titulli i Gjetjes | Pagesa për shpërblimin e anëtarëve të KD |
|-----------------------|---|
| Situata | Këshilli Drejtues me Vendimin nr. 11, datë 27.12.2018 , ka kërkuar në MIE miratim për ndryshimin e Buxhetit të vitit 2018. Vendimi është mbështetur në proces verbalin e datës 27.12.2018 të KD, në relacionin e Drejtorit Ekzekutiv nr. 9826/2 prot, dt. 27.12.2018, shkresën nr. 9826/1, dt. 27.12.2017 të Drejtorisë së Administratës. Ndryshimi buxhetit të vitit 2018 është miratuar me Urdhër të Ministrit të MIE nr. 897 prot, datë 27.12.2018 shoqëruar me tabelave bashkëlidhur, duke <u>shtuar</u> te ardhurat në zërin òTë ardhura nga marrëveshjet hidrokarbureò në shumën 40,000,000 lekë dhe duke <u>pakësuar</u> shpenzimet në zërin òPaga të punonjësveò në shumën 7,755,000 lekë dhe <u>shtuar</u> zërin òShpërblim për punonjësitò në shumën 7.650.000 lekë dhe <u>shtuar</u> zërin òShpërblim për Këshillin Drejtuesò në shumën 105.000 lekë. Pas miratimit nga Ministri MIE-s të ndryshimit të zërave të buxhetit 2018, Drejtori Ekzekutiv ka lëshuar Urdhër nr. 442, date 28.12.2018, nëpërmjet të cilit ka urdhëruar shpërblimin për 7 anëtarë aktual të KD, me gjysmë page mujore nga fondi òShpërblim për Këshillin Drejtuesò. Pagesa për shpërblim është kryer me Urdhër Transfertë nr. 948, datë 31.12.2018, në vlerën 88,617 lekë , pas mbajtjes dhe derdhjes së tatimit në burim në shumën 15.638 lekë. |
| Kriteri | -Ligji nr. .9367, datë 7.4.2005 òPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò i ndryshuar neni 1 dhe neni 3 -Statut Rregullor e AKBN-së, neni 8 pika 4; neni 10 pika 8. |
| Ndikimi/Efekti | Përdorim jo efektiv i fondeve buxhetore të AKBN në kryerjen e shpenzimeve (shpërblim) për anëtarët e KD, në vlerën neto 88,617 lekë . |
| Shkaku | Vendimmarrje në kushtet e konfliktit të interesit në lidhje me shpërblimin e anëtarëve të KD dhe interpretimit të gabuar i akteve rregullative /Statut Rregullorja (neni 8, pika 4 dhe neni 10 pika 3 dhe pika 8). |
| Rëndësia | I mesëm |
| Rekomandim | Të merren masa për përmirësimin e nenit 10, pika 8, të Statut Rregullores për përcaktimin e kriterëve në rastet e shpërblimit për anëtarët e Këshillit Drejtues për performancë në punë, duke reflektuar ndryshimet në aktet e dala në zbatim Statut Rregullores. |

SITUATA: Vendimi Qarkullues nr. 15, datë 22.09.2020 i Këshilli Drejtues ka dalë në procedurë të zbatimit të shkresës së MIE me nr. 6452 prot, datë 10.09.2020. Ekzekutimi shpërblimit e ka fillësën në Urdhrin nr. 424, datë 12.11.2019 të Ministrit MIE, për ngritjen e grupit negociator për fillimin e negociatave për lidhjen e Marrëveshjes Hidrokarbure, në formën e kontratës me ndarje prodhimi, kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi hidrokarburesh në bllokun

ōDumreaō në tokē. Grupi negociator i ngritur nga MIE pērbēhet nga 5 (pesē) anētarē tē MIE dhe 3 (tre) anētarē tē AKBN.

Ministri me shkresēn nr. 6452 prot, datē 10.09.2020 vlerēson rezultatet e arritura nga Grupi Negociator pēr punēn e kryer, dhe pēr arritjen e kētij rezultati pērcakton shpērbllim tē Grupit Negociator nē masēn njē pagē e gjysmē tē pagēs sē Drejtorit Ekzekutiv tē AKBN-sē, nga fondet e zērit ōBonus i firmosjes nē vlerēn 4.000.000 USDō.

Me shkresēn ōMemoō nr. 1625/14 prot, datē 18.09.2020 tē Drejtorisē Hidrokarbure z. A.M., z.E.K.dhe z. B.P., referuar shkresēs 6452, dt 10.09.2020 tē Ministrit, bazuar nē nenin 113 tē Kodit tē Punēs, i kanē kērkuar Drejtorit Ekzekutiv shpērbllim grupit te angazhuar intesivisht nē kētē proces (jō grupi negociator), duke vlerēsuar kontributin e tyre pēr pjesēn teknike dhe ligjore lidhur me marrēveshjen hidrokarbure.

Mē tej Drejtoria Ekonomike nē AKBN ka paraqitur pērpara Kēshillit Drejtues tē AKBN-sē, ōRelacionr. 1625/15 prot, datē 18.09.2020, pēr ndryshime nē buxhetin e vitit 2020ō duke llogaritur shpenzimet totale pēr shpērbllim **2,372,700 lekē, bazuar nē:**

1.Shkresēn e MIE-s nr. 6452 dt. 10.09.2020 llogaritje e shpenzimeve tē anētarēve tē grupit negociator, duke shtuar zērin e shpenzimeve ō*Shpērbllime pēr grupin negociator pēr lidhjen e MH...*” pēr 5 pjesētarē tē MIE-es nē shumen =1,078,500 leke dhe 3 pjesētarē tē AKBN-sē nē shumēn =647,100 lekē, nē total = **1,725,600 lekē**

2.Shkresēs ōMemoō tē AKBN me nr. 1625/14 dt. 18.09.2020, llogaritje e shpenzimeve pēr 3 punonjēs tē AKBN-sē, tē cilēt nuk janē pjesē e grupit negociator, duke shtuar zērin e shpenzimeve ō*Shpērbllime pēr grupin negociator pēr lidhjen e MH...*ō nē total = **647,100 lekē.**

Kēshilli Drejtues i AKBN me **Vendim Qarkullues nr.15, datē 22.09.2020**, ka miratuar ndryshimin e buxhetit tē vitit 2020 sipas tabelēs bashkēlidhur relacionit dhe me shkresēn nr. 1625/17 prot, datē 22.09.2020 ka dērguar vendimin pēr miratim nē MIE. Ministri i MIE me shkresē nr. 6736/1 prot, datē 02.10.2020, protokolluar nē AKBN me nr. 1625/18, dt 05.10.2020, ka miratuar ndryshimin e buxhetit viti 2020 sipas Vendimin nr. 15, datē 22.09.2020 tē AKBN.

Vendimi ka kaluar pēr njohje dhe zbatim me shkresē nr. 1625/19 prot, datē 14.10.2020 pēr Drejtorinē Ekonomike dhe Drejtorinē e Administratēs.

Drejtori Ekzekutiv i AKBN ka nxjerrē Urdhēr nr. 94, datē 20.10.2020 pēr shpērbllimin e grupit tē angazhuar nē procesin e negociatave me shoqērinē E.A. B.V, nē masēn e njē page e gjysmē tē Drejtorit Ekzekutiv tē AKBN.

Lidhur me kryerjen e pagesēs nga **Drejtoria e Administratēs** ka hartuar liste pagesat e muajit Tetor 2020, nē tē cilēn ka pērfshirē pagesēn pēr shpērbllimin e çdo personi si mē poshtë:

- Pagesēn nē masēn 215,700 lekē (shuma bruto) pēr punonjēs tē MIE, njēkohēsisht anētarē tē Kēshillit Drejtues, dhe pjesētar tē grupit negociator, pērkatēsisht z. I.B.dhe z. I.G., pēr te cilēt pasi ēshtë mbajtur tatimi nē burim pēr tē ardhurat mujore, shpērbllimi ēshtë kaluar nē llogaritē personale, datē 30.10.2020

- Nē masēn 215,700 lekē (shuma bruto) pēr punonjēs tē MIE, tē cilēt janē vetēm pjesē e grupit negociator, pērkatēsisht znj. S.D., znj. K.N.dhe z. M.B., pēr te cilēn pasi ēshtë mbajtur tatimi nē burim nē masēn 32,355 lekē ēshtë kaluar nē llogaritē personale shuma 183,345 leke pēr person, datē 30.10.2020

- Nē masēn 215,700 lekē (shuma bruto) pēr punonjēs te AKBN-sē, pjesē e grupit negociator, pērkatēsisht pēr z. A.B., z. D.D. dhe Q.H., pēr te cilēt pasi ēshtë mbajtur tatimi nē burim pēr tē ardhurat mujore, ēshtë kaluar nē llogarite personale shuma neto, datē 30.10.2020

- Nē masēn 215,700 lekē (shuma bruto) pēr punonjēs te AKBN-sē, qē nuk janē pjesē e grupit negociator, z. A.M., z. B.P. dhe z. E.K., pēr tē cilēt pasi ēshtë mbajtur tatimi nē burim pēr tē

ardhurat mujore shuma neto e shpërblimit në datë 30.10.2020 është kaluar në llogarite personale të personave përfitues.

Nga auditimi rezulton sëshpërblimi në masën (bruto) 2,372,700 lekë në muajin Tetor 2020, për 8 anëtarët e Grupit Negociator dhe 3 punonjës të AKBN të angazhuar në procesin e negociatave për lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure, nuk është në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi pasi:

1. Propozimi për shpërblim për grupin negociator nga MIE, referuar shkresës nr. 6452 prot, datë 10.09.2020, mbi të cilin është bazuar e gjithë procedura e shpërblimit për grupin negociator, nuk ka të përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën legjitimohet shpërblimi. Kjo bie ndesh edhe Statut Rregulloren e AKBN, nenin 8 pika 4, ku përcaktohet së shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues, caktohet sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Gjithashtu bie ndesh me Vendimin e KD nr. 5/2007 të AKBN, i cili rregullon masën e òshpërblimit mujorë të anëtarëve të KD për pjesëmarrje në mbledhje të Kryetarit dhe anëtarëve të KD dhe jo për shpërblimin të tjera si ato në fund të vitit buxhetor. Gjithashtu bie ndesh edhe me nenin 113 të Kodit të Punës, pasi kjo dispozitë, parashikon dhënien e shpërblimit në bazë të rezultatit vjetor, ligjit dhe parimeve tregtare të pranuar, kritere që nuk plotësohen në shpërblimin e përfituar.

Kodi Punës.

Kur në bazë të kontratës, punëmarrësi ka të drejtë të përfitojë një shpërblim në raport me rezultatin e shfrytëzimit, ky llogaritet mbi bazën e rezultatit vjetor, i përcaktuar në bazë të ligjit dhe parimeve tregtare përgjithësisht të pranuar. (neni 113)

2. Vendimmarrja e KD në Vendimin Qarkullues nr. 15, datë 22.09.2020, *òPër ndryshime në programin ekonomik financiar të AKBN-së për vitin 2020ò* është në kushtet e òKonfliktit të interesitò për kryetarin dhe anëtarët e KD pasi prej tyre ushtrohet një funksion publik, vendimmarrja e të cilit lidhet drejtpërdrejt me interes privat (shpërblimi) ose indirekt (propozim nga MIE), referuar **Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005** *òPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò*, i ndryshuar, **neni 3**, sipas të cilit:- **"Konflikt i interesit"** është gjendja e konfliktit *ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe te përgjegjësi të tij publike*".

3. Vendimmarrja e KD në Vendimin Qarkullues nr. 15, datë 22.09.2020, *òPër ndryshime në programin ekonomik financiar të AKBN-së për vitin 2020ò* gjendet në kushtet e òKonfliktit të interesitò për kryetarin dhe anëtarët e KD pasi në kompetencat e tij sipas Statut Rregullore, **neni 10 pika 8**, parashikohet së: *òKD... Aprovon strukturën e pagave e shpërblimeve dhe ia paraqet ato, për miratim, Ministrin të Infrastrukturës dhe Energjisëò*. Pra kjo dispozitë parashikon aprovim lidhur me pagat dhe shpërblimet e punonjësve të AKBN dhe jo për vetë anëtarët e KD.

4. Në Statut Rregullore në nenin 8, pika 4 përcaktohet së: *-òShpërblimi anëtarëve të Këshillit Drejtues, caktohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi*". Kjo dispozite statutore nuk gjen mbështetje në Vendimin 15/2020 për shpërblimin e përfituar nga anëtarët e KD.

5. Vendimi Qarkullues nr. 15, datë 22.09.2020, *òPër ndryshime në programin ekonomik financiar të AKBN-së për vitin 2020ò*, lidhur me shpërblimin e punonjësve të AKBN-së, të cilët nuk janë pjesë e grupit negociator, përkatësisht z. A.M., z. B.P. dhe z. E.K. gjendet në kushtet në tejkalimit të kompetencave, referuar Urdhrit të Ministrin të MIE nr. 424/2019 dhe shkresës së Ministrin të MIE nr. 6452/2019 dhe përben konflikt interesi nga vete personat përfitues, të cilët njëkohësisht janë propozues dhe përfitues të shpërblimit sipas shkresës òMemoò e Drejtorisë Hidrokarbure të AKBN nr. 1625/14, datë 18.09.2020 òMbi shpërblimin e grupit negociatorò.

6. Nxjerrja nga Drejtori Ekzekutiv i Urdhrit nr. 94, datë 20.10.2020, *“Për Shpërblimin e grupit të angazhuar në procesin e negociatave me shoqërinë E.A. BV”*, nuk është në përputhje me nenin 12/1 të Statut Rregullores së AKBN-së, pasi kjo dispozitë në kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv parashikon organizim dhe drejtim pune dhe nuk përmban aprovim page dhe shpërblimi për punonjësit e saj, kompetencë kjo e Këshillit Drejtues (neni 10 pika 8). Funkcioni i Drejtorit Ekzekutiv është raportimi përpara Këshillit Drejtues mbi gjendjen financiare të njësisë shpenzuese, realizmin e buxhetit sipas pasqyrave financiare, etj... administrimi fondeve në bazë të buxhetit të aprovuar nga Këshilli Drejtues (neni 12).

Statut Rregullores e AKBN: Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv të AKBN

1. Organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e AKBN, nëpërmjet urdhrave dhe udhëzimeve, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me këtë Statut-Rregullore, për përmbushjen e misionit, për të cilin është krijuar AKBN. (neni 12 pika 1)

7. Urdhër nr. 94, datë 20.10.2020 i Drejtorit Ekzekutiv të AKBN *“Për shpërblimin e grupit të angazhuar në procesin e negociatave me shoqërinë E.A. B.Vö lidhur me shpërblimin e z.A.M., z. B.P. dhe z. E.K. është në kundërshtim me Urdhërin e Ministrit të MIE nr. 424/2019, pasi personat nuk janë pjesë e grupit negociator.*

8. Në buxhetin e AKBN-së për vitin 2020, sipas Vendimin Qarkullues nr. 15, datë 22.09.2020, janë ndryshuar zërat buxhetor duke **shtuar zërin** *“Shpërblime për Grupin Negociator për lidhjen e Marrëveshjes Hidrokarbure për bllokun e kërkimit “Dumreaö në shumën 2.372.700 lekë dhe duke pakësuar zërin “Udhëtime e dieta jashtë vendit, trajnime, konferenca, seminareö në shumën 2.372.700 lekë. Ndryshimi nuk është në përputhje me shkresën së MIE nr. 6452, datë 10.09.2020 sipas të cilës citojmë: “... Grupi Negociator të shpërblehet në masën me një pagë e gjysmë të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN nga fondet e zërit “Bonus i firmosjes në vlerën prej 4.000.000 USDö, zë i pa programuar në programin buxhetor të AKBN-së për vitin 2020*

9. Në total shpenzimet e vitit 2020 nuk janë ndryshuar, por pakësimi për fondet e papërdorura në zërin *“Udhëtime dieta jashtë venditö dhe shtimi zërit shpërblime për grupin negociator (anëtarë të KD, punonjës të AKBN-së) dhe 3 punonjës të MIE, cenon buxhetin e AKBN së vitit 2020, pasi siç dihet si AKBN dhe MIE funksionojnë me programe buxhetore të miratuara për vitin buxhetor si njësi të veçanta shpenzuese.*

Konkluzion: Për shpërblim të veçantë mbi pagë sipas Statut Rregullores së AKBN në vendimmarrjen e Këshillit Drejtues, ka gjetur zbatim neni 10 pika 3 si shqyrtim i programit ekonomik financiar në vend të nenit 10 pika 8 si shpërblim mbi pagë. Kjo tregon së Neni 10 i Statut Rregullores e AKBN-së nuk ka përcaktuar qartë kriteret për rastet e shpërblimit të veçantë mbi pagë për organet drejtuese ose punonjësve të tjerë përfitues.

Për pasojë shpenzimet e bëra nga AKBN për shpërblim të grupit të angazhuar në procesin e negociatave për lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure, në vlerë bruto **2,372,700 lekë** përbejnë përdorimin pa efektivitet të shpenzimeve nga njësia shpenzuese AKBN.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me:

1. Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeö, i ndryshuar, neni 3.*
2. Statut Rregulloren e AKBN, neni 8 pika 4, neni 10 pika 8, neni 12 pika 1.

Veprimet e mësipërme janë në kompetencë të:

1. Drejtorit Ekzekutiv z. A.B.

2. Këshillit Drejtues përfaqësuar nga ish-Kryetar z. G.K.

3. Këshillit Drejtues përfaqësuar nga Kryetar z. I.B.

| Titulli i Gjetjes | Pagesa për shpërblimin e anëtarëve të KD |
|-------------------|---|
| Situata | <p>Vendimi Qarkullues nr. 15, datë 22.09.2020 i KD ka dalë në procedurë të zbatimit të shkresës së MIE me nr. 6452 prot, datë 10.09.2020. Ekzekutimi shpërblimit e ka filluesën në Urdhrin nr. 424, datë 12.11.2019 të Ministrit MIE, për ngritjen e grupit negociator për fillimin e negociatave për lidhjen e Marrëveshjes Hidrokarbure, në formën e kontratës me ndarje prodhimi, kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi hidrokarburesh në bllokun oDumreao në tokë. Grupi negociator i ngritur nga MIE përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të MIE dhe 3 (tre) anëtarë të AKBN.</p> <p>Ministri me shkresën nr. 6452 prot, datë 10.09.2020 vlerëson rezultatet e arritura nga Grupi Negociator për punën e kryer dhe për arritjen e këtij rezultati përcakton shpërblim të tij në masën një pagë e gjysmë të pagës së Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së, nga fondet e zërit <i>oBonus i firmosjes në vlerën 4.000.000 USD</i>. Në respekt të procedurave për ekzekutimin e këtij vendimi, Ministri kërkon që këto shpenzime të pasqyrohen edhe në Planin dhe Buxhetin e AKBN-ë për vitin 2020.</p> <p>Me shkresën oMemoo nr. 1625/14 prot, datë 18.09.2020 të Drejtorisë Hidrokarbure z. A.M., z. E.K. dhe z. B.P., referuar shkresës 6452, dt 10.09.2020 të Ministrit, bazuar në nenin 113 të Kodit të Punës, i kanë <u>kërkuar</u> Drejtorit Ekzekutiv shpërblim grupit të angazhuar intensivisht në këtë proces (<i>jo grupi negociator</i>), duke vlerësuar kontributin e tyre për pjesën teknike dhe ligjore lidhur me marrëveshjen hidrokarbure.</p> <p>Më tej Drejtoria Ekonomike në AKBN ka paraqitur përpara Këshillit Drejtues të AKBN-së, oRelacionönr. 1625/15 prot, datë 18.09.2020, për ndryshime në buxhetin e vitit 2020 duke llogaritur shpenzimet totale për shpërblim 2,372,700 lekë, bazuar në:</p> <p>Ministri MIE-s në shkresën nr. 6452 dt. 10.09.2020, kërkon llogaritje e shpenzimeve të <u>anëtarëve të grupit negociator</u>, duke shtuar zërin e shpenzimeve <i>oShpërblime për grupin negociator për lidhjen e MH...</i> për 5 pjesëtarë të MIE-s në shumën =1,078,500 leke dhe 3 pjesëtarë të AKBN-së në shumën =647,100 lekë, në total = 1,725,600 lekë</p> <p>Shkresës oMemoo të AKBN me nr. 1625/14 dt. 18.09.2020, llogaritje e shpenzimeve për 3 punonjës të AKBN-së, të cilët <u>nuk janë pjesë e grupit negociator</u>, duke shtuar zërin e shpenzimeve <i>oShpërblime për grupin negociator për lidhjen e MH...</i> në total = 647,100 lekë.</p> <p>Këshilli Drejtues i AKBN me Vendim Qarkullues nr. 15, datë 22.09.2020, ka miratuar ndryshimin e buxhetit të vitit 2020 sipas tabelës bashkëlidhur relacionit dhe me shkresën nr. 1625/17 prot, datë 22.09.2020 ka dërguar vendimin për miratim në MIE. Ministri MIE-s me shkresë nr. 6736/1 prot, datë 02.10.2020, protokolluar në AKBN me nr. 1625/18, dt. 05.10.2020, ka miratuar ndryshimin e buxhetit viti 2020 sipas Vendimin nr. 15, datë 22.09.2020 të AKBN.</p> <p>Vendimi ka kaluar për njohje dhe zbatim me shkresë nr. 1625/19 prot, datë 14.10.2020 për Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë e Administratës.</p> <p>Drejtori Ekzekutiv i AKBN ka nxjerrë Urdhër nr. 94, datë 20.10.2020 për shpërblimin e grupit të angazhuar në procesin e negociatave me shoqërinë E.A. B.V, në masën e një page e gjysmë të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN.</p> |

| | |
|------------------------|---|
| | <p>Lidhur me kryerjen e pagesës nga Drejtoria e Administratës ka hartuar listë pagesat e muajit Tetor 2020, në të cilën ka përfshirë pagesën për shpërblimin e çdo personi si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pagesën në masën 215,700 lekë (shuma bruto) për punonjës të MIE, njëkohësisht anëtarë të Këshillit Drejtues, dhe pjesëtarë të Grupit Negociator, përkatësisht z. I.B.dhe z. I.G., për te cilët pasi është mbajtur tatimi në burim për të ardhurat mujore, shpërblimi është kaluar në llogaritë personale, datë 30.10.2020 - Në masën 215,700 lekë (shuma bruto) për punonjës të MIE, të cilët janë vetëm pjesë e grupit negociator, përkatësisht znj. S.D., znj. K.N.dhe z. M.B., për te cilën pasi është mbajtur tatimi në burim në masën 32,355 lekë është kaluar në llogaritë personale shuma 183,345 leke për person, datë 30.10.2020 - Në masën 215,700 lekë (shuma bruto) për punonjës të AKBN-së, pjesë e Grupit Negociator, përkatësisht për z. A.B., z. D.D dhe Q.H., për te cilët pasi është mbajtur tatimi në burim për të ardhurat mujore, është kaluar në llogarite personale shuma neto, datë 30.10.2020 - Në masën 215,700 lekë (shuma bruto) për punonjës të AKBN-së, që nuk janë pjesë e grupit negociator, z. A.M., z. B.P.dhe z. E.K., për te cilët pasi është mbajtur tatimi në burim për të ardhurat mujore shuma neto e shpërblimit në datë 30.10.2020 është kaluar në llogarite personale të personave përfitues. |
| Kriteri | -Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 òPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò i ndryshuar neni 1 dhe neni 3 - Statut Rregulloren e AKBN, neni 8 pika 4, neni 10 pika 8, neni 12 pika 1. |
| Ndikimi/E fekti | Përdorim jo efektiv i fondeve buxhetore të AKBN në kryerjen e shpenzimeve (shpërblim) për anëtarët e KD, në shumën bruto 2,372,700 lekë. |
| Shkaku | Vendimmarrje në kushtet e konfliktit të interesit në lidhje me shpërblimin e anëtarëve të KD dhe interpretimit të gabuar i akteve rregullative /Statut Rregullorja (neni 8, pika 4 dhe neni 10, pika 8 dhe neni 10 pika 3). |
| Rëndësia | I mesëm |
| Rekomandime | Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së të ndalojë shpërblimin për performancë në punë për anëtarët e Këshillit Drejtues, deri në përmirësimin e kriterëve të duhura për përmirësimin e nenit 10 Statut Rregullores së AKBN-së lidhur me shpërblimin mbi pagë. |

b. Organizmi dhe funksionimi i Këshillit Teknik.

Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare kryhen nga ministria (MIE) si dhe nga strukturat përgjegjëse, në varësi të saj. (neni 43 i ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerar në Republikën e Shqipërisëò, të ndryshuar).Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimi i veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit në zbatim të VKM nr. 232 datë 23.03.2011 òPër miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisëò, pikat 1,2 dhe 3, është dhe **Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.**

Dokumentacioni i aplikimit për leje minerare kërkim-zbulimi duhet të jetë në format elektronik sipas kërkesave të pikës B.2 të VKM nr. 942, datë 17.11.2010 òPër miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapuraò, i konsoliduar.Forma dhe përmbajtja Vendimi i Këshillit Teknik është e përcaktuar me Urdhrin e Ministrit Nr. 478, date 27.06.2011 Këshillit Teknik është organ kolegjal, vendimmarrës, i përhershëm, sipas detyrimeve të Statut Rregullores, neni 13, i cili kryesohet nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së. Anëtarët e Këshillit Teknik emërohen nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN. Këshilli Teknik funksionon mbështetur në

Rregulloren së Këshillit Teknik, miratuar nga KD i AKBN me Vendimin nr. 3, datë 18.1.2010, i ndryshuar. Këshilli teknik **shqyrton dhe merr vendim** për projekte të hartuara nga vete AKBN, si dhe projekte të hartua në bashkëpunim me institucione të tjera vendase ose të huaja, **projekte** të hartuara nga subjekte private për tu **pajisur me leje shfrytëzimi** sipas fushës së veprimtarisë së saj, dhe **studime** të kryera në përfundim të **zbatimit të projekteve**. Këshilli Teknik **shqyrton dhe jep mendim për programet kombëtare** të zhvillimit në fushat e saj dhe jep mendim për probleme që lidhen me projekte dhe investime.

Këshillit Teknik në zbatim të *ËRregullores për Funkcionimin e Këshillit Teknik*, neni 2, ka për objekt të veprimtarisë shqyrtimin e projekteve të shfrytëzimit të burimeve natyrore, që paraqiten nga subjekte private vendas, të huaj si dhe nga vetë AKBN. Numri i anëtarëve dhe emërimi i tyre bëhet nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së dhe ata janë punonjës të AKBN-së (neni 3). Rregullorja e Funkcionimit të Këshillit Teknik të AKBN-së, në nenin 6 ka përcaktuar procedurat kalimit të projekteve të paraqitura për miratim.

Këshillit Teknik përbëhet nga **11 anëtarë si dhe një sekretar** (pa të drejtë vote) emëruar me Urdhrin nr. 27, datë 30.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv. Ai mbledhet një herë në muaj. Vendimmarrjet e Këshillit Teknik, për periudhën objekt auditimi, rezultojnë si më poshtë:

Tabela nr. 2: Vendimet e Këshillit Teknik në AKBN

| Viti | Numër |
|-----------|-------|
| Viti 2018 | 101 |
| Viti 2019 | 86 |
| Viti 2020 | 66 |
| Viti 2021 | 52 |

Burimi: AKBN

Masa për shpërblimin e anëtarëve të KT është bazuar në Urdhrin nr. 894, datë 16.12.2010 të ish Ministrisë të ish Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës sipas të cilit për anëtarët e KT **shpërblimi** bëhet çdo muaj në raportin 10% të pagës së Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së, dhe për Sekretarin e KT **shpërblimi** bëhet çdo muaj 15% të pagës së Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së. Shpenzimet e kryera për shpërblimin e anëtarëve të KT për periudhën objekt auditimi pasqyrohen më poshtë në tabelë:

Tabela nr.3: Shpenzimet e kryera për shpërblimin e anëtarëve të KT

| Viti | Vlera (bruto) (Në lekë) |
|---------------------|----------------------------|
| 2018 (4-mujori III) | 719,000 |
| Viti 2019 | 2,131,508 |
| Viti 2020 | 1,704,030 |
| Viti 2021 | 2,329,560 |

Burimi: AKBN

Bazuar në piken 6, të VKM nr. 267, datë 31.3.2020 òPër trajtimin e përkohshëm financiar mujor të disa funksionarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë shkaktuar nga Covid-19, shpërblimi për anëtarët e Këshillit Teknik është arkëtuar pranë fondit COVID-19 me numër llogarie x për muajt Prill 2020 në shumën 179,750 leke, date 30.04.2020; Maj 2020 në shumën 179,750 leke, date 29.05.2020 dhe Qershor 2020 në shumën 179,750 leke, date 01.07.2020.

Për sa më sipër grupi auditimit ka mbajtur Akt Konstatimi nr. 1, datë 31.02.2022

III.2.3. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- 1) Programet Buxhetore Afatmesëm 2020-2022 dhe PBA-në 2021-2023;
- 2) Projektbuxheti për vitin 2019 dhe vitin 2020, si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit gjatë vitit ushtrimor;
- 3) Raportet e monitorimit të realizimit të buxhetit;
- 4) Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.

a) Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore financohet si më poshtë:

ÉProjekte të financuara nga buxheti i shtetit;

ÉTë ardhura që krijohen nga: Projektet dhe shërbimet për të tretët; Administrimi i të dhënave; bonuset dhe fondet, kualifikim-administrim, nga marrëveshjet hidrokarbure; shitja e pjesës së shtetit në një marrëveshje hidrokarbure; interesat bankare; donacione etj.

AKBN ka të drejtë të përfitojë projekte të financuara nga buxheti i shtetit apo subjekte të tjera. Për shërbimet që ofron, siguron të ardhura në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë e saj. Buxheti i AKBN-së miratohet nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Për të gjithë veprimtarinë e saj ekonomike-financiare, AKBN përgatit programin ekonomik (buxhetin) dhe programin e zhvillimit për çdo vit kalendarik. Për projektet e financuara nga buxheti i shtetit, AKBN operon në përputhje me udhëzimin vjetor të MIE-es, për këtë qëllim.

Viti 2018

Për vitin 2018, AKBN ka përgatitur fazën e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 për programin mbështetës për Burimet Natyrore dhe programin mbështetës për Energjinë.

Me shkresën nr. 4542, datë 02.05.2018 dhe nr. 4542/1, datë 03.05.2018 AKBN ka dërguar në MIE PBA-të 2019-2020 për programin mbështetës për energjinë dhe programin mbështetës për Burimet Natyrore, brenda afateve ligjore të përcaktuara në pikën 9/a të Udhëzimi nr. 7/1 datë 28.02.2018 òPër përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm 2019-2021ò

Nga institucioni nuk është përgatitur faza e II e PBA-së 2019-2021, me arsyetimin së nuk u është kërkuar nga ministria e linjës përgatitja e fazës së dytë të PBA-së.

Parashikimi i shpenzimeve në PBA- në 2019-2021

Tabela nr. 4

'000

lekë

| Artikujt | Tavanet 2019 | Kërkesa 2019 | Tavanet 2020 | Kërkesa 2020 | Tavanet 2021 | Kërkesa 2021 |
|--|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|
| Programi Mbështetje për Burimet Natyrore | 35,935 | 36,100 | 36,100 | 36,100 | 50,000 | 50,000 |
| Programi Mbështetje për Energjinë | 35,947 | 59,000 | 37,100 | 60,600 | 37,100 | 81,000 |

| | | | | | | |
|-------------------|---------------|-------------|---------------|------------|---------------|--|
| Projektet e Huaja | 7,663 | 105,000 EUR | 7,663 | 50,970 EUR | | |
| Totali | 79,545 | | 80,863 | | 87,100 | |

Burimi: Drejtoria ekonomike, AKBN.

Viti 2019

Për vitin 2019, AKBN ka përgatitur fazën e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për programin mbështetës për Burimet Natyrore dhe programin mbështetës për Energjinë.

Me shkresën nr. nr. 2509/3, datë 06.05.2019 dhe nr.2509/4, datë 31.05.2019 AKBN ka dërguar në MIE PBA-të 2020-2022 për programin mbështetës për energjinë dhe programin mbështetës për Burimet Natyrore, brenda afateve ligjore të përcaktuara në pikën 7/a të Udhëzimit nr. 8, datë 22.02.2019 të Ministrit të Financës për përgatitjen e PBA-së 2020-2022.

Nga institucioni nuk është përgatitur faza e dytë e PBA-së 2020-2021, me arsyetimin se nuk u është kërkuar nga ministria e linjës përgatitja e fazës së dytë të PBA-së.

Parashikimi i shpenzimeve në PBA- në 2020-2022

Tabela nr. 5

'000 lekë

| Artikujt | Tavanet 2020 | Kërkesa 2020 | Tavanet 2021 | Kërkesa 2021 | Tavanet 2022 | Kërkesa 2022 |
|--|---------------|----------------|----------------|---------------|---------------|---------------|
| Programi Mbështetje për Burimet Natyrore | 36,100 | 44,100 | 50,000 | 44,600 | 55,000 | 50,100 |
| Programi Mbështetje për Energjinë | 22,500 | 37,100 | 66,059 | 37,100 | 40,150 | 46,100 |
| Tvsh-te e projekteve te huaja | 30,400 | 40,203 | 1,200 | 1,000 | | |
| Totali | 89,000 | 121,403 | 117,259 | 82,700 | 95,150 | 96,200 |

Burimi: Drejtoria ekonomike, AKBN.

Viti 2020

Për vitin 2020, AKBN ka përgatitur fazën e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 për programin mbështetës për Burimet Natyrore dhe programin mbështetës për Energjinë.

Me shkresën nr. nr. 1518/2, datë 19.08.2020 AKBN ka dërguar në MIE PBA-të 2021-2023 për programin mbështetës për energjinë dhe programin mbështetës për Burimet Natyrore. Me aktin normativ nr. 17, datë 22.4.2020 u vendos përjashtimisht për vitin 2020, si pasojë e situatës epidemike të shkaktuar nga COVID-19, procedurat dhe afatet për përgatitjen e projekt dokumentit të PBA të mos zbatohen.

Me shkresën nr.1518/4, datë 07.12.2020, institucioni ka dërguar fazën e dytë e PBA-së 2021-2023 për programin mbështetës për energjinë. Sa i takon programit të burimeve natyrore, nuk është përgatitur faza e dytë e PBA-së me arsyetimin se nuk u është kërkuar nga ministria e linjës përgatitja e fazës së dytë të PBA-së.

Parashikimi i shpenzimeve në PBA- në 2021-2023

Tabela nr. 6 '000 lekë

| Artikujt | Tavanet 2021 | Kërkesa 2021 | Tavanet 2022 | Kërkesa 2022 | Tavanet 2023 | Kërkesa 2023 |
|--|---------------|----------------|---------------|---------------|---------------|----------------|
| Programi Mbështetje për Burimet Natyrore | 45,100 | 45,100 | 44,600 | 52,600 | 44,600 | 63,400 |
| Programi Mbështetje për Energjinë | 17,450 | 45,409 | 20,500 | 26,500 | 46,350 | 45,409 |
| Tvsh-të e projekteve te huaja | 11,200 | 31,200 | 3,500 | 7,400 | 4,500.00 | 10,000 |
| Totali | 73,750 | 121,709 | 68,600 | 86,500 | 95,450 | 118,809 |

Burimi: Drejtoria ekonomike, AKBN.

Statut Rregullorja e funksionimit të AKBN përcakton në nenin 13 së òKëshilli Teknikò është organ kolegjal, vendimmarrës, i përhershëm, që kryesohet nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN, i krijuar për shqyrtimin e projekteve të shfrytëzimit të burimeve natyrore.

Në zbatim të udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së, paragrafi 2.5, pika 1/a, në njësitë shpenzuese të

nivelit të dytë që zbatojnë një program buxhetor të vetëm, drejtues programi, si rregull, është respektivisht nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në paragrafin 2.5, pika 2, citohet së: ò...Drejtuesit e programit janë përgjegjës për të garantuar që janë duke u realizuar siç duhet përgjegjësitë e ekipit të menaxhimit të programit, si një komponent kyç i organizimit institucional për përgatitjen e kërkesave buxhetore. Konkretisht, në AKBN rolin e Ekipit të Menaxhimit të Programit, e luan Këshilli Teknik.

Në zbatim të udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018, paragrafi 2.5, pika 5, citohet së ò...Drejtuesi i programit (Drejtori Ekzekutiv) dërgon tek të gjithë anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit (a) Udhëzimin e Përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, (b) përshkrimin e Misionit (c) propozimin e anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit dhe (d) kalendarin për fazën e parë të hartimit të kërkesave buxhetore etj.ò, e cila nuk ka funksionuar. Përgatitja e fishave të projekteve të cilat financohen nga buxheti i shtetit për PBA-në bëhet nga secila drejtori përkatëse Në përgatitjen e PBA-së janë konsideruar kërkesat e paraqitura nga drejtoritë e institucionit dhe janë përpunuar nga drejtoria e financës.

Gjithashtu u konstatua së institucioni ndër vite nuk ka një program zhvillimi afatmesëm ku të përcaktohen objektiva konkrete që të garantojnë rritjen e vazhdueshme të të ardhurave dhe rrjedhimisht të rezultatit të saj financiar. Në programin ekonomik të vitit 2021, institucioni ka bërë parashikimin për tre vitet pasardhëse, por duke mos përcaktuar objektiva konkrete që të garantojnë rritjen e vazhdueshme të të ardhurave.

b) Zbatimi i kriterëve në realizimi i planit të buxhetit.

Viti 2018

Në zbatim të Ligjit nr. 109/2017 òPër buxhetin e vitit 2018ò dhe në vijim të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 19.01.2018 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2018ò, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò AKBN-së i janë planifikuar fonde buxhetore për projekte për vitin 2018 në shumën 71,881,902 lekë dhe për investimet e huaja (TVSH-në) është planifikuar një fond prej 7,663,000 lekë, ku plani është miratuar nga MIE dhe është dërguar detajimi pranë AKBN-së me shkresën nr. 761/4 datë 22.02.2019 .

Në zbatim të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 òPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetitò janë përgatitur raportet e monitorimit nga AKBN-ja dhe janë dërguar në Ministrinë e linjës. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për projektet e financuar nga buxheti i shtetit paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 7

| Nr | Emërtimi | Plan | Fakt | % e realizimit |
|----|--|-------------------|-------------------|----------------|
| 1 | Programi Mbështetës për burimet natyrore | 38,000,000 | 35,400,000 | 93% |
| 2 | Programi Mbështetës për Energjinë | 29,100,000 | 29,100,000 | 100% |
| | Totali | 67,100,000 | 64,500,000 | 96% |

Burimi: Drejtoria e ekonomike e AKBN-së

Në programin Mbështetës për Burimet Natyrore në mosrealizimin 100% të projekteve të financuar nga buxheti i shtetit ka ndikuar mos realizimi i projekti òDixhitalizimi i të dhënave të industrisë së minieraveòi cili ishte planifikuar në shumën 2,000 mijë lekë.

Analiza e shpenzimeve të realizuar nga aktiviteti i AKBN-së për vitin 2018

AKBN-ja pasi ka marrë detajimin e fondit të projekteve nga MIE ka bërë planifikim e shpenzimeve për vitin buxhetor, ku me shkresën nr. 2181/2, datë 19.04.2018 është realizuar projekt drafti i shpenzimeve për vitin 2018, i cili është paraqitur pranë Këshillit Drejtues për miratim. Me vendimin nr. 3, datë 16.05.2018 Këshilli Drejtues ka miratuar ÷Buxhetin për vitin 2018, ku është dërguar në MIE për miratim. Ministri i MIE me Urdhrin nr. 457, datë 16.05.2018 ka dërguar miratimin e vendimit të Këshillit Drejtues të AKBN-së ÷Për miratimin e buxhetit për zhvillimin e programit ekonomik financiar të AKBN-së për vitin 2018.

Shpenzimet e realizuara për vitin 2018

Tabela nr. 8

Në lekë

| Nr | Emërtimi i shpenzimeve | Plan | Fakt | % realizimit |
|-----------|---|-------------|-------------|---------------------|
| 1 | Paga bazë, punonjës me kontratë, sig. shoq | 231,745,000 | 217,325,113 | 93.8% |
| 2 | Pagesa e KD dhe KT | 4,900,000 | 4,837,847 | 98.7% |
| 3 | Pagesa për punonjës të larguar | 15,000,000 | 6,988,721 | 46.6% |
| 4 | Shpërblim për punonjësit | 7,650,000 | 7,611,904 | 99.5% |
| 5 | Shpërblim për KD | 105,000 | 88,617 | 84.4% |
| 6 | Shpenzime për udhëtim e dieta brenda vendit | 13,000,000 | 11,427,860 | 87.9% |
| 7 | Shpenzime për udhëtim e dieta jashtë vendit | 7,000,000 | 5,727,798 | 81.8% |
| 8 | Konsulenca oponentra trajnime | 14,100,000 | 6,469,794 | 45.9% |
| 9 | Bojë printer, kancelari, letër | 1,200,000 | 1,164,820 | 97.1% |
| 10 | Blerje materialtë tjera | 1,640,000 | 980,793 | 59.8% |
| 11 | Energji elektrike ujë | 4,400,000 | 3,699,076 | 84.1% |
| 12 | Shpenzime telefonie | 1,700,000 | 1,562,735 | 91.9% |
| 13 | Rojat 6 objektit | 9,500,000 | 4,046,097 | 42.6% |
| 14 | Qira godine (Fier) | 7,100,000 | 7,058,830 | 99.4% |
| 15 | Shpenzime për procese gj. dhe arbitrazhi | 263,420,000 | 3,714,293 | 1.4% |
| 16 | Shpenzime për shërbime dhe riparime | 4,230,000 | 2,477,028 | 58.6% |
| 17 | Mirëmbajtje e Sistemit GIS | 15,000,000 | 14,929,387 | 99.5% |
| 18 | Mirëmbajtje REVZON | 1,500,000 | 1,475,000 | 98.3% |
| 19 | Tatim taksa | 1,500,000 | 1,447,950 | 96.5% |
| 20 | Blerje Pajisje Kompjuterike | 800,000 | 723,485 | 90.4% |

Burimi: Drejtoria ekonomike, AKBN.

Zërat e shpenzimeve për pagën bazë të punonjësve me kontratë dhe sigurimeve shoqërore janë realizuar në masën 93.8%. Pagesat ndaj Këshillit Drejtues dhe Këshillit Teknik janë realizuar në masën 98.7%.

Shuma e planifikuar për shpenzimet për punonjës të larguar nga puna, ku nga 15 milionë lekë të planifikuara janë paguar detyrime në vlerën 6.9 milionë lekë ose në masën 46.6%. Arsyeja e mospagesës së shtatë ish-punonjësve (të cilët kanë fituar procesin gjyqësor dhe kanë marrë vendimin e formës së prerë) është së AKBN-ja nuk ka mundësi ekonomike financiare për shlyerjen e këtyre detyrimeve.

Shpenzimet për udhëtime e dieta brenda vendit janë realizuar në masën 87.9%.

Shpenzimet për udhëtime e dieta jashtë vendi dhe trajnime janë realizuar në masën 81.8%, ku gjatë periudhës 2018 janë realizuar 11 udhëtime si pjesëmarrje në konferenca, takime në kuadër të projekteve IPA si dhe trajnime.

Zëri ÷Konsulenca, Oponentra, Trajnime ÷ është realizuar në masën 45.9% dhe i përket pagesave për konsulentët e Grupit të Oponentës Teknike të Hec-eve, konsulentët e projekteve të Drejtorive të Energjive të Rinovueshme dhe Hidrokarbure, si dhe detyrimet për ekspertin kontabël, i cili ka realizuar auditimin dhe certifikimin e pasqyrave financiare për vitin 2017.

Zëri ÷Blerje bojë printer, Kancelari, Letër ÷ është realizuar në masën 97.1%.

ōBlerje materiale të tjeraō është realizuar në masën 59.8% e cila përfshin shpenzimet për blerje goma makine për automjetet e AKBN-së, blerje pjesë për fotokopje dhe kompjutera, blerje matëse të certifikuar etj.

Shpenzimet utilitare për energji elektrike, ujë janë realizuar në vlerën prej 3.69 milionë ose 84.1% e shumës së planifikuar.

Shpenzime për telefon fax janë realizuar në shumën 1.56 milionë lekë ose 91.9%.

Zëri òShpenzime për shërbime dhe riparimeō është realizuar në shumën prej 2.47 milionë lekë ose në masën 58.6%, ku përfshihen shpenzime për shërbime interneti, shpenzime për mirëmbajtjen e programit Financa 5, shpenzime dokumentacion makine, vaj, filtra dhe kontroll teknik, shpenzime për siguracion automjetesh, etj.

Zëri òRoje objektiō është realizuar në masën 42.6%, pasi kontratat për Sigurimin e godinave me roje i shtrijnë efektet e tyre nga muaji Maj 2018 deri në Korrik 2019. Në mosrealizim ka ndikuar fakti së në planifikimin e buxhetit është përllogaritur e gjithë vlera e kontratës për 12 muaj.

Zëriō Qera godine Fierō është realizuar në shumën prej 7.058 milionë lekë ose 99.4%.

Shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit GIS janë realizuar në masën prej 99.5 % dhe Revzone janë realizuar në masën 98.3%.

Në zërin òBlerje e pajisjeve kompjuterikeō është realizuar në vlerën 90.4%.

Viti 2019

Në zbatim të Ligjit nr. 99/2018 òPër buxhetin e vitit 2019ō, dhe në vijim të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë të Financave nr. 1, datë 17.01.2019 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ō, AKBN-së i janë planifikuar fonde buxhetore për projekte për vitin 2019 në shumën 71,881,902 lekë dhe për investimet e huaja (TVSH-në) është planifikuar një fond prej 7,663,000 lekë, ku plani është miratuar nga MEI dhe është dërguar detajimi pranë AKBN-së me shkresën nr.761/4 datë 22.02.2019 .

Në zbatim të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 òPër procedurat standarde te monitorimit të buxhetitō janë përgatitur raportet e monitorimit nga AKBN-ja dhe janë dërguar në Ministrinë e linjës. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për projektet e financuar nga buxheti i shtetit paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 9

| Nr | Emërtimi | Plan | Fakt | % e realizimit |
|----|--|-------------------|-------------------|----------------|
| 1 | Programi Mbështetës për burimet natyrore | 35,935,000 | 35,735,000 | 99% |
| 2 | Programi Mbështetës për Energjinë | 35,947,000 | 35,947,000 | 100% |
| | Totali | 71,882,000 | 71,682,000 | 99.7% |

Burimi: Drejtoria e ekonomike e AKBN-së

Në programin Mbështetës për Burimet në mosrealizimin 100% të projekteve të financuar nga buxheti i shtetit ka ndikuar projekti òAkreditimi dhe certifikimi i laboratorit kimik M064067ōi cili nga 1,000 mijë lekë të planifikuara është realizuar në 800 mijë lekë.

Analiza e shpenzimeve të realizuar nga aktiviteti i AKBN-së për vitin 2019

AKBN-ja pasi ka marrë detajimin e fondit të projekteve nga MIE ka bërë planifikim e shpenzimeve për vitin buxhetor, ku me shkresën nr. 1993, datë 11.03.2019 është realizuar projekt drafti i shpenzimeve për vitin 2019, i cili është paraqitur pranë Këshillit Drejtues për miratim.

Me shkresën 1993/1, datë 03.04.2019 është ridërguar buxheti i rishikuar me një ndryshim në zërin òTatim taksaō duke e rritur vlerën e shpenzime të planifikuara për këtë zë në vlerën prej

200,000 lekë, si dhe me shkresën 1993/2, datë 03.04.2019 është rishikuar buxheti për zërin e shpenzimeve për blerje pjesë kompjuteri dhe software-i duke e rritur vlerën e shpenzime të planifikuara përkatësisht 150,000 lekë dhe 500,000 lekë.

Me vendimin nr. 4, datë 24.05.2019 Këshilli Drejtues ka miratuar ÷Buxhetin për vitin 2019, ku me shkresën nr. 3444/1, datë 30.05.2019 është dërguar në MIE për miratim.

Me shkresën nr. 5538/1, datë 21.06.2019 Ministri i MIE ka dërguar miratimin e vendimit të Këshillit Drejtues të AKBN-së ÷Për miratimin e buxhetit për zhvillimin e programit ekonomik financiar të AKBN-së për vitin 2019.

Shpenzimet e realizuara për vitin 2019

Tabela nr. 10

Në lekë

| Nr | Emërtimi i shpenzimeve | Plan | Fakt | % realizimit |
|-----------|---|-------------|-------------|---------------------|
| 1 | Paga bazë, punonjës me kontratë, sig. shoq | 251,000,000 | 227,033,869 | 90% |
| 2 | Pagesa e KD dhe KT | 5,100,000 | 4,647,111 | 91% |
| 3 | Pagesa për punonjës të larguar | 31,000,000 | 2,323,620 | 7.5% |
| 4 | Shpenzime për udhëtim e dieta brenda vendit | 12,000,000 | 8,514,880 | 71% |
| 5 | Shpenzime për udhëtim e dieta jashtë vendit | 22,000,000 | 1,746,092 | 8% |
| 6 | Konsulenca oponentra trajnime | 15,000,000 | 5,000,000 | 33% |
| 7 | Bojë printer, kancelari, letër | 900,000 | 792,492 | 88% |
| 8 | Blerje material të tjera | 1,150,000 | 603,637 | 52% |
| 9 | Blerje Karburanti | 3,600,000 | 3,599,835 | 100% |
| 10 | Energji elektrike ujë | 4,400,000 | 3,699,076 | 75% |
| 11 | Shpenzime telefonie | 2,000,000 | 1,665,801 | 83% |
| 12 | Rojat 6 objektit | 15,000,000 | 8,165,890 | 54% |
| 13 | Qira godine (Fier) | 7,100,000 | 7,058,832 | 99% |
| 14 | Shpenzime për procese gjyq. dhe arbitrazhi | 140,000,000 | 1,559,415 | 1% |
| 15 | Shpenzime jete për punonjësi | 570,000 | 569,800 | 100% |
| 16 | Shpenzime për 31161 bime dhe riparime | 3,430,000 | 2,010,905 | 58.6% |
| 17 | Mirëmbajtje e Sistemit GIS | 36,223,462 | 6,364,688 | 17.6% |
| 18 | Mirëmbajtje REVZON | 4,302,084 | 1,352,083 | 31.4% |
| 19 | Organizimi eventesh dhe shpenzim për prom. | 150,000 | 150,000 | 100% |
| 20 | Te paparashikuara | 300,000 | 300,000 | 100% |
| 21 | Tatim taksa | 1,700,000 | 1,641,533 | 97% |

Burimi: Drejtoria ekonomike, AKBN.

Zërat e shpenzimeve për pagën bazë të punonjësve me kontratë dhe sigurimeve shoqërore janë realizuar në masën 90%. Pagesat ndaj Këshillit Drejtues dhe Këshillit Teknik janë realizuar në masën 91%.

Shuma e planifikuar për shpenzimet për punonjës të larguar nga puna, nga 31 milionë lekë të planifikuara janë paguar detyrime në vlerën 2.3 milionë lekë ose në masën 7.5%.

Shpenzimet për udhëtime e dieta brenda vendit janë realizuar në masën 71% Institucioni për arsye të mos realizimit të të ardhurave të planifikuara nga aktivitetit, gjatë vitit 2019 ka riorganizuar grupet e punës me qëllim realizimin e shërbimeve në drejtim të uljes së numrit të personave dhe ditëve të qëndrimit.

Zëri ÷Konsulenca, Oponentra Trajnime është realizuar në masën 33.3% dhe i përket pagesave për konsulentët e Grupit të Oponencës Teknike të Hec-eve, konsulentët e projekteve të Drejtorive të Energjive të Rinovueshme dhe Hidrokarbure, si dhe detyrimet për ekspertin kontabël, i cili ka realizuar auditimin dhe certifikimin e pasqyrave financiare për vitin 2018.

Zërat ÷Blerje bojë printerë është realizuar në masën 85.4%, ÷Kancelarië në masën 88.6% dhe ÷Letërë janë realizuar në masën 99.8%.

•Blerje materiale të tjera është realizuar në masën 52.5% e cila përfshin shpenzimet për blerje goma makine për automjetet e AKBN-së, blerje pjesë për fotokopje dhe kompjutera, blerje reagent dhe pajisje laboratorike, si dhe shtypshkrime dhe kartëvizita etj.

Shpenzimet utilitare për energji elektrike, ujë, postë, telefon, fax dhe celular janë realizuar në vlerën prej 4.96 milionë ose 80%.e shumës së planifikuar.

Shpenzime për blerje karburanti është realizuar në shumën 3.599 milionë lekë ose 100%.

Zëri •Shpenzimeve për shërbime dhe riparime është realizuar në shumën prej 2 milionë lekë ose në masën 58.6%., ku përfshihen shpenzime për shërbime interneti, shpenzime për mirëmbajtjen e programit Financa 5, shpenzime dokumentacion makine, vaj, filtra dhe kontroll teknik, shpenzime për siguracion automjetesh, shpenzime për rikonstruksionin e laboratorit, si dhe shpenzime për sigurimin e godinave në Tiranë dhe Fier etj.

Zëri •Roje objekti është realizuar në masën 54 4%, pasi kontratat për sigurimin e godinave me roje i shtrijnë efektet e tyre nga muaji Maj 2019 deri në Korrik 2020, ndërsa fondi planifikohet për të gjithë shumën e kontratës.

Zëri •Qira godine Fier është realizuar në shumën prej 7.058 milionë lekë ose 99.4%.

Shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit GIS janë realizuar në masën prej 17.6 % dhe Revzon janë realizuar në masën 31.4%, (që i përkasin pagesave për dy kontratat aktuale të mirëmbajtjes për vitin 2019). Për këto shërbime, në buxhet ishte parashikuar edhe vlera e kontratave të reja që do të lidheshin për një periudhë 2-vjeçare, me mbarimin e kontratave ekzistuese në muajin Nëntor (sipas VKM-së nr. 710, datë 21.08.2013, që përcakton kohëzgjatjen jo më të shkurtër së 2-vjet).

Zëri shpenzime •Organizim eventesh dhe promovimi janë realizuar në masën 100%, e cila ka të bëjë me pjesëmarrje e AKBN-së në edicionin e 26-të të Panairit Ndërkombëtar të Tiranës-UFI Approved Event në Pallatin e Kongreseve, si një element i rëndësishëm për promovimin e burimeve natyrore dhe fushave të veprimtarisë së institucionit.

Zëri •Shpenzime të paparashikuara është realizuar në masën 100%. Në kushtet e shpalljes së •Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore në Durrës dhe Tiranë, datë 27.11 2019, në zbatim të VKM-së nr. 750, datë 27 11 2019, AKBN-ja për tu ardhur në ndihmë banorëve në zonat e prekura nga tërmeti ka vënë në dispozicion shumën prej 3 milionë lekë të planifikuar për zërin •Shpenzime të paparashikuara .

Viti 2020

Në zbatim të Ligjit nr. 88/2019 •Për buxhetin e vitit 2020, si dhe në vijim të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 20.01.2019 •Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020 dhe të Udhëzimit Plotësues Shtesë të Ministrit të Financave nr. 2/1 datë 21.09.2020, AKBN-së i janë planifikuar fonde buxhetore për projekte për vitin 2020 në shumën 58,600,000 lekë dhe për investimet e huaja (TVSH-në) është planifikuar një fond prej 30,400,000 lekë, ku plani është miratuar nga MIE dhe është dërguar detajimi pranë AKBN-së me shkresën nr.4948/4 datë 20.08.2020 .

Në zbatim të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 •Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit janë përgatitur raportet e monitorimit nga AKBN-ja dhe janë dërguar në Ministrinë e linjës. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për projektet e financuar nga buxheti i shtetit paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 11

| Nr | Emërtimi | Plan | Fakt | % e realizimit |
|----|--|------------|------------|----------------|
| 1 | Programi Mbështetës për burimet natyrore | 36,100,000 | 36,100,000 | 100% |
| 2 | Programi Mbështetës për Energjinë | 22,500,500 | 22,500,500 | 100% |

| | | | |
|---------------|------------|------------|------|
| Totali | 58,600,500 | 58,600,500 | 100% |
|---------------|------------|------------|------|

Burimi: Drejtoria e ekonomike e AKBN-së

Të dy programet buxhetore të financuara nga buxheti i shtetit janë realizuar 100%.

Tabela nr. 12

| Programi "Mbështetje për Energjinë" | | | |
|---|--|------------------|--|
| Shkresa | Projekti | Shtesa/Pakësime | Komente |
| Nr.196/23 datë 21.08.2020 | Transferim TVSH-je për Games Target Blue Deal Sme.ec | +10,000,000 lekë | Transferim fondesh nga Aparati i MIE në AKBN |
| Nr.6505/4 prot., datë 09.10.2020; nr.196/37 prot., datë 05.11.2020 | TVSH për Games Target Blue Deal Sme.ec | -1,000,000 lekë | Transferim fondesh për shpenzime kapitale me financim të brendshëm |
| | TVSH për Aquanex | -4,800,000 lekë | |
| Nr.7930/2 prot., datë 10.12.2020 | TVSH për LED | -5,000,000 lekë | Transferim fondesh për shpenzime kapitale me financim të brendshëm |
| | TVSH për Aquanex | -13,379,467 lekë | |
| | TVSH Seadrion | -5,400,000 lekë | |

Burimi: Drejtoria ekonomike, AKBN
Përpunuar nga grupi i auditimit.

Analiza e shpenzimeve të realizuar nga aktiviteti i AKBN-së për vitin 2020

AKBN-ja pasi ka marrë detajimin e fondit të projekteve nga MIE ka bërë planifikim e shpenzimeve për vitin buxhetor, ku me shkresën nr. 64/7 datë 04.03.2020, Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së i ka dërguar Këshillit Drejtues relacionin e parë për Projektbuxhetin, i cili është miratuar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr. 13 datë 06.03.2020. Me shkresën nr. 2788/1 datë 30.04.2020, Ministri i MIE ka kërkuar rishikimin e programit ekonomik, me qëllim planifikim sa më të arsyeshëm të të ardhurave dhe shpenzimeve, për shkak të situatës të krijuar nga Pandemia Covid-19.

Me Vendimin Qarkullues të Këshillit Drejtues nr.14 datë 14.05.2020 òBuxheti për vitin 2020ö, i cili është miratuar nga Ministri i MIE me shkresën nr.2788/3 datë 19.05.2020 òPër miratimin e buxhetit për zhvillimin e programit ekonomik financiar të AKBN-së për vitin 2020ö.

Tabela nr. 13

| Shpenzimet | | | |
|------------------------------|--|-----------------|---|
| Shkresa | Shpenzimet | Shtesa/Pakësime | Komente |
| Nr. 1625/15, datë 18.09.2020 | Shpërblime për grupin negociator të bllokut Dumrea | +2,372,700 lekë | Me shkresën nr.6452 datë 10.09.2020 me lëndë òVlerësim për rezultatet e arritura nga Grupi Negociator për lidhjen e Marrëveshjes Hidrokarbure për bllokun e kërimit òDumreaö, Ministri i MIE-s, ka kërkuar shpërblimin e grupit negociator në masën prej një page e gjysmë të drejtorit ekzekutiv të AKBN-së. Miratuar me Vendimin Qarkullues nr.15 të KD datë 22.09.2020 dhe me shkresën nr.6736/1 prot. datë 02.10.2020 nga Ministri i MIE. |
| | Udhëtime e dieta jashtë vendit, trajnime, konferenca, seminare | -2,372,700 lekë | |

Burimi: Drejtoria ekonomike, AKBN
Përpunuar nga grupi i auditimit.

Shpenzimet e realizuara për vitin 2020

Tabela nr. 14

Në lekë

| Nr | Emërtimi i shpenzimeve | Plan | Fakt | % realizimit |
|----|---|-------------|-------------|--------------|
| 1 | Paga bazë, punonjës me kontratë, sig. shoq. | 238,100,000 | 217,534,863 | 91% |
| 2 | Pagesa e KD dhe KT | 5,150,000 | 4,788,545 | 93% |
| 3 | Pagesa për punonjës të larguar | 28,500,000 | 936,525 | 3% |
| 4 | Shpenzime për udhëtim e dieta brenda vendit | 12,000,000 | 6,155,230 | 51% |

| | | | | |
|----|--|-------------|-----------|------|
| 5 | Shpenzime për udhëtim e dieta jashtë vendit | 10,627,300 | 0 | 0% |
| 6 | Shpërblime Grupin Negociator për lidhjen e MH për bllokun "Dumrea" | 2,372,700 | 2,372,700 | 100% |
| 7 | Konsulenca oponentra trajnime | 15,300,000 | 7,748,913 | 51% |
| 8 | Bojë printer, kancelari, letër | 1,500,000 | 1,320,000 | 88% |
| 9 | Blerje materiale e të tjera | 3,350,000 | 2,015,752 | 60% |
| 10 | Blerje Karburanti | 2,538,000 | 2,537,851 | 100% |
| 11 | Energji elektrike ujë | 3,800,000 | 2,928,617 | 77% |
| 12 | Shpenzime telefonie | 2,000,000 | 1,333,474 | 67% |
| 13 | Rojet e objektit | 16,100,000 | 8,720,275 | 54% |
| 14 | Qira godine (Fier) | 7,200,000 | 6,882,360 | 96% |
| 15 | Shpenzime për procese gjyq. dhe arbitrazhi | 138,100,000 | 1,214,553 | 1% |
| 16 | Shpenzime jete për punonjësit | 570,000 | 570,000 | 100% |
| 17 | Shpenzime për shërbime dhe riparime | 5,513,000 | 3,450,011 | 63% |
| 18 | Mirëmbajtje e sistemit GIS | 29,858,774 | 1,226,667 | 4% |
| 19 | Mirëmbajtje REVZON | 2,950,000 | 121,667 | 4% |
| 20 | Organizim eventesh dhe shpenzim për prom. | 300,000 | - | 0% |
| 21 | Të paparashikuar | 500,000 | - | 0% |
| 22 | Tatim taksa | 1,700,000 | 1,638,600 | 96% |

Burimi: Drejtoria ekonomike, AKBN.

Zërat e shpenzimeve për pagën bazë të punonjësve me kontratë dhe sigurimeve shoqërore janë realizuar në masën 91%. Pagesat ndaj Këshillit Drejtues dhe Këshillit Teknik janë realizuar në masën 93%.

Shuma e planifikuar për shpenzimet për punonjës të larguar nga puna, nga 28.5 milionë lekë të planifikuara janë paguar detyrime në vlerën 936,525 lekë ose në masën 3%.

Shpenzimet për udhëtime e dieta brenda vendit janë realizuar në masën 51%, si dhe nuk është realizuar edhe zëri i shpenzimeve për udhëtim e dieta jashtë vendi, pasindodhur në situatën e krijuar nga pandemia globale Covid-19, institucioni për periudhën MarsóMaj pothuajse nuk u kryen shërbime dhe udhëtime nga punonjësit e AKBN-së, si dhe nuk ka kryer shërbime jashtë vendit.

Zëri ÷Konsulenca, Oponentra Trajnimeo është realizuar në masën 51% dhe i përket pagesave për konsulentët e Grupit të Oponentra Teknike të Hec-eve për një periudhë 3 mujore, pasi në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, aktiviteti i Grupit të Oponentra Teknike për muajt Mars dhe Prill 2020 u pezullua (shkresa Nr. 489/10 Prot., datë 28.04.2020), ekspertit të transkriptimit të të dhënave hidrokarbure dhe konsulentit të kësaj drejtorie, konsulentët e Drejtorisë së Energjive të Rinovueshme për projektet buxhetore të Programit ÷Mbështetje për energjinë, eksperti për akreditimin e laboratorit, bazuar në kontratën e shërbimit Nr. 326/1 Prot., datë 29.01.2020.

Zërat ÷Blerje bojë printerë është realizuar në masën 91%, ÷Kancelarië në masën 95.7% dhe ÷Letërë janë realizuar në masën 79%.

÷Blerje materiale të tjerao është realizuar në masën 60% e cila përfshin kryerjen e procedurave për goma makine për automjetet e AKBN-së, pjesë për fotokopje dhe kompjutera, blerje rroba e vegla pune, material pastrimi dhe dezinfektimi për masat anti-Covid, reagent dhe pajisje laboratorike, shtypshkrime dhe kartëvizita etj.

Shpenzimet utilitare për energji elektrike, ujë, postë, telefon, fax dhe celular janë realizuar 4.37 milionë ose 73%.

Shpenzimi për blerje karburanti është realizuar në shumën 2.537 milionë lekë ose 100%.

Sa i përket zërit të shpenzimeve për shërbime dhe riparime është realizuar 3.45 milionë lekë ose 63% dhe përfshin shpenzime për shërbime interneti, mirëmbajtje Financa 5, shpenzime dokumentacion makine, vaj, filtra dhe kontroll teknik, siguracion për automjetet e institucionit, mirëmbajtje ambienti, mirëmbajtje e sistemit ngrohës-ftohës, shpenzime gjeneratori, sigurim për godinat në Tiranë dhe Fier etj.

Zëri Roje objekti është realizuar në masën 54 %, për arsye së kontratat për sigurimin e godinave me roje i shtrijnë efektet e tyre deri në muajin Shtator dhe Tetor të vitit 2020.

Gjithashtu zëri Qira godine Fier është realizuar sipas planit 6.88 milionë lekë ose 96%.

Në zërin Mirëmbajtjet për sistemet Gis dhe Revzon, të cilat janë realizuar në masën 4% janë përfshirë dy mirëmbajtje sistemesh për sistemin GIS dhe mirëmbajtja e sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore REVZONE.

Vlera e planifikuar për vitin 2020 për këto dy mirëmbajtje i referohej VKM Nr. 710 datë 21.08.2013, òPër krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimitò pika 2/b) për sistemet ekzistuese, për një afat 2 vjeçar. Për efekt prokurimi në kuadër të Marrëveshjes në vitin 2020 është pasqyruar vlera totale jo më e vogël së 2 vjet. Kontratat për mirëmbajtjet e mësipërme u lidhën nga AKSHI, bazuar në VKM Nr. 673 datë 22.11.2017, respektivisht:

-Kontrata Nr. 5418 prot. datë 19.10.2020 për òMirëmbajtja për serverat dhe pajisjet elektronike të dhomës së serverëve dhe sistemit GISò me vlerë totale 29.44 milionë lekë (pa TVSH),

-Kontrata Nr. 5301 prot. datë 14.10.2020 për òMirëmbajtja e sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore REVZONò me vlerë totale 2.92 milionë lekë (pa TVSH).

Shpenzimi Organizim eventesh dhe promovimuk është realizuar për shkak të situatës së pandemisë globale.

Në zërin Tatime dhe Taksa janë kryer pagesat për taksën e Bashkisë në shumën 1.6 milionë lekë ose 96%.

Viti 2021

Në zbatim të Ligjit nr. 137/2020 òPër buxhetin e vitit 2021ò dhe në vijim të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 4, datë 25.01.2021 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2021ò, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò AKBN-së i janë planifikuar fonde buxhetore për projekte për vitin 2021 në shumën 62,550,000 lekë dhe për investimet e huaja (TVSH-në) është planifikuar një fond prej 12,700,000 lekë, ku plani është miratuar nga MIE dhe është dërguar detajimi pranë AKBN-së me shkresën nr.383/11 datë 17.02.2021 .

Në zbatim të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 òPër procedurat standarde te monitorimit të buxhetitò janë përgatitur raportet e monitorimit nga AKBN-ja dhe janë dërguar në Ministrinë e linjës. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për projektet e financuar nga buxheti i shtetit paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 15

| Nr. | Emërtimi | Plan | Fakt | % e realizimit |
|-----|--|-------------------|-------------------|----------------|
| 1 | Programi Mbështetës për burimet natyrore | 45,100,000 | 45,100,000 | 100% |
| 2 | Programi Mbështetës për Energjinë | 17,450,000 | 17,450,000 | 100% |
| | Totali | 62,550,000 | 62,550,000 | 100% |

Burimi: Drejtoria e ekonomike e AKBN-së

Të dy programet buxhetore të financuara nga buxheti i shtetit janë realizuar 100%.

Gjatë vitit 2021, kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme sa i takon buxhetit me financim të brendshëm nga MIE:

Tabela nr. 16

| Programi “Mbështetje për Energjinë” | | | |
|--|--|------------------------|---|
| Shkresa | Projekti | Shtesa/Pakësime | Komente |
| Nr.57/11,datë 25.10.2021 | Proenergy | +1,500,000 lekë | Miratur me vendim të KD nr.6, datë 06.12.2021 |
| Nr. 57/17, datë 09.12.2021 | TVSH për Games Target Blue Deal Sme.ec | +1,500,000 lekë | Miratur me Vendimin Qarkullues të KD nr.8 datë 20.12.2021 |
| | Kostot lokale për Games Target Blue Deal Sme.ec dhe Resource | +1,700,000 lekë | |
| | TVSH për òLEDò | -1,200,000 lekë | |
| | TVSH për òAquanexò | -1,000,000 lekë | |
| | TVSH për òSeadriò | -1,000,000 lekë | |

*Burimi: Drejtoria ekonomike, AKBN
Përpunuar nga grupi i auditimit.*

Analiza e shpenzimeve të realizuar nga aktiviteti i AKBN-së për vitin 2021

AKBN-ja ka bërë planifikim e shpenzimeve për vitin buxhetor, ku me shkresën nr. 57, datë 07.01.2021 është realizuar projekt drafti i shpenzimeve për vitin 2020, i cili është paraqitur pranë Këshillit Drejtues për miratim. Me vendimin nr. 1, datë 26.02.2021 Këshilli Drejtues ka miratur òBuxhetin afatmesëm për vitet 2021-2023ò, si dhe me shkresën nr.938/1 prot,datë 26.02.2021 òMbi miratimin e programit ekonomik për vitin 2021, Ministri i MIE ka dërguar miratimin e vendimit të KD. Sa i takon shpenzimeve, gjatë vitit 2021 janë bërë ndryshimet e mëposhtme:

Tabela nr. 17

| Shpenzimet | | | |
|----------------------------|---|------------------------|---|
| Shkresa | Shpenzimet | Shtesa/Pakësime | Komente |
| Nr. 57/6, datë 25.08.2021 | Shpenzime për udhëtim e dieta brenda vendit | +4,000,000 lekë | Miratur me Vendimin Qarkullues nr.4 të KD datë 31.08.2021 |
| | Shpenzime për udhëtim e dieta jashtë vendit, trajnime, konferenca, seminare | -4,000,000 lekë | |
| Nr. 57/12, datë 26.11.2021 | Shpenzime utilitare energji elektrike | +600,000 lekë | Miratur me Vendimin Qarkullues të KD nr.7 datë 06.12.2021 |
| | Shpenzime utilitare postë, telefon, fax | -600,000 lekë | |

*Burimi: Drejtoria ekonomike, AKBN
Përpunuar nga grupi i auditimit.*

Shpenzimet e realizuara për vitin 2021

Tabela nr. 18

Në lekë

| Nr | Emërtimi i shpenzimeve | Plan | Fakt | % realizimit |
|-----------|---|-------------|-------------|---------------------|
| 1 | Paga bazë, shpërblim, pun. kontrat.sig. shoq. | 268,000,000 | 233,605,402 | 87% |
| 2 | Pagesa e KD dhe KT | 5,000,000 | 4,817,304 | 96% |
| 3 | Pagesa për punonjës të larguar | 30,000,000 | 501,444 | 1.7% |
| 4 | Shpenzime për udhëtim e dieta brenda vendit | 10,000,000 | 9,321,780 | 93% |
| 5 | Shpenzime për udhëtim e dieta jashtë vendit | 10,000,000 | 1,411,318 | 14% |
| 6 | Shpërblime për punonjësit | 17,000,000 | 14,224,379 | 84% |
| 7 | Konsulenca oponentra trajnime | 13,725,000 | 5,092,000 | 37% |
| 8 | Bojë printer, kancelari, letër | 1,200,000 | 1,120,900 | 93% |

| | | | | |
|----|--|-------------|------------|-------|
| 9 | Blerje materiale e të tjera | 3,400,000 | 1,514,077 | 44.5% |
| 10 | Blerje Karburanti | 3,000,000 | 2,921,670 | 97% |
| 11 | Energji elektrike ujë | 4,000,000 | 3,986,954 | 99.7% |
| 12 | Shpenzime telefonie | 2,000,000 | 1,282,918 | 64% |
| 13 | Rojet e objektit | 17,400,000 | 10,407,849 | 60% |
| 14 | Qera godine (Fier) | 7,200,000 | 7,058,828 | 98% |
| 15 | Shpenzime për procese gjyq. dhe arbitrazhi | 153,250,831 | 73,004 | 0.05% |
| 16 | Shpenzime jete për punonjësit | 570,000 | 570,000 | 100% |
| 17 | Shpenzime për shërbime dhe riparime | 4,309,720 | 3,043,810 | 70.6% |
| 18 | Shpenzime laborator | 500,000 | 143,998 | 29% |
| 19 | Mirëmbajtje e sistemit Gis | 16,461,075 | 15,234,408 | 93% |
| 20 | Mirëmbajtje e sistemit Revzon | 1,652,312 | 1,530,645 | 93% |
| 21 | Tatim taksa | 2,000,000 | 1,638,600 | 82% |

Burimi: Drejtoria ekonomike, AKBN

Zërat e shpenzimeve për pagën bazë të punonjësve me kontratë dhe sigurimeve shoqërore janë realizuar në masën 87%. Pagesat ndaj Këshillit Drejtues dhe Këshillit Teknik janë realizuar në masën 96%.

Fondi i pagesave për Shpenzime për punonjës të larguar nga puna ka qenë minimal, rreth 0.5 milionë lekë, sepse për shkak të situatës së pandemisë shumë nga proceset gjyqësore që iu përkasin ish-punonjësve janë shtyrë në kohë dhe do të kryhen gjatë periudhës në vazhdim.

Shpenzimet për udhëtime e dieta brenda vendit janë realizuar në masën 9.3 milionë lekë ose 93.2% të fondit të planifikuar. Gjithashtu gjatë këtij viti për shkak të situatës së pandemisë u kryen shumë pak Udhëtime jashtë vendit dhe realizimi ishte në shumën 1.4 milionë lekë ose 14.1%.

Zëri Konsulenca Oponenca është realizuar në masën 5.09 milionë lekë ose 37.1% dhe i përket pagesave për konsulentët e Grupit të Oponencës Teknike të Hec-eve (1,440,000 lekë), konsulentët e Drejtorisë Hidrokabure (2,772,000 lekë), konsulentët e Drejtorisë së Energjive të Rinovueshme (500 000 lekë) dhe ekspertit për certifikimin e pasqyrave financiare të vitit 2020 (380,000 lekë)

Zërat Blerje bojë printeri, kancelari dhe letër janë realizuar respektivisht 88%, 96.6%, dhe 97.75% dhe përfshijnë procedura të kryera për mbarëvajtjen e punës së përditshme në institucion.

Blerje materiale të tjera është realizuar në masën 1.5 milionë lekë ose 45.5% dhe përfshin kryerjen e pagesave për procedurat për goma makine për automjetet e AKBN-së, pjesë për fotokopje dhe kompjutera, blerje rroba e vegla pune, goma, materiale pastrimi e dizifektimi për masat anti-Covid, reagent dhe pajisje laboratorike, shtypshkrime, kartëvizita etj.

Shpenzimet utilitare i përkasin shpenzimeve për energji eklektike, ujë, postë, telefon, fax dhe celular, që për vitin 2021 janë realizuar 5.26 milionë ose 88%.

Shpenzimi për Blerje karburanti është realizuar në shumën 2.9 milionë lekë ose 97%.

Përsa i përket zërit të Shpenzimeve për shërbime dhe riparime është realizuar 3.6 milionë lekë ose 70% dhe përfshin shpenzime për shërbime interneti, mirëmbajtje Financa 5, shpenzime dokumentacion makine, vaj, filtra dhe kontroll teknik, siguracion për automjetet e institucionit, mirëmbajtje ambienti, mirëmbajtje e sistemit ngrohës-ftohës, shpenz. gjeneratori, sigurim për godinat në Tiranë dhe Fier etj.

Zëri Roje objekti për vitin 2021 është realizuar në masën 10.4 milionë lekë ose 60 %.

Pagesat për këtë zë janë bazuar në kontratat ekzistuese: S.S., Kontrata Nr.1834/34 Prot., datë. 15.10.2020 (Ruajtje objekti për periudhën 15.10.2020 -15.10.2021), M.S. Kontrata Nr. 1834/19 Prot, datë 03.09.2020 (Ruajtje objekti për periudhën 03.09.2020-03.09.2021), si dhe kontratën e

re lidhur me shoqërinë d.l.G.ö sha Nr. 1143/12 prot., datë 01.09.2021 për dy godinat Tiranë (Ruajtje objekti për periudhën 16.10.2021-15.08.2020) dhe Fier (Ruajtje objekti për periudhën 04.09.2021-03.07.2022).

Zëri Qera godine Fier është realizuar sipas planit 7.058 milionë lekë ose 98%, bazuar sipas Kontratës Nr. 9208/9 Prot., datë 31.12.2018.

Zëri Shpenzime laboratorit është realizuar në masën 0.14 milionë lekë ose 29% e fondit të planifikuar dhe përfshin shpenzime për sigurimi ambjenteve, kalibrimi i mjeteve matëse dhe shërbime në DPA.

Në zërin Mirëmbajtjet për sistemet Gis dhe Revzon, janë përfshirë mirëmbajtja për serverat dhe pajisjet elektronike të dhomës së serverave dhe sistemit GIS dhe mirëmbajtja e sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncensioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore REVZON.

Vlera e planifikuar për vitin 2021 për këto dy mirëmbajtje i referohej VKM Nr. 710 datë 21.08.2013, për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimito pika 2/b) për sistemet ekzistuese, për një afat 2 vjeçar.

Kontratat për mirëmbajtjet e mësipërme u lidhën nga AKSHI, bazuar në VKM 673 datë 22.11.2017, respektivisht:

-Kontrata Nr. 5418 Prot. datë 19.10.2020 për pikën 1, me vlerë totale 29.44 milionë lekë (pa TVSH), dhe realizimi për vitin 2021 është në vlerën 15.23 milionë lekë ose 93%.

-Kontrata Nr. 5301 Prot. datë 14.10.2020 për pikën 2, me vlerë totale 2.92 milionë lekë (pa TVSH), dhe realizimi për vitin 2021 është në vlerën 1.53 milionë lekë ose 93%.

Fondi i planifikuar për zërin Shpenzime për procese gjyqësore dhe arbitrazhi për vitin 2021 ishte 153.25 milionë lekë. Me shkresën nr. 57/12, datë 26.11.2021 është miratuar kryerja e pagesës të studios ligjore H.L., si detyrimi për vendimin e arbitrazhit ndaj B. 1.16 milionë \$ (124 milionë). Kjo pagesë nuk u krye gjatë vitit 2021 në kushtet kur për mosdakordësitë me kompaninë B. çështja është adresuar për zgjidhje në arbitrazh dhe AKBN-MIE ende nuk ka marrë një vendim për pagesë. Ky detyrim është mbartur në bilancin e institucionit si dhe në planifikimin e buxhetit të vitit 2022.

-Shpenzimet gjyqësore të detyrueshme për t'u paguar (palëve paditëse dhe zyrave përmbartimore) për punonjës të larguar dhe subjekte të ndryshme që kanë procese gjyqësore me institucionin. Gjatë këtij viti, institucioni pagoi vetëm një vendim gjyqi ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore 73 004 lekë.

Në zërin Tatime dhe Taksa janë kryer pagesat për taksën e Bashkisë në shumën 1.64 milionë lekë ose 82%.

c. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave

Viti 2018 dhe 2019

Këshilli Drejtues ka miratuar Buxhetin për vitin 2018, me vendimin nr. 3, datë 16.05.2018 dhe Buxhetin për vitin 2019 me vendimin nr. 4, datë 24.05.2019.

Plani i të ardhurave paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 19


Në lekë

| Nr | Emërtimi | Plan 2018 | Fakt 2018 | % | Plan 2019 | Fakt 2019 | % |
|-----------|--------------------------|------------------|------------------|----------|------------------|------------------|----------|
| 1 | Drejtoria Minerare | 22,202,859 | 21,678,722 | 98% | 22,000,000 | 11,246,244 | 51% |
| 2 | Drejtoria Monitorimit të | 5,500,000 | 15,900,000 | 289% | 11,000,000 | 5,712,000 | 52% |

| | | | | | | | |
|---------------|--------------------------|--------------------|--------------------|------------|--------------------|--------------------|------------|
| | Hec-eve | | | | | | |
| 3 | Drejtoria Hidrokarbureve | 452,378,600 | 250,608,324 | 51% | 498,176,683 | 131,968,177 | 26% |
| Totali | | 520,081,459 | 287,925,385 | 55% | 531,176,683 | 148,926,421 | 28% |

Burimi: AKBN, përpunuar nga grupi i auditimit

Bazuar në sa më sipër, të ardhurat e përgjithshme të institucionit gjatë vitit 2018 u realizuan në masën 55% kundrejt totalit të planifikuar të të ardhurave nga aktiviteti i AKBN-së, ndërsa në vitin 2019 u realizuan në masën 28% ndaj totalit të planifikuar, duke pësuar një rënie prej 27% në arkëtimin e të ardhurave.



- *Në fushën minerare:* Në vitin 2018 janë arkëtuar 98% e të ardhurave të planifikuara, ndërsa në vitin 2019 janë arkëtuar 51% e të ardhurave të planifikuara, të cilat janë përfituar nga të ardhurat nga kryerja e aktverifikimeve, oponencave dhe analizave laboratorike. Shkak i mosrealizimit të të ardhurave janë vonesat në shpalljen e zonave të tenderuara dhe lejeve minerare për vitin 2019, të cilat kanë ndikuar në mos kryerjen e pagesave të aktverifikimeve dhe oponencave teknike të subjekteve.

-*Në fushën hidroenergjetike:* Për vitin 2018 janë realizuar në masën 289% të të ardhurave të planifikuara, duke tejkaluar fondin e planifikuar për tu arkëtuar gjatë kësaj periudhe. Të ardhurat e arkëtuara janë nga tarifat e oponencës teknike dhe studimeve të fizibilitetit të cilat kapin vlerën prej 15.9 milionë lekë.

Në vitin 2019 nuk u realizuan plotësisht të ardhurat e planifikuara si rezultat i pezullimit të procedurës për kryerjen e Oponencës Teknike bazuar në Urdhrin e Ministrit nr.47, datë 30.01.2019 dhe rinisjen e veprimtarisë me Urdhrin e Ministrit nr. 311, datë 31.07.2019.

- *Në fushën hidrokarbure:* Në vitin 2018 janë arkëtuar në masën 51% të të ardhurave të planifikuara, ndërsa në vitin 2019 janë arkëtuar në masën 26%, duke pësuar rënie masën 25%, të cilat janë përftuar nga detyrimet që kanë kompanitë hidrokarbure ndaj AKBN-së. Për vitin 2018 në AKBN janë arkëtuar 35.7 milionë lekë nga DGC ose rreth 17 % të të ardhurave të planifikuara për tu likuiduar në vitin 2018, si dhe vlera prej 164.1 milionë lekë nga kompania S. për pagesën e bonusit të nënshkrimit për bllokun 4 dhe 10.7 milionë lekë të detyrimeve sipas aktmarrëveshjes së nënshkruar për bllokun 2.3. Në vitin 2018 në AKBN u arkëtua shuma prej 40 milionë lekë nga A. bazuar në Urdhrin e MIE-së nr. 862, datë 13.12.2018 mbi ÷Miratimin e shpërndarjes së të ardhurave që përfitohen nga marrëveshjet e hidrokarbureve.

Për vitin 2019 në AKBN janë arkëtuar nga marrëveshja Hidrokarbure për Bllokun 2-3 dhe 4 (400 mijë \$), si pagesë për programet e kualifikimit dhe si bonus trajnimi, të cilat janë realizuar plotësisht me pagesat e kryera nga kompania S..Nga Kompania D.G.C. janë arkëtuar rreth 900 mijë \$, vetëm 27.5% e të ardhurave planifikuar për tu arkëtuar gjatë vitit 2019.

Viti 2020 dhe 2021

Këshilli Drejtues ka miratuar me vendimin nr. 13, datë 04.03.2020 ÷Buxhetin për vitin 2020÷ dhe me vendimin nr. 1, datë 13.01.2021 ÷Buxhetin për vitin 2021÷.

Plani i të ardhurave paraqitet si më poshtë:


Tabela nr. 20

Në lekë

| Nr | Emërtimi | Plan 2020 | Fakt 2020 | % | Plan 2021 | Fakt 2021 | % |
|---------------|----------------------------------|--------------------|--------------------|------------|--------------------|--------------------|------------|
| 1 | Drejtoria Minerare | 9,259,100 | 13,191,612 | 142% | 11,900,000 | 8,954,868 | 75.2 |
| 2 | Drejtoria Monitorimit të Hec-eve | 11,135,723 | 13,000,000 | 117% | 6,820,000 | 1,920,000 | 28.1 |
| 3 | Drejtoria Hidrokarbureve | 692,055,000 | 641,514,386 | 93% | 249,619,000 | 145,332,900 | 58.2 |
| Totali | | 712,449,823 | 667,705,998 | 94% | 268,339,000 | 156,207,768 | 58% |

Burimi: AKBN, përpunuar nga grupi i auditimit

Bazuar në sa më sipër, të ardhurat e përgjithshme të institucionit gjatë vitit 2020 u realizuan në masën 94% kundrejt totalit të planifikuar të të ardhurave nga aktiviteti i AKBN-së, ndërsa në vitin 2021 u realizuan në masën 58% ndaj totalit të planifikuar, duke pësuar një rënie prej 36% në arkëtimin e të ardhurave.



- *Në fushën minerare:* Në vitin 2020 janë arkëtuar 142% e të ardhurave të planifikuara, ndërsa në vitin 2021 janë arkëtuar 75.2% e të ardhurave të planifikuara, të cilat janë përfituar nga të ardhurat nga kryerja e aktverifikimeve, oponencave dhe analizave laboratorike.

-*Në fushën hidroenergjetike:* Për vitin 2020 janë realizuar në masën 117% të fondit të planifikuar, të realizuara nga pagesat e tarifave të oponencës teknike dhe studimeve të fizibilitetit


të projekteve që paraqiten në AKBN, të cilat janë tejkaluar gjatë kësaj periudhe dhe janë realizuar në masën 13 milionë lekë (91 pagesa).

Në vitin 2021 të ardhurat e tjera nga pagesat e tarifave të oponencës teknike dhe studimeve të fizibilitetit të projekteve që paraqiten në AKBN të cilat janë realizuar në masën 1.92 milionë lekë (7 pagesa) ose 28.1 % e fondit të planifikuar.


- *Në fushën hidrokarbure:* Në vitin 2020 janë arkëtuar në masën 93% të të ardhurave të planifikuara, ndërsa në vitin 2021 janë arkëtuar në masën 58.2%, duke pësuar rënie masën 34.8%, të cilat janë përfutur nga detyrimet që kanë kompanitë hidrokarbure ndaj AKBN-së.

Për vitin 2020 në AKBN janë arkëtuar shuma 31.20 milionë lekë nga marrëveshja hidrokarbure për bllokun 2-3, si dhe 34.39 milionë lekë nga marrëveshja hidrokarbure për bllokun 4, si pagesë për bonus trajnimi dhe administrimi. Nga DGC gjatë kësaj periudhe janë arkëtuar të ardhura në shumën 499,792 \$ ose 53.46 milionë lekë. Nga marrëveshja bllokun Dumrea, si pagesë për bonus nënshkrimi administrimi dhe trajnimi sipas VKM Nr. 187 datë 26.02.2020, është arkëtuar shuma 522.45 milionë lekë.

Për vitin 2021 në AKBN janë arkëtuar shuma 52.4 milionë lekë nga marrëveshja hidrokarbure për bllokun Dumrea, 61.6 milionë lekë nga marrëveshja hidrokarbure për bllokun 2-3 dhe 4, si dhe nga D G C për një detyrim të mbetur (1.2 milionë USD planifikuar për vitin 2021), shuma 300 000 USD ose 31.2 milionë lekë, e cila është realizuar në masën 25%.



Nga analiza e të ardhurave të planifikuara dhe të ardhurave të realizuara për vitet 2018-2021, viti 2019 ka qenë viti në të cilin AKBN ka arkëtuar më pak të ardhura në krahasim me fondin e planifikuar. Në vitin 2020, pavarësisht nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, janë realizuar rreth 94% e të ardhurave të planifikuara, duke qenë ky viti në të cilin institucioni ka shlyer dhe detyrimet e prapambetura nga viti i mëparshëm, për shkak të mungesës së likuiditetit nga mosrealizimi i të ardhurave të planifikuara.



Nga analiza e planifikimit të zërave shpenzimeve dhe të ardhurave konstatohet së vetëm në vitin 2020 AKBN ka bërë planifikim më të lartë të të ardhurave që pret të arkëtojë në krahasim me shpenzimet, ndërsa për periudhën tjetër institucioni planifikon shpenzime më të larta së vetë të ardhurat që priten të arkëtohen nga institucioni, duke riskuar që institucioni të përballet me vështirësi ekonomiko- financiare gjatë realizimit të objektivave të saj.

| | |
|---------------------------|---|
| Titulli i gjetjes: | <i>Mbi mangësitë e konstatuara në përgatitjen e PBA-ve dhe tejkalimin e afatit të likuidimit të faturave</i> |
| Situata: | <p>Nga auditimi i PBA-ve të përgatitura nga institucioni konstatohet së për periudhën objekt auditimi, institucioni nuk ka ngritur Ekipin e Menaxhimit të Programit, për përgatitjen e PBA-së. Në përgatitjen e PBA-së janë konsideruar kërkesat e paraqitura nga drejtoritë e institucionit dhe janë përpunuar nga drejtoria ekonomike, veprime në kundërshtim me udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë <i>o</i> Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së <i>o</i> paragrafi 2.5 pika 1/a, paragrafi 2.5 pika 5.</p> <p>-AKBN nuk ka realizuar në kohë pagesat ndaj subjekteve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve. Nga kryerja e testeve mbi urdhër pagesat, rezultoi tejkalim i afatit ligjor sa i takon likuidimit të faturave. Konkretisht, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 <i>o</i> Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare <i>o</i> neni 7, 39 urdhër pagesa ,duke sjellë:</p> <p>a. Tejkalim të afateve që parashikon VKM nr.50, datë 05.02.2014 <i>o</i> Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimtë dhe Udhëzimit nr. 37 datë 06.10.2020 <i>o</i> Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara në një ligj/marrëveshje/vendim të gjykatës së formës së prerë që mbeten të papaguara 60 ditë, pas datës së lëshimit të faturës nga operatori ekonomik.</p> <p>b. mosrealizimi në kohë i të ardhurave të planifikuara nga buxheti i AKBN-së, sjell risk për krijimin e detyrimeve të prapambetura.</p> <p>-Nga analiza e planifikimit të zërave shpenzimeve dhe të ardhura konstatohet, së</p> |

| | |
|------------------------|---|
| | shpenzimet që institucioni planifikon janë më të larta së vetë të ardhurat që priten të arkëtohen nga institucioni, duke rrisur që institucioni të përballlet me vështirësi ekonomiko-financiare gjatë realizimit të objektivave të saj. -Grupi i auditimit konstatoi së institucioni ndër vite nuk ka një program zhvillimi afatmesëm ku të përcaktohen objektiva konkrete që të garantojnë rritjen e vazhdueshme të të ardhurave dhe rrjedhimisht të rezultatit të saj financiar |
| Kriteri: | Ligji nr. 48/2014 ðPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare ð neni 7, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ðPër menaxhimin financiar dhe kontrollin ð i ndryshuar neni 9,pika 4; VKM nr.50, datë 05.02.2014 ðPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit; Udhëzimit nr. 37 datë 06.10.2020 ðPër monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme. |
| Ndikimi/Efekti: | Risqe për krijimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe përballjen me vështirësi ekonomike financiare të institucionit, për realizimin e objektivave të saj. |
| Shkaku: | Mungesë e fondeve në dispozicion |
| Rëndësia: | E lartë |
| Rekomandimi: | -Titullari i institucionit të AKBN-së të marrë masa për krijimin Ekipin e Menaxhimit të Programit, çdo vit për përgatitjen e PBA-së, me qëllim për të mundësuar një planifikim sa më real të shpenzimeve korrente dhe investimeve, për përmbushjen e objektivave të institucionit. - Nga strukturat drejtuese dhe menaxhuese të institucionit, të punohet për një programim real të shpenzimeve dhe të ardhurave, duke u bazuar në mundësitë dhe kërkesat reale që ka institucioni, me qëllim eliminimin e formaliteteve në programimin e këtyre fondeve . Realizimi i burimeve të financimit të monitorohet në mënyrë sistematike, ku ndryshimet apo devijimet e mëdha nga plani fillestar të reflektohen në një plan të rishikuar. - AKBN të hartojë një pasqyrë të plotë të objektivave që synon të arrijë institucioni dhe mbi këtë bazë të përgatitet një program zhvillimi afatmesëm për qëndrueshmërinë ekonomike-financiare të institucionit. |

Për sa më sipër, mban përgjegjësi Drejtoria Ekonomike.

III.2.4. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Në zbatim të pikës nr. 4 të programit të auditimit nr. 1418/1, datë 12.01.2022, mbi ðAuditimin financiar e përputhshmërisë në AKBN, u shqyrtua dokumentacioni si mëposhtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër-shpenzim;
 - Transaksionet e llogarive bankare ;
 - Pagesa për shërbime e mallra/shërbime, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme;
 - Komisionet e ngritura për inventarizimin, jashtë përdorimit të materialeve dhe asgjësimin e tyre.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës

Nga auditimi me zgjedhje mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Agjencinë

Kombëtare të Burimeve Natyrore rezultoi së, veprimet janë kryer konform kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalët dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.) konform pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

- Të gjitha Urdhër Pagesat e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.09.2018-31.12.2018 janë në vlerën totale 124,614,546 lekë;
- Të gjitha Urdhër Pagesat e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 janë në vlerën totale 309,493,174 lekë;
- Të gjitha Urdhër Pagesat e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 janë në vlerën totale 788,471,609 lekë;
- Të gjitha Urdhër Pagesat e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 janë në vlerën totale 421,930,273 lekë.

Nga këto grupi i auditimit, me përzgjedhje auditoi transaksionet sipas urdhër pagesave të realizuara në muajt Dhjetor të vitit 2018; Prill, Tetor, Dhjetor të vitit 2019; Prill, Nëntor, Dhjetor të vitit 2020 dhe Mars, Prill, Dhjetor të vitit 2021. Grupi i auditimit përzgjodhi këto muaj pasi kanë përqindjen më të lartë të shpenzimeve mujore ndaj totalit.

Urdhër Pagesat e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *dokumentet autorizues, dokumentet vërtetues, dokumente të kontabilitetit, etj.*

Nga auditimi rezultoi:

- Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, pasqyrohen me dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.
- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit përgjithësisht është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dokumentet autorizues, dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.
- Gjatë auditimit të transaksioneve me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë u përdorën teknikat e auditimit si: kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.

Proceset gjyqësore

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të urdhër pagesave për proceset gjyqësore për periudhën 01.09.2018-31.12.2021 u konstatua së, në urdhër pagesat e listuara si më poshtë janë paguar gjyqëfituesit dhe subjektet përmbaruese gjyqësore private për tarifën e shërbimit përmbarimor. Shuma e detyrimeve për vendimet gjyqësore të paguara nga buxheti i AKBN-së për 2018 është në shumën 404,260, për vitin 2019 në shumën 3,586,067 lekë, nga të cilat 2,191,073 lekë janë për gjyqin e fituar nga një ish-punonjës dhe vlera prej 1,394,994 lekë për gjyqin e fituar nga

shoqëria S.P.E G.sh.p.k.. Për vitin 2020 në shumën 741,375 lekë janë për gjyqet e fituar nga një ish-punonjës dhe vlera prej 506,400 lekë për gjyqin e fituar nga D.N.sh.p.k. dhe A.R..

Tabela nr. 21

Në lekë

| Nr | Datë | Largim nga puna (Ish-punonjës) | | | |
|---------------|------------|--------------------------------|----------------------------|----------------------|--------------------|
| | | Përshkrimi | Pagesë për vendim gjyqësor | Shpenzimet gjyqësore | Tarifë përbarimore |
| 820 | 14.12.2018 | xx | 316,260 | 52,000 | 36,000 |
| 255 | 20.05.2019 | xx | 1,956,315 | 0 | 234,758 |
| 109 | 06.02.2020 | xx | 274,425 | 0 | 26,400 |
| 482 | 08.07.2020 | xx | 379,050 | 25,500 | 36,000 |
| TOTALI | | | 3,275,208 | 77,500 | 333,158 |

Burimi: Drejtoria Ekonomike, AKBN

Tabela nr. 22

Në lekë

| Nr | Datë | Shoqëritë Gjyqë fituese | | | |
|---------------|------------|--------------------------|----------------------------|----------------------|--------------------|
| | | Përshkrimi | Pagesë për vendim gjyqësor | Shpenzimet gjyqësore | Tarifë përbarimore |
| 477 | 23.08.2019 | Shoqëria S.P.E G.sh.p.k. | 1,058,330 | 187,200 | 149,464 |
| 483 | 09.07.2020 | D.N.sh.p.k. | 66,000 | 48,000 | 18,000 |
| 690 | 24.09.2020 | A.R. | 187,200 | 0 | 187,200 |
| TOTALI | | | 1,311,530 | 235,200 | 354,664 |

Burimi: Drejtoria Ekonomike, AKBN

Sa i takon pagesave të vendimeve gjyqësore të mësipërme, pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga AKBN-ja me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përbaruesit privat, duke paguar tarifa përbarimore.

| Titulli i gjetjes: | Pagesa e gjyqë fitueseve |
|--------------------|---|
| Situata: | <p>Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit të urdhër pagesave për periudhën 01.09.2018-31.12.2021 u konstatua së, pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga AKBN-ja me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përbaruesit privat, duke paguar tarifa përbarimore në shumën prej 698,892 lekë, veprime të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin AKBN-së, veprime në kundërshtim me Kodin e Procedurës Civile, neni 130 òRregullat e njoftimit shkresor të akteveo ku citon sëi .òNë rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteveo, nenit 451/a ku citon së í . òVendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palëtö dhe neni 510/a òTitujt ekzekutivëo.</p> <p>Nga auditimi i planifikimit të buxhetit për proceset gjyqësore konstatohet së për të gjithë proceset gjyqësore pavarësisht shkallëve të gjykimit janë llogaritur dhe shpenzimet përbarimore, për të cilën institucioni do të paguajë.</p> <p>Institucioni në këtë mënyrë ka paragjykuar së kreditori (pala fituese) do të kërkojë ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor, pa ju drejtuar institucionit për ekzekutimin vullnetar. Referuar Kodit të Procedurës Civile, neni 130 òRregullat e njoftimit shkresor të akteveo ku citon së... òNë rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteveo, institucionit i lind e drejta për ti kërkuar gjyqë fituesit paraqitjen e titullit ekzekutiv të vendimit të formës së prerë, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, me qëllim shmangien e</p> |

| | |
|------------------------|---|
| | kostove shtesë të tarifave të përmblyesit gjyqësor. |
| Kriteri: | Kodin e Procedurës Civile, neni 130 dhe Rregullat e njoftimit shkresor të akteve në neni 451/a; neni 510/a dhe Titujt ekzekutivë |
| Ndikimi/Efekti: | Krijimi i kostove shtesë në dëm të buxhetit të institucionit |
| Shkaku: | Mos fillimi i procedurave nga institucioni nda gjyqësor fituesit që me marrjen e njoftimit nga organet kompetente. |
| Rëndësia: | E mesme |
| Rekomandimi: | Drejtoria e Shërbimeve Ligjore në AKBN të marrë masat që me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë nga gjykata ti kërkojë fituesit paraqitjen e titullit ekzekutiv të vendimit pranë AKBN-së, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit. |

Për sa më sipër, mban përgjegjësi Drejtoria e Shërbimeve Ligjore.

Të drejtat e arkëtueshme (debitorët)

Grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin mbi të drejtat e arkëtueshme (debitorët) dhe urdhër xhirimet mbi të ardhurat e arkëtuara për periudhën 01.09.2018-31.12.2021.

AKBN përfiton të ardhura të tjera sipas projekteve të ndryshme, përkatësisht nga Drejtoria e Monitorimit të Hidrocentraleve për pagesat e tarifave të oponencës teknike dhe studimeve të fizibilitetit të projekteve. Në pagesat e shoqërive koncesionare për kryerjen e oponencës teknike nga ana e AKBN për projektet e ndërtimit të hidrocentraleve, nuk është llogaritur dhe paguar TVSH mbi vlerën e tarifës, por është konsideruar e përfshirë brenda saj, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 datë 24.07.2014 për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 39, pika 1, òa. *Në vlerën e tatueshme përfshihen elementet e mëposhtme: a) tatimet, taksat, detyrimet, tarifat dhe pagesa të ngjashme, me përjashtim të TVSH-së.*"

Për këtë arsye, Drejtoria e Monitorimit të HEC-eve, ka dërguar një shkresë njoftuese në subjektin që ka përfituar nga projekti mbi shlyerjen e detyrimit të TVSH-së, nga ku një pjesë e tyre, e kanë paguar detyrimin e TVSH-së, ndërsa për 108 subjekte, me një vlerë prej 4,460,000 lekë (22,300,000 lekë vlera e faturave gjithsej x 20% TVSH), nuk është lëshuar fatura përkatëse e TVSH-së dhe nuk janë arkëtuara të ardhurat nga institucioni.

Institucionit të AKBN-së i ka lindur e drejta për të arkëtuara të ardhurat për TVSH-në nga subjektet për projektin përkatës. Nga auditimi i llogarisë së debitorëve në pasqyrën e pozicionit financiar, u konstatua se nuk janë njohur në kontabilitet të drejtat e arkëtueshme për të ardhurat nga TVSH-ja që priten të arkëtohen nga institucioni në të ardhmen, veprime këto në kundërshtim me SKK 1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, pika 41 citohet ... *"Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur para ja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe njihen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Pasqyrat financiare, të përgatitura në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, i informojnë përdoruesit jo vetëm mbi transaksionet e shkuara të shoqëruara me arkëtime dhe pagesa, por edhe mbi detyrimet për tu paguar në të ardhmen si dhe mbi aktive që do të sjellin arkëtime në të ardhmen. Në këtë mënyrë, ato paraqesin informacione mbi transaksionet dhe ngjarjet e shkuara të cilat u shërbejnë përdoruesve më së miri në marrjen e vendimeve ekonomike."*

(Trajtuar më hollësisht në pikën e detyrimeve të prapambetura të Drejtorisë së Monitorimit të HEC-eve.)

b. Saktësia dhe rregullshmëria e veprimeve të kryera në magazinë

Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.

- U audituan me të zgjedhur dokumentacioni i magazinës për periudhën 01.09.2018-30.04.2020. Fletë daljet dhe fletë hyrjet e mallrave janë të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime të plotësuara adresën nga vjen malli dhe kujt i dërgohet malli.

Hyrja e mallrave në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletë-hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletë-hyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*, i ndryshuar. Kontabilizimet e fletë-daljeve dhe fletë hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës.

c. Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Inventarizimi i vitit 2018

Nga auditimi u konstatua së Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për vitin 2018, ka ngritur komisionin me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv nr. 21, datë 05.02.2019 *ËPër kryerjen e inventarizimit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët në gjithë drejtorinë dhe komisionin ËPër verifikimin e gjendjes aktuale të materialeve, pajisjeve dhe inventarit të imët në magazinën e AKBN-së, për vitin 2018 duke bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit.*

Përpara fillimit të procesit të inventarizimit, komisionet kanë fiksuar numrin rendor të fletë hyrjes dhe fletë daljeve, nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, veprim ky në përputhje me pikën 83 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*.

Më shkresën nr.1223/3 datë 18.02.2019 me lëndë *ËMbi rezultatet e inventarizimit të orendi pajisjeve dhe inventarit të imët në të gjitha drejtoritë e AKBN-së, nga komisioni i inventarizimit ka rezultuar së nuk ka diferenca të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet.*

Më shkresën nr. 1223/4 datë 18.02.2019 me lëndë *ËMbi rezultatet e inventarizimit të orendi pajisjeve dhe inventarit të imët, të kryer në magazinën e AKBN-së, nga komisioni i inventarizimit ka rezultuar së nuk ka diferenca të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet. Gjithashtu, komisionet propozuan për dalje jashtë përdorimi aktive në vlerën 9,573,025 lekë.*

Veprimet e mësipërme janë kryer në përputhje me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30 të MFE datë

27.12.2011 *oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Me urdhrin e titullarit të AKBN-së nr. 82 datë 17.05.2019 *oPër ngritjen e komisionit për vlerësimin e praktikës për nxjerrjen jashtë përdorimit të AAMö, është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve i cili ka marr në shqyrtim listat e materialeve të propozuara për dalje jashtë përdorimit duke verifikuar gjendjen e secilit aktiv si dhe arsyet e propozimit për nxjerrje jashtë përdorimi. Në fund të procesit të vlerësimit të aktiveve, komisioni ka përpiluar relacionin e vlerësimit të aktiveve, nga ku rezultoi:*

Tabela nr. 23

Në lekë

| <i>Viti 2018</i> | <i>Totali i propozuar për dalje jashtë përdorimi</i> | <i>Shuma e vlerësuar nga komisioni i vlerësimit për dalje jashtë përdorimi</i> | <i>Vlera e mbetur në inventar</i> |
|------------------------|--|--|-----------------------------------|
| <i>Mjete Kryesore</i> | 4,084,010 | 1,451,070 | 2,632,940 |
| <i>Inventar i imët</i> | 415,432 | 231,951 | 183,481 |
| <i>Automjete</i> | 5,073,583 | 0 | 5,073,583 |
| Totali | 9,573,025 | 1,683,021 | 7,890,004 |

Burimi: Drejtoria Ekonomike, AKBN

Komisioni i vlerësimit të aktiveve hartoi procesverbalin dhe relacionin e vlerësimit të aktiveve në përputhje me pikën 104 dhe 106 të udhëzimit të MFE nr.30 datë 27.12.2011 *oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö*

Me vendimin nr.8 datë 02.09.2019, Këshilli Drejtues vendosi nxjerrjen jashtë përdorimi të AAM-ve në vlerën prej 1,683,021 lekë.

Inventarizimi i vitit 2019

Për vitin 2019, AKBN ka ngritur komisionin me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv nr. 4, datë 28.01.2020 *oPër kryerjen e inventarizimit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët në gjithë drejtorinë dhe komisionin oPër verifikimin e gjendjes aktuale të materialeve, pajisjeve dhe inventarit të imët në magazinën e AKBN-së, për vitin 2019ö dhe ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit.*

Përpara fillimit të procesit të inventarizimit, komisionet kanë fiksuar numrin rendor të fletëve hyrjes dhe fletëve daljeve, nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, veprim ky në përputhje me pikën 83 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Më shkresën nr.891/2 datë 13.02.2020 me lëndë *oMbi rezultatet e inventarizimit të orendi pajisjeve dhe inventarit të imët në të gjitha drejtoritë e AKBN-sëö, nga komisioni i inventarizimit ka rezultuar së nuk ka diferenca të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet.*

Më shkresën nr.891/3 datë 14.02.2020 me lëndë *oMbi rezultatet e inventarizimit të orendi pajisjeve dhe inventarit të imët, të kryer në magazinën e AKBN-sëö, nga komisioni i inventarizimit ka rezultuar së nuk ka diferenca të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet. Gjithashtu, komisionet propozuan për dalje jashtë përdorimi aktive në vlerën 7,752,337 lekë.*

Veprimet e mësipërme janë kryer në përputhje me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30 të MFE datë 27.12.2011 *oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Me urdhrin e titullarit të AKBN-së nr. 100 datë 07.07.2021 *oPër ngritjen e komisionit për vlerësimin e praktikës për nxjerrjen jashtë përdorimit të AAM për vitin 2019ö, është ngritur*

komisioni i vlerësimit të aktiveve i cili ka marr në shqyrtim listat e materialeve të propozuara për dalje jashtë përdorimit duke verifikuar gjendjen e secilit aktiv si dhe arsyet e propozimit për nxjerrje jashtë përdorimi. Në fund të procesit të vlerësimit të aktiveve, komisioni ka përpiluar relacionin e vlerësimit të aktiveve, nga ku rezultoi:

Tabela nr. 24

Në lekë

| Viti 2019 | Totali i propozuar për dalje jashtë përdorimi | Shuma e vlerësuar nga komisioni i vlerësimit për dalje jashtë përdorimi | Vlera e mbetur në inventar |
|------------------------|---|---|----------------------------|
| Mjete Kryesore | 5,876,046 | 2,598,127 | 3,277,919 |
| Inventar i imët | 1,876,291 | 1,457,633 | 418,658 |
| Totali | 7,752,337 | 4,055,760 | 3,696,577 |

Burimi: Drejtoria Ekonomike, AKBN

Komisioni i vlerësimit të aktiveve hartoi procesverbalin dhe relacionin e vlerësimit të aktiveve në përputhje me pikën 104 dhe 106 të udhëzimit e MFE nr.30 datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*

Me shkresën nr. 2625/2 datë 26.08.2021 titullari i AKBN-së i ka dërguar Këshillit Drejtues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë relacionin e vlerësimit të aktiveve për dalje jashtë përdorimit të vitit 2019, për të cilat procedura nuk është kryer për shkak të gjendjes së pandemisë shkaktuar nga Covid-19.

Me vendimin nr.5 datë 06.12.2021, Këshilli Drejtues vendosi nxjerrjen jashtë përdorimi të AAM-ve në vlerën prej 4,055,760 lekë.

Inventarizimi i vitit 2020

Për vitin 2020, AKBN ka ngritur komisionin me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv nr. 27, datë 23.02.2021 *“Për kryerjen e inventarizimit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët në gjithë drejtorinë dhe komisionin për verifikimin e gjendjes aktuale të materialeve, pajisjeve dhe inventarit të imët në magazinën e AKBN-së, për vitin 2020 dhe ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit.*

Përpara fillimit të procesit të inventarizimit, komisionet kanë fiksuar numrin rendor të fletëve hyrjes dhe fletëve daljeve, nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, veprim ky në përputhje me pikën 83 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*.

Më shkresën nr.902/3 datë 12.03.2021 me lëndë *“Mbi rezultatet e inventarizimit të orendi pajisjeve dhe inventarit të imët në të gjitha drejtoritë e AKBN-së, nga komisioni i inventarizimit ka rezultuar së nuk ka diferenca të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet.*

Më shkresën nr.902/4 datë 12.03.2021 me lëndë *“Mbi rezultatet e inventarizimit të orendi pajisjeve dhe inventarit të imët, të kryer në magazinën e AKBN-së, nga komisioni i inventarizimit ka rezultuar së nuk ka diferenca të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet. Gjithashtu, komisionet propozuan për dalje jashtë përdorimi materialet e mëposhtme:*

Tabela nr.24

Në lekë

| Viti 2020 | Drejtoritë e AKBN-së | Magazina |
|------------------------|----------------------|-----------|
| Mjete Kryesore | 965,770 | 2,843,125 |
| Inventar i imët | 502,661 | 796,916 |
| TOTALI | 1,468,431 | 3,640,041 |

Veprimet e mësipërme janë kryer në përputhje me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

Me urdhrin e titullarit të AKBN-së nr. 37 datë 02.03.2022 òPër ngritjen e komisionit për vlerësimin e praktikës për nxjerrjen jashtë përdorimit të AAM për vitin 2020ö, është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve, i cili do të marrë në shqyrtim listat e materialeve të propozuara për dalje jashtë përdorimit duke verifikuar gjendjen e secilit aktiv si dhe arsyet e propozimit për nxjerrje jashtë përdorimi.

Respektimi i rregullave kontabël për nxjerrjen jashtë përdorimi të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabël për shkarkimin nga magazina

Me urdhrin e titullarit të AKBN-së nr.194, datë 18.10.2019 òPër ngritjen e komisionit për ndarjen e materialeve skrap nga mallrat jashtë përdorimi dhe asgjësimin e materialeve të mbeturaö, është ngritur komisioni i cili ka bërë realizimin e ndarjes së materialeve të cilat do shiten për skrap dhe materialeve të cilat do të asgjësohen.

Me urdhër të titullarit nr. 246, datë 27.12.2019 është ngritur komisioni për përcaktimin e vlerës fillestare të ankandit publik për materialet skrap. Komisioni me akt-vlerësimin nr. 948 prot., datë 29.02.2020 ka specifikuar vlerësimin e materialeve për skrap dhe çmimet e referencës bazuar në tregun e brendshëm.

Me urdhër të titullarit të institucionit nr. 11, datë 24.02.2020 është ngritur njësia e ankandit publik për shitjen e materialeve të vlerësuara për skrap.

Me shkresën nr.1441 prot., datë 08.04.2021, Drejtoria Ekonomike ka kërkuar informacion mbi fazën e punës në të cilën ndodhet shitja e materialit skrap për te vijuar me procedurat e mëtejshme të inventarizimit.

Me shkresën nr.1441/1 prot., datë 29.04.2021, Komisioni i Ankandit Publik ka informuar Drejtorinë Ekonomike të AKBN-së së procedurat e ankandit publik janë zhvilluar dy herë dhe janë anuluar për shkak të mosshfaqjes së interesit nga OE.

| Titulli i gjetjes: | <i>Ekzistenca e konfliktit të interesit përgjatë kryerjes së inventarizimit.</i> |
|---------------------------|---|
| Situata: | <p>Nga auditimi i procedurës së inventarizimit u konstatua së në Urdhrin nr. 21, datë 05.02.2019 òPër kryerjen e inventarizimit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët në gjithë drejtorinë e AKBN-së për vitin 2018, Urdhrin nr. 4, datë 28.01.2020 òPër kryerjen e inventarizimit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët në gjithë drejtorinë e AKBN-së për vitin 2019ö dhe Urdhrin nr. 27, datë 23.02.2021 òPër kryerjen e inventarizimit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët në gjithë drejtorinë e AKBN-së për vitin 2020ö komisioni i inventarizimit përbehet nga pesë anëtarë, ndër të cilët në përbërje të tyre ka patur Specialistin e Sektorit të Financës dhe Buxhetit në Drejtorinë Ekonomike. Në këtë proces nuk u konstatua firmosja e deklaratave të mungesës së konfliktit të interesit në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö, i ndryshuar ku citohet... 82.ö<i>Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesö.</i></p> <p>Gjithashtu veprimi mësipërm i vendosjes së specialistit të financës në komisionin e inventarizimit, bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinö, i ndryshuar, Neni 22, ku citohet:... 3.b <i>öndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë</i></p> |

| | |
|------------------------|--|
| | <i>për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave”.</i> |
| Kriteri: | Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 <i>“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i> , i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i> ”, i ndryshuar. |
| Ndikimi/Efekti: | Mangësi në procesin e inventarizimit |
| Shkaku: | Ngritja e komisionit të inventarizimit me punonjës në kushtet e konfliktit të interesit |
| Rëndësia: | E mesme |
| Rekomandimi: | AKBN të marrë masat që në ngritjen e komisionit të inventarizimit të verifikojë dhe vërtetojë mungesën e konfliktit të interesit, për të ruajtur plotësinë e aktiveve dhe regjistrimin e duhur në dokumentet kontabël. |

Për sa më sipër, mban përgjegjësi Drejtoria Ekonomike.

III.2.5. Mbi zbatimin e procesit të prokurimit publik.

a. Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.

b. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave punëve, mallrave dhe shërbimeve.

Auditimi i prokurimeve publike për vitin 4 mujorin III-2018, i 2019 dhe 4 mujori I-2020.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) **për 4 mujorin III-2018** me shkresën nr. 571 prot, datë 16.01.2019 ka dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) regjistrin e realizimeve.

Sipas regjistrin, janë realizuar 13 procedura prokurimi me vlerë totale të kontratave 4,864,136 lekë me TVSH dhe fond limit 3,712,039 lekë pa TVSH, me të ardhura nga vetë AKBN, nga të cilat:

4 mujori III-2018

Tabela nr. 25

Në lekë

| Nr. Procedurave të realizuara | Lloji procedurës së prokurimit | Vlera e kontratës me TVSH | Vlera e kontratës pa TVSH |
|--------------------------------------|--|----------------------------------|----------------------------------|
| 1 | Kërkesë për propozim (marrëveshje kuadër) | 3,031,870 | 2,526,558 |
| 7 | blerje me vlerë të vogël | 1,066,864 | 889,053 |
| 2 | sistem dinamik blerje bileta transporti ajror ndërkombëtar | 512,370 | 426,975 |
| 2 | blerje nën vlerën 100,000 lekë | 163,200 | 136,000 |
| 1 | me procesverbal rast emergjent | 89,832 | 74,860 |
| Totali 13 | | 4,864,136 | 4,053,446 |

Burimi: AKBN (regjistrat e realizimit të prokurimeve)

Për **vitin 2019**, me shkresat nr. 3410 prot, datë 17.05.2019, nr. 3410/1 prot., datë 27.09.2019 dhe nr. 1321 prot., datë 04.02.2020 janë dërguar në APP regjistrat e realizimeve të ndarë në tre katër mujorë sipas të cilave rezulton se janë kryer gjithsej 32 procedura prokurimi, me vlerë totale të kontratave 22,321,780 lekë dhe fond limit 18,321,310 lekë pa TVSH, nga të cilat:

Viti 2019

Tabela nr. 26

Në lekë

| Nr. Procedurave të realizuara | Lloji procedurës së prokurimit | Vlera e kontratës me TVSH | Vlera e kontratës pa TVSH |
|-------------------------------|--|---------------------------|---------------------------|
| 2 | T. Hapur (marrëveshje kuadër) | 11,376,785 | 9,480,654 |
| 14 | blerje me vlerë të vogël | 4,205,657 | 3,504,714 |
| 2 | Kërkesë për propozim | 5,466,000 | 4,555,000 |
| 3 | sistem dinamik blerje bileta transporti ajror ndërkombëtar | 857,346 | 714,455 |
| 6 | blerje nen vlerën 100,000 lekë | 370,373 | 308,644 |
| 5 | me procesverbal rast emergjent | 45,619 | 38,016 |
| Totali 32 | | 22,321,780 | 18,601,483 |

Burimi: AKBN (regjistrat e realizimit të prokurimeve)

Për 4 mujorin I-2020, Autoriteti Kontraktor-AKBN nuk ka dërguar në APP sipas legjislacionit të prokurimit publik regjistër realizimi, për shkak të shpalljes së situatës së jashtëzakonshme COVID-19, me Vendim të Këshillit të Ministrave, datë 24.3.2020 òShpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Në këtë periudhë është zhvilluar vetëm procedura e prokurimit òBlerje me vlerë të vogël me objekt òPërfitim i shërbimit të internetit për godinat e AKBN në Tiranë dhe Fierë me vlerë kontrate 156,000 lekë, me OE fitues òM.ò.

Për vitin 2019, u audituan në mënyrë të njëpasnjëshme procedurat e tenderave të hapur (3 procedura prokurimi) me të dhënat në tabelën më poshtë:

1. Tenderi me objekt: "Ruajtja dhe sigurimi fizik me roje i godinës së selisë qendrore të AKBNò- Loti I dhe òRuajtja dhe sigurimi fizik me roje i arkivës teknike hidrokarbure dhe depot e kampioneve të naftës Fierë- Loti II.

| | | |
|--|--|---|
| 1.Urdhër Prokurimi Nr. 69, Datë 26.04.2019 | 3.Njësia e Prokurimit B.P. - anëtar | 4.Komisioni VO S.H. -Kryetar D.R.-anëtar F.M.- anëtar |
| 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit T. Hapurò, | E.L.ò ò E.G.- ò | |
| 5.Fondi Limit (pa tvsh) 3,323,924 lekë - loti I 6,647,880 lekë òloti II | 6.Oferta fituese (pa tvsh) S.-3,160,218.16 lekë-loti I M.S.-6,320,436.32 lekë-Loti II | 7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) -163,706 lekë- loti I -327,444lekë-loti II |
| 8. Data e hapjes së tenderit 31.05.2019-loti I dhe loti II | 9.Burimi Financimit AKBN | 10.Operatorë Ekonomike: Loti I- 16 OE Loti II-5 OE |
| b. Kontrata | | |
| 14.Lidhja e kontratës Nr.856/35, Datë 10.09.2019-loti I Nr.856/27, datë23.07.2019-loti II | 15.Vlera e kontratës (me tvsh) 3,792,261.79 lekë-loti I 7,584,523.58 lekë-loti II | |

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Nga auditimi i dosjeve dhe në sistemin prokurimit elektronik (SPE) konstatohet së:

-**Loti I**, morën pjesë dhe paraqitën ofertat 16 OE nga të cilët u kualifikuan në vend të parë OE me vlerë të ofertës të barabartë 3,160,218.16 lekë pa TVSH: òD.S.ò, òS.S.ò, òR.S.ò, òA. S.ò, òC.M.S.ò, òM.S.ò, òL.S.ò, òT.S.ò dhe òF.S.ò. Pas përfundimit të afatit të ankimit,

në zbatim të nenit 66, pika 8 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, fituesi i procedurës zgjidhet me short. Në përfundim të shortit për shpalljen e fituesit rezultoi në vend të parë dhe fitues i tenderit, OE ðS.S.ö me vlerë oferte 3,160,218.16 lekë pa TVSH.

-**Loti II**, morën pjesë dhe paraqitën ofertat 5 OE, nga të cilët u kualifikuan në vend të parë OE me vlerë të ofertës të barabartë 6,320,436.32 lekë pa TVSH: öM.S.ö, F.S.2004ö dhe öP.ö. Pas përfundimit të afatit të ankimit, në zbatim të nenit 66, pika 8 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, fituesi i procedurës zgjidhet me short. Në përfundim të shortit për shpalljen e fituesit rezultoi në vend të parë dhe fitues i tenderit, OE öM.S.ö me vlerë oferte 6,320,436.32 lekë pa TVSH.

Lidhja dhe Zbatimi i kontratës.

Mefituesit e dy loteve janë lidhur kontratat respektive Nr. 856/35, datë 10.09.2019-loti I, me vlerë 3,792,261.79 lekë me TVSH dhe Nr. 856/27, datë 23.07.2019-loti II, me vlerë 7,584,523.58 lekë me afat 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

2. Tenderi me objekt:öBlerje karburantiö:

| | | |
|--|---|--|
| 1.Urdhër Prokurimi Nr. 117, Datë 27.06 .2019 | 3.Njësia e Prokurimit B.P. - anëtar A.L.ó ö E.K.- ö | 4.Komisioni VO Urdhër nr.118, datë 27.6.2019 S.H. -Kryetar S.M-anëtar E.B.óanëtar |
| 2.Lloji i Procedurës së Prokurimit T.Hapurö, | | |
| 5.Fondi Limit (pa tvsh) 3,000,000 lekë | 6.Oferta fituese (pa tvsh) 3,000,000 lekë | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit 22.8.2019 | 9.Burimi Financimit AKBN | 10.Operatorë Ekonomike: G. C. BOE öA dhe O. |
| b. Kontrata | | |
| 14.Lidhja e kontratës 2234/11 datë 13.9.2019 | 15.Vlera e kontratës (me tvsh) | |

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Nga auditimi i procedurës në SPE dhe dosjes fizike vënë në dispozicion të grupit të auditimit nuk rezulton mos përputhje mes kriterëve dhe rregullave të përcaktuara për prokurimin publik. Në tender morën pjesë 2 OE: GC G dhe BOE öA dhe O. duke u shpallur fitues i tenderit GCG me vlerë oferte 3,000, 000 lekë pa TVSH dhe marzh fitimi 8.6%.(vlera më e ulët).

Lidhja dhe Zbatimi i kontratës.

Mefituesin është lidhur kontrata nr.2234/11, datë 13.9.2019 me afat nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri me datë 31.12.2019.

3. Nga auditimi i prokurimeve me ösistem dinamik blerje të biletave të transportit ajror ndërkombëtarö për 4 mujorin III-2018 dhe vitin 2019, konstatohet së:

Autoriteti Kontraktor bazuar në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) nr.4, datë 09.01.2018 öMbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronikeö, pika 3, në fillim të vitit buxhetor ka ngritur Komisionin e Sistemit Dinamik (SD) për blerjen e biletave i përbërë nga 3 anëtarë.

Komisioni në zbatim të pikës 4 të udhëzimit të sipërcituar, ka bërë në çdo rast llogaritjen e fondit limit pas nxjerrjes së autorizimit për pjesëmarrje nga titullari, duke ju referuar treguesit të çmimeve në internet dhe përzgjedhur çmimin më të ulët.

Mbi bazën e fondit limit të llogaritur nga Komisioni, titullari i AK, referuar pikës 5 të Udhëzimit ka nxjerr urdhër prokurimet përkatëse dhe procedura e prokurimit është kryer nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (SPE).

Titulli i Gjetjes: Shpenzimet për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar në procedurat me sistem dinamik blerje.

Situata: Për 4 mujorin III-2018 dhe vitin 2019 konstatohet së në 3 raste (*blerja e biletave të avionit Urdhër pagesë datë 26.12.2018 me vlerë 264,795 lekë, Urdhër pagesa datë 03.9.2019 me vlerë 388,080 lekë dhe Urdhër pagesa datë 03.9.2019 me vlerë 204,375 lekë, gjithsej 857,250 lekë*):

-Blerja e biletave është realizuar afër datës së nisjes/udhëtimit (1-2 ditë) megjithëse ftesa për pjesëmarrje nga organizatorët e takimit/eventit etj. është dërguar disa javë para kryerjes së procedurave të prokurimit dhe blerjes së biletave. Një fenomen i tillë sjellë si pasojë riskun e blerjes së biletave me çmim më të lartë kur prokurohet 1-2 para datës së nisjes krahasuar me çmimet e tregut.

-Procedura e prokurimit në ndonjë rast është kryer para së të miratohet kërkesa nga ministri (*rasti kur kërkesa i është dërguar ministrit*), e pjesëmarrjes së titullarit/Drejtorit Ekzekutiv të AKBN në takime/evente, jashtë shtetit për të cilën detyrimisht kërkohet miratimi i ministrit të linjës sipas Urdhrit të Ministrit nr. 213, datë 20.8.2004 *ōPër miratimin e shërbimeve jashtë shtetit të drejtorëve të institucioneve të varësisë dhe të linjësō*, apo në ndonjë rast tjetër procedura është realizuar pa marrë miratimin e ministrit (*rasti kur mungon kërkesa drejtuar ministrit*). Shkak për këtë veprim ka qenë mos menaxhimi në kohë i përgatitjes së dokumentacionit për fillimin e procedurës së prokurimit.

Më konkretisht në procedurat:

1. Blerje e 3 biletave të avionit me vlerë 264,795 lekë (Urdhër pagesë datë 26.12.2018) destinacioni Tiranë-Londër (vajtje) Edinburg-Frankfurt (kthim) dhe Frankfurt-Tiranë, me Urdhër Prokurimin nr.370, datë **17.9.2018** ka filluar procedura, pas kërkesës së bërë nga Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë drejtuar Komisionit të blerjeve të vogla, me shkresën nr.1226/4, datë 12.9.2018. Ftesa për pjesëmarrje ka ardhur me postë elektronike datë **24.8.2018** dhe me datë 30.8.2018 është njoftuar Drejtori Ekzekutiv z. A.B. me shkresën nr.7226 prot. të këtij Sektori mbi kërkesat për pjesëmarrje në këtë trajnim. Me Urdhër të Drejtorit Ekzekutiv nr. 363, datë 31.8.2018 janë caktuar personat për pjesëmarrje: A.B., D.D.dhe E.K.. Bazuar në Urdhrin e Ministrit nr. 213, datë 20.8.2004 *ōPër miratimin e shërbimeve jashtë shtetit të drejtorëve të institucioneve të varësisë dhe të linjësō*, me shkresën nr. 7226/3, datë 12.9.2018 është kërkuar miratimi i shërbimit për Drejtorin Ekzekutiv nga Ministri i linjës, kërkesë e cila është miratuar me shkresën nr. 11572/1, datë 19.9.2018. Nga kronologjia e veprimeve të kryera konstatohet së procedura e prokurimit ka filluar (**18.9.2018**) pa u miratuar më parë kërkesa për shërbim e titullarit të AKBN (miratuar datë **19.9.2018**). Nga ana tjetër, nga momenti i dërgimit të ftesës për pjesëmarrje (datë 24.8.2018) deri në fillimin e procedurës (datë 17.9.2018) ka vonesa në përgatitjen e dokumentacionit për fillimin e procedurës së prokurimit.

2. Blerje e 3 biletave të avionit me vlerë 388,080 lekë (Urdhër pagesa datë 03.9.2019) me destinacion Tiranë-Gjenevë-Tiranë, me Urdhër Prokurimin nr. 66, datë 12.4.2019, ka filluar procedura, pas kërkesës së bërë nga Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë drejtuar Komisionit të blerjeve të vogla, me shkresën nr.229/4, datë 08.4.2019. Ftesa për pjesëmarrje është protokolluar me nr.2229, datë **21.3.2019** dhe me memo datë 21.03.2019 të Sektorit të Marrëdhënieve me

Jashtë është njoftuar Drejtori Ekzekutiv z. A.B. mbi kërkesat për pjesëmarrje në këtë takim. Me Urdhër të Drejtorit Ekzekutiv nr. 55, datë 21.03.2019 janë caktuar personat për pjesëmarrje: A.B., D.D. dhe A.L.. Me shkresën nr. 2223/3, datë 21.03.2019 është kërkuar miratimi i shërbimit për Drejtorin Ekzekutiv drejtuar Ministrit të linjës bazuar në Urdhrin e Ministrit nr.213, datë 20.8.2004. Në praktikën e urdhër pagesave mungon miratimi i kërkesës nga Ministri. Procedura e prokurimit ka filluar pa u miratuar kërkesa për shërbim e titullarit të AKBN. Nga momenti i dërgimit të ftesës për pjesëmarrje (datë 21.3.2019) deri në fillimin e procedurës (datë **12.4.2019**) ka vonesa në përgatitjen e dokumentacionit për fillimin e procedurës së prokurimit.

3. Blerje e 2 biletave të avionit me vlerë 204,375 lekë (Urdhër pagesa datë 03.9.2019) me destinacion Tiranë-Kiev-Tiranë, me Urdhër Prokurimin nr. 96, datë **24.5.2019**, ka filluar procedura, pas kërkesës së bërë nga Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë për blerje bileta avioni drejtuar Komisionit të blerjeve të vogla, me shkresën nr. 3526/5, datë 24.5.2019. Ftesa për pjesëmarrje është protokolluar me nr. 3526, datë **23.5.2019** dhe me memo datë 23.5.2019 të Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë është njoftuar Drejtori Ekzekutiv z. A.B. mbi kërkesat për pjesëmarrje në këtë takim. Me Urdhër të Drejtorit Ekzekutiv nr.94, datë 23.5.2019 janë caktuar personat për pjesëmarrje: A.B., D.D.. Në praktikën e urdhër pagesave mungon kërkesa e AKBN për miratimin e shërbimit nga Ministri i linjës bazuar në Urdhrin e Ministrit nr. 213, datë 20.8.2004 si dhe miratimi i kërkesës nga Ministri. Procedura e prokurimit ka filluar pa u miratuar kërkesa për shërbim e titullarit të AKBN. Nga momenti i dërgimit të ftesës për pjesëmarrje (datë 24.5.2019) deri në fillimin e procedurës (datë 24.5.2019) ka vonesa në përgatitjen e dokumentacionit.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1) Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 ÷Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm neni 8, pika 1, neni 9, pika 1 dhe neni 12, pika 3, germa a,

2) Urdhrin e Ministrit nr. 213, datë 20.8.2004 ÷Për miratimin e shërbimeve jashtë shtetit të drejtorëve të institucioneve të varësisë dhe të linjës.

Këto veprime janë kompetencë:

A.B., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të Njësisë (Drejtor Ekzekutiv i AKBN).

D.D. në cilësinë e Nëpunësit Zbatues të Njësisë (Drejtoria Ekonomike).

Kriteri: Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 ÷Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm neni 8, pika 1, neni 9, pika 1 dhe neni 12, pika 3, germa a, Urdhri i Ministrit nr.213, datë 20.8.2004 ÷Për miratimin e shërbimeve jashtë shtetit të drejtorëve të institucioneve të varësisë dhe të linjës.

Ndikimi/Efekti: Blerje e biletave me çmim më të lartë kur prokurohet 1-2 para datës së nisjes krahasuar me çmimet e tregut.

Shkaku: Mos menaxhimi në kohë i përgatitjes së dokumentacionit për fillimin e procedurës së prokurimit.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandime: Të merren masa nga titullari, që menjëherë pas dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në takime/evente jashtë vendit, të përgatitet dokumentacioni ligjor në kohë optimale duke respektuar afatet për qarkullimin e shkresave administrative, në mënyrë që blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me sistem dinamik blerje të kryhet jo në datë të përafërt (apo brenda ditës) me datën e nisjes.

Për vitin 2020, me shkresën nr.62 prot, datë 07.01.2021, është dërguar në APP regjistri me realizimin e prokurimeve për vitin 2020, sipas të cilit rezulton se janë kryer gjithsej 42 procedura

prokurimi, me vlerë totale të kontratave 18,790,773 lekë dhe fond limit 19,720,539 lekë pa TVSH, nga të cilat:

Tabela nr. 27 Viti 2020

Në lekë

| Nr. Procedurave të realizuara | Lloji procedurës së prokurimit | Vlera e kontratës me TVSH | Vlera e kontratës pa TVSH | Audituar | Vlera |
|-------------------------------|--------------------------------|---------------------------|---------------------------|----------|------------|
| 2 | T.Hapur(marrëveshje kuadër) | 11,372,105 | 9,476,754 | 1 | 9,476,754 |
| 20 | blerje me vlerë të vogël | 7,321,811 | 6,101,509 | 2 | 1,400,000 |
| 1 | Kërkesë për propozim | 2,538,000 | 2,115,000 | 1 | 2,115,000 |
| 9 | blerje nen vlerën 100,000 lekë | 862,547 | 718,789 | | |
| 10 | me procesverbal rast emergjent | 454,465 | 378,721 | | |
| Totali 42 | | 22,548,928 | 18,790,773 | 4 | 12,991,754 |

Burimi: AKBN (regjistrat e realizimit të prokurimeve)

Për vitin 2020, u audituan në mënyrë të njëpasnjëshme procedurat e tenderave të hapur (4 procedura prokurimi) me të dhënat në tabelën më poshtë:

1.Tenderi me objekt: òRuajtja dhe sigurimi fizik me roje i godinës së selisë qendrore të AKBNò-Loti I dhe òRuajtja dhe sigurimi fizik me roje i arkivës teknike hidrokarbure dhe depot e kampioneve të naftës Fierò- Loti II.

| | | |
|--|---|---|
| 1.Urdhër Prokurimi Nr. 48, Datë 13.07.2020 | 3.Njësia e Prokurimit Nr. 48/6, Datë 13.07.2020 | 4.Komisioni VO Nr. 49, Datë 13.07.2020 |
| 2.Lloji i Procedurës së Prokurimit T.Hapurò, | R.M.-anëtar E.L.ò ò F.B.- ò | S.H. J.B. F.M. |
| 5.Fondi Limit (pa tvsh) 3,323,940 lekë - loti I 6,647,880 lekë òloti II | 6.Oferta fituese (pa tvsh) S.-3,158,918 lekë-loti I M.S.-6,317,836 lekë-Loti II | 7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) -165,022 lekë- loti I -330,044 lekë-loti II |
| 8. Data e hapjes së tenderit 06.08.2020 -loti I dhe loti II | 9.Burimi Financimit AKBN | 10.Operatorë Ekonomike: Loti I- 11 OE Loti II-5 OE |
| b. Kontrata | | |
| 14.Lidhja e kontratës Nr.1834/35, datë 15.10.2020-loti I Nr.1834/34, datë 12.10.2020-loti II | 15.Vlera e kontratës (me tvsh) 3,158,918 lekë-loti I 6,317,836 lekë-Loti II | |

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Nga auditimi i dosjeve dhe në sistemin prokurimit elektronik(SPE) konstatohet së:

-**Loti I**, morën pjesë dhe paraqitën ofertat 11 OE nga të cilët u kualifikuan në vend të parë OE me vlerë të ofertës të barabartë 3,158,918 lekë pa TVSH:òM.S.ò, òT.S.ò, òS.S.ò, òS.S.ò, òS.S.Xò, òASò, òM.S.ò, òT.S.ò dhe òK.ò. Pas përfundimit të afatit të ankimit, në zbatim të nenit 66, pika 8 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, fituesi i procedurës zgjidhet me short. Në përfundim të shortit për shpalljen e fituesit rezultoi në vend të parë dhe fitues i tenderit, OE òS.S.ò me vlerë oferte 3,158,918 lekë pa TVSH.

-**Loti II**, morën pjesë dhe paraqitën ofertat 3 OE, nga të cilët u kualifikuan në vend të parë OE me vlerë të ofertës të barabartë 6,317,836 lekë pa TVSH: òM.S.ò dhe òF.S.ò,OE òA SH.Aò nuk ka paraqitur ofertë. Pas përfundimit të afatit të ankimit, në zbatim të nenit 66, pika 8 të VKM

nr.914, datë 29.12.2014 me ndryshime, fituesi i procedurës zgjidhet me short. Në përfundim të shortit për shpalljen e fituesit rezultoi në vend të parë dhe fitues i tenderit, OE öM.S.ö me vlerë oferte 6,317,836 lekë pa TVSH.

Lidhja dhe Zbatimi i kontratës.

Me fituesit e dy loteve janë lidhur kontratat respektive Nr.1834/35, datë 15.10.2020-loti I, me vlerë 3,790,702 lekë me TVSH dhe Nr.1834/34, datë 12.10.2020-loti II, me vlerë 7,581,403 lekë me TVSH me afat 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Likujdimi është kryer me urdhër shpenzimet mujore deri në datën e përfundimit të kontratës 30.12.2022 në vlerën 9,476,754 lekë me TVSH.

- Gjetje: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me përzgjedhje u konstatua së, njësia e prokurimit nuk ka dosje në të cilën të dokumentojë si dhe inventarizojë e arkivojë në rend kronologjik të gjitha procedurat e prokurimit të kryera për periudhën objekt auditimit në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 *öPër prokurimit publikö i cili citon së öAutoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjitö apo nenit 12 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006, i ndryshuar.*

- Këto veprime janë kompetencë:

- A.B., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të Njësisë (Drejtor Ekzekutiv i AKBN).
- E.L.Kryetar i njësisë së prokurimit
- F.B.Anëtar i njësisë së prokurimit
- R.M.Anëtar i njësisë së prokurimit

-Kriteri: Ligji nr.nr.162 datë 23.12.2020 *öPër prokurimit publikö, nenin 21 i cili citon së öAutoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjitö apo nenit 12 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006, i ndryshuar.*

- Rëndësia:I mesëm

2.Tenderi me objekt:öBlerje karburant Diezel D1 dhe Benzin pa plumbö:

| | | |
|---|---|--|
| 1.Urdhër Prokurimi Nr. 85, Datë 18.09 .2020 | 3.Njësia e Prokurimit O.N. | 4.Komisioni VO Urdhër nr.86, datë 18.09 .2020 |
| 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit T.Hapurö, | E.L. F.B. | S.L. S.M E.B. |
| 5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,115,000 lekë | 6.Oferta fituese (pa tvsh) 2,115,000 lekë | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit 09.10.2020 | 9.Burimi Financimit AKBN | 10.Operatore Ekonomike: 1-öG C GKöö 2-BOE öA dhe Oö 3-BOE öD Odhe EOö 4-öKö |
| b. Kontrata | | |
| 14.Lidhja e kontratës 3472/8 datë 16.11.2020 | 15.Vlera e kontratës 2,115,000 lekë | |

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Nga auditimi i procedurës në SPE dhe dosjes fizike vënë në dispozicion të grupit të auditimit nuk rezulton mos përputhje mes kriterëve dhe rregullave të përcaktuara për prokurimin publik. Në tender morën pjesë 4 OE: GC G me marzh fitimi 18.8 % , BOE öA dhe O me marzh fitimi 19.9 %

(Sëkualifikohet pasi nuk përmbushë të gjitha kriteret kualifikuese të DST, konkretisht nuk plotëson kriterin i cili OE duhet të disponojë minimalisht 5 pika shitje në Qarkun e Tiranës dhe nga një për çdo qark tjetër), BOE òDO dhe E Oò me marzh fitimi 16.4 % (sëkualifikohet pasi nuk ka paraqitur Raport Analizimi për tregun e brendshëm sipas shtojcës 9 të DST i cili duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave) dhe òKò me marzh fitimi 17 %.

KVO ka shpallur fitues i òKò me marzh fitimi 17 % me vlerë oferte 2,115,000 lekë pa TVSH dhe marzh fitimi 17 %.(vlera më e ulët).

Lidhja dhe Zbatimi i kontratës.

Me fituesin është lidhur kontrata 3472/8 datë 16.11.2020 me afat nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri me datë 31.12.2020.

Likuidimi është kryer me urdhër shpenzimin nr.13, datë 06.01.2021 në vlerën 2,474,550 lekë me TVSH.

- Gjetje: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me përzgjedhje u konstatua së, njësia e prokurimit nuk ka dosje në të cilën të dokumentojë si dhe inventarizojë e arkivojë në rend kronologjik të gjitha procedurat e prokurimit të kryera për periudhën objekt auditimit në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 òPër prokurimit publikò i cili citon së òAutoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjitò apo nenit 12 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006, i ndryshuar.

- Këto veprime janë kompetencë:

- A.B., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të Njësisë (Drejtor Ekzekutiv i AKBN).
- E.L.Kryetar i njësisë së prokurimit
- O.N.Anëtar i njësisë së prokurimit
- F.B.Anëtar i njësisë së prokurimit

- **Kriteri:** Ligji nr.162 datë 23.12.2020 òPër prokurimit publikò, nenin 21 i cili citon së òAutoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjitò apo nenit 12 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006, i ndryshuar.

- Rëndësia:I mesëm

3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj në mjete elektronikeò referuar regjistrave të Institucionit u konstatua së për vitin 2020, me urdhër prokurimin me nr.55, datë 15/07/2020 kërkohet të zhvillohet prokurimi për òBlerje tonera për printerò, parashikuar me fondin limit 699.470 lekë, hartimi dhe përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga Komisioni I Prokurimit me Vlerë të Vogël me përbërje : S.H., L.O.dhe E.L..janë paraqitur gjithsej 22 OE, ku fitues pas tërheqjes së disa OE me ofertë më të ulët fitues është shpallur òI.O.ò me vlerën 637,000 lekë,i cili pas njoftimit brenda afatit ka dorëzuar dokumentacionin në AKBN me nr.2786/6 prot, datë 11.08.2020 dhe brenda 24 orëve ka kryer edhe dorëzimin e mallit me faturën tatimore nr. 321880201, datë 11.08.2020.

Likuidimi është kryer me urdhër shpenzimin nr.071, datë 06.10.2020 në vlerën 764,500 lekë me TVSH.

4. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj në mjete elektronikeò referuar regjistrave të Institucionit u konstatua së për vitin 2020, me urdhër prokurimin me nr.61, datë 22/07/2020 kërkohet të zhvillohet prokurimi për òShërbim riparimi dhe mirëmbajtje e automjeteve të AKBNò, parashikuar me fondin limit 700,000 lekë, hartimi dhe përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga Komisioni I Prokurimit me

Vlerë të Vogël me përbërje: S.H., L.O.dhe E.L..janë paraqitur gjithsej 10 OE, ku fitues pas tërheqjes së disa OE me ofertë më të ulët fitues është shpallur oP.I.ö me vlerën 679,000 lekë,i cili pas njoftimit brenda afatit ka dorëzuar dokumentacionin në AKBN dhe brenda afatit 10 ditor ka kryer shërbimet e kërkuara të cilat janë marrë në dorëzim nga grupi i ngritur me Urdhrin nr.71 prot, datë 30.07.2020 me faturën tatimore nr.12, datë 13.08.2020.

Likuidimi është kryer me urdhër shpenzimin nr.772, datë 06.10.2020 për vlerën 814,000 lekë me TVSH.

Për vitin 2021, me shkresën nr.116 prot, datë 10.01.2022, është dërguar në APP regjistri me realizimin e prokurimeve për vitin 2021, sipas të cilit rezulton së janë kryer gjithsej 33 procedura prokurimi, me vlerë totale të kontratave 9,694,601 lekë dhe fond limit 10,302,835 lekë pa TVSH, nga të cilat:

Tabela nr. 28. Viti 2021 Në lekë

| Nr. Procedurave të realizuara | Lloji procedurës së prokurimit | Vlera e kontratës me TVSH | Vlera e kontratës pa TVSH | Audituar | Vlera |
|-------------------------------|--|---------------------------|---------------------------|----------|-----------|
| 17 | Blerje me vlerë të vogël | 7,164,322 | 5,970,268 | 3 | 1,256,800 |
| 1 | Procedurë e Hapur e thjeshtuar | 2,921,670 | 2,434,725 | 1 | 2,434,725 |
| 3 | Sistem Dinamik i blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar | 369,174 | 307,645 | | |
| 8 | Blerje nen vlerën 100,000 lekë | 899,477 | 749,564 | | |
| 4 | Blerje me procesverbal rast emergjent | 278,879 | 232,399 | | |
| Totali 33 | | 11,633,521 | 9,694,601 | 4 | 3,691,525 |

Burimi: AKBN (regjistrat e realizimit të prokurimeve)

Për vitin 2021, u audituan në mënyrë të njëpasnjëshme procedurat e tenderave të hapur (4 procedura prokurimi) me të dhënat në tabelën më poshtë:

1.Tenderi me objekt:ö Blerje karburanti për automjete, Gazoil D1 (Euro Diezel) dhe Benzinë pa Plumbö:

| | | |
|---|--|---|
| 1.Urdhër Prokurimi Nr. 117, Datë 17.08.2021 | 3.Njësia e Prokurimit O.N. E.L. F.B. | 4.Komisioni VO Urdhër nr.116, datë 17.08.2021 S.L. S.M E.B. |
| 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "T.Hapurö | | |
| 5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,499,835 lekë | 6.Oferta fituese (pa tvsh) 2,434,725 lekë | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 65,110 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit 08.10.2021 | 9.Burimi Financimit AKBN | 10.Operatorë Ekonomike: 1-BOE- öGCGö dhe GOG. 2-öK.ö. |
| b. Kontrata | | |
| 14.Lidhja e kontratës 2294/17 datë 26.10.2021 | 15.Vlera e kontratës (me tvsh) | |

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Nga auditimi i procedurës në SPE dhe dosjes fizike vënë në dispozicion të grupit të auditimit nuk rezulton mos përputhje mes kritereve dhe rregullave të përcaktuara për prokurimin publik. Në tender morën pjesë 2 OE: BOE- òGCGò dhe GOG me ofertë ekonomike 2,434,725 lekë dhe òK.ò me ofertë ekonomike 2,4997,847 lekë, KVO duke u bazuar në parimin e ofertës ekonomike më të favorshme bazuar në çmim ka shpallur fitues OE BOE- òGCGò dhe GOG me ofertë 2,434,725 lekë.

Lidhja dhe Zbatimi i kontratës.

Me fituesin është lidhur kontrata 2294/17 datë 26.10.2021 me afat nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri me datë 31.12.2021.

Likuidimi është kryer me urdhër shpenzimit nr.124 , datë 11.12.2021.

- Gjetje: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me përzgjedhje u konstatua së, njësia e prokurimit nuk ka dosje në të cilën të dokumentojë si dhe inventarizojë e arkivojë në rend kronologjik të gjitha procedurat e prokurimit të kryera për periudhën objekt auditimit në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 òPër prokurimit publikò i cili citon së òAutoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjitò apo nenit 12 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006, i ndryshuar.

- Këto veprime janë kompetencë:

- A.B., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të Njësisë (Drejtor Ekzekutiv i AKBN).
- E.L.Kryetar i njësisë së prokurimit
- F.B.Anëtar i njësisë së prokurimit
- O.N.Anëtar i njësisë së prokurimit

- **Kriteri:** Ligji nr.nr.162 datë 23.12.2020 òPër prokurimit publikò, nenin 21 i cili citon së òAutoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjitò apo nenit 12 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006, i ndryshuar.

- Rëndësia:I mesëm

2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj në mjete elektronikeò referuar regjistrave të Institucionit u konstatua së për vitin 2021, me urdhër prokurimin me nr.142, datë 21/09/2021 kërkohet të zhvillohet prokurimi për òBlerje Bojë printerò, parashikuar me fondin limit 499.333 lekë, hartimi dhe përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga Komisioni I Prokurimit me Vlerë të Vogël me përbërje : S.H., R.M.dhe D.M., janë paraqitur gjithsej 23 OE, ku fitues pas tërheqjes së disa OE me ofertë më të ulët fitues është shpallur òR.ò me vlerën 440,000 lekë,i cili pas njoftimit brenda afatit ka dorëzuar dokumentacionin në AKBN.Konstatohet se afati i dorëzimit të mallit është përcaktuar të kryhet brenda 24 orëve nga data e shpalljes së fituesit dhe dorëzimit të dokumentacionit i cili ka përfunduar më datën 15.10.2021.Procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit është mbajtur në datën 19.10.2021, pra 3 ditë me vonesë, OE òR.ò me faturën tatimore nr.7/2021 datë 19.10.2021,në kontratë nuk janë përcaktuar penalitete dhe si arsye nga institucioni është pamundësia për ti marrë në dorëzim për subjektin nuk janë mbajtur penalitete.

Likuidimi është kryer me urdhër shpenzimit nr.880, datë 18.06.2020 në vlerën 524,160 lekë me TVSH.

3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj në mjete elektronike referuar regjistrave të Institucionit u konstatua së për vitin 2021, me urdhër prokurimin me nr.66, datë 10/05/2021 kërkohet të zhvillohet prokurimi për òBlerje materiale

pastrimi,dezinfektimi për masat anti Covidö, parashikuar me fondin limit 800,000 lekë, hartimi dhe përlogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga Komisioni I Prokurimit me Vlerë të Vogël me përbërje : S.H., L.O.dhe R.M., janë paraqitur gjithsej 36 OE, ku fitues pas tërheqjes të OE òA.ò klasifikuar I pari, OE I radhës me ofertë më të ulët fitues është shpallur òM.V.ò me vlerën 436,800 lekë, i cili pas njoftimit brenda afatit ka dorëzuar dokumentacionin në AKBN dhe brenda afatit 48 orë ka kryer shërbimet e kërkuara të cilat janë marrë në dorëzim nga grupi i ngritur me Urdhrin nr.38 prot, datë 25.05.2021 me faturën tatimore nr.56, datë 20.05.2021.

4. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj në mjete elektronike referuar regjistrave të Institucionit u konstatua së për vitin 2021, me urdhër prokurimin me nr.35, datë 16/03/2021 kërkohet të zhvillohet prokurimi për òPërzgjedhje e ekspertit kontabël për certifikimin e bilancit dhe pasqyrave financiare të AKBN për vitin 2020ö, parashikuar me fondin limit 400,000 lekë, hartimi dhe përlogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga Komisioni I Prokurimit me Vlerë të Vogël me përbërje : S.S.H., L.O.dhe E.L., janë paraqitur gjithsej 2 OE, ku fitues pas tërheqjes së OE òH.E.A.ò klasifikuar I pari, OE I radhës me ofertë më të ulët fitues është shpallur òA.A.P.ò me vlerën 380.000 lekë, i cili pas njoftimit brenda afatit ka dorëzuar dokumentacionin në AKBN dhe brenda afatit i cili është deri në datën 31.03.2021 ka kryer shërbimin e kërkuar i cili është marrë në dorëzim nga grupi i ngritur me Urdhrin nr.38 prot, datë 25.05.2021 me faturën tatimore nr.56, datë 20.05.2021.

Likuidimi është kryer me urdhër shpenzimin nr.469, datë 30.07.2021 në vlerën 456,000 lekë me TVSH.

III.2.6. Mbi shfrytëzimin e burimeve hidrokarbure.

- a. Miratimi, monitorimi, mbikëqyrja dhe zbatimi i Marrëveshjeve Hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit.
- b. Shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit për shfrytëzimin dhe prodhimin e hidrokarbureve.
- c. Marrëdhëniet me Albpetrol SHA dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve.
- ç. Auditimi i Marrëveshjeve Hidrokarbure nga struktura e Auditimit të Brendshëm të AKBN.

Aktualisht janë në zbatim 16 Licence Marrëveshje për zhvillimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit në vendburimet ekzistuese, mbi bazën e të cilave, kompania Albpetrol SHA dhe AKBN kanë lidhur 16 Marrëveshje Hidrokarbure. Konkretisht: Licence Marrëveshja për vendburimin e naftësPatos-Marinës; Licence Marrëveshja për vendburimin e naftës Ballsh-Hekal; Licence Marrëveshja për vendburimin e naftës Cakran-Mollaj; Licence Marrëveshja për vendburimin e naftës Gorisht-Kocul; Licence Marrëveshja për vendburimin e gazit Delvine; Licence Marrëveshja për vendburimin e naftës Kuçovë; Licence Marrëveshja për vendburimin e naftës Visoke; Licence Marrëveshja për vendburimin e naftës, Amonice, Drashovice, Finiq-Krane, Pekisht-Murris dhe pesë vendburime gazi, konkretisht vendburimet: Divjake, Ballaj, Pocolçe, Panaja dhe Frrakull.Këto 16 licencë Marrëveshje implementohen nga 7 kompani të ndryshme. Po kështu janë në zbatim edhe 3 Marrëveshje Hidrokarbure ose Kontrata me Ndarje Prodhimi (KNP), për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Blloqet e Kërkimit në Shqipëri, të cilat implementohen nga 2 kompani.

Auditimi u krye me zgjedhje, më poshtë po trajtojmë në mënyrë të përmbledhur treguesit kryesore të realizuar gjatë implementimit të disa marrëveshjeve, si dhe disa problematika kryesore e konstatuara nga auditimi i tyre:

1. Titulli i Gjetjes: Zbatimi i Licencë Marrëveshjes dhe Marrëveshjes Hidrokarbure lidhur me kompaninë BPAL për vendburimin Patos-Marinëz, miratuar me VKM nr. 427, datë 16.07. 2004.

Situata: Marrëveshja Hidrokarbure me BPAL përfshin zhvillimin dhe prodhimin e naftës në vendburimin Patos-Marinez e cila zë rreth 95-98 të prodhimit ekzistues të naftës në rangë vendi dhe është miratuar me VKM nr. 427, datë 16.07. 2004. Data efektive e kësaj marrëveshje është 20.07.2004 dhe aktualisht ajo ndodhet në vitin e 16^{të} të saj.

Fillimisht kjo marrëveshje është nënshkruar me kompaninë òS.E.ò, ndërsa në vitin 2005 interesat e kësaj marrëveshje u blenë nga kompania BPAL.

Marrëveshja ka kaluar fazën e vlerësimit që zgjati 18 muaj gjatë të cilës, për zbatimin e Planit Minimal të Punës të parashikuar në Aneksin B të Licencës, kompania realizoi investime kapitale në vlerën prej 20 milion USD (nga 2 milion lekë që ishte kushti).

Mbas përfundimit të Fazës së Vlerësimit, kompania vendosi të hyjë në fazën e zhvillimit, duke paraqitur për miratim Planin e Zhvillimit, i cili, mbas oponentëve së realizuar nga institucione të licencuara, u miratua nga AKH (sot AKBN) dhe Ministri në 20.03.2006.


Në mars 2009, BPAL dhe A. ranë dakord të amendojnë Planin e Zhvillimit të miratuar më parë, për shkak të parashikimeve jo të plota të prodhimit të naftës, të ardhur nga shkalla e kufizuar e njohjes të vendburimit. Shtojca e Planit të Zhvillimit, u miratua nga METE me 11.06.2009, pasi kompania mori në konsideratë vërejtjet e bëra nga AKBN. Në vitin 2011 (21/12/2011) u miratua shtojca e Programit të zhvillimit e cila përfshin një zonë të re zhvillimi duke zgjeruar zonën ekzistuese. Gjate vitit 2014-2015 u dorëzua për miratim një amendim tjetër i planit afatgjatë të zhvillimit të këtij vendburimi, i cili mori në konsideratë situatën e re të tregut ndërkombëtar të hidrokarbureve. Ky plan kaloi në fazën e vlerësimit e diskutimit për miratim tek kompania A. dhe AKBN. Gjate muajit Mars 2016 kompania paraqiti tek A. dhe AKBN variantin e fundit të këtij plani, i cili u miratua në mars 2018.

Në shtator 2016 aksionet e kompanisë BPAL u blenë nga kompania kineze G.J. e cila vijon kryerjen e operacioneve hidrokarbure për zhvillimin e vendburimit Patos-Marinza, duke ruajtur të njëjtin emër për kompaninë operatore.

Marrëveshja ndodhet në vitin e 16^{të} të Periudhës së Zhvillimit, e cila në përputhje me Licencën dhe Marrëveshjen mund të zgjasë deri në 25 vjet.

Për të bërë të mundur ruajtjen dhe rritjen e prodhimit të naftës, kompania në Planin e Zhvillimit, përveç riaktivizimit të puseve ekzistues, ka bërë të mundur shpimin e puseve të kategorive të ndryshme. Kështu gjatë periudhës nga viti 2008 deri në fund të vitit 2019 numri i puseve të shpuar ka arritur në 770 puse të rinj dhe 24 puse të ri shpuar.

Politika e shpimit të puseve nga ana e kompanisë ka qenë e ndërvarur nga ecuria e kuotimit të çmimit të naftës bruto në tregun vendas dhe ndërkombëtar, duke qenë së kostoja e shpimit të puseve zë një vend të rëndësishëm në koston totale të nxjerrjes së naftës (kostoja e një pusi të ri është rreth 1.5-2 milion USD). Shpimi i këtyre puseve ka qenë sikurse pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.



Në këtë grafik vihet re qartësisht së rritja e çmimit të shitjes së naftës bruto ka sjelle edhe rritjen e numrit të puseve të shpuar për të mbështetur rritjen e prodhimit të naftës nga këto puse. Për shkak të situatës së tregut të naftës, shpimi i puseve të rinj ka ardhur duke u reduktuar. Kështu, gjatë viteve 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019 janë shpuar respektivisht 85 puse, 126 puse, 131 puse, 151 puse, 55 puse, 8 puse, 16 puse, 35 puse dhe 83 puse. Ndërkohe që nuk është vazhduar me shpimin e puseve të rinj, për arsye të rënies së çmimit në bursa.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, që nga fillimi e deri në fund të muajit dhjetor 2021, janë shpenzuar gjithsej rreth 3,671,000 mijë USD, nga të cilat rreth 1,790,611 mijë USD janë investime kapitale dhe 1,810,088 mijë USD janë shpenzime operative, pjesa tjetër detyrime si dhe taksa të tjera të përfshira si kosto të rikuperueshme.

Investimet janë orientuar sipas parashikimeve të Planit të Zhvillimit, kryesisht në shpimin e puseve të rinj, riaktivizimin e puseve ekzistues, rehabilitimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së nxjerrjes transportimit dhe tregtimit, përmirësimin dhe rehabilitimin e mjedisit, menaxhimin e integruar i mbetjeve operacionale, etj.

Prodhimi maksimal mujor i naftës është arritur në vitin 2014 në një nivel prej rreth 111 mijë ton, nga 22 mijë ton/muaj që prodhohej në vitin 2004. Aktualisht vërehet një rënie e prodhimit për shkak të kufizimit të investimeve kapitale që mbështesin nxjerrjen e naftës si parametri kryesor që ndikon në zbutjen e rënies së prodhimit.

Gjate periudhës objekt auditimi, shtator-dhjetor 2018 u prodhuan mesatarisht rreth 72 mijë ton/muaj naftë dhe gjate vitit 2019 u realizua një prodhim mesatar prej 73.8 mijë ton në muaj, me një prodhim maksimal prej 76 mijë ton naftë gjate muajit gusht 2019. Ndërkohe që gjatë tremujorit të parë 2020 prodhimi mesatar rezultoi prej 71.6 mijë ton/muaj. Në këtë nivel ka ndikuar shumë edhe situata e pandemisë së COVID-19 për periudhën shkurt 2-mars 2020 gjate të cilës prodhimi ishte në nivelin 68 mijë ton në muaj. Pra kemi një rënie gati 10.5% në muaj krahasuar me prodhimin mesatar të realizuar gjate vitit 2019.

Nga gjithë sasia e naftës së prodhuar gjatë gjithë periudhës, kompania A deri tani ka përfituar në formën e detyrimit për prodhimin PEP (prodhimi para ekzistues) dhe ASP (pjesa fitim) një sasi prej gati 754 mijë ton.

Në përputhje me fazat në të cilat ka kaluar marrëveshja, kompania ka respektuar kërkesat e saj duke paguar detyrimet financiare të parashikuara ndaj A. dhe shtetit. Për periudhën që nga miratimi i ligjit për rentën minerare, janë paguar gjithsej rreth 373.3 milion USD në shtet për detyrimin për rentën minerare.

Në tabelat me poshtë po pasqyrojmë disa nga treguesit kryesore të realizuar gjatë viteve të mëparshme dhe gjatë periudhës objekt auditimi (3M-II-2018-3M-I-2020) nga kompania BPAL për periudhën 2004-2021:

Treguesit kryesore të realizuar në vite nga Kompania BPAL në Vendburimi Patos Marinza
Tabela nr. 29

| Viti | Naftë bruto ton | | | | | | Te ardhurat Milion US\$ | Shpenzime (Milion US\$) | | Renta Minerare Milion US\$ |
|------|-----------------|----------------|-----------|----------|---------|-----------------|----------------------------|----------------------------|---------|-------------------------------|
| | Prodhim | Shitjet Totale | Eksport | PEP | ASP | Injektim Solari | Neto | Capex | Opex | |
| 2005 | 97,874 | 97,017 | 3,495 | 10,343 | 875 | 14,586 | 14,310 | 16,809 | 12,268 | |
| 2006 | 202,496 | 192,015 | 67,829 | 25,002 | 1,775 | 15,778 | 30,388 | 39,086 | 20,126 | |
| 2007 | 279,708 | 274,245 | 155,156 | 41,020 | 2,387 | 18,522 | 58,070 | 45,907 | 29,500 | 0.058 |
| 2008 | 341,860 | 341,771 | 181,920 | 61,371 | 2,805 | 17,262 | 91,723 | 69,149 | 44,393 | 5,939 |
| 2009 | 371,206 | 373,499 | 319,678 | 63,621 | 3,076 | 15,799 | 69,083 | 40,079 | 41,221 | 7,562 |
| 2010 | 568,885 | 556,744 | 501,117 | 67,043 | 5,018 | 29,769 | 144,365 | 114,079 | 69,608 | 15,855 |
| 2011 | 757,532 | 741,680 | 652,083 | 70,276 | 6,872 | 77,327 | 310,363 | 236,910 | 155,984 | 33,607 |
| 2012 | 873,691 | 861,201 | 883,363 | 62,780 | 8,109 | 106,561 | 403,048 | 217,084 | 206,811 | 46,043 |
| 2013 | 1,053,999 | 1,054,200 | 1,138,424 | 54,043 | 10,000 | 136,384 | 541,957 | 225,850 | 259,146 | 61,407 |
| 2014 | 1,199,861 | 1,199,229 | 1,014,801 | 46,521 | 11,533 | 92,953 | 539,172 | 283,860 | 193,370 | 57,611 |
| 2015 | 1,121,489 | 1,130,806 | 932,760 | 40,047 | 10,814 | 61,218 | 260,100 | 141,776 | 194,402 | 28,765 |
| 2016 | 917,602 | 944,119 | 871,951 | 34,474 | 8,831 | 44,577 | 151,012 | 43,042 | 119,936 | 16,740 |
| 2017 | 836,351 | 788,718 | 488,024 | 29,677 | 8,047 | 14,709 | 174,287 | 66,163 | 91,644 | 18,885 |
| 2018 | 793,615 | 741,105 | 565,728 | 25,612 | 7,680 | 1,073 | 225,063 | 86,346 | 106,497 | 24,480 |
| 2019 | 885,692 | 852,753 | 631,228 | 22,069 | 8,636 | 6,961 | 237,921 | 119,519 | 110,300 | 26,349 |
| 2020 | 670,009 | 81,908 | 574,967 | 18,932.0 | 6,553.0 | 6,204 | 119,795 | 21,245 | 84,631 | 14,114 |
| 2021 | 601,663 | 62,044 | 544,676 | 16,301 | 5,908 | 13,362 | 96,357 | 10,476 | 64,339 | 15,968 |

Burimi: AKBN

Treguesit e realizuar në 2(dy) tremujorët e fundit të vitit 2018 dhe për vitin 2019 të Kompanisë BPAL në Vendburimi Patos Marinza

Tabela nr. 30

| KOMPANIA BPAL PETROLEUM (Vendburimi Patos-Marinza) | Korrik-Shtator 2018 | | Tetor-Dhjetor 2018 | | Viti 2019 | | 2020 | | 2021 | | |
|---|------------------------|--------|-----------------------|-------|-----------|--------|-------|---------|------|---------|-------|
| | Plan | Fakt | Plan | Fakt | Plan | Fakt | Plan | Fakt | Plan | Fakt | |
| Prodhim (mijë fuçi) | 1,329 | 1,302 | 1,355 | 1,374 | 5,312 | 5,551 | 5099 | 4216 | 2926 | 2,910 | |
| Shitje | Vend (mijë fuçi) | 671 | 467 | 683 | 486 | 2,656 | 3,962 | 2544 | 522 | 878 | 245 |
| | Export (mijë fuçi) | 671 | 739 | 683 | 853 | 2,656 | 1,392 | 2544 | 3618 | 2,048 | 2,753 |
| PEP + ASP | Detyrim (fuçi) | 8,296 | | 8,173 | | 30,704 | | 160,000 | | 139,225 | |
| | Likuidim (mijë fuçi) | 11,896 | | 4,993 | | 27,132 | | 6,625 | | 139,715 | |
| Cmimi i shitjes (US\$/fuçi) | 55,00 | 75.27 | 41.23 | 41.85 | 62.16 | 49.65 | 67 | 41.7 | 47 | 68 | |

| | | | | | | | | | | | |
|--------------------------------------|------------------|--------|--------|--------|---------|---------|---------|--------|--------|--------|--------|
| Te ardhura net of diluent (mijë USD) | 52,490 | 70,937 | 53,355 | 67,026 | 327,728 | 272,132 | 131,434 | 535,71 | 38,673 | 89,890 | |
| Shpenzime | Capex (mijë USD) | 20,411 | 24,147 | 19,664 | 26,570 | 159,171 | 108,919 | 91,322 | 21,245 | 21,150 | 10,476 |
| | Opex (mijë USD) | 19,164 | 20,696 | 14,480 | 16,050 | 18,118 | 16,067 | 82,945 | 71,340 | 45,878 | 64,330 |
| | G&A (mijë USD) | 3,444 | 3,288 | 3,443 | 6,613 | 18,118 | 16,067 | 16,145 | 13,291 | 11,587 | 8,219 |
| Renta (mijë USD) | 6,616 | | 6,595 | | 26,349 | | 12,935 | 14,114 | 20,560 | 15,968 | |
| Holluesi (%) | 0.92 | | 0.17 | | 0.79 | | 0.92 | | 2.41 | | |
| R- factor (Fraksion) | 0.9477 | | 0.9488 | | 0.9583 | | 0.9635 | 0.9764 | 0.9917 | 0.9993 | |

Burimi: AKBN

Megjithëse prodhimi i naftës dhe te ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj sasive janë rritur ndjeshëm, faktori R, si treguesi kryesor i balancës së treguesve **Te ardhura-Shpenzime** ende nuk ka arritur vlerën 1.

Sipas nenit 9 òPjesa e Albetrolit dhe rikuperimi i kostoveò, të marrëveshjes hidrokarbure, faktori R llogaritet në çdo tremujor si, raport i të ardhurave të akumuluar në vite nga shitja e naftës së prodhuar me shpenzimet e akumuluar në vite që janë kryer për prodhimin e kësaj nafte. Po kështu, në nenin 10.2 òRikuperimi i Kostove. Kostot e Parikuperueshmeò të Licencë Marrëveshjes është përcaktuar së: *“Kompania do të rikuperojë (mbulojë) të gjitha kostot hidrokarbure (investimet dhe shpenzime) deri në masën 100% nga shitja e hidrokarbureve të prodhuara (pas zbritjes së prodhimit para ekzistues). Dhe në atë masë që në një vit fiskal, kostot dhe shpenzimet e rikuperueshme e kalojnë vlerën e hidrokarbureve (të ardhurat) për mbulim kostos për atë vit fiskal, pjesa e mbetur do të mbartet për mbulimin në vitin fiskal ose në vitet fiskale që pasojnë derisa të mbulohet plotësisht, por në asnjë rast nuk do të mbartet mbas përfundimit të kësaj Licencë marrëveshje”.*

Bazuar në planin e zhvillimit, të përmirësuar në vitin 2014, Pika 1 òPërmbledhje ekzekutiveò, rezulton së:

Shpenzimet kapitale dhe operative te parashikuara për kompletimin e zhvillimit te programit te propozuar janë në total rreth 1.25 Miliard USD midis 2014 dhe 2018 dhe pas 2018 mbajtjen e shpenzimeve kapitale në 179 Milion USD. Parashikimi për shpenzimet kapitale që kërkohen për te realizuar planin e zhvillimit te propozuar për Rastin e Ulet është 1.03 miliard USD.

Kjo Shtojce e Planit të Zhvillimit nënkupton që investimet do të ndalojnë pas 2018. Ky është një skenar i mundshëm pasi shumë nga vendet për shpime horizontale në të ardhmen janë zhvilluar gjatë pesë viteve të ardhshme. Megjithatë, investimet aktuale pas 2018 do të varen në mundësitë në dispozicion, çmimi i naftës, dhe faktorë te tjerë. Mundësitë në të ardhmen për zhvillimin e vendburimit pas 2018 përfshijnë shtimin e Programeve Dytësore së bashku me akoma me shume shpime primare si brenda vendburimit, ashtu edhe në pjesën jugore dhe zonat periferike te tij. Vlerësimi i mëtejshëm i rezervuarit brenda pjesës jugore dhe zonave periferike ka te ngjare te shtojce në të ardhmen numrin e puseve dhe vitet e zhvillimit të vendburimit. Në rast së të dhënat ekonomike janë pozitive për të shtuar zhvillimin e vendburimit në te ardhmen kjo gjë do te vazhdojë të propozohet në Planet e Punës dhe Buxhetet vjetore. Ndryshimet e rëndësishme që mund të pësoje kjo Shtojcë e Planit të Zhvillimit do të prezantohen në Shtojcat e ardhshme të Planit ekzistues të Zhvillimit. Planet vjetore nuk janë miratuar nga AKBN, pasi ka patur vërejtje për përmbajtjen e tyre, por bazuar në marrëveshjen hidrokarbure dhe Licencë marrëveshje, ato hyjnë në fuqi, pas kalimit të afatit të përcaktuar për miratimin e tyre.




Figura 1-1: Prodhimi dhe Parashikimi ner Shpenzimet Kanitale

Në varësi të kushteve të tregut të naftës dhe gazit BPAL synon të përshpejtojë investimet kur çmimi i naftës të jetë i lartë dhe të investojë në mënyrë të moderuar kur çmimi i naftës të jetë i ulët.

Për vitin 2020.

Bazuar në Planin e Zhvillimit të përmirësuar, për vitin 2020 shpenzimet kapitale ishin parashikuar me vlerë afërsisht 40 milionë USD dhe një prodhim mesatar ditor 2500 m³ (912500 m³/vit).

Bazuar në planin vjetor për vitin 2020, ishin parashikuar shpenzime kapitale me vlerë 91.3 milionë USD dhe janë realizuar 21.6 milionë USD, ndërsa shpenzimet operative ishin parashikuar 16.1 milionë USD dhe janë realizuar me vlerë 13.3 milionë USD. Prodhimi i parashikuar ishte 810676 m³ dhe është realizuar 669981.8 m³.

Sa më sipër rezultojnë një mospërputhje në realizimin e investimeve.

Për vitin 2021.

Bazuar në Planin e Zhvillimit të përmirësuar, për vitin 2021, shpenzimet kapitale ishin parashikuar afërsisht 20 milionë USD (për periudhën 9 mujore), me një prodhim mesatar ditor 2000 m³ (730000 m³/vit).

Bazuar në planin e vitit 2021, shpenzimet kapitale janë parashikuar me vlerë 21.2 milionë USD (për periudhën 9 mujore) dhe janë realizuar 12.5 milionë USD, ndërsa shpenzimet operative ishin parashikuar 11.6 milionë USD dhe janë realizuar 8.2 milionë USD. Prodhimi për 9 mujorin është parashikuar 465196 m³ dhe është realizuar 462464 m³.

Bazuar në planin e zhvillimit të përmirësuar në vitin 2014, koeficienti R do të ishte më i madh se 1 duke filluar nga viti 2016 (plani i zhvillimit 2009, parashikonte R = 1, në vitin 2014).




Figura 11-24: Faktori -R Krahasuar me 2009 dhe 2014 PoD

Sa më sipër rezulton së operacionet hidrokarbure nuk janë realizuar sipas parashikimeve në planin e zhvillimit, por as dhe në planet vjetore të cilat gjithashtu nuk janë në përputhje me planin e zhvillimit, duke mos arritur koeficientin R më të madh së 1 në periudhën e parashikuar. Kjo shoqërohet me mungesë të fitimit për Qeverinë Shqiptare nga ndarja e fitimit si dhe sasi më të vogël të naftës bruto pjesë e prodhimit për Albpetrol SHA, e cila nga 1 % që është në periudhën aktuale, duhej të ishte 3 %, pas arritjes së koeficientit R më të madh së 1 dhe më i vogël së 1.5, 4 % për R nga 1.5 deri 2 dhe 5 % për R më të madhe së 2.

Ky veprim është në kundërshtim me Licencë Marrëveshjen, neni 7, pika 2.b (iii), ku përcaktohet:

“...në rast së i LICENSUAR-i ka përfunduar Periudhën e Vlerësimit dhe ka hyrë ose është duke kryer Operacionet e Zhvillimit dhe Prodhimit, Programi Vjetor i propozuar do të jetë në përputhje me Planin e Zhvillimit...”.

Si konkluzion: BPAL nga data efektive e marrëveshjes deri në fund të vitit 2021 ka akumuluar humbje krahasuar me të ardhurat, për pasojë nuk ka paguar në asnjë vit fiskal që nga viti 2004 deri në vitin 2021, tatim mbi fitimin në favor të buxhetit të shtetit, duke mos përmbushur qëllimin e nenit 13.1 të Licencë Marrëveshjes në të cilën behet fjalë që:

Kompania BPAL do të jetë përgjegjëse për pagesën e taksës mbi fitimin në përputhje me Ligjin nr. 7811, datë 12.04.1994 òMbi sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve. Ky ligj përcakton së: **"Kontraktuesi detyrohet të paguajë, në çdo vit fiskal, tatimin mbi fitimin e realizuar në atë vit fiskal"**. Tatimi mbi fitimin është, në masën 50 për qind të fitimit të realizuar. Për efekt të llogaritjes së fitimit të realizuar, kontraktuesit i njihen si kosto shpenzimet kapitale, ato operative e administrative, etj., (specifikimet përkatëse bëhen në marrëveshjen hidrokarbure të miratuar nga ministri) dhe lejohet shlyerja e tyre nga të ardhurat e fituara sipas kritereve të pranuar nga ministri, si dhe sipas praktikave ndërkombëtare të industrisë së naftës që zbatohen në çdo marrëveshje hidrokarburesh.

Faktori R në fund të vitit 2021 është nën vlerën 1, nga ku rezulton së kompania nuk ka derdhur për buxhetin asnjë të ardhur nga ndarja e fitimit e parashikuar.

Kriteri: Ligji nr. 7811, datë 12.04.1994 òMbi sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve dhe Licencë Marrëveshja dhe Marrëveshja Hidrokarbure, miratuar me VKM nr. 427, datë 16.07.2004

Ndikimi: Shmangie të detyrimeve fiskale.

Shkaku: Rritja e kostove për kryerjen e operacioneve hidrokarbure mbi çmimet e tregut dhe normativave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 1: AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë BPAL, që të intensifikojë operacionet që mundësojnë rritjen e prodhimit të naftës, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhurashpenzime në vlera më të larta së, R=1, me qëllim rritjen e fitimit të Kompanisë dhe pagimin e tatimit mbi fitimin në buxhetin e shtetit.

2. Titulli i Gjetjes: Mbikëqyrja e kostove hidrokarbure të kryera nga kompaninë BPAL.

Situata: Në zbatim të nenit 9 òPjesa e Albetrol dhe rikuperimi i kostoveò, të marrëveshjes hidrokarbure dhe në zbatim të nenin 10.2 òRikuperimi i Kostoveò dhe òKostot e Parikuperueshmeò të Licencë Marrëveshjes, faktori R llogaritet në çdo tremujor si, raport i të ardhurave të akumuluar në vite nga shitja e naftës së prodhuar me shpenzimet e akumuluar në vite që janë kryer për prodhimin e kësaj nafte. Për të mbikëqyrur dhe monitoruar kostot hidrokarbure të kryera nga BPAL, në licencë marrëveshje është përcaktuar së, BPAL ka detyrimin ti dërgojë AKBN-së:

-Në zbatim të nenin 15.2 që bënë fjalë për òRegjistrimet që i jepen AKBNò, BPAL duhet që: *òJo me vonë së dyzet e pesë (45) ditë pas përfundimit të çdo Periudhe 6 (gjashtë) mujore i LICENSUAR-i (BPAL) i dorëzon AKBN kopje të dokumentacioneve të llogarive që pasqyrojnë Kostot Hidrokarbure që i LICENSUAR-i realizoi gjatë asaj Periudhe 6 (gjashtë) mujore. Dokumentacioni llogaritës i dhënë nga i LICENSUAR-i do të jetë me hollësi të mjaftueshme për të lejuar AKBN të përcaktojë rregullsinë e Kostove Hidrokarbure të realizuara. Në shtesë të sa më sipër i LICENSUAR-i do t'i jap AKBN kopje të regjistrave të Operacioneve Hidrokarbure, ashtu si ato janë kryer”.*

-Në nenin 16.3 që bënë fjalë për òNën-kon traktorëtò, BPAL duhet që:

òTë informojë AKBN për emrin dhe adresën e çdo nënkontraktori dhe identitetin e përfaqësuesit të tij të autorizuar dhe me kërkesën e arsyeshme të AKBN i jep AKBN një kopje të kontratës brenda tridhjetë (30) ditëve pasi ky nënkontraktor është punësuar nga i LICENSUAR-i. Në raportin e tij dhe në bazë të këtij neni i LICENSUAR-i do të përfshijë raportime mbi punët e gjithë nënkontraktorëve të tij. AKBN ruan konfidencialitetin e gjithë informacioneve që lidhen me gjithçka që i LICENSUARI do t'i japë në përputhje me këtë Seksion 16.3.

Nga auditimi mbi përmbushjen e këtyre detyrimeve u konstatua së, BPAL nuk ka dërguar në AKBN kopje të dokumentacioneve të llogarive që pasqyrojnë me hollësi Kostot Hidrokarbure (shpenzimet e kryera) që i ka realizuar gjatë, 6 (gjashtë) mujorit të 2 (dytë) të vitit 2018, gjatë 6 (gjashtë) mujorit të 1(parë) dhe të 2 (dytë) të vitit 2019, po ashtu edhe për periudhën në vazhdim. Nuk ka dërguar dokumentacion jo vetëm gjatë kësaj periudhe por edhe për 6 (gjashtë) e mujorët e tjerë të mëparshëm që nga data efektive e marrëveshjes. Gjithashtu, BPAL nuk ka dërguar raporte dhe nuk ka informuar AKBN mbi punët e gjithë nën kontraktorëve të punësuar prej saj, jo vetëm gjatë periudhës objekt auditimi, por edhe të periudhave të mëparshme.

Ky problem është trajtuar gjerësisht në auditimet e mëparshme të KLSH dhe për eliminimin dhe rregullimin i kësaj parregullsie është dalë dhe me rekomandimin përkatës që:

òNë kushtet e mungesës së dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për realizimin e proceseve hidrokarbure nga BPA për vitin 2014, 2015 dhe 2016 KLSH, nuk mundi të llogarisë saktë dhe objektivisht efektet financiare që kanë ardhur nga shpenzimet e kryera, mbi çmimet e tregut, mbi normativat dhe referencat ligjore në fuqi si dhe efekte ekonomike negative që kanë këto

shpenzime në buxhetin e shtetit. Për të materializuar një auditim më të plotë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit publik, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, kërkojmë që:

•AKBN të bashkëpunojë me Albetrolin dhe ME dhe në zbatim të nenit 15.2 të Licencë Marrëveshjes, brenda muajit maj 2017 të marrë zyrtarisht nga BPA të gjithë dokumentacionit e hollësishëm të kostove hidrokarbure të realizuar nga BPA për vitin 2004, 2015 dhe 2016, dhe në bazë të tyre të analizojë dhe të llogarisë saktë faktorin R.

Por me gjithë insistimin e AKBN për të zbatuar këto rekomandim të KLSH dhe këtë kërkesë të Marrëveshjes Hidrokarbure, përsëri nga BPAL nuk janë dërguar në AKBN kopje të dokumentacioneve që pasqyrojnë me Kostot Hidrokarbure të kryera për periudhat e sipërcituara, por as në periudhën objekt auditimi.

Për këtë shkak, përsëri edhe ky auditim, në kushtet e mungesës së këtij dokumentacioni, u krye në bazë të evidencave dhe situacioneve (progres raporteve) periodike të kostove hidrokarbureve që BPAL i ka dërguar në AKBN në çdo tremujor për të llogaritjen e faktorit R.

Megjithatë mbështetur në këto situacione, dhe bazuar në të dhënat dhe vlerat e pasqyruara dhe në dokumentet mbështetëse të raporteve të auditimit që struktura e Auditimit të AKBN kanë audituar BPAL për vitet 2011 deri në vitin 2017 të cilat janë kontrata të lidhura për furnizime të mallrave, punëve dhe shërbimeve që nga vitet e mëparshme dhe vazhdojnë të jenë në fuqi dhe në zbatim edhe gjatë vitit 2018, 2019, 2020 dhe 2021, dalim në konkluzionin së, BPAL që nga datë e bërjes efektive të licencë marrëveshjes dhe marrëveshjes hidrokarbure ka kryer disa shpenzime për operacione hidrokarbure, me çmimet mbi tregut vendas, mbi limitet dhe normativat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe disa shpenzime të tjera që nuk kanë të bëjnë dhe nuk lidhen me Operacionet Hidrokarbure dhe janë në kundërshtim me Aneksi B neni 2 i Marrëveshjes Hidrokarbure dhe me neni 10.2 të Licencë Marrëveshjes, duke rënduar padrejtësisht kostot hidrokarbure të cilat konsiderohet si kosto që nuk duhet të njihet dhe të rikuperohet.

Rritja fiktive e kostove hidrokarbure ka sjell efekte të ndjeshëm në uljen e pjesës fitim të Alpetrolit dhe në uljen e fitimit të BPAL dhe për pasojë në nivelin e tatimit mbi fitimin që duhet të paguhet buxhetit të shtetit nëse arrihet faktori R=1.

Mirëpo, në kushtet e mungesës së dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për realizimin e proceseve hidrokarbure nga BPA për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021, KLSH nuk mundi të llogarisë saktë dhe objektivisht efektet financiare që kanë ardhur nga shpenzimet e kryera, mbi çmimet e tregut, mbi normativat dhe referencat ligjore në fuqi si dhe efekte ekonomike negative që kanë këto shpenzime në buxhetin e shtetit.

Kriteri: Neni 9 ÷ Pjesa e Albetrolit dhe rikuperimi i kostove, të marrëveshjes hidrokarbure dhe neni 10.2 ÷ Rikuperimi i Kostove dhe Kostot e Parikuperueshme të Licencë Marrëveshjes.

Ndikimi: Shmangie të detyrimeve fiskale.

Shkaku: Përfshirje në shpenzime që nuk kanë të bëjnë me kostot hidrokarbure

Rëndësia: E lartë

Rekomandim 1: AKBN në bashkëpunim me Albetrolin dhe MIE në zbatim të nenit 15.2 të Licencë Marrëveshjes, të marrin zyrtarisht nga BPAL të gjithë dokumentacionit e hollësishëm të kostove hidrokarbure të realizuar për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2022, dhe në bazë të tyre të analizojë dhe të llogarisë saktë faktorin R.

3. Titulli i Gjetjes: Auditimin e kostove hidrokarbure nga AKBN për kompaninë BPAL

Situata: Në lidhje me auditimin e kostove hidrokarbure, në zbatim të Licencë Marrëveshjeve AKBN, ka të drejtën të inspektoje dhe auditoi librat e llogarisë dhe dokumentacionin e kontabilitetit të LICENSUAR-it në lidhje me Operacionet Hidrokarbure, por jo me shpesh së një here në një Vit Fiskal, përveçse kur bihet dakord ndryshe me Operatorin. Kjo e drejte Auditit do të përfundojë tre (3) vjet pas datës në të cilën i LICENSUAR-i dorëzon dokumentacionin e tij të kontabilitetit për atë Vit Fiskal, përndryshe, ky dokumentacion kontabiliteti gjykohet të jetë i saktë dhe më vonë nuk mund të jetë objekt kundërshtimi. Kështu, struktura e auditimit të AKBN, gjatë vitit 2018 ka kryer auditim për vitin 2015, gjatë 2019 ka kryer auditim për vitin 2016, gjatë vitit 2020 është audituar viti 2017 dhe gjatë vitit 2021, janë audituar llogaritë kosto të vitit 2018.

Kriteri: Licencë Marrëveshja dhe Marrëveshja Hidrokarbure, miratuar me VKM nr. 427, datë 16.07. 2004.

Ndikimi: Përmbajtjet e Licencë Marrëveshja dhe Marrëveshja Hidrokarbure.

Shkaku: Auditimi kostove hidrokarbure mbas tre vjetësh lejon të licencuarin që të kryej kosto hidrokarbure jashtë fushës së marrëveshjes.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 1: AKBN, MIE, Albpetrol në bashkëpunim me kompaninë BPAL të gjejnë rrugët e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit, për të përmirësuar marrëveshjet hidrokarbure në lidhje me të drejtën e auditimit të librave të llogarisë dhe dokumentacionin e kontabilitetit të LICENSUAR-it në lidhje me Operacionet Hidrokarbure. Kjo e drejte Auditit të përfundojë 1 (një) vjet pas datës në të cilën i LICENSUAR-i dorëzon dokumentacionin e tij të kontabilitetit për atë Vit Fiskal.

4. Titulli i Gjetjes. Kostot hidrokarbure që nuk njihen kompanisë BPAL të konstatuara nga Auditimet e AKBN

Situata: Në auditime e kryera nga AKBN janë konstatuar kosto hidrokarbure të tepërta dhe të kryera në kundërshtim me Licencë Marrëveshjen dhe i ka kërkuar kompanisë që nuk i njeh si kosto hidrokarbure. Më poshtë po pasqyrojmë kostot hidrokarbure të nxjerra nga auditimi i AKBN të cilat konsiderohet si kosto që nuk duhet ti njihet dhe ti rikuperohet ndër vite kompanisë BPAL:

Tabela nr. 31

| Nr | Viti | Vlera e kostove hidrokarbure të pretenduara si të panjohura në USD |
|---------------|------|--|
| 1 | 2011 | 247,584,845 |
| 2 | 2012 | 195,050,456 |
| 3 | 2013 | 198,373,077 |
| 4 | 2014 | 210,459,068 |
| 5 | 2015 | 133,347,633 |
| 6 | 2016 | 39,054,859 |
| 7 | 2017 | 22,804,003 |
| Totali | | 1,046,673,940 |

Burimi: AKBN

Për sa më sipër, vlen të theksohet së, në llogaritjet e faktorit R, nuk janë marre në konsiderate gjetjet e auditimit të aktivitetit të kompanisë BPAL nën këtë marrëveshje, i kryer nga AKBN për vitin 2011, 2012, 2013 dhe 2014, 2015 dhe 2016, pasi konkluzionet e paraqitura në këto raporte auditimi janë duke u vlerësuar nga Arbitrazhi Ndërkombëtar. Konkretisht:

Mbi arbitrazhin ndërkombëtar oBPAL, kundër ish-Ministria e Energjisë dhe Industrisë (sot MIE) e përfaqësuar nga AKBN dhe Albpetrol sh.a. ó ICC Case 21349/GR:

Në muajin shtator 2015, BPAL ka paraqitur kërkesë për arbitrazh në arbitrazhin ndërkombëtar të ICC (International Chamber of Commerce) kundër MIE/AKBN dhe Albpetrol SH.A. (óInstitucionet Shqiptareó), duke pretenduar që Institucionet Shqiptare janë në shkelje të marrëveshjeve të lidhura me të, përkatësisht Licencë Marrëveshjes (óLMó) dhe Marrëveshjes Hidrokarbure (óMHó) për vendburimin e Patos - Marinzës, për shkak të mosnjohjes së kostove të pretenduara si kosto hidrokarbure në një vlerë që tejkalon shumë 600,000,000 USD.

Në Mars 2014, grupi i auditimit të AKBN, i përbërë nga përfaqësues të saj dhe të autoriteteve tatimore, kreu auditimin e kostove dhe shpenzimeve të BPAL për vitin 2011 dhe nxori raportin e auditimit përkatës, ku konstatoi një vlerë prej 299,000,000 USD si kosto të panjohura nga totali i kostove prej 384,000,000 USD.

Në vijim, autoritetet tatimore proceduan me nxjerrjen e njoftim-vlerësimit tatimor përkatës në bazë të raportit të auditimit për 2011 dhe i kërkuan BPAL pagesën e tatimit përkatës.

BPAL kundërshtoi si raportin e auditimit ashtu edhe njoftim-vlerësimin tatimor në arbitrazhin ndërkombëtar të ICC dhe në gjykatën shqiptare, përkatësisht, duke kërkuar gjithashtu edhe masë sigurimi për pezullimin e zbatimit të njoftim-vlerësimit tatimor si në arbitrazhin ndërkombëtar ashtu edhe në gjykatën shqiptare. Përfundimisht, masat e sigurimit nuk iu dhanë nga asnjë prej forumeve të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Pas observacioneve të paraqitura, u konkludua në shumën prej 247,584,845 USD si kosto të parikuperueshme.

Më pas, BPAL lidhi marrëveshje (óMarrëveshjaó) me autoritetet tatimore për pagesën me këste të detyrimit të përcaktuar në Njoftim-Vlerësim. Në bazë të Marrëveshjes, autoritetet tatimore janë të angazhuara të ri përlllogaritin detyrimin tatimor në momentin e një Vendimi Përfundimtar të Arbitrazhit Ndërkombëtar ose Marrëveshjeje Përfundimtare të lidhur ndërmjet BPAL dhe AKBN për raportin e auditit të vitit 2011.

Është për t'u theksuar së, në po të njëjtën datë të depozitimit të kërkesës për arbitrazh në ICC dhe kërkesë paditë në autoritetet gjyqësore shqiptare, në 25.09.2015, BPAL lidhi marrëveshje me MEI/AKBN për përcaktimin e Termave të Referencës (óToRó) përzgjidhje të mosmarrëveshjeve nga auditimi i 2011 me Ekspert, në bazë të nenit 25.4 të Licencë marrëveshjes hidrokarbure.

Krahas procedimit në arbitrazh, BPAL, pas nënshkrimit të ToR për procedimin me Ekspertë, vazhdon të shkëmbente korrespondencë me AKBN-në, duke i kërkuar kësaj të fundit të procedonte me vlerësimin e propozimeve për identifikimin e kandidatëve të mundshëm për t'u përzgjedhur si ekspertë, për të shqyrtuar dhe vlerësuar mosmarrëveshjet e rrjedhura nga auditimi i vitit 2011.

Në Janar 2016 u zhvillua seanca përkatëse në arbitrazhin ndërkombëtar mbi menaxhimin e çështjes, Termat e Referencës, përfshirë pranimin ose jo të disa pretendimeve shtesë të BPAL kundrejt AKBN dhe Albpetrol, si edhe aplikimin e BPAL për masën e sigurimit. Përfaqësimi i Albpetrolit u realizua nga firma óC,M-P,C&MLLPó.

Trupa e gjykimit në arbitrazh vendosi pranimin e pretendimeve shtesë të BPAL dhe mosvendosjen e masës së sigurimit të kërkuar nga BPAL. Kjo siguroi që shteti Shqiptar të vijonte mbledhjen e detyrimeve ndaj BPAL dhe uljen e tij në tavolinën e bisedimeve. Referuar Termave të Referencës të dakordësuara për këtë proces, pretendimet e Paditësit do të përmblihdeshin si më poshtë:

1. Mosmarrëveshje mbi njohjen e kostove të rrjedhura nga Auditimi i vitit 2011;
2. Mosmarrëveshje mbi njohjen e shpenzimeve ligjore;

3. Mosmarrëveshjet mbi përjashtimet e TVSH-së dhe përdorimit të diluentit në periudhën 2012/2013;
4. Mosmarrëveshje mbi njohjen e kostove të periudhës Q1-Q3 2013;
5. Mosmarrëveshje mbi njohjen e kostove të rrjedhura nga Auditit i vitit 2012;
6. Mosmarrëveshje mbi njohjen e kostove të rrjedhura nga auditit i periudhës Q4/2013 dhe Q1 ó Q4/2014;
7. Mosmarrëveshje mbi njohjen e kostove të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga BPAL;
8. Mosmarrëveshje mbi hipotekimin e asetëve;
9. Mosmarrëveshje mbi transferimin e titullit;
10. Mosmarrëveshje mbi ASP dhe PEP, të detyrueshme për t'ju dhënë Albpetrolit.

Pas refuzimit të dhënies së masës së sigurimit nga trupa e gjykimit në arbitrazh, BPAL i vazhdoi negociatat me AKBN për të zgjidhur mosmarrëveshjet e auditit të 2011 me ekspertë ndërkombëtarë dhe si pasojë e këtyre negociatave, palët dakortësuan për të pezulluar procesin e arbitrazhit, duke paraqitur një shkresë të përbashkët në Mars 2016. Trupa e gjykimit në arbitrazh vendosi pezullimin e tij në Mars 2016 deri në një njoftim të dytë të palëve mbi përfundimin e procesit të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve me ekspertë.

Në këtë faze të gjykimit në arbitrazh, pra vetëm për procesin e shqyrtimit të mosmarrëveshjeve me eksperte, AKBN u përfaqësua nga Avokatura e Shtetit dhe Studioja Ligjore òC.ò.

Vlera financiare e kostove, objekt shqyrtimi para Panelit të Ekspertëve Ndërkombëtarë ishte 247,584,845 USD dhe pas zhvillimit të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve bashkë me provat përkatëse, Paneli i ekspertëve ndërkombëtarë vendosi së vlera totale e kostove të panjohura ishte **526,621 USD dhe jo 247,584,845 USD e konstatuar nga auditit i AKBN-së.**

Avokatura e Shtetit/AKBN e ankimoi Vendimin e Panelit të Ekspertëve Ndërkombëtarë duke rifilluar procesin e arbitrazhit ndërkombëtar vetëm për mosmarrëveshjet e Auditit të vitit 2011.

Vendimi i arbitrazhit u shpall në shkurt 2018 duke lenë përfundimisht në fuqi vendimin e eksperteve i cili kishte vendosur së, vlera totale e kostove të panjohura ishte **526,621 USD dhe jo 247,584,845 USD.**

Trupa e gjykimit në arbitrazh pas shqyrtimit të ankimit të AKBN dhe ngarkoi këtë të fundit me pagesën e kostove të këtij nën procesi në vlerën rreth **1,161,309 USD.**

Me daljen e vendimit të mësipërm të tribunalit lidhur me procesin e apelimit të vendimit të eksperteve, përfunduan edhe efektet e autorizimit me të cilin ishte pajisur studioja ligjore për përfaqësimin dhe mbrojtjen e kësaj çështjeje. Përfundimi i marrëdhënieve me këtë studio ligjore u shoqërua me faturën përkatëse për shërbimet e përfaqësimit të ofruara për MIE/AKBN dhe Albpetrol sh.a., fature e cila është likuiduar nga Albpetrol sh.a.

Pas përfundimit me sukses në favor të tij të çështjes lidhur me Auditin e vitit 2011 dhe me synimin për të trajtuar këtë rast si precedent, BPAL kërkoi rifillimin e procesit të arbitrazhit dhe shtimin e pretendimeve (pas nënshkrimit të Termave të Referencës të arbitrazhit), duke kundërshtuar edhe auditimet e AKBN-së për vitet 2012, 2013, 2014 e 2015 (auditimi i vitit 2012, aktualisht, është i përfshirë në gjykim në arbitrazh, ndërsa për auditimet e viteve 2013, 2014 e 2015 i është bere kërkesë Tribunalit nga BPAL për t'ja përfshirë edhe këto në po në të njëjtin proces).

Në kushtet kur, marrëdhëniet me studion ligjore kishin përfunduar, nga ana e Avokaturës së Shtetit, iu kërkua kohe shtese Tribunalit për t'ja dhënë mundësi MIE dhe AKBN-së për të zgjedhur një avokat për ta përfaqësuar në këtë proces.

Kompania BPAL e kundërshtoi këtë kërkesë të Avokatura e Shtetit dhe nga ana e saj trupa e gjyqimit, bëri të ditur vendimin e saj për refuzimin e kohës shtesë të kërkuar nga Avokatura e Shtetit dhe ka kërkuar që palët të shprehen mbi disponueshmërinë e tyre për zhvillimin e një seance procedurale (conference call) mbi aplikimin e BPAL për të shtuar mosmarrëveshje të reja në gjykim (auditimin e viteve: 2013, 2014 dhe 2015 sipas korrespondencës me Avokaturën e Shtetit).

Në këtë fazë të gjyqimit të çështjes, Tribunali njoftoi datën 24.05.2019 për zhvillimin e një "Conference call" për të diskutuar pretendimet shtesë të BPAL në arbitrazh ..." Në datë 24.05.2019 u zhvillua seanca në fjalë në të cilën u shqyrtua kërkesa e BPAL sipas së cilës përveç çështjeve të auditit 2013 e 2014 të shtohet edhe auditimi i vitit 2015. Lidhur me këtë kërkesë të BPAL Trupa Gjyquese vendosi që palët pjesëmarrëse në këtë proces BPAL, MIE, AKBN dhe Albpetrol të shprehin qëndrimet e tyre brenda datës 31.05.2019.

Lidhur me këtë kërkesë nga ana e MIE-s u njoftua Avokatura e Shtetit që draft raportet e auditeve në fjalë të mos përfshihen në procesin e arbitrazhit.

Duke pasur parasysh mënyrën së si u trajtua dhe përfundoi çështja lidhur me Auditimin e vitit 2011, kostoja që pati ky proces për shtetin shqiptar vetëm në këtë fazë, si dhe mundësitë që kjo çështje të trajtohet nga BPAL si precedent edhe në të ardhmen, nga ana e MIE-s u negociua me BPAL mundësia për pezullimin e procesit të arbitrazhit. Si rezultat i këtyre negociatave, u nënshkruan marrëveshjet si me poshtë:

1. Marrëveshja e pezullimit të datë 27.08.2019;
2. "Ndryshimi dhe Përmirësimi i Marrëveshjes së pezullimit të datës 27 Gusht 2019" datë 19.12.2019;
3. "Ndryshimi i dytë i Marrëveshjes së pezullimit" të datës 27 gusht 2019 ", datë 30.04.2020.

Në objektin e tyre, këto marrëveshje (Standstill Agreement) parashikojnë pezullimin për një periudhë prej 90 ditësh të procesit të arbitrazhit ndërkombëtar ICC Case 21349/GR ndërmjet palëve BPAL kundër MIE e përfaqësuar nga AKBN dhe Albpetrol sh.a.

Ky pezullim i procesit të arbitrazhit nëpërmjet marrëveshjeve si me sipër synon zgjidhjen me mirëkuptim të çështjeve objekt gjykimi në këtë proces.

Gjate gjithë periudhës 90 ditore të pezullimit (sipas marrëveshjes e dyte përfundon në datën në 30.07.2020), palët në këto marrëveshje, kanë marrë përsipër që të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen me mirëkuptim të sa më shumë prej çështjeve të lindura nga auditimet e viteve 2012, 2013, 2014 dhe 2015.

Përveç sa me sipër, palët janë angazhuar për të respektuar parashikimet e këtyre marrëveshjeve duke vene në dijeni edhe Grupin e Gjyqimit në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar për dakordsinë e arritur nëpërmjet tyre (marrëveshjeve).

Kriteri: Arbitrazhi Ndërkombëtar, BPAL, kundër ish-Ministria e Energjisë dhe Industrisë (sot MIE) e përfaqësuar nga AKBN dhe Albpetrol sh.a. ó ICC Case 21349/GR

Ndikimi: Mos pagim të detyrimit për tatimin mbi fitimin

Shkaku: Njohje nga Arbitrazhin Ndërkombëtar të kostove hidrokarbure të pretenduara nga AKBN si kosto të rikuperueshme.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 1: AKBN, MIE, Albpetrol të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme realizimin e proceseve hidrokarbure, për parandalimin e përfshirjes në të të shpenzimeve të cilat nuk konsiderohen të rikuperueshme. Nga ana e AKBN dhe Albpetro të merren masa për realizimin e proceseve audituese, duke u referuar në standardet më të pranuar ndërkombëtarisht.

5. Titulli i gjetjes: Shpenzime hidrokarbure të përfshira padrejtësisht në kosto hidrokarbure të rikuperueshme.

Situata: Gjatë vitit 2020 dhe 2021 nga ana e Drejtorisë Hidrokarbure dhe Drejtorisë ekonomike janë realizuar dy auditime për saktësinë e shpenzimeve të përfshira si kosto hidrokarbure.

Auditimi i kryer në vitin 2020, është realizuar për aktivitetin e kontraktimit për vitin 2017. Gjetjet paraprake i janë dërguar kontraktorit me shkresë nr. 2179/6 prot., datë 31.12.2020. Auditimi ka filluar në muajin maj dhe ka përfunduar në muajin dhjetor. Gjatë auditimit janë bërë shtesa të afatit të auditimit. Nga auditimi janë konstatuar parregullsi që kryesisht kanë të bëjnë me:

-Kontraktori ka kryer shërbime që kalojnë vlerën 2 milionë USD, për të cilat nuk është realizuar procedurë prokurimi, apo vlerësim tregu, në kundërshtim me Marrëveshjen Hidrokarbure neni 21, pika 2.

- Kontraktori ka bërë sponsorizime, pa marrë më parë miratimin e AKBN.

- Inventari është përfshirë në kosto hidrokarbure, pa u futur më parë në përdorim.

- Shpenzime për shërbime konsulente, pa kontratë dhe pa asnjë përcaktim.

- Shpenzime personeli të kryera nga kompania mëmë, por që nuk kanë lidhje me kostot hidrokarbure në Shqipëri, pasi nuk rezultojnë pagesa për sigurimet shoqërore apo shëndetësore, pra të pa argumentuara.

Në mënyrë të përmblodhur, shpenzimet kryesore të përfshira në kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure dhe licencë marrëveshjen, paraqiten në tabelën (Aneks 5).

Vlera totale e konstatuar nga grupi i auditimit të AKBN, për llogaritë kosto hidrokarbure që nuk konsiderohet kosto hidrokarbure të rikuperueshme për vitin 2017, është me vlerë 22,804,003 USD.

Nga ana e grupit të auditimit të AKBN, të përbërë nga znj. O.M., B.B., z. F.O., znj. R.Q., znj. I.B., znj. S.B., znj. M.H., z. V.P., z. F.M., z. A.Z. dhe z. M.S, është rekomanduar marrja e masave që kontraktori të ketë në vëmendje verifikimin dhe plotësimin e dokumentacionit ligjor, rekomandohet mos rëndojë koston me shpenzime të pa rikuperueshme, para lidhjes së kontratave të qirasë të studiojës tregun, të kontaktohet direkt me njësitë vendore për marrjen e tokave me qira, të bëhet një vlerësim ekonomik për kostot e qirave të apartamenteve. Sa i përket mediave, Kontraktori inkurajohet të mbajë marrëdhënie të mira profesionale me median lidhur me publikime të ndryshme të aktivitetit të tij, por kostot e shërbimeve të ngarkojë në buxhetin e tij dhe jo si kosto hidrokarbure.

Auditimi i kryer në vitin 2021, është realizuar për aktivitetin e kontraktimit për vitin 2018. Gjetjet paraprake i janë dërguar kontraktorit me shkresë nr. 405/8 prot., datë 29.12.2021. Auditimi ka filluar në muajin shkurt 2021 dhe ka përfunduar në muajin dhjetor 2021. Gjatë auditimit janë bërë shtesa të afatit të auditimit. Nga auditimi janë konstatuar parregullsi që për nga natyra janë pothuajse të njëjta me parregullsitë e konstatuara në vitin 2020, për aktivitetin hidrokarbur të vitit 2017. Në aneks 5, paraqitet tabela me kostot e panjohura.

Kriteri: Marrëveshjen Hidrokarbure, aneksi B, neni 2, pika 2.h.

Marrëveshjen Hidrokarbure, neni 2, pika 17 dhe 2.9.

Licencë-Marrëveshjen, neni 15 pika 3 dhe 16 pika 3.

Licencë-Marrëveshjen, neni 10.2, germa d.

Ndikimi: Mos pagim te detyrimit për tatimin mbi fitimin

Shkaku: Veprim në mënyrë të përsëritur nga ana e Kontraktorit në kundërshtim me marrëveshjen.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AKBN dhe Albpetrol, në bashkëpunim me ministrinë e linjës të marrin masa për vlerësimin rast pas rasti, në nivel ekspertësh të fushës për shkeljet e përsëritura nga ana e kontraktorëve jo vetëm për mos realizimin e planit të zhvillimit, apo programeve vjetore, por edhe për përfshirje të shpenzimeve në kosto hidrokarbure të pa rikuperueshme në kundërshtim me marrëveshjet, në mënyrë të përsëritur, për arritjen e konkluzionit për bërjen e njoftimeve për thyerje të marrëveshjes, sipas përcaktimeve në marrëveshjet hidrokarbure dhe licencë marrëveshjet.

Rekomandimi: AKBN dhe Albpetrol, të marrin masa për kordinim me institucionet ligjzbatuese, për monitorimin sa është e mundur nëpërmjet instrumenteve ligjore, të operacioneve hidrokarbure të kompanive, duke monitoruar edhe zbatimin e kontratave të kontraktorit me nënkontraktorë si për punime, mallra dhe shërbime, ashtu edhe për marrje me qira të pronës.

Rekomandimi: AKBN në bashkëpunim me Albpetrol SHA dhe MIE, të marrin masa për hartimin e manualeve dhe udhëzuesve të auditimit, me referenca standarde të pranuar ndërkombëtare të auditimit dhe të bëhen negociata për pranimin e tyre nga palët.

6. Titulli i Gjetjes: Mos miratime të planeve dhe buxheteve vjetore kompanisë BPAL brenda afateve të përcaktuara në Licencë dhe Marrëveshjen Hidrokarbure:

Situata: Mbeten problem shqetësues vonesat e miratimit nga Albpetroli të planeve dhe buxheteve vjetore që vet kompania BPAL propozon për tu realizuar gjate një viti. Konkretisht: Në Licencë Marrëveshje, nen 7.2,a,b,c,d parashikohet së: *ōjo më vonë së gjashtëdhjetë (60) ditë para përfundimit të çdo Viti Fiskal, ose sipas afateve të tjera që mund të bihet dakord midis AKBN dhe të Licencuar-it, i Licencuari përgatit dhe i dorëzon AKBN një propozim të Programit Vjetor dhe Buxhetit që paraqet Operacionet Hidrokarbure që do të kryhen gjatë Vitit Fiskal që pason.....;*

Për te plotësuar këtë klauzole te licencës, në pikë 2 të nenit 8 të marrëveshjes hidrokarbure është parashikuar që: *“Të paktën nëntëdhjetë (90) dite para fundit te Vitit Fiskal te pare pas aprovimit te Planit te Zhvillimit dhe çdo Vit Fiskal pas tij, ose në kohe te tilla siç do te bihet dakord nga Palët, Kontraktori do te përgatis dhe dorëzoje në Komitetin Këshillimor për aprovim një Program Vjetor dhe Buxhet te propozuar për Vitin Fiskal pasardhës. Çdo Program Vjetor dhe Buxhet do te jete konsistent me Planin e Zhvillimit. Nëse përfaqësuesit e Albpetrolit në Komitetin Këshillimor dëshirojnë te propozojnë një rishikim në lidhje me disa veçori specifike te Programit Vjetor dhe Buxhetit në fjale, brenda njëzet e një (21) ditëve pas marrjes nga Komiteti Këshillimor ai do te njoftoje njësoj Kontraktorin, duke specifikuar me detaje te arsyeshme arsyet e tij për këtë. Menjëherë pas kësaj, Palët do te takohen dhe do te përpiqen te bien dakord mbi rishikimin e propozuar nga përfaqësuesit e Albpetrolit. Kontraktori do te japë atë që i takon në lidhje me propozimet e përfaqësuesve te Albpetrolit, me kusht qe Albpetrolit do ti kërkohet te aprovoje çdo Program Vjetor dhe Buxhet qe është konsistent me Planin e Zhvillimit, dhe çdo rishikim i propozuar ndaj një Programi Vjetor dhe Buxheti qe janë konsistent me Planin e Zhvillimit nuk ka nevojte te pranohet nga Kontraktori. Në rast te lindjes së ndonjë konflikti në lidhje me aprovimin e një Programi Vjetor dhe Buxheti, në përputhje me Nenin 19.10, çështja do te çohet për përcaktim Eksperti. Para zgjidhjes te çdo konflikti te tille, Programi Vjetor dhe Buxheti i propozuar nga Kontraktori, do te gjykohet i aprovuar për qëllime operacionesh te brendshme gjate zgjidhjesō.*

Sa më sipër, përcaktimet e marrëveshjeve hidrokarbure kane parashikuar me afate strikte gjithë procedurën në të cilën kalon vlerësimi, diskutimi dhe miratimi i këtyre programeve, ndërkohe që zbatimi në praktike i kësaj procedure është larg këtyre afateve.

Referuar këtyre përcaktimeve të licencës dhe marrëveshjeve hidrokarbure, programet dhe buxhetet e kompanive të miratuara nga palët në mbledhjet e komiteteve këshillimore respektive, duhet të dërgohen për miratime të mëtejshme në AKBN në fund të muajit Tetor. Mirëpo nga auditimi u konstatua së, në asnjë rast kjo procedure nuk është zbatuar tërësisht. Gjithmonë ka pasur shtyrje, zvarritje deri edhe në kalim të buxheteve vjetore të pa miratuara.

Në të njëjtën kohe, duhet të njohim faktin që, përgjithësisht kompania i ka dërguar këto programe brenda afatit të përcaktuar në MH dhe LM, por vazhdimi i mëtejshëm i procedurës miratuese nuk ka qene në përputhje me ato të duhura.

Në një kohë që kompanisë Albpetrol nuk i lejohet të tejkalojë afatin 21 ditor për vlerësimin, diskutimin dhe miratimin e tij në ACM, kjo kohe ka tejkaluar çdo limit të mundshëm, duke arritur sikurse për vitin 2020, ku edhe tani që jemi në muajin qershor 2020 (periudha e ushtrimit të auditimit), këto programe nuk janë miratuar.

Edhe po të marrim në konsideratë vështirësitë që mund të evidentojmë aktualisht për situatën emergjente të COVID-19, argumenti i përdorur nuk justifikon vonesën. Këto programe duhej të ishin miratuar nga palët minimalisht në fund të muajit nëntor, nëse do të pranonim një zgjidhje që do të kalonte nëpërmjet Ekspertit, por ama ky miratim do të ishte para vitit që pason.

Me gjithë përpjekjet e AKBN është e vështirë të kuptohen arsyet e mosrespektimit të procedurës për miratim të këtyre planeve pasi për këtë problem në AKBN nga kompania Albpetrol nuk paraqiten argumente dhe arsye të qenësishme, ndërkohe që procedura e përgatitjes, paraqitjes dhe e miratimit të këtyre programeve por dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjate këtij procesi, është e pasqyruar mjaft qarte në Licencë dhe në Marrëveshje, me veprime dhe me afate konkrete.

KLSH, e shikon këtë pa rregullsi përgjithësisht tek kompania Albpetrol, e cila jo vetëm që nuk i trajton në kohë programet e propozuara nga kompania, por edhe problemet që ekspozon si defekte të programeve i paraqet vetëm në formën e konstatimit, pa propozuar vetë ndryshimet që ajo kërkon të behën tek këto programe, në mënyrë që edhe kompania ti marrë në konsideratë këto propozime ose ti kundërshtojë ato, duke zvarritur pafund procedurën e diskutimit e miratimit.

Rrisku i mosrespektimit të afateve të miratimit të programeve dhe buxheteve është që kompania duke mos pasur programe të miratuara, hezitojnë të kryejnë investime sipas vizionit të tyre të pasqyruar në planet e zhvillimit. Kryejnë investime sa për të mos ndërprerë operacionet, të cilat nuk mund të kontribuojnë në zhvillimin e vendburimeve sipas planeve të zhvillimit të miratuara. Dhe efektet negative bëhen të ndërvarura nga njëra tjetra. Për me tepër, mos miratimi i programeve dhe buxheteve e jep shkas kompanisë që, në një konflikt të mundshëm në gjykatën e arbitrazhit, ata të përdorin këto probleme edhe si argumente pengues në punën e tyre.

Në gjykimin e KLSH, vonesa e veprimeve të tilla nuk i shërbejnë mbarëvajtjes dhe ecurisë normale të implementimit të planeve të zhvillimit afatgjatë të miratuar për vendburimet duke qenë edhe larg pritmërisë dhe angazhimeve të vet palëve në marrëveshje, që pasqyrohen në preambulat (*pikat "H" dhe "I"*) e Licencë Marrëveshjeve, por edhe atyre të pasqyruara në planet e zhvillimit të vendburimeve.

Siç u tha më sipër edhe pse në mënyrë të përsëritur AKBN ka kërkuar në rrugë shkresore, që të respektohen afatet e përcaktuara në Licencë Marrëveshjedhe Marrëveshjen Hidrokarbure të

dorëzimit për miratim pranë AKBN që bëhet në fillim të muajit nëntor, pra 60 ditë para fillimit të vitit ri fiskal edhe për periudhën objekt auditimi nuk janë respektuar këto afate. Konkretisht:

-Për 2018 programi u dorëzua pranë AKBN dhe u miratua në fund të muajit mars 2018, pra në një kohë kur ishin shkelur të gjitha afatet e pranueshme e të mundshme për miratimin e tij.

-Për vitin 2019 programi i propozuar nga kompania u miratua gjatë muajit shtator 2019, mbas disa varianteve të përgatitura e të diskutuara në mbledhjet e komitetit këshillimor të kompanisë.

-Për vitin 2020 programi i punës dhe buxheti ende nuk është miratuar. Varianti i parë i përgatitur nga kompania gjatë muajit dhjetor 2019, u dërgua për rregullime të mëtejshme. U përgatit edhe një variant tjetër gjatë muajit janar 2020, po edhe ky nuk mori miratimin dhe dakordësinë e palëve. Në fund të muajit mars 2020 kompania ka paraqitur një variant tjetër të këtij programi, i cili është në fazën e diskutimit. Paraprakisht mund të themi së, në variantin e fundit të paraqitur nuk është marrë në konsiderate rënia drastike e çmimit të Brentit sidomos gjatë periudhës mars prill ku ky çmim arriti në vlera (15-20) USD/bbl.

KLSH në auditimet e fundit i ka evidentuar këto vonesa dhe për këtë problem ka rekomanduar masa për respektimin e termave të parashikuara në licencë e marrëveshje për dorëzimin për miratim të këtyre programeve. Por nga ana e kompanisë Albpetrol nuk ka gjetur zbatim për ta zgjidhur këtë problem. Veprimet e Albpetrolit në këtë drejtim kanë qenë mjaft të ngadalta duke tejkaluar pothuaj në të gjitha rastet periudhën e vlerësimit, diskutimit e miratimit të këtyre programeve.

Kriteri: Mos respektim të afateve të përcaktuara në Licencë Marrëveshje, neni 7.2,a,b,c,d dhe neni 8 të marrëveshjes hidrokarbure

Ndikimi: Kryejnë investime sa për të mos ndërprerë operacionet, të cilat nuk kontribuojnë në zhvillimin e vendburimeve

Shkaku: Kompania duke mos pasur programe të miratuara, hezitojnë të kryejnë investime sipas vizionit të tyre të pasqyruar në planet e zhvillimit.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandimi:AKBN, MIE dhe Albpetrol të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e humbjes në Arbitrazhin Ndërkombëtar.

Rekomandimi:AKBN, MIE dhe Albpetrol të mos tolerojnë praktikatat e miratimit në heshtje dhe formal të Planeve Vjetor dhe buxheteve të paraqitura. Të miratojnë sa më shpejte Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2020. Të ndiqen me rigorozitet kërkesat e përcaktuara në MH dhe LM për shqyrtimin dhe dakordësimin e Planeve Vjetore dhe buxheteve të paraqitura nga kompania òA O&Gò.

7. Titulli i Gjetjes: Zbatimi iLicencë Marrëveshjes dhe Marrëveshjes Hidrokarbure për vendburimin Ballsh-Hekal lidhur midis Albpetrol sha dhe kompanisë A O&G (fillimisht S O G me pas me kompaninë T.), miratuar me VKM Nr.509, datë 08.08.20207.

Situata: Kjo marrëveshje hidrokarbure aktualisht ajo është në vitin e 13, të implementimit të saj. Kjo marrëveshje parashikonte, si faze të parë atë të vlerësimit, me një kohëzgjatje prej 18 muajsh, në periudhën 24.08.2007 deri 24.02.2009. Me përfundimin e kësaj periudhe palët në marrëveshje kërkuan zgjatjen e periudhës së vlerësimit me 6 muaj, zgjatje e cila u miratua nga AKBN. Pra e gjithë periudha e vlerësimit ka përfunduar në datën 23.08.2009.

Me përfundimin e periudhës vlerësimit kompania shprehu interes për të hyrë në fazën e dytë, atë të zhvillimit e prodhimit, kështu ajo përgatiti dhe përcolli për miratim në AKBN Planin e Zhvillimit afatgjatë të vendburimit.

Që prej vitit 2010, kompania ka vijuar kryerjen e operacioneve hidrokarbure për përpunimin e vendburimit, mbështetur në Planin e Zhvillimit dhe në programet e punës dhe buxhetet e miratuara për këto periudha.

Gjate periudhës 2007-2017 kompania ka respektuar formulën e ndarjes së naftës së prodhuar ashtu siç përcaktohet në Marrëveshje.

Gjate kësaj periudhe, prodhimi i naftës ka qene rreth 31% te prodhimit te parashikuar në planet e punës dhe buxhetet vjetore. Ky mosrealizim është përgjithësisht pasoje e mos marrjes në dorëzim të pjesës tjetër të vendburimit në përputhje me parashikimin e Planit të Zhvillimit por edhe për mungese te investimeve dhe operacioneve qe ndikojnë drejtpërdrejte për rritjen e prodhimit te naftës. Theksojmë së, që nga viti 2008 deri në vitin 2018, kompania vazhdoi të operonte në 15 puse nga 22 puse që ka marrë në dorëzim, në një kohe që në gjithë vendburimin janë 81 puse aktive. Pretendimet e kompanisë për marrjen e puseve në dorëzim kanë qenë të mëdha, por këto pretendime nuk janë mbështetur sa duhet nga kompania Albpetrol. Kështu, në të njëjtën mase kane qene edhe investimet kapitale të kompanisë, në përputhjeje numrin e puseve në të cilët kryente operacione.

Konstatohet së, ka pasur mungesa dhe vonesa të mëdha për kryerjen e investimeve kapitale. Gjithashtu ka mungese të projekteve dhe drejtimeve të mundshme për investime kapitale që synojnë dhe ndikojnë në rritjen e naftë nxjerrjes. Për rrjedhoje, qe nga viti 2012 e në vazhdim, nuk reflektohet asnjë rritje të sasisë së nxjerrjes së naftës bruto nga vendburim, me një rënie mjaft të madhe, prej gati 12% në vit.

Në pjesën e pa dorëzuar e vendburimit, që deri në vitin 2018 administrohej nga kompania Albpetrol sha, nga viti 2013 e në vijim vërehet një rritje konstante e prodhimit me një trend prej gati 7.5% në vit. (rritje nga 11,970 ton/muaj në vitin 2013 në gati 19,500 ton/muaj, në vitin 2017). Pra performanca e administrimit te vendburimit nga kompania Albpetrol është shume me pozitive së ajo e kompanisë T..

Me hyrjen në fuqi e ligjit Nr. 9975, òPër Taksat Kombëtareò dhe në përputhje me Ligjin 7746, òPër Hidrokarburetò, me qellim ruajtjen e ekuilibrit ekonomik te marrëveshjes, palët duhet të negocionin së bashku për të bërë të mundur ndryshimet e nevojshme dhe arritjen e një marrëveshje për amendimin e MH dhe LM, e cila do të mundësonte pagesat për rentën minerare. Deri me sot palët nuk munden të arrinin këtë marrëveshje. Nga zbatimi i këtij ligji shteti shqiptar ka përfituar pagesën për rentën minerare vetëm një vlere prej 600 mije USD.

Sipas inspektimeve periodike te kryera nga AKBN, por edhe nga shqyrtimi i informacioneve periodike te dërguara nga kompania, janë konstatuar vonesa dhe mungesa te mëdha në realizimin e investimeve. Megjithëse në të gjitha mbledhjet e Komitetit Këshillimor, palët kane miratuar Planet e Punës dhe Buxhetet, në te cilat përfshihen operacione hidrokarbure qe lidhen me kryerjen e investimeve për riaktivizimin e puseve të ndalur dhe kompletimin e tyre me pajisje për ti përshtatur ata me teknologjinë PCP, nga palët nuk është bere asgjë për implementimin e këtyre.

Sipas planit te zhvillimit, viti i pare dhe i dyte i implementimit te këtij plani do te përqendrohej në kryerjen e remontit (workover) në puse dhe riaktivizimin e tyre. Por realisht, këto lloj investimesh asnjëherë nuk u kryen të gjitha, gjë që solli edhe vonesa në implementimin e planit të zhvillimit. Në vijim, investimet kapitale, të përqendruara kryesisht në riaktivizimin e puseve dhe në përmirësimin teknologjik te tyre, te cilat lidhen drejtpërdrejte me rritjen e prodhimit te naftës, kane qene në nivele tepër të ulta.

Investimet e kryera deri në vitet 2015 kane qene përqendruar kryesisht në:

-Investime në infrastrukturën lidhëse midis puseve,

-përgatitjen e puseve të prodhimit nëpërmjet rehabilitimit të shesheve të tyre për zhvillimin normal të operacioneve hidrokarbure,

blerje të makinerive e pajisjeve për kompletimin e puseve me teknologjinë PCP.

Pavarësisht së, në Planin e Zhvillimit, për periudhën 2007-2017, ishin parashikuar të realizoheshin rreth 27 milion USD investime kapitale dhe ndërkohe që në programet vjetore ishin parashikuar rreth 39 milion USD investime Kapitale, në realitet, nga viti 2014 e në vijim këto investime janë inekzistente. Investimet maksimale kanë qenë në vitin 2012 me rreth 3.7 milion USD. Mbas këtij viti, vërehet rënie e këtyre investimeve deri në ndërprerjen totale të tyre, ku për vitin 2015, 2016 dhe 2017 nuk ka fare investime kapitale.

Ky fakt ka ndikuar edhe tek prodhimi i naftës i cili siç e përmendem edhe me sipër, mbas vitit 2012 ka rënie të madhe.

Gjithashtu kanë munguar investimet për infrastrukturën e magazinimit dhe trajtimit të naftës. Kompania ka mjaftuar me përdorimin e linjës së trajtimit të naftës në Usojë, e cila administrohet nga kompania Albpetrol, për të cilën kompania ka pasur mjaft mosmarrëveshje në drejtim të realizimit e zbatimit të kontratës së shërbimit të lidhur me Albpetrolin, si në drejtim të trajtimit të naftës ashtu edhe në drejtim të shlyerjes së detyrimeve financiare që lidhen me shërbimin e trajtimit e përgatitjes së naftës për tregtim.

Kompania nuk punoi në drejtim të krijimit të pavarësisë së kryerjes së shërbimeve e cila solli mosmarrëveshje me kompaninë Albpetrol si për magazinimin e naftës së prodhuar nga kompania në Ballsh-Hekal ashtu edhe për trajtimin e saj dhe shlyerjen e detyrimit për kostot e trajtimit.

Në Prill të vitit 2015, AKBN miratoi kalimin e interesave nga kompania S O G tek kompania T., duke besuar së implementimi i marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet Ballsh-Hekal, Cakran-Mollaj, Delvine dhe Gorisht-Kocul, do të bëhej me një vizion të ri, në ndryshim nga ai i kompanisë S.O..

Në vijimësi, kompania nuk ka qenë korrekte për përgatitjen dhe miratimin e programeve dhe buxheteve vjetore për operacionet hidrokarbure që parashikohen të kryhen gjatë një viti fiskal. Në këtë drejtim ka pasur zvarritje, vonesa dhe mangësi të karakterit procedural si dhe mos rakordime me kompaninë Albpetrol për paraqitjen, diskutimin, vlerësimin dhe miratimin e tyre.

Kanë qenë katër vite radhazi që nga ana e palëve në këtë marrëveshje është proceduar me shumë vonesa për miratimin e programeve vjetore. Në vitin 2013 nuk u miratuan fare programe dhe buxhete vjetore, për vitin 2014 këto programe u miratuan në muajin shtator 2014, ndërkohe që për vitin 2015 dhe 2016, 2017 u procedua me programe vjetore të pa miratuara. Deri në fund të muajit përfundimor 2018, edhe programi për vitin 2018 nuk u miratua as nga Komiteti Këshillimor i kompanisë as nga AKBN.

Duke marrë në konsideratë problematikat e pasqyruara me sipër por edhe mungesën e angazhimeve të kompanisë T. për riparimin e tyre, në muajin janar 2018 nga ana e kompanisë Albpetrol u përdorën instrumente ligjore jashtë marrëveshjes hidrokarbure (nëpërmjet përmbauesit ligjor privat dhe shitjes së vendburimit me ankandit), për të transferuar me vone, gjatë muajit Maj 2018, interesat e kësaj marrëveshje tek kompania òA O&Gö.

Kompania òA O&Gö si fituese e ankandit, në muajin gusht 2018 mori në dorëzim të gjithë vendburimin Ballsh-Hekal dhe filloi implementimin e marrëveshjes në përputhje me planin e zhvillimit ekzistues dhe programit dhe buxhetit të përgatitur prej saj për periudhën e mbetur.

Vlen të theksohet së nga kompania A. dhe A. është rënë dakord që plani i zhvillimit të miratuar në mars 2010 për këtë vendburim e ka humbur kuptimin e tij si në aspektet teknike ashtu edhe në ato komerciale, pasi kushtet në të cilat ndodhet zhvillimi i vendburimit kanë ndryshuar, për me tepër që edhe operatori është ndryshuar. Për këtë arsye në mbledhjen e Komitetit Këshillimor të

kompanisë të zhvilluar në muajin Janar 2019 është lënë si detyrë që të behet një amendim i këtij plani zhvillimi duke e përshtatur atë me kushtet aktuale. Gjatë muajve tetor-nëntor 2019 kompania paraqiti një amendim të planit të zhvillimit të ekzistues për zhvillimit e vendburimit. Ky program ende nuk është diskutuar e miratuar nga Komiteti Këshillimor pasi kompania Albpetrol e lidh këtë miratim me zgjidhjen paraprakisht të problemit të detyrimeve të prapambetura ende të pashlyera që kompania ka ndaj kompanisë Albpetrol në lidhje me PEP (prodhimi para ekzistues) dhe ASP (pjesës fitim), në një vlerë prej 16 mijë ton naftë.

Konstatohet së, gjatë vitit 2018 kompania realizoi rreth 1,6 milion USD investime kapitale për vënien në eficence të gjithë vendburimit të naftës Ballsh-Hekal, duke prodhuar rreth 6,700 ton naftë nga rreth 16,500 ton te planifikuara duke shlyer edhe detyrimet ndaj kompanisë Albpetrol dhe duke paguar edhe 185 mije USD si detyrimin për rentën minerare.

Edhe gjatë vitit 2019 kompania vazhdoi të kryejë operacione hidrokarbure në vendburim në përputhje me parashikimet në programin dhe buxhetin e përgatitur prej saj. U realizuan gjithsej rreth 2.9 milion USD investime kapitale, te cilat përbejnë rreth rreth 30% të investimeve të parashikuara, u realizua plani i prodhimit te naftës në masën rreth 97%, duke prodhuar 24,400 ton naftë nga 25 mije te parashikuara si dhe u krye pagesa e rentës minerare prej rreth 600 mije USD.

Kompania pretendon së, nga operatori paraardhës janë dorëzuar tek kompania Albpetrol një sasi naftë prej rreth 16 mije ton me tepër së detyrimi, ndërkohe që kompania Albpetrol e kundërshton në mënyrë kategorike këtë fakt. Kompania Albpetrol pretendon së, për këtë sasi Albpetrolit ka rënë dakord me kompaninë paraardhëse (T.) që të njihet si shlyerje e detyrimeve për PEP dhe ASP për vendburimet Ca-Mo dhe Go-Ko, të cilat së bashku me Ballsh-Hekalin i administronte kjo kompani. Aktualisht kjo problematike, në përputhje me licencë marrëveshjen dhe marrëveshjen hidrokarbure si dhe me marrëveshje midis Albpetrolit dhe òA O&G do ti kaloje për tu trajtuar nga Eksperti (avokati).

Për shkak të mos zgjidhjes së këtij problemi edhe Programet e Punës dhe Buxhetet për vitin 2019 dhe 2020 të kompanisë òA O&G nuk janë miratuar nga kompania Albpetrol.

Në lidhje me shlyerjen e këtyre detyrimeve duhet të theksohet me forcë së, KLSH në auditimin e fundit ka trajtuar paligjshmërinë e kalimit të interesave të kësaj marrëveshje nga kompania òT.ò tek kompania òA O&G dhe ka dale me konkluzionin së:

òKompania T., nëse kërkon këto detyrime në Gjykatën e Arbitrazhit, buxheti i shtetit mund të pësojë humbje që mund të shkojnë në vlera të konsiderueshme nga 30 milion USD deri në 50 milion USD” si dhe për të eliminuar këto efekte ekonomike ka rekomanduar që:

- AKBN në bashkëpunim me MIE dhe Albpetrolin, të ngrenë një grup pune të përbashkët për të analizuar të gjitha detyrimet e ndërsjellat që kanë rrjedhur nga zbatimi i Marrëveshje Hidrokarbure ndërmjet Kompanisë “T.” dhe Albpetrolit për Vendburimin Ballsh-Hekal.

-AKBN ti kërkojë Albpetrolit dhe Përmbaruesit Gjyqësor, që të paraqesin, dokumentacionin në lidhje me arkëtimin e vlerës 700,637.84 USD nga shoqëria fituese e ankandit “A. O & G” si dhe dokumentacionin për shlyerjen e detyrimeve nga përmbaruesi, për të gjithë kreditorët e Vendburimit Ballsh-Hekal, për të cilët janë nxjerrë Urdhrat e Ekzekutimit të Gjykatave, e në veçanti shlyerjen e detyrimeve ndaj Albpetrolit i cili është edhe kreditori më i madh.

-AKBN, MIE, Albpetrol dhe Avokati i Shtetit, të përgatiten për mbrojtjen ligjore dhe të bashkëpunojnë për të grumbulluar dokumente, fakte dhe prova, për ti paraqitur në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar për të vërtetuar ligjshmërinë e kalimin e të drejtave të lindura nga “MH për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Vendburimin Ballsh-Hekal”, datë

19.07.2007 lidhur midis shoqërisë "Albpetrol" Sha dhe shoqërisë "T." në favor të shoqërisë "A. O & G" sh.a.

Gjithçka më sipër që ka trajtuar KLSH, është bërë fakt dhe realitet nga kompania òT.ò, e cila ka hapur çështjen gjyqësore në Arbitrazhin Ndërkombëtar (ICC Case no.22676), duke paditur MIE dhe shoqërinë òAlbpetrolò dhe i kërkon òAlbpetrolitò, pikërisht detyrimet dhe fitimin e munguar në vlerën 113,000,000 USD, pa përfshirë këtu vlerat e pagesave që Albpetrol i ka bërë avokatëve të caktuar nëpërmjet Avokatit të Shteti për mbrojtjen e çështjes që arrijnë mbi 2 milion USD. Për këtë proces gjyqësor sipas të dhënave operative të marra në AKBN nga emailit dërguar nga Avokatura e Shtetit dhe nga MIE si dhe nga observacionet e dërguara për aktkonstatimin e mbajtur, këto pretendime të kompanisë janë rrëzuar pjesërisht nga Arbitrazhi Ndërkombëtar i datës 06.07 2020, i cili ka vendosur në favor të kompanisë òT.ò ti rimburojë nga buxheti i shteti vetëm pagesat e rentës minerare në vlerën 12,577,852 USD. Për këtë problem në AKBN nuk ka dokumente dhe informacion të bollshëm për të dale më rezultat të qarte dhe të sakte sepse, palë në këtë proces është MIE dhe òAlbpetrolò, ndërsa AKBN është si palë e trete dhe i gjithë dokumentacioni ligjor dhe financiar ndodhet në MIE, në òAlbpetrolò dhe në Avokaturën e Shtetit.

Si përfundim përmbledhim, operacionet hidrokarbure në këtë vendburim nuk janë kryer me ritmet e parashikuara. Ato kanë ecur mjaft ngadalë për shkak të mungesës së investimeve, duke kompromentuar ndjeshëm implementimin e treguesve të planit të zhvillimit në përgjithësi dhe Licencë marrëveshjen në veçanti, sepse:

-Që nga viti 2012 deri në vitin 2017, nuk reflektohet asnjë rritje për sasinë e nxjerrjes së naftës bruto nga vendburimi. Kjo sasi ka qenë me rënie të vazhdueshme, në një trend prej gati 12% në vit. Ndërkohë që në pjesën e pa dorëzuar të vendburimit, që administrohej nga kompania Albpetrol sha, nga viti 2013 e në vijim ka pasur rritje konstante e prodhimit me një trend prej gati 7.5% në vit. (rritje nga 11,970 ton/muaj në vitin 2013 në gati 19,500 ton/muaj, në vitin 2017). Pra performanca e administrimit të vendburimit nga kompania Albpetrol është shumë me pozitive së ajo e kompanisë T..

-Ka pasur mungesa dhe vonesa të mëdha për kryerjen e investimeve kapitale. Ka pasur gjithashtu mungese edhe të projekteve dhe drejtimeve të mundshme për investime kapitale që synojnë dhe ndikojnë në rritjen e naftë nxjerrjes dhe përfitimeve të shtetit dhe kompanisë. Në Planin e Zhvillimit, për periudhën 2007-2017, ishin parashikuar të realizoheshin rreth 27 milion USD investime kapitale, ndërsa në programet vjetore për këtë periudhë ishin parashikuar në total rreth 39 milion USD investime kapitale. Në realitet, nga viti 2014 e në vijim këto investime janë inekzistente. Investimet maksimale kanë qenë në vitin 2012 me rreth 3.7 milion USD. Mbas këtij viti, vërehet rënie e këtyre investimeve deri në ndërprerjen totale të tyre, ku për vitin 2015, 2016 dhe 2017 nuk ka fare investime kapitale.

- Në lidhje me programet vjetore është i pesti vit që procedohet me shumë vonesa për miratimin e tyre. Për vitet 2013 nuk u dorëzuan program dhe buxhete vjetor, për vitin 2014 këto programe u miratuan në muajin shtator 2014, ndërkohë që për vitin 2015 dhe 2016, 2017, u procedua me programe vjetore të pamerituara. Programi dhe buxheti për vitin 2018 u miratua në gusht të vitit 2018. Ndërkohë që për vitet 2019 dhe 2020 këto programe nuk janë miratuar as nga Komiteti Këshillimor i kompanisë as nga AKBN.

Plani i Zhvillimit i miratuar në vitin 2009 dhe është përmirësuar në vitin 2019. Ndryshimi ka ardhur me kërkesë të Albpetrol SHA, për arsye të mos dhënies në përdorim të puseve sipas parashikimit nga vetë Albpetrol SHA. Të drejtat e shfrytëzimit të hidrokarbureve për zonën

Ballsh-Hekal janë blerë në ankand nga shoqëria me datë 26.09.2017. Me datë 02.05.2018, është nënshkruar nga AKBN instrumenti i transferimit (më parë është nënshkruar nga Albpetrol dhe vetë shoqëria). Në inventarin e burimit Ballsh-Hekal ndodhen 226 puse nga të cilat 130 konsiderohen aktivë. Sipas këtij plani është parashikuar që për vitin 2020 të investohet me vlerë 5.5 milionë USD, për vitin 2021 me vlerë 12.6 milionë USD dhe për gjithë periudhën 2020-2037, 110 milionë USD. Për vitin 2020, është parashikuar futja në aktivitet e 9 puseve të fondit të ndaluar. Për vitin 2021 është parashikuar shpimi i dy puseve të rinj. Për vitin 2020 janë parashikuar shpenzime operative (OPEX) me vlerë 4.2 milionë USD, ndërsa për vitin 2021, me vlerë 5.3 milionë USD. Për vitin 2020 janë parashikuar të ardhura me vlerë 3.1 milionë USD dhe për vitin 2021, 6.9 milionë USD. Koeficienti R parashikohet të kalojë 1, në vitin 2025.

Bazuar në planet vjetore, janë parashikuar dhe realizuar të ardhura e shpenzime si më poshtë:

Tabela nr. 32

USD

| Viti | Plani i zhvillimit 2019 | | Planet vjetore | | | |
|-----------------|-------------------------|------------|----------------|-----------|---------------------|-----------|
| | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2020 | | Viti 2021 (9 mujor) | |
| | Plan | plan | Plan | Fakt | Plan | fakt |
| Shpenzime CAPEX | 5,427,300 | 12,680,300 | 4,836,200 | 1,256,475 | 2,308,750 | 1,169,100 |
| Shpenzime OPEX | 4,226,250 | 5,330,500 | 2,405,800 | 1,788,679 | 1,420,500 | 1,099,731 |

Burimi: Të dhëna nga AKBN

Sa më sipër konstatohet se programet vjetore janë miratuar në ndryshim me planin e zhvillimit sa i takon shpenzimeve dhe të ardhurave. Pavarësisht kësaj mospërputhje, treguesit e planeve përkatëse vjetore nuk janë realizuar. Pretendimi kryesor është i rënies së çmimit të naftës në bursa. Për vitin 2020, ishte parashikuar një fitim neto me vlerë 208,618 USD, ndërkohë që rezultoi me humbje me vlerë 457,567 USD, ndërsa për vitin 2021, ishte parashikuar një fitim neto me vlerë 1,314,250 USD dhe në fakt është realizuar fitim 1,452,140 USD.

Faktori R, në fund të tremujorit të tretë 2021 është 0.62. Bazuar në planin e zhvillimit, ky faktor në fund të vitit 2020 duhet të ishte 0.628 dhe në fund të vitit 2021, 0.645.

Rezultoni se nga ana e kontraktorit nuk është realizuar plani i zhvillimit, sipas përcaktimeve dhe miratimeve.

Në tabelat e mëposhtme duken qartë performanca e dobët e treguesve për implementimin e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Ballsh-Hekal:

Tabela nr. 33

| Viti | Puse | Prodh Naftë (ton) | | Detyrime naftë (ton) | | Renta Minerare mije US\$ |
|------|---------|-------------------|-------|----------------------|-----|--------------------------|
| | Në punë | Program | Fakt | PPE | ASP | |
| 2007 | 5 | 500 | 576 | 258 | 6 | 0 |
| 2008 | 15 | 8,000 | 4931 | 2,200 | 55 | 33 |
| 2009 | 15 | 9,000 | 5,724 | 2,380 | 67 | 78 |
| 2010 | 15 | 16,500 | 5,425 | 2,154 | 66 | 87 |
| 2011 | 15 | 31,000 | 5,906 | 1,949 | 79 | 2 |
| 2012 | 15 | 22,000 | 7,642 | 1,764 | 117 | 31 |
| 2013 | 15 | 27,500 | 5,882 | 1,595 | 86 | 91 |
| 2014 | 13 | 20,000 | 6,185 | 1,444 | 95 | 286 |
| 2015 | 14 | 15,100 | 5,793 | 1,307 | 90 | |
| 2016 | 14 | 9,100 | 3,568 | 1,181 | 50 | |
| 2017 | 14 | 16,500 | 3,178 | 1,70 | 42 | |

| | | | | | | |
|------|-----|--------|--------|--------|-----|-----|
| 2018 | 62 | 16,600 | 6,688 | 4,803 | 39 | 185 |
| 2019 | 95 | 25,000 | 24,439 | 11,810 | 253 | 605 |
| 2020 | 117 | 32624 | 26191 | 10026 | 323 | 439 |
| 2021 | 107 | 29678 | 27734 | 10154 | 352 | 111 |

| Viti | Të ardhurat mijë US\$ | | Shpenzime (mijë US\$) | | | |
|------|-----------------------|-------|-----------------------|---------|-------|-------|
| | Plan | Fakt | Capex | | Opex | |
| | | | Plan | Fakt | Plan | Fakt |
| 2007 | 25 | 60 | 200 | 62 | 175 | 110 |
| 2008 | 750 | 706 | 1,200 | 1,225 | 1,260 | 788 |
| 2009 | 580 | 587 | 1,870 | 252 | 720 | 660 |
| 2010 | 1,300 | 836 | 2,530 | 850 | 2,200 | 818 |
| 2011 | 4,700 | 16 | 5,450 | 3,730 | 4,200 | 1,600 |
| 2012 | 5,450 | 308 | 7,220 | 3,740 | 2,800 | 823 |
| 2013 | 7,830 | 908 | 7,050 | 2,420 | 3,400 | 1,530 |
| 2014 | 5,180 | 2,854 | 7,130 | 856 | 4,150 | 1,100 |
| 2015 | 2,600 | | 2,480 | 27 | 1,620 | 824 |
| 2016 | 2,100 | | 1,030 | | 1,100 | 230 |
| 2017 | 3,170 | | 3,000 | | 3,200 | 420 |
| 2018 | 2,205 | 1,854 | 1,070 | 1,620 | 1,393 | 640 |
| 2019 | 6,424 | 6,047 | 10,100 | 2,859.3 | 1,941 | 1,081 |
| 2020 | 7423 | 4392 | 4836 | 1257 | 2882 | 2227 |
| 2021 | 5542 | 6061 | 3627 | 1874 | 2312 | 2743 |

Kriteri: Ligji nr. 7811, datë 12.04.1994 òmbi sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureveò dhe Licencë Marrëveshja dhe Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin Ballsh-Hekal, miratuar me VKM Nr.509, date 08.08.2007

Ndikimi: Shmangie dhe me qëllim mos pagim te detyrimeve fiskale

Shkaku: Nuk ka rritje të sasisë së nxjerrjes së naftës bruto nga vendburimi me rënie të vazhdueshme, gati 12% në vit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim 1: AKBN, MIE dhe Albpetrol të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e humbjes në Arbitrazhin Ndërkombëtar.

Rekomandim 2: AKBN, MIE dhe Albpetrol të mos tolerojnë praktikatat e miratimit në heshtje dhe formal të Planeve Vjetor dhe buxheteve të paraqitura. Të miratojnë sa më shpejte Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2020. Të ndiqen me rigozitet kërkesat e përcaktuara në MH dhe LM për shqyrtimin dhe dakordësimin e Planeve Vjetore dhe buxheteve të paraqitura nga kompania òA O&Gò.

8. Titulli i gjetjes: Shpenzime te përfshira padrejtësisht në kosto hidrokarbure të rikuperueshme të KompanisëA O&G.

Situata: Auditimi për mbulimin e kostove hidrokarbure të Shoqërisë òA O&Gòshtë realizuar për periudhën 02.05.2018 deri me datë 31.12.2021. Shoqëria nuk ka dorëzuar për Albpetrol pjesën takuese në sasinë, me pretendimin së ka dhënë paradhënie sasinë 21128.3 ton, por që nuk është provuar me dokumentacion. Shoqëria ka ngarkuar si kosto hidrokarbure vlerën 700,692

USD, që në fakt përcaktojnë shpenzime të periudhave të mëparshme, audituar më parë nga AKBN dhe i përkasin detyrimeve në marrëdhëniet kontraktor nënkontraktor dhe për këtë arsye nuk është konsideruar kosto hidrokarbure e rikuperueshme vlera 68,064 USD.

Sa më sipër nuk njihet si kosto hidrokarbure vlera 768,756 USD.

Është kërkuar pasqyrimi në kostot hidrokarbure të rikuperueshme të vlerës së mësipërme, por nuk është njoftuar për thyerje marrëveshje, pasi kemi të bëjmë me situata të përsëritura.

Kriteri: Licencë marrëveshja, Marrëveshja Hidrokarbure.

Ndikimi: Shmangie dhe me qëllim mos pagim te detyrimeve fiskale.

Shkaku: Nuk ka rritje të sasisë së nxjerrjes së naftës bruto nga vendburimi me rënie të vazhdueshme, gati 12% në vit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: AKBN, t^a kërkojë kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira padrejtësisht në kosto hidrokarbure të rikuperueshme, duke bërë edhe njoftimin përkatës për shkelje të marrëveshjes licence dhe marrëveshjes hidrokarbure.

9. Titulli i Gjetjes: Zbatimi i Marrëveshjes për Vendburimin e Delvinës lidhur midis kompanisë Albpetrol dhe S O G (SOG) miratuar me VKM Nr. 509, date 08.08.2007. Aktualisht kjo marrëveshje është në vitin e 10 te implementimit të saj.

Situata: Që prej muajit gusht 2016, kjo marrëveshje administrohet nga kompania DGC , e cila deri tani nuk ka treguar asnjë vizion për zhvillimin e këtij vendburimi. Nuk ka asnjë plan e program vjetor të miratuar. Gjatë viteve 2016 dhe 2017 investimet janë shumë të ulëta.

Për t^a evidentuar është fakti që nuk shohim përpjekje të Kompanisë për të gjetur treg për shitjen e gazit, duke e kthyer vendburimin e Delvinës në një vendburim jo operacional, me mungesë prodhim gazi e kondensati. Nga ana e shoqërisë nuk po merren masa për rivendosjen në punë minimalisht të puseve nga të cilët është prodhuar gaz ose kondensat respektivisht deri në vitin 2011 dhe 2014.

Sipas specialistëve të AKBN, pusi i shpimit Del-34H, me detyre kryesore prodhimin e gazit (plotësim rrjeti) u pezullua që prej muajit Gusht 2015 për shkak së kapacitetet teknike te sondës nuk përballuan vazhdimin e shpimit. Nga ana e Kompanisë nuk është bërë e mundur të rifillojnë operacionet për vazhdimin e shpimit te tij. Pusi ka arritur në thellësinë 1991.3 m dhe sonda e shpimit është larguar.

Kompania paraqitet me mungesa të theksuara të likuiditeteve duke marrë në konsideratë mungesën e angazhimeve të saj në shlyerjen e detyrimeve që kjo Kompani ka ndaj Albpetrolit dhe AKBN.

Deri në fund të muajit Gusht 2019, kompania i detyrohet Albpetrol sha me rreth 2000 ton kondensat dhe rreth 19 milion Nm³ga.

Kompania ka gjithashtu edhe detyrim ndaj AKBN me një principal prej 4,971,000 USD te lindur qe prej vitit 2013, si detyrim i pa përmbushur nga Kompania për investimet kapitale gjatë fazës së dytë të kërkimit në këtë Vendburim.

Megjithëse me kërkesën e kompanisë u firmos një Marrëveshje për skedulimin e këtij detyrimi deri në fund te vitit 2016, kompania kishte paguar vetëm një vlere prej rreth 283 mije USD, e cila përfaqësonte kamate vonesat për mos pagesën në kohe te detyrimit gjate periudhës 2013-2016.

Në gusht te 2016, u nënshkrua një marrëveshje për pagesën me këste prej 1.2 milion USD për shlyerjen totale te këtij detyrimi deri në gusht te vitit 2020. Me gjithë këtë kjo pagesë përsëri nuk u mundësua, me argumentin e kompanisë së nuk kishte mundësi financiare për të bërë këto pagesa. Gjate kësaj kohe u shlyen vetëm 836 mije USD detyrime.

Në gusht 2019 midis AKBN dhe kompanisë DGC u dakortësua vijimi i pagesave mujore prej 100 mijë USD. Qe prej muajit shtator 2019 këto pagesa kane vazhduar rregullisht. Totali i detyrimit te shlyer deri tani është 2,220,000 USD

Gjatë vitit 2018 kompania kreu një investim prej rreth 1.4 milion USD për likuidimin e një avarie në pusin Del-12. Punimet dhe investimi te cilat ishin mjaft delikate, konsistonin në nxjertjen e disa instrumenteve që kishin rënë në pus në periudha të ndryshme të shfrytëzimit të pusit.

Aktualisht punimet janë pezulluar pasi kompania është duke tenderuar për një sonde shpimi me kapacitete te mjaftueshme për te vazhduar punimet në të dy puset, Del-34H dhe Del-12.

Për gjithë këtë periudhë, nga vendburimi nuk është prodhuar gaz apo kondensat.

Për këtë marrëveshje hidrokarbure ende nuk është miratuar programi dhe buxheti për vitin 2020 nga Albpetroli.

Plani i zhvillimit për zonën e Delvinës është miratuar në vitin 2010. Sipas këtij plani, janë parashikuar si më poshtë:

Tabela nr. 34

| Viti | Plani i zhvillimit 2010 | | Planet vjetore | | | |
|-----------------|-------------------------|-----------|----------------|---------|---------------------|------|
| | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2020 | | Viti 2021 (6 mujor) | |
| | Plan | plan | Plan | Fakt | Plan | fakt |
| Shpenzime CAPEX | | | 10,790,000 | 208,000 | 10,022 | 985 |
| Shpenzime OPEX | 3,800,000 | 3,800,000 | 976,760 | 203570 | 523 | 178 |

Burimi: Të dhëna nga AKBN

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, rezulton së nuk është respektuar plani i zhvillimit.

Kriteri: Ligji nr. 7811, datë 12.04.1994 òMbi sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureveò dhe Marrëveshja për Vendburimin e Delvinës miratuar me VKM Nr. 509, date 08.08.2007

Ndikimi: Shmangia nga detyrimet dhe mos pagim të detyrimeve fiskale

Shkaku: Mos prodhim nga vendburimi i gazit apo kondensatit

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë òDGCò, për intensifikimin e operacioneve që mundësojnë rritjen e prodhimit të gazit, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhura-shpenzime në vlera më të larta ($R > 1$).

10. Titulli i gjetjes: Shpenzime të përfshira padrejtësisht në kostot hidrokarbure të pa rikuperueshme nga Kompania DG, për vitin 2018.

Situata: Auditimi është realizuar nga z. V.P., z. M.S, z. F.O. dheznj. M.H..

Nga ana e AKBN është audituar aktiviteti hidrokarbur i Shoqërisë òDGò, për periudhën 01.07.2017 deri 31.12.2018, realizuar në vitin 2020.

Detyrimet për gaz dhe kondensat Kontraktorit për Albpetrol, sipas viteve paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 35

| Emërtimi | Detyrimi deri 2016 | Detyrimi 2017 | Detyrimi 2018 | Detyrimi total |
|---------------------|--------------------|---------------|---------------|----------------|
| Gaz Nm ³ | 14387 | 1739 | 1654 | 17780 |
| Kondensat ton | 2199 | 336 | 319 | 2854 |

Burimi: Të dhëna nga AKBN

Nuk është konsideruar kosto hidrokarbure e rikuperueshme vlera 116,641 USD.

Kriteri: Marrëveshja hidrokarbure, licencë marrëveshja.

Ndikimi: Shmangia nga detyrimet dhe mos pagim të detyrimeve fiskale

Shkak: Mos respektimi i marrëveshjeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AKBN, t^a kërkojë kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira padrejtësisht në kosto hidrokarbure të rikuperueshme, duke bërë edhe njoftimin përkatës për shkelje të marrëveshjes licence dhe marrëveshjes hidrokarbure.

11. Titulli i Gjetjes: Zbatimi i Marrëveshjeve hidrokarbure me kompaninë Fin-Pek Petroleum për vendburimet Finiq-Krane dhe Pekisht-Rrase-Murris. Marrëveshjet hidrokarbure për vendburimet, Finiq-Krane dhe Pekisht-Rrase-Murris, janë lidhur me kompaninë PP dhe janë miratuar me VKM Nr. 699, date 16.08.2013. Aktualisht këto marrëveshje kanë kaluar nga kompania oPPö te kompania oFPPö e cila mori përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet për këto marrëveshje nëpërmjet Instrumentit të Transferimit i datës 10.05.2016. Këto marrëveshje janë në vitin e 5 të të implementimit të Planeve të Zhvillimit të miratuara.

Situata: Implementimi i këtyre marrëveshjeve po bëhet në mënyrë shumë të ngadaltë. Pavarësisht së të dyja këto vendburime janë në fazën e fundit të shfrytëzimit të tyre, me energji dhe rezerve naftë të ezauruara, edhe për këtë marrëveshje po del në pah së kompania nuk ka kapacitetet e duhura teknike e financiare për të zhvilluar me tej vendburimet Finiq dhe Pekisht, duke munguar me paraqitjen e një vizioni të qartë. Programi i miratuar për vitin 2017 akoma nuk është u implementuar në mënyrë integrale.

Përveç kryerjes së operacioneve klasike për nxjerrjen e naftës, mungojnë investimet dhe kryerja e operacioneve suplementare për intensifikimin e nxjerrjes së naftës dhe rritjen e prodhimit.

Me këto ritme të kryerjes së operacioneve hidrokarbure në këto marrëveshje, komprometohet implementimi dhe zbatimi i planeve të zhvillimit të miratuar.

Kompania F-P ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj Albpetrolit për PEP dhe ASP duke tejkaluar këtë detyrim me rreth 110 ton, ndërkohe që ka detyrime për shërbime elektrike, të cilat deri në fund të muajit shtator 2019, kohë për të cilën kanë rakorduar me njëra tjetrën, janë në një vlerë rreth 155,000 lekë.

Nga vendburimi Finiq-Krane nuk është bere asnjë shitje pasi depozitat në të cilat është grumbulluar nafta e prodhuar është nen sekuestro konservative nga Dega e Doganës Sarande, për probleme të konstatuara nga ana e tyre gjate inspektimeve të kryera në vendburim nga kjo dege.

Për këtë marrëveshje ende nuk është bere miratimi i programit dhe buxhetit për vitin 2020.

Në tabelën më poshtë po paraqesim disa të dhëna që kanë të bëjnë me prodhimin dhe tregtimin e naftës si dhe investimet kapitale të realizuara deri në fund të vitit 2021.

Tregues për MH për vendburimin Pekisht-Murris

Tabela nr. 36

| Viti | Prodhim naftë (ton) | | Shitje naftë (ton) | | Dorëzuar Albpetrolit (ton) | | Investime Kapitale mije USD | |
|------|---------------------|----------------|--------------------|----------------|----------------------------|----------------|-----------------------------|----------------|
| | Finiq-Krane | Pekisht-Murris | Finiq-Krane | Pekisht-Murris | Finiq-Krane | Pekisht-Murris | Finiq-Krane | Pekisht-Murris |
| 2014 | | 98 | | | | 34 | | 26 |
| 2015 | 102 | 129 | | 14 | | 65.6 | 180 | 66 |
| 2016 | 8 | 274 | | 18 | | 180.8 | | 193 |
| 2017 | 103 | 355 | | 284 | | 81.9 | 4 | 76 |
| 2018 | 54 | 311 | | 216 | | 42.9 | 4 | 43 |
| 2019 | 132 | 365 | | 212 | | 314.5 | 63 | 315 |
| 2020 | 37 | 167 | | 54 | | 0.7 | 15 | 6 |

| | | | | | | | | |
|------|-----|-----|-----|-----|--|-----|---|---|
| 2021 | 311 | 944 | 176 | 316 | | 6.2 | 0 | 0 |
|------|-----|-----|-----|-----|--|-----|---|---|

Burimi: AKBN

Për vitin 2020 shpenzimet CAPEX janë parashikuar 229,000 USD dhe janë realizuar 14,752 USD si dhe shpenzimet OPEX janë parashikuar 237,334 USD dhe janë realizuar me vlerë 26,227 USD.

Për vitin 2020 (9 mujori), janë parashikuar shpenzime CAPEX me vlerë 159,000 USD dhe nuk janë realizuar, si dhe janë parashikuar shpenzime OPEX me vlerë 164,000 USD dhe janë realizuar 33,938 USD. Koeficienti R vazhdon të jetë më i vogël së 1.

Për zonën Pekisht-Murriz, për vitin 2020, janë parashikuar shpenzime CAPEX me vlerë 35,000 USD dhe janë realizuar me vlerë 6,139 USD. Shpenzimet OPEX janë parashikuar me vlerë 85,405 USD dhe janë realizuar me vlerë 30,809 USD.

Për vitin 2021 (9 mujori), janë parashikuar shpenzime CAPEX me vlerë 16,500 të cilat nuk janë realizuar. Shpenzimet OPEX janë parashikuar me vlerë 27,747 USD dhe janë realizuar me vlerë 43,741 USD. Koeficienti R vazhdon të jetë më i vogël së 1.

Kriteri: Ligji nr. 7811, datë 12.04.1994 ÷ Mbi sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve, dhe Marrëveshjet hidrokarbure për vendburimet Finiq-Krane dhe Pekisht-Rrase-Murriz, miratuar me VKM nr. 699, date 16.08.2013.

Ndikimi: Shmangie dhe mos pagim të detyrimeve fiskale

Shkaku: Mos prodhim nafte nga vendburimet

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim 1: AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë ÷FPPö, për intensifikimin e operacioneve që mundësojnë rritjen e prodhimit të naftës, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhura-shpenzime në vlera më të larta ($R > 1$).

12. Titulli i gjetjes: Shpenzime të përfshira padrejtësisht në kosto hidrokarbure të rikuperueshme.

Situata: Kontraktori nuk ka reflektuar në llogaritë kosto hidrokarbure, shpenzimet e panjohura në periudhat e mëparshme, konkretisht 534 USD dhe 17,176 USD. Është rekomanduar përcaktimi si shpenzime të papranueshme.

Për këtë periudhë Kontraktori ka realizuar të ardhura me vlerë 65,034 USD, por ka raportuar vlerën 54,753 USD. Për këtë fakt nuk është rekomanduar marrja e masave për rregullimet përkatëse.

Konstatohet mungesë e investimeve, krahasuar me programet e miratuara. Për zonën Pekisht-Murriz janë parashikuar investime me vlerë 113,100 USD dhe janë realizuar 42,107 USD, ndërsa për zonën Finiq-Krane janë parashikuar investime me vlerë 236,440 USD dhe janë realizuar 119,829 USD. Është rekomanduar sistemimi i kostove të rikuperueshme dhe të ardhurave. Në shpenzimet e raportuara është konstatuar diferencë me vlerë 8,545 USD për të dy zonat.

Nga ana e grupit të auditimit të përbërë nga z. M.S, z. KH, znj. O.M. dhe znj. M.H., është rekomanduar që:

-Shoqëria ÷FPPö të lidhë kontratën e shitjes së naftës me Shoqërinë ÷A.G.Oö SHA.

- Shoqëria të jetë e kujdesshme në pasqyrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, hartimin e saktë të raporteve dhe përfshirjen e progresivitetit të tyre.

- **I rekomandohet Shoqërisë të shtojë përpjekjet në drejtim të rritjes së investimeve kapitale, në përputhje me programet vjetore.**

- Kërkohet reflektimi i kostove hidrokarbure të pa njohura, si zë më vete ÷Kosto të pa njohuraö.

Konkluzion:

Nga ana e Kontraktorit nuk zbatohet programi vjetor dhe nga ana e grupit të auditimit i rekomandohet të shtojë përpjekjet për realizimin e programit, ndërkohë që ky program është i detyrueshëm për zbatim. Mos realizimi i planit në mënyrë të përsëritur, duhet të konsiderohej si shkelje materiale e marrëveshjes, veprim në kundërshtim me Licencë ó Marrëveshjen:

Kriteri: Marrëveshja hidrokarbure, licencë marrëveshja.

Ndikimi: Shmangia nga detyrimet dhe mos pagim të detyrimeve fiskale

Shkaku: Mos respektimi i marrëveshjeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AKBN, t^a kërkojë kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira padrejtësisht në kosto hidrokarbure të rikuperueshme, duke bërë edhe njoftimin përkatës për shkelje të marrëveshjes licence dhe marrëveshjes hidrokarbure.

13. Titulli i Gjetjes: Zbatimi i Licencë Marrëveshja dhe Marrëveshja Hidrokarbure për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Visokës lidhur me Albpetrol sha dhe kompanisë T.G. (pasardhëse e kompanisë I.V.), miratuar me VKM Nr.90, datë 27.01.2009 me date efektive 09.02.2009.

Situata: Marrëveshja parashikonte si faze të pare të saj, Fazën e Vlerësimit, me një kohëzgjatje prej 18 muajsh e cila filloi më 09.02.2009 dhe mbaroi më 09.08.2010. Gjate kësaj periudhe kontraktori angazhohej të kryente investime kapitale (CAPEX) në masën 600,000 mije USD për realizimin e programin minimal të punës.

Që prej fillimit të zbatimit të kësaj marrëveshje, kompania I.V. u ndesh me një sërë problemesh që kishin të bënin me organizimin e kompanisë, me emërimin e përfaqësuesit të saj ligjor, regjistrimin e kompanisë, dorëzimin e planit të punës dhe buxhetin si dhe fillimin e operacioneve hidrokarbureve.

Pas njoftimit nga ana AKBN, së i licencuari kishte shkelur licence marrëveshjen dhe paralajmërimin së në rast së nuk merreshin masat e duhura për riparimin e tyre, do të përfundohej licenca, këto probleme u riparuan dhe u zgjidhen brenda afateve të përcaktuara në licence marrëveshje.

Në muajin Dhjetor 2009 u bë marrja në dorëzim e 11 puseve, gjë e cila i mundësoi kompanisë fillimin e operacioneve hidrokarbure për fazën e vlerësimit, e cila zgjati gjithsej 24 muaj, duke marrë në konsideratë edhe një zgjatje të saj prej 6 muaj me miratim të AKBN.

Në muajin prill 2011, kompania paraqiti për miratim planin e zhvillimit afatgjatë të vendburimit, i cili pasi u diskutua në të gjitha instancat, u miratua në muajin tetor 2011 edhe nga AKBN, duke krijuar kushte për fillimin e implementimit të tij.

Me kërkesë të kompanisë I.V. dhe miratimin e kompanisë Albpetrol, në qershor 2011, AKBN miratoi transferimin e interesave të marrëveshjes hidrokarbure nga kompania I.V. tek kompania T.G. AG.

Me gjithë kërkesën e vazhdueshme të kompanisë T.G. për marrjen në dorëzim të puseve dhe asetëve që përfshihen brenda zonës së kontratës, me ndërhyrjen e AKBN dhe të METE (sot MIE), vetëm në fillim të muajit shkurt 2012 u bë e mundur dorëzimi i vendburimit nga Albpetroli tek T.G..

Nga ky moment kompania po vazhdon kryerjen e operacioneve hidrokarbure në zbatim të planit të zhvillimit, veçanërisht implementimin e metodës termike të propozuar në planin e miratuar.

Sipas specialistëve të AKBN, meqenëse implementimi i kësaj metode po paraqiste vështirësi zbatimi të karakterit fizik e teknik, në vitin 2014 kompania paraqiti një amendim të planit të zhvillimit duke përfshirë edhe rezultatet e deritanishme të këtij zhvillimi. Ky plan mbështetej

kryesisht në shpimin e puseve te rinj brenda zonës së kontratës, në zona me sipërfaqe të pambuluar me puse si dhe kompletimin e puseve me pompat me burme. Ky plan zhvillimi u miratua në shkurt 2015 në mbledhjen e komitetit Këshillimor të kompanisë.

Në vijim e deri tani, kompania vazhdon kryerjen e operacioneve në zbatim të këtij plani zhvillimi, duke qenë aktualisht në vitin e 9^{-të} të implementimit të tij.

Gjate kësaj kohe në vendburim janë instaluar gjithsej 52 puse me pompa me burme të cilat në aspektin teknik sipas mendimit të specialistëve te AKBN janë me të konsoliduara dhe me jete gjata për tu përdorur për prodhimin e naftës nga vendburime me nafte me viskozitet të lartë, sikurse është edhe kjo e vendburimit të Visokës.

Gjate periudhës 2014-2016 janë shpuar gjithsej 12 puse te rinj duke mbuluar një sipërfaqe të konsiderueshme te zonës së kontratës. Prodhimi i naftës i realizuar nga këta puse është shume larg parashikimeve.

Pavarësisht operacioneve të kryera, niveli i prodhimit ditore te naftës ka qene dhe është në nivele të ulëta dhe nën atë të parashikuar në planin e zhvillimit. Aktiviteti i kompanisë për kryerjen e investimeve deri sot ka qenë shume i ngadalte gjë që pasqyrohet edhe në nivelin e ulët të prodhimit. Rënia e investimeve vjen për shkak te efektivitetit të ulët që patën pusët e rinj që realizoi kompania gjatë viteve 2014-2016

Nga të dhënat e marra në AKBN konstatohet së, gjatë viteve 2018-2019, mbështetja e rënies së prodhimit është bere kryesisht me metodat intensifikuese që po aplikohet në vendburim, siç mund te përmendim injektimin e nitrogenit (azotit). Megjithëse kjo teknologji është në fazat e para të aplikimit te saj, rezultatet e deritanishme janë premtuese. Efektiviteti i kësaj metode duket i larte.

Gjate tremujorit te katërt 2018, vitit 2019 dhe tremujorit te pare 2020 u prodhuan respektivisht 4,529, 17,778 dhe 3,990 ton nafta. Për vitin 2019 shkalla e realizimit te prodhimit është rreth 75%, ndërkohe qa për tremujorin e para 2019, kjo vlere është rreth 70%. Ky mosrealizim sipas specialistëve te AKBN vjen kryesisht nga rritja e shkalles së inondimit të puseve nga ujërat fundore, gjë që ka sjellë uljen e përmbajtjes së naftës në emulsionin e prodhuar, njëkohësisht edhe uljen naftë nxjerrjes nga rezervuari.

Mosrealizimet e vitit 2019 lidhen në mënyre integrale me mos kryerjen e shpimit te 5 puseve te rinj te parashikuar për tu shpuar gjate këtij viti, pasi nga rezultatet e deritanishme te këtyre puseve por edhe zona ku ata mendohej te shpoheshin, gjykohet së janë me rentabilitet të ulët, duke zbehur në këtë mënyre edhe realizimin e programit të shpimit të puseve.

Plani i ri zhvillimit do te paraqesë një vizion të ri kompanisë si dhe do të marrë në konsideratë te gjithë faktorët të cilët kanë influencuar në rezultatet e deritanishme.

Realizimi i treguesve nga T.në marrëveshjen për Visokë:

Tabela nr. 37

| Viti | Puse | Prodh Naftë (ton) | | Detyrime naftë (ton) | | Renta Minerare mije US\$ |
|------|---------|-------------------|--------|----------------------|-------|--------------------------|
| | Në punë | Program | Fakt | PPE | ASP | |
| 2012 | 73 | 18,821 | 12,390 | 6,008.5 | 67.6 | 472 |
| 2013 | 78 | 25,755 | 18,315 | 6,026.6 | 117.3 | 314 |
| 2014 | 97 | 34,519 | 24,529 | 5,453.1 | 181 | 705 |
| 2015 | 96 | 57,801 | 27,190 | 4,934.2 | 242.3 | 585 |
| 2016 | 93 | 37,550 | 25,530 | 4,464.7 | 209.7 | 483 |
| 2017 | 89 | 36,988 | 20,643 | 4,039.7 | 165.4 | 299 |

| | | | | | | |
|------|----|--------|--------|---------|-------|-----|
| 2018 | 89 | 32,010 | 18,908 | 3,655.4 | 152.4 | 293 |
| 2019 | 91 | 23,658 | 17,778 | 3,307.5 | 144.1 | 279 |
| 2020 | 81 | 20,866 | 16,420 | 2993 | 116 | 182 |
| 2021 | 78 | 19,530 | 16,624 | 2708 | 118 | 367 |

| Viti | Të ardhurat mijë US\$ | | Shpenzime (mijë US\$) | | | |
|------|-----------------------|-------|-----------------------|--------|--------------|--------|
| | Plan | Fakt | Capex | | Opex dhe G&A | |
| | | | Plan | Fakt | Plan | Fakt |
| 2012 | 2,462 | 4,445 | 3,688 | 3,373 | 5,507 | 8,987 |
| 2013 | 7,186 | 2,825 | 5,821 | 3,202 | 7,607 | 13,873 |
| 2014 | 14,305 | 6,345 | 13,877 | 14,500 | 14,946 | 6,963 |
| 2015 | 19,162 | 5,358 | 53,100 | 9,869 | 9,051 | 5,313 |
| 2016 | 4,938 | 4,600 | 1,750 | 1,245 | 4,273 | 3,890 |
| 2017 | 7,365 | 3,106 | 860 | 274 | 4,774 | 4,064 |
| 2018 | 6,068 | 3,587 | 6,210 | 254 | 4,560 | 4,808 |
| 2019 | 6,117 | 2,796 | 1,650 | 847 | 4,482 | 4,881 |
| 2020 | 6,820 | 3,395 | 2,374 | 479 | 4,658 | 4242 |
| 2021 | 5,795 | 3,669 | 3,293 | 866 | 4,354 | 4,361 |

Burimi: AKBN

Plani i zhvillimit është miratuar në vitin 2010 dhe është rishikuar në vitin 2019. Sipas planit të vitit 2019, për vitin 2020 është parashikuar një prodhim 15390 ton dhe për vitin 2021, 18981 ton. Për vitin 2020, faktori R është parashikuar të rritet nga 0.43 në 0.47. Për vitin 2021, është parashikuar që faktori R të rritet nga 0.43 në 0.45. Nga verifikimi i raporteve 3 mujore, rezulton së faktori R në fund të vitit 2020 është 0.55. Për vitin 2020 janë prodhuar 17650 ton naftë bruto më shumë nga parashikimi në planin e zhvillimit (për vitin 2021, nuk ka të dhëna).

Pavarësisht rezultateve të deritanishme, ajo që vërehet tek kjo marrëveshje është ngadalësia e kryerjes së operacioneve, niveli dhe rentabiliteti i ulet i investimeve kapitale, të cilat reflektohen edhe në vlerën e ulet të Faktorit R, i cili vlerëson efektivitetin e rikthimit të investimeve, i cili aktualisht është në vlerën 0.35.

Kriteri: Ligji nr. 7811, datë 12.04.1994 ÷ Mbi sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve, dhe Marrëveshjet Hidrokarbure për vendburimin e Visokës, miratuar me VKM Nr.90, datë 27.01.2009 me date efektive 09.02.2009.

Ndikimi: Shmangie dhe mos pagim të detyrimeve fiskale

Shkaku: Mungesë investimesh me pasoje mos prodhim naftë nga vendburimi

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim 1. AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë ÷ T.G.ö, që të intensifikojë operacionet që mundësojnë rritjen e prodhimit të naftës, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhura-shpenzime në vlera më të larta së, R=1.

14. Titulli i Gjetjes: Zbatimi i Licencë Marrëveshja dhe Marrëveshja Hidrokarbure për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Kuçovës lidhur midis Albpetrol sha dhe kompanisë ÷ S.I.ö, miratuar me VKM Nr.686, datë 19/10/2007

Situata: Data efektive për këtë Marrëveshje është data 02.11.2007 dhe përfshin kryerjen e operacioneve të vlerësimit, zhvillimit dhe prodhimit të hidrokarbureve në vendburimin Kuçovës.

Marrëveshja parashikonte si fazë të parë të saj, Fazën e Vlerësimit, me një kohëzgjatje prej 24 muajsh. Sipas përcaktimit të kësaj Marrëveshjeje, Faza e Vlerësimit fillon 02.11.2007 dhe mbaron më 01.11.2009. Angazhimi minimal i kontraktorit gjatë kësaj periudhe është që ai të realizojë investime kapitale në masën 1,500,000 USD, për kryerjen e operacioneve që përfshihen në programin e vlerësimit.

Kompania mori në dorëzim 12 puse për realizimin e programit minimal të punës të përfshirë në Marrëveshjen Hidrokarbure. Në datë 24.01.2008 u zhvillua ACM#1 ku u miratua X. për vitin 2008.

Në mars 2008 kompania òS.ò njoftoi së kompania BPAL Petroleum bleu 50% të aksioneve të saj. Ndërsa në shtator 2008, kompania BPAL njoftoi kompaninë Albpetrol, METE (sot MIE) dhe AKBN së ajo bleu edhe pjesën tjetër të aksioneve të òS.I.ò duke u bërë aksionare e vetme e kësaj kompanie. Ndërkohe që emri i operatorit qëndroi i pandryshuar. Ky ndryshim ishte një problem i thjeshtë, pasi personi juridik tek i cili kaloi pronësia e òS.ò plotëson gjithë kushtet dhe kërkesat nenit 16.1 të Marrëveshjes Hidrokarbure, për transferimin e interesave.

Sipas përcaktimit të Marrëveshjes Hidrokarbure faza e vlerësimit filloi në datën 02.11.2007 dhe mbaroi më 02.11.2009 (24 muaj). Gjatë fazës së vlerësimit ishin parashikuar të kryheshin operacione hidrokarbure që kanë të bëjnë me studimin, rivlerësimin dhe certifikimin e rezervave të naftës, përcaktimin e skemës teknologjike të shfrytëzimit të vendburimit, si dhe përcaktimin dhe testimin e metodave të ndryshme intensifikuese për rritjen e performancës së rezervuarit naftëmbajtës, etj.

Gjate periudhës së Vlerësimit kompania òS.ò nuk ka pasur aktivitet të prodhimit të naftës, por ka kryer një aktivitet që mund të përmbledhet në studimin dhe përcaktimin e metodës me efikasitet të shfrytëzimit të vendburimit.

Në datën 20.05.2009 u zhvillua ACM#2 në të cilën u miratua kalimi i interesave dhe të drejtimit të kompanisë òS.I.ò tek òBPALò. Ky transaksion përfundoi në 31.12.2008, datë e cila konsiderohet edhe si datë efektive. Pas kësaj date, òBPALò është ortaku i vetëm i kompanisë òS.I.ò

Ndryshimi i pronësisë së kompanisë òS.I.ò, sipas specialistëve të AKBN, solli edhe ndryshimin e vizionit të pronarit të ri për zhvillimin e këtij vendburimi. Pasi që e këtij ndryshimi është edhe konkluzioni që ka arritur kompania së teknologjia e nxjerrjes së naftës, e parashikuar në marrëveshjen e mëparshme, me metodën CHOP, me pompa me burmë (PCP) nuk rezulton efektive, pasi kemi të bëjmë me naftëjo viskoze dhe së metoda më e përshtatshme për nxjerrjen e naftës në këtë vendburim është ajo me pompë thellësie duke aplikuar njëkohësisht injektimin e ujit për ruajtjen e presionit të shtresës. Ky ndryshim domosdoshmërisht kërkoi edhe amendimin e Licencës dhe Marrëveshjes Hidrokarbure

Kompania òS.I.ò përgatiti amendamentet për ndryshimet e kërkuara dhe i paraqiti për miratim në mbledhjen e Komitetit Këshillimor të datës 20.05.2009. Megjithëse në këtë mbledhje këto amendamente u miratuan në parim, kompania Albpetrol kërkoi që në to të përfshiheshin edhe ndryshimet e propozuara në këtë mbledhje, dhe më vonë ai do të shprehej zyrtarisht për qëndrimin e tij me shkresën nr.769/1 Prot datë 17.03.2010, së ishte dakord me amendamentet e propozuara.

Me letrën nr. 001/10, datë 11.02.2010, kompania òS.I.ò dërgoi të plota pranë AKBN amendimet përkatëse të Licencës Hidrokarbure dhe Marrëveshjes Hidrokarbure për vendburimin e Kuçovës. Këto amendime konsistojnë në zgjatjen e periudhës së vlerësimit për një periudhë një vjeçare, ndryshimin e metodës së shfrytëzimit të vendburimit dhe ndryshimin e Programit të Vlerësimit për Periudhën e Vlerësimit.

Përpara përfundimit të Periudhës së Vlerësimit, Kompania òS.I.ò, Albpetrol, AKBN dhe METE (sot MIE) ranë dakord midis tyre për përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e draftit të Marrëveshjes plotësuese të Licence Marrëveshjes e cila me autorizim të Ministrit të METE u nënshkrua nga AKBN dhe òS.ò në datën 16.09.2010.

Me amendimin e Licencës Hidrokarbure, u krijuan kushte edhe për amendimin e Marrëveshjes Hidrokarbure. Kjo marrëveshje u miratua në KM me 02.11.2010. Në këtë amendim janë përfshirë edhe ndryshimet që rrjedhin nga Ligji òPër Taksat Kombëtareò si dhe ndryshimi i Programit Minimal të Punës që parashikohet në Marrëveshjen Hidrokarbure.

Në 10.12.2010 u zhvillua ACM#5 ku u miratua Plani i Zhvillimit afatgjatë të vendburimit të Kuçovës, i cili në fund të muajit mars 2011 u miratua edhe nga AKBN, me kushtin që brenda një kohe të arsyeshme e të nevojshme për marrjen e të dhënave të testimit të metodës së injektimit të ujit, ky plan të rishikohej në mënyrë që të ishte i mbështetur në të dhëna reale.

Sipas specialistëve të AKBN, kompania filloi marrjen e puseve në dorëzim (12 puset e pare në Kuçovë në datë 27.12.2010) dhe ka vijuar me implementimin e zbatimit të planit të miratuar. Injektimi i ujit i parashikuar në planin e zhvillimit të miratuar, filloi në maj 2011, pas kompletimit të dy puseve për injektim. Prodhimi i naftës filloi vetëm në disa puse, të cilët në pozicionin e tyre të rrjetit të injektimit quhen puse reagimi. Ky prodhim ishte i papërfillshëm.

Në përputhje me programin e punës dhe buxhetin e viteve 2010,2011,2012 dhe 2013 për implementimin e metodës së injektimit të ujit në puset e Grupit F-38, ishin parashikuar të merreshin në dorëzim prej kompanisë òS.ò, puset e grupit Ferma 4 të cilat ndodhen në pjesën veriore të zonës së Fermës si dhe rreth 55 puseve të Arrëzës.

Në mars 2014 kompania paraqiti për diskutim një amendim të ri të planit të miratuar në vitin 2011 dhe kërkoi miratimin e tij për një periudhë 5-vjeçare deri në vitin 2019.

Nga vlerësimi i bërë këtij plani zhvillimi u konkludua së ky plan kishte mjaft pasaktësi dhe mungesa të cilat nuk jepnin garanci për implementimin e tij.

Duke qenë në vitin e shtatë të implementimit të marrëveshjes hidrokarbure dhe rezultateve të dobëta konkrete të realizuara gjatë këtij implementimi dhe vendburimi nuk po vihej në eficiensë për të siguruar të ardhurat dhe fitimet e parashikuara, për të evituar një dështim të ri të planit të zhvillimit, AKBN kërkoi nga Albpetroli dorëzimin *menjëherë dhe pa kushte të puseve, siç palët kanë rënë dakord në Vendimet e marra në ACM. AKBN dhe riparimin e vërejtjeve të evidentuara për planin e amenduar të paraqitur nga kompania S. dhe Albpetrol.* Përmbushja e këtyre kërkesave çoi në miratimin e këtij plani në shtator 2014.

Aktualisht marrëveshja është në fillim të vitit të 6-të implementimit të Planit të Zhvillimit të miratuar në vitin 2014 për këtë vendburim.

Sipas specialistëve, duke qenë së, edhe metoda e injektimit të ujit nuk po jep rezultatet e pritshme, gjatë vitit 2019 kompania përgatiti dhe paraqiti për diskutim një amendim të planit të zhvillimit ekzistues duke parashikuar një metode tjetër në të cilën do të mbështetet zhvillimi i vendburimit në të ardhmen. Metoda që propozohet në këtë plan zhvillimi është ajo e izolimit të ujerave të shtresës dhe rritjes së përshkueshmërisë relative të naftës në shtresë, pra e lëvizshmërisë së naftës në shtresë. Këto metoda lidhen me injektimin e polimereve dhe bio-enzimave. Ky plan është ende duke u diskutuar nga palët në marrëveshje. Aspekti më negativ në këtë ecuri është së edhe tani që kanë kaluar mbi 5 vjet që kur është miratuar ky plan zhvillimi, ende kompania nuk ka një vizion me një projekt të qëndrueshëm mbi bazën e të cilit do të përqendrohen investimet për zhvillimin e mëtejshëm të vendburimit. Edhe projekti që propozohet në këtë planin e ri të zhvillimit, ai i injektimit të polimereve dhe i *bio enzimave*, nuk

jep garanci dhe siguri për të ardhmen, pasi ende janë në fazat eksperimentale dhe janë të panjohura efektivitetet e tyre.

Kjo ecuri është edhe në logjikën e investimeve kapitale të realizuara nga kompania krahasuar me atë të planifikuar. Ndërkohë që në planin e zhvillimit, për periudhën 2014-2019 ishin planifikuar të realizoheshin rreth 50 milion USD investime kapitale, nga informacionet e dërguara nga kompania, realizimi faktik deri në fund të vitit 2019 është rreth 40 milion USD, pra rreth 78%.

Edhe për këtë kompani programi dhe buxheti i parashikuar për vitin 2020, ende nuk është miratuar nga palët në marrëveshje, pasi kompania Albpetrol nuk ka qenë dakord me treguesit e propozuar.

Për periudhat 3M-IV 2018, viti 2019 dhe 3M-I-2020 nga vendburimi i Kuçovës janë prodhuar respektivisht 375 ton naftë, 1,169 ton dhe 243 ton naftë, të cilat përbëjnë respektivisht 58%, 11% dhe 30% të prodhimit të parashikuar në programet vjetore.

Presa i përket investimeve kapitale të realizuara gjatë këtyre periudhave ato janë 1,419,000 USD për 3M-VI-2018, 535,000 USD për vitin 2019 dhe 86,000 USD për 3M-I-2020. Vlerat e këtyre shpenzimeve janë shumë larg parashikimeve të planit të zhvillimit, gjë që reflektohet edhe në vlerën e Faktorit R i cili është në vlera të papërfillshme, 0.03.

Plani i zhvillimit për zonën e Kuçovës është miratuar në vitin 2011, rishikuar në vitin 2014 dhe i është bërë një shtesë në vitin 2019. Bazuar në këtë plan dhe në planet vjetore, shpenzimet CAPEX dhe OPEX, paraqitën si më poshtë:

Tabela nr. 38

| Viti | Plani i zhvillimit 2019 (přitshmëri e mesme) | | Planet vjetore | | | |
|-----------------|---|-----------|----------------|---------|---------------------|---------|
| | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2020 | | Viti 2021 (9 mujor) | |
| | Plan | plan | Plan | Fakt | Plan | fakt |
| Shpenzime CAPEX | 1,417,510 | 1,449,070 | 414,000 | 233,000 | 263,000 | 149,000 |
| Shpenzime OPEX | 2,687,000 | 3,571,000 | 173,000 | 280,000 | 130,000 | 34,000 |

Burimi: Të dhëna nga AKBN

Për vitin 2023, janë prodhuar 1104 m³ naftë, ndërsa parashikimi ishte parashikuar të prodhohej 5723 m³. Për vitin 2021, është prodhuar 9281 m³, ndërsa ishte parashikuar prodhimi 8551 m³. Në raporte nuk përshkruhet ecuria e koeficientit R.

Realizimi i treguesve nga "S.I." në MH për vendburimin Kuçovë:

Tabela nr. 39

| Viti | Puse | Prodh Naftë (ton) | | Detyrime naftë (ton) | | Renta Minerare mije US\$ |
|------|---------|-------------------|-------|----------------------|-----|--------------------------|
| | Në punë | Program | Fakt | PPE | ASP | |
| 2010 | | 1,320 | | 4.9 | | |
| 2011 | 2 | 160 | | 347 | | |
| 2012 | 2 | 1,510 | 288 | 314 | | |
| 2013 | 4 | 540 | 98 | 284 | | |
| 2014 | 2 | 2,862 | 188 | 483 | | |
| 2015 | 2 | 2,067 | 2,688 | 931 | 18 | |
| 2016 | 2 | 4,610 | 2,871 | 968 | 19 | |
| 2017 | 2 | 1,430 | 1,062 | 876 | 0.4 | 49 |
| 2018 | 2 | 1,520 | 1,635 | 793 | 8.4 | 33 |
| 2019 | 2 | 11,130 | 1,172 | 717 | 4.6 | 8 |

| | | | | | | |
|------|---|-------|-------|-----|-----|----|
| 2020 | 2 | 1,041 | 1,092 | 150 | 4.8 | 18 |
| 2021 | 2 | 1,422 | 1,125 | 587 | 5.7 | 20 |

| Viti | Të ardhurat mijë US\$ | | Shpenzime (mijë US\$) | | | |
|------|-----------------------|------|-----------------------|-------|-------|-------|
| | Plan | Fakt | Capex | | Opex | |
| | | | Plan | Fakt | Plan | Fakt |
| 2010 | | | 265 | 377 | 124 | 88 |
| 2011 | | | 2,213 | 1,151 | 379 | 100 |
| 2012 | 598 | | 5,747 | 1,537 | 600 | 337 |
| 2013 | 3 | | 4,136 | 2,279 | 622 | 309 |
| 2014 | 192 | | 4,136 | 3,931 | 509 | 653 |
| 2015 | 1 | | 623 | 1,932 | 950 | 1,257 |
| 2016 | 1.1 | 604 | 4,165 | 335 | 995 | 1,276 |
| 2017 | 320 | 305 | 1,773 | 1,430 | 639 | 798 |
| 2018 | 492 | | 2,448 | 1,584 | 879 | 1,215 |
| 2019 | 4 | 66 | 5,229 | 535 | 2,627 | 1,152 |
| 2020 | 64 | 40 | 419 | 189 | 1,237 | 697 |
| 2021 | 167 | 96 | 156 | 34 | 382 | 513 |

Kriteri: Ligji nr. 7811, datë 12.04.1994 òMbi sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureveò, dhe Marrëveshjet hidrokarbure për Kuçovës lidhur, miratuar me VKM Nr.686, datë 19.10.2007.

Ndikimi: Shmangie dhe mos pagim të detyrimeve fiskale

Shkaku: Mungesë investimesh dhe investime te pa miratuara me pasoje mos prodhim nafte nga vendburimi

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim 1. AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë òS.I.ò, që të intensifikojë operacionet që mundësojnë rritjen e prodhimit të naftës, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhura-shpenzime në vlera më të larta së, R=1.

Rekomandim 2. AKBN, MIE dhe Albpetrol në bashkëpunim me kompaninë òS.I.ò, të gjejnë rrugët e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit për miratimin sa më shpejte të Programit të Punës dhe Buxhetit të vitit 2020.

15. Titulli i gjetjes: Shpenzime të përfshira padrejtësisht në kosto hidrokarbure të rikuperueshme.

Situata: Nga ana e AKBN është audituar aktiviteti për mbulimin e kostove hidrokarbure të Shoqërisë òS.ò, për vitin 2019. Auditimi është realizuar në vitin 2021. Konstatohet së nuk është zbatuar plani i zhvillimit. Pavarësisht së ishte marrë angazhim, nuk është realizuar investimi me vlerë 1.97 milionë USD për shpimin e një pusi horizontal deri në dhjetor 2018 dhe futjen e bioenzimave në trupet e 6 puseve. Nuk është konsideruar kosto hidrokarbure vlera 99,122 USD. Është kërkuar pasqyrimi në kostot hidrokarbure të parikuperueshme të vlerës së mësipërme, por nuk është njoftuar për thyerje marrëveshje, pasi kemi të bëjmë me situata të përsëritura.

Kriteri: Marrëveshja hidrokarbure, licencë marrëveshja.

Ndikimi: Shmangia nga detyrimet dhe mos pagim të detyrimeve fiskale

Shkaku: Mos respektimi i marrëveshjeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AKBN, t'ò kërkojë kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira padrejtësisht në kosto hidrokarbure të rikuperueshme, duke bërë edhe njoftimin përkatës për shkelje të

marrëveshjes licence dhe marrëveshjes hidrokarbure.

16. Titulli i Gjetjes: Zbatimi i Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Licence Marrëveshjet për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve. Në periudhën 01.09.2018 - 30.04.2021 janë në fuqi këto Marrëveshje Hidrokarbure ose Kontrata me Ndarje Prodhimi (KNP) për kërkimin, zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Bllloqet e kërkimit në Shqipëri:

1. Marrëveshja për Blllokun 2-3, në toke;
2. Marrëveshja për Blllokun 4, në toke;
3. Marrëveshja për Blllokun Dumrea.

Situata 1: Marrëveshja për Bllloqet 2-3, në tokë është miratuar me VKM nr.754, date 08.07.2009. Interesat e pjesëmarrjes në këtë Marrëveshje janë: RDS 100% dhe operator është kompania òS.U.A.ò, duke filluar nga data 30.03.2016 është bere zotëruesi i 100% te interesave te KNP për Bllloqet 2-3. Së fundmi kjo marrëveshje u amendua me VKM Nr. 180, datë 26.02.2020 dhe u botua në Fletoren Zyrtare Nr.25, datë 28.02.2020.

Marrëveshja për këto Bllloqe është aktualisht në Periudhë Vlerësimi, pas deklarimit te zbulimit të naftës në pusin Shpiragu-2 dhe përfundimit të Fazës së Dytë të Kërkimit. Në zbatim të marrëveshjes Hidrokarbure për òKërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Bllloqet 2-3ò, kompania òS.U.A.ò, gjate vitit 2018 nisi shpimin e pusit Shpiragu-4.

Pusi Shpirag-4, ishte pusi i katërt që u shpua për llogari të kësaj Marrëveshjeje. Shpimi i pusit Shpiragu-4, filloi më datë 05.01.2018, me një thellësi të projektuar prej 6,106 m. Sipas specialistëve të AKBN të cilët kanë monitoruar në terren operacionet hidrokarbure te kryera në pusin Shpirag-4, objektivi i pusit ishte të vlerësonte naftë gaz mbajtjen e depozitimeve karbonatike të Eocenit dhe të Kretakut të sipërm. Shpimi i pusit përfundoi në datën 28.08.2018 duke arritur thellësinë 5643.6 mMD. Vendimi për ndërprerjen e shpimit pa arritur në thellësinë e parashikuar në projekt u mor në datën 03.09.2018 dhe erdhi si pasojë e humbjeve të mëdha të lëngut larës dhe shqetësimeve në trungun e pusit.

Pas një periudhe të gjatë kontrolli, riparimi dhe pastrimi me Nitrogjen të të gjitha pajisjeve dhe linjave të cilat marrin pjesë në Stimulimin e Testimin e pusit si dhe ricertifikimin e plotë të tyre më datë 25.03.2019 rifilluan operacionet hidrokarbure për kryerjen e Stimulimit dhe Testimit Afatshkurtër i cili përfundoi në datën 04.06.2019. Rezultate e marra nga ky testim cilësohen si shumë të kënaqshme dhe rrisin pritshmërinë lidhur me perspektiven naftë gaz mbajtëse në këtë rajon. Me përfundimin e testit afatshkurtër, ashtu siç parashikonte programi, filloj demontimi i sondës dhe transporti për në pusin Shpirag-3, për ri shpimin e tij.

Pas përfundimit me sukses të shpimit të pusit Shpiragu-4, kompania paraqiti në AKBN versionin e përzgjedhur për rifillimin e shpimit në pusin Shpirag -3, i cili ishte pezulluar me 09.11.2017, si pasojë e problemeve teknike në trungun e tij. Ky version u diskutua në mbledhje teknike midis përfaqësuesve të AKBN-së dhe kompanisë òS.U.A B.Vò. Detajimi i versionit të zgjedhur u dërgua në AKBN në dy programe, Rikuperimi i Kolonës së Shpirag -3 dhe Programi i Shpimit në Flish. Kështu, me date 09.07.2019 rifilloi shpimi në pusin Shpirag-3, me thellësi te projektuar 6800m MD dhe objekti vlerësimin e naftë gaz mbajtjen në gëlqerorët e Eocen óKretës. Me arrijten e thellësisë 4496m MD, në datën 06.11.2019 në trungun e pusit u shfaqen përsëri probleme teknike, te cilat pavarësisht përpjekjeve te kompanisë nuk arritën te kalohen. Kështu, në Mbledhjen e Komitetit Këshillimor te Kërkimit (EACM) për KNP Bllloku 2-3, mbajtur me 13.12.2019 nga kompania u be me dije së operacionet hidrokarbure në këtë pus u pezulluan.

Krahas operacioneve për shpimin e puseve, kompani ka kryer në përputhje me kontratën punime sizmike si dhe është kryer përpunimi dhe interpretimi i matjeve të sizmikes pasive ekzistuese në këto blloqe.

Lidhur me investimet e kryera nga kompania , për vitin 2018 investimet e kompanisë kanë qenë rreth 74.3 milion USD, me një buxhet të miratuar prej 89.7 milion USD. Ndërkohe për vitin 2019 buxheti i miratuar ka qenë në vlerën 111.8 milion USD dhe investimet janë kryer rreth 87.6 milion USD.

Për vitin 2020 në Mbledhjen e Komitetit Këshillimor të Kërkimit (EACM) për KNP Blloku 2-3, mbajtur me 13.12.2019 u miratua në parim buxheti prej 66.47 milion USD.

Investimet akumulative nga fillimi i kësaj marrëveshjeje deri me 31.12.2019 janë kryer rreth 636.8 milion USD.

Në tabelën me poshtme jepen pjesët përkatëse të AKBN-së dhe Kontraktorit nga hidrokarburet fitim për naftën bruto dhe për gazin sipas Marrëveshjes së re të amenduar për KNP për Blloqet 2,3 në toke:

Tabela nr. 40

| Faktori òRò | Nafta | | Gazi | |
|-----------------|--------------------|------------|--------------------|------------|
| | Pjesa Kontraktorit | Pjesa AKBN | Pjesa Kontraktorit | Pjesa AKBN |
| 0 < R Ò 1.50 | 99 % | 1 % | 100 % | 0 % |
| 1.50 < R Ò 2.00 | 95 % | 5 % | 100 % | 0 % |
| 2.00 < R Ò 2.50 | 90 % | 10 % | 100 % | 0 % |
| 2.50 < R | 85 % | 15 % | 100 | 0 % |

Burimi: AKBN

Situata:2. Kontrata (marrëveshja) me Ndarje Prodhimi òPër Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në toke, në Shqipëriò Blloku 4, ndërmjet MIE, përfaqësuar nga AKBN dhe òS.U.A B.Vò është miratuar me VKM Nr 350, date 12.06.2018.

Kompania òS.U.Aò në përputhje me nenin 19.2 të KNP me datë 18.07.2019 nënshkroi një òAkti Transferimiò me Filialin e kompanisë òS.A.B 4BVò. Në baze të këtij òAkti Transferimiò i cili hyri në fuqi me 06.09.2020, òS.U.Aò transferoj interesat e sipas KNP tek òS.A.B 4BVò si mbajtëse e 100% të interesave të pjesëmarrjes në këtë Kontrate.

Kjo marrëveshje parashikon kërkimin e hidrokarbureve në këtë Bllok, kërkim i cili do të kryhet në tre faza:

-Faza e pare do të zgjas 3 vite. Gjate kësaj faze do të kryhen punime sizmike, përpunim dhe interpretim i të dhënave sizmike 2D për 125 km, dhe vlerësimi gjeologjik dhe gjeofizik (G&G). Angazhimi financiar minimal për këtë faze është 8.57 milion USD.

-Faza e dyte do të zgjasë 2 vjet. Gjatë kësaj faze do të kryhen rreth 300 km punime sizmike 2D dhe ripërpunimi i 200 km profile sizmike 2D. Gjatë kësaj faze është opsional shpimi i një pusi kërkimi me thellësi 3000 m. Angazhimi financiar minimal për këtë faze është rreth 20 milion USD.

-Faza e trete do të zgjasë 2 vjet. Gjate kësaj faze do të kryhet shpimi i një pusi kërkimi me thellësi minimale 3000m. Angazhimi financiar minimal për këtë faze është 14 milion USD.

Kohëzgjatja e Kontratës për rastin që do të ketë një zbulim të ri, pra periudha e Zhvillim ó Prodhimit, do të jete 25 vjet me të drejtë zgjatje.

Në zbatim të Marrëveshjes, kompania ka filluar dhe po kryen punime sizmike sipas angazhimit të fazës së parë që parashikon KNP.

Investimet akumulative nga fillimi i kësaj marrëveshje deri me 31.12.2019 janë rreth 1.3 milion USD. Ndërkohe buxheti i miratuar për vitin 2020 është 13.47 milion USD.

Në tabelën më poshtme do jepen pjesët përkatëse të AKBN-së dhe Kontraktorit nga hidrokarburet fitim për naftën bruto dhe për gazin:

Tabela nr. 41

| Faktori òRö | Nafta | | Gazi | |
|-----------------|--------------------|------------|--------------------|------------|
| | Pjesa Kontraktorit | Pjesa AKBN | Pjesa Kontraktorit | Pjesa AKBN |
| 0 < R ò 1.50 | 99 % | 1 % | 100 % | 0 % |
| 1.50 < R ò 2.00 | 95 % | 5 % | 100 % | 0 % |
| 2.00 < R ò 2.50 | 90 % | 10 % | 100 % | 0 % |
| 2.50 < R | 85 % | 15 | 100% | 0 % |

AKBN ka audituar aktivitetin hidrokarbur të Shoqërisë “S.U.A”, për blloqet 2 dhe 3, për periudhën 01.07.2019 deri 31.12.2019, auditim i realizuar vitin 2020 dhe 2021. Konstatohet së kontraktori nuk ka program pune dhe buxhet.

Janë konsideruar si kosto të pezulluara shpenzimet për shërbime në vlerë 21,706 USD, 56,486 USD, 33,497 USD, 7,935 USD, shpenzime për karburant me vlerë 3,766 USD, shërbime rekrutimi me vlerë 13,795 USD, shpenzime sigurimi me vlerë 3,551 USD, punime rikonstruksioni me vlerë 139,524 USD, siguracion automjetesh me vlerë 1,177 USD, sigurim përgjegjësie me vlerë 148,192 USD, shpenzime qiraje me vlerë 15,756 USD.

Po ashtu nga shpenzimet e audituara për aktivitetin 2020, janë konsideruar kosto të pezulluara vlerat 65,816 USD, 8,309 USD, 5,056 USD, 25,448 USD, 5,270 USD, 1,861 USD dhe 30,034 USD.

Situata 3: Me datë 20.012.2019 u nënshkrua Kontrata me ndarje prodhimi òPër Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në tokë, në Shqipëriò Blloku Dumreja, ndërmjet MIE, përfaqësuar nga AKBN dhe kompanisë òE.A. B.Vö. Kjo kontrate u miratua me VKM nr. 187, date 26.02.2020.

Kjo Kontrate parashikon kërkimin e hidrokarbureve në këtë Bllok me një periudha të parë kërkimi e cila do të zgjas 5 vite. Angazhimi financiar minimal për këtë fazë është 46 milion USD. Gjate kësaj faze do të kryhen punime sizmike, përpunim dhe interpretim i të dhënave sizmike 2D për 200 km dhe vlerësimi gjeologjik dhe gjeofizik (G&G). Po kështu në këtë faze parashikohet edhe shpimi i një pusi kërkimi me thellësi 6150 m.

Në tabelën e më poshtme jepen pjesët përkatëse të AKBN-së dhe Kontraktorit nga hidrokarburet fitim për naftën bruto:

Tabela nr. 42

| Faktori òRö | Nafta | |
|--------------|--------------------|------------|
| | Pjesa Kontraktorit | Pjesa AKBN |
| 0 < R < 1.00 | 97 % | 3 % |
| 1 òR < 1.5 | 95 % | 5 % |
| 1.5 òR < 2.0 | 93 % | 7 % |
| 2.0 òR < 2.5 | 87.5 % | 12.5 % |
| 2.5 òR | 82.5 % | 17.5 % |

Referuar parashikimeve të KNP-së për Bllokun Dumreja, në tokë, në rast të zbulimit të gazit, përpara depozitimit të programit të vlerësimit, AKBN dhe Kontraktori do të negociojnë ndarjen e

gazit fitim bazuar në faktorët teknik dhe ekonomik për zhvillimin e zonës për ta bere këtë projekt ekonomikisht të zbatueshëm.

AKBN ka audituar aktivitetin hidrokarbur të Shoqërisë òE.A. BVò, për Bllokun Dumre, për periudhën 01.03.2020 deri 30.06.2020, auditim i realizuar vitin 2021. Për aktivitetin e kontraktorit është konsideruar kosto e pezulluar shpenzimet e shërbimeve me vlerë 32,679.5 USD.

Për aktivitetin hidrokarbur të Shoqërisë òE.A. BVò, për Bllokun Dumre, është audituar edhe periudha 01.07.2020 deri 31.12.2020, auditim i realizuar vitin 2021.

Për aktivitetin e kontraktorit është konsideruar kosto e pezulluar shpenzimet e shërbimeve me vlerë 992,359 USD. Rezulton së Kompania nuk realizon shpenzime sipas programit të miratuar.

Kriteri: Ligji nr. 7811, datë 12.04.1994 òMbi sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureveò, dhe Marrëveshjet Hidrokarbure òPër Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në tokeò miratuar me VKM të sipërcituara

Ndikimi: Pritshmëri për të ardhura të konsiderueshme të hyra në buxhetin e shtetit.

Shkaku: Nga kërkimi do të zbulohen rezerva naftë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: AKBN, tã kërkojë kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira padrejtësisht në kosto hidrokarbure të rikuperueshme, duke bërë edhe njoftimin përkatës për shkelje të marrëveshjes licence dhe marrëveshjes hidrokarbure.

17. Titulli i gjetjes: Shpenzime të përfshira padrejtësisht në kosto hidrokarbure:

Situata: Nga ana e AKBN është audituar aktiviteti hidrokarbur i Shoqërisë òS.A.B 4 BVò, për periudhën 01.06.2019 deri 31.12.2018, realizuar në vitin 2020.

Raporti i auditimit i është dërguar kompanisë me shkresë nr. 3083/5 prot., datë 17.08.2020.

Nga auditimi janë konsideruar si kosto të pezulluara vlera 13,251 USD dhe 3,428 USD, për shërbime të ofruara nga kompani të tjera si dhe shërbime rekrutimi.

Është audituar dokumentacioni i kostove hidrokarbure për periudhën 01.06.2019 deri 31.12.2019.

Është audituar dokumentacioni i kostove hidrokarbure për vitin 2020, audit i realizuar në vitin 2021. Për vitin 2020, totali i kostove të raportuara është 1,989,381 USD, nga të cilat 1,976,498 USD, i përkasin zërit sizmike.

Kriteri: Marrëveshja hidrokarbure, licencë marrëveshja.

Ndikimi: Shmangia nga detyrimet dhe mos pagim të detyrimeve fiskale

Shkaku: Mos respektimi i marrëveshjeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AKBN, tã kërkojë kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira padrejtësisht në kosto hidrokarbure të rikuperueshme, duke bërë edhe njoftimin përkatës për shkelje të marrëveshjes licence dhe marrëveshjes hidrokarbure.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Drejtori i Përgjithshëm i AKBN z. A.B..

Drejtori i Marrëveshjeve Hidrokarbure z. E.K..

Shefe e Sektorit të Auditit të Marrëveshjeve Hidrokarbure znj. O.M..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga AKBN është paraqitur observacioni me shkresë nr. 216/28 prot., datë 02.06.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Pretendohet se AKBN ka kërkuar në vazhdimësi nga BPAL të intensifikojë përpjekjet me qëllim arritjen e rezultateve optimale nga kryerja e operacioneve hidrokarbure. Në tre mujorin e katërt të vitit 2021, Kontraktori ka deklaruar arritjen e faktorit $R=1.0056$.
- Nga ana e AKBN citohet se nga ana e Kompanisë BPAL janë dorëzuar kopje të të regjistrimeve kontabël, si dhe kompania ka shprehur gatishmërinë për vënien në dispozicion të AKBN dokumentacionin lidhur me kostot hidrokarbure, por në ambientet e kompanisë, në kuadër të auditimeve që bëhen nga AKBN sipas marrëveshjes.
- Gjetjet në raportet e auditit të AKBN dhe kundërshtimet e kompanisë për kostot hidrokarbure të pa rikuperueshme përbën një mosmarrëveshje kryesore mes palëve.
- Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet BPAL dhe AKBN është ngritur një grup pune ndërmnistror me përfaqësues të MIE, AKBN, Albpetrol dhe BPAL, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që dalin nga raportet e auditit, por nuk është arritur ndonjë dakordësi.
- Sa i takon standardeve të auditimit, AKBN ka qenë pjesë e një programi të asistencës teknike nga Departamenti i Shtetit Amerikan dhe Departamenti i Thesarit. Vijohet puna për përgatitjen e një manuali.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Arritja e faktorit R më të madh se 1, siç paraqitet në observacion i përket periudhës e cila nuk është audituar. Gjithsesi ky faktor është arritur me shumë vonesë dhe nëse nuk monitorohet siç duhet mund të ketë zvogëlim të këtij faktori.

Pavarësisht se ka mangësi në përcaktimet e marrëveshjes, dokumentacioni i detajuar i shpenzimeve duhet të jetë i aksesueshëm nga AKBN.

Në shpenzimet e konsideruara të pa disbursueshme përfshihen edhe ato për të cilat kontrata është shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Aplikimi i standardeve të auditimit të pranuar nga palët do të lehtësojë kontradiktat ndërmjet palëve dhe do të rritjë saktësinë e rezultateve dhe përcaktimi i përgjegjësisë.

II.2.7. Mbi shfrytëzimin e burimeve minerare.

1. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurës monitoruese.
2. Mbi respektimin e kushteve të përcaktuara në lejen e shfrytëzimit.
3. Respektimi i programit të veprimtarisë ekonomiko-financiare të subjekteve minerare metalore dhe jo metalore.

7. Mbi shfrytëzimin e burimeve minerare.

Auditimi u krye në këto drejtime:

1. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurës monitoruese.
2. Mbi respektimin e kushteve të përcaktuara në lejen e shfrytëzimit.
3. Respektimi i programit të veprimtarisë ekonomiko-financiare të subjekteve minerare metalore dhe jo metalore.

Baza Ligjore;

- Ligji nr. 10304, datë 15.07.2010 ÷Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.199, ÷Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 9975, datë 28 korrik 2008 ÷Për taksat kombëtare, i ndryshuar;
- Ligji nr. 151/2020, ÷Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, ÷për taksat kombëtare;

- VKM nr. 547, datë 09.08.2006 òPër krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN)ò;
- VKM nr. 479, datë 29.06.2011 òPër miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisëò;
- Rregullore e brendshme e AKBN;
- Statut ó Rregullore e funksionimit të AKBN;
- Rregullore e òKomisionit të shqyrtimit të programeve vjetore në sektorin minerar;
- Urdhër Nr.201, datë 20.06.2016 òPër miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrier për grupin e mineraleve ndërtimoreò;
- Urdhër Nr.202, datë 20.06.2016 òPër miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumetò;
- Etj.....

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, (më pas AKBN), ushtron funksionin monitorues ndaj subjekteve që zotërojnë leje të shfrytëzimit minerar në zbatim të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerar në Republikën e Shqipërisëò, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014.

Në zbatim të VKM nr. 479, datë 29.06.2011 òPër miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisëò, për periudhën 2010-2025, veprimtaria e shfrytëzimit minerar është rregulluar me një serë normash ligjore dhe vendimesh të KM, të cilat janë ndryshuar dhe përmirësuar në vazhdimësi, në të cilat janë përcaktuar detyrimet dhe të drejtat e institucioneve shtetërore si dhe të subjekteve të kontraktuara për shfrytëzimin racional dhe të sigurt të vendburimeve minerare. Veprimtaria e AKBN bazohet në VKM nr. 547, datë 09.08.2006 òPër krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyroreò.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Konsulton, propozon dhe bashkëpunon me strukturat përkatëse të qeverisë për hartimin e politikave të saj në fushën e minierave, të hidrokarbureve dhe të energjetikës;
- Zbaton politikat e qeverisë në fushën e minierave, të hidrokarbureve dhe energjetike;
- Siguron, brenda fushës së veprimtarisë së vet, oponencën qeveritare për studimet dhe projektet në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike, të paraqitura nga subjektet, shtetërore a private, vendase ose të huaja. Për raste të veçanta mund të kërkojë asistencë të specializuar;
- Promovon burimet minerare e hidrokarbure, negociacion marrëveshjet hidrokarbure dhe minerare, si dhe ndjek zbatimin e planeve të zhvillimit të tyre;
- Përgatit dokumentacionin dhe praktikën e nevojshme për dhënien e lejeve, të licencave, autorizimeve, në përputhje me ligjin, të cilat mundësojnë hyrjen në marrëveshjet hidrokarbure dhe kryerjen e operacioneve hidrokarbure, sipas marrëveshjeve të lidhura;
- Mbikëqyr veprimtarinë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike;
- Ndjek zbatimin e marrëveshjeve të lidhura hidrokarbure;
- Realizon monitorimin e zonave të shfrytëzuara, të rrezikut minerar dhe të mbylljes së veprimtarisë minerare;
- Administron, ekskluzivisht, të gjitha të dhënat parësore të sektorit hidrokarbur dhe të dhënat, që lidhen me veprimtarinë minerare dhe postminerare.
- Shërben si organ i specializuar për ministrin përgjegjës për energjinë, për problemet e strategjisë dhe të politikës në këtë fushë;

- Promovon burimet e rinovueshme të energjisë, si dhe propozon masa për rritjen e shfrytëzimit të energjisë në ciklin energjetik;
- Harton dhe publikon bilancin energjetik vjetor, në nivel kombëtar dhe rajonal, në përputhje me formatet e EUROSTAT-it dhe të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë;
- Monitoron kontratat koncesionare për hidrocentralet.

Drejtoria Minerare në AKBN, në bazë të nenit nr. 16 të Statutit Rregullores të funksionimit të AKBN-së, ka për objektiv:

1. Konsulton, propozon dhe bashkëpunon, me strukturat përkatëse të Qeverisë, për hartimin e politikave të saj në fushën minerare;
2. Zbaton politikat e Qeverisë në fushën minerare;
3. Siguron, brenda fushës së veprimtarisë së vet, oponencën qeveritare për studimet dhe projektet në fushën minerare dhe postminerare;
4. Promovon burimet minerare, negociacion marrëveshjet minerare dhe ndjek zbatimin e planit të zhvillimit të tyre;
5. Mbikëqyr veprimtarinë minerare e postminerare dhe raporton për gjendjen aktuale;
6. Realizon monitorimin e zonave të shfrytëzuara, të rrezikut minerar dhe të mbylljes së veprimtarisë minerare;
7. Vlerëson shkallën e rrezikut minerar, efektet e mundshme dhe propozon masat që duhet të merren për parandalimin e tyre;
8. Administron, ekskluzivisht, të gjithë të dhënat parësore, që lidhen me veprimtarinë minerare dhe postminerare.
9. Organizon grupe pune për kryerjen e Akt-verifikimeve në terren për të gjitha kërkesat e bëra nga subjektet private për leje të reja minerare dhe harton dokumentacionin për to.
10. Organizon azhurnimin periodik me sektorin e projekteve minerare dhe industriale në ministri të lejeve të reja të dhëna nga ministria.
11. Të japë një pasqyrë sa më të qartë të aktivitetit minerar në kompleksi tetin e tij në secilin subjekt, zonë, bashki apo qark.
12. Gjendjen teknike të objektit, duke paraqitur edhe të dhëna statistikore si, nivelin e prodhimit apo tregues cilësorë, për secilin objekt në veçanti.
13. Ecurinë e lejeve në mënyrë kronologjike. Përditësimin e të dhënave të subjekteve minerare që lidhen me statusin e tyre.

Në ushtrimin e funksionit monitorues AKBN ka detyrimin të monitorojë çdo subjekt kontraktues 2 herë në vit, me objekt:

- a. Respektimin e afateve ligjore dhe formatin e caktuar për dorëzimin e dokumentacionit
- b. Respektimin e sipërfaqes së kontraktuar të përcaktuar në lejen e shfrytëzimit
- c. Rinovimin e lejes minerare;
- d. Shqyrtimin e planit vjetor;
- e. Respektimin e pagesave të detyrimeve ndaj shtetit.

Sipas nenit 36, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014, zotëruesi i lejes minerare gjatë ushtrimit të veprimtarisë minerare të mbikëqyruar dhe monitoruar nga AKBN ka detyrim:

-Të paraqesë në çdo vit të vlefshmërisë së lejes dhe brenda datës së vitit vazhdues, që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes, dokumentin e garancisë financiare, për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare.

-Të paguajë rentën minerare, sipas tipit të lejes minerare, në afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

-Të marrë masat e nevojshme të sigurisë për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e punonjësve e të personave të tjerë, të cilët hyjnë në zonën e lejes minerare, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e teknikës së sigurimit e të mbrojtjes në punë.

- Të marrë masat e nevojshme për sigurimin e kushteve të punës, sipas legjislacionit në fuqi.

- Të bëjë sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë, sipas rregullave të sigurimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

-Të realizojë dhe të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse informacionet tremujore mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor.

- Të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo vit raportin financiar dhe teknik të të gjitha operacioneve të kryera, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij dhe planin vjetor të punës.

- Të paraqesë çdo vit për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse një plan pune vjetor, të hartuar në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare.

- Të paraqesë çdo vit për miratim kapacitetet e prodhimit, vlerën e investimeve, vlerat e garancive të përcaktuara në nenin 31, të këtij ligji, në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare.

- Të paraqesë çdo vit raportin mbi pagesat për taksat vendore dhe kombëtare, garancinë financiare të miratuar për rehabilitimin përfundimtar të mjedisit, në përputhje me planin e veprimtarive të mbylljes së minierës dhe projektin e rehabilitimit të mjedisit dhe planin e menaxhimit të mbetjeve minerare dhe garancinë financiare të miratuar për realizimin e investimit dhe programit minimal të punës.

AKBN për çdo vit ushtrimor harton programin vjetor miratuar nga titullari për kontrollin e subjekteve që kanë lidhur kontratë shfrytëzimi minerar dhe jo minerar me objekt shqyrtimin e dokumentacionit për raportimin e aktivitetit të kryer dhe miratimin e programit vjetor për veprimtarinë e vitit pasardhës. Kontrolli i aktivitetit kryhet mbi dokumentacionin e kërkuar nga Drejtoria Minerare, e protokolluar dhe arkivuar sipas tabelës së inventarit të miratuar në programin vjetor të punës, me të cilat është njohur çdo subjekt i licencuar që i nënshtrohet monitorimit periodik. Drejtoria Minerare, sipas përcaktimeve në Statut-Rregulloren e AKBN-së, ajo është kompozuar me 6 sektorë, dy prej të cilëve monitorojnë aktivitetin minerar prodhues për subjektet e licencuara, një sektor i monitorimit postminerar, sektori i statistikave, sektori i Akt-Verifikimit dhe trajtimit të ankesave si dhe laboratorit minerar dhe i pasurimit.

Aktiviteti i prodhimit të mineraleve ndërtimore metalore e jometalore

Bazuar në raportimin vjetor të Drejtorisë Minerare të AKBN, në lidhje me aktivitetin e subjekteve private me leje shfrytëzimi nga Ministria, të mineraleve metalore dhe ndërtimore jo metalore situata paraqitet si më poshtë vijon:

- *Për periudhën 01.09.2018-31.12.2018 kanë qenë aktive 597 leje shfrytëzimi.*

Në drejtim të shfrytëzimit të mineraleve të grupit jo metalor deri më 31 Dhjetor 2018 kanë ushtruar aktivitet minerar dhe kanë zotëruar leje minerare 294 subjekte, të ndara këto në 50 Bashki në rang vendi. Nga aktiviteti minerar gjatë vitit 2018 janë prodhuar 3,532,648 m³ dhe 4,720,272 ton, minerale ndërtimore.

Përsa i përket grupit të mineraleve metalore, gjatë vitit 2018 në të gjithë territorin e vendit kanë ushtruar aktivitet minerar dhe kanë zotëruar leje minerare 303 subjekte (nga të cilat 252 në mineralin e kromit, 5 leje për sterile kromi, 31 leje në Fe-Ni dhe Ni-Si, 13 leje në minierat e bakrit, 1 leje në magnezite dhe 1 leje për skorje Fe-Cr.), të shpërndara në 15 bashki në rang vendit.

- *Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 kanë qenë aktive 571 leje shfrytëzimi.*

Në drejtim të shfrytëzimit të mineraleve të grupit jo metalor deri më 31 Dhjetor 2019 kanë ushtruar aktivitet minerar dhe kanë zotëruar leje minerare 270 subjekte, të ndara këto në 49 Bashki në rang vendi. Nga aktiviteti minerar gjatë vitit 2019 janë prodhuar 3,695,410 m³ & 3,899,057 ton, minerale ndërtimore.

Përsa i përket grupit të mineraleve metalore, gjatë vitit 2019 në të gjithë territorin e vendit kanë ushtruar aktivitet minerar dhe kanë zotëruar leje minerare 301 subjekte (nga të cilat 251 në mineralin e kromit, 4 leje për sterile kromi, 28 leje në Fe-Ni dhe Ni-Si, 16 leje në minierat e bakrit, 1 leje Shllame Fe dhe 1 leje për skorje Fe-Cr.), të shpërndara në 18 bashki në rang vendit.

- *Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 kanë qenë aktive 576 leje shfrytëzimi.*

Në drejtim të shfrytëzimit të mineraleve të grupit jo metalor deri më 31 Dhjetor 2020 kanë ushtruar aktivitet minerar dhe kanë zotëruar leje minerare 273 subjekte, të ndara këto në 49 Bashki në rang vendi. Nga aktiviteti minerar gjatë vitit 2020 janë prodhuar 2.411.292 m³ & 4.112.448 ton, minerale ndërtimore.

Përsa i përket grupit të mineraleve metalore, gjatë vitit 2020 në të gjithë territorin e vendit kanë ushtruar aktivitet minerar dhe kanë zotëruar leje minerare 303 subjekte (nga të cilat 256 në mineralin e kromit, 31 leje në Fe-Ni dhe Ni-Si, 16 leje në minierat e bakrit.), të shpërndara në 18 bashki në rang vendit.

- *Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 kanë qenë aktive 587 leje shfrytëzimi.*

Në drejtim të shfrytëzimit të mineraleve të grupit jo metalor deri më 31 Dhjetor 2021 kanë ushtruar aktivitet minerar dhe kanë zotëruar leje minerare 289 subjekte, të ndara këto në 49 Bashki në rang vendi. Nga aktiviteti minerar gjatë vitit 2021 janë prodhuar 2.398.232 m³ & 3.814.702 ton minerale ndërtimore.

Përsa i përket grupit të mineraleve metalore, gjatë vitit 2021 në të gjithë territorin e vendit kanë ushtruar aktivitet minerar dhe kanë zotëruar leje minerare 298 subjekte (nga të cilat 251 në mineralin e kromit, 31 leje në Fe-Ni dhe Ni-Si, 16 leje në minierat e bakrit.), të shpërndara në 19 bashki në rang vendit.

Renta Minerare

"Renta Minerare" është përqindja e vlerës së mineralit të shitur, që i paguhet shtetit ngazotëruesii lejes minerare, si kompensimpërzvogëlimin e burimeveminerare.

Renta minerare përbën fluksin kryesor të të ardhurave nga aktiviteti minerar. Ajo përlllogaritet mbi vlerën e tatueshme (ose vlerën fiskale) të të ardhurave nga aktiviteti i nxjerrjes, në bazë të ligjit Nr. 9975, datë 28 korrik 2008 òPër taksat kombëtare, i ndryshuar, shtojca nr. 2.

Renta për sasi të mineralit që eksportohet mbledhet nga Administrata Doganore Shqiptare, ndërsa dhe për shitjet brenda vendit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në përputhje me ligjin për taksat kombëtare, Shteti transferon një pjesë të rentës së mbledhur tek njësitë e qeverisjes vendore, ku gjenerohet prodhimi minerar.

Për periudhën nga viti 2018 ó vitin 2021, treguesit e rentës nga mineralet paraqiten si vijon:

- Për grupin e mineraleve metalorë:

Tabela nr. 43

| Renta në % dhe Renta (lekë), Viti 2018 për mineralet metalor | | | |
|---|---------------|---------|-----------------------|
| Lloji Mineralit | Prodhimi(ton) | %rentës | Renta(lekë) |
| Krom | 1,156,444.53 | 6% | 596,064,481.00 |
| Bakër | 236,459.00 | 6% | 7,302,298.00 |
| Hekur-nikel | 385,710.00 | 5% | 18,898,991.00 |
| Totali Rentës | | | 622,265,770.00 |

| Renta në % dhe Renta (lekë), Viti 2019 për mineralet metalor | | | |
|---|---------------|---------|-----------------------|
| Lloji Mineralit | Prodhimi(ton) | %rentës | Renta(lekë) |
| Krom | 1,098,105.00 | 7% | 413,760,019.00 |
| Bakër | 325,593.00 | 6% | 16,385,066.00 |
| Hekur-nikel | 394,530.00 | 5% | 25,953,018.00 |
| Totali Rentës | | | 456,098,103.00 |

| Renta në % dhe Renta (lekë), Viti 2020 për mineralet metalor | | | |
|---|---------------|---------|-----------------------|
| Lloji Mineralit | Prodhimi(ton) | %rentës | Renta(lekë) |
| Krom | 626,627.00 | 8% | 317,843,012.00 |
| Bakër | 432,673.00 | 6% | 27,098,698.00 |
| Hekur-nikel | 333,715.00 | 5% | 23,844,210.00 |
| Totali Rentës | | | 368,785,920.00 |

| Renta në % dhe Renta (lekë), Viti 2021 për mineralet metalor | | | |
|---|---------------|---------|-----------------------|
| Lloji Mineralit | Prodhimi(ton) | %rentës | Renta(lekë) |
| Krom | 650,200.00 | 9% | 303,465,305.00 |
| Bakër | 470,552.00 | 6% | 24,989,407.00 |
| Hekur-nikel | 618,517.00 | 5% | 331,614,536.00 |
| Totali Rentës | | | 660,069,248.00 |

Burimi: AKBN, Drejtorja e Minierave.

Vihet re së edhe pse përqindja e aplikimit të rentës minerare, bazuar në Ligjin Nr. 9975, datë 28 korrik 2008 ÷Për taksat kombëtare÷, i ndryshuar, ka ndryshuar në rritje për mineralin e Kromit, i cili është edhe minerali më i prodhuar dhe më i shitur, (përkatësisht nga 6 % në vitin 2018, 7 % në vitin 2019 dhe 8 % në vitin 2020 dhe 9% në vitin 2021), të ardhurat e siguruara për buxhetin e shtetit nga renta kanë ardhur në rënie për vitet 2019 dhe 2020. Kjo rënie është arsyetuar nga ana e Drejtorisë Minerare të AKBN-së me faktin së për vitin 2019 dhe në vitin 2020 për arsye së çmimi i mineraleve metor në bursat ndërkombëtare ka pësuar një rënie të ndjeshëm dhe shumë subjekte minerare kanë bllokuar shitjet për eksportë.

Gjithashtu vlen të theksohet së në vitin 2021, pas hyrjes në fuqi të ligjit 151,÷ për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, ÷për taksat kombëtare÷, të ndryshuar, përqindja e aplikimit të rentës minerare është zëruar, pra përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit metalor në nënproduktin minerar, pas marsit të vitit 2021 dhe deri në fund të vitit 2023 do të jetë 0%.

Rritja të ardhurave të siguruara nga renta minerare për vitin 2021, ka ardhur si pasojë e rritjes së përqindjes së taksës së rentës për mineralin e Kromit nga 8%, në 9% si dhe si pasojë e rritjes së çmimit të mineraleve të grupit metalorë në Bursë.

- Tabela nr. 44 Për grupin e mineraleve jo metalorë (ndërtimorë):

| Renta (leke) për vitin 2018 për mineralet JoMetalore sipas vetë deklarimit | | | |
|---|-------------------------------|-----------------------------|-----------------------|
| Minerali | Prodhimi(ton/m ³) | Shitja(ton/m ³) | Renta(lekë) |
| Gurë Gëlqeror | | | |
| Gurë Gëlqeror (Inerte Ndërtimi) | 3,365,664 m ³ | 3,233,920 m ³ | 154,387,934.00 |
| Për nevoja hidrocentrali òMogliceò | 1,176,401 ton | 0 | 0.00 |
| Inerte ndërtimi | 117,398 m ³ | 205,556 m ³ | 8,109,801.00 |
| Gurë Gëlqeror (Fabrika Çimento) | 2,367,185.36 ton | | 59,134,072.00 |
| Gëlqeror Pllakor | 20,050 m ³ | 24,230 m ³ | 5,638,917.00 |
| Gëlqeror i Mermerizuar | 14,923 m ³ | 6,611.28 m ³ | 12,004,538.00 |
| Ranor Silicor | 11,243 m ³ | 9,514 m ³ | 5,934,116.00 |
| Zhavorr Bituminoz | 297,529 ton | 275,920 ton | 55,467,307.00 |
| Bitum | 1,861 ton | 1,315 ton | 0.00 |
| rërë Bituminoze | 42,521 ton | 40,921 ton | 2,659,933.00 |
| Argjilë | 708,311 ton | 364,900 ton | 28,465,865.00 |
| Gips | 102,015.7 ton | 101,820.18 ton | 2,143,868.00 |
| Qymyr Guri | 150 ton | 0 | 0.00 |
| Kuarc | 24,298.5 ton | 20,119.5 ton | 1,142,301.00 |
| Ndërtimorë të tjerë | 3,370 m ³ | 0 | 0.00 |
| Totali Rentës | | | 335,088,652.00 |

| Renta (leke) për vitin 2019 për mineralet JoMetalore sipas vetëdeklarimit | | | |
|--|-------------------------------|-----------------------------|-----------------------|
| Minerali | Prodhimi(ton/m ³) | Shitja(ton/m ³) | Renta(lekë) |
| Gurë Gëlqeror | | | |
| Gurë Gëlqeror (Inerte Ndërtimi) | 3,433,165m ³ | 2,289,237 m ³ | 126,039,554.00 |
| Konglomeratë, Brekie shpati, Zhure | 219,281m ³ | 328,902 m ³ | 9,790,309.00 |
| Gurë Gëlqeror (Fabrika Çimento) | 2,839,740 ton | 108,405 ton | 93,898,967.00 |
| Gëlqeror Pllakor | 15,087m ³ | 13,763 m ³ | 2,966,070.00 |
| Gëlqeror i Mermerizuar | 15,082m ³ | 28,879 m ³ | 19,426,747.00 |
| Ranor Silicor | 12,795m ³ | 10,654 m ³ | 8,034,271.00 |
| Zhavorr Bituminoz, Bitum | 95,679 ton | 90830 ton | 24,053,210.00 |
| rërë Bituminoze | 31,045 ton | 15,000 ton | 2,906,865.00 |
| Argjilë | 742,000 ton | 429,471 ton | 70,669,500.00 |
| Gips, Gips Alabastër | 168,470 ton | 298,403 ton | 5,799,137.00 |
| Qymyr Guri | 500 ton | | |
| Kuarc, Rëra kuarcore | 7,343 ton | 7,851 ton | 497,290.00 |
| Ndërtimorë të tjerë | 14,280 ton | 7,615 ton | 599,382.00 |
| Totali Rentës | | | 364,681,302.00 |

| Renta (leke) për vitin 2020 për mineralet JoMetalore sipas vetë deklarimit | | | |
|---|-------------------------------|-----------------------------|----------------|
| Minerali | Prodhimi(ton/m ³) | Shitja(ton/m ³) | Renta(lekë) |
| Gurë Gëlqeror | 2,454,833 m ³ | 1,764,224 m ³ | 124,670,891.00 |

| | | | |
|-------------------------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|
| Konglomeratë, Brekcie shpati, Zhure | 88,436 m ³ | 11,226 m ³ | 4,567,104.00 |
| Gurë Gëlqeror (Fabrika Çimento) | 2,521,898 ton | - | 77,833,680.00 |
| Gëlqeror Pllakor | 15,767 m ³ | 14,189 m ³ | 5,570,550.00 |
| Gëlqeror i Mermerizuar | 19,336 m ³ | 17,040 m ³ | 13,613,041.00 |
| Ranor Silicor | 13,292 m ³ | 10,099 m ³ | 5,177,225.00 |
| Zhavorr Bituminoz, Bitum | 151,231 ton | 117,677 ton | 31,098,087.00 |
| rëre Bituminoze | 27,063 ton | 27,063 ton | 2,581,371.00 |
| Argjilë | 924,950 ton | 385,195 ton | 21,196,527.00 |
| Gips, Gips Alabastër | 11,880 ton | 110,112 ton | 2,316,517.00 |
| Qymyr Guri | 2,577 ton | 2,577 ton | 515,440.00 |
| Kuarc, Rëra kuarcore | 20,500 ton | 8,365 ton | 386,350.00 |
| Ndërtimorë të tjerë | 27,083 m ³ | 3,850 m ³ | 589,056.00 |
| Totali Rentës | | | 290,115,839.00 |

| Renta (leke) për vitin 2021 për mineralet JoMetalore sipas vetë deklarimit | | | |
|---|-------------------------------|-----------------------------|-----------------------|
| Minerali | Prodhimi(ton/m ³) | Shitja(ton/m ³) | Renta(lekë) |
| Gurë Gëlqeror | | | |
| Gurë Gëlqeror (Inerte Ndërtimi) | 2,243,735 m ³ | 2,159,472 m ³ | 129,036,043.00 |
| Konglomeratë, Brekcie shpati, Zhure | 102,746 m ³ | 117,102 m ³ | 3,746,403.00 |
| Gurë Gëlqeror (Fabrika Çimento) | 2,502,939 ton | 66022 ton | 87,361,596.00 |
| Gëlqeror Pllakor | 16674 m ³ | 8,383 m ³ | 2,978,236.00 |
| Gëlqeror i Mermerizuar & Masiv & Dekorativ | 21,852 m ³ | 20,475 m ³ | 11,049,667.00 |
| Ranor Silicor | 11,355 m ³ | 9620 m ³ | 7,301,199.00 |
| Zhavorr Bituminoz, Bitum & Rërë Bituminoze | 251,334 ton | 160,527 ton | 31,409,906.00 |
| Argjilë | 879,435 ton | 454,233 ton | 48,440,856.00 |
| Gips, Gips Alabaster | 116295 ton | 115,086 ton | 2,416,816.00 |
| Qymyr Guri | 24,482 ton | 24,382 ton | 4,874,600.00 |
| Kuarc, Rëra kuarcore | 29,217 ton | 20,854 ton | 1,042,858.00 |
| Ndërtimorë të tjerë | 11,950 ton | 6,106 ton | 481,873.00 |
| Totali Rentës | | | 330,140,053.00 |

Burimi: AKBN, Drejtoria e Minerave.

Duhet theksuar që të dhënat mbi prodhimin shitjen dhe pagesën e rentës janë marrë bazuar në vetë deklarimin e subjekteve private të licencuara. Nga ana e autoritetit shtetëror përgjegjës (AKBN) hartohen dy raport periodike (6 mujor dhe vjetor) për mineralet metalorë dhe jometalorë, dokumente që pas miratimit nga grupi i punës dhe Drejtori Ekzekutiv, i adresohen Ministrisë së linjës (MIE).

Konstatim:

1. Dy raportet përmbledhës periodik (6 mujor dhe vjetor) që i adresohen Ministrisë së linjës (MIE) pasqyrojnë informacionet dhe treguesit bazë të zhvillimit të industrisë, me të dhëna mbi sasinë e mineralit të shitur brenda vendit apo eksportuar. Pas riverifikimeve të raporteve, grupi i auditimit konstaton se raportet e konsoliduara 6-Mujore dhe Vjetore japin informacione mbi numrin e subjekteve që janë propozuar tu revokohet leja minerare, numrin e subjekteve që është kërkuar pezullim aktiviteti; numri i subjekteve që nuk kanë paguar garancitë e rehabilitimit si dhe atyre që nuk kanë paguar rentën minerare në mënyrë të plotë apo të pjesshme. Këto raporte

duhen analizuar e shfrytëzuar nga ministria e linjës për hapat që duhen ndërmarrë në konsolidimin dhe rritjen e efikasitetit dhe efijensës së kësaj industrie.

2. Në kushtet që nuk janë kryer matjet e volumeve të mineralit të prodhuar dhe të shitur nga strukturat shtetërore monitoruese, të dhënat e raportuara nga subjektet private nëpërmjet vetë deklaramit nuk kanë nivel besueshmërie, meqenëse nuk janë kontrolluar dhe testuar. Për sa sipër, certifikimi i saktësisë së këtyre informacioneve bëhet pothuajse i pamundur dhe kjo situatë lë vend për raportime fiktive. Ky informacion i raportuar mbetet vetëm në nivelin e vetë deklaramit nga subjektet private të licencuara. Grupi i auditimit ka konstatuar së mungojnë kontrollet, inspektimet dhe vlerësimet e përbashkëta në terren me përfaqësues të AKBN/DM dhe Drejtorisë së Tatimeve ku ushtrojnë aktivitetin subjektet private të licencuara në shfrytëzimin e këtyre burimeve për të rritur nivelin e besueshmërisë dhe të saktësisë së këtyre të dhënave.

Për realizimin e programit të punës nr. 1418/1 Prot., datë 12.01.2022 miratuar nga Kryetari i KLSH-së, grupi i auditimit, përzgjedhi 40 dosje të shfrytëzimit jo mineralar dhe 20 dosje të shfrytëzimit mineralar si dhe analizoi gjithë bazën e të dhënave të (vete deklaramive) për treguesit e veçantë të testuar, sipas raportimeve tremujore dhe ato vjetore. Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e veprimtarisë mineralare dhe të monitoruara nga grupet e punës të ngritura me urdhër të titullarit u konstatuan të meta dhe mangësi si më poshtë:

Parregullsi në fushën e zbatimit të kërkesave të ligjit mineralar dhe akteve të tjera të Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë mbi zbatimin e kritereve mbi lejet mineralare dhe miratimi i planit vjetor për subjektet e licencuara.

Parregullsi në fushën e zbatimit të kërkesave të ligjit mineralar dhe akteve të tjera të Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë për periudhën objekt auditimi, mbi zbatimin e kritereve mbi lejet mineralare dhe miratimin e planit vjetor për subjektet e licencuara, pasi zotëruesit e lejeve mineralare nuk kanë paraqitur për miratim planin vjetor të veprimtarisë (ku të specifikohet sasia e prodhimit, shitjeve, vlera e investimeve, vlerat e garancive, në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij mineralare për çdo vit).

- Për vitin 2018, nga 597 subjekte gjithsej me leje shfrytëzimi, kanë miratuar planet vjetore 502, janë refuzuar për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar pranë organit përgjegjës 32 dhe kthim përgjigje (për pezullim të përkohshëm, leje të reja, mos heqje nga fondi pyjor, procese gjyqësore, etj.) 63 prej tyre;

- Për vitin 2019, nga 571 subjekte gjithsej me leje shfrytëzimi, kanë miratuar planet vjetore 427, janë refuzuar për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar pranë organit përgjegjës 63 dhe kthim përgjigje (për pezullim të përkohshëm, leje të reja, mos heqje nga fondi pyjor, procese gjyqësore, etj.) 81 prej tyre;

Për vitin 2020, nga 576 subjekte gjithsej me leje shfrytëzimi, kanë miratuar planet vjetore 424, janë refuzuar për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar pranë organit përgjegjës 59 dhe kthim përgjigje (për pezullim të përkohshëm, leje të reja, mos heqje nga fondi pyjor, procese gjyqësore, etj.) 32 prej tyre;

Për vitin 2021, nga 587 subjekte gjithsej me leje shfrytëzimi, kanë miratuar planet vjetore 493, janë refuzuar për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar pranë organit përgjegjës 36 dhe kthim përgjigje (për pezullim të përkohshëm, leje të reja, mos heqje nga fondi pyjor, procese gjyqësore, etj.) 49 prej tyre;

Tabela nr. 45

| Periudha | Minerale Metalore | | Minerale Jometalore | | Leje Subjekte me leje | Minerare Gjithsej Numri i planeve |
|----------|-------------------|-----------------|---------------------|-----------------|-----------------------|-----------------------------------|
| | Subjekte me leje | Numri i planeve | Subjekte me leje | Numri i planeve | | |
| | | | | | | |

| | shfrytëzimi | vjetore të miratuara | shfrytëzimi | vjetore të miratuara | shfrytëzimi | vjetore të miratuara |
|------|-------------|----------------------|-------------|----------------------|-------------|----------------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5=(1+3) | 6=(2+4) |
| 2018 | 303 | 293 | 294 | 264 | 597 | 557 |
| 2019 | 301 | 293 | 270 | 253 | 571 | 546 |
| 2020 | 303 | 232 | 273 | 192 | 576 | 424 |
| 2021 | 298 | 243 | 289 | 250 | 587 | 493 |

Burimi: AKBN, DM

Pretendimi Subjektit:

Duke iu referuar procedurave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit auditues, mendojmë se Komisioni i shqyrtimit të Planeve Vjetore të Punës ka zbatuar me korrektësi përcaktimet e rregullores përkatëse të miratuar me Urdhër të Drejtorit Ekzekutiv Nr. 9 me nr. Prot 694 datë 16.01.2018, si dhe rregullores së re të miratuar në fund të vitit 2021. Nr. 830/2 datë 15.11.2021. Për sa i përket konstatimit lidhur me numrin e lejeve (597) për vitin 2018, bëjmë të ditur se miratime janë dhënë për 557 leje dhe diferenca e lejeve që nuk kanë marrë miratim rezulton të jetë 40. Kjo situatë paraqitet e tillë për arsye se subjektet që i përkasin kësaj kategorie

- janë me statusin e “Pezullimit të Përkohshëm” nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas kërkesës së vetë subjekteve minerare në zbatim të Ligjit 10304 datë 15.07.2010 dhe nuk kanë paraqitur për miratim Planin Vjetor të Punës,

- nuk kanë bërë heqjen nga fondi pyjor dhe janë në vazhdim të procedurës,

- janë në procedurë revokimi, procedurë e cila ndiqet tërësisht nga MIE (edhe në këtë situatë, ka subjekte që i drejtohen AKBN-së me kërkesë për miratimin e Planit Vjetor të Punës i cili nuk miratohet. Në këtë rast subjektet njoftohen për qëndrimin e institucionit në lidhje me kërkesën e tyre,

- u ka mbaruar afati ligjor i lejes minerare.

Për sa i përket bashkisë “Dimal” qarku Berat në të cilën ndodhen 13 leje minerare shfrytëzimi, situata paraqitet si më poshtë:

2 subjekte kanë marrë miratimin e Planit Vjetor të Punës;

1 subjekti i ka mbaruar afati i lejes minerare;

10 subjekte nuk kanë marrë miratimin e Planit Vjetor të Punës pasi nuk kanë bërë heqjen nga fondi pyjor sipas kërkesave të ligjit.

Bejme të ditur se subjektet e mësipërme të cilat nuk kanë marrë miratimin e Planit Vjetor të Punës përbëjnë diferencën në numrin e lejeve.

Ju informojmë se e njëjta procedurë është ndjekur edhe gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021 ku komisioni ka marrë në shqyrtim dhe ka trajtuar çdo praktikë/dosje si dhe ka informuar në çdo rast subjektet për vendimmarrjen e institucionit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Observacioni i paraqitur nga DM pranë AKBN merret pjesërisht në konsideratë pasi grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni mbi rinovimin, pezullimin e përkohshëm, mbarimi afatit ligjor i lejes minerare, heqjen nga fondi pyjor etj.

| | |
|---------------------------------|---|
| Titulli i gjetjes Nr. 1: | Parregullsi në fushën e zbatimit të kërkesave të ligjit minerar dhe akteve të tjera të MIEmbi zbatimin e kritereve mbi lejet minerare dhe miratimin e planit vjetor për subjektet e licencuara, pasi zotëruesit e lejeve minerare |
|---------------------------------|---|

| | |
|-----------------|---|
| | nuk kanë paraqitur për miratim planin vjetor të veprimtarisë (ku të specifikohet sasia e prodhimit, shitjeve, vlera e investimeve, vlerat e garancive, në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit) |
| Situata: | <p>- Për vitin 2018, nga 597 subjekte gjithsej me leje shfrytëzimi, kanë miratuar planet vjetore 502, janë refuzuar për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar pranë organit përgjegjës 32 dhe kthim përgjigje (për pezullim të përkohshëm, leje të reja, mos heqje nga fondi pyjor, procese gjyqësore, etj.) 63 prej tyre;</p> <p>- Për vitin 2018, nga 571 subjekte gjithsej me leje shfrytëzimi, kanë miratuar planet vjetore 427, janë refuzuar për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar pranë organit përgjegjës 63 dhe kthim përgjigje (për pezullim të përkohshëm, leje të reja, mos heqje nga fondi pyjor, procese gjyqësore, etj.) 81 prej tyre;</p> <p>Për vitin 2020, nga 576 subjekte gjithsej me leje shfrytëzimi, kanë miratuar planet vjetore 424, janë refuzuar për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar pranë organit përgjegjës 59 dhe kthim përgjigje (për pezullim të përkohshëm, leje të reja, mos heqje nga fondi pyjor, procese gjyqësore, etj.) 32 prej tyre;</p> <p>Për vitin 2021, nga 587 subjekte gjithsej me leje shfrytëzimi, kanë miratuar planet vjetore 493, janë refuzuar për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar pranë organit përgjegjës 36 dhe kthim përgjigje (për pezullim të përkohshëm, leje të reja, mos heqje nga fondi pyjor, procese gjyqësore, etj.) 49 prej tyre;</p> |
| Kriteri: | <p>Vepruar në kundërshtim me kërkesat e pikës nr.1/ç, të Nenit 18 të Detyrimit e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumetö, të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 të Përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, sipas të cilit, zotëruesit e këtyre lejeve kanë detyrimin që të paraqesin për miratim planin vjetor në mënyrë të specifikuar vlerën e investimeve, vlerat e garancive, në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit, ku shprehimisht përcaktohet së zotëruesi i lejes duhet,</p> <p>• të paraqesë për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse një plan vjetor pune, të hartuar në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare, për çdo vit, jo më vonë së 30 ditë kalendrike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të lejes. Ky plan duhet të përmbajë në mënyrë të specifikuar kapacitetet e prodhimit, vlerën e investimeve, vlerat e garancive të përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji, në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit, të cilat miratohen nga strukturat përgjegjëse jo më vonë së 30 ditë nga data e paraqitjes së tyre. Në rast mosmiratimi, struktura përgjegjëse e njofton zotëruesin e lejes minerare për arsyet e këtij mosmiratimi. Nëse ajo nuk kthen përgjigje, pas tejkalimit të këtij afati, plani quhet i miratuar. Përmbajtja e planit të punës dhe dokumentet</p> |

| | |
|-----------------------|---|
| | e tjera të nevojshme që e shoqërojnë duhet të jetë në përputhje me aktet nënligjore të miratuara nga ministri; |
| Ndikimi/Efekti | Pasojat që vijnë nga shmangia e këtyre subjekteve nga përmbushja e detyrimit ligjor për dërgimin dhe miratimin e planeve mund të jenë të natyrës së risqeve të evacionit fiskal dhe ushtrimit të aktiviteti vjetor të palicensuar nga subjektet me leje shfrytëzimi duke nxitur konkurrencë të pandershme. |
| Shkaku | Si pasojë e neglizhencës së subjekteve të licencuara për të përmbushur detyrimet sipas ligjit. |
| Rëndësia | E lartë |
| Rekomandime | Drejtoria Minerare pranë AKBN-së dhe Komisioni i Shqyrtimit të Planeve Vjetore të Punës të bëjnë një përditësim për të gjitha subjektet që kanë leje shfrytëzimi minerar dhe situatën e tyre mbi miratimin e planit vjetor për subjektet e licencuara. Drejtoria Minerare pranë AKBN të marrë masa për zbatimin e sanksioneve që parashikohen në legjislacion nëse subjektet zotërues të lejeve minerare nuk paraqesin për miratim planin vjetor të veprimtarisë. |

Konstatim:

Nga auditimi u konstatuan parregullsi në fushën e zbatimit të kërkesave të ligjit minerar dhe akteve të tjera të Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë në vitet 2018- 2021, pasi konstatohet se nuk janë hartuar dhe dërguar në strukturën shtetërore përgjegjëse, informacionet tremujore dhe vjetore me treguesit mbirealizimprodhimit, investimeve, vlerëne produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejet e tyre të miratimit dhe planin vjetor të punës, vepruar kështu në kundërshtim me kërkesat e pikës b dhe c, të Nenit 25 të Detyrimit të zotëruesit të lejes së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, ku zotëruesit të lejes minerare kanë detyrimin që:

b) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo 3 muaj, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas tremujorit përkatës, një informacion mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor. Subjektet të cilat nuk paraqesin këtë informacion sanksionohen me 100,000 lekë sipas nenit 45 të kundërvajtjet administrative, pezullim dhe revokimi, pika nr.1, germa dçö

c) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo vit, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i vitit përkatës, raportin financiar dhe teknik të të gjitha operacioneve të kryera, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejet e tyre të miratimit dhe planin vjetor të punës. Subjektet të cilat nuk paraqesin këtë informacion sanksionohen me 150,000 lekë sipas nenit 45 të kundërvajtjet administrative, pezullim dhe revokimi, pika nr.1 germa dçö

Sanksionet e parashikuara në nenin nr. 45, të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë mund të ndërmerren nga struktura përgjegjëse, nëse nga data e kryerjes së shkeljes nuk ka kaluar një periudhë më e madhe se 5 vite kalendarike (neni nr. 45, pika nr. 2, ligji nr. 10304, datë 15.07.2010 për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë).

Pas shqyrtimit të dokumentacionit grupi i auditimit konstatoi së raportimet tre mujore dhe ato vjetore nuk janë kryer apo janë kryer me vonesë, pra në kundërshtim me kërkesat e pikës b dhe c, të Nenit 25 të Detyrimit e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë. Në këto raste strukturat përgjegjëse duhet të aplikojnë sanksionet e përcaktuara në nenin 45, pika 1, germa òç dhe d.

Nga dokumentacioni i servitur si dhe nga të dhënat e gjeneruara në Rev Zone, grupi i auditimit ka konstatuar së për periudhën objekt auditimi duhet të aplikoheshin sanksione për këto subjekte që nuk kanë raportuar si më poshtë:

Tabela nr. 46

| Pa raportuar (Raportimin Vjetor dhe tre mujor për vitin 2018) | | | |
|--|--|----------------------------|----------------------|
| Periudha | Nr. Subjekteve që nuk kanë raportuar. | Vlera Gjobës (Lekë) | Totali (Lekë) |
| RaportVjetor(2018) | 8 | 150,000.00 | 1,200,000.00 |
| RaportTreMujIII(2018) | 10 | 100,000.00 | 1,000,000.00 |
| RaportTreMujIV(2018) | 9 | 100,000.00 | 900,000.00 |
| Total(2018) | | | 3,100,000.00 |

| Pa raportuar (Raportimin Vjetor dhe tre mujor për vitin 2019) | | | |
|--|---|----------------------------|----------------------|
| Periudha | Nr.Subjekteve që nuk kanë raportuar. | Vlera Gjobës (Lekë) | Totali (Lekë) |
| RaportVjetor(2019) | 6 | 150,000.00 | 900,000.00 |
| RaportTreMujI(2019) | 5 | 100,000.00 | 500,000.00 |
| RaportTreMujII(2019) | 4 | 100,000.00 | 400,000.00 |
| RaportTreMujIII(2019) | 4 | 100,000.00 | 400,000.00 |
| RaportTreMujIV(2019) | 6 | 100,000.00 | 600,000.00 |
| | | Total(2019) | 2,500,000.00 |

| Pa raportuar (Raportimin Vjetor dhe tre mujor për vitin 2020) | | | |
|--|---|----------------------------|----------------------|
| Periudha | Nr.Subjekteve që nuk kanë raportuar. | Vlera Gjobës (Lekë) | Totali (Lekë) |
| RaportVjetor(2020) | 8 | 150,000.00 | 1,200,000.00 |
| RaportTreMujI(2020) | 15 | 100,000.00 | 1,500,000.00 |
| RaportTreMujII(2020) | 6 | 100,000.00 | 600,000.00 |
| RaportTreMujIII(2020) | 6 | 100,000.00 | 600,000.00 |
| RaportTreMujIV(2020) | 6 | 100,000.00 | 600,000.00 |
| Total(2020) | | | 4,500,000.00 |

| Pa raportuar (Raportimin Vjetor dhe tre mujor për vitin 2021) | | | |
|--|--|--|--|
|--|--|--|--|

| Periudha | Nr. Subjekteve që nuk kanë raportuar. | Vlera Gjobës (Lekë) | Totali (Lekë) |
|-----------------------|---------------------------------------|---------------------|---------------------|
| RaportVjetor(2021) | 5 | 150,000.00 | 750,000.00 |
| RaportTreMujI(2021) | 6 | 100,000.00 | 600,000.00 |
| RaportTreMujII(2021) | 7 | 100,000.00 | 700,000.00 |
| RaportTreMujIII(2021) | 9 | 100,000.00 | 900,000.00 |
| RaportTreMujIV(2021) | 3 | 100,000.00 | 300,000.00 |
| Total(2021) | | | 3,250,000.00 |

Burimi: Sektori Statistikave në DM, AKBN,

Gjithashtu nga dokumentacioni i servitur si dhe nga të dhënat e gjeneruara në Rev Zone, grupi i auditimit ka konstatuar së për periudhën objekt auditimi duhet të aplikoheshin sanksione për këto subjekte që kanë raportuar me vonesë si më poshtë:

Tabela nr. 47

| <i>Raportuar me vonesë (Raportimin Vjetor dhe tre mujor për vitin 2018)</i> | | | |
|---|--|---------------------|---------------------|
| Periudha | Nr. Subjekteve që kanë raportuar me vonesë | Vlera Gjobës (Lekë) | Totali (Lekë) |
| RaportVjetor(2018) | 10 | 150,000.00 | 1,500,000.00 |
| RaportTreMujIII(2018) | 7 | 100,000.00 | 700,000.00 |
| RaportTreMujIV(2018) | 5 | 100,000.00 | 500,000.00 |
| Total(2018) | | | 2,700,000.00 |

| <i>Raportuar me vonesë (Raportimin Vjetor dhe tre mujor për vitin 2019)</i> | | | |
|---|---|---------------------|---------------------|
| Periudha | Nr.Subjekteve që kanë raportuar me vonesë | Vlera Gjobës (Lekë) | Totali (Lekë) |
| RaportVjetor(2019) | 19 | 150,000.00 | 2,850,000.00 |
| RaportTreMujI(2019) | 16 | 100,000.00 | 1,600,000.00 |
| RaportTreMujII(2019) | 7 | 100,000.00 | 700,000.00 |
| RaportTreMujIII(2019) | 10 | 100,000.00 | 1,000,000.00 |
| RaportTreMujIV(2019) | 3 | 100,000.00 | 300,000.00 |
| Total(2019) | | | 6,450,000.00 |

| <i>Raportuar me vonesë (Raportimin Vjetor dhe tre mujor për vitin 2020)</i> | | | |
|---|---|---------------------|---------------------|
| Periudha | Nr.Subjekteve që kanë raportuar me vonesë | Vlera Gjobës (Lekë) | Totali (Lekë) |
| RaportVjetor(2020) | 11 | 150,000.00 | 1,650,000.00 |
| RaportTreMujI(2020) | 8 | 100,000.00 | 800,000.00 |
| RaportTreMujII(2020) | 11 | 100,000.00 | 1,100,000.00 |
| RaportTreMujIII(2020) | 12 | 100,000.00 | 1,200,000.00 |
| RaportTreMujIV(2020) | 7 | 100,000.00 | 700,000.00 |
| Total(2020) | | | 5,450,000.00 |

| Raportuar me vonesë (Raportimin Vjetor dhe tre mujor për vitin 2021) | | | |
|---|---|-----------------------------|----------------------|
| Periudha | Nr. Subjekteve që kanë raportuar me vonesë | Vlera Gjorbës (Lekë) | Totali (Lekë) |
| RaportVjetor(2021) | 2 | 150,000.00 | 300,000.00 |
| RaportTreMujI(2021) | 5 | 100,000.00 | 500,000.00 |
| RaportTreMujII(2021) | 2 | 100,000.00 | 200,000.00 |
| RaportTreMujIII(2021) | 21 | 100,000.00 | 2,100,000.00 |
| RaportTreMujIV(2021) | 12 | 100,000.00 | 1,200,000.00 |
| Total(2021) | | | 4,300,000.00 |

Burimi: Sektori Statistikave në DM, AKBN,

Në mënyrë më të detajuar në aneksin nr. 1

Pretendimi Subjektit:

Viti 2021

Lidhur me këtë gjetje si dhe duke iu referuar qëndrimin të grupit auditues se “nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se asnjë subjekt nuk ka bërë raportimin 6 mujor, por vetëm raportime tremujore”, (faqe 122), bëjmë me dije se:

Bazuar në ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 20, pika 3 “Format e raportimit përshkruhen në aktet nënligjore që miratohen nga ministri”, bëjmë të ditur se formati për raportimin në afat për 6 mujorin e dytë viti 2021, nuk ju është ofruar subjekteve minerare për zbatim, pasi ky format nuk është miratuar ende nga ministri i linjës.

Në vijim të sa më sipër, mendojmë se, për periudhën kohore, nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 65/2021, tremujori i tretë dhe i katërt, viti 2021, subjektet minerare, të renditura në tabelat e mëposhtme nr.1, nr.2, nr. 3 dhe nr.4, kanë vepruar në përputhje me procedurat përkatëse ligjore në fuqi në momentin e paraqitjes së raportimeve në fjalë pranë strukturës përgjegjëse (AKBN). Për rrjedhojë nuk duhet të vlerësohen shkelës të detyrimeve ligjore në realizimin e raportimeve 3-mujore.

Në tabelat e paraqitura nga ana e grupit të auditimit, për tremujorin e tretë dhe të katërt, të bëhen disa saktësime në tabelat e paraqitura në aneksin nr.1.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Observacioni i paraqitur nga DM pranë AKBN nuk merret në konsideratë pasi sipas informacionit të marrë nga Sektori Statistikave në DM pranë AKBN raportimet janë bërë 3 mujore dhe vjetore deri në fund të vitit 2021.

Edhe në rastin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 65/2021, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i shpallur në fletoren zyrtare nr.107, date 06.07.2021, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se asnjë subjekt nuk ka bërë raportimin 6 mujor por vetëm raportime 3 mujore,

Gjithashtu edhe përsa i përket pretendimeve të AKBN-së për subjektet që kanë raportuar brënda afatit në tabelat e paraqitura në aneksin nr. 1, nuk merret në konsideratë pasi Grupit të auditimit nuk I është vënë në dispozicion asnjë dokument që vërteton deklarin e këtyre subjekteve brënda afatit gjatë periudhës së auditimit dhe as në observacionet e bëra nga AKBN nuk janë shoqëruar me këto dokumenta që vërtetojnë deklarin e këtyre subjekteve brënda afatit të

përcaktuar nëligjin nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”

Pretendimi Subjektit:

Viti 2020,

Për sa i përket vitit 2020, duke vlerësuar qëndrimin e grupit auditues i cili ka marrë pjesërisht në konsideratë komentet dhe sqarimet e AKBN-së, sjellim në vëmendjen se ky vit u karakterizua nga një situatë jo normale mbarëbotërore për shkak të pandemisë Covid-19.

Shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore me VKM-së nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” dhe zbatimimi i masave kufizuese të vendosura nga institucionet shëndetësore sollën pasoja si në sektorin shtetëror ashtu edhe në atë privat të cilat u shoqëruan me ndërprerje apo punë me staf të kufizuar, bllokim apo/dhe kufizim të komunikimeve tregtare etj.

Pavarësisht sa më sipër, sqarojmë se në tabelën nr. 1, nga 15 subjekte gjithsej, 8 (tetë) subjekte janë me statusin e raportimit jashtë afatit ligjor. Këto subjekte nga ana e grupit të auditimit janë paraqitur të përsëritura dy herë, (në tabelën nr.1 “Subjektet që nuk kanë bërë raportimin për tremujorin e I-rë 2020, edhe në tabelën raportimet jashtë afatit për tremujorin e parë 2020).

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Observacioni i paraqitur nga DM pranë AKBN merret pjesërisht në konsideratë pasi shumë subjekte e kanë bërë raportimin me vonesë, pra mundësia për të bërë raportimet online qëndronte.

Gjithashtu edhe për sa i përket pretendimeve të AKBN-së që nga 15 subjekte gjithsej, 8 (tetë) subjekte janë paraqitur edhe në tabelën e mos raportimit për tre muajorin e parë të vitit 2020 por edhe në tabelën e raportimit me vonesë për të njëjtën periudhë observacioni merret në konsideratë poasi e dokumentoj se nga ana e AKBN-së ky informacion është raportuar gjithashtu dy herë për të njëjtën periudhë për këto tetë subjekte.

Pretendimi Subjektit:

Për vitet 2018 & 2019, është fakt se nuk janë vendosur sanksione ndaj shkeljeve të konstatuara.

Në zbatim të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 45 “Kundërvajtjet administrative”, pika 2, meqenëse nga data e kryerjes së shkeljes nuk ka kaluar një periudhë më e madhe se 5 vite kalendrike, ndodhemi brenda afateve për të realizuar plotësimin e procedurave ligjore. Jemi në pritje për tu njohur edhe me vlerësimin e realizuar nga ana juaj për shkeljet e konstatuara në raportimet e bëra nga subjektet minerare në vitet 2018 & 2019, për të plotësuar procedurat në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Për sa i përket pretendimeve të AKBN-së për subjektet që kanë raportuar brenda afatit në tabelat e paraqitura në aneksin nr. 1, nuk merret në konsideratë pasi Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokument që vërteton deklarin e këtyre subjekteve brenda afatit gjatë periudhës së auditimit dhe as në observacionet e bëra nga AKBN nuk janë shoqëruar me këto dokumenta që vërtetojnë deklarin e këtyre subjekteve brenda afatit të përcaktuar nëligjin nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”

| | |
|--|--|
| <p>Titulli i gjetjes Nr. 2:</p> | <p>Parregullsi në fushën e zbatimit të kërkesave të ligjit mineralar dhe akteve të tjera të Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë në vitet 2018-2021, pasi konstatohet së nuk janë hartuar dhe dërguar në strukturën shtetërore përgjegjëse, informacionet tremujore dhe vjetore me treguesit mbirealizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare në përputhje me detyrimet e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë, ku zotëruesit e lejes minerare kanë detyrimin që:</p> <p>b) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo 3 muaj, jo më vonë së data 15 e muajit që vijon pas tremujorit përkatës, një informacion mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor. Subjektet të cilat nuk paraqesin këtë informacion sanksionohen me 100,000 lekë sipas nenit 45 kundërvajtjet administrative, pezullim idhere vokimi, pika nr.1, germa oç o</p> <p>c) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo vit, jo më vonë së 30 ditë nga përfundimi i vitit përkatës, raportin financiar dhe teknik të të gjitha operacioneve të kryera, në përputhje me detyrimet e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë. Në këto raste strukturat përgjegjëse duhet të aplikojnë sanksionet e përcaktuara në nenin 45, pika 1, germa oç dhe d o.</p> <p>Nga dokumentacioni i servitur si dhe nga të dhënat e gjeneruara në Rev Zone, grupi i auditimit ka konstatuar së për periudhën objekt auditimi duhet të aplikoheshin sanksione për këto subjekte që nuk kanë raportuar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Subjektet që në vitin 2018 (tre mujorin III dhe IV) nuk kanë raportuar (Raportin vjetor dhe tremujor) janë 27 subjekte për të cilat sanksionet shkojnë 3,100,000 lekë. - Subjektet që në vitin 2019 nuk kanë raportuar (Raportin vjetor dhe tremujor) janë 25 subjekte për të cilat sanksionet shkojnë 2,500,000 lekë. |
| <p>Situata:</p> | <p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit grupi i auditimit konstatoi së raportimet tre mujore dhe ato vjetore nuk janë kryer apo janë kryer me vonesë, pra në kundërshtim me kërkesat e pikës b dhe c, të Nenit 25 të Detyrimit e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë. Në këto raste strukturat përgjegjëse duhet të aplikojnë sanksionet e përcaktuara në nenin 45, pika 1, germa oç dhe d o.</p> <p>Nga dokumentacioni i servitur si dhe nga të dhënat e gjeneruara në Rev Zone, grupi i auditimit ka konstatuar së për periudhën objekt auditimi duhet të aplikoheshin sanksione për këto subjekte që nuk kanë raportuar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Subjektet që në vitin 2018 (tre mujorin III dhe IV) nuk kanë raportuar (Raportin vjetor dhe tremujor) janë 27 subjekte për të cilat sanksionet shkojnë 3,100,000 lekë. - Subjektet që në vitin 2019 nuk kanë raportuar (Raportin vjetor dhe tremujor) janë 25 subjekte për të cilat sanksionet shkojnë 2,500,000 lekë. |

| | |
|-----------------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Subjektet që në vitin 2020 nuk kanë raportuar (Raportin vjetor dhe tremujor) janë 41 subjekte për të cilat sanksionet shkojnë 4,500,000 lekë. - Subjektet që në vitin 2020 nuk kanë raportuar (Raportin vjetor dhe tremujor) janë 30 subjekte për të cilat sanksionet shkojnë 3,250,000 lekë. - Subjektet që në vitin 2018 (tre mujorin III dhe IV) kanë raportuar me vonesë (Raportin vjetor dhe tremujor) janë 22 subjekte për të cilat sanksionet shkojnë 2,700,000 lekë. - Subjektet që në vitin 2019 kanë raportuar me vonesë (Raportin vjetor dhe tremujor) janë 55 subjekte për të cilat sanksionet shkojnë 6,450,000 lekë. - Subjektet që në vitin 2020 kanë raportuar me vonesë (Raportin vjetor dhe tremujor) janë 49 subjekte për të cilat sanksionet shkojnë 5,450,000 lekë. - Subjektet që në vitin 2021 kanë raportuar me vonesë (Raportin vjetor dhe tremujor) janë 42 subjekte për të cilat sanksionet shkojnë 4,300,000 lekë. |
| Kriteri: | <p>Vepruar në kundërshtim me kërkesat e pikës b dhe c, të Nenit 25 të Detyrimit e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineralevendërtimore të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë, ku zotëruesit e lejes minerare kanë detyrimin që:</p> <p>b) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo 3 muaj, jo më vonë së data 15 e muajit që vijon pas tremujorit përkatës, një informacion mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor. Subjektet të cilat nuk paraqesin këtë informacion sanksionohen me 100,000 lekë sipas nenit 45 të kundërvajtjet administrative, pezullim dhe revokimi, pika nr.1, germa dço</p> <p>c) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo vit, jo më vonë së 30 ditë nga përfundimi i vitit përkatës, raportin financiar dhe teknik të të gjitha operacioneve të kryera, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare dhe planin vjetor të punës. Subjektet të cilat nuk paraqesin këtë informacion sanksionohen me 150,000 lekë sipas nenit 45 të kundërvajtjet administrative, pezullim dhe revokimi, pika nr.1 germa ddo</p> |
| Ndikimi/Efekti | Pasojat që vijnë nga shmangia e këtyre subjekteve duke mos kryer raportimin vjetor apo tre mujor gjenerojnë pasaktësi në statistikat e AKBN-së si dhe mos respektimin e atyre ligjore dhe nënligjore nga ana e subjekteve që disponojnë leje minerare. |
| Shkaku | Si pasojë e neglizhencës së subjekteve të licencuara për të përmbushur detyrimet sipas ligjit. |
| Rëndësia | E lartë |
| Rekomandime | Drejtoria Minerare pranë AKBN-së të marrë masa për zbatimin e sanksioneve që parashikohen në legjislacion për subjektet zotërues të lejeve minerare të cilat nuk kanë kryer raportimet vjetore apo tre mujore |

apo i kanë bërë këto raportime me vonesë.

Konstatim:

Grupi i auditimit konstatoi së për periudhën objekt auditimi mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive dhe aktivitetit minerar të raportuar nga subjektet e licencuara dhe zbatimi i kërkesave të legjislacionit minerar jo vetëm që nuk është ushtruar i plotë dhe 2 herë në vit, por për shumë subjekte nuk janë kryer fare kontrole dhe inspektime, në shkelje të dispozitave të këtij ligji. Për sa sipër, nuk ka gjetur zbatim neni 43, i ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, dhe neni 16, pikat 6-9 të Statut-Rregullores së AKBN për ushtrimin e kontroleve e inspektimeve pasi, për periudhën objekt auditimi nuk i janë nënshtruar skemës së mbikëqyrjes dhe inspektimit për subjekte të licencuar në fushën e shfrytëzimit të pasurive minerare metalore dhe jometalore, ndërkohë që detyrimi ligjor është që duhet ti nënshtrohen monitorimit dhe inspektimit dy herë brenda një viti. Konkretisht, situata paraqitet si vijon:

Tabela nr. 48

| Periudha | Minerale Metalore | | Minerale Jometalore | |
|----------------------|------------------------------|---|------------------------------|---|
| | Subjekte me leje shfrytëzimi | Aktivitete të pa kontrolluara gjatë vitit | Subjekte me leje shfrytëzimi | Aktivitete të pa kontrolluara gjatë vitit |
| 2018 | 303 | 65 | 294 | 50 |
| 2019 | 301 | 97 | 270 | 35 |
| 2020 (gjashtëmuorII) | 303 | 53 | 273 | 7 |
| 2021 | 298 | 76 | 289 | 38 |

Burimi: AKBN, Raportet Vjetore

Subjekti nuk ka bërë observacion mbi konstatimin e grupit të auditimit

| | |
|---------------------------------|---|
| Titulli i gjetjes Nr. 3: | Nuk është kryer mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive dhe aktivitetit minerar të raportuar nga subjektet e licencuara, në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore në fuqi, pasi për vitet 2018-2019 nuk i janë nënshtruar skemës së mbikëqyrjes dhe inspektimit 247 subjekte të licencuar në fushën e shfrytëzimit të pasurive minerare metalore dhe jometalore, ndërkohë që detyrimi ligjor është që duhet ti nënshtrohen monitorimit dhe inspektimit dy herë brenda një viti. |
| Situata: | Grupi i auditimit konstatoi së për periudhën objekt auditimi mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive dhe aktivitetit minerar të raportuar nga subjektet e licencuara dhe zbatimi i kërkesave të legjislacionit minerar jo vetëm që nuk është ushtruar i plotë dhe 2 herë në vit, por për shumë subjekte nuk janë kryer fare kontrole dhe inspektime, në shkelje të dispozitave të këtij ligji. Për sa sipër, nuk ka gjetur zbatim neni 43, i ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, dhe neni 16, pikat 6-9 të Statut-Rregullores së AKBN për ushtrimin e kontroleve e inspektimeve pasi, për periudhën objekt auditimi nuk i janë nënshtruar skemës së mbikëqyrjes dhe inspektimit për subjekte të licencuar në fushën e shfrytëzimit të pasurive minerare metalore dhe jometalore, ndërkohë që detyrimi ligjor është që |

| | |
|-----------------------|--|
| | <p>duhet ti nënshtrohen monitorimit dhe inspektimit dy herë brenda një viti. Konkretisht, situata paraqitet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitin 2018, nga 303 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale metalore janë kontrolluar 238 subjekte dhe 65 nuk janë kontrolluar asnjë herë. - Për vitin 2018, nga 294 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale jo metalore(ndërtimore) janë kontrolluar 244 subjekte dhe 50 nuk janë kontrolluar asnjë herë. - Për vitin 2019, nga 301 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale metalore janë kontrolluar 204 subjekte dhe 97 nuk janë kontrolluar asnjë herë. - Për vitin 2019, nga 270 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale jo metalore(ndërtimore) janë kontrolluar 235 subjekte dhe 35 nuk janë kontrolluar asnjë herë. - Për vitin 2020, nga 303 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale metalore janë kontrolluar 53 subjekte dhe 250 nuk janë kontrolluar asnjë herë. - Për vitin 2020, nga 273 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale jo metalore(ndërtimore) janë kontrolluar 266 subjekte dhe 7 nuk janë kontrolluar asnjë herë. - Për vitin 2021, nga 298 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale metalore janë kontrolluar 222 subjekte dhe 76 nuk janë kontrolluar asnjë herë. - Për vitin 2021, nga 289 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale jo metalore (ndërtimore) janë kontrolluar 251 subjekte dhe 38 nuk janë kontrolluar asnjë herë. |
| Kriteri: | <p>Nga auditimi rezulton së nuk ka gjetur zbatim neni 43/pika 3, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, që sanksionon së pas inspektimeve të detyrueshme dy herë në vit,ò Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare, i cili përmban të dhëna për:</p> <p>a) respektimin e realizimit të projektit minerar; b) realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare; c) lëvizjen e rezervave minerare; ç) kryerjen e operacioneve minerare, në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar, duke u këshilluar me njësitë qeverisjes vendore të zonës minerarë si dhe neni 16, pikat 6-9 të Statut-Rregullores së AKBN për ushtrimin e kontrolleve dhe inspektimeve.</p> |
| Ndikimi/Efekti | <p>Pasojat që vijnë nga mos kryerja dy herë në vit e inspektimeve në terren pranë subjekteve të licencuara, krijojnë rrisje të evazionit fiskal dhe ushtrimin të aktivitetit vjetor të palicencuar nga subjektet me leje shfrytëzimi, duke nxitur konkurrencë të pandershme.</p> |
| Shkaku | <p>Si pasojë e mungesës së kapaciteteve dhe logjistikës së pa mjaftueshme për të përmbushur detyrimet sipas ligjit.</p> |
| Rëndësia | <p>E lartë</p> |

| | |
|--------------------|---|
| Rekomandime | <p>-Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv i AKBN të analizojnë rastet për të cilat nuk janë bërë monitorimet dhe në përputhje me përcaktimet e Statut-Rregullores së AKBN, t'aj propozojnë ministrin të Infrastrukturës dhe Energjisë ndryshimet e nevojshme në lidhje me kapacitetet e burimeve njerëzore dhe strukturën organizative të Drejtorisë Minerare në AKBN në funksion të mbikëqyrjes dhe monitorimit të subjekteve me leje shfrytëzimi.</p> <p>-AKBN të marrë masa për përcaktimin në planin vjetor të monitorimit dy here në vit, të të gjithë subjekteve minerare, si dhe dhe inicimime inspektive dhe kontroleve të subjekteve në terren me grupe të përbashkëta me përfaqësues të Drejtorive Rajonale të Tatimeve, me qëllim saktësimin e treguesve të vetë raportuar nga subjektet e licencuar në sistemin elektronik, dhe përlllogaritjet e efekteve të mundshme për buxhetin e shtetit.</p> |
|--------------------|---|

Konstatim:

Parregullsi dhe pasaktësi në të dhënat e evidencës statistikore, pasi evidenca vjetore për veprimtarinë e aktivitetit prodhues dhe tregtar të shoqërive që zotërojnë leje shfrytëzimi minerar nuk është plotësuar me të gjithë treguesit kryesorë të prodhimit, të shitjes, të ardhurat e realizuara dhe renta e paguar, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014.

Referuar data bazës së të dhënave mbi vetë-deklarimet për periudhën objekt auditimi rezulton së një numër i konsiderueshëm i subjekteve nuk kanë vetë-deklaruar asnjë të dhënë dhe nuk kanë raportuar rregullisht, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga Neni 15 òLeja e shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumetö dhe nenit 19 të ligjit minerar, ku zotëruesit e këtyre lejeve kanë detyrimin që, të hartojnë dhe dërgojnë në strukturën përgjegjëse informacionet tremujore me treguesit mbi realizimin e investimeve, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin progresiv të mjedisit përkatësisht sipas viteve dhe për vitin 2021 sipas tremujorëve:

- Për vitin 2018 nga 600 rekorde që përfshin matrica e data bazës së të dhënave të AKBN,
 - nuk ka asnjë të dhënë nga 6 subjekte.
 - 136 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve
 - 154 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve me sigurim jete
 - 6 subjekte edhe pse kanë bërë shitje brenda vendit ose kanë patur eksporte nuk kanë deklaruar pagesën e rentës minerare
- Për vitin 2019 nga 574 rekorde që përfshin matrica e data bazës së të dhënave të AKBN,
 - nuk ka asnjë të dhënë nga 58 subjekte.
 - 116 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve
 - 138 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve me sigurim jete

- 2 subjekte edhe pse kanë bërë shitje brenda vendit ose kanë patur eksporte nuk kanë deklaruar pagesën e rentës minerare

Për vitin 2020 nga 554 rekorde që përfshin matrica e data bazës së të dhënave të AKBN,

- nuk ka asnjë të dhënë nga 62 subjekte.

- 88 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve

- 100 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve me sigurim jete

- 2 subjekte edhe pse kanë bërë shitje brenda vendit ose kanë patur eksporte nuk kanë deklaruar pagesën e rentës minerare

• Për vitin 2021 nga 561 rekorde që përfshin matrica e data bazës së të dhënave të AKBN,

- nuk ka asnjë të dhënë nga 69 subjekte.

- 139 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve

- 157 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve me sigurim jete

- 40 subjekte edhe pse kanë bërë shitje brenda vendit ose kanë patur eksporte nuk kanë deklaruar pagesën e rentës minerare.

Pretendimi Subjektit:

Nga sa konstatohet nga grupi i auditimit, subjektet, pavarësisht arsyeve, bëjnë shumë gabime në plotësimin e të dhënave sipas formularëve të miratuar.

Ka raste që subjektet raportojnë në të gjitha rubrikat 0,0. Raportime bëjnë edhe ato që janë të revokuara, ose janë me pezullim të përkohshëm të aktivitetit të shfrytëzimit. Në rastin e ndonjë subjekti, që është në aktivitet dhe ka raportuar 0,0 menjëherë nga specialistët e zyrës komunikohet me subjektin dhe reflektohen plotësimet e nevojshme.

Edhe në rastin kur konstatohet se në tabelën e informimit ka të meta, jo vetëm në plotësimin e rubrikave, por shpesh edhe në fryrjen artificiale të shifrave duke kaluar nga lekë në dollarë e anasjelltas, nga shifra /000 në /000000, specialistët e institucionit i kontaktojnë dhe i orientojnë subjektet për përmirësimin e raportimit. Që nga fillimi i vitit 2022, janë marrë masat për standardizimin e formës së mbajtjes së të dhënave lidhur me aktivitetin minerar, për të pasur gjithmonë një monitorim të vazhdueshëm dhe efektiv të këtij sektori.

Njëkohësisht ne vlerësojmë se është e nevojshme që nga ana jonë si struktura përgjegjëse të merren këto masa:

• *Nëpërmjet programit RevZone, t'u dërgohet subjekteve manuali i përdorimit të këtij programi për njohje e zbatim.*

• *Formati i informacionit të thjeshtohet, të jetë sa më i qartë në leximin e plotësimin e rubrikave.*

• *Të rritet kërkesa ndaj subjekteve për t'u ndërgjegjësuar për rëndësinë që ka raportimi i saktë i të dhënave duke dalë nga konturet e formaliteteve.*

(Subjekti pranon konstatimin e Grupit të auditimit)

| | |
|-------------------------------------|--|
| Titulli i gjetjes Nr. 4: | Parregullsi dhe pasaktësi në të dhënat e evidencës statistikore, pasi informacioni vjetor për veprimtarinë e aktivitetit prodhues dhe tregtar të shoqërive që zotërojnë leje shfrytëzimi minerar nuk është plotësuar me të |
|-------------------------------------|--|

| | |
|------------------------|--|
| | <p>gjithë treguesit kryesorë të prodhimit, të shitjes, të ardhurat e realizuara dhe renta e paguar, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014.</p> |
| <p>Situata:</p> | <p>Referuar data bazës së të dhënave mbi vetë-deklarimet për periudhën objekt auditimi rezulton së një numër i konsiderueshëm i subjekteve nuk kanë vetë-deklaruar asnjë të dhënë dhe nuk kanë raportuar rregullisht, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga Neni 15 òLeja e shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumetò dhe nenit 19 të ligjit mineralar, ku zotëruesit e këtyre lejeve kanë detyrimin që, të hartojnë dhe dërgojnë në strukturën përgjegjëse informacionet tremujore me treguesit mbi realizimin e investimeve, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin progresiv të mjedisit përkatësisht sipas viteve dhe për vitin 2021 sipas tremujorëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për vitin 2018 nga 600 rekorde që përfshin matrica e data bazës së të dhënave të AKBN, <ul style="list-style-type: none"> - nuk ka asnjë të dhënë nga 6 subjekte. - 136 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve - 154 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve me sigurim jete - 6 subjekte edhe pse kanë bërë shitje brenda vendit ose kanë patur eksporte nuk kanë deklaruar pagesën e rentës minerare • Për vitin 2019 nga 574 rekorde që përfshin matrica e data bazës së të dhënave të AKBN <ul style="list-style-type: none"> - nuk ka asnjë të dhënë nga 58 subjekte. - 116 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve - 138 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve me sigurim jete - 2 subjekte edhe pse kanë bërë shitje brenda vendit ose kanë patur eksporte nuk kanë deklaruar pagesën e rentës minerare • Për vitin 2020 nga 554 rekorde që përfshin matrica e data bazës së të dhënave të AKBN, <ul style="list-style-type: none"> - nuk ka asnjë të dhënë nga 62 subjekte. - 88 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve - 100 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve me sigurim jete - 2 subjekte edhe pse kanë bërë shitje brenda vendit ose kanë patur eksporte nuk kanë deklaruar pagesën e rentës minerare • Për vitin 2021 nga 561 rekorde që përfshin matrica e data bazës së të dhënave të AKBN, <ul style="list-style-type: none"> - nuk ka asnjë të dhënë nga 69 subjekte. - 139 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve - 157 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve me sigurim jete - 40 subjekte edhe pse kanë bërë shitje brenda vendit ose kanë patur eksporte nuk kanë deklaruar pagesën e rentës minerare |

| | |
|-----------------------|---|
| Kriteri: | Është vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 36, pika 11, të Detyrimit e përgjithshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë minerare, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar, ku përcaktohet se operatorët ekonomikë me leje shfrytëzimi duhet, “të realizojë dhe të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse informacionet tremujore mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetorë. |
| Ndikimi/Efekti | Pasojat që vijnë nga mos kryerja dy herë në vit e inspektimeve në terren pranë subjekteve të licensuara, krijojnë risqeve të evazionit fiskal dhe ushtrimit të aktiviteti vjetor të palicensuar nga subjektet me leje shfrytëzimi, duke nxitur konkurrencë të pandershme. |
| Shkaku | Pasojat që vijnë nga shmangia e këtyre subjekteve nga përmbushja e detyrimit ligjor për dërgimin tek DM/ AKBN të raportimeve periodike dhe vjetore, mund të jenë të natyrës së risqeve të evazionit fiskal dhe ushtrimit të aktiviteti vjetor të palicensuar nga subjektet me leje shfrytëzimi duke nxitur konkurrencë të pandershme. |
| Rëndësia | E Mesme |
| Rekomandime | Drejtoria Minerare pranë AKBN-së të marrë masa dhe të informojë operatorët ekonomikë me leje shfrytëzimi se duhet të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse informacionet tremujore mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetorë. |

Konstatim:

Referuar të dhënave dokumentare të AKBN, konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi ka një rritje të sasive të kromeve të varfra dhe koncentrateve të kromit, të përpunuara në fabrikat e pasurimit, ku numri i tyre ka rritur në 17, përkatësisht:

- 7 impiante pasurimi për mineralin e Kromit në Bashkinë Bulqizë;
- 3 impiante pasurimi për mineralin e Kromit në Bashkinë Kukës;
- 2 impiante pasurimi për mineralin e Kromit në Bashkinë Has;
- 1 impiant pasurimi për mineralin e Kromit në Bashkinë Librazhd;
- 1 impiant pasurimi për mineralin e Kromit në Bashkinë Përrenjas;
- 2 impiante pasurimi për mineralin e Bakrit në Bashkinë Fushë - Arrëz;

Tabela nr. 49

| Emri Fabrikës | Minerali | Bashkia |
|----------------------|-----------------|----------------|
| Fabrika PK | Krom | Bulqizë |
| Fabrika T | Krom | Bulqizë |
| Fabrika T | Krom | Bulqizë |
| MLK | Krom | Bulqizë |
| YQB | Krom | Burrel |
| Fabrika B | Krom | Bulqizë |

| | | |
|----------------|-------|---------------|
| Fabrika PK | Krom | Kukës |
| Fabrika P P | Krom | Has |
| V D | Krom | Has |
| K C | Krom | Kukës |
| "ECK | Krom | Kukës |
| Fabrika L | Krom | Bulqiz |
| Fabrika PK | Krom | Prrenjas |
| Farbrika M L | Krom | Bulqiz |
| Fabrika L | Krom | Librazhd |
| Fabrika P B | Bakër | Fushë - Arrëz |
| Fabrika Pt B S | Bakër | Fushë - Arrëz |

Burimi: AKBN, DM

Grupi i auditimit ka konstatuar për periudhën e audituar nga KLSH rezultojnë se nuk janë përfshirë asnjëherë në skemën e inspektimit, monitorimit dhe kontrollit nga struktura përgjegjëse shtetërore (AKBN), të 17 impianteve të pasurimit / fabrikat e pasurimit që kanë përpunuar krome të varfra dhe koncentrate të kromit, vepruar kështu në kundërshtim me kërkesat e në përcaktimet e nenit 1 dhe nenit 2, të ligjit Nr. 10304, datë 15.7.2010 për sektorin mineral në RSHö, i ndryshuar janë përcaktimet e mëposhtme që,

oKy ligj përcakton rregullat për zhvillimin e veprimtarive minerare e postminerare...ö, dhe së "Veprimtari minerare" janë veprimtaritë e kërkimit, të zbulimit, të shfrytëzimit, të përpunimit, të mbylljes, të konservimit dhe të rehabilitimit të mjedisit mineral.

Dhe në pikën nr. 12 të nenit 2, ku cilësohet së,

"Përpunim mineral" është trajtimi i mineralit/mineraleve, të nxjerra nga një minierë ose karrierë, nëpërmjet çdo procesi apo kombinimi procesesh, të cilave u nënshtrohen minerali/mineralet deri në formën e produktit të shitshëm.

Subjekti pranon konstatimin e Grupit të auditimit.

| | |
|---------------------------------|--|
| Titulli i gjetjes Nr. 5: | Për periudhën objekt audituar nga rezultojnë se nuk janë përfshirë asnjëherë në skemën e inspektimit, monitorimit dhe kontrollit nga struktura përgjegjëse shtetërore (AKBN), asnjë nga 17 impiantet e pasurimit / fabrikat e pasurimit që kanë përpunuar mineralet e kromit apo bakrit. |
| Situata: | Referuar të dhënave dokumentare të AKBN, konstatohet së gjatë periudhës objekt auditimi ka një rritje të sasive të mineraleve të kromit dhe të bakrit, të përpunuara në fabrikat e pasurimit, ku numri i tyre në rang vendi ka arritur në 17 impiante / fabrika. |
| Kriteri: | Vepruar në kundërshtim me kërkesat e në përcaktimet e nenit 1 dhe nenit 2, të ligjit Nr. 10304, datë 15.7.2010 për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar në të cilin janë përcaktimet e mëposhtme që: oKy ligj përcakton rregullat për zhvillimin e veprimtarive minerare e postminerare...ö, dhe së "Veprimtari minerare" janë veprimtaritë e kërkimit, të zbulimit, të shfrytëzimit, të përpunimit, të mbylljes, të konservimit dhe të |

| | |
|-----------------------|---|
| | rehabilitimit të mjedisit mineralar. Dhe në pikën nr. 12 të nenit 2, cilësohet së, "Përpunim mineralar" është trajtimi i mineralit/mineraleve, të nxjerra nga një minierë ose karrierë, nëpërmjet çdo procesi apo kombinimi procesesh, të cilave u nënshtrohen minerali/mineralet deri në formën e produktit të shitshëm. |
| Ndikimi/Efekti | Pasojat që vijnë nga shmangia dhe mos përfshirja asnjëherë në skemën e inspektimit, monitorimin dhe kontrollit nga struktura përgjegjëse shtetërore (AKBN), të 17 impianteve të pasurimit / fabrikat e pasurimit që kanë përpunuar dhe pasuruar mineralet e kromit dhe bakrit, mund të krijojë risqet e pasaktësive të raportimit të sasive të mineralit të përpunuar dhe shitur nga ana e subjekteve që zotërojnë leje të shfrytëzimit mineralar. |
| Shkaku | Si pasojë e mosveprimeve nga struktura shtetërore përgjegjëse për të përmbushur detyrimet sipas ligjit. |
| Rëndësia | E Lartë |
| Rekomandime | AKBN të marrë masa për përmirësimet e duhura në Statut-Rregulloren e funksionimit të AKBN-së në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 547, datë 09.08.2006, pika 7, për të normuar detyrimin e kontrollit prej strukturës së Drejtorisë Minerare, të fabrikave të pasurimit të mineraleve, duke e shoqëruar këtë veprim me masat për rekrutimin në përbërje të Drejtorisë Minerare të inxhinierëve të pasurimit. Të merren masa për planifikimin e kryerjes me përparësi të inspektimeve për impiantet e pasurimit, të cilat janë subjekte të licencuara, në bashkëpunim me strukturat tatimore vendore, për të konfirmuar nëpërmjet akt-konstatimeve në terren të saktësisë së deklarimeve të këtyre subjekteve, mbi gjendjen e stokut të prodhimit, duke krahasuar dhe rakorduar të dhënat dhe informacionet periodike e raportimet vjetore të subjekteve të licencuar mbi sasitë e mineralit të përpunuar dhe pasuruar për qëllim tregtimi. |

Konstatim:

Grupi i auditimit ka konstatuar së mungojnë kontrollet, inspektimet dhe vlerësimet e përbashkëta në terren me përfaqësues të AKBN/DM dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, ku ushtrojnë aktivitetin subjektet private të licencuara në shfrytëzimin e këtyre burimeve.

Në mbështetje të VKM nr. 867, datë 10.12.2014 òPër procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetërore midis AKBN dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Taksave është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit nr. 9689, datë 06.11.2015, por në dosjet e monitorimit nuk u provua nëse ka funksionuar ky bashkëpunim me objekt shkëmbimin e informacionit në kohë reale, për të parandaluar dhe luftuar aktivitetet e paligjshme dhe evazionin fiskal në fushën minerale, informacion mbi lëvizjen e rezervave, volumin stokun e prodhimit, diferencat në vite, fuqinë punëtore reale të subjekteve që zotërojnë leje minerare dhe që paguajnë sigurime shoqërore si objekt për të ardhurat tatimore.

Mungesa e rakordimit me Degët Rajonale të Tatimeve Taksave dhe mungesa e gatishmërisë së këtyre degëve, ku janë të regjistruar subjektet zotëruese të lejeve minerare, kanë sjellë si pasojë që, prodhimi i mineralit të nxjerrë dhe të shitur dhe renta minerare të deklarohen dhe të pranohet

në mënyrë të njëanshme nga subjektet që zotërojnë leje shfrytëzimi. Kjo mënyrë veprimi krijon kushte të favorshme për evazion fiskal ndaj të ardhurave tatimore dhe buxhetit të shtetit, pasi edhe ato matje që mund të jenë kryer nuk janë vënë në shërbim të ushtrimit të kompetencave që ka AKBN në funksion të përgjegjësive që burojnë nga neni 1, dhe pika 24 e nenit 2, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010.

Nëpërmjet këtij bashkëpunimi bëhet e mundur kontrolli teknik, ekonomik dhe fiskal duke kryqëzuar volumet e deklaruar nga vetë subjektet me volumin dhe stokun e prodhimit të matur fizikisht nga AKBN, si një faktor i rëndësishëm për realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

Duhet të theksohet së AKBN ka dërguar disa shkresa në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për të marrë informacion nga këto institucione për prodhimin e shitur brenda vendit dhe të eksportuar, por kjo marrëveshje ka mbetur e pa finalizuar, pasi edhe në rast së konstatohen diferenca në prodhimin e shitur, të ardhurat e realizuara dhe diferenca në llogaritjen e detyrimeve ndaj buxhetit për rentën e padeklaruar (apo të fshehur), AKBN nuk mund t'ia arkëtojë këto detyrime. Në zbatim të marrëveshjes dypalëshe, shkëmbimi i informacionit nuk është bërë nga secila palë konform pikës nr. 1 dhe 2, të nenit 2 të kësaj marrëveshje, pasi nuk u gjenden komunikime midis palëve që kanë nënshkruar marrëveshjen për të realizuar kryqëzimin e treguesve të prodhimit nga personat e kontaktit dhe nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në rrugë elektronike, siç përcaktohet në nenin 4 të kësaj marrëveshje.

- Shkresa Nr. 1013/8 Prot , date 15.11.2017, dërguar MIE dhe MFE me lëndë òKërkesë për rishikimin e emërimit të mineralit të vendosur në lejet minerare të shfrytëzimit dhe në ligjin nr. 141/5015 hyrë në fuqi me 01.01.2016 òPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9975, date 28.07.2008 ò Për taksat Kombëtare, i ndryshuar.

- Shkresa me Nr. 7567 Prot, date 07.11.2017 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe dijeni MIE me lëndë òDërgohet për kompetencë ku kërkohet bashkëpunim për të përcaktuara dhe shlyer diferencën e pa paguara të rentës minerare.

Institucioni AKBN ka pasur korrespondencë të rregullt me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Tatimeve për sasinë e prodhimit të nxjerrë dhe cilësitë e mineraleve të eksportuara dhe pagesën e rentës minerare, e konkretisht:

- Shkresa Nr. 1130 Prot, date 30.01.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me lëndë òKërkohen të dhëna mbi realizimin e pagesës së rentës minerare dhe eksportit të realizuar nga industria minerare në sasi dhe vlerë për periudhën 01.01. 2017 deri me 31.12.2017.

- Shkresa Nr. 1131 Prot, datë 30.01.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me lëndë òKërkohen të dhëna mbi realizimin e pagesës së rentës minerare për periudhën 01.01. 2017 deri me 31.12.2017.

- Shkresa Nr. 5366 Prot , date 05.06.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me lëndë ò kërkohen të dhëna mbi sasinë dhe cilësinë e mineraleve të eksportuara për vitin 2017, etj.

Grupi i Auditimit, vlerëson së aktmarrëveshjet e lidhura me Drejtorinë e Tatimeve dhe Drejtorinë e Doganës nuk kanë shërbyer për të shkëmbyer informacione në kohë reale dhe në periudha tremujore, gjashtë mujore dhe vjetore. Theksojmë së, siç dërgohet informacion në MIE për prodhimin vjetor dhe rentën e deklaruar dhe të paguar, ky informacion duhet t'ia bëhet i ditur dhe DPT dhe DPD, me qëllim rakordimin e të dhënave midis këtyre institucioneve, veprime dhe

mosveprime në kundërshtim me kërkesa e VKM nr. 867, datë 10.12.2014 òPër procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetërore.

Vlen të përmendet së nga ana e AKBN-së (Komisionit të shqyrtimit të planeve vjetore të punës), në vitin 2020, është implementuar në dosjet e planit vjetor të punës për subjektet që kryejnë aktivitetet minerar shfrytëzimi edhe formulari FDP (Formular Deklarimit e Pagesës) për Rentën minerare të paguar nga subjektet. Ky formular lëshohet nga DPT dhe në këtë mënyrë mund të bëhet nga ana e AKBN-së një rakordim ndërmjet shitjeve të deklaruara nga subjektet dhe rentë së paguar për këto shitje.

Subjekti pranon konstatimin e Grupit të auditimit.

| | |
|--|---|
| <p>Titulli i gjetjes Nr. 6:</p> | <p>Mungojnë kontrollet dhe inspektimet dhe vlerësimet e përbashkëta në terren me përfaqësues të AKBN/DM dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, ku ushtrojnë aktivitetin subjektet private të licencuara në shfrytëzimin e këtyre burimeve.</p> |
| <p>Situata:</p> | <p>Në mbështetje të VKM nr. 867, datë 10.12.2014 òPër procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetërore midis AKBN dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Taksave është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit nr. 9689, datë 06.11.2015, por në dosjet e monitorimit nuk u provua nëse ka funksionuar ky bashkëpunim me objekt shkëmbimin e informacionit në kohë reale, për të parandaluar dhe luftuar aktivitetet e paligjshme dhe evazionin fiskal në fushën minerale, informacion mbi lëvizjen e rezervave, volumin stokun e prodhimit, diferencat në vite, fuqinë punëtore reale të subjekteve që zotërojnë leje minerare dhe që paguajnë sigurime shoqërore si objekt për të ardhurat tatimore.</p> <p>Mungesa e rakordimit me Degët Rajonale të Tatimeve Taksave dhe mungesa e gatishmërisë së këtyre degëve, ku janë të regjistruar subjektet zotëruese të lejeve minerare, kanë sjellë si pasojë që, prodhimi i mineralit të nxjerrë dhe të shitur dhe renta minerare të deklarohen dhe të pranohet në mënyrë të njëanshme nga subjektet që zotërojnë leje shfrytëzimi. Kjo mënyrë veprimi krijon kushte të favorshme për evazion fiskal ndaj të ardhurave tatimore dhe buxhetit të shtetit, pasi edhe ato matje që mund të jenë kryer nuk janë vënë në shërbim të ushtrimit të kompetencave që ka AKBN në funksion të përgjegjësive që burojnë nga neni 1, dhe pika 24 e nenit 2, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010.</p> <p>Nëpërmjet këtij bashkëpunimi bëhet e mundur kontrolli teknik, ekonomik dhe fiskal duke kryqëzuar volumet e deklaruara nga vetë subjektet me volumin dhe stokun e prodhimit të matur fizikisht nga AKBN, si një faktor i rëndësishëm për realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Duhet të theksohet së AKBN ka dërguar disa shkresa në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për të marrë informacion nga këto institucione për prodhimin e shitur brenda vendit dhe të eksportuar, por kjo marrëveshje ka mbetur e pa finalizuar, pasi edhe në rast së konstatohen diferenca në prodhimin e shitur, të</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>ardhurat e realizuara dhe diferenca në llogaritjen e detyrimeve ndaj buxhetit për rentën e padeklaruar (apo të fshehur), AKBN nuk mund t'ia arkëtojë këto detyrime. Në zbatim të marrëveshjes dypalëshe, shkëmbimi i informacionit nuk është bërë nga secila palë konform pikës nr. 1 dhe 2, të nenit 2 të kësaj marrëveshje, pasi nuk u gjendën komunikime midis palëve që kanë nënshkruar marrëveshjen për të realizuar kryqëzimin e treguesve të prodhimit nga personat e kontaktit dhe nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në rrugë elektronike, siç përcaktohet në nenin 4 të kësaj marrëveshje.</p> <p>- Shkresa Nr. 1013/8 Prot, date 15.11.2017, dërguar MIE dhe MFE me lëndë òKërkesë për rishikimin e emërimit të mineralit të vendosur në lejet minerare të shfrytëzimit dhe në ligjin nr. 141/5015 hyrë në fuqi me 01.01.2016 òPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9975, date 28.07.2008 òPër taksat Kombëtareò, i ndryshuar.</p> <p>- Shkresa me Nr. 7567 Prot, date 07.11.2017 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe dijeni MIE me lëndë òDërgohet për kompetencëò ku kërkohet bashkëpunim për të përcaktuara dhe shlyer diferencën e pa paguara të rentës minerare.</p> <p>Institucioni AKBN ka pasur korrespondencë të rregullt me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Tatimeve për sasinë e prodhimit të nxjerrë dhe cilësitë e mineraleve të eksportuara dhe pagesën e rentës minerare, e konkretisht:</p> <p>- Shkresa Nr. 1130 Prot, date 30.01.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me lëndë òKërkohen të dhëna mbi realizimin e pagesës së rentës minerare dhe eksportit të realizuar nga industria minerare në sase dhe vlere për periudhën 01.01. 2017 deri me 31.12.2017.</p> <p>- Shkresa Nr. 1131 Prot, datë 30.01.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me lëndë òKërkohen të dhëna mbi realizimin e pagesës së rentës minerare për periudhën 01.01. 2017 deri me 31.12.2017ò .</p> <p>- Shkresa Nr. 5366 Prot , date 05.06.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me lëndë ò kërkohen të dhëna mbi sasinë dhe cilësinë e mineraleve të eksportuara për vitin 2017, etj.</p> <p>Grupi i Auditimit, vlerëson së aktmarrëveshjet e lidhura me Drejtorinë e Tatim Taksave dhe Drejtorinë e Doganës nuk kanë shërbyer për të shkëmbyer informacione në kohë reale dhe në periudha tremujore, gjashtë mujore dhe vjetore. Theksojmë së, siç dërgohet informacion në MIE për prodhimin vjetor dhe rentën e deklaruar dhe të paguar, ky informacion duhet t'ia bëhet i ditur dhe DPT dhe DPD, me qëllim rakordimin e të dhënave midis këtyre institucioneve, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me kërkesa e VKM nr. 867, datë 10.12.2014 òPër procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetëroreò.</p> |
|--|---|

| | |
|-----------------------|---|
| Kriteri: | Vepruar në kundërshtim me VKM nr. 867, datë 10.12.2014 òPër procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetëroreò dhe marrëveshjen e bashkëpunimit AKBN - DPTT me nr. 9689, datë 06.11.2015, |
| Ndikimi/Efekti | Mungesa e rakordimit me Degët Rajonale të Tatim Taksave ku janë të regjistruar subjektet zotëruese të lejeve minerare, ka sjellë si pasojë që, prodhimi i mineralit të nxjerrë dhe të shitur dhe renta minerare të deklarohen dhe të pranohet në mënyrë të njëanshme nga subjektet që zotërojnë leje shfrytëzimi. Kjo mënyrë veprimi krijon kushte të favorshme për evazion fiskal ndaj të ardhurave tatimore dhe buxhetit të shtetit, pasi edhe ato matje që mund të jenë kryer nuk janë vënë në shërbim të ushtrimit të kompetencave që ka AKBN në funksion të përgjegjësisë që burojnë nga neni 1, dhe pika 24 e nenit 2, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 |
| Shkaku | Si pasojë e neglizhencës së autoriteteve tatimore për të përmbushur detyrimet sipas VKM nr. 867, datë 10.12.2014 òPër procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetëroreò dhe marrëveshjes së nënshkruar mes palëve. |
| Rëndësia | E Lartë |
| Rekomandime | AKBN në zbatim të marrëveshjes dypalëshe të lidhura, me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (respektivisht me nr. 1920 dhe 1922, datë 12.02.2016), të marrë masa për të shkëmbyer informacione periodike dhe në kohë reale për të parandaluar dhe luftuar aktivitetet e paligjshme dhe evazionin fiskal në fushën minerare, duke ndarë informacione mbi lëvizjen e rezervave, stokun e prodhimit dhe diferencat e tij në vite, fuqinë punëtore reale të subjekteve që zotërojnë leje minerare dhe që paguajnë sigurime shoqërore si objekt për të ardhurat tatimore, etj. |

Informacion mbi veprimtarinë e Komisionit të Miratimit të Planeve Vjetore të punës

Nga viti 2018, Komisioni për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planit vjetor të punës, të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit, ka funksionuar bazuar në Urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv nr. 08, datë 16.01.2018 "Për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit të planit vjetor të punës të zotëruesit të lejes minerare".

Ky komision ka funksionuar rregullisht, një herë në javë, në varësi të dosjeve të paraqitura për shqyrtim. Komisioni përbëhet nga specialistët përkatës të fushës minerare, ekonomist, jurist dhe sekretari i komisionit. Për çdo dosje të shqyrtuar mbahet procesverbal përkatës i firmosur nga specialistët e sipërcituar, administratori i subjektit dhe drejtuesi teknik.

Konstatim:

Nga shqyrtimi i dosjeve të përzgjedhura në mënyrë rastësore, u vu re së ka mangësi si më poshtë:

1. Pasi shqyrtohet dosja në komision dhe konstatohen mangësitë, lihen afatet për plotësimin e dokumentacionit që duhet të përfshihet në dosje. Në komisionin pasardhës edhe pse janë plotësuar këto mangësi, nuk është mbajtur një procesverbal i ri, por është mjaftuar vetëm me shënimet përkatëse në procesverbalin e parë.

2. Në dosje mungon inventari i dokumentacionit që ndodhet në dosje.
3. Në dosjet e shqyrtuara ka raste që procesverbali i mbajtur në komision nuk është firmosur nga administratori i subjektit dhe drejtuesi teknik.

Gjatë periudhës mars 2020 deri në qershor 2020, komisioni nuk është mbledhur rregullisht pasi kjo periudhë përkon me gjendjen e fatkeqësisë natyrore, V.K.M nr. 243, datë 24.03.2020. Kjo ka sjellë vonesa në shqyrtimin e dokumentacionit për disa subjekte dhe rrjedhimisht miratimin me vonesë të planit të punës. Në këtë periudhë, ka dosje të cilat nuk janë firmosur nga administratori ose drejtuesi teknik.

Vlen të përmendet së në vitin 2021 është bërë rishikimi dhe përditësimi i rregullores së brendshme të funksionimit të komisionit të shqyrtimit të planeve vjetore të punës, të zotëruesve të lejeve minerare, Urdhër nr. 162, datë 21.10.2021, ku specifikohen në mënyrë të detajuar detyrimet e çdo specialisti, pjesëmarrës në komision.

Më poshtë po japim një tabelë përmbledhëse ku pasqyrohen dosjet e shqyrtuara për vitet 2018-2021, për sektorin metalor dhe jo metalor.

Tabela nr. 50

| VITI | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
|--------------------------------|------|------|------|------|
| Nr. Lejeve aktive (ndërtimore) | 294 | 270 | 273 | 289 |
| Nr. Lejeve aktive (metalore) | 303 | 301 | 303 | 298 |
| Miratuar | 502 | 427 | 424 | 493 |
| Refuzuar | 32 | 63 | 59 | 36 |
| Kthim Përgjigje | 63 | 81 | 32 | 48 |
| Gjithsej | 597 | 571 | 576 | 587 |

Pretendimi Subjektit:

Lidhur me sa është konstatuar, bëjmë të ditur se pavarësisht rasteve të mundshme të mungesës së nënshkrimit nga ana e drejtuesit teknik, komisioni për shqyrtimin e dokumentacionit ka patur dhe ka prioritet respektimin e akteve përkatëse ligjore e nënligjore në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale.

Përsa i përket rastit kur në mbledhjen e radhës lihen detyra dhe afate për plotësimin e mangësive, nga ana e subjekteve janë plotësuar në kohë të gjitha dokumentat e munguara pavarësisht mosreflektimit në procesverbal. Duke vlerësuar gjetjen, bëjmë të ditur se nga ana e AKBN-së janë hedhur hapa për rishikimin dhe përditësimin e rregullores së brendshme të funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Planeve Vjetore të Punës si dhe është përgatitur një procesverbal për të gjitha rastet që kanë nevojë për plotësim.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Observacioni merret pjesërisht në konsideratë. Sikurse shprehet edhe subjekti duhet të hidhen hapa të mëtejshëm në rishikimin dhe përditësimin e rregullores së brendshme të funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Planeve Vjetore të Punës.

| | |
|-------------------------------------|--|
| Titulli i gjetjes Nr. 7: | Mangësi dhe parregullsi në zbatimin e Rregullores òPër organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimitò, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv. |
| Situata: | Nga shqyrtimi i dosjeve të përzgjedhura në mënyrë rastësore, u vu re së ka mangësi si më poshtë: - Pasi shqyrtohet dosja në komision dhe konstatohen mangësitë, lihen afatet për plotësimin e dokumentacionit që duhet të përfshihet në dosje. Në komisionin pasardhës edhe pse janë plotësuar këto mangësi, nuk është mbajtur një procesverbal i ri, por është mjaftuar vetëm me shënimet përkatëse në procesverbalin e parë. - Në dosje mungon inventari i dokumentacionit që ndodhet në dosje. - Në dosjet e shqyrtuara ka raste që procesverbali i mbajtur në komision nuk është firmosur nga administratori i subjektit dhe drejtuesi teknik. - Gjatë periudhës mars 2020 deri në qershor 2020, komisioni nuk është mbledhur rregullisht pasi kjo periudhë përkon me gjendjen e fatkeqësisë natyrore V.K.M nr. 243, datë 24.03.2020. Kjo ka sjellë vonesa në shqyrtimin e dokumentacionit për disa subjekte dhe rrjedhimisht miratimin me vonesë të planit të punës. Në këtë periudhë, ka dosje të cilat nuk janë firmosur nga administratori ose drejtuesi teknik. |
| Kriteri: | - Bazuar në Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 13, pika 12, - Bazuar në Rregulloren òPër organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimitò, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv, neni 7, pika 1, neni 6, pika 5, neni 4, pika 2 dhe neni 8. - Bazuar në Urdhrin Nr.201, datë 20.06.2016 ò Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimoreò; - Bazuar në Urdhrin Nr.202, datë 20.06.2016 ò Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumetò |
| Ndikimi/Efekti | Pasojat që vijnë nga shmangia e këtyre normave janë të karakterit administrativ dhe ekonomik. -Pengesa në rinovimin e licencës të subjektit zotërues të lejes minerare. -Pa saktësi në konfirmimin mbi rregullshmërinë e dokumentacionit të shprehur në aktet. |
| Shkaku | Si pasojë moszbatimit me korrektesë të Rregullores òPër organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimitò nga çdo anëtar i Komisionit të ekspertëve, të caktuar për |

| | |
|--------------------|--|
| | këtë qëllim. |
| Rëndësia | E Mesme |
| Rekomandime | Drejtoria Minerare pranë AKBN të marrë masa për zbatimin e kërkesave të rregullores për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit. Drejtoria Minerare pranë AKBN të marrë masa për zbatimin e kërkesave të rregullores për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit. |

Konstatim:

Parregullsi, mangësi dhe të meta në shqyrtimin dhe miratimin e planeve vjetore të punës për subjektet minerare.

Lidhur me respektimin e ligjshmërisë e rregullshmërisë gjatë kryerjes së procedurave për marrjen në shqyrtim, analizën dhe marrjen e vendimeve përkatëse për miratimin ose jo të planit vjetor të punës së subjekteve të pajisura nga Ministria me lejeve minerare shfrytëzimi, me urdhër të vecantë të Drejtorit Ekzekutiv është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e dokumentacionit të planit vjetor të punës, ku janë përcaktuar qartë detyra dhe mbi atë bazë është operuar.

Në dosjet që u morën në shqyrtim për vitet 2018-2019, konstatohet se:

- Miratimi i programit/planit vjetor të punës nga ana e Komisionit, ishte bërë në shumë raste me vonesë, në tejkallim të afatit 30 ditor të parashikuar në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 13, pika 12, duke sjellë si pasojë pengesa në rinovimin e licencës të subjektit zotërues të lejes minerare. Bazuar në nenin 13, pika 12 sipas të cilit në rast mosmiratimi, struktura përgjegjëse e njofton zotëruesin e lejes minerare për arsyet e këtij mosmiratimi. Nëse ajo nuk kthen përgjigje, pas tejkallimit të këtij afati, plani quhet i miratuar, subjekti zotërues i lejes minerare vazhdon aktivitetin mbi bazën e miratimit në heshtje të planit vjetor të punës. Në ato raste kur plani vjetor i punës nuk miratohet nga Komisioni për shkak të mungesës së dokumentacionit të kërkuar dhe njoftimi i subjektit bëhet me vonesë, miratimi në heshtje i planit vjetor të punës, sjell pengesa në ushtrimin e aktivitetit të subjektit.

- Për ato raste ku, Komisioni është shprehur për plotësim të dokumentacionit nga subjekti minerar, në dosje nuk ka gjurmë/dokument të administruar nga Komisioni, nëse dokumentacioni është plotësuar nga subjekti dhe është marrë në shqyrtim nga Komisioni brenda afatit të përcaktuar prej tij.

- Nga Grupi i punës (Komisioni) për shqyrtimin e planeve vjetore të punës të subjekteve zotërues të lejeve minerare, për periudhën objekt kontrolli, nuk është mbajtur asnjë protokoll për mbledhjet e zhvilluara.

Subjektet zotërues të lejeve minerare, kanë paraqitur pranë AKBN-së programet e punës për rinovimin e lejeve minerare, të cilat pasi janë protokolluar, i kanë kaluar për shqyrtim grupit të punës. Në secilën nga këto dosje është vendosur një procesverbal tip (i parapërgatitur) me hapësirat për plotësim të shënimeve mbi plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit dhe të dhënave të dorëzuara nga subjektet që zotërojnë lejet minerare. Mungon një tabelë kontrolli ku të jenë listuar gjithë dokumentat e nevojshme për dorëzim nga subjekti, sipas Udhëzimeve të lëshuara për këtë qëllim nga Ministri MIE.

- Rregullorja nuk ka parashikuar penalite për vonesat e krijuara nga Komisioni dhe çdo zyrtar i lidhur me procesin e shqyrtimit të dokumentacionit për miratimin ose jo të programit/planit vjetor të punës, ndërkohë që ka parashikuar penalitete (gjobë) për subjektin

zotërues të lejes minerare, në rastet e kalimit të afatit për paraqitjen e dokumentacionit për shqyrtim të programit vjetor/planit të ushtrimit të aktivitetit bazuar kjo në neni 4, pika 2 si dhe Ligjin nr.10304 datë 15.07.2011 ÷Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë në neni 12.

Në lidhje me këto konstatime/gjetje, grupi i auditimit mori shpjegime nga zyrtarët/anëtarët dhe Sekretari i Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit për miratim të programit/planit vjetor të punës, sipas të cilave rezultoi se ka keqinterpretim dhe mosnjohje të akteve ligjore dhe nënligjore e konkretisht të Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 ÷Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 13, pika 12, dhe Rregullores neni 7, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv.

Ligji nr. 10304, datë 15.07.2010 ÷Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 13, pika 12,

Rregullore ÷Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv, neni 7, pika 1, neni 6, pika 5, neni 4, pika 2 dhe neni 8.

Në dosjet që u morën në shqyrtim për vitet 2020-2021, konstatohet se këto parregullsi dhe mangësi janë riparuar pasi për çdo mangësi apo parregullsi që konstatohet në dosjet e subjekteve mbahet procesverban më vete deri në plotësimin e plotë dhe të saktë të dosjes. Nga ana e organit përgjegjës, për këtë periudhë (2020-2021) u lihet afat 30 ditor për plotësimin e dosjes. Nëse subjekti nuk plotëson dosjen sipas kërkesave të organit përgjegjës. Nga shqyrtimi i dosjeve u konstatua se rregullorja e brendshme e funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të planeve vjetore të punës nuk ishte e plotë për sa i përket dokumentacionit që shoqëron dosjen e planit vjetor të punës për subjektet që kryejnë aktivitet minerar shfrytëzimi. Duke parë këto mangësi është bërë rishikimi dhe përditësimi i rregullores së brendshme të funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare me urdhër nr. 162, datë 21.10.2021.

Konkretisht mangësitë e sipërme janë trajtuar më poshtë sipas rasteve:

- Nga shqyrtimi i dosjes së subjektit ÷S.P.÷ sh.p.k, zotërues i lejes minerare me nr.862/2, datë 03.04.2015, për shfrytëzim të mineralit ÷Guri Gëlqeror i mermerizuar÷ në Mëlovë, Skrapar, mbi dërgimin e planit vjetor 2019-2020, paraqitur në AKBN me nr. 1851, datë 01.03.2019, konstatohet se, dosja është vlerësuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit Juridik dhe Tekniko-Ekonomik me datën 18.07.2019 dhe dokumentacioni ekonomik dhe tekniko-juridik është konsideruar i pa plotë dhe me mangësi. Nga auditimi rezultoi që:

Konstatohet se nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Nenit 6, ÷Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komisionë, pika nr.2 të Rregullores ÷Për organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimin e Planit vjetor të Punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit, miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, pasi referuar subjekti nuk është përfaqësuar nga administratori dhe drejtuesi teknik për mbrojtjen e këtyre planeve, vetëm nga drejtuesi teknik J.P..

Miratimi i programit vjetor të punës është bërë me shkresën e Drejtorit Ekzekutiv të AKB me nr.3373/8, datë 18.07.2019, për periudhën 16.07.2019 deri më 03.04.2020.

Në këtë shkresë në mbyllje të saj është vënë shënimi se:

÷Ky miratim jepet për mos bllokimin e punës në objekt, por subjekti ka detyrim të plotësojë detyrimet e lëna në procesverbalin e mbledhjes së komisionit për miratimin e programit vjetor të datës 16.7.2019 dhe pikën 3 të plotësimeve të nevojshme të lëna në refuzimin e programit vjetor të punës, me nr. 1851/1, datë 09.05.2019.

Konstatohet se subjektit i është miratuar plani vjetor për shfrytëzimin e pasurive minerare, ndonëse për subjektin òS.P.ò shpk, Komisioni me datën 28.5.2019 ka vërejtur mangësitë për sa i përket diferencës së rentes minerare për vitet 2016, 2017 dhe 2018, renta nuk është paguar sipas shtojcës nr.2 të ligjit për taksat kombetare me nr. 9975, datë 28.7.2008.

Nga ana tjetër, në bazë të procesverbalit të rishqyrtimit, të datës 18.07.2019, në lidhje me njohjen e detyrimeve të rentës minerare që lidhen me saktësimin e emertimit të mineralit, Komisioni është shprehur se jemi të mendimit që subjekti të vijojë procedurën për miratimin e planit vjetor deri sa të shprehen institucionet kompetente të ngarkuara me ligj.

Rezulton se subjekti òS.P.ò shpk, ka kërkuar miratimin e planit vjetor të aktivitetit për periudhën kohore vjetore 3.4.2019 deri më 3.4.2020, dhe nga vonesat në shqyrtimin dhe vendimarrjen, miratimi është bërë me datën 18 Korrik 2019 për periudhën 16/7/2019-deri me 03/04/2020, pra rezulton se për periudhën 3/4/2019 deri më 16/7/2019 subjekti për një periudhë 3.5 mujore ka kryer aktivitetet pa miratim të planit të aktiviteteve, (ka patur refuzim të programit me nr. 1851/1 datë 9.5.2019).

- Nga shqyrtimi i dosjes së subjektit òK.ò, zotërues i lejes minerare me nr.1342/7, datë 06.09.2013, mbi dërgimin e planit vjetor të vitit 2020, paraqitur në AKBN me nr.4936, datë 05.08.2019, konstatohet se, dosja nuk është vlerësuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit Juridik dhe Tekniko-Ekonomik dhe dokumentacioni ekonomik dhe tekniko-juridik nuk ka asnjë shënim apo nënshkrim nëse konsiderohet i rregullt apo me mangësi. Nga auditimi rezulton që:

Konstatohet se nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Nenit 6, òProcedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komisionë, të Rregullores òPër organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimin e Planit vjetor të Punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit, miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, pasi nuk ka asnjë të dhënë në procesverbal mbi të dhënat e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti.

Programi vjetor i punës është refuzuar për tu miratuar, pasi siç thuhet në shkresën e Drejtorit Ekzekutiv të AKB me nr.4936/1, datë 12.09.2019, òsubjekti ishte njoftuar me datën 28.8.2019 për mbrojtje por nuk ka qene prezent në komision. Komisioni perkates nuk e ka shqyrtuar dosjen pa prezencën e perfaqesuesve të subjektit.

- Subjekti òS-Gö sh.p.k. zotërues i lejes minerare nr.722/1, datë 23.5.2014 ka paraqitur pranë Komisionit dokumentacionin për miratimin e planit vjetor të punës i cili është regjistruar në AKBN me nr.2941 prot., datë 23.4.2019 brenda afatit të parashikuar në legjislacionin minerar (30 ditë para mbarimit të afatit të lejes minerare datë 23.5.2019).

-Me shkresën nr.2941/1, datë 31.5.2019 është vënë në dijeni subjekti për mos miratimin e planit vjetor të punës sipas detyrimit të përcaktuar në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 i ndryshuar, neni 13, pika 12, dhe Rregulloren, neni 7, pika 1.

-Në dosje nuk ka asnjë gjurmë (sipas procesverbalit tip të mbledhjes së Komisionit) që vërteton marrjen në shqyrtim të dokumentacionit sipas kërkesave të nenit 6, pika 5 të Rregullores.

DM e AKBN konfirmon se procesverbali nuk është mbajtur, pasi subjekti nuk është paraqitur në komision dhe për këtë është bërë pezullimi i aktivitetit me shkresën nr. 785, datë 23.01.2020.

- Nga shqyrtimi i dosjes së subjektit òR.ò sh.p.k, me administrator z.N.S. zotërues i lejes minerare me nr.718, datë 20.08.2003, me objektin òrërë bituminoze në vendburimin Patos Fshatë, mbi dërgimin e planit vjetor të vitit 2019-2020, paraqitur në AKBN me nr. 4574, datë 18.07.2019, konstatohet se, dosja është vlerësuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit

Juridik dhe Tekniko-Ekonomik me datën 21.8.2019 dhe dokumentacioni ekonomik dhe tekniko-juridik është konsideruar me mangësi.

Konstatohet se nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Nenit 6, ÷Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komisionë, pika nr.2 të Rregullores ÷Për organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimin e Planit vjetor të Punës të zotruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit, miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, pasi referuar subjekti nuk është përfaqësuar nga administratori dhe drejtuesi teknik për mbrojtjen e këtyre planeve, por vetëm nga drejtuesi teknik N.S.. Ka mungesë të garancive të rehabilitimit për vitin 2018 dhe 2019 si dhe siguracionet e jetes.

Refuzimi i miratimit të programit vjetor të punës për këtë subjekt është bërë me shkresën e Drejtorit Ekzekutiv të AKB me nr.4574/1, datë 24.12.2019. Konstatohet se në fund të kësaj shkrese është vënë shënimi se subjekti urdhërohet të pezullojë aktivitetin mineral, për të cilën subjekti ka patur të drejtën e rishqyrtimit të planit vjetor të punës duke plotësuar dokumentacionin brenda 10 ditësh, gjë e cila nuk ka ndodhur.

Sa sipër, është vepruar në shkelje të përcaktimeve të urdhrin të Ministrisë të MIE nr. 201 dhe 202, datë 20.6.2016, pasi nga ana e AKBN nuk janë vijuar procedurat e pezullimit të aktivitetit mineral, nuk është njoftuar subjekti dhe autoritetet shtetërore kompetente për pezullimin e aktivitetit dhe revokimin e lejes minerare, në shkelje të dispozitave të ligjit mineral në fuqi për një periudhë mbi 6 muaj (pasi data e refuzimit për miratim të planit vjetor të veprimtarisë ka qenë 24 dhjetor 2019)

Në dosje ekziston një njoftim i konceptuar nga z.A.H. dhe të konfirmuar nga z.M.R., por që deri në momentin e kryerjes së auditimit nuk është përcjellë subjektit dhe autoritetit sipas kompetencave ligjore.

- Subjekti ÷G-Gö sh.p.k. zotërues i lejes minerare nr.1706, datë 28.5.2014 ka paraqitur pranë Komisionit dokumentacionin për miratimin e planit vjetor të punës i cili është regjistruar në AKBN me nr.3038 prot., datë 26.04.2019 brenda afatit të parashikuar në legjislacionin mineral (30 ditë para mbarimit të afatit të lejes minerare datë 28.5.2019).

-Me shkresën nr.3038/1, datë 24.5.2019 është vënë në dijeni subjekti për mos miratimin e planit vjetor të punës sipas lërkesave të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 i ndryshuar, neni 13, pika 12, dhe Rregulloren, neni 7 dhe 8.

-Në dosje nuk ka asnjë gjurmë (sipas procesverbalit tip të mbledhjes së Komisionit) që vërteton marrjen në shqyrtim të dokumentacionit sipas kërkesave të nenit 6, pika 5 të Rregullores.

- Nga shqyrtimi i dosjes së subjektit ÷B.P.ö sh.p.k. zotërues i lejes minerare me nr.1211, datë 26.6.2012, mbi dërgimin e planit vjetor të vitit 2019-2020, paraqitur në AKBN me nr. 3542, datë 24.05.2019, me objekt ÷nxjerrje kromi, Maja e Lajthizes, Burrelë, konstatohet se, dosja është vlerësuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit Juridik dhe Tekniko-Ekonomik me datën 14.06.2019 dhe dokumentacioni ekonomik dhe tekniko-juridik është konsideruar i rregullt. Nga auditimi rezulton që:

Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Nenit 6, ÷Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komisionë, pika nr.2 të Rregullores ÷Për organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimin e Planit vjetor të Punës të zotruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit, miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, pasi referuar subjekti nuk është përfaqësuar nga administratori dhe drejtuesi teknik për mbrojtjen e këtyre planeve, por vetëm nga ky i fundit (z.A.S.).

Ndonëse nga ana e Komisionit janë konstatuar se ka mangësi të dokumentacionit (garancia e rehabilitimit 2018 dhe 2019, vërtetimi i Bashkisë dhe licenca e drejtuesit teknik dhe sigurimet e

jetes, per te cilat më pas është vënë dhe shënimi OK. Gjithashtu, ne lidhje me anen teknike eshte vendosur shenimi qe te hidhen te dhenat gjeologjike ne profile etj., duke caktuar afatin 7 ditor per korigjimin e mangësive, por në dosje nuk ka asnjë akt tjetër që të konfirmojë plotesimin e dokumentacionit dhe korigjimin e mangësive të verejtjura nga komsioni si dhe mungon një gjurmë dokumentare e hyrjes së këtyre suplementeve në dosjen e aplikimit të subjektit që është zoterues i lejes minerare te shfrytezimit.

Dokumentacioni teknik dhe sigurimet e jetës, se bashku me vertetimet që nuk ka detyrime ndaj Bashkisë, janë administruar në dosje, por nuk ka asnje gjurme të dokumentacionit perkates (garancia e rehabilitimit 2018 dhe 2019).

Miratimi i programit vjetor të punës është bërë me shkresën e Drejtorit Ekzekutiv te AKB me nr.3542/1, datë 17.07.2019.

- Subjekti ðE.A.ð sh.p.k. B., zotërues i lejes minerare nr.1410, datë 01.09.2009 ka paraqitur pranë Komisionit dokumentacionin për miratimin e planit vjetor të punës i cili është regjistruar në AKBN me nr.4771 prot., datë 25.07.2019 brenda afatit të parashikuar në legjislacionin minerar.

-Shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti është bërë nga Komisioni me datë 28.8.2019 ku për shkak të mungesës së dokumentacionit janë lënë detyra për plotësimin e dosjes brenda një afati 2 ditor deri me datë 30.8.2019, përcaktuar në procesverbalin e mbajtur nga Komisioni.

-Në dosje nuk ka gjurmë (sipas procesverbalit tip të mbledhjes së Komisionit) nëse subjekti brenda afatit 2 ditor ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar dhe nëse Komisioni e ka rishqyrtuar atë sipas kërkesave të nenit 6, pika 5 të Rregullores.

-Miratimi i programit/planit vjetor të punës, zbardhja e miratimit për ushtrimin e aktivitetit dhe njëkohësisht edhe njoftimi i subjektit për miratimin e planit vjetor të punës është bërë me vonesë (12.9.2019 ndërkohë leja minerare ka vlefshmëri deri 01.9.2019) veprim ky në mospërputhje të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 i ndryshuar, neni 13, pika 12, dhe Rregullores neni 7.

- Nga shqyrtimi i dosjes së subjektit ðS.B.ð sh.p.k, zotërues i lejes minerare me nr.355/1, datë 17.6.1997, per objektin ðzhavorr bituminozö, mbi dërgimin e planit vjetor të vitit 2019-2020, paraqitur në AKBN me nr. 3238, datë 13,05.2019, konstatohet se, dosja është vlerësuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit Juridik dhe Tekniko-Ekonomik me datën 06.06.2019 dhe dokumentacioni ekonomik dhe tekniko-juridik është konsideruar me mangësi. Nga auditimi rezulton që:

Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Nenit 6, ðProcedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komisionö, pika nr.2 të Rregullores ðPër organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimin e Planit vjetor të Punës të zotruarve të lejeve minerare të shfrytëzimitö, miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, pasi referuar subjekti nuk është përfaqësuar nga administratori dhe drejtuesi teknik per mbrojtjen e këtyre planeve, por vetem nga drejtuesi teknik G.B.. Subjekti aplikues ka patur mungesë të formularit E-Sig 25, i cili rezulton që të jetë vendosur në dosje, si dhe është kerkuar nga Komisioni të rakordohen shitjet me rentën. Në lidhje me këtë përcaktim, nuk dispozitohet në dosje asnjë dokument (akt-rakordimi) që të konfirmojë rakordimin e këtyre sasivës së prodhimit të shitur dhe rentës së paguar.

Persa i perket garancise së rehabilitimit, në vitin 2016 sipas një shkrese të lëshuar nga Drejtoria Minerare në Ministrinë e linjës (MIE), është bërë një rivlerësim për diferencë të vlerës së garancisë.

Nuk ka inventar te dosjes së aplikantit mbi dokumentacionin përbërës të dosjes.

Periudha e vlerfshmërisë së lejes është 17.6.2019-17.6.2020.

Miratimi i programit vjetor të punës është bërë me shkresën e Drejtorit Ekzekutiv të AKB me nr.3238/1, datë 17.07.2019.

- Nga shqyrtimi i dosjes së subjektit òM.V.Aò, zotërues i lejes minerare me nr.1784, datë 19.11.2015 për objektin ògur gelqeror masivò në Melovë të Skraparit mbi dërgimin e planit vjetor 2019- 2020, paraqitur në AKBN me nr. 6320, datë 18.10.2019, konstatohet se, dosja është vlerësuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit Juridik dhe Tekniko-Ekonomik me datën 07.11.2019 dhe dokumentacioni ekonomik dhe tekniko-juridik është konsideruar m' mangesi. Nga auditimi rezultoi që :

Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Nenit 6, òProcedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komisionò, pika nr.2 të Rregullores òPër organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimin e Planit vjetor të Punës të zotruesve të lejeve minerare të shfrytëzimitò, miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, pasi referuar subjekti nuk është përfaqësuar nga administratori dhe drejtuesi teknik për mbrojtjen e këtyre planeve.

Nga Grupi i shqyrtimit është vërejtur se në datën e paraqitjes nga subjekti ka mungesa të dokumentacionit juridik si dhe siguracionet e jetës, licenca e noterizuar, kontratat e punës. Në vijim është vënë OK, pa një procesverbal të ri të komisionit.

Miratimi i programit vjetor të punës është bërë me shkresën e Drejtorit Ekzekutiv të AKB me nr.964, datë 29.1.2020 për periudhën nga 19 Nentori 2019 deri me 19 nentor 2020. Pra shkresa ka fuqi prarvepruese, pasi për 2 muaj subjekti ka operuar pa një plan të miratuar.

- Subjekti òP.ò sh.p.k. zotërues i lejes minerare nr.1700, datë 21.5.2014 ka paraqitur pranë Komisionit dokumentacionin për miratimin e planit vjetor të punës i cili është regjistruar në AKBN me nr.3480 prot., datë 21.5.2019 në tejkallim të afatit të parashikuar Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 i ndryshuar, neni 13, pika 12, dhe Rregullore neni 4, pika 2 në të cilin përcaktohet ò... Ndaj subjekteve minerare dosjet të cilat i kanë depozituar jashtë afatit të parashikuar në ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 i ndryshuar do të merret masa administrative me gjobë....ò. Nga ana e Komisionit ky fakt nuk është marrë në konsideratë pasi dosja është marrë në shqyrtim dhe pse në tejkallim të afateve ligjore (30 ditë para mbarimit të afatit të lejes minerare datë 21.5.2019).

- Me shkresën nr.3480/1, datë 17.7.2019 nuk është miratuar plani vjetor i punësi cili i është vënë në dijeni me vonesë nga Komisioni i subjektit minerar dhe gjithashtu është marrë në shqyrtim me vonesë nga Komisioni, jo në përputhje me Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 i ndryshuar, neni 13, pika 12, dhe Rregulloren neni 7 pika 1. Nga përmbajtja e shkresës, shkak për mos miratimin e programit vjetor të punës është mungesa e garancisë së rehabilitimit 2019-2020, siguracionet e jetës, kontrata e punës me drejtuesin teknik dhe E SIG 25, të cilat janë konstatuar pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Komisioni. Konstatohet se në procesverbalin datë 14.6.2019 të shqyrtimit të dokumentacionit për miratimin e planit vjetor të punës, Komisioni është shprehur òu plotësua materiali teknik është në rregullò, ndërsa për materialin ekonomik dhe juridik Komisioni është shprehur òplotësoi vërtetimin nga Bashkia dhe vërtetimin nga Tatimetò dhe nuk është shprehur nëse është plotësuar i gjithë dokumentacioni i kërkuar. Për pasojë, në zbardhjen e vendimit të mos miratimit të programit vjetor të punës të nënshkruar nga Drejtori Ekzekutiv z. A.B. dhe në procesverbalin e mbledhjes për shqyrtimin e dokumentacionit të mbajtur nga Komisioni, kemi shprehje të ndryshme të qëndrimeve të tyre, pa saktësi në konfirmimin mbi rregullshmërinë e dokumentacionit të shprehur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit dhe shkresës së titullarit/Drejtorit Ekzekutiv për zbardhjen e mos miratimit të planit vjetor të punës

veprim i cili nuk është në përputhje me nenin 6, pika 5 të Rregullores që është në kompetencë të Komisionit (anëtarëve të cilët kanë nënshkruar procesverbalin e mbledhjes R.B.k/Komisioni, E.M., E.B., H.C. dhe R.M.) dhe Drejtorit Ekzekutiv A.B.).

- Nga shqyrtimi i dosjes së subjektit òK.T.ò, zotërues i lejes minerare me nr.1331, datë 20.03.2009, mbi dërgimin e planit vjetor të vitit 2020, paraqitur në AKBN me nr.1351, datë 18.02.2020, konstatohet se, dosja është vlerësuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit Juridik dhe Tekniko-Ekonomik me datën 10.03.2020 dhe dokumentacioni ekonomik dhe tekniko-juridik është konsideruar me disa mangësi. Nga auditimi rezulton që:

Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Nenit 6, òProcedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komisionë, pika nr.2 të Rregullores òPër organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimin e Planit vjetor të Punës të zotruesve të lejeve minerare të shfrytëzimitò, miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, pasi referuar subjekti nuk është përfaqësuar nga administratori, por vetem nga drejtuesi teknik N.S.per mbrojtjen e këtyre planeve.

Miratimi i programit vjetor të punës nuk është kryer, ndonëse në procesverbalin e mbajtur nga ana e komisionit, është vendosur shënimi se ka mungesa të kontratave të punës, formulari ESIG-25, është kërkuar ndryshimi i rentes (por pa specifikuar vlerën që duhet vendosur), vertetimet e taitimeve dhe të pageses së rentes, për të cilat ka një shenim OK, por pa reflektim të pasqyruar me një procesverbal nga komisioni. Deri në datën 10.6.2020 nuk është dhënë miratimi i planit të veprimtarisë për vitin 2020 (mungon në dosje), ndonëse afati për korigjim ka qenë deri në datën 20.3.2020. Në emër të Komisionit kanë vendosur nënshkrimet vetëm 4 anëtarë: M.R., B.C., S.M., E.M. dhe R.M..

- Subjekti òM.D.ò sh.p.k. zotërues i lejes minerare nr.1499, datë 10.9.2010 ka paraqitur pranë Komisionit dokumentacionin për miratimin e planit vjetor të punës i cili është regjistruar në AKBN me nr.5036 prot., datë 9.8.2019 brenda afatit të parashikuar në legjislacionin minerar (30 ditë para mbarimit të afatit të lejes minerare datë 10.9.2019).

-Me shkresën nr.5036/1, datë 12.9.2019 është vënë në dijeni subjekti (2 ditë me vonë) për mos miratimin e planit vjetor të punës sipas detyrimit të përcaktuar në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 i ndryshuar, neni 13, pika 12, dhe Rregulloren, neni 7 dhe 8.

-Në dosje, procesverbali i mbledhjes së Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit për miratim të planit vjetor të punës nuk është plotësuar sipas formatit tip dhe nuk është i nënshkruar nga anëtarët e Komisionit në mos përputhje me Rregulloren, neni 6, pika 5.

- Subjekti òF.-K. C. F.ò sh.a. Krujë, zotërues i lejes minerare nr.795/1, datë 27.04.2015 ka paraqitur pranë Komisionit të ngritur me Urdhrin nr.8, datë 16.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv z. A.B., dokumentacionin për miratimin e planit vjetor të punës i cili është regjistruar në AKBN me nr. 2286 prot., datë 26.03.2019 brenda afatit të parashikuar në legjislacionin minerar (30 ditë para mbarimit të afatit të lejes minerare datë 27.4.2019).

-Shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti është bërë nga Komisioni me datë 16.4.2019 ku për shkak të mungesës së dokumentacionit janë lënë detyra për plotësimin e dosjes brenda një afati 7 ditor deri me datë 24.4.2019, përcaktuar në procesverbalin e mbajtur nga Komisioni.

-Në dosje nuk ka gjurmë nëse subjekti brenda afatit 7 ditor ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar dhe nëse Komisioni e ka rishqyrtuar atë sipas kërkesave të nenit 6, pika 5 të Rregullores.

-Miratimi i programit/planit vjetor të punës, zbardhja e miratimit për ushtrimin e aktivitetit dhe njëkohësisht edhe njoftimi i subjektit për miratimin e planit vjetor të punës është bërë me vonë

(17.07.2019) veprim ky në mospërputhje të Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 13, pika 12, dhe Rregullores neni 7, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se òMbas Komisioni mbyll shqyrtimin e dokumentacionit të një subjekti minerar Sekretari i Komisionit brenda afatit jo më vonë se 30 ditë nga data e depozitimit në zyrën e protokoll të AKBN-së, vë në dijeni subjektin minerar për miratimin ose jo,.....ò.

Nga kuptimi literar i nenit, del qartë se Komisioni duhet të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur brenda 30 ditëve nga data e depozitimit në zyrën e protokollit të AKBN-së në mënyrë që Sekretari i Komisionit të vërë në dijeni subjektin minerar për miratimin ose jo të programit/planit vjetor. Për rrjedhojë njoftimi i subjektit për miratimin e planit vjetor të punës nuk është bërë brenda afatit 30 ditor. Vonesa të tilla në rastet e mos miratimit të planit vjetor të punës nga Komisioni sjellin pengesa për subjektin pasi plani vjetor i punës miratohet në heshtje me kalimin e afatit 30 ditor bazuar në Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 13, pika 12. Në këtë rast subjektit zotërues të lejes minerare i ka mbaruar afati i vlefshmërisë së programit/planit vjetor të punës me datë 27.04.2019.

- Nga shqyrtimi i dosjes së subjektit òV.I.ò, zotërues i lejes minerare me nr.1675, datë 06.09.2020, mbi dërgimin e planit vjetor të vitit 2019-2020, paraqitur në AKBN me nr. 4967, datë 06.08.2019, konstatohet se, dosja është vlerësuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit Juridik dhe Tekniko-Ekonomik me datën 28.8.2019 dhe dokumentacioni ekonomik dhe tekniko-juridik është konsideruar me mengaesi. Nga auditimi rezulton që:

Konstatohet se nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Nenit 6, òProcedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komisionò, pika nr.2 të Rregullores òPër organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimin e Planit vjetor të Punës të zotruesve të lejeve minerare të shfrytëzimitò, miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, pasi referuar subjekti nuk është përfaqësuar nga administratori dhe drejtuesi teknik për mbrojtjen e këtyre planeve.

Subjekti nuk ka ushtruar aktivitetin që nga marrja e lejes së shfrytëzimit, dhe për këtë arsye është propozuar revokimi i lejes me shkresën nr. 6218, datë 10.07.2018, pasi ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 47, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010

Kthimi i përgjigjes për mos marrjen në shqyrtim të kërkesës së subjektit òV.I.ò për mosshqyrtim të kërkesës për programin vjetor të punës është bërë me shkresën e Drejtorit Ekzekutiv të AKB me nr.4967/1 datë 12.09.2019.

Në dosjen e këtij subjekti nuk ka informacion të çfare masash janë marrë në vazhdim, a ka vijuar subjekti punë pas kesaj shkrese që nuk miraton planin e punës. DM e AKBN nuk ka miratuar planin vjetor të punës, subjekti nuk ka zhvilluar aktivitet minerar nga momenti i marrjes së lejes (komenti AKBN faqe 26 e objeksioneve) dhe se MIE nuk ka revokuar lejen e shfrytëzimit, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit për sektorin minerar.

- Nga shqyrtimi i dosjes së subjektit òI.M.I.ò, zotërues i lejes minerare me nr.1650, datë 20.09.2019, mbi dërgimin e planit vjetor të vitit 2019-2020, për mineralin e kromit në Minieren Kalimash të Kukësit paraqitur në AKBN me nr. 4121, datë 28.6.2019, konstatohet se, dosja është vlerësuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit Juridik dhe Tekniko-Ekonomik me datën 31.7.2019 dhe dokumentacioni ekonomik dhe tekniko-juridik është konsideruar i rregullt. Konstatohet se nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Nenit 6, òProcedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komisionò, pika nr.2 të Rregullores òPër organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimin e Planit vjetor të Punës të zotruesve

të lejeve minerare të shfrytëzimitit, miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, pasi referuar subjekti nuk është përfaqësuar nga administratori dhe drejtuesi teknik për mbrojtjen e këtyre planeve.

Nga Grupi i shqyrtimit është vërejtur se në datën e paraqitjes së dokumentacionit nga subjekti ka mungesa në të gjithë rubrikat e dokumentacionit ekonomik dhe juridik si dhe të bilancit të lëvizjes së mineraleve. Ne vijim është vënë OK, pa një procesverbal të ri të komisionit dhe pa asnjë gjurmë që të shpjegojë reflektimin e vërejtjeve të bëra sipas procesverbalit të mëparshëm të komisionit.

Miratimi i programit vjetor të punës është bërë me shkresën e Drejtorit Ekzekutiv të AKB me nr.4121/2, datë 20.09.2019.

- Nga shqyrtimi i dosjes së subjektit òS.B.ò sh.p. k, zotërues i lejes minerare me nr.355/1, datë 17.6.1997, për objektin òzhavorr bituminozò, mbi dërgimin e planit vjetor të vitit 2019-2020, paraqitur në AKBN me nr. 3238, datë 13.05.2019, konstatohet se, dosja është vlerësuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit Juridik dhe Tekniko-Ekonomik me datën 06.06.2019 dhe dokumentacioni ekonomik dhe tekniko-juridik është konsideruar me mangësi. Nga auditimi rezultoi që:

Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Nenit 6, òProcedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komisionë, pika nr.2 të Rregullores òPër organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimin e Planit vjetor të Punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimitit, miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, pasi referuar subjekti nuk është përfaqësuar nga administratori dhe drejtuesi teknik për mbrojtjen e këtyre planeve, por vetëm nga drejtuesi teknik G.B.. Subjekti aplikues ka patur mungesë të formularit E-Sig 25, i cili rezultoi që të jetë vendosur në dosje, si dhe është kërkuar nga Komisioni të rakordohen shitjet me rentën. Në lidhje me këtë përcaktim, nuk dispozitohet në dosje asnjë dokument (akt-rakordimi) që të konfirmojë rakordimin e këtyre sasivës së prodhimit të shitur dhe rentës së paguar.

Persa i përket garancisë së rehabilitimit, në vitin 2016 sipas një shkrese të lëshuar nga Drejtoria Minerare në Ministrinë e Linjës (MIE), është bërë një rivlerësim për diferencë të vlerës së garancisë.

Nuk ka inventar të dosjes së aplikantit mbi dokumentacionin përbërës të dosjes.

Perioda e vlerfshmërisë së lejes është 17.6.2019-17.6.2020.

Miratimi i programit vjetor të punës është bërë me shkresën e Drejtorit Ekzekutiv të AKB me nr.3238/1, datë 17.07.2019.

- Nga shqyrtimi i dosjes së subjektit òB.A.ò, që zotëruesi i lejes minerare me nr. 1867, datë 17.10.2018 ka dërguar dokumentacionin mbi dërgimin e planit vjetor të vitit 2020 paraqitur në AKBN me nr. 00433 prot., datë 29.10.2019, konstatohet se nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Nenit 6, òProcedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komisionë, të Rregullores òPër organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimin e Planit vjetor të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimitit, miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, pasi subjekti nuk është përfaqësuar nga administratori dhe drejtuesi teknik për mbrojtjen e këtyre planeve.

Nga Komisioni është konstatuar se nuk është respektuar afati ligjor dhe formati për dorëzimin e dokumentacionit nga ana e subjektit të licensuar për objektin òGur gëlqerorò në Kaninë të Vlorës. Gjithashtu është konstatuar mungesa e garancisë së rehabilitimit për periudhën 2019-2020 si dhe dokumentet e sigurimit të jetës për dy punonjës, për të cilin është kërkuar plotësimi

brenda një afati 7 ditor. Nga Komsioni dosja është shqyrtuar me datën 07.11.2019, por nuk kanë nënshkruar të gjithë anëtarët e komisionit etj. Konstatohet se dokumenti procesverbal nuk identifikon nëse subjekti është përfaqësuar nga administratori dhe drejtuesi teknik, kërkesë kjo e nenit 6, pika 3, të Rregullores së funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit. Procesverbali është mbajtur me datë 18.2.2020 dhe është nënshkruar vetëm nga drejtuesi teknik z.A.K..

- Nga shqyrtimi i dosjes së subjektit ðA.N.G.ö, zotërues i lejes minerare me nr.1660, datë 10.05.2016, mbi dërgimin e planit vjetor të vitit 2020, paraqitur në AKBN me sistemin revzone, datë 09.04.2019, konstatohet se, dosja është vlerësuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit Juridik dhe Tekniko-Ekonomik me datën 02.05.2019 dhe nuk është bërë vlerësimi i dokumentacionit ekonomik dhe tekniko-juridik pasi është vënë shënimi se subjekti ka pezullim të përkohshëm me shkresën e MIE me nr. 15474/1 prot, datë 28.12.2018. Nga auditimi rezulton që:

Nuk është marrë në shqyrtim nga komsioni dhe procesverbali ka vetëm nënshkrimin e Sekretarit të Komsionit z.A.H., por nuk i është kthyer përgjigje subjektit siç përcaktohet në Nenin 7, ðNjoftimi i subjekteve, të Rregullores ðPër organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimin e Planit vjetor të Punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit, miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN. Sa sipër, mungon miratimi apo refuzimi rreth programit vjetor të punës nga ana e Drejtorit Ekzekutiv të AKB.

- Nga shqyrtimi i dosjes së subjektit ðX.ö mbi dërgimin e planit vjetor të vitit 2020 paraqitur në AKBN me nr. 7035, datë 25.11.2019, konstatohet se nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Nenit 6, ðProcedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komision, pika nr.5 të Rregullores ðPër organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimin e Planit vjetor të Punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit, miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, pasi subjekti është përfaqësuar nga drejtuesi teknik për mbrojtjen e këtyre planeve.

- Konstatohet se dokumenti procesverbal nuk identifikon nëse subjekti është përfaqësuar nga administratori dhe drejtuesi teknik, kërkesë kjo e nenit 6, pika 3, të Rregullores së funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit. Procesverbali është mbajtur me datë 18.2.2020 dhe është nënshkruar vetëm nga drejtuesi teknik z.Z.L..

- Nga Komisioni është lënë detyra të ndryshohen shitjet në vend (për të cilën nuk ka asnjë arsyetim sqarues rreth treguesit, sa ishte dhe sa duhet ndryshuar dhe për çfarë arsyeje) dhe hartimi i akt-marreveshjes me shoqërinë ðK.ö, dokument i cili është pjesë e dosjes por nuk ka asnjë gjurmë të datës dhe kohës së saj apo dhe një raport që ta konfirmojë reflektimin e këtyre dy kërkesave të lëna nga komisioni, duke administruar dokumentacionin e rregulluar.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se nuk ka asnjë element të identifikimit të dokumenteve që e përbëjnë atë, dmth një listë të dokumenteve me nr. e faqeve, për të shmangur mundësinë e humbjes së dokumentacionit të administruar në to, kërkesë e detyrueshme e dispozitave të arkivit.

Pretendimi Subjektit:

Lidhur me sa është konstatuar sqarojmë si vijon:

Në një numër rastesh, subjektet i dorëzojnë dosjet me mangësi në dokumentacionin Teknik, faturat e Rentës minerare, vërtetimet e Tatimeve si dhe vërtetimet e pushtetit Vendor. Pavarësisht se iu vihet në dispozicion një afat i arsyeshëm për plotësimin e të metave, përsëri

nga ana e subjekteve ka mangësi apo vonesa në plotësimin e tyre. Në mungesë të një rregulloreje me hapa procedurale të mirëpërcaktuar, komisioni është detyruar t'iu lërë një afat tjetër subjekteve duke iu dhënë përsëri mundësinë për plotësimin e të metave. Aktualisht nga ana e AKBN-së është bërë përditësimi i rregullores së brendshme të funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Planeve Vjetore të Punës nëpërmjet të cilit janë përcaktuar afatet e nevojshme për këto raste.

Subjekteve minerare në rast mosmiratimi të projektit vjetor iu kthehet përgjegje për plotësimin e dosjes së rinovimit sipas vërejtjeve të komisionit (dokumentacion juridik, ekonomik dhe teknik). Subjekti brenda afatit 10 ditor nga data e njoftimit është i detyruar që të bëjë plotësimin e dosjes. Në rastet kur nuk përmbushen plotësimet e dosjes, ndaj subjektit propozohen masa si pezullim të aktivitetit deri në revokim të lejes minerare.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Observacioni i paraqitur nga DM pranë AKBN merret pjesërisht në konsideratë pasi duhet të kryhet shqyrtimi i të gjitha dosjeve, plotësimi i tyre si dhe për të gjithë subjektet që kanë paraqitur dokumentacionin për mbrojtjen e planeve vjetore, por nuk janë shqyrtuar sipas afateve të ligjit minerar dhe nuk është kthyer përgjegje nga Drejtoria Minerare sipas Rregullores së miratuar me Urdhrin nr.19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv, të rivendosen në afat, analizohen dhe t'u kthehet përgjegje subjekteve aplikuese.

| | |
|--|---|
| <p>Titulli i gjetjes Nr. 8:</p> | <p>Parregullsi, mangësi dhe të meta në shqyrtimin dhe miratimin e planeve vjetore të punës për subjektet minerare.</p> |
| <p>Situata:</p> | <p>Lidhur me respektimin e ligjshmërisë e rregullshmërisë gjatë kryerjes së procedurave për marrjen në shqyrtim, analizën dhe marrjen e vendimeve përkatëse për miratimin ose jo të planit vjetor të punës së subjekteve të pajisura nga Ministria me lejeve minerare shfrytëzimi, me urdhër të veçantë të Drejtorit Ekzekutiv është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e dokumentacionit të planit vjetor të punës, ku janë përcaktuar qartë detyra dhe mbi atë bazë është operuar.</p> <p>Në kampionet (dosjet) që u morën në shqyrtim, konstatohet së:</p> <p>Miratimi i programit/planit vjetor të punës nga ana e Komisionit, ishte bërë në shumë raste me vonesë, në tejkalim të afatit 30 ditor të parashikuar në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 13, pika 12, duke sjellë si pasojë pengesa në rinovimin e licencës të subjektit zotërues të lejes minerare. Bazuar në nenin 13, pika 12 sipas të cilit ò Në rast mosmiratimi, struktura përgjegjëse e njofton zotëruesin e lejes minerare për arsyet e këtij mosmiratimi. Nëse ajo nuk kthen përgjegje, pas tejkalimit të këtij afati, plani quhet i miratuar, subjekti zotërues i lejes minerare vazhdon aktivitetin mbi bazën e miratimit në heshtje të planit vjetor të punës. Në ato raste kur plani vjetor i punës nuk miratohet nga Komisioni për shkak të mungesës së dokumentacionit të kërkuar dhe njoftimi i subjektit bëhet me vonesë, miratimi në heshtje i planit vjetor të punës, sjell pengesa në ushtrimin e aktivitetit të subjektit.</p> <p>Për ato raste ku, Komisioni është shprehur për plotësim të dokumentacionit nga subjekti minerar, në dosje nuk ka</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>gjurmë/dokument të administruar nga Komisioni, nëse dokumentacioni është plotësuar nga subjekti dhe është marrë në shqyrtim nga Komisioni brenda afatit të përcaktuar prej tij.</p> <p>Nga Grupi i punës (Komisioni) për shqyrtimin e planeve vjetore të punës të subjekteve zotërues të lejeve minerare, për periudhën objekt kontrolli, nuk është mbajtur asnjë protokoll për mbledhjet e zhvilluara. Subjektet zotërues të lejeve minerare, kanë paraqitur pranë AKBN-së programet e punës për rinovimin e lejeve minerare, të cilat pasi janë protokolluar, i kanë kaluar për shqyrtim grupit të punës. Në secilën nga këto dosje është vendosur një procesverbal tip (i parapërgatitur) me hapësirat për plotësim të shënimeve mbi plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit dhe të dhënave të dorëzuara nga subjektet që zotërojnë lejet minerare. Mungon një tabelë kontrolli ku të jenë listuar gjithë dokumentet e nevojshme për dorëzim nga subjekti, sipas Udhëzimeve të lëshuara për këtë qëllim nga Ministri MIE.</p> <p>Në disa raste të mos miratimit të planit vjetor të punës, u evidentua mungesa e procesverbalit të mbajtur nga Komisioni si dhe mungesa e nënshkrimit të anëtarëve të Komisionit, jo në përputhje me kërkesat e nenit 6, pika 5 të Rregullores òPër organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimitò (këtu e më poshtë Rregullorja)</p> <p>Në dosjet e shqyrtuara gjendet përveç dokumentacionit dhe vërtetimeve të sjella nga subjekti privat, edhe procesverbali, i cili është plotësuar manualisht nga grupi i punonjësve të AKBN në disa rubrika të tij si subjekti, mungesat ligjore, mungesat teknike, afati për plotësimin e mangësive të konstatuara në dokumentacion etj.</p> <p>Në ka disa raste nuk ka gjurmë (në procesverbalin tip të mbledhjes së Komisionit) së subjekti minerar ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni si dhe nëse ai është marrë në shqyrtim prej tij.</p> <p>Rregullorja nuk ka parashikuar penalitete për vonesat e krijuara nga Komisioni dhe çdo zyrtar i lidhur me procesin e shqyrtimit të dokumentacionit për miratimin ose jo të programit/planit vjetor të punës, ndërkohë që ka parashikuar penalitete (gjobë) për subjektin zotërues të lejes minerare, në rastet e kalimit të afatit për paraqitjen e dokumentacionit për shqyrtim të programit vjetor/planit të ushtrimit të aktivitetit bazuar kjo në neni 4, pika 2 si dhe Ligjin nr.10304 datë 15.07.2011 òPër sektorin minerar në Republikën e Shqipërisëò neni 12.</p> <p>Në lidhje me këto konstatime/gjetje, grupi i auditimit mori shpjegime nga zyrtarët/anëtarët dhe Sekretari i Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit për miratim të programit/planit vjetor të punës, sipas të cilave rezulton së ka keqinterpretim dhe mosnjohje të akteve ligjore dhe nënligjore e konkretisht të Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 13, pika 12, dhe Rregullores neni 7, miratuar me Urdhrin nr.19, datë</p> |
|--|---|

| | |
|-----------------------|---|
| | 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv. |
| Kriteri: | Ligji nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 13, pika 12, Rregullore òPër organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv, neni 7, pika 1, neni 6, pika 5, neni 4, pika 2 dhe neni 8. |
| Ndikimi/Efekti | Pasojat që vijnë nga këto parregullsi, mangësi dhe të meta në shqyrtimin dhe miratimin e planeve vjetore të punës për subjektet minerare janë vonesat që mund të vijnë në rinovimin e lejes apo në miratimin e planit vjetor të punës për subjektet që zotërojnë leje të shfrytëzimit minerar. |
| Shkaku | Si pasojë mos zbatimit me korrektesë të Rregullores òPër organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit nga çdo anëtar i Komisionit të ekspertëve, të caktuar për këtë qëllim. |
| Rëndësia | E Mesme |
| Rekomandime | Drejtoria Minerare pranë AKBN, të marrë masa për shqyrtimin në afat dhe kthimin përgjigje të planeve vjetore që paraqiten nga subjektet e licencuara për miratim. |

Konstatim:

Mos shlyerja e garancive financiare vjetore të përcaktuara për rehabilitimin mjedisor të zonës së lejuar minerare, nga subjektet me leje shfrytëzimi minerar, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerar, i ndryshuar me ligjin nr. 13/2014, datë 09.10.2014 si dhe VKM nr. 741, datë 09.09.2015.

Rezultojnë disa subjekte me leje aktive minerare të shfrytëzimit, që në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerar, i ndryshuar me ligjin nr. 13/2014, datë 09.10.2014 si dhe VKM nr. 741, datë 09.09.2015 nuk kanë paguar në kohë garancitë financiare të përcaktuara për rehabilitimin mjedisor të zonës së lejuar minerare, sipas nenit 31, të ligjit nr. 10304/2010, neni 31, pika nr.1 që specifikojnë së,

òGarancia financiare për rehabilitimin e mjedisit përlllogaritet në vlerë monetare dhe përdoret nga zotëruesi i lejes ose shteti për realizimin e planit të rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Garancia financiare depozitohet pas marrjes së lejes minerare çdo vit, në datën efektive të marrjes së lejes dhe vlera vjetore përcaktohet në bazë të vlerës së përgjithshme të garancisë financiare për realizimin e planit për rehabilitimin e mjedisit, të miratuar nga ministri, të viteve të jetëgjatësisë së lejes minerare dhe të sasisë së mineralit të programuar për t'u shfrytëzuar çdo vit, sipas planit vjetor të veprimtarisë minerare. Vlera totale e garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit, rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe realizimin e planit të aktiviteteve për mbylljen e veprimtarisë minerare vlerësohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga ministri. Ajo përfshin garancinë financiare për mbylljen e veprimtarisë minerare, mbylljen e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit.ò

Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, duke konstatuar këto vonesa në kryerjen e pagesës së garancisë financiare për rehabilitimin, ka marrë masa duke propozuar revokimin për këto

subjekte në zbatim të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerarò, neni nr. 47, pika nr.1, germa òçò. Saktësisht:

- për vitin 2019 janë kërkuar nga Drejtoria Minerare pranë AKBN-s, 15 revokime;
- për vitin 2020 janë kërkuar nga Drejtoria Minerare pranë AKBN-s, 52 revokime;
- për vitin 2021 janë kërkuar nga Drejtoria Minerare pranë AKBN-s, 6 revokime;

Në mënyrë më të detajuar në aneksin nr. 2

Pretendimi Subjektit:

Gjatë shqyrtimit të Programit Vjetor të Punës në Komision subjekti është i detyruar të sjellë pagesën e Garancisë së Rehabilitimit, pasi është një nga dokumentat që kërkohet për Miratimin e tij (programit) në zbatim të ligjit nr. 10304 datë 15.07.2010 ‘Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar dhe rregullores së funksionimit të komisionit të miratimit të Programit Vjetor të Punës, në të kundërt subjektit nuk i miratohet Programi Vjetor i Punës. Gjithashtu, përpara dërgimit të Propozimeve për Revokime subjektet njoftohen paraprakisht për të bërë pagesën, si nga AKBN-ja ashtu edhe nga MIE.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Observacioni i paraqitur nga DM pranë AKBN merret pjesërisht në konsideratë pasi ende ka subjekte që nuk kanë bërë pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit dhe që ende nuk janë revokuar.

| | |
|-------------------------------------|---|
| Titulli i gjetjes Nr. 9: | Mos shlyerja e garancive financiare vjetore të përcaktuara për rehabilitimin mjedisor të zonës së lejuar minerare, nga subjektet me leje minerare shfrytëzimi. |
| Situata: | Rezultojnë disa subjekte me leje aktive minerare të shfrytëzimit, që në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerarò, i ndryshuar me ligjin nr. 13/2014, datë 09.10.2014 si dhe VKM nr. 741, datë 09.09.2015 <u>nuk kanë paguar në kohë garancitë financiare të përcaktuara për rehabilitimin mjedisor të zonës së lejuar minerare, sipas nenit 31, të ligjit nr. 10304/2010, neni 31, pika nr.1 që specifikojnë së,</u> òGarancia financiare për rehabilitimin e mjedisit përlllogaritet në vlerë monetare dhe përdoret nga zotëruesi i lejes ose shteti për realizimin e planit të rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Garancia financiare depozitohet pas marrjes së lejes minerare çdo vit, në datën efektive të marrjes së lejes dhe vlera vjetore përcaktohet në bazë të vlerës së përgjithshme të garancisë financiare për realizimin e planit për rehabilitimin e mjedisit, të miratuar nga ministri, të viteve të jetëgjatësisë së lejes minerare dhe të sasisë së mineralit të programuar për t'u shfrytëzuar çdo vit, sipas planit vjetor të veprimtarisë minerare. Vlera totale e garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit, rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe realizimin e planit të aktiviteteve për mbylljen e veprimtarisë minerare vlerësohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga ministri. Ajo përfshin garancinë financiare për mbylljen e veprimtarisë minerare, mbylljen e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit.ò |

| | |
|-----------------------|---|
| | Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, duke konstatuar këto vonesa në kryerjen e pagesës së garancisë financiare për rehabilitimin, ka marrë masa duke propozuar revokimin për këto subjekte në zbatim të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerarò, neni nr. 47, pika nr.1, germa òçò. Saktësisht: - për vitin 2019 janë kërkuar nga Drejtoria Minerare pranë AKBN-s, 15 revokime; - për vitin 2020 janë kërkuar nga Drejtoria Minerare pranë AKBN-s, 52 revokime; - për vitin 2021 janë kërkuar nga Drejtoria Minerare pranë AKBN-s, 6 revokime; |
| Kriteri: | Vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10304 (Neni 47, pika1/ç), datë 15.07.2010 òPër sektorin minerarò, i ndryshuar me ligjin nr. 13/2014, datë 09.10.2014 si dhe VKM nr. 741, datë 09.09.2015. |
| Ndikimi/Efekti | Pasojat që vijnë nga këto mos likuidime të garancive të rehabilitimit është pamundësia e rehabilitimit mjedisor të zonave të lejuara për shfrytëzim minerar. |
| Shkaku | Mos zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerarò nga ana e subjekteve me leje shfrytëzimi minerar. |
| Rëndësia | E Lartë |
| Rekomandime | Drejtoria Minerare pranë AKBN të marrë masa duke u kërkuar subjekteve me leje shfrytëzimi minerar, shlyerjen e detyrimeve për garancitë financiare të rehabilitimit, në të kundërt të aplikohen sanksionet e parashikuara në ligjin përkatës. Drejtoria Minerare pranë AKBN të mbajë korespondencë të vazhdueshme me ministrinë e linjës (MIE) për revokimin e lejeve të shfrytëzimit për subjektet që nuk kryejnë pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit. |

Konstatim:

Parregullsi dhe shkelje në aplikimin e rentës minerare nga subjektet; mospërputhja e emrit të mineralit të vendosur në akt miratimin e ministrit të lejes minerare të shfrytëzimit nuk është i saktë me llojin e mineralit që ndodhet në objektin që shfrytëzohet dhe emërtesës së vendosur në ligjin për taksat kombëtare.

Grupi auditimit ka konstatuar parregullsi dhe shkelje në aplikimin e rentës minerare nga subjektet minerare, mospërputhje e emrit të mineralit të vendosur në akt miratimin e ministrit të lejes minerare të shfrytëzimit me emrin e mineralit në terren ku ushtrohet aktiviteti minerar i shfrytëzimit.

Konstatohet së, gjatë shqyrtimit të dosjeve të subjekteve minerare emri i mineralit të vendosur në Akt Miratimin e Ministrit të lejes minerare të shfrytëzimit, nuk është i saktë me emrin e mineralit që ndodhet në objekt ku ushtrohet aktiviteti minerar,

Konstatohet së në Lejen minerare është shënuar gurë gëlqerorë por në terren është gëlqerorë dekorativ, i cili bie ndesh me Ligjin Nr. 9975, datë 28.07. 2008 òPër Taksat Kombëtareò, i ndryshuar.

Për këtë arsye nga ana e AKBN janë mbajtur korrespondenca shkresore me Tatimet dhe Doganat, ku kërkohet informacion mbi rentën e paguar dhe mënyrën së si është paguar kjo rentë minerare edhe për raste specifike.

✓ Me shkresën nr.1646 prot. AKBN datë 21.02.2019 drejtuar Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë në MIE si dhe Komisionit Ad-Hoc pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkohet shtesë minerali në shtojcën nr.2 për mineralin Zhavorr Bituminoz.

✓ Me shkresën nr.1647 prot. AKBN datë 21.02.2019 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, kërkohet bashkëpunim për mënyrën e pagesës së rentës minerare të subjekteve që mineralin e gurit gëlqeror e përdorin për prodhimin e çimentos si Shoqëria òA.C.ò sha dhe Shoqëria òF.K.C.F.ò sha.

Nga AKBN i u është dërguar njoftim subjekteve minerare për pagesën e diferencës së rentës minerare si:

✓ Me shkresën nr.1648 prot. AKBN datë 21.02.2019 drejtuar subjektit òR.ò sh.p.k. për të paguar diferencën e rentës me vlerën 186 lekë/ton dhe jo me 127 lekë/ton.

✓ Me shkresën nr.1649 prot. AKBN datë 21.02.2019 drejtuar subjektit òA.ò sh.p.k. për të paguar diferencën e rentës me vlerën 104 lekë/m³ dhe jo me 47 lekë/m³. Subjekti ka bërë pagesën e diferencës së rentës minerare me marrjen e njoftimit nga AKBN.

Gjithashtu nga shqyrtimi i dosjeve të subjekteve minerare rezulton problematike. Problematikë mbetet mënyra e pagesës së rentës minerare në të njëjtat vendburime për subjekte të ndryshme. Përmendim vendburimin e Mëlovës, Bashkia Skrapar, ku është i njëjti mineral por mënyra e pagesës së rentës minerare është e ndryshme.

Nga shqyrtimi i dosjeve të subjekteve minerare, u konstatua së:

- Subjekti òS.P.ò sh.p.k me leje minerare nr. 862/2 datë 03.04.2015, ku në Akt Miratimin e MIE ka emërtimin e mineralit òGëlqeror i Mermerizuarò dhe paguan rentë me vlerën 104 lekë/m³.

Për këtë arsye AKBN ka mbajtur korrespondencë me MIE si më poshtë:

1. Me shkresën Nr. 441, datë 15.01.2020, AKBN bazuar dhe në shkresën e MIE bën me dije subjektin S.P. së vlera që duhet paguar për rentën minerare është 4095 Lekë/m³.
2. MIE, nëpërmjet shkresës Nr. 674/3, datë 27.02.2020, njofton zyrtarisht subjektin mbi vlerën e rentës që duhet të paguaj.
3. Gjatë kësaj periudhe subjekti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të paguar diferencën e rentës minerare. Me shkresën Nr.2224/1, datë 14.07.2020, AKBN njofton së subjektit i është refuzuar programi vjetor i punës.

Shoqëria pas refuzimit të programit vjetor ka paraqitur një kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për kundërshtimin e aktit Administrativ Nr.2224/1, datë 14.07.2022 ku ka kërkuar dhe sigurimin e padisë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka pranuar kërkesën për sigurimin e padisë nëpërmjet Vendimit Nr.2182, datë 30.07.2020. Pas përfundimit të procesit gjyqësor gjykata nëpërmjet vendimit Nr.2664, datë 28.10.2020 ka rrëzuar pretendimet e AKBN si të pabazuara në ligj dhe në prova pasi emërtimi Gëlqeror i Mermerizuar nuk ekziston në Shtojcën Nr. 2, të ligjit Nr. 9975, datë 28.07.2008 òPër Taksat Kombëtare në Republikën e Shqipërisëò

Nga ana e AKBN janë ankimuar të dy vendimet e sipërcituara çështja është në proces pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, Tiranë.

Subjektit i miratohet programi vjetor i punës si rrjedhojë e pranimit të kërkesës për sigurim padie nga ana e gjykatës.

Në të njëjtin vendburim (Melovë) janë të pajisura me leje minerare shfrytëzimi edhe subjekte të tjera:

- Subjekti òV.H.ò, nr. leje 1656
- Subjekti òT.E.ò, nr. leje 1661/2
- Subjekti òF.ò, nr. leje 1548
- Subjekti òW.S.ò, nr. leje 1653

Këto subjekte kanë në Akt Miratimin nga MIE emërtimin e mineralit òGëlqeror i Mermerizuarò dhe paguajnë rentë minerare në vlerën 4095 lekë/m³, përveç subjektit "S.P." që paguan rentë me vlerën 104 lekë/m³.

Nga sa më sipër konstatohet së emërtimi i mineraleve në Akt Miratimet e ministrit nuk përkon me emërtimet e mineraleve të përcaktuara në Shtojcën Nr. 2, të ligjit Nr. 9975, datë 28.07.2008 òPër Taksat Kombëtare në Republikën e Shqipërisëò, ndryshuar në vitin 2016 dhe si pasojë, renta minerare paguhet sipas "Gjithë mineralet e tjera të grupit të katërt" me vlerën 104 lekë/m³.

Gjithashtu u konstatua së në vendburimin "Lepenicë", Bashkia Selenicë, janë të licencuara 6 Leje Minerare shfrytëzimi, ku në emërtimin e mineralit në Akt Miratimin e Ministrit kanë të shënuar "Gëlqeror Dekorativ", "Gëlqeror i Mermerizuar" dhe "Gëlqeror Masiv". Vendburimi është i njëjtë, ndërsa emërtimet e mineralit janë të ndryshëm. Të gjitha këto subjekte paguajnë rentë minerare sipas zërit "Gjithë mineralet e tjera të grupit të katërt" me vlerën 104 lekë/m³, përcaktuar në Shtojcën Nr. 2, të ligjit Nr. 9975, datë 28.07.2008 òPër Taksat Kombëtare në Republikën e Shqipërisëò.

Duke parë çmimin e tregtimit të këtyre mineraleve që varion nga 25.000 - 30.000 lekë/m³, llogaritet që paguhet detyrim për rentën minerare rreth 0.42 % deri 0.35 % të vlerës (me pagesën për rentë me vlerën 104 lekë/m³).

Për sa më sipër, nisur nga shfrytëzimi me ekonomikitet dhe efektivitet i pasurisë publike me qëllim rritjen e të ardhurave buxhetore, renta minerare duhet të jetë e unifikuar dhe e barabartë për çdo subjekt që zotëron leje shfrytëzimi dhe në kushtet e konkurrencës së lirë midis subjekteve, renta duhet të unifikohet për efekt llogaritjeje sipas llojit të mineralit që shfrytëzohet. Grupi i auditimit ka mendimin së zgjidhja e kësaj situatë do të ishte që pagesa e Rentës Minerare, referuar shtojcës nr. II, òRenta minerare pas klasifikimitò, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 òPër taksat kombëtareò, i ndryshuar, për grupin e mineraleve jometalorë, qymyret, bitumet etj. të mos aplikohet me çmim reference, por me përqindje mbi çmimin e shitjes, ashtu siç aplikohet për kategoritë e mineraleve metalore.

Pretendimi Subjektit:

Për sa i përket konstatimeve tuaja për parregullsitë për rentën minerare, dhe në zbatim të detyrave të lëna më parë nga ana e grupit të Auditit të KLSH-së, për mospërputhjen e emrit të mineralit të vendosur në Akt miratimin e lejes minerare nga Ministri me llojin e mineralit që ndodhet në objektin që shfrytëzohet si dhe me emërtesën e vendosur në ligjin Nr. 9975, dt. 28,07.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, nga ana e AKBN-së është mbajtur korrespondencë e vazhdueshme me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrinë e Financave për unifikimin e rentës minerare si më poshtë:

1. Shkresa me nr. 2368 prot. datë 28.03.2019, ku është kërkuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që pagesa e rentës minerare të mos bëhet me vlerë fikse por në përqindje, të ndarë sipas grupeve të mineraleve.

2. Shkresa me Nr. Prot. 233/5, dt. 30.07.2019, me lëndë: “Mbi problematikat për saktësimin e emërimit të llojit të mineralit në lejet minerare dhe të pagesave të rentës”, drejtuar MIE-s për unifikimin dhe saktësimin e pagesave të rentës minerare, përfshirë dhe Subjektin “S.P.” dhe zonën Melovë, Skrapar dhe Lepenicë, Vlorë,
 3. Shkresa me Nr. Prot. 772, dt. 23.01.2020, me lëndë: “Kërkesë për unifikim të pagesës së rentës minerare”, dërguar MIE-s dhe MFE-së.
 4. Shkresa me Nr. Prot. 1687/2, dt. 28.02.2020, dhe me Nr. Prot. hyrës 772/1, dt. 02.03.2020, me lëndë: “Mbi ngritjen e një grupi pune”, nga MFE.
 5. Shkresa me Nr. Prot. 772/3, dt. 07.07.2020, me lëndë: “Për ngritjen e grupit të punës”, dërguar MFE.
 6. Shkresa me Nr. Prot. 4432, dt. 07.12.2021, me lëndë: “Propozim për rishikimin e emërimit të mineraleve dhe rentës minerare” dërguar MIE-s dhe MFE-së.
 7. Shkresa me Nr. Prot. 2268/1, dt. 11.01.2022 dhe me Nr. Prot. hyrës 212, dt. 13.01.2022, me lëndë: “Kthim përgjigje” nga MFE për dakordësinë e rishikimit të rentës minerare dhe ngritjes së grupit të punës.
 8. Shkresa me Nr. Prot. 212/1, dt. 18.01.2022, me lëndë: “Ngritja e grupit të punës për rishikimin e rentës minerare”, dërguar MFE-së.
 9. Shkresa me Nr. Prot. 4212, dt. 03.03.2022, me Nr. Prot. hyrës 1268, dt. 07.03.2022, me lëndë: “Për ngritjen e Komisionit AD-HOC”, dërguar nga MFE për ngritjen e Komisionit AD-HOC,
 10. Shkresa me Nr. Prot. 1268/1, dt. 10.03.2022, me lëndë: “Kthim përgjigje”, dërguar MFE për propozimin e 2 punonjësve në komisionin AD-HOC.
- Pas propozimeve të dërguara në MIE dhe MEF lidhur me unifikimin e rentës minerare, AKBN mbetet ende në pritje të realizimit të takimeve të përbashkëta për këtë qëllim.
- (Subjekti bie dakort me konstatimin e grupit të auditimit)**

| | |
|---|--|
| <p>Titulli i gjetjes Nr. 10:</p> | <p>Parregullsi në aplikimin e rentës minerare nga subjektet me leje shfrytëzimi mineralar. Mospërputhja e emrit të mineralit të vendosur në akt miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit nga Ministri, me cilësimin dhe llojin e mineralit që shfrytëzohet efektivisht në objekt si dhe emërtesës së vendosur në Ligjin Nr. 9975, datë 28.07. 2008 òPër Taksat Kombëtareò, i ndryshuar</p> <p>Problematikë në mënyrën e pagesës së rentës minerare në të njëjtat vendburime për subjekte të ndryshme.</p> |
| <p>Situata:</p> | <p>Grupi auditimit ka konstatuar parregullsi dhe shkelje në aplikimin e rentës minerare nga subjektet minerare, mospërputhje e emrit të mineralit të vendosur në akt miratimin e ministrit të lejes minerare të shfrytëzimit me emrin e mineralit në terren ku ushtrohet aktiviteti mineralar i shfrytëzimit.</p> <p>Konstatohet së, gjatë shqyrtimit të dosjeve të subjekteve minerare emri i <u>mineralit të vendosur në Akt Miratimin e Ministrit të lejes minerare të shfrytëzimit, nuk është i saktë me emrin e mineralit që ndodhet në objekt ku ushtrohet aktiviteti mineralar.</u></p> <p>Konstatohet së në Lejen minerare është shënuar gurë gëlqerorë por në terren është gëlqerorë dekorativ, i cili bie ndesh me me Ligjin Nr. 9975, datë 28.07. 2008 òPër Taksat Kombëtareò, i ndryshuar.</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>Për këtë arsye nga ana e AKBN janë mbajtur korrespondenca shkresore me Tatimet dhe Doganat, ku kërkohet informacion mbi rentën e paguar dhe mënyrën së si është paguar kjo rentë minerare edhe për raste specifike.</p> <p>✓ Me shkresën nr.1646 prot. AKBN datë 21.02.2019 drejtuar Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë në MIE si dhe Komisionit Ad-Hoc pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkohet shtesë minerali në shtojcën nr.2 për mineralin Zhavorr Bituminoz.</p> <p>✓ Me shkresën nr.1647 prot. AKBN datë 21.02.2019 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, kërkohet bashkëpunim për mënyrën e pagesës së rentës minerare të subjekteve që mineralin e gurit gëlqeror e përdorin për prodhimin e çimentos si Shoqëria òA.C.ò sha dhe Shoqëria òF.K.C.F.ò sha.</p> <p>Nga AKBN i u është dërguar njoftim subjekteve minerare për pagesën e diferencës së rentës minerare si:</p> <p>✓ Me shkresën nr.1648 prot. AKBN datë 21.02.2019 drejtuar subjektit òR.ò sh.p.k. për të paguar diferencën e rentës me vlerën 186 lekë/ton dhe jo me 127 lekë/ton.</p> <p>✓ Me shkresën nr.1649 prot. AKBN datë 21.02.2019 drejtuar subjektit òA.ò sh.p.k. për të paguar diferencën e rentës me vlerën 104 lekë/m³ dhe jo me 47 lekë/m³. Subjekti ka bërë pagesën e diferencës së rentës minerare me marrjen e njoftimit nga AKBN.</p> <p>Gjithashtu nga shqyrtimi i dosjeve të subjekteve minerare rezulton problematikë Problematikë mbetet mënyra e pagesës së rentës minerare në të njëjtat vendburime për subjekte të ndryshme. Përmendim vendburimin e Mëlovës, Bashkia Skrapar, ku është i njëjti mineral por mënyra e pagesës së rentës minerare është e ndryshme.</p> <p>Nga shqyrtimi i dosjeve të subjekteve minerare, u konstatua së:</p> <p>- Subjekti <u>òS.P.ò sh.p.k</u> me leje minerare nr. 862/2 datë 03.04.2015, ku në Akt Miratimin e MIE ka emërtimin e mineralit òGëlqeror i Mermerizuarò dhe paguan rentë me vlerën 104 lekë/m³.</p> <p>Për këtë arsye AKBN ka mbajtur korespondencë me MIE si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 4. Me shkresën Nr. 441, datë 15.01.2020, AKBN bazuar dhe në shkresën e MIE bën me dije subjektin S.P. së vlera që duhet paguar për rentën minerare është 4095 Lekë/m³. 5. MIE, nëpërmjet shkresës Nr. 674/3, datë 27.02.2020, njofton zyrtarisht subjektin mbi vlerën e rentës që duhet të paguaj. 6. Gjatë kësaj periudhe subjekti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të paguar diferencën e rentës minerare. Me shkresën Nr.2224/1, datë 14.07.2020, AKBN njofton së subjektit i është refuzuar programi vjetor i punës. <p>Shoqëria pas refuzimit të programit vjetor ka paraqitur një kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për</p> |
|--|--|

| | |
|------------------------|---|
| | <p>kundërshtimin e aktit Administrativ Nr.2224/1, datë 14.07.2022 ku ka kërkuar dhe sigurimin e padisë.</p> <p>Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka pranuar kërkesën për sigurimin e padisë nëpërmjet Vendimit Nr.2182, datë 30.07.2020. Pas përfundimit të procesit gjyqësor gjykata nëpërmjet vendimit Nr.2664, datë 28.10.2020 ka rrëzuar pretendimet e AKBN si të pabazuara në ligj dhe në prova pasi emërtimi Gëlqeror i Mermerizuar nuk ekziston në Shtojcën Nr. 2, të ligjit Nr. 9975, datë 28.07.2008 ÷Për Taksat Kombëtare në Republikën e Shqipërisë</p> <p>Nga ana e AKBN janë ankimuar të dy vendimet e sipërcituara çështja është në proces pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, Tiranë.</p> <p>Subjektit i miratohet programi vjetor i punës si rrjedhojë e pranimit të kërkesës për sigurim padie nga ana e gjykatës.</p> <p>Në të njëjtin vendburim (Melovë) janë të pajisura me leje minerare shfrytëzimi edhe subjekte të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Subjekti ÷V.H.ö, nr. leje 1656 - Subjekti ÷T.E.ö, nr. leje 1661/2 - Subjekti ÷F.ö, nr. leje 1548 - Subjekti ÷W.S.ö, nr. leje 1653 <p>Këto subjekte kanë në Akt Miratimin nga MIE emërtimin e mineralit ÷Gëlqeror i Mermerizuar dhe paguajnë rentë minerare në vlerën 4095 lekë/m³, përveç subjektit "S.P." që paguan rentë me vlerën 104 lekë/m³.</p> <p>Nga sa më sipër konstatohet së emërtimi i mineraleve në Akt Miratimet e ministrit nuk përkon me emërtimet e mineraleve të përcaktuara në Shtojcën Nr. 2, të ligjit Nr. 9975, datë 28.07.2008 ÷Për Taksat Kombëtare në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar në vitin 2016 dhe si pasojë, renta minerare paguhet sipas "Gjithë mineralet e tjera të grupit të katërt" me vlerën 104 lekë/m³.</p> <p>Gjithashtu u konstatua së në vendburimin "Lepenicë", Bashkia Selenicë, janë të licencuara 6 Leje Minerare shfrytëzimi, ku në emërtimin e mineralit në Akt Miratimin e Ministrit kanë të shënuar "Gëlqeror Dekorativ", "Gëlqeror i Mermerizuar" dhe "Gëlqeror Masiv". Vendburimi është i njëjtë, ndërsa emërtimet e mineralit janë të ndryshëm. Të gjitha këto subjekte paguajnë rentë minerare sipas zërit "Gjithë mineralet e tjera të grupit të katërt" me vlerën 104 lekë/m³, përcaktuar në Shtojcën Nr. 2, të ligjit Nr. 9975, datë 28.07.2008 ÷Për Taksat Kombëtare në Republikën e Shqipërisë.</p> |
| <p>Kriteri:</p> | <p>Vepruar në kundërshtim me Nenin 40 ÷ Renta minerare ÷ të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 ÷Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku shprehimisht përcaktohet së:</p> <p>÷ 1. Renta minerare është detyrim i zotëruesve të lejeve minerare:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, grupin e mineraleve radioaktive dhe grupin e mineraleve ndërtimore; b) të kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të gurëve të çmuar e gjysmë të çmuar. |

| | |
|-----------------------|---|
| | <p>2. Renta minerare llogaritet në përqindje të vlerës së siguar nga shitja e mineralit të papërpunuar, të prodhuar nga zona e lejuar minerare, dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit dhe në buxhetin e njësisve të qeverisjes vendore përkatëse.</p> <p>3. Vlerat e përqindjeve, forma, mënyra e ndarjes dhe afatet e pagesës së rentës minerare përcaktohen në legjislacionin për taksat kombëtare; dhe përcaktimet në Shtojcën nr. 2 të Ligjin Nr. 9975, datë 28.07. 2008 òPër Taksat Kombëtare, i ndryshuar.</p> |
| Ndikimi/Efekti | Pasojat që vijnë nga shmangia e subjekteve në aplikimin e tarifave të ndryshme, në kushte të mungesës së një norme të rentës minerare në përqindje, duke krijuar efekte financiare dhe të ardhura të mungura anë buxhetin e shtetit. |
| Shkaku | Si pasojë e mungesës së përputhjes së emërtimeve të mineralit në lejen e shfrytëzimit dhe llojit të mineralit që shfrytëzohet efektisht nga ana e subjekteve me leje shfrytëzimi mineralar. |
| Rëndësia | E Lartë |
| Rekomandime | Drejtoria Ekzekutive e AKBN të hartojë propozimet për përmirësim të legjislacionit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për ndryshimin e nenit 4, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 òPër taksat kombëtare, i ndryshuar, që pagesa e rentës minerare të bëhet në % të vlerës së produktit të shitur. Gjithashtu të hartojë propozime për rishikimin e Shtojcës nr. 2 òRenta minerale sipas klasifikimit, që i bashkëlidhet ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 òPër taksat kombëtare, i ndryshuar, me qëllimin e unifikimit të mënyrës së pagesës së rentës minerare, duke propozuar dhe rishikimin e përqindjes së rentës minerare për çdo kategori të mineralit, për ti harmonizuar këto dy norma ligjore midis tyre, me qëllim shmangien nga favorizimi që mund të bëhen subjekteve të veçanta nëpërmjet pagimit të diferencuar të rentës minerare nëpërmjet sistemit me tarifë fikse për emërtesa të mineraleve që nuk specifikohen posaçërisht në këtë shtojcë |

Informacion mbi funksionimin e Laboratorit Minerar dhe i Pasurimit, pjesë e Drejtorisë Minerare në AKBN

Spektori i Laboratorit Minerar dhe i Pasurimit është pjesë e Drejtorisë Minerare në AKBN. Ky sektor ka si qëllim kryerjen e analizave të mineraleve të ngurta dhe kryerjen e analizave fiziko kimike të ujërave.

Laboratori kryen analiza për interes të institucionit dhe gjithashtu kryen e analiza për të tretët, (subjektet mineralar ose individë) për të cilat institucioni ka përfitime monetare pasi këto analiza ndaj të tretëve kanë një kosto për subjektet.

Gjate periudhës objekt auditimi janë kryer analiza për të tretët (për subjekte minerare dhe individë) kundrejt pagesave të kryera në bankat e nivelit të dytë për llogari të institucionit të AKBN-së si me poshtë

Tabela e analizave dhe vlerave të paguara nga të tretët për llogari të AKBN-së.

Tabela nr. 51

| Viti | Vlera(Lekë) | Nr analizave |
|--------------|-------------|--------------|
| 2018(6mujII) | 239,000.00 | 21 |

| | | |
|--------|--------------|----|
| 2019 | 307,000.00 | 24 |
| 2020 | 177,500.00 | 16 |
| 2021 | 343,500.00 | 25 |
| Totali | 1,067,000.00 | 86 |

Burimi: Sektori i Laboratorit Minerar

Konstatim:

Grupi i auditimit ka konstatuar së të ardhurat monetare që përfiton institucioni i AKBN-së nga ky laborator janë shumë të ulëta me të cilat nuk përballohen as edhe shpenzimet që ka ky laborator (rrogat, preparatet, reagjentët, lëndët kimike, etj.). Kjo për faktin së në treg ka shumë laborator minerar dhe pasurimi privat si dhe për faktin së ky laborator është ende i pa akredituar. Grupi i auditimit mendon së nëse do të finalizohet akreditimi i këtij laborator do të rritej besueshmëria ndaj të tretëve dhe si pasojë do të rritej edhe fluksi i kryerjes së analizave nga ky laborator.

Gjithashtu, për rritjen e të ardhurave të institucionit si dhe për rritjen e besueshmërisë në analizat e mineraleve, mund të studiohet ndonjë artificë ligjore për të bërë të detyruar kryerjen e analizave të mineraleve nga subjektet minerare të paktën në marrjen e lejes minerare. Në këtë mënyrë mund edhe të shmanget evazioni që mund të vijë nga kryerja e analizave në laboratorët privat.

Gjithashtu grupi i auditimit ka konstatuar së nuk ekziston një rregullore të brendshme të funksionimit të Sektorit të Laboratorit që është në përbërje të Drejtorisë Minerare pranë AKBN-së

Pretendimi Subjektit:

Gjetja dhe rekomandimi për sa më sipër është e reflektuar dhe nga ana e AKBN-së duke u pasqyruar në Raportet Vjetore të Sektorit përkatës siç rezulton edhe në Raportin e fundit të vitit 2021 me nr. projekti 3054, në faqen 310 tek paragrafi -Konkluzione e Projektet/Planet e Rehabilitimit hartohen nga ana e A. dhe A. me hartimin e projekteve nga ana e tyre në AKBN, miratohen projektet dhe më pas dërgohet vendimi në MIE për çeljen e fondeve dhe vazhdimin e procedurës për mbylljen përfundimtare të tyre.

(Subjekti bie dakort me konstatimin e grupit të auditimit)

| | |
|----------------------------------|---|
| Titulli i gjetjes Nr. 11: | Fluksi i ulët i analizave të kryera nga të tretët dhe në laboratorin Minerar dhe të Pasurimit, pjesë e Drejtorisë Minerare në AKBN, si rrjedhojë e këtij fluksi të ulët edhe të ardhurat që vijnë nga ky laborator janë të ulëta. Shkak për këtë është edhe mos akreditimi i këtij laborator. |
| Situata: | Sektori i Laboratorit Minerar dhe i Pasurimit është pjesë e Drejtorisë Minerare në AKBN. Ky sektor ka si qëllim kryerjen e analizave të mineraleve të ngurta dhe kryerjen analizave fiziko kimike të ujërave. Laboratori kryen analiza për interes të institucionit dhe gjithashtu kryen e analiza për të tretët, (subjektet minerar ose individë) për të cilat institucioni ka përfitime monetare pasi këto analiza ndaj të tretëve kanë një kosto për subjektet. Gjate periudhës objekt auditimi janë kryer analiza për të tretët (për subjekte minerare dhe individë) kundrejt pagesave të kryera në bankat e |

| | <p>nivelit të dytë për llogari të institucionit të AKBN-së si me poshtë Tabela e analizave dhe vlerave të paguara nga të tretet për llogari të AKBN-së.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Vlera(Lekë)</th> <th>Nr. analizave</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018(6mujII)</td> <td>239,000.00</td> <td>21</td> </tr> <tr> <td>2019</td> <td>307,000.00</td> <td>24</td> </tr> <tr> <td>2020</td> <td>177,500.00</td> <td>16</td> </tr> <tr> <td>2021</td> <td>343,500.00</td> <td>25</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>1,067,000.00</td> <td>86</td> </tr> </tbody> </table> <p>Grupi i auditimit ka konstatuar së të ardhurat monetare që përfiton institucioni i AKBN-së nga ky laborator janë shumë të ulëta me të cilat nuk përballohen as edhe shpenzimet që ka ky laborator (rrogat, preparatet, reagjentët, lëndët kimike, etj.). Kjo për faktin së në treg ka shumë laborator minerar dhe pasurimi privat si dhe për faktin së ky laborator është ende i pa akredituar.</p> | Viti | Vlera(Lekë) | Nr. analizave | 2018(6mujII) | 239,000.00 | 21 | 2019 | 307,000.00 | 24 | 2020 | 177,500.00 | 16 | 2021 | 343,500.00 | 25 | Totali | 1,067,000.00 | 86 |
|-----------------------|---|---------------|-------------|---------------|--------------|------------|----|------|------------|----|------|------------|----|------|------------|----|---------------|---------------------|-----------|
| Viti | Vlera(Lekë) | Nr. analizave | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2018(6mujII) | 239,000.00 | 21 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2019 | 307,000.00 | 24 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2020 | 177,500.00 | 16 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2021 | 343,500.00 | 25 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Totali | 1,067,000.00 | 86 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Kriteri: | Akreditimi kryhet në përputhje me procedurën e akreditimit të laboratorëve testues dhe kalibruës, mbështetur në Ligjin Nr.9824, datë 01.12.2007 për akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Ndikimi/Efekti | Fluks i ulët në kryerjen e analizave nga të tretet që sjell të ardhura të ulëta financiare për buxhetin e AKBN-së. | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shkaku | Ekzistenca e laboratorëve Fiziko ó Kimik nga subjekte private dhe shtetërore të akredituara. | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Rëndësia | E Lartë | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Rekomandime | <ul style="list-style-type: none"> - Drejtoria Ekzekutive e AKBN të mbajë korrespondencë të vazhdueshme dhe të rrisë bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit. - Krijimi i një rregulloreje të brendshme të funksionimit të Sektorit të Laboratorit që është në përbërje të Drejtorisë Minerare pranë AKBN-së apo përfshirja e këtij sektori në Statut-Rregulloren e funksionimit të AKBN-së. | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

Informacion mbi sektorin e monitorimit post minerar

Sektori i Monitorimit të fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura pjesë e Drejtorisë Minerare, është pjesë e investimeve publike të parashikuara në buxhetin e AKBN në vite, bazuar në ligjin e buxhetit për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

Në zbatim të Ligjit Nr.10 304, dt.15.07.2010 për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, citohet detyra dhe funksioni i këtij sektori.

Në nenin 1 (Qëllimi dhe objekti) theksohet që ky ligj përcakton rregullat për zhvillimin e veprimtarive minerare e postminerare në Republikën e Shqipërisë.

Në përputhje me nenin 2, përkuftizime, pika 24 të këtij ligji me termin monitorim minerar dhe postminerar kuptohet, citojmë, monitorim minerar dhe postminerar është vëzhgimi, regjistrimi, mbajtja nën kontroll i ndryshimeve fiziografike të tokës, ajrit, ujërave, sipërfaqësore apo nëntokësore, dhe ekosistemit në përgjithësi, në zonat ku ushtrohet apo është ushtruar veprimtari minerare, në zonat përreth tyre, si dhe marrja e masave parandaluese për fenomenet negative, që shfaqen gjatë apo pas veprimtarisë minerare.

Sipas pikës 1, neni 43, kreu VII, mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare kryhen nga ministria dhe nga strukturat përgjegjëse në varësi të saj.

Në zbatim të germave ç) dhe d), pika 2, e nenit 43 e këtij ligji, Struktura përgjegjëse (AKBN-ja), midis të tjerave, ka për funksione ÷monitorimin mineral e postmineral të minierave të mbyllura dhe në regjim konservimi, dhe ÷monitorimin e depozitimeve të mbetjeve minerare të minierave në veprimtari të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi.

Mbikëqyrja e procesit të konservimit realizohet nga strukturat përgjegjëse, sipas formës dhe përmbajtjes së projektit të konservimit të minierës të miratuar nga ministri.

V.K.M. nr.232, datë 23.03.2011 ÷ Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë

Detyrat dhe të drejtat e AKBN-së, si strukturë përgjegjëse, përcaktohen në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi. Në përputhje me germën f) e g) të pikës 2, AKBN-ja ka për detyrë të bëjë, citojmë, ÷monitorimin mineral e postmineral të minierave të mbyllura dhe në regjim konservimi dhe, përveç të detyrave të tjera, ÷mbikëqyrjen dhe monitorimin e depozitimeve të mbetjeve minerare të minierave në veprimtari shfrytëzimi, të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi.

Si detyra bazë të Sektorit të ÷Monitorimit të fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura.

- a. Harton në kohe dhe me cilësi projektin vjetor të monitorimit të rreziqeve minerare për minierat e mbyllura dhe metalurgjitë, në kuadër të programit vjetor të investimeve të AKBN.
- b. Mban korrespondencë, nëpërmjet Drejtorit Ekzekutiv, me përfaqësues të pushtetit vendor dhe institucione shtetërore, në zonat minerare, dhe informon ato mbi problemet e shfaqura nga aktiviteti mineral;
- c. Evidenton gjendjen e punimeve minerare të braktisura apo të mbyllura me dalje në sipërfaqe;
- d. Bën propozime me shkrim deri në projekt ide për përmirësimin e gjendjes së konstatuar;
- e. Me miratim të Drejtorit të Drejtorisë, bashkëpunon me drejtues të strukturave të brendshme të AKBN, me institucione të ndryshme të interesuara për zgjidhjen e çështjeve specifike.
- f. Përgatit materiale në lidhje me aktivitetin në terren, si raporte, relacione, informacione, ku pasqyrohen problemet shqetësuese, masat dhe mënyrat për të ndërhyrë me qëllim parandalimin e aksidenteve.

Konstatim:

Grupi i auditimit nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ka konstatuar së gjatë inspektimeve që kryen Sektori ÷Monitorimit të fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura pjesë e Drejtorisë Minerare pranë AKBN-së, ka problematika si më poshtë:

- a) Minierat e mbyllura/braktisura shtetërore, janë mbyllur me mënyrën provizore (të përkohshme). Në vite, pothuaj të gjitha punimet e mbyllura të këtyre minierave janë hapur ose dëmtuar, duke qenë, potencialisht, rrezik serioz për jetën e njerëzve;
- b) Mbyllja e puseve vertikale është kryer me metodën e mbylljes provizore.
- c) Gjendja e objekteve sipërfaqësore, ndërtesave dhe ndërtimeve në të gjitha sheshet industriale të minierave është shumë e degraduar. Ato janë amortizuar dhe të dëmtuara dhe

aktualisht përbejnë rrezik për jetën e banoreve përreth. Vetëm një numër shumë i vogël i këtyre ndërtesave të ish minierave janë privatizuar.

d) Shpesh-herë grupi i monitorimit është ndeshur me dalje të hinkave në sipërfaqe në shumë zona si pasojë e hapësirave të krijuara nga shfrytëzimi në vite në këto ish miniera si përmendim Miniera Rehovë, bashkia Korçë, në Minierën e Mborje Drenovës, bashkia Korçë në Minierën e Kurbneshit bashkia Mirditë, në minierën e Kripës Dhrovjan bashkia Finiq

e) Problematikë tjetër ndërtime mbi ish minierat siç përmendim ato të qarkut të Tiranës (Valias, Mëzes, etj.....

f) Në përgjithësi, sinjalistika treguese e minierave dhe objekteve minerare, sinjalistika paralajmëruese dhe ndaluese e rreziqeve minerare mungon, është e dëmtuar ose jo në përputhje me standardet e sinjalistikës përkatëse për minierat e braktisura. Kjo e bën të vështirë dallimin e zonës të minerares së mbyllur dhe të objekteve të saj nga banorët e zonës apo të kalimtarëve të rastit.

g) Dambat e fabrikave të pasurimit të mineralit të bakrit, që nuk janë rehabilituar, janë në gjendje jo të mirë. Mund të përmendim damba e sterileve të ish fabrikës së pasurimit të bakrit Kurbneshit, në të cilën krijuar disa gropa (hinka) me diametër dhe thellësi prej disa metrash dhe janë dëmtuar (erozion nga ujërat) sipërfaqet ballore dhe anësore të dambave, kryesisht nga dëmtimi, apo mungesa, i kanaleve të ujërave të larta dhe, për pasojë, mos kontrolli i ujërave të shiut dhe të dëborës.

h) Disa miniera të mbyllura si minierat e kripës D. e M., të fosforiteve Gusmar e Fushëbardhë apo ish miniera e qymyrgurit G., nuk janë në administrim të asnjë prej tre shoqërive (A., A.B. dhe Ak.), që administrojnë miniera e mbyllura/braktisura.

Pretendimi Subjektit:

Ky rekomandim i dhënë nga Grupi i Auditimit është e reflektuar nga ana e AKBN-se në verifikimet e terrenit dhe e pasqyruar si gjetje në Raportet Vjetore në Vite të Sektorit perkates ku përmendim Raportin e fundit të vitit 2021 me nr projekti 3054, në faqen 310 tek pragrafi Konkluzione dhe më poshtë dhënë Rekomandime. Lista me subjektet të cilat nuk janë mbyllur ose që nuk janë mbyllur definitivisht do të ridërgohet në MIE.

Drejtoria Minerare pranë AKBN-së ka paraqitur në MIE zonat për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare sipas Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, sipas nenit 8 pika 4, 5, 6, 7 të ligjit minerar.

Pika 4. Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare hartohet nga ministria paskëshillimitmeministrisë përgjegjëse për mjedisin,pyjet, zonate mbrojtura,tokënbujqësore,trashëgiminëkulturore, turizmin embrojtjen dhenjësitë e qeverisjes vendorepërkatëse, dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

Pika 5. Në zbatim të programit të veprimit miratohet plani vjetor minerar, i cili përmban zonat minerare, për të cilat do të jepen të drejtat minerare, në vitin përkatës, zonat minerare, të drejtat minerare të të cilave përfitohen në bazë të një konkurimi publik, në vijim zona konkurruese, dhe zonat e hapura, të drejtat minerare të të cilave përfitohen nga subjektet e interesuara, që plotësojnë kushtet e lejimit, në vijim zona të hapura.

Pika 6. Planin vjetor minerar hartohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga Ministri. Planin vjetor minerar është kalendarik dhe pas miratimit publikohet në faqen e internetit të ministrisë dhe në Fletoren Zyrtare dhe pasqyrohet në hartën minerare dixhitale.

Pika 7. Ministri miraton procedurat për përgatitjen e programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare dhe të planit vjetor minerar, duke siguruar publikimin, transparencën dhe

këshillimet me subjektet e interesuara gjatë këtij procesi.

Drejtoritë përgjegjëse në MIE realizojnë të gjitha procedurat e miratimit të Programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare nga Këshilli i Ministrave (Urdhëri nr.305, datë 13.04.2011).

Sa më sipër Drejtoria Minerare pranë AKBN-së ka kryer njoftimet dhe zbatimin e detyrave të saj me dërgimin e propozimeve për zonat minerare. Aktualisht, publikimi i këtyre zonave konkurruese dhe të hapuara është kompetencë ligjore e "MIE"-s.

Nga ana e AKBN-së janë dërguar propozimet, plani 3-vjecar 2022-2024 shkresa me nr 3653/1 datë 01.11.2021, shkresa me nr. 3653/2 datë 28.12.2021 dhe shkresa me nr 1048 prot. datë 22.02.2022.

(Subjekti bie dakort me konstatimin e grupit të auditimit)

| | |
|------------------------------|---|
| Titulli i gjetjes Nr. 12: | Problematika dhe parregullsi të konstatuara gjatë inspektimeve që ka kryer Sektori i Monitorimit të fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura pjesë e Drejtorisë Minerare pranë AKBN-së |
| Situata: | <p>Grupi i auditimit nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ka konstatuar së gjatë inspektimeve që kryen Sektori i Monitorimit të fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura pjesë e Drejtorisë Minerare pranë AKBN-së, ka problematika si më poshtë:</p> <p>a) Minierat e mbyllura/braktisura shtetërore, janë mbyllur me mënyrën provizore (të përkohshme). Në vite, pothuaj të gjitha punimet e mbyllura të këtyre minierave janë hapur ose dëmtuar, duke qenë, potencialisht, rrezik serioz për jetën e njerëzve;</p> <p>b) Mbyllja e puseve vertikale është kryer me metodën e mbylljes provizore.</p> <p>c) Gjendja e objekteve sipërfaqësore, ndërtesave dhe ndërtimeve në të gjitha sheshet industriale të minierave është shumë e degraduar. Ato janë amortizuar dhe të dëmtuara dhe aktualisht përbejnë rrezik për jetën e banoreve përreth. Vetëm një numër shumë i vogël i këtyre ndërtesave të ish minierave janë privatizuar.</p> <p>d) Shpesh-herë grupi i monitorimit është ndeshur me dalje të hinkave në sipërfaqe në shumë zona si pasojë e hapësirave të krijuara nga shfrytëzimi në vite në këto ish miniera si përmendim Miniera R., bashkia Korçë, në Minierën e M. D., bashkia Korçë në Minierën e K. bashkia Mirditë, në minierën e K.Dh. bashkia Finiq.</p> <p>e) Problematikë tjetër ndërtime mbi ish minierat sic përmendim ato të qarkut të Tiranës (Valias, Mëzez, etj.....</p> <p>f) Në përgjithësi, sinjalistika treguese e minierave dhe objekteve minerare, sinjalistika paralajmëruese dhe ndaluese e rreziqeve minerare mungon, është e dëmtuar ose jo në përputhje me standardet e sinjalistikës përkatëse për minierat e braktisura. Kjo e bën të vështirë dallimin e zonës të minierares së mbyllur dhe të objekteve të saj nga banorët e zonës apo të kalimtarëve të rastit.</p> <p>g) Dambat e fabrikave të pasurimit të mineralit të bakrit, që nuk janë rehabilituar, janë në gjendje jo të mirë. Mund të përmendim damba e sterileve të ish fabrikës së pasurimit të bakrit Kurbneshit, në të cilën</p> |

| | |
|----------------|---|
| | <p>krijuar disa gropa (hinka) me diametër dhe thellësi prej disa metrash dhe janë dëmtuar (erozion nga ujërat) sipërfaqet ballore dhe anësore të dambave, kryesisht nga dëmtimi, apo mungesa, i kanaleve të ujërave të larta dhe, për pasojë, mos kontrolli i ujërave të shiut dhe të dëborës.</p> <p>h) Disa miniera të mbyllura si minierat e kripës D. e M., të fosforiteve Gusmar e Fushëbardhë apo ish miniera e qymyrgurit G., nuk janë në administrim të asnjë prej tre shoqërive (Am., AB. dhe Ak.), që administrojnë miniera e mbyllura/braktisura.</p> |
| Kriteri: | Zbatimi Ligjit Nr.10 304, dt.15.07.2010 për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, (Neni nr. 1. Neni nr. 2, pika 1. Kreu VI, Neni nr. 43, pika 1. Neni nr. 43, pika 2, germa òço dhe òdò Zbatimi i nenit nr. 48, nenit nr. 49, nenit nr. 53 dhe i nenit nr. 54 të ligjit Mineral nr.10304, datë 15.07.2010, për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, (të ushtrohet detyrimi i zbatimit të planit të mbylljes, rehabilitimit dhe trajtimit të mbetjeve, nga subjektet që kanë qenë zotërues të lejeve përkatëse minerare.) |
| Ndikimi/Efekti | Rreziqe shembjeje në zonat ku ka patur miniera të mbyllura/braktisura |
| Shkaku | Mungesa e investimit në këto zona për të bërë rehabilitimin e këtyre zonave për shmangjen e rreziqeve që mund të vijnë si pasojë e degradimit të tyre. |
| Rëndësia | E Lartë |
| Rekomandime | <p>Drejtorja Ekzekutive e AKBN të marrë masa për plotësimin e kriterëve dhe aplikimin për akreditim, me qëllim rritjen e numrit dhe cilësisë së analizave, rrjedhimisht rritjen e monitorimit të aktivitetit mineral dhe të ardhurave të institucionit.</p> <p>AKBN të marrë masa për hartimin e një rregulloreje të funksionimit të Sektorit të Laboratorit që është në përbërje të Drejtorisë Minerare pranë AKBN-së, si dhe përfshirja e këtij sektori në Statut-Rregulloren e funksionimit të AKBN-së.</p> |

Informacion mbi Sektorin e Akt Verifikimit dhe Trajtimit të Ankesave

Sektori i Akt ó Verifikimeve është pjesë e Drejtorisë Minerare në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Sektori zhvillon aktivitetin e tij në bazë të Ligjit nr. 10304 date 15.07.2010 për Sektorin Mineral në Republikën Shqipërisë i ndryshuar, VKM nr. 942 datë 17.11.2010 për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura dhe Rregulloren e Brendshme të AKBN-së.

Sektori përbëhet nga 3 (tre) specialistë të fushës së shfrytëzimit të mineraleve dhe në strukturën e tij ka:

1 Inxhinier Markshajder (Topograf)

1 Inxhinier Miniere

1 Inxhinier Gjeolog

Detyrat funksionale të Sektorit

- Kryerja e Akt ó Verifikimeve për zonat e shpallura fituese në konkurim,
- Kryerja e Akt ó Verifikimeve për shtyrjen e afatit të lejeve minerare

- Kryerja e Akt 6 Verifikimeve për lejet minerare që u jepet e drejta për fillim procedurash nga MIE për zgjerim zone.(VKM 218)
 - Vendorsja e koordinatave në terren me kërkesën e vete subjektit
 - Angazhimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis subjekteve në përcaktimin e kufijve të zonave të licencuara dhe problemeve të tjera që lindin gjatë aktivitetit mineral.
 - Angazhimi në zgjidhjen e problemeve me Urdhër dhe Porosi nga MIE
 - Angazhimi për kryerjen e të gjitha detyrave të ngarkuara nga organet eprore të AKBN-së.
 - Studimi dhe ndjekja në vazhdimësi e legjislacionit në fushën minerare, etj.
 - Sektori përpilon temën studimore ÷Përcaktimi i zonave të mundshme për licencim për leje minerare shfrytëzimi
- Për kryerjen e Akt-Verifikimeve janë përcaktuar tarifat në bazë të Urdhrit të Ministrit Nr.250,date 31.12.2013, të përcaktuara këto sipas zonave

Tabela nr. 52

| Tarifat e akt-verifikimeve dhe mbikëqyrjes për vlerësimin e kthimit të garancisë të investimit sipas rretheve | | |
|---|-------------------|---------------|
| Nr | Rrethi | Tarifa (Lekë) |
| 1 | Mirdita | 69,000 |
| 2 | Pukë | 162,000 |
| 3 | Kukës | 166,000 |
| 4 | Hasi | 171,000 |
| 5 | Mati | 157,000 |
| 6 | Bulqizë | 164,000 |
| 7 | Krujë+Tiranë | 61,000 |
| 8 | Kurbini | 69,000 |
| 9 | Shkodër | 157,000 |
| 10 | Lezhë | 72,000 |
| 11 | Malësi e madhe | 161,000 |
| 12 | Dibër | 168,000 |
| 13 | Korçë | 168,000 |
| 14 | Berati | 156,000 |
| 15 | Devoll | 172,000 |
| 16 | Mallakastër | 158,000 |
| 17 | Tropojë | 197,000 |
| 18 | Skrapari | 165,000 |
| 19 | Elbasani + Peqini | 63,000 |
| 20 | Kolonjë | 182,000 |
| 21 | Gjirokastër | 189,000 |
| 22 | Kavajë | 63,000 |
| 23 | Lushnje | 67,000 |

| | | |
|----|-------------------|---------|
| 24 | Librazhd | 74,000 |
| 25 | Vlorë | 161,000 |
| 26 | Përmet | 168,000 |
| 27 | Pogradec | 158,000 |
| 28 | Sarandë + Delvinë | 191,000 |
| 29 | Fieri | 79,000 |
| 30 | Tepelenë | 181,000 |

Burimi: Sektori i Akt Verifikimit dhe Trajtimin të Ankesave

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua që për periudhën objekt auditimi janë kryer këto Akt Verifikime.

Tabela nr. 53

| Viti | Nr. Akt Verifikime |
|--------------|--------------------|
| 2018 | 74 |
| 2019 | 42 |
| 2020 | 45 |
| 2021 | 26 |
| Shuma | 187 |

Burimi: Sektori i Akt Verifikimit dhe Trajtimin të Ankesave

Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua që për periudhën objekt auditimi këto Akt Verifikime të ardhurat financiare të përfituara nga pagesat e kryera nga të tretët janë:

Tabela nr. 54

| Viti | Totali (lekë) |
|--------------|----------------------|
| 2018 | 6,000,000.00 |
| 2019 | 4,900,000.00 |
| 2020 | 3,500,000.00 |
| 2021 | 2,300,000.00 |
| Total | 16,700,000.00 |

Burimi: Drejtoria Ekonomike

Konstatim:

Grupi i auditimit ka konstatuar së nga sektori *Sektori i Akt Verifikimit dhe Trajtimin të Ankesave* ka patur një ulje të ndjeshme në numrin e Akt Verifikimeve të kryera ndër vite dhe si rrjedhojë edhe të ardhurat e përfituara nga të tretët për Akt Verifikimet e kryera nga *Sektori i Akt Verifikimit dhe Trajtimin të Ankesave kanë ardhur në rënie të ndjeshme. Kjo për faktin së MIE nuk ka publikuar zona të reja për shfrytëzimin minerar.*

Pretendimi Subjektit:

Drejtoria Minerare pranë AKBN-së ka paraqitur në MIE zonat për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare sipas Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, sipas nenit 8 pika 4, 5, 6, 7 të ligjit minerar.

Pika 4. Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare hartohet nga ministria

paskëshillimitmeministritë përgjegjëse për mjedisin,pyjet, zonate mbrojtura,tokënbujqësore,trashëgiminëkulturore, turizmin embrojtjen dhenjësitë e qeverisjes vendorepërkatëse, dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

Pika 5. Në zbatim të programit të veprimit miratohet plani vjetor minerar, i cili përmban zonat minerare, për të cilat do të jepen të drejtat minerare, në vitin përkatës, zonat minerare, të drejtat minerare të të cilave përfitohen në bazë të një konkurimi publik, në vijim zona konkurruese, dhe zonat e hapura, të drejtat minerare të të cilave përfitohen nga subjektet e interesuara, që plotësojnë kushtet e lejimit, në vijim zona të hapura.

Pika 6. Plani vjetor minerar hartohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga Ministri. Plani vjetor minerar është kalendarik dhe pas miratimit publikohet në faqen e internetit të ministrisë dhe në Fletoren Zyrtare dhe pasqyrohet në hartën minerare dixhitale.

Pika 7. Ministri miraton procedurat për përgatitjen e programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare dhe të planit vjetor minerar, duke siguruar publikimin, transparencën dhe këshillimet me subjektet e interesuara gjatë këtij procesi.

Drejtoritë përgjegjëse në MIE realizojnë të gjitha procedurat e miratimit të Programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare nga Këshilli i Ministrave (Urdhëri nr.305, datë 13.04.2011).

Sa më sipër Drejtoria Minerare pranë AKBN-së ka kryer njoftimet dhe zbatimin e detyrave të saj me dërgimin e propozimeve për zonat minerare. Aktualisht, publikimi i këtyre zonave konkurruese dhe të hapura është kompetencë ligjore e “MIE”-s.

Nga ana e AKBN-së janë dërguar propozimet, plani 3-vjecar 2022-2024 shkresa me nr 3653/1 datë 01.11.2021, shkresa me nr. 3653/2 datë 28.12.2021 dhe shkresa me nr 1048 prot. datë 22.02.2022.

(Subjekti bie dakort me konstatimin e grupit të auditimit)

| Titulli i gjetjes Nr. 13: | <i>Rënia e fluksit të Akt Verifikimeve dhe si rrjedhojë edhe rënia e të ardhurave që AKBN përfiton nga subjektet që zotërojnë leje të shfrytëzimit minerar për kryerjen e Akt Verifikimeve.</i> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|--------------------------------------|--|------|--------------------|------|----|------|----|------|----|------|----|--------------|------------|------|---------------|------|--------------|------|--------------|------|--------------|------|--------------|
| Situata: | <p><i>Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua që për periudhën objekt auditimi janë kryer këto Akt Verifikime.</i></p> <table border="1" data-bbox="624 1395 1230 1585"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Nr. Akt Verifikime</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018</td> <td>74</td> </tr> <tr> <td>2019</td> <td>42</td> </tr> <tr> <td>2020</td> <td>45</td> </tr> <tr> <td>2021</td> <td>26</td> </tr> <tr> <td>Shuma</td> <td>187</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua që për periudhën objekt auditimi këto Akt Verifikime të ardhurat financiare të përfituara nga pagesat e kryera nga të tretët janë:</i></p> <table border="1" data-bbox="759 1727 1094 1937"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Totali (lekë)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018</td> <td>6,000,000.00</td> </tr> <tr> <td>2019</td> <td>4,900,000.00</td> </tr> <tr> <td>2020</td> <td>3,500,000.00</td> </tr> <tr> <td>2021</td> <td>2,300,000.00</td> </tr> </tbody> </table> | Viti | Nr. Akt Verifikime | 2018 | 74 | 2019 | 42 | 2020 | 45 | 2021 | 26 | Shuma | 187 | Viti | Totali (lekë) | 2018 | 6,000,000.00 | 2019 | 4,900,000.00 | 2020 | 3,500,000.00 | 2021 | 2,300,000.00 |
| Viti | Nr. Akt Verifikime | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2018 | 74 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2019 | 42 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2020 | 45 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2021 | 26 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shuma | 187 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Viti | Totali (lekë) | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2018 | 6,000,000.00 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2019 | 4,900,000.00 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2020 | 3,500,000.00 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2021 | 2,300,000.00 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

| | |
|-----------------------|--|
| | Total 16,700,000.00 |
| | Grupi i auditimit ka konstatuar së nga sektori <i>Sektori i Akt Verifikimit dhe Trajtimit të Ankesave</i> ka patur një ulje të ndjeshme në numrin e Akt Verifikimeve të kryera ndër vite dhe si rrjedhojë edhe të ardhurat e përfituara nga të tretët për Akt Verifikimet e kryera nga <i>Sektori i Akt Verifikimit dhe Trajtimit të Ankesave</i> kanë ardhur në rënie të ndjeshme. <i>Kjo për faktin së MIE nuk ka publikuar zona të reja për shfrytëzimin mineral.</i> |
| Kriteri: | - Bazuar në Ligjin nr. 10304 date 15.07.2010 ÷Për Sektorin Mineral në Republikën Shqipërisë i ndryshuar, VKM nr. 942 datë 17.11.2010 ÷Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura dhe Rregulloren e Brendshme të AKBN-së. - VKM nr. 218, datë 11.3.2015 ÷Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe rregullave për shfrytëzimin, në sipërfaqe dhe nëntokë, të zonave që janë ngjitur me lejet ekzistuese dhe ndryshimin e koordinatave për lejet minerare të përcaktuara në hapësirë me tri koordinata |
| Ndikimi/Efekti | Rënia e të ardhurave të përfituara nga AKBN |
| Shkaku | <i>Kjo për faktin së MIE nuk ka publikuar zona të reja për shfrytëzimin mineral.</i> |
| Rëndësia | E Lartë |
| Rekomandime | Drejtoria Minerare pranë AKBN-së si dhe Drejtoria Ekzekutive e AKBN të bëjë kërkesë në MIE për publikimin e zonave të reja për shfrytëzim mineral. |

INFORMACION PER PROBLEMATIKEN E KRIJUAR NE BASHKITE KRUIJE DHE SKRAPARE PAS REVOKIMIT TE LEJEVE MINERARE

1.Për lejet e revokuara në bashkinë Krujë objekti Krastë –Verjon

Konstatim:

Gjatë vitit 2019, bazuar në Urdhërin e Përbashkët Nr. 322 datë 13.09.2018 për "Ngritjen e grupit të punës për kontrollin mbi zbatimin e kërkesave të Lejeve të Mjedisit dhe të Lejeve Minerare nga subjektet e shfrytëzimit mineral (guratorët), që preken nga zbatimi i VKM Nr. 468 date 26.07.2018 "Për shpalljen e Peisazhit Natyror të Mbrojtur Krastë - Verjon", të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, u propozuan dhe më pas u revokuan nga MIE 16 leje minerare, më datë 29.05.2019 që ushtronin aktivitet mineral shfrytëzimi në këtë vendburim.

Këto leje zënë një sipërfaqe totale të liçensuar prej 5.5025 km² dhe sipërfaqja e prekur është 0.5514 km² kurse sipërfaqja e demtuar në vite është 0.95km²

Në kontrollin e ushtruar nga Drejtoria Minerare pranë AKBN-së në bashkinë e Krujës në muajin Dhjetor 2020 u konstatua se nuk ishte bërë evadimi dhe as çmontimi i plotë i materialeve në këtë zonë, por vazhdohej të punohej.

Vlen të përmendet, se nisur nga kjo situatë Drejtoria Minerare pranë AKBN-ës i është drejtuar me shkresën Nr. 4627 Prot. datë 24.12.2021 institucioneve si më poshtë:

- **Ministrisë Infeastrukturës dhe Energjisë;**
- **Drejtorisë së Përgjithëshme të Policisë së Shtetit**
- **Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit**
- **Bashkisë Krujë**

Gjithashtu muajin Tetor 2021, Drejtoria Minerare pranë AKBN-së mbikqyri zonën ku janë revokuar këto leje minerare dhe ku ka rezultuar që punohej nga persona të pa identifikuar dhe për këtë situatë Drejtoria Minerare pranë AKBN-së i drejtuar me një shkresë me Nr. 3538 Prot, datë 25.10.2021 Ministrisë Infeastrukturës dhe Energjisë.

Vazhdimi i këtij aktiviteti minerare pa Plan Vjetor pune sjell si pasojë zgjerimin e sipërfaqeve të prekura si dhe punohet jashtë kushteve teknike dhe rrezikon jetën e njerëzve që punojnë në këto aktivitete. Duhet theksuar se këto subjekte ushtrojnë aktivitetin e tyre në informalitet të plotë pasi këtyre subjekteve u është revokuar leja minerare, gjë e cila sjell si pasojë edhe shmangjen e pagesës së rentës minerare.

2. Per lejet e revokuara në objektin Novaj bashkia Skrapar.

Konstatim:

Në Bashkinë e Skraparit, objekti Novaj ishin të liçencuara gjithsej 11 subjekte me leje minerare shfrytëzimi për prodhimin e mineralit të gëlqeror pllakorë. Bazuar në VKM Nr. 611, datë 11.09.2019 "Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar "Mali i Tomorit", dhenë zbatim të Urdhërit të Ministrit nr. 378, datë 07.10.2019 "Për caktimin e grupeve të inspektimit në terren për Ministrinë e Infeastrukturës dhe Energjisë për vlerësimin e përmbushjes së kërkesave ligjore nga subjektet që ushtrojnë veprimtari për shfrytëzimin minerar, brenda dhe në afërsi të parkut kombëtar të "Malit të Tomorrit" u realizua revokimi i 11 lejeve minerare më datë 19.12.2019.

Këto leje zënë një sipërfaqe totale të liçensuar prej 1.01 km² dhe sipërfaqja e prekur është 0.3528 km², por jashtë sipërfaqes se liçencuar sipërfaqja e prekur rezulton te jete rreth 80 hektare.

Nga informacionet e ardhura në AKBN por që kanë ardhur jo në rrugë zyrtare, pasi nga ana e Drejtorisë Minerare pranë AKBN-së nuk është ushtruar mbikqyrje në këtë objekt, subjektet me leje shfrytëzimi të revokuar vazhdojnë të zhvillojnë aktivitetet minerar të jashtëligjshëm.

Pretendimi Subjektit:

Në Bashkinë e Skraparit, në objektin Novaj ishin të liçencuara gjithsej 11 subjekte me leje minerare shfrytëzimi për prodhimin e mineralit të gëlqerorit pllakor. Bazuar në VKM Nr. 611, datë 11.09.2019 "Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar "Mali i Tomorit", dhe në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr. 378, datë 07.10.2019 "Për caktimin e grupeve të inspektimit në terren për Ministrinë e Infeastrukturës dhe Energjisë për vlerësimin e përmbushjes së kërkesave ligjore nga subjektet që ushtrojnë veprimtari për shfrytëzimin minerar, brenda dhe në afërsi të parkut kombëtar të "Malit të Tomorrit" u be revokimi i 11 lejeve minerare me datë 19.12.2019.

Nga vrojtimit e kryera prej specialistëve të AKBN-së rezulton se; në zonën Novaj është kryer aktivitetet minerar në të gjitha ish lejet minerare të shfrytëzimit dhe sipërfaqja e prekur nga shfrytëzimi është rritur në raport me atë që ka qenë në momentin e revokimit të lejeve minerare të shfrytëzimit, ndërkohë persona të panjohur punojnë pa projekte minerare, nuk paguajnë garanci për rehabilitimin e mjedisit dhe rentë minerare për mineralin e shitur.

Këto leje zënë një sipërfaqe totale të liçensuar prej 1.01 km² dhe sipërfaqja e prekur deri në momentin e revokimit të Lejeve Minerare të Shfrytëzimit ishte 0.3528 km², kurse sipërfaqja e dëmtuar aktualisht është rritur krahasuar me atë që ka qenë në momentin e revokimit të lejeve minerare.

Duke qene se AKBN ka ne objekt te veprimtarise se saj monitorimin e subjekteve qe ushtrojne aktivitet ne baze te lejeve minerare, ndalimi i aktivitetit te paligjshem minerar në zonë, është në kompetencë të pushtetit lokal dhe organeve ligj-zbatuese të Policisë së Shtetit, duke i paraprirë rehabilitimit të zonës.

Në Bashkinë Krujë, pas daljes së V.K.M-së nr. 468, datë 26.07.2018 “Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë-Verjon, Peisazh i Mbrojtur”, u revokuan 16 leje minerare shfrytëzimi, nga të cilat 4 leje minerare shfrytëzimi u revokuan gjatë muajit Dhjetor 2018, ndërsa 12 lejet e tjera u revokuan gjatë muajit Maj 2019.

Gjatë mbikqyrjes në terren të lejeve minerare të shfrytëzimit që janë aktive në Bashkinë Krujë në Tetor 2021, nga specialistët e Drejtorisë Minerare është vërejtur se, në ish lejet minerare të shfrytëzimit të revokuara në zonën “Krastë -Verjon” që është shpallur zonë e mbrojtur sipas V.K.M nr. 468, datë 26.07.2018, kryhet aktivitet minerar nga individë të palicënsuar duke shmangur detyrimet e rentës minerare, pagesën e detyrimeve për rehabilitimin e zonës së dëmtuar dhe duke kryer aktivitet minerar jashtë kushteve teknike. Këto leje zënë një sipërfaqe totale të liçensuar prej 5.5025 km² dhe sipërfaqja e prekur deri në momentin e revokimit të Lejeve Minerare të Shfrytëzimit ishte 0.5514 km², kurse sipërfaqja e dëmtuar aktualisht është rritur krahasuar me atë që ka qenë në momentin e revokimit të lejeve minerare. Nga kontrolli i ushtruar në Bashkinë e Krujës në muajin Dhjetor 2020 nuk është bërë ç’montimi dhe evadimi i plotë i materialeve në këtë zonë por vazhdohej e punohej.

Nisur nga kjo situatë Drejtoria Minerare pranë AKBN-së i është drejtuar me një shkresë me Nr. 4627 Prot. datë 24.12.2020 institucioneve si:

- *Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë*
- *Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit*
- *Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit*
- *Bashkisë Krujë*

Në muajin Tetor 2021 AKBN-ja vrojtoi zonën ku janë revokuar këto leje minerare dhe rezultoi që punohej nga persona të pa identifikuar dhe të pa liçensuar për kryerje të aktivitetit minerar të shfrytëzimit. Për këtë situatë AKBN-ja i është drejtuar me shkresë me Nr. 3538 Prot., datë 25.10.2021 Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Zhvillimi i aktivitetit minerar pa Plan Vjetor të punës rrit sipërfaqen e prekur nga shfrytëzimi, punohet jashtë kushteve teknike duke rrezikuar jetën e njerëzve që punojnë aty, shmang rentën minerare pasi këto subjekte janë të palicënsuar dhe për këtë arsye nuk paguajnë Rentë minerare. Subjektet, zotërues të ish lejeve minerare të shfrytëzimit në këtë zonë, të revokuara, janë në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Dytë.

AKBN-ja, në vijimësi do të bëjë verifikimin në këto dy zona duke informuar instancat përgjegjëse si Ministrinë e linjës, Pushtetin vendor dhe organet ligj zbatuese për zbatimin e kompetencave ligjore.

(Subjekti bie dakort me konstatimin e grupit të auditimit)

| | |
|--------------------------------------|--|
| Titulli i gjetjes Nr. 14: | Shfrytëzimi i objekteve minerare nga subjekte të palicensuara apo me leje minerare të revokuar. |
| Situata: | <p>Gjatë vitit 2019, bazuar në Urdhërin e Përbashkët Nr. 322 datë 13.09.2018 për "Ngritjen e grupit të punës për kontrollin mbi zbatimin e kërkesave të Lejeve të Mjedisit dhe të Lejeve Minerare nga subjektet e shfrytëzimit mineral (gurorët), që preken nga zbatimi i VKM Nr. 468 date 26.07.2018 "Për shpalljen e Peisazhit Natyror të Mbrojtur Krastë - Verjon", të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, u propozuan dhe më pas u revokuan nga MIE 16 leje minerare, më datë 29.05.2019 që ushtronin aktivitetet mineral shfrytëzimi në këtë vendburim.</p> <p>Këto leje zënë një sipërfaqe totale të licencuar prej 5.5025 km² dhe sipërfaqja e prekur është 0.5514 km² kurse sipërfaqja e demtuar në vite është 0.95km²</p> <p>Në kontrollin e ushtruar nga Drejtoria Minerare pranë AKBN-së në bashkinë e Krujës në muajin Dhjetor 2020 u konstatua se nuk ishte bërë evadimi dhe as çmontimi i plotë i materialeve në këtë zonë, por vazhdohej të punohej.</p> <p>Vlen të përmendet, se nisur nga kjo situatë Drejtoria Minerare pranë AKBN-ës i është drejtuar me shkresën Nr. 4627 Prot. datë 24.12.2021 institucioneve si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë; • Drejtorisë së Përgjithëshme të Policisë së Shtetit • Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit • Bashkisë Krujë <p>Gjithashtu muajin Tetor 2021, Drejtoria Minerare pranë AKBN-së mbikqyri zonën ku janë revokuar këto leje minerare dhe ku ka rezultuar që punohej nga persona të pa identifikuar dhe për këtë situatë Drejtoria Minerare pranë AKBN-së i drejtuar me një shkresë me Nr. 3538 Prot, datë 25.10.2021 Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë.</p> <p>Në Bashkinë e Skraparit, objekti Novaj ishin të licencuara gjithsej 11 subjekte me leje minerare shfrytëzimi për prodhimin e mineralit të gëlqeror pllakorë. Bazuar në VKM Nr. 611, datë 11.09.2019 "Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar "Mali i Tomorit", dhenë zbatim të Urdhërit të Ministrit nr. 378, datë 07.10.2019 "Për caktimin e grupeve të inspektimit në terren për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vlerësimin e përmbushjes së kërkesave ligjore nga subjektet që ushtrojnë veprimtari për shfrytëzimin mineral, brenda dhe në afërsi të parkut kombëtar të "Malit të Tomorit" u realizua revokimi i 11 lejeve minerare më datë 19.12.2019.</p> <p>Këto leje zënë një sipërfaqe totale të licencuar prej 1.01 km² dhe sipërfaqja e prekur është 0.3528 km², por jashtë sipërfaqes së licencuar sipërfaqja e prekur rezulton të jete rreth 80 hektare.</p> <p>Nga informacionet e ardhura në AKBN por që kanë ardhur jo në rrugë</p> |

| | |
|-----------------------|---|
| | zyrtare, pasi nga ana e Drejtorisë Minerare pranë AKBN-së nuk është ushtruar mbikqyrje në këtë objekt, subjektet me leje shfrytëzimi të revokuar vazhdojnë të zhvillojnë aktivitetet minerar të jashtëligjshëm. Vazhdimi i këtij aktiviteti minerar pa Plan Vjetor pune sjell si pasojë zgjerimin e sipërfaqeve të prekura si dhe punohet jashtë kushteve teknike dhe rrezikon jetën e njerëzve që punojnë në këto aktivitete. Duhet theksuar se këto subjekte ushtrojnë aktivitetin e tyre në informalitet të plotë pasi këtyre subjekteve u është revokuar leja minerare, gjë e cila sjell si pasojë edhe shmangjen e pagesës së rentës minerare. |
| Kriteri: | Bazuar në Urdhërin e Përbashkët Nr. 322 datë 13.09.2018 për "Ngritjen e grupit të punës për kontrollin mbi zbatimin e kërkesave të Lejeve të Mjedisit dhe të Lejeve Minerare nga subjektet e shfrytëzimit minerar (gurorët), që preken nga zbatimi i VKM Nr. 468 date 26.07.2018 "Për shpalljen e Peisazhit Natyror të Mbrojtur Krastë - Verjon" Bazuar në VKM Nr. 611, datë 11.09.2019 "Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar òMali i Tomoritò, dhe në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr. 378, datë 07.10.2019 òPër caktimin e grupeve të inspektimit në terren për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vlerësimin e përmbushjes së kërkesave ligjore nga subjektet që ushtrojnë veprimtari për shfrytëzimin minerar, brenda dhe në afërsi të parkut kombëtar të "Malit të Tomoritò |
| Ndikimi/Efekti | Puna në informalitet dhe aktivitet i jashtëligjshëm i shfrytëzimit minerar gjë që sjell si pasojë edhe shmangja e pagesave dhe taksave. |
| Shkaku | Mungesa e zbatimit të ligjit nga organet ligjzbatuese |
| Rëndësia | E Lartë |
| Rekomandime | Drejtoria Minerare pranë AKBN-së të vazhdojë korrespondencën me Ministrinë e linjës, me Organet e pushtetit vendor si dhe me organet ligjzbatuese për ndërprerjen e aktivitetit të subjekteve të cilëve u është revokuar leja, duke marrë masave ligjore për kundërvajtësit, si dhe rehabilitimin e këtyre zonave. |

III.3.8. Mbi shfrytëzimin e burimeve energjetike.

- Monitorimi i zbatimit të marrëveshjeve koncesionare në sektorin energjetik dhe mbikëqyrja e veprimtarisë të shoqërive koncesionare që veprojnë në këtë sektor.
- Oponencat teknike, dhënia e lejeve dhe licencave për shfrytëzimin e burimeve energjetike.
- Shlyerja e detyrimeve ndaj shtetit për shfrytëzimin dhe prodhimin e burimeve energjetike.
- Marrëdhëniet me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për shfrytëzimin e burimeve energjetike.

8.a. Monitorimi i zbatimit të marrëveshjeve koncesionare në sektorin energjetik dhe mbikëqyrja e veprimtarisë të shoqërive koncesionare që veprojnë në këtë sektor.

Bazuar në VKM nr. 547, datë 9.8.2006 òPër krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyroreò, të ndryshuar, pika 2, një ndër detyrat dhe përgjegjësit e saj është edhe mbikëqyrja e veprimtarisë energjetike.

Sipas Statut Rregullores së Funkcionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore

(AKBN), të azhurnuar në korrik 2018, neni 18, objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë së Monitorimit të HEC-eve, midis të tjerave është dhe monitorimi i realizimit të investimit në impiantet gjeneruese, vlerësimin e investimeve, testimin dhe monitorimin e prodhimit që janë objekt koncesioni ose jo, si dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë hidroenergjetike.

Sipas përcaktimeve për veprimtarinë e Sektorit të monitorimit të kontratave koncesionare në Drejtorinë e Monitorimit të HEC-eve, rezulton së ky sektor krahas të tjerave duhet të hartojë dhe të zbatojë planet e monitorimit në terren për HEC-et që janë në fazën e ndërtimit deri në përmbylljen e procesit. Mbi këtë bazë, harton raporte tremujore të monitorimit dhe i përcjell ato tek Autoriteti kontraktor duke bërë propozimet përkatëse për parregullsitë e konstatuara dhe sanksionet sipas parashikimeve në kontratë.

Bazuar në Memo nr. 2162 prot., datë 12.05.2020, të Drejtorisë së Monitorimit të HEC-EVE, për vitin 2020, drejtuar Drejtorit Ekzekutiv z. A.B., janë parashikuar për monitorim si më poshtë:

Pjesëmarrje në teste për 20 HEC-e, verifikime në terren për 40 HEC-e, për vlerësimin e investimeve në terren për 7 HEC-e. Bazuar në këtë memo, theksohet së monitorimi i plotë çdo tre muaj është i pa mundur për mungesë fondesh, pasi për monitorimet e parashikuara nga grupet e monitorimit janë parashikuar 8.6 milionë lekë dhe në kuadër drejtorie 18,2 milionë lekë.

Miratimi i planit të monitorimit në terren është miratuar me shkresë nr. 2162/1 prot., datë 08.06.2020. Sipas këtij plani, kriteret për përzgjedhjen e objekteve për monitorim janë:

- Kryesisht kontratat për objekte në fazë ndërtimi.
- Kontrata për të cilat është miratuar leja e ndërtimit nga KKT, e që parashikohen të fillojnë punimet brenda vitit.
- Rreth 20 verifikime kur kërkohet nga autoriteti kontraktor, apo kur disponohet informacion i besueshëm së shoqëritë financiare kanë filluar ose vijojnë procesin e ndërtimit pa njoftuar zyrtarisht.
- 10 verifikime në terren referuar të dhënave të që disponohen në sektorin e monitorimit të kontratave koncesionare.
- 4 verifikime që i referohen parashikimit të veprimtarisë së komisionit të ngritur sipas VKM nr. 332, datë 06.06.2018, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 10496, datë 31.07.2017, për vlerësimin e investimeve.

Nga plani i miratuar janë bërë ndryshime.

Gjatë monitorimit për vitin 2020, rezulton së janë shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me objektin e kontratës (shoqëria, nr. dhe data e kontratës, fillimi i punimeve, vlera e investimit etj.); kuadrin ligjor (regjistrimin e kontratës, projekti i zbatimit, leja e ndërtimit, afati i vënies në punë etj.); raportin e monitorimit (elementë të preventivit të projektit, foto, konstatime, analiza ekonomike etj.)

Nga shqyrtimi i raporteve të monitorimit për vitin 2020, konstatohet:

- Për koncesione në prodhim:

Nga monitorimi i realizuar si të dokumentacionit, ashtu dhe në terren rezulton së nuk është paraqitur dhe nuk vërtetohet me dokumente **marrja e lejes së ndërtimit** për HEC-et Lenie, Çorovodë, HEC Stranik, Zall Tore, HEC Tuçep, HEC Tuçep 2, HEC Niçë, HEC nismova 1 dhe 2, HEC Mollaj, HEC-et Holta, Kabash dhe Poroçan.

Në kontratat koncesionare është përcaktuar, midis të tjerave, sasia e prodhimit vjetor të energjisë elektrike në Kwh në nenin 1, pika 1.5; në nenin 3, pika 3.1 etj. Referuar nenit 23.2 pika 0iö, tarifa koncesionare në një përqindje të caktuar është e shprehur dhe në sasi në Kwh/vit, mbi bazën e sasisë së prodhimit Kwh/vit, çka do të thotë së çfarëdo rritje e sasisë së prodhimit vjetor të energjisë elektrike, e pandryshuar në rritje në kontratën koncesionare, do të ketë pasoja

financiare në pagesën e kontraktorit për llogari të Autoritetin Kontraktor (në këtë rast MIE) në mungesën e vjeljes së plotë të fee së koncesionare.

Nga monitorimi kanë rezultuar me **diferenca të kapacitetit** të vendosur krahasuar më atë të projektuar (miratuara në kontratën e koncesionit) për HEC Martanesh, HEC Murdhari 1 dhe 2, Hec-in Murdhar 1, HEC Meshanik dhe Guvë.

Janë konstatuar mangësi të theksuar të dokumentacionit tekniko financiar i cili ka të bëjë me:

-Ka mungesë të paraqitje së lejes për përdorimin e rezervave ujore.

-Mungojnë lejet nga OST, leje përdorimi rezerva ujore.

-Nuk behën njoftime për fillimin e punimeve apo përfundimin tyre.

-Nuk janë paraqitur kontrata pune me sipërmarrës dhe punonjës dhe sigurime.

-Në disa raste nuk është paraqitur certifikatë pronësie mbi truallin ku bëhet ndërtimi.

-Dokumentacioni teknik i punimeve është i pasaktë, librezat e masave nuk nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve, madje në disa raste nuk korrespondojnë me sasitë e përshkruara në situacione. Situacionet në disa raste nuk nënshkruhen. Ka pasaktësi të shumta të dokumentacionit teknik.

-Ka mungesa në dokumentacion në lidhje me kontrata e punës, licenca profesionale, kontrata mbikëqyrje punimesh.

-Në disa raste nuk është krijuar shoqëri e re.

-Nuk paraqiten miratime të projektit të punimeve. Po ashtu nuk bëhen miratime për ndryshimet gjatë zbatimit.

-Nuk bëhen njoftime për marrjen pjesë në testime.

-Pavarësisht njoftimeve të AKBN për plotësim dokumentacioni, në shumë raste nuk ka përgjigje nga koncesionarët.

- Objekti i veprimtarisë nuk është i plotë dhe në përputhje me objektin e kontratës koncesionare.

- Nuk ka paraqiten kopje të policave të sigurimit në zbatim të nenit 15 të kontratës së koncesionit i cili parashikon së koncesionari duhet të bëjë sigurimin e objektit gjatë fazës së shfrytëzimit gjatë gjithë periudhës së koncesionit dhe duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor një kopje.

-Mbikëqyrësite punimeve nuk disponojnë pikën e licencës që i përket llojit të punimeve.

- Të paktën në një rast është paraqitur aktkollaudim, pa miratuar më parë situacionin përfundimtar. Situacionet paraqesin punime të cilat nuk janë realizuar në fakt. Faturat tatimore kanë vlera të ndryshme nga situacioni shoqërues.

- Nuk disponohen raporte të testimit.

Referuar monitorimit për 6 mujorin e parë 2020, mungesa në dokumentacion si më sipër është konstatuar për 40 HEC-e, ndërsa për 6 mujorin e dytë në 32 HEC-e.

HEC Sllabinjë 2, HEC-i ka filluar punimet ndërtimore. Është përfunduar vepra e marrjes po punohej në kanal in e derivacionit, tubacionit e presionit edhe në godinën e centralit.

Hec-i Arsti ka përfunduar punimet e ndërtimit por nuk ka kaluar ende në prodhim.

Punimet për ndërtimin e hidrocentralit Veleshica 1, 2 janë duke u kryer. Hidrocentrali ndodhet në fazën e ndërtimit. Për Hec-in Zall Bulqizë nuk kanë filluar punimet ndërtimore.

Punimet për ndërtimin e hidrocentralit Bistrica 3 kanë përfunduar. Hidrocentrali ndodhet në fazën e prodhimit të energjisë. Për hidrocentralin Bistrica 4 nuk kanë filluar puna për ndërtimin e tij.

Punimet për hecet (sipas emertimeve të koncesionarit) Dragostunja 2 dhe Dragostunja 3 kanë përfunduar dhe këto hece janë në fazën e prodhimit prej Dhjetorit 2018 . Punimet për hecet e tjerë nuk kanë filluar. Hec Hurdhas është në fazën e prodhimit/ndërtimit.

HEC Llenga 1, 2 dhe 3, kanë mungesë dokumentacioni.

Llenga 1 ishte në prodhim, por punimet ndërtimore përkëtë HEC nuk kane përfunduar akoma.

Nëgodinën e HEC Llenga 1 është e instaluar një turbine por në targeten qe kishte nuk jepej fuqia e saj. Llenga 2,3 nuk kane përfunduar punimet ndërtimore, 2 vepra marrje kishin përfunduar dhe po punohej përveprën e tjetër. Nëgodinën e përbashkëtpër HEC Llenga 2 dhe 3 në momentin e monitorimit ishte vetëmnjë turbine ku dhe asaj i mungonte gjeneratori. Gjithashtu turbinës i mungonte edhe targeta dhe fuqia e saj nuk mund te verifikohet. Gjithashtu shoqëria nuk ka dorëzuar dokumentacion elektromekanik në lidhje me pajisjet e instaluara në HEC-e.

HEC Sekë dhe Zais, janë në fazë ndërtimore. Nga monitorimi i kryer në terren më datë 01.09.2020 u konstatua së Hec-et Shutri 1, 2 janë në fazën e ndërtimit te rrugëve ndihmese. Në momentin e monitorimit po punohej për hapjen e rrugëve te shërbimit. Nuk kanë filluar punimet për ndërtimin e veprave te Hec.HEC-et e Gjadrit, janë në ndërtim e sipër.

- Për koncesione në ndërtim.

Disa nga HEC-et e monitoruara kanë mangësi dokumentacioni tekniko-ekonomik, kryesisht sa i takon:

Nuk disponohet dokumentacion ekonomik, për vërtetimin e punimeve të kryera.

Pavarësisht së shoqëria koncesionare nuk e ka realizuar investimin për ndërtimin e veprave hidroenergjetike, ajo është në fazën e rinovimit të lejeve të nevojshme për ndërtim.

Në një rast, ka ndryshim skeme si në kuotat e nënobjekteve ashtu edhe në numrin e hec-eve referuar kontratës së koncesionit, e cila është e pa firmosur nga personat përgjegjës.

Nuk disponohet Leje të përdorimit të Burimit Ujor, Vendim të KKA (Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë), Vendim të KKR (Këshilli Kombëtar i Restaurimeve), miratim pikë lidhje me OSHEE/OST, licencë për prodhimin e energjisë nga ERE etj.

Mangësitë si në dokumentacionit tekniko-ekonomik, janë konstatuar për HEC Plepi, HEC Bençë, Tepelenë, HEC-et Blacka, Staravecka, HEC Shëngjon 1, 2 dhe 3, HEC Valbonë, HEC Sllabinjë 2, HEC Lingjancë 1 dhe Lingjancë 2, HEC-et Hurdhas 1, 2 dhe 3.

Për HEC-e në fazë procedure janë konstatuar mangësi pothuajse për të gjithë HEC-et e monitoruara.

1. Titulli i gjetjes: Grupi i punës për verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i VKM nr.822, datë 07.10.2015, nga burimet hidrike të energjisë i ngritur me Urdhrin e Ministres së MIE nr.233 datë 06.06.2019 ka evidentuar së 35 % të kontratave koncesionare janë jashtë afatit, me shkelje, si dhe në procese gjyqësore (92 nga 265) gjë që tregon për nivelin e dobët të monitorimit nga të gjitha institucionet përkatëse, përfshirë dhe AKBN

Situata: Gjatë vitit 2019 Drejtoria e Monitorimit të HEC ve ka raportuar vetëm për tremujorin e tretë dhe të katërt. Kjo pasi, Ministri i MIE me Urdhrin nr.48, datë 30.01.2019 oPër verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i VKM nr. 822, datë 07.10.2015, nga burimet hidrike të energjisë, ka urdhëruar fillimin e procesit të këtij verifikimi për sa i përket zbatimit të afateve kontraktore, zbatimit me përpikmëri të projektit dhe respektimi i kushteve mjedisore, kapacitetit prodhues dhe çdo angazhimi tjetër kontraktor.

Për këtë qëllim me Urdhrin e Ministrin nr.49, datë 31.1.2019 u ngrit një grup pune i përbërë nga 5 anëtarë për vlerësimin e ecurisë së zbatimit e kontratave që nuk kanë filluar procesin e operimit. Grupi e fokusoi e punën organizimin dhe koordinimin e punës së strukturave përgjegjëse në këtë sektor, kryesisht tek AKBN, duke bërë që Drejtoria e Monitorimit të HEC eve të jetë e angazhuar plotësisht në këtë drejtim. Kjo periudhë ka zgjatur 6 muaj (shkurt - korrik) deri sa me Urdhrin e Ministrin të MIE nr.311, datë 31.07.2019, pika 5, Grupi i punës ka përfunduar Raportin për këtë

qëllim dhe Drejtoria e Monitorimit të HEC eve ka vijuar normalisht me detyrat funksionale të saja.

Duhet theksuar së analiza në vijim për këtë çështje nuk i referohet burimeve zyrtare nga MIE, por kopje të dokumenteve nga pjesëtarë të grupit të punës, përfaqësues të AKBN. Pas kryerjes së kësaj veprimtarie në skanimin e 116 kontratave, sipas grupit të punës rezultoi së asnjë strukturë publike nuk disponon një data bazë të saktë, të shoqëruar me dosjet e plota hidrocentraleve duke nisur që tek kontrata dhe deri në vijimësinë e monitorimit për ato që janë në operim. Madje komisioni cilëson së nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nuk i është vënë në dispozicion AKBN informacioni i as për kontratat që janë lidhur nga MIE, duke sjellë për pasojë shmangien e përgjegjësisë së nëpunësve publik të këtij zinxhiri kompleks procedurash të këtij sektori.

Grupi i punës ka konstatuar së, në përgjithësi shoqëritë nuk vënë në dispozicion procesverbalin e fillimit të punimeve, për të shmangur penalizmin pasi pothuajse të gjithë kanë filluar punimet me vonesë; mungon informacioni dhe dokumentacioni mbi vlerën totale të investimit, duke vështirësuar vlerësimin e investimit (detyrim i nenit 9 të kontratës koncesionare); nuk raportojnë çdo tre muaj për ecurinë e punimeve (detyrim i nenit 16 të kontratës koncesionare); braktisje e punimeve mbi 100 ditë të njëpasnjëshme; mungesa e mbikëqyrësit të punimeve në objekt; vepër marrje shtesë për shfrytëzimin e burimeve; mungojnë lejet e ujit, mungon sigurimi i kontratës etj. Rezultojnë së janë brenda afateve kohore gjithsej 101 kontrata dhe 153 HEC e: nga të cilët 44 kontrata koncesionare dhe një numër prej 92 HEC e, dhe 57 kontrata dhe një numër prej 61 HEC e në zbatim të VKM nr.822, datë 07.10.2015.

Ndërsa u ka përfunduar afati kontraktual dhe janë në shkelje të kushteve të kontratës 31 kontrata dhe 81 HEC-e, nga të cilët: kanë vënë vetëm një dhe/ose disa HEC e në prodhim ndërsa një dhe/ose disa të tjerë nuk kanë përfunduar ndërtimin 20 kontrata me një numër total të parashikuar për t'u vënë në prodhim prej 60 HEC e, si dhe sipas VKM nr.822, datë 07.10.2015 është 1 kontratë për të vënë në prodhim 3 HEC e; pavarësisht përfundimit të afateve kontraktuale nuk kanë vënë në prodhim asnjë HEC, ndërkohë që kanë bërë investime kapitale 11 kontrata dhe një numër total të parashikuar për t'u vënë në prodhim prej 21 HEC-e.

Janë në shkeljet më të rënda të detyrimeve kontraktuale pasi ende nuk kanë filluar punime në terren, ose kanë filluar të ndërtojnë pa leje (dhe nuk janë në prodhim), ose janë braktisur për një kohë të gjatë 27 kontrata koncesionare dhe një numër prej 80 HEC e.

Veç kësaj rezultojnë së 30 praktika janë në procese gjyqësore me MIE ku në pjesën më të madhe të rasteve ajo është palë e paditur me objekt *“Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të kontratave koncesionare si dhe të gjithë dokumentacionit të procedurës koncesionare dhe dokumentacionit të përfituar në bazë të nënshkrimit të kontratës koncesionare”*, por ka dhe 6 rastet që është palë paditëse me objekt *“Detyrimi i të paditurve të paguajnë penalitetin në masën 0.005% të vlerës së investimit për çdo ditë vonesë për mosparaqitjen në kohë të projektit të zbatimit, si dhe kamatëvonesat e përlogaritura për këto detyrime”* çështje të cilat është në gjykatë të apelit, pasi janë rrëzuar në gjykatat e faktit.

Tabela nr.1 Rezultatet përmbledhëse të skanimit të kontratave nga grupi i punës 2019

Tabela nr. 55

| Emërtimi | Në prodhim | Brenda afatit | Jashtë afatit dhe me shkelje | Shkelje dhe pa filluar | Në procese gjyqësore | Gjithsej |
|-------------------|------------|---------------|------------------------------|------------------------|----------------------|----------|
| Gjithsej kontrata | 72 | 101 | 32 | 30 | 30 | 265 |

| | | | | | | |
|-------|-----|-----|----|----|---|-----|
| HEC-e | 123 | 153 | 84 | 83 | 0 | 443 |
|-------|-----|-----|----|----|---|-----|

Burimi: Të dhëna nga raporti i grupit të punës, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Kriteri: 1) Urdhri i Ministrit të MIE nr.48, datë 30.01.2019 për verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i VKM nr.822, datë 07.10.2015, nga burimet hidrike të energjisë.

Ndikimi: Pezullim i veprimtarisë monitoruese të AKBN për një periudhë 6-mujore në vitin 2019, si dhe mungesa e rezultateve zyrtare në këtë rast.

Shkaku: Urdhri i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë për angazhimin e AKBN jashtë detyrave funksionale.

Rëndësia: E Mesme.

Tabela nr.1 Tabela e pasqyrimit të kontratave koncesionare sipas fazës në të cilën ndodhen derti në vitin 2021.

Tabela nr. 56

| | Faza në të cilën ndodhet kontrata | Forma e kontratës | |
|---|-----------------------------------|-----------------------|-----------------------------|
| | | Kontrata koncesionare | Kontrata sipas VKM 822/2015 |
| 1 | Në prodhim energjie | 112 | 32 |
| 2 | Në ndërtim | 12 | 10 |
| 3 | Në procedura | 54 | 44 |

Burimi: AKBN

Tabela nr.2 Shkeljeve e pasqyruar në numër të konstatuara nga monitorimet e kryera për vitin 2021.

Tabela nr. 57

| | | |
|----|---|----|
| 1 | K.K në fazë prodhimi me shkelje të afateve të fillimit dhe përfundimit të punimeve | 69 |
| 2 | K.K në fazë prodhimi në shkelje të afateve të lejes që disponojnë | 65 |
| 3 | Pa leje ndërtimi | 12 |
| 4 | K.K në fazë prodhimi me ndryshime të projektit të zbatimeve të miratuara | 45 |
| 5 | K.K në fazë prodhimi me vlerë të raportuar investimi të ndryshme nga vlera reale | 63 |
| 6 | K.K në fazë ndërtimi në shkelje të afateve të lejes që disponojnë | 10 |
| 7 | K.K në fazë ndërtimi pa leje ndërtimi | 4 |
| 8 | K.K që nuk kanë filluar ndërtimin ose me shkelje të afateve | 53 |
| 9 | K.K objekt I VKM 822 në fazë prodhimi në shkelje të afateve koncesionare (fillimin dhe përfundimin e punimeve) | 15 |
| 10 | K.K objekt I VKM 822 në fazë prodhimi pa leje ndërtimi | 3 |
| 11 | K.K objekt I VKM 822 në fazë prodhimi në shkelje të afateve koncesionare | 13 |
| 12 | K.K objekt I VKM 822 në fazë prodhimi me ndryshime të projektit të zbatimeve të miratuara | 2 |
| 13 | K.K objekt I VKM 822 në fazë prodhimi të cilat nuk kanë raportuar vlerën e investuar | 19 |
| 14 | K.K objekt I VKM 822 në fazë ndërtimi të cilat rezultojnë me shkelje të afateve koncesionare | 7 |
| 15 | K.K objekt I VKM 822 në fazë ndërtimi të cilat rezultojnë pa leje ndërtimi | 7 |
| 16 | K.K objekt I VKM 822 në fazë ndërtimi të cilat rezultojnë me ndryshime të projektit | 2 |
| 17 | K.K objekt I VKM 822 që nuk kanë filluar ndërtimin | 28 |

Burimi: AKBN

Tabela nr.58 Shkeljet e pasqyruar në % të konstatuara nga monitorimet e kryera për vitin 2021.

| | | Faza në të cilën | Forma e kontratës | |
|---|--|---------------------|-------------------|----------------|
| | | ndodhet kontrata | Kontrata | Kontrata sipas |
| | | | konçesionare | VKM 822/2015 |
| 1 | Kontrata në shkelje të afateve për fillimin dhe përfundimin e punimeve | Në prodhim energjie | 37% | 47% |
| | | Në ndërtim | 79% | 64% |
| | | Në procedura | 91% | 30% |
| 2 | Ndërtuar pa leje ndërtimi apo në shkelje të afateve të lejes së ndërtimit | Në prodhim energjie | 71% | 50% |
| | | Në ndërtim | 86% | 64% |
| 3 | Ndryshuar skemën hidroenergjitike dhe P/Z, pa reflektuar ndryshimet në kontratë shtesë | Në prodhim energjie | 41% | 6% |
| | | Në ndërtim | 29% | 18% |
| 4 | Mangësi në raportimin e vlerës së investimit | Në prodhim energjie | 52% | 28% |

Burimi: Të dhëna nga raporti i grupit të punës, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Monitorimit të HEC-eve në AKBN, në vitin 2021 me shkresën nr.1807, datë 06.05.2021 janë planifikuar për t'u monitoruar gjithsej 75 kontrata (shoqëri), me Memo-n nr. 1807/1, datë 11.11.2021 drejtuar Drejtorit Ekzekutiv kërkohet shtimi në planin e monitorimit edhe për 5 kontrata të tjera duke e dërguar numrin e monitorimeve në 80, të cilat kanë përfunduar deri në fund të vitit 2021 sipas planifikimit. Me ndryshimet e numrit të monitorimeve kanë bërë që realizimi në jetë në masën 100% (80 nga 80 monitorime).

Referuar të dhënave të AKBN mbi shoqëritë e planifikuara për vitin 2021 së numri i kontratave për ndërtimin e HEC-eve gjithsej deri në dhjetor 2021 rezulton të jenë 265 (në prodhim, në ndërtim, në prodhim dhe në ndërtim, nuk kanë filluar punimet etj.), monitorimi është kryer për të gjitha kontratat për vitin 2021 të ndara në tre lloje monitorimi.

Rekomandimi: AKBN të marrë masa për rritjen e monitorimit të aktivitetit të realizimit të veprave hidrike, sipas përcaktimeve në marrëveshjet përkatëse dhe akteve ligjore në fuqi.

2. Titulli i gjetjes: Monitorimet, nuk kanë një shpërndarje përafërsisht të njëtrajtshme midis tremujorëve për vitin 2019, duke ndikuar në ngarkesën e punonjësve dhe cilësinë e monitorimit për shkak të intensifikimit të punës në periudha të veçanta të vitit; mungojnë përgjithësisht në tremujorin e parë të vitit për mungesë buxheti për mangësi procedurale dhe administrative; nuk janë mbuluar me monitorim të gjitha kontratat dhe HEC-et në ndërtim; nga raportimet e tremujorit të tretë dhe të katërt 2019 rezulton në përgjithësi së ka mungesë dokumentacioni dhe probleme komplekse të lidhura me shumë institucione publike, si dhe penalitete për mosrespektim të detyrimeve kontraktore për 41 % të kontratave të monitoruara, duke shkaktuar deformim të sipërmarrjes në fushën prodhimit të energjisë elektrike nga burimet ujore, si rezultat veprimeve dhe mosveprimeve të MIE në cilësinë e Autoritetit kontraktor.

Situata: Bazuar në VKM nr. 547, datë 9.8.2006 për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, të ndryshuar, pika 2, një ndër detyrat dhe përgjegjësit e saj është edhe mbikëqyrja e veprimtarisë energjetike.

Sipas Statut Rregullores së Funkcionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), të azhurnuar në korrik 2018, neni 18, objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë së

Monitorimit të HEC-eve, midis të tjerave është dhe monitorimi i realizimit të investimit në impiantet gjeneruese, vlerësimin e investimeve, testimin dhe monitorimin e prodhimit që janë objekt koncesioni ose jo, si dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë hidroenergjetike.

Drejtoria e monitorimit të HEC-eve në periudhën e auditimit janar 2019 deri më 30.04.2020, është angazhuar me grup pune me urdhër të ministrit në shkurt-korrik 2019 për vlerësimin e ecurisë së zbatimit e kontratave, dhe koha tjetër ka qenë në dispozicion të veprimtarisë funksionale për AKBN, sipas kërkesave VKM nr. 547, datë 9.8.2006.

Sipas përcaktimeve për veprimtarinë e Sektorit të monitorimit të kontratave koncesionare në Drejtorinë e Monitorimit të HEC-eve, rezultojnë se ky sektor krahas të tjerave duhet të hartojë dhe të zbatojë planet e monitorimit në terren për HEC-et që janë në fazën e ndërtimit deri në përmbylljen e procesit. Mbi këtë bazë, harton raporte tremujore të monitorimit dhe i përcjell ato tek Autoriteti kontraktor duke bërë propozimet përkatëse për parregullsitë e konstatuara dhe sanksionet sipas parashikimeve në kontratë.

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Monitorimit të HEC-eve në AKBN, në vitin 2019 janë planifikuar për të monitoruar gjithsej 202 kontrata (shoqëri) dhe janë realizuar 180 prej tyre, ndërsa për periudhën janar prill 2020 nuk ka monitorime të planifikuara, por janë monitoruar gjithsej vetëm 4 kontrata. *Duke analizuar hartimin e planit rezultojnë një mungesë shpërndarjeje përafërt midis tremujoreve të vitit, pasi janë 116 për tremujorin e parë dhe të dytë dhe 25 e 61 përkatësisht në tremujorin e tretë dhe të katërt, duke ndikuar në ngarkesën e punonjësve dhe cilësinë e monitorimit për shkak të intensifikimit në periudha të veçanta të vitit. Veç kësaj ndryshimet e theksuara të numrit të monitorimeve midis tremujoreve të vitit kanë bërë që realizimi në tremujorin e katërt të jetë 70% (43 nga 61 monitorime), dhe në total për vitin 2019 programi i monitorimeve është realizuar 89 %.*

Referuar të dhënave të AKBN mbi numrin e kontratave për ndërtimin e HEC-eve gjithsej në janar 2019 rezultojnë të jenë 250 (në prodhim, në ndërtim, në prodhim dhe në ndërtim, nuk kanë filluar punimet etj.), ndërsa planifikuar për të monitoruar janë 202 ose 80 % e tyre, duke mos garantuar mbulimin e plotë me monitorim të të gjitha kontratave.

Referuar nenit 6, pika 6.1 të kontratave koncesionare, Autoriteti kontraktues ka të drejtë që në periudha kohore prej tre muajsh, gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve prej tij, të monitorojë objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit. Po ashtu, në pikën 6.2 të këtij neni, Autoriteti kontraktues ushtron mbikëqyrje të përgjithshme me afate tre mujore gjatë realizimit dhe vënies në punë që të verifikojë ecurinë e punimeve dhe konformitetin në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionit të projektit.

Gjatë monitorimit për tremujorin e tretë dhe të katërt 2019, rezultojnë se janë shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me objektin e kontratës (shoqëria, nr. dhe data e kontratës, fillimi i punimeve, vlera e investimit etj.); kuadrin ligjor (regjistrimin e kontratës, projekti i zbatimit, leja e ndërtimit, afati i vënies në punë etj.); raportin e monitorimit (elementë të preventivit të projektit, foto, konstatime, analiza ekonomike etj.) për 64 shoqëri ndërtimi për kontrata për hidrocentrale në fazë ndërtimi, prodhimi, në ndërtim dhe në prodhim etj. *Kështu, AKBN gjatë vitit 2019 ka raportuar për monitorimin e vetëm 25 % të kontratave gjithsej (64/250), për shkak të angazhimit të Drejtorisë përkatëse të AKBN nga MIE për të cilat janë konsideruar 116 kontrata të monitoruara, si dhe për mangësi procedurale dhe administrative të AKBN lidhur me sigurimin e burimeve të financimit në tremujorin e parë të vitit kalendarik. Gjithashtu, kjo është edhe për neglizhencë të institucionit pasi, në tremujorin e tretë janë vetëm 21 dhe në tremujorin e katërt 43 kontrata, ose dyfishi prej tyre, gjë që tregon se ky kapacitet ka ekzistuar dhe tremujorin e*

tretë por nuk është shfrytëzuar prej tyre.

Nuk ka monitorime dhe raportime për periudhën janar prill 2020, pasi sipas shpjegimeve të Drejtorit të Drejtorisë së Monitorimit të HEC-ve nuk janë kryer monitorime, për arsye të mungesë së burimeve financiare të AKBN për monitorimin në terren të hidrocentraleve, si dhe për shkak të pandemisë në mars-prill 2020. *Në këto kushte nga ana e AKBN nuk sigurohet një monitorim në vijimësi i sektorit hidroenergjetik, duke sjellë pasoja dhe mangësi funksionimi lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë energjetike.*

Drejtoria e Energjive të Rinovueshme për vitin 2019 ka monitoruar 8 shoqëri: 6 në zonën e Topojës Fier dhe nga një në zonën e Grabianit Lushnjë dhe atë të Bilishtit, sipas shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4917/1 prot., datë 24.05.2019 në të cilën ngarkohet AKBN-në, në cilësinë e përfaqësuesit të Autoritetit kontraktues, për pjesëmarrje në kryerjen e testimit të impiantit fototovoltaik. Gjatë inspektimit janë verifikuar çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e impiantit, fuqinë, veprimtarinë sipas projektit etj.

Kriteri: 1) VKM nr. 547, datë 09.08.2006, òPër krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve natyrore, të ndryshuar, pika 2;
2) Kontratat koncesionare, nenin 23 pika 1, shkronja òiò; pika 23.2 shkronja òiiò; pikën 23.3,

Ndikimi: Mungesë stabilizimi të fushës koncesionare të prodhimit të energjisë elektrike si dhe mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit për të ardhurat nga burimet e tjera të paplanifikuara.

Shkaku: Mungesa e konsiderimit të rolit të rëndësishëm të Drejtorisë së Monitorimit të HEC-ve në fushën hidroenergjetike nga ana e AKBN.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masa për të siguruar një shpërndarje të përafërt të monitorimeve gjatë gjithë vitit, si dhe të sigurojë monitorimin e plotë të të gjitha kontratave koncesionare, duke informuar në mënyrë të detajuar MIE mbi problematikat evidentuara dhe inkurajuar bashkëpunimin me institucionet e tjera publike për disiplinimin e fushës së prodhimit të energjisë elektrike.

3. Titulli i Gjetjes: Si rezultat i mos ndryshimit në rritje të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike të rezultuar nga oponenca teknike për projektet e zbatimit në kontratat koncesionare për 25 prej tyre, sjellë për pasojë mungesën e përfitimit nga fee koncesionare (energji elektrike pa pagesë) në vlera të konsiderueshme. Veç kësaj rezulton së nga 37 kontrata koncesionare për 149 HEC-e në 11 prej tyre ose në 30 %, fuqia (në kw) sipas projektit të zbatimit të vlerësuar nga AKBN dhe të miratuar nga AK është më e ulët nga 7 deri në 60%, mungesa e reflektimit të të cilave në kontratë rrezikon koncesionarët për penalizim në vlera të konsiderueshme për ulje të fuqisë së instaluar.

Situata: Nga të dhënat e AKBN rezulton së nga 102 kontrata koncesionare të nënshkruara dhe në operim (prodhim të energjisë elektrike), për vitin 2019 në 25 prej tyre (24,5 %) prodhimi i energjisë elektrike është rritur në projektin e zbatimit krahasuar me sasinë e Kwh të përcaktuar në kontratë.

Në kontratat koncesionare është përcaktuar, midis të tjerave, sasia e prodhimit vjetor të energjisë elektrike në Kwh në nenin 1, pika 1.5; në nenin 3, pika 3.1 etj. Referuar nenit 23.2 pika òiò, tarifa koncesionare në një përqindje të caktuar është e shprehur dhe në sasi në Kwh/vit, mbi bazën e sasisë së prodhimit Kwh/vit, çka do të thotë së çfarëdo rritje e sasisë së prodhimit vjetor të energjisë elektrike, e pandryshuar në rritje në kontratën koncesionare, do të ketë pasoja

financiare në pagesën e kontraktorit për llogari të Autoritetin Kontraktor (në këtë rast MIE) në mungesën e vjeljes së plotë të fee së koncesionare.

Gjatë shqyrtimit të projektit të zbatimit nga oponenca teknike, ka mjaft raste që krahas vlerësimit është rritur sasia e prodhimit vjetor të energjisë elektrike për projekte dhe hidrocentrale të ndryshme. Këto përmirësime nuk janë shoqëruar me ndryshimet në kontratën koncesionare, të cilat janë dokumenti bazë për llogaritjen e fee së koncesionare nga ana e OSHEE. Në këtë mënyrë, mungesa e ndryshimeve të sasisë së shtuar të prodhimit vjetor të energjisë elektrike nga projekti i zbatimit në kontratën koncesionare sjell për pasojë efekte financiare negative në buxhetin e shtetit nga vlera e fee së për sasinë vjetore të shtuar të prodhimit të energjisë elektrike sipas projektit të zbatimit.

Nga të dhënat e kërkuara dhe të vëna në dispozicion nga AKBN rezulton së nga 37 kontrata koncesionare për 149 HEC-e, në 11 prej tyre ose në 30 % e tyre, fuqia (në kw) sipas projektit të zbatimit të vlerësuar nga AKBN dhe të miratuar nga AK është më e ulët nga 7 deri në 60%. Mungesa e reflektimit të këtyre ndryshimeve në kontratat koncesionare, mund të sjellë si pasojë penalizimin e shoqërive koncesionare në përputhje me nenin 23, pika 23.2 shkronja öiö, për mosrealizim të fuqisë së vendosur, përcaktuar sipas nenit 3 të kësaj kontrate, koncesionari penalizohet në shumën e llogaritur si më poshtë: Shuma e penaltetit= prodhimi vjetor i energjisë elektrike x fuqia e painstaluar (në %) x vitet e operimit si të llogaritura në ofertë x Çmimi i shitjes së energjisë elektrike vendosur nga ERE në momentin e kryerjes së testimit të veprës sipas nenit 11 të kësaj kontrate x. Fee koncesionare (në %). *Sipas llogaritjeve për këto raste për prodhimin vjetor sipas kontratës, periudhën koncesionare 35 vjet, çmimin e vitit 2019 prej 8.4582 lekë për Kwh dhe me një mesatare të Fee koncesionare prej 2.5 %, shuma e penalizimeve për mos instalim fuqie sipas përcaktimeve në kontratë për 11 projekte koncesionare mund të arrijë në 346,352,031 lekë.*

Kriteri: 1) VKM nr. 547, datë 09.08.2006, òPër krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve natyrore, të ndryshuar, pika 2;
2) Kontratat koncesionare, nenin 23 pika 1, shkronja öiö; pika 23.2 shkronja öiö; pikën 23.3,

Ndikimi: Mospërputhje e zhvillimit të prodhimit të energjisë elektrike me kuadrin rregullator përkatës dhe mos marrja e masave nga ana e MIE, me pasojë edhe në ardhurat e buxhetit të shtetit nga burime të tjera të paplanifikuara.

Shkaku: Mungesë angazhimi dhe bashkërendimi të punës midis institucioneve publike mbi ndjekjen dhe eliminimin e problematikave që shfaqen në fushën e prodhimit të energjisë elektrike nga ana koncesionarët, të evidentuara gjatë monitorimeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masa për të evidentuar në mënyrë të hollësishme të gjitha kontratat koncesionare, në të cilat ka rritje të prodhimit të energjisë elektrike nga oponenca teknike por që nuk është ndryshuar sasia e prodhimit në kontratë fuqia e hidrocentraleve, duke njoftuar për këtë qëllim Autoritetin kontraktor (MIE).

4. Titulli i Gjetjes: Ndryshimi i monitorimit të prodhimit vjetor të energjisë elektrike me VKM nr. 332, datë 6.6.2018 duke e kaluar me mesatare për periudha 5-vjeçare, pa vendosur vitin e fillimit, jo vetëm që është në kundërshtim me përcaktimet në kontratat koncesionare, në pjesën më të madhe të të cilave janë miratuar po me VKM, por sjell si pasojë heqjen e një elementi të rëndësishëm të monitorimit vjetor të veprimtarisë hidronergjetike, pikërisht atë të prodhimit, sëbashku me reduktimin funksionit institucional të sektorit përkatës me një staf prej 8

specialistësh, shtyrjen në kohë të sanksioneve për këtë qëllim duke i zbutur deri në shuarje e tyre, krahas përfshirë këtu dhe ndryshimin e çmimit të blerjes të energjisë elektrike përgjatë 5 viteve për efekt penaliteti, të cilat të analizuar për vitin 2019 janë në vlera të konsiderueshme

Situata: Gjithashtu bazuar në VKM nr. 332, datë 6.6.2018 òPër disa shtesa në Vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore", të ndryshuar, pika 1/a, AKBN ka për detyrë monitorimin e prodhimit të energjisë elektrike, i cili do të kryhet çdo 5 vjet dhe, për efekt penaliteti, vlerësimi do t'i referohet mesatares së prodhimit të energjisë, duke filluar nga viti i parë i plotë financiar i vënies në punë të hidrocentralit.

Për monitorimin e prodhimit, sipas Raportit të komisionit janë në operim 67+1 kontrata dhe 117+1 HEC e dhe praktikat për të cilat janë lidhur kontratat në zbatim të VKM NR.822, datë 07.10.2015, në prodhim janë 4 kontrata për ndërtimin e 5 HEC eve, por që figurojnë me probleme.

Në zbatim të Kontratave koncesionare neni 23.2, shkronja òio: Në rast mosrealizimi, për faj të koncesionarit të prodhimit të energjisë elektrike të sasisë së caktuar (Kwh/vit) në kontratë të prodhimit të energjisë elektrike, koncesionari penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të përcaktuar për periudhën raportuese, duke pasur parasysh së në këtë rast Autoriteti Kontraktues do ta marrë të plotë tarifën koncesionare të caktuar në përqindje për sasinë vjetore të Kwh/vit. Sipas të dhënave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion nga AKBN për vitin 2019 janë 64 hidrocentrale nga 103 gjithsej (62 %) e tyre të cilët nuk kanë realizuar prodhimin vjetor të energjisë elektrike në sasi të ndryshme. Duhet theksuar së, paraprakisht MIE duhet të analizojë shkaqet e mosrealizimit të prodhimit vjetor të energjisë elektrike, të cilat meqenëse ka dhe mjaft raste që prodhimi është tejkaluar nga hidrocentrale të ndryshme, të çon në arsyetimin e fajësimit të koncesionarit për këtë mosrealizim dhe jo për shkaqe të tjera, dhe në këto kushte në zbatim të nenit 23.2, shkronja òio koncesionarët rrezikojnë të penalizohen me vlerën 303,005,182 lekë.

Veç kësaj, në referencë të nenit mësipërm të kontratës koncesionare, dhe të kushteve të mosrealizimit të prodhimit për energjinë elektrike për faj të kontraktorit për vitin 2019 për këto 64 hidrocentrale, Autoriteti Kontraktues (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) duhej të kishte kërkuar dhe marrë 154,740,070 lekë për tarifën e plotë koncesionare të caktuar në përqindje për sasinë vjetore të Kwh/vit. (Bashkëlidhur pasqyra nr.4 në mënyrë të detajuar në anekse).

Mungesa e analizës së shkaqeve për mosrealizimin e prodhimit dhe për pasojë dhe e mos kërkit të penaliteteve të mësipërme është e lidhur ngushtë dhe me disa ndryshime të bëra në kuadrin rregullativ të veprimtarisë së AKBN. Kështu, sipas VKM 332, datë 06.06.2018, òPër disa shtesa në Vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave, òPër krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve natyrore", të ndryshuar, pika 1, shkronja òaö: *Monitorimi i prodhimit të energjisë elektrike do të kryhet çdo 5 vjet dhe, për efekt penaliteti, vlerësimi do t'i referohet mesatares së prodhimit të energjisë, duke filluar nga viti i parë i plotë financiar i vënies në punë të hidrocentralit.*

Sipas Udhëzimit të MIE nr. 10496, datë 31.07.2018, të dalë në zbatim të tij, ...ò*Monitorimi i prodhimit të energjisë elektrike do të kryhet çdo 5 vjet dhe, për efekt penaliteti, vlerësimi do t'i referohet mesatares së prodhimit të energjisë elektrike, duke filluar nga viti i plotë financiar i vënies në punë të hidrocentralit*, përllogaritja do të bëhet duke mbledhur sasinë e plotë vjetore të energjisë elektrike të prodhuar gjatë 5 viteve, vërtetuar me dokumentacionin përkatës të konfirmuar nga OSHEE SHA dhe duke e pjesëtuar me numrin 5 (pesë), që jep sasinë mesatare të energjisë elektrike të prodhuar në një vit".

Kuadri rregullator i mësipërm, si dhe mungesa e përcaktimit të vitit të fillimit të përlogaritjeve është në kundërshtim me kontratat koncesionare, nenin 23 óSanksionet, i cili në pikën 23.3 përcakton: *óSanksionet do të llogariten çdo fund viti kalendarik, sipas një akt rakordimi të përbashkët që bëhet ndërmjet palëve të kësaj Kontrateó, e cila duhet theksuar së një numër i konsiderueshëm i tyre janë miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.*

Në këtë mënyrë, do të shtyjë në kohë sanksionet për këtë qëllim duke sjellë për pasojë zbutjen deri në shuarje të efekteve të penalizimeve të parashikuara në kontratat koncesionare për rregullimin dhe disiplinimin e operatorëve të tregut energjetik. Gjithashtu, në një farë mënyre ka ligjëruar mosveprimin e deritanishëm të Autoritetet kontraktues (Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë) për këtë çështje, me pasoja në deformimin e tregut ashtu siç ka rezultuar dhe nga skanimi i kryer nga MIE në periudhën shkurt-korrik 2019.

Një veprim i tillë sjell pasoja dhe në të hyrat buxhetore nga të ardhurat e tjera të paplanifikuara, pasi konstatohet së deri tani shifrat e penalizimeve të shoqërive koncesionare të evidentuara nga AKBN gjatë monitorimeve, por të pa kërkuara dhe të pa mbledhura nga MIE janë të konsiderueshme.

Veç sa më sipër, edhe AKBN, për një periudhë së paku 5 vjeçare (kjo dhe për shkak të mos përcaktimit të vitit të fillimit të pesëvjeçarit) i ka hequr një element të rëndësishëm të monitorimit të veprimtarisë hidroenergjetike, pikërisht atë të prodhimit, së bashku me reduktimin funksionit institucional të Sektorit të Monitorimit të Kontratave Koncesionare me një staf prej 8 specialistësh, përfshirë këtu dhe ndryshimin e çmimit të blerjes të energjisë elektrike përgjatë 5 viteve për efekt penaliteti.

Kriteri: 1) VKM nr. 332, datë 6.6.2018 óPër disa shtesa në Vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore", të ndryshuar, pika 1/a.

2) Udhëzimi i MIE nr. 10496, datë 31.07.2018 "Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.322, datë 06.06.2018 "Për disa shtesa në Vendimin nr.547, datë 09.08.2006, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore", të ndryshuar.

Ndikimi: Heq monitorimin vjetor të veprimtarisë hidroenergjetike të AKBN, me reduktimin funksionit institucional të sektorit përkatës me një staf prej 8 specialistësh, si dhe shtyn në kohë të sanksionet për këtë qëllim duke i zbutur efektet e tyre, me pasoja dhe në llogaritjen e çmimit mesatar për pesë vite.

Shkaku: VKM e pa konsultuar siç duhet dhe sa duhet, në kundërshtim dhe me VKM që miraton kontratat koncesionare

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të njoftojë me shkrim MIE në mënyrë të detajuar lidhur me problematikat ligjore, funksionale dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore që ka nxjerrë dhe janë evidentuar në praktikë nga zbatimi i VKM dhe Udhëzimit të mësipërm.

Mbi vlerësimin e investimeve.

Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, për vitin 2020, është vlerësuar vetëm një investim i cili ka të bëjë me HEC Prellë.

Drejtori i AKBN, me Urdhër nr. 835 prot., datë 22.01.2019, ka ngritur komisionin për vlerësimin e investimeve të kryera për HEC Prellë të përbërë nga z. A.H., znj. O.N. dhe z. B.L.. Për vlerësimin është emëruar eksperti i pavarur znj. L.F.. Raporti i vlerësimit është përcaktuar të

paraqitet brenda 90 ditëve kalendarike. Raporti i Vlerësimit është paraqitur nga znj. L. F. me datë 04.09.2019, ose 5 muaj me vonesë.

Komisioni i shqyrtimit të raportit të vlerësimit të paraqitur nga eksperti përkatës, ka paraqitur vërejtjet të cilat kanë të bëjnë me:

-Në raport nuk justifikohen ndryshimet e bëra gjatë zbatimit të kontratës.

- Nuk përmbushen kërkesat e VKM nr. 332, datë 06.06.2018.

- Kontraktori ka kryer punime pa leje ndërtimi nga data 04.05.2015 deri 30.06.2016.

- Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve është nënshkruar pas fillimit të punimeve.

- Nuk disponohet raport testimi. Për vënie me vonesë në prodhim, Kontraktori penalizohet me vlerë **18,182,397 lekë**.

- Kolaudimi është kryer nga e njëjta kompani që ka kryer mbikëqyrjen e punimeve në kundërshtim me legjislacionin e ndërtimit.

- Ka ndryshime sa i përket kapacitetit prodhues.

Sa më sipër, nga ana e komisionit është vendosur së nuk plotësohen kushtet për vlerësimin e investimit të këtij koncesioni, për të cilin, me shkresë nr. 1417 prot., datë 19.02.2020, është njoftuar MEI, Vlerësuesi dhe Koncesionari. MEI me shkresë nr. 1985 prot., datë 14.05.2020, i ka kërkuar AKBN (komisionit), që në përputhje me Udhëzimin nr. 10496, datë 31.07.2018 të MIE, të marrë masa për shqyrtimin e korrigjimeve të mundshme.

Pas marrjes në shqyrtim të dokumentacionit të paraqitur në plotësim të dokumenteve të kërkuara, AKBN me shkresë nr. 1417/9 prot., datë 14.09.2020, ka informuar MIE së Raporti i Komisionit të Vlerësimit të Investimit i dorëzuar në MIE me shkresë nr. 1417/6 prot., datë 02.07.2020, është hartuar duke u bazuar në dokumentacionin shtesë të dorëzuar nga subjektet dhe konsiderohet përfundimtar.

8.b) Oponencat teknike, dhënia e lejeve dhe licencave për shfrytëzimin e burimeve energjetike

5. Titulli i gjetjes: Grupi i oponencës teknike prej 9 anëtarësh, ka në shumicë ekspertë të jashtëm (5) në kundërshtim me VKM nr. 547, pika 3, pasi vendim-marrja del jashtë kompetencës saj institucionale, e varur dhe e përcaktuar nga ekspertët e jashtëm, si dhe në të njëjtën kohë është kosto financiare për vetë AKBN; evidenton mungesën e rekrutimit të stafit profesional sipas fushave të AKBN në përgjithësi dhe atij të Drejtorisë Monitorimit të Hec-eve në veçanti, duke vepruar në kundërshtim dhe me VKM nr. 547, datë 09.08.2006, të ndryshuar, fjalë e fundit e paragrafit të katërt të pikës 3, që i mundëson AKBN kërkimin e asistencës së specializuar për raste të veçanta, por jo për veprimtari funksionale institucionale; shfaq mungesën e përcaktimit të kriterëve që duhet të plotësojnë ekspertët e jashtëm e bën procedurën e kryerjes së oponencës teknike subjektive dhe me mangësi potenciale të kësaj veprimtarie; vazhdon të mbetet problem mungesa e një specialisti hidroteknik në përbërje të grupit të oponencës teknike, duke vepruar në kundërshtim me nenin 6 pika 2 dhe nenin 7 pika 12, të rregullores òPër kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBNö, i cili përcakton përbërjen me 2 specialistë të kësaj fushe.

Situata: Sipas VKM nr. 547, datë 09.08.2006, òPër krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve natyroreö, të ndryshuar, pika 3, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) siguron, brenda fushës së veprimtarisë së vet, *oponencën qeveritare për studimet dhe projektet në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike*, të paraqitura nga subjektet, shtetërore a private, vendase ose të huaja.

Në nenin 13/2 të Statut Rregullores së Funksionimit të AKBN, të azhurnuar në korrik 2018, për

objekt të veprimtarisë së Drejtorisë të Hidroenergjetikës është përcaktuar midis të tjerave dhe sigurimi, brenda fushës së veprimtarisë së vet, të oponencës qeveritare për studimet dhe projektet në fushën hidroenergjetike (pika 4).

AKBN, dhe brenda saj Drejtoria e Hidroenergjetikës, veprimtarinë oponencës qeveritare për studimet dhe projektet në fushën hidroenergjetike, e kryen nëpërmjet grupit të oponencës teknike. Grupi i oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion është një strukturë e posaçme e krijuar me urdhër të Ministrit të ngarkuar për Energjinë. Në zhvillimin e veprimtarisë së tij, i referohet Rregullores òPër kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBNò me nr.6453/8 prot., datë 18.10.2010 të miratuar nga Ministri i METE (ish Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës).

Gjatë periudhës që auditohet, nga data 01.01.2019 deri më datë 30.04.2020, grupi i oponencës teknike është miratuar me Urdhrin e Ministres së MIE nr.233 datë 06.06.2019 dhe përbëhet nga 9 anëtarë, kryetar i së cilës është Drejtori Ekzekutiv i AKBN, 4 nga të cilët janë punonjës të AKBN si dhe 5 janë ekspertë të jashtëm. Referuar kësaj përbërjeje, sigurimi i oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve del jashtë kompetencave të AKBN, në kundërshtim me VKM nr. 547, pika 3, pasi vendim-marrja është jashtë kompetencës saj institucionale, e varur dhe e përcaktuar nga ekspertët e jashtëm, si dhe në të njëjtën kohë është kosto financiare për vetë AKBN.

Ky raport i përbërjes së grupit të oponencës teknike nxjerr në pah dhe mungesën e rekrutimit të stafit profesional sipas fushave të AKBN në përgjithësi dhe atij të Drejtorisë Monitorimit të HEC-eve në veçanti, i cili megjithëse ka 16 specialistë të niveleve dhe profesioneve të ndryshme, përsëri në pjesën më të madhe detyrohet të marrë ekspertë të jashtëm, duke vepruar në kundërshtim dhe me VKM nr. 547, datë 09.08.2006, të ndryshuar, fjalia e fundit e paragrafit të katërt të pikës 3, që i mundëson AKBN kërkimin e asistencës së specializuar për raste të veçanta, por jo për veprimtari funksionale institucionale.

Veç këtyre, mungesa e përcaktimit të kriterëve që duhet të plotësojnë ekspertët e jashtëm e bën procedurën e kryerjes së oponencës teknike subjektive dhe me mangësi potenciale të kësaj veprimtarie.

Vazhdon të mbetet problem mungesa e një specialisti hidroteknik në përbërje të grupit të oponencës teknike, duke vepruar në kundërshtim me nenin 6 pika 2 dhe nenin 7 pika 12, të rregullores “Për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBN”, i cili përcakton përbërjen me 2 specialistë të kësaj fushe.

Kriteri: 1) VKM nr. 547, datë 09.08.2006, òPër krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve natyroreò, të ndryshuar, pika 3;
2) Rregullore òPër kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBNò me nr.6453/8 prot., datë 18.10.2010, neni 7, pika 6.

Ndikimi: Vendim-marrje jashtë kompetencës institucionale funksionale.

Shkaku: Mungesë vlerësimi i zbatimit të procedurave dhe afateve në përputhje me kuadrin rregullativ.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandimi:Drejtori Ekzekutiv i AKBN t'i propozojë Ministrit rregullimin e raporteve midis ekspertëve të jashtëm e të brendshëm, në favor të këtyre të fundit duke përcaktuar kriteret e duhura, si dhe të rekrutojë staf profesional në përputhje me detyrat funksionale institucionale.

6. Titulli i Gjetjes: Grupi i oponencës teknike nuk ka zhvilluar aktivitetet të rregullt, pasi në 3 muaj ka zhvilluar vetëm nga një mbledhje (shtator, nëntor dhe dhjetor 2019) kur zakonisht duhet të mbledhet dy herë në muaj; nuk ka zhvilluar aktivitetet fare për 9 muaj nga 16 gjithsej, duke sjellë për pasojë vonesa të pajustificuara, si dhe shpërblim jo eficient për grupin e punës në tre muajt që është zhvilluar nga një mbledhje; janë paraqitur për shqyrtim projektet me mbi 300 ditë me vonesë në rreth 19 % të rasteve, duke e bërë procesin e shqyrtimit fakultativ dhe subjektiv; janë rishqyrtuar 23 projekte (nga 40 gjithsej) ose 57 % e projekteve të shqyrtuara gjatë kësaj periudhe, çka do të thotë së dhe operatorët që aspirojnë të futen në tregun e energjisë elektrike nuk përgatisin projekte zbatimi serioze; rishqyrtimi është kryer në 12 raste (nga 23 gjithsej) jashtë afatit maksimal të përcaktuar në Rregullore (15 + 60=75 ditë), me nga 30 deri në 200 ditë me vonesë; parregullsi nënshkrimesh nga anëtarët e grupit të oponencës teknike në një rast etj.

Situata: Në zhvillimin e veprimtarisë së tij, Grupi i oponencës teknike paraprihet nga sekretariati i cili tërheq materialet e depozituara në protokoll dhe ja vë në dispozicion grupit të oponencës teknike. Grupi i oponencës teknike mbledhet normalisht 2 herë në muaj ose sa herë që Drejtori Ekzekutiv e sheh të nevojshme (neni 6/1 i Rregullores). Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, Grupi i oponencës teknike ka marrë në shqyrtim vlerësimin e projekteve të zbatimit si dhe rishqyrtime dhe vlerësime të projekteve të zbatimit në proces, sipas kërkesave të Rregullores së funksionimit të mësipërm.

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar 9 mbledhje përkatësisht 3 në muajin janar; 1 në shtator, 3 në tetor dhe nga një në muajin nëntor dhe dhjetor. Me Urdhrin e Ministres së MIE nr.47, datë 30.01.2019 janë pezulluar procedurat koncesionare dhe procedurat objekt i VKM nr.822, datë 07.10.2015 nga burimet hidrike të energjisë të cilat nuk janë finalizuar me lidhje kontrate, çka do të thotë së ky grup e ka ndërprerë veprimtarinë e tij. Ky Urdhër është shfuqizuar me Urdhrin e Ministres së MIE nr.311, date 31.07.2019, çka do të thotë së në periudhën gjashtë mujore shkurt-korrik 2019 grupi i oponencës teknike ka qenë i pezulluar dhe rifunksionimin duhej ta kishte nisur në gusht të vitit 2019, por e ka vazhduar në tetor 2019, pra dy muaj pas heqjes së pezullimit.

Në periudhën janar-prill 2020, grupi ka zhvilluar 5 mbledhje gjithsej 3 nga të cilat në muajin janar dhe 2 në muajin shkurt, kurse në mars-prill nuk janë zhvilluar mbledhje për shkak të fatkeqësisë natyrore të pandemisë.

Nga sa më sipër rezulton së grupi i oponencës teknike nuk ka zhvilluar aktivitetet të rregullt, pasi në 3 muaj ka zhvilluar vetëm nga një mbledhje (shtator, nëntor dhe dhjetor 2019) kur zakonisht duhet të mbledhet dy herë në muaj; nuk ka zhvilluar aktivitetet fare për 9 muaj nga 16 gjithsej, pasi 8 muaj (6 muaj në 2019 urdhri i Ministrit për pezullimin dhe 2 muaj në 2020 për periudhën e pandemisë) të arsyetuara dhe muajin gusht 2019 në mënyrë të paargumentuar. Një gjë e tillë ka sjellë për pasojë vonesa të pajustificuara, si dhe shpërblim jo eficient për grupin e punës në tre muajt që është zhvilluar nga një mbledhje.

Megjithëse në Rregullore nuk ka të përcaktuar afat për shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve të zbatimit të cilët vijnë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), rezulton së koha e qëndrimit të dosjes pa u shqyrtuar nga Grupi i oponencës në AKBN është nga 6 deri në 480 ditë. Në 6 raste nga 32 gjithsej të shqyrtimeve nga ana e Sektorit të Procedurave, Verifikimit dhe Trajtimit të Ankesave në Drejtorinë e Monitorimit të Hec –eve janë paraqitur për shqyrtim me mbi 300 ditë me vonesë, pra në rreth 19 % të rasteve, duke e bërë procesin e shqyrtimit fakultativ dhe subjektiv.

Për periudhën 1.01.2019 deri më 30.04.2020 janë rishqyrtuar 23 projekte (nga 40 gjithsej) ose 57 % e projekteve të shqyrtuara gjatë kësaj periudhe, çka do të thotë së dhe operatorët që aspirojnë të futen në tregun e energjisë elektrike nuk përgatisin projekte zbatimi serioze, duke sjellë jo

vetëm vonesa të panevojshme, por dhe deformime që në zanafillën e këtyre investimeve të dobishme për popullatën dhe fitimprurëse për sipërmarrësit. Në zbatim të Rregullores së grupit për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve, neni 7, pika 6 është përcaktuar së në rastet kur ky grup vëren së një Projekt-propozim ose projekt-zbatim nuk është i plotë de duhet rishikuar njoftohen zyrtarisht subjekti që ka paraqitur brenda 15 ditëve nga kryetari i grupit dhe brenda 60 ditëve nga marrja e njoftimit, subjekti duhet të plotësojë vërejtjet përkatëse. Sipas Rregullores, me përfundimin e këtij afati, grupi i oponencës teknike në mbledhjen e radhës shpreh qëndrimin përfundimtar ndaj projekt-propozimit apo projekt-zbatimit. Sipas të dhënave të veprimtarisë së Grupit të oponencës, rishqyrtimi është kryer në 12 raste (nga 23 gjithsej) jashtë këtij afati (15 + 60=75 ditë) maksimal nga 30 deri në 200 ditë me vonesë, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në Rregullore.

Audituesit e KLSH kryen shqyrtimin me zgjedhje të dokumentacionit të veprimtarisë së Grupit të oponencës teknike për 15 % të mbledhjeve (2/13).

- Në mbledhjen e datës 17.01.2019 ka pasur në rend dite shqyrtimin dhe projektin e vlerësimit për ndërtimin e hidrocentralit òRodi 1 dhe Rodi 2ò si dhe të Hidrocentralit òKërnaja 1 dhe 2ò. Nuk është nënshkruar deklarata e mungesës së konfliktit të interesit nga eksperti i jashtëm E.D., ndërkohë që është firmosur procesverbali i mbledhjes prej tij.

Raporti i oponencës teknike i është dërguar shoqërisë më datë 18.09.2019, pra 8 muaj pas zhvillimit të mbledhjes dhe nuk është i firmosur nga anëtarët e grupit të Oponencës teknike E.D., G.T.dhe M.B..

Raporti i oponencës teknike i është dërguar MIE me datë 25.11.2019, pra mbi 2 muaj nga data e dërgimit shoqërisë ndërtuese i nënshkruar nga të gjithë grupi i oponencës teknike.

Për vitin 2020, është realizuar oponencë teknike për 30 HEC-e.

Kriteri: 1) VKM nr. 547, datë 09.08.2006, òPër krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve natyroreò, të ndryshuar, pika 3;
2) Rregullore òPër kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBNò me nr.6453/8 prot., datë 18.10.2010, neni 7, pika 6.

Ndikimi: Mungesë performance e plotë e grupit të oponencës teknike.

Shkaku: Mungesë e zbatimit të plotë të kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia: E ulët.

Rekomandimi:Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masa për të siguruar performancë të plotë të grupit të oponencës teknike, duke zhvilluar mbledhjet e nevojshme për shmangien e vonesave dhe disiplinimin e sektorit të prodhimit të energjisë elektrike.

7. Titulli i gjetjes: Nga 30 oponenca teknike të realizuara për vitin 2020, janë audituar 5 prej tyre, nga ku ka rezultuar së në 3 oponenca ka mangësi.

Situata: MIE me shkresë nr. 7119/1 prot., datë 30.12.2019, i ka dërguar AKBN projektin e HEC òS&S Bò, për kryerjen e oponencës teknike.

AKBN me shkresë nr. 649/1 prot., datë21.01.2020, i ka kërkuar Shoqërisë òM.S.ò SH.P.K., plotësimin e dokumentacionit, ndërsa me shkresë nr. 649/3 prot., datë 29.06.2020 i ka dërguar raportin e oponencës teknike me vërejtjet përkatëse, disa nga të cilat trajtohen si më poshtë:

-Nuk është argumentuar zgjedhja e skemës.

- Mungojnë llogaritjet statike, llogaritjet e qëndrueshmërisë për të gjitha nën veprat dhe llogaritjet konstruktive.

- Preventivi është i pa plotësuar me analizat e çmimeve.

-Ekzistojnë të dhënat e prurjeve nga viti 1973 deri në vitin 1988, dhe nuk është sqaruar influenca në prurjet mesatare shumë vjeçare. Si janë marrë parasysh të dhënat hidrologjike të stacioneve Fushë Arrëz, Breg dhe Bukmirë?

- Nuk është saktësuar shtrirja e projektit në dy bashki atë të Fushë Arrëzit dhe Pukës.

- Në raport nuk ka asnjë të dhënë për volumin e punimeve që do të kryhen.

- nuk ka sqarim nëse projekti përputhet me planet e zhvillimit të zonës.

- Nuk paraqitet dokumentacion mbi opinionin paraprak të banorëve të zonës dhe cili është mendimi i tyre.

Oponenca teknike i është dërguar MIE me shkresë nr. 649/5 prot., datë 31.08.2020.

-Në Dokumentin e oponencës teknike, pika III.1 ÷Studimi i shfrytëzimit hidroenergjetikë përcaktohet: ÷Studimet inxhinierike të hartuara për projektin e zbatimit e mbështesin skemën e zgjedhur. Është paraqitur hartë me shkallë 1:25000 për pellgun ujëmbledhës përkatës, ku janë paraqitur edhe hecet e tjera në pellg. Rekomandohet që gjatë zbatimit të **kontratës të saktësohet skema e re**, të rakordohen/azhurnohen të gjitha objektet energjetike si dhe objekte të tjera koncesionare ose jo, të respektohet infrastruktura energjetike si dhe të azhurnohen planet urbanistike të zhvillimit të zonës etj.ö.

-Në Dokumentin e oponencës teknike, pika III.2 ÷Zgjidhja teknike e hidrocentralitö, përcaktohet: ÷Në raportet teknike janë pasqyruar të gjitha llogaritjet hidraulike, hidroteknike e hidroenergjetike, të bëra në lidhje me zgjidhjet teknike dhe dimensionimin e veprave hidroteknike. **Gjykojmë së pjesë e studimit duhet të ishin dhe llogaritjet statike dhe konstruktive të veprave**, të cilat duhet të merren në konsideratë nga inxhinierët e licencuar që do të merren me zbatimin e projektit në terren. **Mungojnë llogaritjet e sistemit të derivacionit dhe zgjidhja teknike është e pjesshme**. Të merren në konsideratë edhe prurjet maksimale në aksin e ndërtesës së centralit, pasi mungon siguria nga përmbytjet eventuale të ndërtesës së centralit, pasi **mungon siguria nga përmbytjet eventuale të ndërtesave të centraleve** nga kalimi i prurjeve maksimale për secilin aks të ndërtesave të centralit. Rekomandohet që, gjatë procesit të zbatimit të punimeve dhe të operimit të hidrocentraleve, **të dhënat e parametrave hidrologjikë të monitoruara e përpunuara në studimin hidrologjik, të pasqyrohen dhe të garantojnë vlerat e parametrave kryesorë energjetikëö.**

-Në Dokumentin e oponencës teknike, pika III.3 ÷Përshkrim i detajuar i vlerësimitö, përcaktohet: HEC ÷S.& S. B.ö do të shfrytëzojë Lumin Fani i Madh, pellgu Mat, me një vepër marrje me sipërfaqe ujëmbledhëse rreth 15 km². Studimi hidrologjik është bazuar në tre vend matje që ndodhen në Fushë Arrëz, Breg dhe Bukmir në lumin Fan i Madh.

Studimi hidrologjik për projektzbatimin e HEC ÷S&S B., konsiderohet i pranueshëm dhe **parametrat hidrologjik janë të besueshëm**.

Është konkluduar që:

-Projekti i zbatimit kushtet teknike dhe standardet e projektimit.

-Zgjidhjet teknike të veprave hidroenergjetike, si dhe kompozimi i tyre në nyjet hidroenergjetike është dhënë drejt dhe argumentuar nga pikëpamja tekniko-mjedisore.

Raporti i oponencës me vërejtje i është përcjellë shoqërive ÷S. C.ö dhe ÷R.ö SH.P.K., me shkresë nr. 304/1 prot., datë 30.01.2020.

Janë konstatuar mangësi dhe është kërkuar plotësimi i dokumentacionit, ndër të tjera si më poshtë:

-Mungojnë llogaritjet statike dhe konstruktive të të gjitha veprave dhe duhet të plotësohen.

- Një pjesë e derivatit është paraqitur sifon.

- Nuk është përcaktuar si është zgjedhur prurja llogaritëse.

- Nuk janë përcaktuar siç duhet prurjet ditore.
- Prurjet ekologjike janë të ndryshme referuar materialit hidrologjik dhe atij hidroteknik.
- Nuk janë llogaritur prurjet maksimale për sigurinë e veprave të marrjes etj.
- Mungojnë llogaritjet e tunelit dhe përshkrimi i formacioneve gjeologjike nëpër të cilat kalon.
- Nuk përcaktohen linjat me të cilat do të lidhet 35, apo 100 kV.
- Nuk ka miratim paraprak nga ABU Bunë etj.

Oponenca teknike për HEC òKorthpulëo, i është dërguar MIE me shkresë nr. 174/1 prot., datë 02.03.2020.

Në pikën III.1, përcaktohet: òKonstatohet së, studimet inxhinierike të hartuara për projektin e zbatimit të hidrocentralit, hidrologjike, gjeologe-inxhinierike, mjedisore, lidhjes me sistemin elektroenergjitik dhe hidroenergjitik e mbështesin këtë skemë të zgjedhur gjatë hartimit të projektit të zbatimit.

Gjykojmë së pjesë e studimit duhet të ishin dhe llogaritjet statike dhe konstruktive të veprave, të cilat duhet të merren në konsideratë nga inxhinierët e licencuar që do të merren me zbatimin e projektit në terren.

-Të merren në konsideratë edhe prurjet maksimale në aksin e ndërtesës së centralit, pasi mungon siguria nga përmbajtjet eventuale të ndërtesave të centraleve nga kalimi I prurjeve maksimale për secilin aks të ndërtesave të centralit.

- Për këtë studim janë marrë parasysh të dhënat në vendmatjen e Urës së Hoxhës, që ka të dhëna për një periudhë 40 vjeçare. Parametrat hidrologjikë të llogaritur për veprën e marrjes të hec janë të saktë. Studimi hidrologjik për projektzbatimin e këtij hec konsiderohet i pranueshëm për këtë fazë. Është konkluduar që:

-Projekti i zbatimit kushtet teknike dhe standardet e projektimit.

-Zgjidhjet teknike të veprave hidroenergjetike, si dhe kompozimi i tyre në nyjet hidroenergjetike është dhënë drejt dhe argumentuar nga pikëpamja tekniko-mjedisore.

Oponenca teknike për HEC òRadatö, i është dërguar MIE me shkresë nr. 3435/7 prot., datë 09.12.2020.

Në pikën III.2, të oponencës teknike përcaktohet: òMungojnë llogaritjet e sistemit të derivacionit dhe zgjidhja teknike është e pjesshme. Raporti është shumë teorik. Materiali grafik është paraqitur i qartë por ka disa mangësi që duhet të plotësohen për në fazat e mëtejshme.

Pavarësisht mangësive si më sipër, por dhe mangësive të tjera, nga ana e grupit të oponencës është konsideruar së projekti i plotëson kushtet teknike dhe standardet e projektimit, si dhe zgjidhjet teknike të veprave hidroenergjetike dhe kompozimi i tyre në nyjet është dhënë drejt dhe argumentuar nga pikëpamja tekniko-mjedisore.

Kriteri: Rregulloren Për Funksonimit e Grupit òPër kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesionö, Neni 2.

Ndikimi: Është kërkuar argumentim për zgjedhjen e skemës, ndërkohë që argumentimi mungon, madje është rekomanduar që gjatë zbatimit të kontratës të saktësohet skema e re.

Mungojnë llogaritjet statike, llogaritjet e qëndrueshmërisë për të gjitha nënveprat dhe llogaritjet konstruktive, të cilat edhe në dokumentin e oponencës konsiderohen të pa plotësuar, madje gjykohet së pjesë e studimit duhet të ishin dhe llogaritjet statike dhe konstruktive të veprave.

Preventivi është i pa plotësuar me analizat e çmimeve, gjë e cila nuk është reflektuar në dokumentin e oponencës teknike., duke mos garantuar realizimin e kushteve teknike të projektimit.

Ekzistojnë të dhënat e prurjeve nga viti 1973 deri në vitin 1988, dhe nuk është sqaruar influenca në prurjet mesatare shumë vjeçare. Megjithëse është kërkuar së si janë marrë parasysh të dhënat

hidrologjike të stacioneve Fushë Arrëz, Breg dhe Bukmirë, të cilat nuk kanë lidhje me prurjet e përroit Bicaç, është konkluduar që të shikohen gjatë zbatimit.

Nuk është saktësuar shtrirja e projektit në dy bashki atë të Fushë Arrëzit dhe Pukës, ndërkohë që në dokumentin e oponencës teknike, i referohet vetëm Bashkisë Pukë.

Në raport nuk ka asnjë të dhënë për volumin e punimeve që do të kryhen, gjithësei është konsideruar në rregull. Nuk ka sqarim nëse projekti përputhet me planet e zhvillimit të zonës, si dhe nuk është reflektuar një fakt i tillë në dokumentin e oponencës. Nuk paraqitet dokumentacion mbi opinionin paraprak të banorëve të zonës dhe cili është mendimi i tyre, fakt i cili nuk reflektohet në dokumentin e oponencës, duke mos garantuar realizimin respektimin e kushteve të projektimit.

Shkaku: Mos shqyrtim me detaje i dokumentacionit teknik.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masa për të siguruar performancë të plotë të grupit të oponencës teknike, duke zhvilluar mbledhjet e nevojshme për shmangien e vonesave dhe disiplinimin e sektorit të prodhimit të energjisë elektrike.

8.c) Shlyerja e detyrimeve ndaj shtetit për shfrytëzimin dhe prodhimin e burimeve energjetike.

8. Titulli i gjetjes: Në pagesat e shoqërive koncesionare për kryerjen e oponencës teknike nga ana e AKBN për projektet e ndërtimit të hidrocentraleve janë 9 raste në faturat e të cilëve nuk është paguar TVSH në vlerën 320,000 lekë.

Situata: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton së, në vitin 2019 janë 9 raste në faturat e pagesave të shoqërive koncesionare për oponencën teknike, nuk është llogaritur dhe paguar TVSH mbi vlerën e tarifës, por është konsideruar e përfshirë brenda saj, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 datë 24.07.2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 39, pika 1, shkronja òaò

Në vlerën e tatueshme përfshihen elementet e mëposhtme: a) tatimet, taksat, detyrimet, tarifatat dhe pagesa të ngjashme, me përjashtim të TVSH-së.

TVSH e munguar për faturat të oponencës teknike të këtyre 9 shoqërive është në vlerën e 320,000 lekë (1,600,000 lekë vlera e faturave gjithsej x 20% TVSH), të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për AKBN.

Vlera prej 320,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën e TVSH së papaguar nga 9 shoqëri që operojnë me kontrata koncesionare për ndërtimin e HEC-eve dhe të pa mbajtur për vlerën e tarifave për oponencën teknike, përbën të ardhura të munguara.

Në pagesat e shoqërive koncesionare për kryerjen e oponencës teknike nga ana e AKBN për projektet e ndërtimit të hidrocentraleve, nuk është llogaritur dhe paguar TVSH mbi vlerën e tarifës, por është konsideruar e përfshirë brenda saj, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 datë 24.07.2014 òPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 39, pika 1, òa. Në vlerën e tatueshme përfshihen elementet e mëposhtme: a) tatimet, taksat, detyrimet, tarifatat dhe pagesa të ngjashme, me përjashtim të TVSH-së. òPër këtë arsye, Drejtoria e Monitorimit të HEC-eve, ka dërguar një shkresë njoftuese në subjektin që ka përfituar nga projekti mbi shlyerjen e detyrimit të TVSH-së, nga ku një pjesë e tyre, e kanë paguar detyrimin e TVSH-së, ndërsa për 108 subjekte, me një vlerë prej 4,460,000 lekë (22,300,000 lekë vlera e faturave gjithsej x 20% TVSH), nuk është lëshuar fatura përkatëse e TVSH-së dhe nuk janë arkëtuar të ardhurat nga institucioni, duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë të financave nr.24 datë 02.09.2008 òPër procedurat tatimore në

Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku citohet... 046.1.11 Gjatë ushtrimit të veprimtarisë për të cilën janë krijuar, organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, entet publike kombëtare e vendore, organizatat politike dhe organet e tjera të ngjashme me to, mund të kryejnë furnizim mallrash apo shërbimesh si dhe të marrin pagesa për arsye të tjera të ndryshme. Në këto raste ato lëshojnë fature të thjeshtë tatimore, me përjashtim të rasteve kur në bazë të legjislacionit tatimor në fuqi janë të detyruar të lëshojnë faturë me TVSH. ËAKBN-së i ka lindur e drejta për të arkëtuar të ardhurat për TVSH-në nga subjektet për projektin përkatës. Nga auditimi i llogarisë së debitorëve në pasqyrën e pozicionit financiar, u konstatua se nuk janë njohur në kontabilitet të drejtat e arkëtueshme për të ardhurat nga TVSH-ja që priten të arkëtohen nga institucioni në të ardhmen, veprime këto në kundërshtim me SKK 1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare", pika 41 citohet ... "Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe njihen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Pasqyrat financiare, të përgatitura në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, i informojnë përdoruesit jo vetëm mbi transaksionet e shkuara të shoqëruara me arkëtime dhe pagesa, por edhe mbi detyrimet për tu paguar në të ardhmen si dhe mbi aktive që do të sjellin arkëtime në të ardhmen. Në këtë mënyrë, ato paraqesin informacione mbi transaksionet dhe ngjarjet e shkuara të cilat u shërbejnë përdoruesve më së miri në marrjen e vendimeve ekonomike."

Vlera prej 4,460,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën e TVSH së papaguar nga 108 shoqëri që operojnë me kontrata koncesionare për ndërtimin e HEC-eve dhe të pa mbajtur për vlerën e tarifave për oponencën teknike, konsiderohet e ardhur e munguar.

Kriteri: 1) Ligji nr. 92/2014 datë 24.07.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 39, pika 1, shkronja òaò;

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e AKBN.

Shkaku: Mungesë e njohjes dhe vëmendjes në zbatimin e legjislacionit përkatës.

Rëndësi E ulët.

Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masa duke njoftuar subjektet përkatëse për të kryer pagesat mësipërme, duke ngarkuar sektorin e financës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi.

9. Titulli i Gjetjes: Gjatë monitorimit të kontratave konesionare për ndërtimin e hidrocentraleve në vitin 2019, Drejtoria përkatëse në AKBN ka evidentuar parregullsi në kundërshtim me kushtet kontraktore, penalitete në vlerën 3,697,850,501 lekë, për vitin 2020 me vlerë 19,445,588,858 lekë, për të cilat është njoftuar autoriteti kontraktor, MIE për secilën kontratë koncesionare. Gjithashtu, mungesa e shoqërimit të ndryshimit të prodhimit të energjisë elektrike nga oponenca teknike në kontratat koncesionare sjell për pasojë mungesën e përfitimit buxhetor për 15,590,253 lekë, dhe të dyja së bashku në vlerën 3,713,440,754 lekë.

Situata: Nga raportet e monitorimit të tremujorit të tretë dhe të katërt 2019 rezulton në përgjithësi se ka mungesë dokumentacioni të lejeve të ndryshme (mjedisore, të ujit etj.); nuk kryhet sigurimi i kontratës dhe i punimeve të ndërtimit; nuk kryhet raportimi i detyruar çdo tremujor; nuk mund të llogariten penalitete për fillimin me vonesë të punimeve, pasi shoqëritë nuk dokumentojnë fillimin e punimeve (përgjegjësi e mbikëqyrësit); janë në shkelje të afatit të ndërtimit dhe janë llogaritur penalitete sipas përcaktimeve në kontratë; ka raste kur shoqëritë

fillojnë punimet pa u miratuar më parë projekti i zbatimit, si dhe pa u pajisur me leje ndërtimi; informacioni financiar lidhur me vëllimin e investimeve është i mangët etj.

Në zbatim të nenit 23 pika 1, shkronja òiò, të kontratës koncesionare òKoncesionari për shkelje të afatit të ndërtimit penalizohet me 0.05% në ditë të vlerës së investimeve të munguaraò, AKBN (Drejtorja e Monitorimit të HEC-eve) ka llogaritur penalitete për 41 % të kontratave të monitoruara (për 26 prej tyre nga 64 gjithsej) për vitin 2019 në vlerën 3,697,850,501 lekë, për vitin 2020 në vlerë 19,445,588,858 lekë, të cilat përbëjnë të hyra të munguara në buxhetin e shtetit për të ardhurat e paplanifikuara nga burime të tjera. AKBN ia ka dërguar Autoritetit Kontraktues (MIE) për veprime të mëtejshme, sipas përcaktimeve në kontratat koncesionare dhe për të cilat AKBN nuk ka informacion në së janë kërkuar për t'u mbajtur dhe arkëtuar, por referuar praktikave të mëparshme MIE nuk ka vepruar për kërkimin dhe mbajtjen e këtyre penaliteteve.

Llogaritja dhe moskërkimi e mos mbajtja e penaliteteve ka shkaktuar deformim të sipërmarrjes në fushën prodhimit të energjisë elektrike nga burimet ujore, si rezultat veprimeve dhe mosveprimeve të MIE në cilësinë e Autoritetit kontraktor, pas raporteve të monitorimit të përgatitura nga Drejtorja e Monitorimit të HEC-eve në AKBN.

Sipas të dhënave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion rezulton së, në vitin 2019 për 25 kontrata koncesionare, prodhimi vjetor i energjisë elektrike të të cilave është rritur në projektin e zbatimit, por që nuk është shoqëruar me ndryshimet në kontratë, sjellë për pasojë mungesën e përfitimit nga fee koncesionare (energji elektrike pa pagesë) për 15,590,253 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit nga burimet e tjera të paplanifikuara.

Vlera prej 23,159,029,612 lekë përbën të hyra të munguara në buxhetin e shtetit për të ardhurat e paplanifikuara nga burime të tjera, nga të cilat 23,143,439,359 lekë, e cila përfaqëson penalitete të evidentuara por të pa mbajtura dhe të pa arkëtuara për shkelje të afatit të ndërtimit të HEC-eve, si dhe 15,590,253 lekë mungesën e përfitimit nga fee koncesionare (energji elektrike pa pagesë) nga ndryshimet në rritje të prodhimit vjetor të energjisë elektrike në oponencën e projekteve të pashoqëruar me këto ndryshime kontratat koncesionare.

Kriteri: 1) VKM nr. 547, datë 09.08.2006, òPër krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve natyroreò, të ndryshuar, pika 2;
2) Kontratat koncesionare, nenin 23 pika 1, shkronja òiò; pika 23.2 shkronja òiiò; pikën 23.3.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit nga burime të tjera të paplanifikuara.

Shkaku: Mungesë e angazhimit e MIE, në cilësinë e Autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratave koncesionare në fushën e prodhimit të energjisë elektrike.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandimi:Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masat e nevojshme për të rritur frymën e bashkëpunimit me MIE për shkëmbimin e informacionit lidhur me ecurinë e zgjidhjes së problematikave të evidentuara gjatë monitorimit të kontratave koncesionare në fushën energjetike.

10. Titulli i gjetjes: Shmangie të shumta të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor nga ana e koncesionarëve.

Situata: Nga monitorimi është konstatuar së disa koncesionarë nuk kanë paraqitur dokumentacionin e lejes së ndërtimit, apo leje të tjera, por nga ana e AKBN, nuk është marrë

asnjë masë për sensibilizimin e organeve kompetente. Mungesa e dokumentacionit si më sipër, nuk krijon mundësinë e monitorimit të ndikimit në mjedis, të problematikave që i krijohen banorëve të zonës në lidhje me përdorimin e burimeve ujore, mungesë pagesë tarifash, mungesë ta trajtimit të problematikave kur projekti shtrihet në më shumë se një bashki et., problematika të cilat nuk parandalohen, por bëhen objekt për ndërprerje të kontratave në të ardhmen, duke ulur nivelin e investimeve në këtë fushë dhe pasoja për mjedisin etj.

- Nga monitorimi konstatohet së disa koncesionar kanë ndryshuar kapacitetin e prodhimit, megjithatë nga ana e AKBN nuk janë bërë llogaritjet për pasojat e veprimit në lidhje me sasinë e energjisë dhe të ardhurave që do të mungojnë nga prodhimi më i ulët i energjisë për shtetin (për rastet kur kapaciteti është më i ulët), si dhe problematika që krijohet në deformimin e skemave të miratuara dhe pasojat në funksionim.

- Pavarësisht monitorimit kontraktorët paraqesin mangësi të theksuara të plotësimit të dokumentacionit tekniko ligjor, madje në disa raste nuk bëhet njoftim për pjesëmarrje në testim nga ana e AKBN, si proces i detyrueshëm, për evidentimin e saktësisë së realizimit të veprave, krahasuar me parashikimin.

-Devijimet e shumta si në skema, kapacitete, ndryshime gjatë zbatimit të kontratave, mund të shoqërohen me vështirësi për realizimin e këtyre veprave dhe në ndonjë rast dështimin e tyre.

- Vonesat në fillimin, zbatimin apo përfundimin e veprave, vë në diskutim vënien në funksion të tyre, ose në rastin më të mirë, vënie me vonesë në eficiencë të investimeve, rrjedhimisht energji elektrike më pak në rrjet dhe të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

- Nga ana e AKBN janë përlllogaritur penalitete si për mos fillim, fillim të vonuar, apo mos përfundim të punimeve në afat, por nuk rezultojnë asnjë rast i ekzekutuar. Mos ekzekutimi i penaliteteve përveç të ardhurave të munguara për buxhetin e shtetit, nuk nxit koncesionarët për të aktivizuar burimet e tyre për realizimin e investimit sipas parashikimeve të miratuara (procesi i aplikimit të penaliteteve është kompetencë e MEI).

- Nisur nga numri i lartë i HEC-eve të miratuara, por të pa filluara, edhe për periudha të gjata të konsiderueshme të cilët konsiderohen pa shpresë realizimi, nuk është shoqëruar me njoftimet përkatëse për ndërprerjen e kontratës, për t'ia dhënë mundësinë operatorëve të tjerë për realizimin e mundshëm të këtyre investimeve.

Kriteri: Kontrata koncesionare, sipas llojit të koncesionit.

Ndikimi: Vonesa në zbatimin e projekteve, shmangie nga përcaktimet në fizibilitet, problematika të cilat çojnë në vendimmarrje të gabuara.

Shkaku: Mos impenjimi i duhur i koncesionarëve për respektimin e përcaktimeve në kontratat përkatëse.

Ndikimi: i mesëm.

Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të hartojë një dokument pune të veçantë me propozime konkrete për institucionalizimin e marrëdhënieve me MIE, në zgjidhje të problematikave të evidentuara nëpërmjet informacioneve përkatëse të AKBN.

8.ç) Marrëdhëniet me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për shfrytëzimin e burimeve energjetike

11. Titulli i Gjetjes: Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka treguar kujdesin e duhur lidhur me informacionin e marrë nga monitorimi i kryer nga AKBN për shfrytëzimin e burimeve energjetike, për të zbatuar plotësisht kuadrin rregullator të fushës.

Situata: Rezultatet e monitorimit të veprave hidroenergjetike dhe zbatimit të detyrimeve kontraktuale të kryera nga AKBN, krahas njoftimit të shoqërive koncesionare për problematikën

përkatëse, i janë bërë të ditura dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Autoritetit kontraktor. Sipas AKBN, mungon informacioni nga ana e MIE lidhur me masat e marra për mangësitë e evidentuara, duke sjellë për pasojë që një numër i konsiderueshëm i kontratave me mangësi të theksuara në dokumentacion, të arrijnë në përfundimin e punimeve dhe nisjen e procesit të testimit, e lidhur kjo dhe mungesën e theksuar të raportimit të subjekteve në AKBN, pasi nuk ekzistojnë masa ndëshkuese për raste të tilla.

Në rezultatet e monitorimeve që AKBN i dërgon MIE nëpërmjet Raportit të detajuar ligjor ó teknik ó financiar në mënyrë periodike tremujore, krahas problematikave të tjera janë dhe propozimet për penalitete për moszbatim të kushteve kontraktore që duhet të evidentohen, kërkohen dhe mbahen nga MIE, por nuk ka asnjë përgjigje në lidhje me këtë çështje thelbësore në rregullimin e kësaj veprimtarie.

Për të gjitha kontratat koncesionare, të cilat nuk kanë filluar ende punimet ndërtimore, ose të marrjes së lejeve të nevojshme, nga AKBN është njoftuar MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, duke i bërë me dije shkeljet e konstatuara të kushteve të paracaktuara në kontratat e koncesionit. Gjithsesi, këto korrespondenca kanë mbetur pa përgjigje dhe situata për ato shoqëri koncesionare, të cilat prej vitesh duhet të kishin përfunduar punimet ndërtimore dhe duhet të kishin kaluar në fazën e prodhimit, kanë mbetur ende pezull. Edhe në këto raste nuk kanë munguar propozimet e AKBN-së për penalitete ndaj shoqërive, por referuar kontratave koncesionare këto shkelje rrallë mund të penalizohen sipas neneve që kanë vlera monetare, por nga ana tjetër ka patur propozime për zbatimin e nenit 6Zgjidhja e njëanshme e kontratës.

I njëjti fenomen konstatohet dhe për kontratat koncesionare me objekte në fazë shfrytëzimi për mungesën e raportimit të prodhimit të energjisë elektrike në AKBN, duke shmangur penalizimin për mosrealizim të prodhimit vjetor të parashikuar sipas nenit përkatës në kontratë.

MIE nuk ka sqaruar dhe rregulluar çështjet që kanë lindur, pas miratimit të Vendimit Nr. 332, datë 6.6.2018 për disa shtesa në Vendimin Nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave, 6Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, të ndryshuar, sipas të cilës 6Monitorimi i prodhimit të energjisë elektrike do të kryhet çdo 5 vjet dhe, për efekt penalteti, vlerësimi do të referohet mesatares së prodhimit të energjisë, duke filluar nga viti i parë i plotë financiar i vënies në punë të hidrocentralitë lidhur me çmimin e aplikueshëm të energjisë elektrike pasi është i ndryshëm gjatë viteve, për cilat hidrocentrale do të aplikohet, si dhe mospërputhjen e saj me përcaktimet në kontratën koncesionare.

Në vijim të zbatimit të detyrimeve kontraktuale, për pajisjet me Lejet e nevojshme për ndërtimin e veprave hidroenergjitike, në zbatim edhe të legjislacioneve në fuqi, AKBN për të gjitha rastet që ka evidentuar punime ndërtimore jashtë lejeve të nevojshme (më së shumti jashtë Lejeve të Ndërtimit), krahas MIE dhe kontraktorit, ka njoftuar autoritetet përkatëse për këtë shkelje të dispozitave ligjore në fuqi por që nuk ka pasur ndonjë aktivitete të veçantë nga ana e Autoritetit kontraktor.

Marrëdhëniet e Drejtorisë së Energjive të Rinovueshme me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë bëhen nëpërmjet Drejtorisë të Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficencën e Energjisë, për koordinimin e detyrave të monitorimit:

- në ndërtimin e programeve të përbashkëta për monitorimin e shoqërive që operojnë në parqet fotovoltaike;
- regjistrimin e bilancit të energjisë të gjithë prodhuesve me përparësi të energjisë;

monitorimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Energjinë e Rinovueshme.

Rezultatet e monitorimit të veprave hidroenergjitike dhe zbatimit të detyrimeve kontraktuale të kryera nga AKBN, krahas njoftimit të shoqërive koncesionare për problematikën përkatëse, i

janë bërë të ditura dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Autoritetit kontraktor.

Në rezultatet e monitorimeve që AKBN i dërgon MIE nëpërmjet Raportit të detajuar ligjor ó teknik ó financiar në mënyrë periodike tremujore, krahas problematikave të tjera janë dhe propozimet për penalitete për moszbatim të kushteve kontraktore që duhet të evidentohen, kërkohen dhe mbahen nga MIE.

Për të gjitha kontratat koncesionare, të cilat nuk kanë filluar ende punimet ndërtimore, ose të marrjes së lejeve të nevojshme, nga AKBN është njoftuar MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, duke i bërë me dije shkeljet e konstatuara të kushteve të paracaktuara në kontratat e koncesionit.

Nga ana e AKBN janë vënë në dispozicion shkresa të MEI me nr. 6488/4, 6488/5, 7971, 7972, 7974, 7975, 7976 prot, datë 05.11.2021, drejtuar AKBN, ku përcaktohet së ka mospërputhje ndërmjet vlerave dhe kërkohet qëndrim përfundimtar, në lidhje me vlerën e penaltetit për disa subjekte, në mënyrë që MIE të vijojë me aplikimin e penaltiteteve. Po ashtu, janë vënë në dispozicion shkresat nr. 8048 prot., datë 08.11.2021, 6488/9 prot., datë 10.12.2021, nr. 6488/10 prot., datë 20.12.2021, ku u kërkohet disa subjekteve koncesionare që në përputhje me pikën 23.5 të nenit 23 të kontratës, të diskutojnë brenda një periudhe 30 ditore lidhur me shkeljet.

Koncesionarëve u është bërë e ditur së në rast të mos paraqitjes në kohë, do të aplikohet sanksioni përkatës dhe do të kërkohet shlyerja e detyrimit brenda 20 ditësh, si dhe në rast të mos shlyerjes në kohë të penaltetit, do të kërkohet edhe pagesa e kamatave ligjore. Ndërkohë që nuk ka informacion në lidhje me aplikimin e ndonjë penaltitet.

Kriteri: 1) VKM nr. 547, datë 9.8.2006 òPër krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore ò i ndryshuar

Ndikimi: Në disiplinimin dhe zhvillimin e prodhimit të energjisë elektrike nga kontratat koncesionare në burimet hidrike.

Shkaku: Mungesë e vëmendjes nga MIE në zbatimin e kuadrit rregullativ në fushën e burimeve energjetike.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të hartojë një dokument pune të veçantë me propozime konkrete për institucionalizimin e marrëdhënieve me MIE, në zgjidhje të problematikave të evidentuara nëpërmjet informacioneve përkatëse të AKBN.

Konkluzione:

1. Grupi i punës për verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i VKM nr.822, datë 07.10.2015, nga burimet hidrike të energjisë i ngritur me Urdhrin e Ministres së MIE nr.233 datë 06.06.2019 ka evidentuar së 35 % të kontratave koncesionare janë jashtë afatit, me shkelje, si dhe në procese gjyqësore (92 nga 265) gjë që tregon për nivelin e dobët të monitorimit nga të gjitha institucionet përkatëse, përfshirë dhe AKBN.

2. Monitorimet, nuk kanë një shpërndarje përafërsisht të njëtrajtshme midis tremujorëve për vitin 2019, duke ndikuar në ngarkesën e punonjësve dhe cilësinë e monitorimit për shkak të intensifikimit të punës në periudha të veçanta të vitit; mungojnë përgjithësisht në tremujorin e parë të vitit për mungesë buxheti për mangësi procedurale dhe administrative; nuk janë mbuluar me monitorim të gjitha kontratat dhe HEC-et në ndërtim; nga raportimet e tremujorit të tretë dhe të katërt 2019 rezulton në përgjithësi së ka mungesë dokumentacioni dhe probleme komplekse të lidhura me shumë institucione publike, si dhe penaltete për mosrespektim të detyrimeve kontraktore për 41 % të kontratave të monitoruara, duke shkaktuar deformim të sipërmarrjes në fushën prodhimit të energjisë elektrike nga burimet ujore, si rezultat veprimeve dhe

mosveprimeve të MIE në cilësinë e Autoritetit kontraktor.

3) Si rezultat i mos ndryshimit në rritje të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike të rezultuar nga oponenca teknike për projektet e zbatimit në kontratat koncesionare për 25 prej tyre, sjellë për pasojë mungesën e përfitimit nga fee koncesionare (energji elektrike pa pagesë) në vlera të konsiderueshme. Veç kësaj rezulton së nga 37 kontrata koncesionare për 149 HEC-e në 11 prej tyre ose në 30 %, fuqia (në kw) sipas projektit të zbatimit të vlerësuar nga AKBN dhe të miratuar nga AK është më e ulët nga 7 deri në 60%, mungesa e reflektimit të të cilave në kontratë rrezikon koncesionarët për penalizim në vlera të konsiderueshme për ulje të fuqisë së instaluar.

4) Ndryshimi i monitorimit të prodhimit vjetor të energjisë elektrike me VKM nr. 332, datë 6.6.2018 duke e kaluar me mesatare për periudha 5-vjeçare, pa vendosur vitin e fillimit, jo vetëm që është në kundërshtim me përcaktimet në kontratat koncesionare, në pjesën më të madhe të të cilave janë miratuar po me VKM, por sjell si pasojë heqjen e një elementi të rëndësishëm të monitorimit vjetor të veprimtarisë hidronergjetike, pikërisht atë të prodhimit, së bashku me reduktimin funksionit institucional të sektorit përkatës me një staf prej 8 specialistësh, shtyrjen në kohë të sanksioneve për këtë qëllim duke i zbutur deri në shuarje e tyre, krahas përfshirë këtu dhe ndryshimin e çmimit të blerjes të energjisë elektrike përgjatë 5 viteve për efekt penaliteti, të cilat të analizuar për vitin 2019 janë në vlera të konsiderueshme.

5) Grupi i oponencës teknike prej 9 anëtarësh, ka në shumicë ekspertë të jashtëm (5) në kundërshtim me VKM nr. 547, pika 3, pasi vendim-marrja del jashtë kompetencës saj institucionale, e varur dhe e përcaktuar nga ekspertët e jashtëm, si dhe në të njëjtën kohë është kosto financiare për vetë AKBN; evidenton mungesën e rekrutimit të stafit profesional sipas fushave të AKBN në përgjithësi dhe atij të Drejtorisë Monitorimit të HEC-eve në veçanti, duke vepruar në kundërshtim dhe me VKM nr. 547, datë 09.08.2006, të ndryshuar, fjalia e fundit e paragrafit të katërt të pikës 3, që i mundëson AKBN kërkimin e asistencës së specializuar për raste të veçanta, por jo për veprimtari funksionale institucionale; shfaq mungesën e përcaktimit të kriterëve që duhet të plotësojnë ekspertët e jashtëm e bën procedurën e kryerjes së oponencës teknike subjektive dhe me mangësi potenciale të kësaj veprimtarie; vazhdon të mbetet problem mungesa e një specialisti hidroteknik në përbërje të grupit të oponencës teknike, duke vepruar në kundërshtim me nenin 6 pika 2 dhe nenin 7 pika 12, të rregullores oPër kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBNö, i cili përcakton përbërjen me 2 specialistë të kësaj fushe.

6) Grupi i oponencës teknike nuk ka zhvilluar aktivitet të rregullt, pasi në 3 muaj ka zhvilluar vetëm nga një mbledhje (shtator, nëntor dhe dhjetor 2019) kur zakonisht duhet të mbledhet dy herë në muaj; nuk ka zhvilluar aktivitet fare për 9 muaj nga 16 gjithsej, duke sjellë për pasojë vonesa të pajustificuara, si dhe shpërblim jo eficient për grupin e punës në tre muajt që është zhvilluar nga një mbledhje; janë paraqitur për shqyrtim projektet me mbi 300 ditë me vonesë në rreth 19 % të rasteve, duke e bërë procesin e shqyrtimit fakultativ dhe subjektiv; janë rishqyrtuar 23 projekte (nga 40 gjithsej) ose 57 % e projekteve të shqyrtuara gjatë kësaj periudhe, çka do të thotë së dhe operatorët që aspirojnë të futen në tregun e energjisë elektrike nuk përgatisin projekte zbatimi serioze; rishqyrtimi është kryer në 12 raste (nga 23 gjithsej) jashtë afatit maksimal të përcaktuar në Rregullore (15 + 60=75 ditë), me nga 30 deri në 200 ditë me vonesë; parregullsi nënshkrimesh nga anëtarët e grupit të oponencës teknike në një rast etj.

7) Në pagesat e shoqërive koncesionare për kryerjen e oponencës teknike nga ana e AKBN për projektet e ndërtimit të hidrocentraleve janë 9 raste në faturat e të cilëve nuk është paguar TVSH në vlerën 320,000 lekë.

8) Gjatë monitorimit të kontratave kocesionare për ndërtimin e hidrocentraleve në vitin 2019, Drejtoria përkatëse në AKBN ka evidentuar parregullsi në kundërshtim me kushtet kontraktore, penaltete në vlerën 3,697,850,501 lekë, për të cilat është njoftuar autoriteti kontraktor, MIE për secilën kontratë kocesionare. Gjithashtu, mungesa e shoqërimit të ndryshimit të prodhimit të energjisë elektrike nga oponenca teknike në kontratat kocesionare sjell për pasojë mungesën e përfitimit buxhetor për 15,590,253 lekë, dhe te dyja së bashku në vlerën 3,713,440,754 lekë

9) Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka treguar kujdesin e duhur lidhur me informacionin e marrë nga monitorimi i kryer nga AKBN për shfrytëzimin e burimeve energjetike, për të zbatuar plotësisht kuadrin rregullator të fushës.

10) Oponenca teknike nuk realizohet duke respektuar në themel rregulloren përkatëse, ku për raste të veçanta nuk garantohet respektimi i kushteve teknike të projektimit, shfrytëzimi optimal i burimeve ujore si dhe ndikimi sa më i ulët në mjedis.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga grupi i oponencës, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 216/15 prot., datë 07.04.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Sa i përket HEC B, pretendohet së është njoftuar zyrtarisht shoqëria për vërejtjet që duhet të plotësojë. Pasi janë bërë plotësimet grupi i oponencës është mbledhur përsëri dhe ka konkluduar me raportin teknik, i cili i është dërguar MIE. Grupi i oponencës cilësohet si organ teknik dhe jo vendimmarrës. Rekomandimet që i janë dërguar MIE janë për të siguruar mbarëvajtjen gjatë punimeve gjatë fazës së zbatimit (pra ndërtimit të veprës) për t'u marrë në konsideratë gjatë marrjes së lejeve përfundimtare si ajo e përdorimit të burimeve ujore, leja e mjedisit, leja e bashkisë përkatëse, leja e lidhjes me sistemin dhe leja e ndërtimit. I njëjti citim është dhe për oponencën teknike të realizuar për HEC K dhe HEC R. Pretendohet së veprimet nuk janë në kundërshtim me rregulloren.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Sqarojmë së nga ana e grupit të auditimit është shqyrtuar raporti me vërejtje që i dërgohet shoqërive për plotësim si dhe raporti përfundimtar i cili i dërgohet ministrisë. Në raportin e dërguar ministrisë cilësohet së janë plotësuar mangësitë, por në fakt, ka mangësi thelbësore të cilat nuk janë plotësuar, megjithatë është marrë vendim pozitiv. Në nenin 2 të Rregullore Për Funkionimit e Grupit ÷Për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me kocesiono është shprehur qartë qëllimi i realizimit të oponencës teknike Si për studimet e fizibilitetit ashtu dhe për projektet e zbatimit, si më poshtë:

÷Oponencë teknike për studimet e fizibilitetit është vlerësimi tekniko-mjedisor i projektpropozimeve për ndërtimin e hidrocentraleve me kocesion, paraqitur nga personat fizikë apo juridikë, privatë, të huaj apo vendas, duke synuar shfrytëzimin optimal të burimeve ujore.

Oponenca teknike për projektet e zbatimit të hidrocentraleve, është kontrolli mbi zbatimin e kushteve teknike të projektimit për ndërtimin e hidrocentralit, në plotësimin dhe saktësimin e të dhënave studimore, hidroenergjetike, gjeologo-inxhinierike, hidrologjike e topo-gjeodezike, elektrike e mjedisore.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga AKBN është paraqitur observacioni me shkresë nr. 216/28 prot., datë 02.06.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Raportet e monitorimit të HEC-ve i janë dërguar periodikisht Ministrisë, ku për çdo kontratë fuqia dhe energjia sipas oponentit teknike dhe kontratës koncesionare. Me shkresë nr. 3505 prot., datë 30.09.2021, AKBN ka dërguar në MEI në mënyrë të përmbledhur informacion mbi përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të shoqërive koncesionare, në të cilin janë evidentuar edhe ndryshimet nga kontratat në zbatim. Në lidhje me mos realizimin e prodhimit të energjisë elektrike, AKBN i është drejtuar MIE në cilësinë e autoritetit kontraktor, për zgjidhjen e problematikës dhe saktësimin e mënyrës që do të përcaktohet fajësia apo pafajësia në realizimin e energjisë elektrike. Pas përcaktimit të mësipërm, shoqëritë koncesionare detyrohen të pguajnë tarifën koncesionare të plotë.

- AKBN me shkresë nr. 8203 prot., datë 11.10.2018, i është drejtuar MIE në lidhje me sqarimin e farzës "Monitorimi i prodhimit të energjisë elektrike do të kryhet çdo 5 vjet dhe për efekt penaliteti vlerësimi do të referohet mesatares së prodhimit të energjisë duke filluar nga viti i plotë financiar i vënies në punë hidrocentralitë.

- Bazuar në Rregulloren e Oponentit teknike, anëtarët e komisionit emërohen nga MIE.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Nga ana e AKBN janë nënënyrë periodike raportet e monitorimit në MIE. Gjithsesi për disa problematika duhet të ndiqet në mënyrë më të zgjeruar jo vetëm me MIE por dhe me organet e qeverisjes vendore për problematika që lidhen me to.

Sa i takon monitorimit të HEC-eve në prodhim çdo 5 vjet, AKBN duhet të bëjë studime dhe relacione nëse është e mjaftueshme për evidentimin e problematikave, ndjekjen e ecurisë së aktivitetit të HEC-eve, realizimin e investimeve në periudhat e përcaktuara etj.

Për veprimet e mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi:

Anëtarët e Grupit të Oponentit i përbërë nga z. A.B., z. I.B., znj. K.T., znj. E.B., z. G.T., z. G.H., z. V.B., z. B.S., z. M.B., si dhe Drejtori i Monitorimit të HEC-eve z. A.H.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME OSE PËRMIRËSIM TË LEGJISLACIONIT NË FUQI.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi kanë rezultuar parregullsi të cilat kanë të bëjnë me mospërputhje të emrit të mineralit të vendosur në akt miratimit të lejes minerare të shfrytëzimit me emrin e mineralit në terren ku ushtrohet aktiviteti mineral i shfrytëzimit.

Në leje minerare përcaktohet shfrytëzim i gurëve gëlqerorë, ndërsa në terren përcaktohet gëlqerorë dekorativ. Për këtë arsye nga ana e AKBN janë mbajtur korrespondenca shkresore me Tatimet dhe Doganat, ku kërkohet informacion mbi rentën e paguar dhe mënyrën së si është paguar kjo rentë minerare edhe për raste specifike.

AKBN i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, bashkëpunim për mënyrën e pagesës së rentës minerare të subjekteve që mineralin e gurit gëlqeror e përdorin për prodhimin e çimentos.

Nga shqyrtimi i dosjeve të subjekteve minerare rezultojnë problematike mënyra e pagesës së rentës minerare në të njëjtat vendburime për subjekte të ndryshme, konkretisht në vendburimin e

Mëlovës, Bashkia Skrapar, ku është i njëjti mineral por mënyra e pagesës së rentës minerare është e ndryshme.

Përcaktimet e emërimit të mineraleve për leje të veçanta, janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 *ōPër Taksat Kombëtare në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, Shtojca nr. 2, me pasoja mos përfitimin e rentës minerare në vlerën e duhur.

Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 110 deri 177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekzekutive e AKBN të hartojë propozimet për përmirësim të legjislacionit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për ndryshimin e nenit 4, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 *ōPër taksat kombëtare*, i ndryshuar, që pagesa e rentës minerare të bëhet në % të vlerës së produktit të shitur.

Gjithashtu të hartojë propozime për rishikimin e Shtojcës nr. 2 *ōRenta minerale sipas klasifikimit*, që i bashkëlidhet ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 *ōPër taksat kombëtare*, i ndryshuar, me qëllimin e unifikimit të mënyrës së pagesës së rentës minerare, duke propozuar dhe rishikimin e përqindjes së rentës minerare për çdo kategori të mineralit, për tō harmonizuar këto dy norma ligjore midis tyre, me qëllim shmangien nga favorizimi që mund tō bëhen subjekteve të veçanta nëpërmjet pagimit të diferencuar të rentës minerare nëpërmjet sistemit me tarifë fikse për emërtesa të mineraleve që nuk specifikohen posaçërisht në këtë shtojcë.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresë nr. 1442/7 prot., datë 06.08.2019, nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyre rezulton së nga **11** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dēmi, 3-E, të ardhura të munguara, paligjshmēri në procedurat e prokurimit, pagesa të kryera në mënyrē jo të rregullt administrative dhe disiplinore*), nga subjekti janë pranuar **11** masa ose 100% e rekomandimeve. Nga **11 masat e** pranuar subjekti ka zbatuar plotësisht **3** masa, përkatësisht **1** masë organizative dhe **2** masa shpërblim dēmi me verifikim situatē (*pa vlerē financiare*), ka në proces zbatimi **5** masa organizative dhe **2** masa shpërblim dēmi në shumën prej 5,537,463 lekē ose 64,11% të dēmit të konstatuar, nuk ka zbatuar **1** masē për eliminimin e efekteve negative të fondeve publike. Drejtoria e Monitorimit të HEC-ve dhe Drejtoria e Administratēs, nuk ka analizuar dhe vlerësuar shkallēn e pērgjegjēsisē pēr secilin punonjēs, pēr mangēsitē dhe shkeljet e konstatuara në Raportin Pērfundimtar të Auditimit. Nga sa shikohet niveli i realizimit plotēsisht është shumë i ulēt, situatē e cila tregon sē Agjencia Kombētare e Burimeve Natyore nuk e ka vlerēsuar plotēsisht dhe drejt procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet 26 deri 37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1. Rekomandimi: Në funksion të zbatimit të kuadrin rregullator përkatēs si dhe duke zbatuar planin e veprimit pērcaktuar në shkresēn Nr. 06/33 prot., datē 26.08.2019, Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrē masat e duhura pēr zbatimin plotēsisht të rekomandimeve të pranuar por ende të pazbatuara ose në proces zbatimi, sipas auditimit paraardhēs të kryer nga KLSH.

Vazhdimisht

2. Gjetje nga auditimi: Shpenzimet e AKBN sipas **Vendimin Qarkullues nr. 15, datē 22.09.2020**, *ōPēr ndryshime në programin ekonomik financiar të AKBN-sē pēr vitin 2020* pēr

shpërblim të grupit të angazhuar në procesin e negociatave për lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure, në vlerë bruto 2,372,700 lekë dhe shpenzimi kryer në fund të vitit 2018 për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të AKBN-së sipas **Vendimin nr. 11, datë 27.12.2018** në vlerën neto 88,617 lekë, gjendet në kushtet interpretimit të gabuar të akteve rregullative si Statut Rregullorja e AKBN, neni 8 pika 4, neni 10 pika 8 dhe neni 10 pika 3, si dhe në kushtet e konfliktit faktik të interesit sipas Ligjit 9367/2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, neni 3 pika 1, të cilat për pasojë kanë sjellë përdorim jo efektiv të fondeve buxhetore të AKBN.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet 26 deri 37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së të marrë masat e duhura për përmirësimin e nenit 10 pika 8, të Statut Rregullores së AKBN-së për përcaktimin e kritereve në rastet e shpërblimit për anëtarët e Këshillit Drejtues për performancë në punë, duke reflektuar ndryshimet në aktet e dala në zbatim Statut Rregullores.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Shpenzimet e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore sipas Vendimit Qarkullues nr. 15, datë 22.09.2020 për shpërblim të grupit të angazhuar në procesin e negociatave për 8 anëtarët e grupit negociator dhe 3 punonjës të AKBN, për lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure në vlerë bruto **2,372,700 lekë** gjenden në mungesë të qartësisë së bazës ligjore mbi të cilën legjitimohet shpërblimi, në kushtet e *“Konfliktit të interesit”* për kryetarin dhe anëtarët e KD pasi prej tyre ushtrohet një funksion publik, vendimmarrja e të cilit lidhet drejtpërdrejt me interes privat (shpërblimi) ose indirekt (propozim nga MIE), sipas Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, neni 3. Shpërblimi gjendet në kushtet e *“Konfliktit të interesit”* për kryetarin dhe anëtarët e KD pasi në kompetencat e tij sipas Statut Rregullores, neni 10 pika 8 parashikohet aprovim lidhur me pagat dhe shpërblimet e punonjësve të AKBN dhe jo për vetë anëtarët e KD.

Urdhri nr. 94, datë 20.10.2020 i Drejtorit Ekzekutiv të AKBN *“Për shpërblimin e grupit të angazhuar në procesin e negociatave me shoqërinë “E.A. B.Vö lidhur me shpërblimin e z. A.M., z. B.P. dhe z. E.K. është në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të MIE nr. 424/2019, pasi personat nuk janë pjesë e grupit negociator.*

Shpenzimi kryer në fund të vitit 2018 për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të AKBN-së sipas Vendimin nr. 11, datë 27.12.2018 në vlerën neto **88,617 lekë** gjendet në kushtet interpretimit të gabuar të akteve rregullative si Statut Rregullorja e AKBN, neni 8 pika 4, neni 10 pika 8, si dhe në kushtet e konfliktit faktik të interesit sipas Ligjit 9367/2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, neni 3 pika 1, të cilat për pasojë kanë sjellë përdorim jo efektiv të fondeve buxhetore të AKBN.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 26 deri 37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së të ndalojë shpërblimin për performancë në punë për anëtarët e Këshillit Drejtues, deri në përmirësimin e kritereve të duhura për përmirësimin e nenit 10 Statut Rregullores së AKBN-së lidhur me shpërblimin mbi pagë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i PBA-ve të përgatitura nga institucioni konstatohet së për periudhën objekt auditimi, institucioni nuk ka ngritur Ekipin e Menaxhimit të Programit, për përgatitjen e PBA-së. Në përgatitjen e PBA-së janë konsideruar kërkesat e paraqitura nga

drejtoritë e institucionit dhe janë përpunuar nga drejtoria ekonomike, veprime në kundërshtim me udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së në paragrafi 2.5 pika 1/a, paragrafi 2.5 pika 5.

- Nga kryerja e testeve mbi urdhër pagesat për muajindhjetor të vitit 2018; prill, tetor, dhjetor të vitit 2019; prill, nëntor, dhjetor të vitit 2020 dhe mars, prill, dhjetor të vitit 2021, u konstatuan likuidim faturash mbi afatin e parashikuar në 39 praktika, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014 për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare në neni 7.

- Nga analiza e planifikimit të zërave shpenzime dhe të ardhura konstatohet, se shpenzimet që institucioni planifikon janë më të larta se vetë të ardhurat që priten të arketohen nga institucioni.

- Institucioni ndër vite nuk ka një program zhvillimi afatmesëm ku të përcaktohen objektiva konkrete që të garantojnë rritjen e vazhdueshme të të ardhurave dhe rrjedhimisht të rezultatit të saj financiar.

Veprimet e mësipërme implikojnë risqe për krijimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe me përpalljen me vështirësi ekonomike-financiare të institucionit, për realizimin e objektivave të tij. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 26 deri 37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

4.1. Rekomandimi: Titullari i institucionit të AKBN-së të marrë masa për krijimin Ekipin e Menaxhimit të Programit, çdo vit për përgatitjen e PBA-së, me qëllim për të mundësuar një planifikim sa më real të shpenzimeve korrente dhe investimeve, për përmbushjen e objektivave të institucionit.

4.2. Rekomandimi: Nga strukturat drejtuese dhe menaxhuese të institucionit, të punohet për një programim real të shpenzimeve dhe të ardhurave, duke u bazuar në mundësitë dhe kërkesat reale që ka institucioni, me qëllim eliminimin e formaliteteve në programimin e këtyre fondeve. Realizimi i burimeve të financimit të monitorohet në mënyrë sistematike, ku ndryshimet apo devijimet e mëdha nga plani fillestar të reflektohen në një plan të rishikuar.

4.3. Rekomandimi: AKBN të hartojë një pasqyrë të plotë të objektivave që synon të arrijë institucioni dhe mbi këtë bazë të përgatitet një program zhvillimi afatmesëm për qëndrueshmërinë ekonomike-financiare të institucionit.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit të urdhër pagesave të vendimeve gjyqësore për periudhën 01.09.2018-31.12.2021 u konstatua se, AKBN nuk i ka kryer vullnetarisht pagesat me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutiveve të lëshuara nga përmbaruesit privat, duke paguar tarifa përmbarimore në shumën prej 698,892 lekë, veprime të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin AKBN-së, veprime në kundërshtim me Kodin e Procedurës Civile, neni 130 dhe Rregullat e njoftimit shkresor të akteveo ku përcaktohet së: *“Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteveo, neni 451/a ku citon së: “Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët dhe neni 510/a Titujt ekzekutivëo.*

Nga auditimi i planifikimit të buxhetit për proceset gjyqësore konstatohet së për të gjithë proceset gjyqësore pavarësisht shkallëve të gjykimit janë llogaritur dhe shpenzimet përmbarimore, për të cilën institucioni do të paguajë.

Institucioni në këtë mënyrë ka paragjykuar së kreditori (pala fituese) do të kërkojë ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor, pa ju drejtuar institucionit për ekzekutimin vullnetar. Referuar Kodit të Procedurës Civile, neni 130 dhe Rregullat e njoftimit shkresor të akteveo ku përcaktohet së: *“Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i*

dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve, institucionit i lind e drejta për ti kërkuar gjyqë fituesit paraqitjen e titullit ekzekutiv të vendimit të formës së prerë, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, me qëllim shmangien e kostove shtesë të tarifave të përmbauesit gjyqësor.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 54 deri 62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Ligjore në AKBN të marrë masat që me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë nga gjykata ti kërkojë fituesit paraqitjen e titullit ekzekutiv të vendimit pranë AKBN-së, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit.

Në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua së Komisioni i Inventarizimit, i ngritur me Urdhrin nr. 21, datë 05.02.2019 òPër kryerjen e inventarizimit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët në gjithë drejtorinë e AKBN-së për vitin 2018ò, komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 4, datë 28.01.2020 òPër kryerjen e inventarizimit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët në gjithë drejtorinë e AKBN-së për vitin 2019ò dhe komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 27, datë 23.02.2021 òPër kryerjen e inventarizimit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët në gjithë drejtorinë e AKBN-së për vitin 2020ò, ka patur në përbërje të tyre Specialistin e Sektorit të Financës dhe Buxhetit në Drejtorinë Ekonomike. Në praktikën e inventarizimit nuk u konstatua firmosja e deklaratave të mungesës së konfliktit të interesit, në kushtet ku është verifikuar ekzistenca dhe plotësia e aktiveve nga punonjësit që i kanë në ngarkim apo i kontabilizojnë ato.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 22 òVeprimtaritë e kontrollitò, Pika 3/b dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, kreu òPërgjegjësitë për inventariziminò, pika 82.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54 deri 62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6.1 Rekomandimi: AKBN të marrë masat që në ngritjen e komisionit të inventarizimit të verifikojë dhe vërtetojë mungesën e konfliktit të interesit, për të ruajtur plotësinë e aktiveve dhe regjistrimin e duhur në dokumentet kontabël.

Vazhdimisht

Mbi shfrytëzimin e burimeve hidrokarbure

7. Gjetje nga auditimi: Licencë Marrëveshjeve dhe Marrëveshja Hidrokarbure lidhur me kompaninë BPAL për vendburimin Patos-Marinëz, zë rreth 95-98 % të prodhimit ekzistues të naftës në rangë vendi dhe është miratuar me VKM nr. 427, datë 16.07. 2004. Marrëveshje aktualisht është në vitin e 18^{-të}, të Periudhës së Zhvillimit dhe mund të zgjasë deri në 25 vjet. Gjate kësaj periudhe deri në fund të vitit 2021 numri i puseve të shpuar ka arritur në 794 puse të rinj. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje deri në fund të muajit dhjetor 2021, janë shpenzuar gjithsej rreth 3,671,000 mijë USD. Gjate periudhës objekt auditimi, shtator-dhjetor 2018 u prodhua mesatarisht rreth 72 mije ton/muaj naftë dhe gjate vitit 2019 u realizua një prodhim mesatar prej 73.8 mije ton në muaj. Gjatë vitit 2020 prodhimi mesatar rezulton prej 55.8 mije ton/muaj, ndërsa gjatë vitit 2021, u prodhuan rreth 50.1 mijë ton në muaj. Në këtë nivel ka ndikuar shume edhe situata e pandemisë së COVID-19. Pra kemi një rënie gati 10.5% në muaj krahasuar me prodhimin mesatar të realizuar gjatë vitit 2019. Për gjithë periudhën e marrëveshjes hidrokarbure, nëpërmjet shpenzimeve të mësipërme janë prodhuar gjithsej 10.65 milion ton naftë. Nga gjithë sasia e naftës së prodhuar, kompania Albpetrol deri tani ka përfituar në formën e detyrimit për prodhimin PEP (Prodhimi para ekzistues) dhe ASP (pjesës fitim) një sasi prej gati

801 mijë ton naftë ose rreth 237,900 mijë USD si dhe nga renta minerare buxheti i shtetit ka përfituar 373,300 mijë USD.

Megjithëse prodhimi i naftës dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e saj janë rritur ndjeshëm, faktori R, ende nuk ka arritur në vlerën 1, në fund të vitit 2021 kjo **vlerë është 0.9993**. Referuar marrëveshjes hidrokarbure, **faktori R** llogaritet në çdo tremujor si, raport i të ardhurave të akumuluar në vite nga shitja e naftës së prodhuar me shpenzimet e akumuluar në vite që janë kryer për prodhimin e kësaj naftë. Ndërsa, në Licencë Marrëveshjes është përcaktuar së: “Kompania do të rikuperojë (mbulojë) të gjitha kostot hidrokarbure (investimet dhe shpenzime) deri në masën 100% nga shitja e hidrokarbureve të prodhuara (pas zbritjes së prodhimit para ekzistues). Dhe në atë masë që në një vit fiskal, kostot dhe shpenzimet e rikuperueshme e kalojnë vlerën e hidrokarbureve (të ardhurave) për mbulim kostos për atë vit fiskal, pjesa e mbetur do të mbartet për mbulimin në vitin fiskal ose në vitet fiskale që pasojnë derisa të mbulohet plotësisht, por në asnjë rast nuk do të mbartet mbas përfundimit të kësaj Licencë marrëveshje”. Kështu, deklarimi i Kostos së Rikuperueshme deri në fund të vitit 2021 llogaritet: të ardhurat bruto të akumuluar deri në fund të vitit 2021, (pas zbritjes së PEP, ASP dhe rentës minerare), janë në shumën **3,471,109 mijë USD**. Shpenzimet e akumuluar për operacionet hidrokarbure deri në fund të 2019 janë **3,671,000mijë USD**. Faktori R del: 3,471,109 mijë USD (të ardhura): 3,671,000mijë USD (shpenzime) = **0.9455**.

Si konkluzion: BPAL nga data efekte e marrëveshjes deri në fund të vitit 2021 ka akumuluar humbje për pasojë nuk ka paguar në asnjë vit fiskal që nga viti 2004 deri në vitin 2021, tatim mbi fitimin në favor të buxhetit të shtetit, duke mos përmbushur qëllimin e nenit 13.1 të Licencë Marrëveshjes në të cilën behet fjalë që: Kompania BPAL do të jetë përgjegjëse për pagesën e taksës mbi fitimin në përputhje me Ligjin nr. 7811, datë 12.04.1994 òMbi sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve. Ky ligj përcakton së: "**Kontraktuesi detyrohet të paguajë, në cdo vit fiskal, tatimin mbi fitimin e realizuar në atë vit fiskal**". Tatimi mbi fitimin është, në masën 50 për qind të fitimit të realizuar. Për efekt të llogaritjes së fitimit të realizuar, kontraktuesit i njihen si kosto shpenzimet kapitale, ato operative e administrative, etj., (specifikimet përkatëse bëhen në marrëveshjen hidrokarbure të miratuar nga ministri) dhe lejohet shlyerja e tyre nga të ardhurat e fituara sipas kriterëve të pranuar nga ministri, si dhe sipas praktikave ndërkombëtare të industrisë së naftës që zbatohen në çdo marrëveshje hidrokarburesh.

Duke qëndruar në këtë kontekst, sipas planit të zhvillimit të kompania, arritja e faktorit **R=1** do të varet shume nga situata ndërkombëtare e kuotimit të naftës bruto. Në skenarin me çmime të larta, faktori R=1 duhej të arrihej në vitin 2016, në skenarin e mesëm, ky faktor duhet të arrihet në vitin 2020 ndërsa në skenarin e ulët, ky faktor arrihet mbas vitit 2024.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, në faqet 72-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

7.1. Rekomandimi: AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë BPAL, që të intensifikojë operacionet që mundësojnë rritjen e prodhimit të naftës, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhurashpenzime në vlera më të larta së, R=1, me qëllim rritjen e fitimit të Kompanisë dhe pagimin e tatimit mbi fitimin në buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Për të mbikëqyrur dhe monitoruar kostot hidrokarbure të kryera nga BPAL, në licencë marrëveshje është përcaktuar së, BPAL ka detyrimin të dërgojë AKBN-së:
- òJo me vonë së dyzet e pesë (45) ditë pas përfundimit të çdo Periudhe 6 (gjashtë) mujore i LICENSUAR-i (BPAL) i dorëzon AKBN kopje të dokumentacioneve të llogarive që pasqyrojnë

Kostot Hidrokarbure që i LICENSUAR-i realizoi gjatë asaj Periudhe 6 (gjashtë) mujore. Dokumentacioni llogaritës i dhënë nga i LICENSUAR-i do të jetë me hollësi të mjaftueshme për të lejuar AKBN të përcaktojë rregullsinë e Kostove Hidrokarbure të realizuara. Në shtesë të sa më sipër i LICENSUAR-i do të jap AKBN kopje të regjistrave të Operacioneve Hidroarbure, ashtu si ato janë kryerë.

Konstatohet së, BPAL nuk ka dërguar në AKBN kopje të dokumentacioneve të llogarive që pasqyrojnë me hollësi Kostot Hidrokarbure (shpenzimet e kryera) që i ka realizuar gjatë kësaj periudhe, por as duke iu referuar fillimit të marrëveshjes. Ky problem është trajtuar gjerësisht edhe në auditimet e mëparshme të KLSH, por me gjithë insistimin e AKBN për të zbatuar këto rekomandim të KLSH dhe këtë kërkesë të Marrëveshjes Hidrokarbure, përsëri nga BPAL nuk janë dërguar në AKBN kopje të dokumentacioneve që pasqyrojnë me Kostot hidrokarbure. Në kushtet e mungesës së dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për realizimin e proceseve hidrokarbure nga BPA për vitin 2018, 2019, 2020, 2021, KLSH nuk mundi të llogarisë saktë dhe objektivisht efektet financiare që kanë ardhur nga shpenzimet e kryera, mbi çmimet e tregut, mbi normativat dhe referencat ligjore në fuqi si dhe efekte ekonomike negative që kanë këto shpenzime në buxhetin e shtetit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, në faqet 72-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8.1 Rekomandimi: AKBN në bashkëpunim me òAlbetrolò sha dhe MIE në zbatim të nenit 15.2 të Licencë Marrëveshjes, të marrin zyrtarisht nga BPAL të gjithë dokumentacionit e hollësishëm të kostove hidrokarbure të realizuar për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2022, dhe në bazë të tyre të analizojë dhe të llogarisë saktë faktorin R.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Auditimi i operacioneve hidrokarbure sipas kësaj zone u përqendrua në progres raportet periodike të kostove hidrokarbureve që BPAL i ka dërguar në AKBN në çdo tremujor për të llogaritjen e faktorit R. Mbështetur në këto situacione dhe bazuar në të dhënat dhe vlerat e pasqyruara në dokumentet mbështetëse të raporteve të auditimit që struktura e Auditimit të AKBN kanë audituar BPAL për vitet 2011 deri në vitin 2016 të cilat janë kontrata të lidhura për furnizime të mallrave, punëve dhe shërbimeve që nga vitet e mëparshme dhe vazhdojnë të jenë në fuqi dhe në zbatim edhe gjatë vitit 2018 dhe 2019, 2020, 2021, dalim në konkluzionin se, *BPAL që nga datë e bërjes efektive të licencë marrëveshjes dhe marrëveshjes hidrokarbure ka kryer disa shpenzime për operacione hidrokarbure, me çmime mbi tregun vendas, mbi limitet dhe normativat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe disa shpenzime të tjera që nuk kanë të bëjnë dhe nuk lidhen me Operacionet Hidrokarbure dhe janë në kundërshtim me Anexi B neni 2 i Marrëveshjes Hidrokarbure dhe me neni 10.2 të Licencë Marrëveshjes, duke rënduar padrejtësisht kostot hidrokarbure të cilat konsiderohet si kosto që nuk duhet ti njihet dhe ti rikuperohet. Rritja fiktive e kostove hidrokarbure ka sjell efekte të ndjeshëm në uljen e pjesës fitim të Alpetrolit dhe në uljen e fitimit të BPAL dhe për pasojë në nivelin e tatimit mbi fitimin që duhet ti paguhet buxhetit të shtetit nëse arrihet faktori R=1. Mirëpo, në kushtet e mungesës së dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për realizimin e proceseve hidrokarbure nga BPA për vitin 2018 deri 2021, KLSH nuk mundi të llogarisë saktë dhe objektivisht efektet financiare që kanë ardhur nga shpenzimet e kryera, mbi çmimet e tregut, mbi normativat dhe referencat ligjore në fuqi si dhe efekte ekonomike negative që kanë këto shpenzime në buxhetin e shtetit.*

Sa më sipër, në lidhje me auditimin e kostove hidrokarbure, në zbatim të Licencë Marrëveshjeve AKBN, ka të drejtën të inspektoje dhe auditoi librat e llogarisë dhe dokumentacionin e

kontabilitetit të LICENSUAR-it në lidhje me Operacionet Hidrokarbure, por jo me shpesh së një here në një Vit Fiskal, përveçse kur bihet dakord ndryshe me Operatorin. Kjo e drejte Auditit do të përfundojë tre (3) vjet pas datës në të cilën i LICENSUAR-i dorëzon dokumentacionin e tij të kontabilitetit për atë Vit Fiskal, përndryshe, ky dokumentacion kontabiliteti gjykohet të jetë i saktë dhe më vonë nuk mund të jetë objekt kundërshtimi. Kështu, struktura e auditimit të AKBN, gjatë vitit 2018 ka kryer auditim për vitin 2015, gjatë 2019 ka kryer auditim për vitin 2016 dhe gjatë vitit 2020 kryer auditimin e viti 2017.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, në faqet 72-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9.1 Rekomandimi: AKBN, MIE, Albpetrol në bashkëpunim me kompaninë BPAL të gjejnë rrugët e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit, për të përmirësuar marrëveshjet hidrokarbure në lidhje me të drejtën e auditimit të librave të llogarisë dhe dokumentacionin e kontabilitetit të LICENSUAR-it në lidhje me Operacionet Hidrokarbure. Kjo e drejte Auditit të përfundojë 1 (një) vjet pas datës në të cilën i LICENSUAR-i dorëzon dokumentacionin e tij të kontabilitetit për atë Vit Fiskal.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në auditimet e kryera ndër vite nga AKBN, janë konstatuar kosto hidrokarbure të tepërta dhe të kryera në kundërshtim me Licencë Marrëveshjen dhe i ka kërkuar kompanisë BPAL, që nuk i njeh si kosto hidrokarbure, e cila për vitet 2011 deri 2018 është me vlerë **1,081,188,172 USD**.

Konstatohet së, vlerat e treguar në tabelë, nuk janë marre në konsiderate nga BPAL në llogaritjen faktorit R dhe për këtë, në muajin shtator 2015 ka paraqitur kërkesë në arbitrazhin ndërkombëtar të ICC. Konkretisht, në mars 2014, AKBN në bashkëpunim me organet tatimore, realizuan auditimin e kostove dhe shpenzimeve të BPAL për vitin 2011 dhe nxorën një vlerë prej 247,584,845 USD si kosto të panjohura. Në vijim, autoritetet tatimore proceduan me nxjerrjen e njoftim-vlerësimit tatimor dhe i kërkuan BPAL pagesën e tatimit përkatës. BPAL kundërshtoi si raportin e auditimit si dhe njoftim-vlerësimin tatimor në arbitrazhin ndërkombëtar të ICC dhe në gjykatën shqiptare, duke kërkuar edhe masë sigurimi për pezullimin e zbatimit të njoftim-vlerësimit tatimor. Masa e pezullimit nuk iu dha nga të dy gjykatat. Më pas, BPAL lidhi marrëveshje me autoritetet tatimore për pagesën me këste të detyrimit të përcaktuar në Njoftim-Vlerësim. Në bazë të marrëveshjes, autoritetet tatimore janë të angazhuara të ri përlllogaritjen detyrimin tatimor në momentin e një Vendimi Përfundimtar të Arbitrazhit Ndërkombëtar ose Marrëveshjeje Përfundimtare të lidhur ndërmjet BPAL dhe AKBN për raportin e auditit të vitit 2011. Theksojmë së, në po të njëjtën date të depozitimit të kërkesës për arbitrazh dhe kërkesë padisë në gjykatën shqiptare, BPAL lidhi marrëveshje me MEI/AKBN për përcaktimin e Termave të Referencës (ōToRō) për zgjidhje të mosmarrëveshjeve nga auditimi i vitit 2011, për të proceduar me Ekspertë.

Në Janar 2016 u zhvillua seanca përkatëse në arbitrazhin ndërkombëtar mbi menaxhimin e çështjes, Termat e Referencës, përfshirë pranimin ose jo të disa pretendimeve shtesë të BPAL kundrejt AKBN dhe Albpetrol, si edhe aplikimin e BPAL për masën e sigurimit. Përfaqësimi i Albpetrolit u realizua nga firma ōC,M-P,C&MLLPō. Trupa e gjykimit në arbitrazh vendosi pranimin e pretendimeve shtesë të BPAL dhe mos vendosjen e masës së sigurimit të kërkuar nga BPAL. Kjo siguroi që shteti Shqiptar të vijonte mbledhjen e detyrimeve ndaj BPAL dhe uljen e tij në tavolinën e bisedimeve.

Pas refuzimit të dhënies së masës së sigurimit, BPAL i vazhdoi negociatat me AKBN për të zgjidhur mosmarrëveshjet e auditit të 2011 me ekspertë ndërkombëtarë dhe si pasojë e këtyre

negociatave, palët u dakordësuan për të pezulluar procesin e arbitrazhit, duke paraqitur një shkresë të përbashkët në mars 2016. Trupa e gjykimit në arbitrazh vendosi pezullimin e tij në mars 2016 deri në një njoftim të dytë të palëve mbi përfundimin e procesit të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve me ekspertë. Në këtë fazë të gjykimit në arbitrazh, pra vetëm për procesin e shqyrtimit të mosmarrëveshjeve me eksperte, AKBN u përfaqësua nga Avokatura e Shtetit dhe Studioja Ligjore òC.ò. Vlera financiare e kostove, objekt shqyrtimi para Panelit të Ekspertëve Ndërkombëtarë ishte 247,584,845 USD dhe pas zhvillimit të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve bashkë me provat përkatëse, Paneli i ekspertëve ndërkombëtarë vendosi së vlera totale e kostove të panjohura ishte **526,621 USD dhe jo 247,584,845 USD e konstatuar nga auditimi i AKBN-së.**

Avokatura e Shtetit/AKBN e ankimoi Vendimin e Panelit të Ekspertëve duke rifilluar procesin e arbitrazhit ndërkombëtar vetëm për mosmarrëveshjet e Auditimit të vitit 2011. Vendimi i arbitrazhit u shpall në shkurt 2018 duke lenë përfundimisht në fuqi vendimin e eksperteve i cili kishte vendosur së, vlera totale e kostove të panjohura ishte **526,621 USD dhe jo 247,584,845 USD.**

Trupa e gjykimit në arbitrazh ngarkoi AKBN me pagesën e kostove të këtij nën procesi në vlerën rreth **1,161,309 USD.** Me daljen e vendimit të mësipërm të tribunalit, përfunduan edhe efektet e autorizimit me të cilin ishte pajisur studioja ligjore për përfaqësimin dhe mbrojtjen e kësaj çështjeje. Përfundimi i marrëdhënieve me këtë studio ligjore u shoqërua me faturën përkatëse për shërbimet e përfaqësimit të ofruara për MIE/AKBN dhe Albpetrol sh.a., fature e cila është likuiduar nga Albpetrol sh.a.

Pas përfundimit në favor të BPAL të çështjes lidhur me auditimin e vitit 2011 dhe me synimin për të trajtuar këtë rast si precedent, BPAL kërkoi rifillimin e procesit të arbitrazhit dhe shtimin e pretendimeve, duke kundërshtuar edhe të gjitha auditimet e kryera ndër vite nga AKBN-së deri në vitin 2015. Mirëpo duke pasur parasysh mënyrën se si u trajtua dhe përfundoi çështja lidhur me auditimin e vitit 2011, kostoja që pati ky proces për shtetin shqiptar vetëm në këtë fazë, si dhe mundësitë që kjo çështje të trajtohej nga BPAL si precedent edhe në të ardhmen, nga ana e MIE-s u negociua me BPAL mundësia për pezullimin e procesit të arbitrazhit. Si rezultat i këtyre negociatave, u nënshkruan 3 marrëveshje. Përveç sa më sipër, palët janë angazhuar për të respektuar parashikimet e këtyre marrëveshjeve duke venë në dijeni edhe Trupën e Gjykimit në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar për dakordësinë e arritur nëpërmjet tyre (marrëveshjeve).

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, në faqet 72-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

10.1 Rekomandimi: AKBN, MIE, Albpetrol të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme realizimin e proceseve hidrokarbure, për parandalimin e përfshirjes në të të shpenzimeve të cilat nuk konsiderohen të rikuperueshme. Nga ana e AKBN dhe Albpetrol të merren masa për realizimin e proceseve audituese, duke u referuar në standardet më të pranuar ndërkombëtarisht.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e auditimit nga ana e Drejtorisë Hidrokarbure dhe Drejtorisë ekonomike janë realizuar dy auditime për saktësinë e shpenzimeve të përfshira si kosto hidrokarbure. Auditimi i kryer në vitin 2020, është realizuar për aktivitetin e kontraktimit për vitin 2017. Nga auditimi janë konstatuar parregullsi që kryesisht kanë të bëjnë me:

-Kontraktori ka kryer shërbime që kalojnë vlerën 2 milionë USD, për të cilat nuk është realizuar procedurë prokurimi, apo vlerësim tregu, në kundërshtim me Marrëveshjen Hidrokarbure neni 21, pika 2, veprim në kundërshtim me Licencë-Marrëveshjen, neni 10.2, germa d.

- Inventari është përfshirë në kosto hidrokarbure, pa u futur më parë në përdorim, veprim në kundërshtim me Licencë-Marrëveshjen, neni 1, pika 1.1.3.
- Shpenzime për shërbime konsulente, pa kontratë dhe pa asnjë përcaktim, në kundërshtim me Licencë-Marrëveshjen, neni 15 pika 3 dhe 16 pika 3.
- Shpenzime personeli të kryera nga kompania mëmë, por që nuk kanë lidhje me kostot hidrokarbure në Shqipëri, pasi nuk rezultojnë pagesa për sigurimet shoqërore apo shëndetësore, pra të pa argumentuara, në kundërshtim me Marrëveshjen Hidrokarbure, neni 2, pika 17 dhe 2.9.
- Shpenzime për shpërbim punonjësish, të cilët nuk janë staf i kontraktorit, në kundërshtim me Marrëveshjen Hidrokarbure, aneksi B, neni 2, pika 2.h.

Vlera totale e konstatuar nga grupi i auditimit të AKBN, për llogaritë kosto hidrokarbure që nuk konsiderohet kosto hidrokarbure të rikuperueshme për vitin 2017, është me vlerë 22,804,003 USD.

Nga ana e grupit të auditimit të AKBN, është rekomanduar marrja e masave që kontraktori të ketë në vëmendje verifikimin dhe plotësimin e dokumentacionit ligjor, rekomandohet mos rëndojë koston me shpenzime të pa rikuperueshme, para lidhjes së kontratave të qirasë të studiojve tregun, të kontaktohet direkt me njësitë vendore për marrjen e tokave me qira, të bëhet një vlerësim ekonomik për kostot e qirave të apartamenteve. Sa i përket mediave, Kontraktori inkurajohet të mbajë marrëdhënie të mira profesionale me median lidhur me publikime të ndryshme të aktivitetit të tij, por kostot e shërbimeve të ngarkojë në buxhetin e tij dhe jo si kosto hidrokarbure.

Auditimi i kryer në vitin 2021, është realizuar për aktivitetin e kontraktimit për vitin 2018. Nga auditimi janë konstatuar parregullsi që për nga natyra janë pothuajse të njëjta me parregullsitë e konstatuara në auditimin e realizuar në vitin 2020, për aktivitetin hidrokarbur të vitit 2017.

Në kosto hidrokarbure përfshihen shpenzime të realizuara nga Kompania B.P.A. Ltd, në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure.

- Kontraktohen kompani për prokurime, ndërkohë që Kontraktori ka staf të mjaftueshëm për realizimin e proceseve të tilla. Për kompani të kontraktuara për këtë qëllim, likuidohen vlera të konsiderueshme si tarifa shërbimi, po ashtu nuk garantohet përfitimi i mallrave, apo pajisjeve me çmime optimale.

- Në kosto hidrokarbure përfshihen pagesa për media të ndryshme, të cilat reklamojnë kompaninë duke siguruar marketingun e saj, por nuk i shërbejnë qëllimit të aktivitetit hidrokarbur.

- Kontraktori nënshkruan kontrata me kompani ligjore për çështje të ndryshme, krahas vlerës së kontratës likuidon edhe tarifa suksesi, veprim në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure dhe licencë marrëveshjen. Dhënia e shpërblimeve për sukses duhet të përfshihet në buxhetin e kompanisë dhe jo të regjistrohet si kosto hidrokarbure, vetëm për vitin 2018, në kostot hidrokarbure të rikuperueshme është përfshirë vlera 329,430 USD.

- Bëhen sponsorizime dhe donacione pa respektuar asnjë kriter dhe pa marrë asnjë miratim nga AKBN.

- Përfshihen në kosto hidrokarbure vlera të konsiderueshme të cilësuar si shërbime për komunitetin, ndërkohë që rezultojnë si janë donacione dhe kontribute, të bëhen pa miratim nga AKBN dhe Albpetrol.

- Në kosto hidrokarbure të rikuperueshme përfshihen pagesa overdraftesh apo interesa në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure.

- Bëhet sigurim prone me një vlerë të konsiderueshme, por në policat e sigurimit përcaktohet sigurim për ndërprerje biznesi, dëmtime personale, dëmtim prone, shpenzime zjarri, ndihmë palë

e tretë, detyrime ligjore ndaj qiramarrësit, detyrime ligjore ndaj punëdhënësit, përfitime të punëmarrësit për gabime të ndryshme, reklamime, sigurim ekstra për shpenzim operator i cili mbulon shpenzimet e tepërta që mund të vijnë nga kontratat me nënkontraktorët etj., të cilat nuk iu referohen risqeve në funksion të operacioneve hidrokarbure.

- Nga ana e kontraktorit përfshihen shpenzime për karburante jo vetëm për automjete në diskonim, por edhe për automjete në diskonim të nënkontraktorëve, në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure.

- Subjekte të ndryshe lidhin kontratë qiraje me njësitë vendore, pastaj këto objekte (prona), i jepen me qira me çmim shumë më të lartë Kontraktorit, i cili mund të lidhë këto kontrata qiraje drejtpërdrejtë me njësitë vendore.

- Në kosto hidrokarbure të rikuperueshme përfshihen një sërë shpenzimesh në kundërshtim me licencë-marrëveshjen dhe në raste të veçanta mund të konsiderohen edhe absurde. Këto lloj shpenzimesh konstatohen çdo periudhë nga fillimi i marrëveshjes në mënyrë të përsëritur duke shmangur në këtë mënyrë rillogaritjen e koeficientit R i cili në rast të zbritje nga grupi i auditimit dhe AKBN nuk konsiderohen si shkelje të marrëveshjes dhe marrjen e masave sipas përcaktimeve në këto raste.

-Pavarësisht së nuk respektohet plani i zhvillimit i miratuar dhe përmirësuar, kryesisht në realizimin e investimeve, shpenzimet rriten në mënyrë të pa argumentuar dhe nga AKBN nuk merret asnjë masë për konsiderimin si shkelje marrëveshje.

-Pavarësisht parregullsive të vazhdueshme, nga ana e AKBN nuk ngrihen problematika në Komitetin Këshillimor, as në nivel ekspertit, si dhe nuk bëhen njoftime sipas përcaktimeve në licencë-marrëveshje.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Licencë-Marrëveshjen, neni 24 ÷Thyerja e licencë-marrëveshjes, pika 24.1.

Problematikat e përshkruara më sipër, janë konstatuar edhe për auditime të realizuara për marrëveshjet e tjera në aktivitet hidrokarbur, megjithatë as në këto raste nuk janë bërë njoftimet sipas përcaktimeve në marrëveshjet hidrokarbure, apo licencë marrëveshje.

Nga ana e AKBN, për periudhën e auditimit nuk është bërë njoftim zyrtar për thyerje të marrëveshjes të paktën për dhënien e mundësisë për rregullime, para proceseve të tjera, në kundërshtim me Licencë-Marrëveshjen, Neni 24, pika h, par.1.

Mos bërja e njoftimeve për thyerje të marrëveshjes, që në nisje të marrëveshjes e fillimit të operacioneve hidrokarbure, kur janë identifikuar problematikat e përfshirjes në kosto hidrokarbure të rikuperueshme të shpenzimeve në kundërshtim me marrëveshjen, i ka kushtuar shtrenjtë buxhetit të shtetit (referuar procesit të arbitrazhit), megjithatë vazhdohet në të njëjtën mënyrë, vetëm duke i konsideruar këto shpenzime si të panjohura, por pa kërkuar në asnjë rast zbatimin strikt të marrëveshjes.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, në faqet 72-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

11.1. Rekomandimi: AKBN dhe Albpetrol, në bashkëpunim me ministrinë e linjës të marrin masa për vlerësimin rast pas rasti, në nivel ekspertësh të fushës për shkeljet e përsëritura nga ana e kontraktorëve jo vetëm për mos realizimin e planit të zhvillimit, apo programeve vjetore, por edhe për përfshirje të shpenzimeve në kosto hidrokarbure të pa rikuperueshme në kundërshtim me marrëveshjet, në mënyrë të përsëritur, për arritjen e konkluzionit për bërjen e njoftimeve për thyerje të marrëveshjes, sipas përcaktimeve në marrëveshjet hidrokarbure dhe licencë marrëveshjet. AKBN, t'ia kërkojë kontraktorëve zbritjen e shpenzimeve të përfshira padrejtësisht në kosto hidrokarbure të rikuperueshme, duke bërë edhe njoftimin përkatës për shkelje të marrëveshjes licence dhe marrëveshjes hidrokarbure.

11.2. Rekomandimi: AKBN dhe Albpétrol, të marrin masa për kordinim me institucionet ligjzbatuese, për monitorimin sa është e mundur nëpërmjet instrumenteve ligjore, të operacioneve hidrokarbure të kompanive, duke monitoruar edhe zbatimin e kontratave të kontraktorit me nënkontraktorë si për punime, mallra dhe shërbime, ashtu edhe për marrje me qira të pronës.

11.3. Rekomandimi: AKBN në bashkëpunim me Albpétrol SHA dhe MIE, të marrin masa për hartimin e manualeve dhe udhëzuesve të auditimit, me referenca standarde të pranuar ndërkombëtare të auditimit dhe të bëhen negociata për pranimin e tyre nga palët.

Në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga ana Albpétrol SHA planet dhe buxheteve vjetore të kompanisë BPAL, miratohen me vonesë. Përcaktimet e marrëveshjeve hidrokarbure kanë parashikuar me afate strikte gjithë procedurën në të cilën kalon vlerësimi, diskutimi dhe miratimi i këtyre programeve, ndërkohë që zbatimi në praktikë i kësaj procedure është larg këtyre afateve. Por edhe pse në mënyrë të përsëritur AKBN ka kërkuar në rrugë shkresore, por edhe KLSH ka rekomanduar në auditimet e mëparshme, që të respektohen afatet e dorëzimit për miratim pranë AKBN që bëhet 60 ditë para fillimit të vitit ri fiskal (në fillim të nëntorit), edhe për periudhën objekt auditimi, ashtu si për periudhat e mëparshme nuk janë respektuar këto afate. Konkretisht:

-Për 2018 programi u dorëzua pranë AKBN dhe u miratua në fund të muajit mars 2018, për vitin 2019 programi i propozuar u miratua gjatë muajit shtator 2019 dhe për vitin 2020 programi i punës dhe buxheti, deri në momentin e auditimit ende nuk ishte miratuar.

Mosrespektimi i afateve të miratimit të programeve dhe buxheteve mbart riskun që, kompania duke mos pasur programe të miratuara, heziton të kryejë investime sipas vizionit të pasqyruara në planin e zhvillimit. Kryejnë investime sa për të mos ndërprerë operacionet, të cilat nuk mund të kontribuojnë në zhvillimin e vendburimeve sipas planeve të zhvillimit të miratuara. Dhe efektet negative bëhen të ndërvarura nga njëra tjetra. Për me tepër, mos miratimi i programeve dhe buxheteve e jep shkas kompanisë që, në një konflikt të mundshëm në gjykatën e arbitrazhit, të përdorin këto probleme edhe si argumente pengues në punën e tyre.

Vonesa e veprimeve të tilla krijojnë problematika në mbarëvajtjen dhe ecurinë normale të implementimit të planeve të zhvillimit afatgjatë të miratuar për vendburimet, duke qenë edhe larg pritmërisë dhe angazhimeve të vetë palëve në marrëveshje, që pasqyrohen në pikat 0H0 dhe 0L0 të Licencë Marrëveshjes.

Veprimet e mësipërme janë në mos përptuje me përcaktimet në Licencë Marrëveshje Hidrokarbure, neni 7.2,a,b,c,d, si dhe neni 8, pika 2.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, në faqet 72-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

12.1. Rekomandimi: AKBN, MIE dhe Albpétrol të marrin masa për diskutimin dhe shqyrtimin e planeve vjetore brenda periudhës së përcaktuar në marrëveshje, duke kërkuar respektimin e planit të zhvillimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Licencë Marrëveshja dhe Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin Ballsh-Hekal e lidhur me kompaninë A. O.&G. (fillimisht S. O. G. e me pas me kompaninë T.), është miratuar me VKM Nr.509, datë 08.08.20207 dhe është në vitin e 13, të implementimit. Operacionet hidrokarbure në këtë vendburim nuk janë kryer me ritmet e parashikuara. Ato kanë ecur mjaft ngadalë për shkak të mungesës së investimeve, duke kompromentuar ndjeshëm implementimin e treguesve të planit të zhvillimit në përgjithësi dhe Licencë marrëveshjen në

veçanti. Duke marrë në konsideratë këto problematikat si dhe mungesën e angazhimeve të kompanisë T. për riparimin e tyre, në muajin janar 2018 nga ana e kompanisë Albpetrol u përdorën instrumente ligjore jashtë marrëveshjes hidrokarbure (nëpërmjet përmbaruesit ligjor privat dhe shitjes së vendburimit me ankandit), për të transferuar më vonë, gjatë muajit Maj 2018, interesat e kësaj marrëveshje tek kompania òA. O.&G.ò.

Konstatohet së, gjatë vitit 2018 kompania A. O.&G.ò realizoi rreth 1,6 milion USD investime kapitale për vënien në eficence të gjithë vendburimit të naftës Ballsh-Hekal, duke prodhuar rreth 6,700 ton naftë nga rreth 16,500 ton të planifikuara, duke shlyer detyrimet ndaj kompanisë Albpetrol dhe duke paguar edhe 185 mijë USD si detyrimin për rentën minerare. Edhe gjatë vitit 2019 kompania vazhdoi të kryejë operacione hidrokarbure në vendburim në përputhje me parashikimet në programin dhe buxhetin e përgatitur prej saj. U realizuan gjithsej rreth 2.9 milion USD investime kapitale, të cilat përbejnë rreth 30% të investimeve të parashikuara, u realizua plani i prodhimit të naftës në masën rreth 97%, duke prodhuar 24,400 ton naftë nga 25 mijë të parashikuara si dhe u krye pagesa e rentës minerare prej rreth 600 mijë USD. Kompania pretendon së, nga operatori paraardhës janë dorëzuar tek kompania Albpetrol një sasi naftë prej rreth 16 mijë ton më tepër së detyrimi, ndërkohe që kompania Albpetrol e kundërshton në mënyrë kategorike këtë fakt. Kompania Albpetrol pretendon së, për këtë sasi Albpetrolit ka rënë dakord me kompaninë paraardhëse (T.) që të njihet si shlyerje e detyrimeve për PEP dhe ASP për vendburimet Ca-Mo dhe Go-Ko, të cilat së bashku me Ballsh-Hekalin i administronte kjo kompani. Aktualisht kjo problematikë, në përputhje me licencë marrëveshjen dhe marrëveshjen hidrokarbure si dhe me marrëveshje midis Albpetrolit dhe òA. O.&G.ò do t'aj kaloje për t'aj trajtuar nga Eksperti (avokati). Për shkak të mos zgjidhjes së këtij problemi edhe Programet e Punës dhe Buxhetet për vitin 2019, 2020 dhe 2021 të kompanisë òA. O.&G.ò nuk janë miratuar nga kompania Albpetrol.

Në lidhje me shlyerjen e këtyre detyrimeve, theksojmë se, KLSH në auditimin e fundit ka trajtuar paligjshmërinë e kalimit të interesave të kësaj marrëveshje nga kompania òT.ò tek kompania òA. O.&G.ò. Për të eliminuar këto efekte ekonomike është rekomanduar që:

- AKBN në bashkëpunim me MIE dhe Albpetrolin, të ngrenë një grup pune të përbashkët për të analizuar të gjitha detyrimet e ndërsjellat që kanë rrjedhur nga zbatimi i Marrëveshje Hidrokarbure ndërmjet Kompanisë òT.ò dhe Albpetrolit për Vendburimin Ballsh-Hekal.

-AKBN, MIE, Albpetrol dhe Avokati i Shtetit, të përgatiten për mbrojtjen ligjore dhe të bashkëpunojnë për të grumbulluar dokumente, fakte dhe prova, për t'aj paraqitur në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar për të vërtetuar ligjshmërinë e kalimin e të drejtave të lindura nga òMH për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Vendburimin Ballsh-Hekalò, datë 19.07.2007 lidhur midis shoqërisë òAlbpetrolò Sha dhe shoqërisë òT.ò në favor të shoqërisë òA. O.& G.ò sh.a.

Kompania òT.ò, e cila ka hapur çështjen gjyqësore në Arbitrazhin Ndërkombëtar (ICC Case no.22676), duke paditur MIE dhe shoqërinë òAlbpetrolò i kërkon òAlbpetrolitò, pikërisht detyrimet dhe fitimin e munguar **në vlerën 113,000,000 USD**, pa përfshirë këtu vlerat e pagesave që Albpetrolit i ka bërë avokatëve të caktuar nëpërmjet Avokatit të Shteti për mbrojtjen e çështjes që arrijnë mbi 2 milion USD. Për këtë proces gjyqësor sipas të dhënave operative të marra në AKBN, këto pretendime të kompanisë janë rrëzuar pjesërisht nga Arbitrazhi Ndërkombëtar i datës 06.07.2020, i cili ka vendosur në favor të kompanisë òT.ò t'aj rimbursojë nga buxheti i shteti vetëm pagesat e rentës minerare në vlerën 12,577,852 USD. Për këtë problem në AKBN nuk ka dokumente dhe informacion të bollshëm për të dalë më rezultat të qartë dhe të saktë sepse, palë në këtë proces është MIE dhe òAlbpetrolò, ndërsa AKBN është si palë e trete dhe i gjithë

dokumentacioni ligjor dhe financiar ndodhet në MIE, në òAlbpetrolò dhe në Avokaturën e Shtetit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, në faqet 72-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

13.1. Rekomandimi: AKBN, MIE dhe Albpetrol të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e humbjes në Arbitrazhin Ndërkombëtar.

Menjëherë

13.2. Rekomandimi: AKBN, MIE dhe Albpetrol të mos tolerojnë praktikën e miratimit në heshtje dhe formal të Planeve Vjetor dhe buxheteve të paraqitura. Të miratojnë sa më shpejtë Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2020. Të ndiqen me rigorozitet kërkesat e përcaktuara në MH dhe LM për shqyrtimin dhe dakordësimin e Planeve Vjetore dhe buxheteve të paraqitura nga kompania òA O&Gò.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Marrëveshja me D.G.C. (DGC) për Vendburimin e Delvinës, është lidhur midis kompanisë Albpetrol dhe S. O .G (SOG) dhe është miratuar me VKM Nr. 509, date 08.08.2007. Marrëveshje aktualisht është në vitin e 10 të implementimit. Që prej muajit gusht 2016, marrëveshje administrohet nga kompania òD.G.Cò e cila deri tani nuk ka treguar asnjë vizion për zhvillimin e këtij vendburimi. Nuk ka asnjë plan e program vjetor të miratuar. Gjatë viteve 2016 dhe 2017 investimet janë shumë të ulëta. Kompania paraqitet me mungesa të theksuara të likuiditeteve duke marrë në konsideratë mungesën e angazhimeve të saj në shlyerjen e detyrimeve që kjo kompani ka ndaj Albpetrolit dhe AKBN. Kështu, deri në fund të muajit Gusht 2019, kompania i detyrohet Albpetrolit sha me rreth 2000 ton kondensat dhe rreth 19 milion Nm³ gaz. Kompania ka gjithashtu edhe detyrim ndaj AKBN me një principal prej 4,971,000 USD të lindur që prej vitit 2013, si detyrim i pa përmbushur nga Kompania për investimet kapitale gjatë fazës së dytë të kërkimit në këtë vendburim. Në gusht 2019 midis AKBN dhe kompanisë D.G.C u dakordësua vijimi i pagesave mujore prej 100 mijë USD. Që prej muajit shtator 2019 këto pagesa kanë vazhduar rregullisht. Për këtë marrëveshje hidrokarbure ende nuk është miratuar programi dhe buxheti për vitin 2021.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, në faqet 72-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

14.1. Rekomandimi: AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë òD.G.Cò, për intensifikimin e operacioneve që mundësojnë rritjen e prodhimit të gazit, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhura-shpenzime në vlera më të larta ($R > 1$).

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Marrëveshjet hidrokarbure për vendburimet, Finiq-Krane dhe Pekisht-Rrase-Murriz, janë lidhur me kompaninë P.P. dhe janë miratuar me VKM Nr. 699, datë 16.08.2013. Aktualisht këto marrëveshje kanë kaluar nga kompania òP.P.ò te kompania òF.P.ò e cila ka marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet për këto marrëveshje nëpërmjet Instrumentit të Transferimit të datës 10.05.2016. Këto marrëveshje janë në vitin e 5 të implementimit të Planeve të Zhvillimit të miratuara. Implementimi i këtyre marrëveshjeve po bëhet në mënyrë shumë të ngadaltë. Pavarësisht së të dyja këto vendburime janë në fazën e fundit të shfrytëzimit, me energji dhe rezervë naftë të ezauruara, edhe për këtë marrëveshje konstatohet se kompania nuk ka kapacitetet e duhura teknike e financiare për të zhvilluar me tej vendburimet Finiq dhe Pekisht, duke munguar me paraqitjen e një vizioni të qartë. Programi i

miratuar për vitin 2017 akoma nuk është implementuar në mënyrë integrale. Përveç kryerjes së operacioneve klasike për nxjerrjen e naftës, mungojnë investimet dhe kryerja e operacioneve suplementare për intensifikimin e nxjerrjes së naftës dhe rritjen e prodhimit. Me këto ritme të kryerjes së operacioneve hidrokarbure në këto marrëveshje, komprometohet implementimi dhe zbatimi i planeve të zhvillimit të miratuar.

Nga vendburimi Finiq-Krane nuk është bërë asnjë shitje pasi depozitat në të cilat është grumbulluar nafta e prodhuar është nën sekuestro konservative nga Dega e Doganës Sarandë, për probleme të konstatuara nga ana e tyre gjatë inspektimeve të kryera në vendburim nga kjo degë. Për këtë marrëveshje ende nuk është bere miratimi i programit dhe buxhetit për vitin 2022.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, në faqet 72-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

15.1. Rekomandimi: AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë oF.P.Pö, për intensifikimin e operacioneve që mundësojnë rritjen e prodhimit të naftës, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhura-shpenzime në vlera më të larta ($R > 1$).

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Licencë Marrëveshja dhe Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin e Visokës me kompaninë T.G. (pasardhëse e kompanisë I.V.) është miratuar me VKM Nr.90, datë 27.01.2009. Kjo marrëveshje është në vitin e 10 të implementimit. Pavarësisht operacioneve të kryera, niveli i prodhimit ditor të naftës ka qenë dhe është në nivele të ulta dhe nën atë të parashikuar në planin e zhvillimit. Aktiviteti i kompanisë për kryerjen e investimeve deri sot ka qenë shumë i ngadaltë gjë që pasqyrohet edhe në nivelin e ulët të prodhimit. Gjatë tremujorit të katërt 2018, vitit 2019 dhe tremujorit të parë 2020 u prodhuan respektivisht 4,529, 17,778 dhe 3,990 ton naftë. Për vitin 2019 shkalla e realizimit të prodhimit është rreth 75%, ndërkohë që për tremujorin e para 2019, kjo vlerë është rreth 70%. Mosrealizimet lidhen në mënyrë integrale me mos kryerjen e shpimit të 5 puseve të rinj të parashikuar për tu shpuar, pasi nga rezultatet e deritanishme të këtyre puseve por edhe zona ku ata mendohej të shpoheshin, gjykohet së janë me rentabilitet të ulët, duke zbehur në këtë mënyrë edhe realizimin e programit të shpimit të puseve. Ajo që vërehet tek kjo marrëveshje është ngadalësia e kryerjes së operacioneve, niveli dhe rentabiliteti i ulët i investimeve kapitale, të cilat reflektohen edhe në vlerën e ulët të Faktorit R, i cili vlerëson efektivitetin e rikthimit të investimeve, i cili aktualisht është në vlerën 0.35.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, në faqet 72-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

16.1. Rekomandimi: AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë oT.G.ö, për intensifikimin e operacioneve që mundësojnë rritjen e prodhimit të naftës, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhura-shpenzime në vlera më të larta ($R > 1$).

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Licencë Marrëveshja dhe Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin e Kuçovës me kompaninë oS.I.ö është miratuar me VKM Nr.686, datë 19.10.2007. Në shtator 2008, kompania BPAL bleu aksioneve të oS.I.ö duke u bërë aksionare e vetme e kësaj kompanie. Ndërkohe që emri i operatorit qëndroi i pandryshuar. Aktualisht marrëveshja është në fillim të vitit të 6-të implementimit të Planit të Zhvillimit. Ndërkohë që në planin e zhvillimit, për periudhën 2014-2019 ishin planifikuar të realizoheshin rreth 50 milion USD investime kapitale, realizimi faktik deri në fund të vitit 2019 është rreth 40 milion USD, pra rreth 78%. Për periudhën shtator 2018 mars 2020 nga vendburimi i Kuçovës janë prodhuar respektivisht 375 ton naftë,

1,169 ton dhe 243 ton naftë, te cilat përbëjnë respektivisht 58%, 11% dhe 30% të prodhimit të parashikuar në programet vjetore. Presa i përket investimeve kapitale të realizuara gjatë këtyre periudhave ato janë 1,419,000 USD për 3 tremujorin e fundit 2018, 535,000 USD për vitin 2019 dhe 86,000 USD për 3 mujorin e parë 2020. Vlerat e këtyre shpenzimeve janë shumë larg parashikimeve të planit të zhvillimit, gjë që reflektohet edhe në vlerën e Faktorit R i cili është në vlera të papërfillshme, 0.03. Edhe për këtë kompani programi dhe buxheti i parashikuar për vitin 2020, ende nuk është miratuar nga palët në marrëveshje, pasi kompania Albpetrol nuk ka qenë dakord me treguesit e propozuar.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, në faqet 72-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

17.1. Rekomandimi: AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë oS.I.ö, që të intensifikojë operacionet që mundësojnë rritjen e prodhimit të naftës, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhura-shpenzime në vlera më të larta së, R=1.

Menjëherë dhe në vijimësi

Mbi shfrytëzimin e burimeve minerare.

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kriterëve mbi lejet minerare dhe miratimin e planit vjetor për subjektet e licencuar, rezulton se zotëruesit e lejeve minerare nuk kanë paraqitur për miratim planin vjetor të veprimtarisë (ku të specifikohet sasia e prodhimit, shitjeve, vlera e investimeve, vlerat e garancive, në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit).

- Për vitin 2018, nga 597 subjekte gjithsej me leje shfrytëzimi, kanë miratuar planet vjetore 502, janë refuzuar për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar pranë organit përgjegjës 32 dhe kthim përgjigje (për pezullim të përkohshëm, leje të reja, mos heqje nga fondi pyjor, procese gjyqësore, etj.) 63 prej tyre;

- Për vitin 2018, nga 571 subjekte gjithsej me leje shfrytëzimi, kanë miratuar planet vjetore 427, janë refuzuar për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar pranë organit përgjegjës 63 dhe kthim përgjigje (për pezullim të përkohshëm, leje të reja, mos heqje nga fondi pyjor, procese gjyqësore, etj.) 81 prej tyre;

Për vitin 2020, nga 576 subjekte gjithsej me leje shfrytëzimi, kanë miratuar planet vjetore 424, janë refuzuar për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar pranë organit përgjegjës 59 dhe kthim përgjigje (për pezullim të përkohshëm, leje të reja, mos heqje nga fondi pyjor, procese gjyqësore, etj.) 32 prej tyre;

Për vitin 2021, nga 587 subjekte gjithsej me leje shfrytëzimi, kanë miratuar planet vjetore 493, janë refuzuar për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar pranë organit përgjegjës 36 dhe kthim përgjigje (për pezullim të përkohshëm, leje të reja, mos heqje nga fondi pyjor, procese gjyqësore, etj.) 49 prej tyre.

Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 110 deri 177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

18.1 Rekomandimi: Drejtoria Minerare pranë AKBN-së dhe Komisioni i Shqyrtimit të Planeve Vjetore të Punës të bëjnë një përditësim për të gjitha subjektet që kanë leje shfrytëzimi minerar dhe situatën e tyre mbi miratimin e planit vjetor për subjektet e licencuara. Drejtoria Minerare pranë AKBN të marrë masa për zbatimin e sanksioneve që parashikohen në legjislacion nëse subjektet zotërues të lejeve minerare nuk paraqesin për miratim planin vjetor të veprimtarisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kërkesave të ligjit minerar dhe akteve të tjera të Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë në vitet 2018- 2021, konstatohet së nuk janë hartuar dhe dërguar në strukturën shtetërore përgjegjëse, informacionet tremujore dhe vjetore me treguesit mbirealizimprodhimit, investimeve, vlerëne produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera përrehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare në përputhje me detyrimet përcaktuar në lejen e tyre minerare dhe planin vjetor të punës, në kundërshtim me kërkesat e pikës b dhe c, të Nenit 25 të Detyrimit të zotëruesit të lejes së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar si dhe nga të dhënat e gjeneruara në sistemin elektronik përkatës, konstatohet se për periudhën objekt auditimi nuk janë aplikuar sanksione për mos raportim, për:

- 27 subjekte për vitin 2018 (tre mujorin III dhe IV), me vlerë 3,100,000 lekë.
- 25 subjekte për vitin 2019 (Raportin vjetor dhe tremujor), me vlerë 2,500,000 lekë.
- 41 subjekte për vitin 2020 (Raportin vjetor dhe tremujor), me vlerë 4,500,000 lekë.
- 30 subjekte për vitin 2020 (Raportin vjetor dhe tremujor) me vlerë 3,250,000 lekë.

Nuk janë aplikuar penalitete për raportim me vonesë për:

- 22 subjekte për vitin 2018 (tre mujorin III dhe IV) me vlerë 2,700,000 lekë.
- 55 subjekte për vitin 2019 (Raportin vjetor dhe tremujor), me vlerë 6,450,000 lekë.
- 49 subjekte për vitin 2020 (Raportin vjetor dhe tremujor) me vlerë 5,450,000 lekë.
- 42 subjekte për vitin 2021 (Raportin vjetor dhe tremujor), me vlerë 4,300,000 lekë.

Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 110 deri 177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

19.1 Rekomandimi: Drejtoria Minerare pranë AKBN-së të marrë masa për zbatimin e sanksioneve që parashikohen në legjislacionin për subjektet zotërues të lejeve minerare të cilat nuk kanë kryer raportimet vjetore apo tre mujore apo i kanë bërë këto raportime me vonesë.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive dhe aktivitetit minerar të raportuar nga subjektet e licencuara dhe zbatimi i kërkesave të legjislacionit minerar jo vetëm që nuk është ushtruar i plotë dhe 2 herë në vit, por për shumë subjekte nuk janë kryer fare kontrole dhe inspektime, në shkelje të dispozitave të këtij ligji. Për sa sipër, nuk ka gjetur zbatim neni 43, i ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, dhe neni 16, pikat 6-9 të Statut-Rregullores së AKBN për ushtrimin e kontroleve e inspektimeve pasi, për periudhën objekt auditimi nuk i janë nënshtruar skemës së mbikëqyrjes dhe inspektimit për subjekte të licencuar në fushën e shfrytëzimit të pasurive minerare metalore dhe jometallore, ndërkohë që detyrimi ligjor është që duhet të nënshtrohen monitorimit dhe inspektimit dy herë brenda një viti. Konkretisht, situata paraqitet si vijon:

- Për vitin 2018, nga 303 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale metalore janë kontrolluar 238 subjekte dhe 65 nuk janë kontrolluar asnjë herë.
- Për vitin 2018, nga 294 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale jo metalore (ndërtimore) janë kontrolluar 244 subjekte dhe 50 nuk janë kontrolluar asnjë herë.
- Për vitin 2019, nga 301 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale metalore janë kontrolluar 204 subjekte dhe 97 nuk janë kontrolluar asnjë herë.
- Për vitin 2019, nga 270 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale jo metalore (ndërtimore) janë kontrolluar 235 subjekte dhe 35 nuk janë kontrolluar asnjë herë.

- Për vitin 2020, nga 303 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale metalore janë kontrolluar 53 subjekte dhe 250 nuk janë kontrolluar asnjë herë.
- Për vitin 2020, nga 273 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale jo metalore(ndërtimore) janë kontrolluar 266 subjekte dhe 7 nuk janë kontrolluar asnjë herë.
- Për vitin 2021, nga 298 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale metalore janë kontrolluar 222 subjekte dhe 76 nuk janë kontrolluar asnjë herë.
- Për vitin 2021, nga 289 subjekte me leje shfrytëzimi për minerale jo metalore (ndërtimore) janë kontrolluar 251 subjekte dhe 38 nuk janë kontrolluar asnjë herë.

Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 110 deri 177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

20.1. Rekomandimi: Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv i AKBN të analizojnë rastet për të cilat nuk janë bërë monitorimet dhe në përputhje me përcaktimet e Statut-Rregullores së AKBN, t'ia propozojnë ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë ndryshimet e nevojshme në lidhje me kapacitetet e burimeve njerëzore dhe strukturën organizative të Drejtorisë Minerare në AKBN në funksion të mbikëqyrjes dhe monitorimit të subjekteve me leje shfrytëzimi.

Menjëherë

20.2 Rekomandimi: AKBN të marrë masa për përcaktimin në planin vjetor të monitorimit dy here në vit, të të gjithë subjekteve minerare, si dhe dhe inicimime inspektimeve dhe kontrolleve të subjekteve në terren me grupe të përbashkëta me përfaqësues të Drejtorive Rajonale të Tatimeve, me qëllim saktësimin e treguesve të vetë raportuar nga subjektet e licencuar në sistemin elektronik, dhe përlogaritjet e efekteve të mundshme për buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohen parregullsi dhe pasaktësi në të dhënat e evidencës statistikore, pasi evidenca vjetore për veprimtarinë e aktivitetit prodhues dhe tregtar të shoqërive që zotërojnë leje shfrytëzimi minerar, nuk është plotësuar me të gjithë treguesit kryesorë të prodhimit, të shitjes, të ardhurat e realizuara dhe renta e paguar, në kundërshtim me ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 dhe Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014.

Referuar data bazës së të dhënave mbi vetë-deklarimet për periudhën objekt auditimi rezulton se një numër i konsiderueshëm i subjekteve nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë dhe nuk kanë raportuar rregullisht, në lidhje me treguesit mbi realizimin e investimeve, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin progresiv të mjedisit, në kundërshtim me ligjin minerar neni 15 dhe 19.

Për vitin 2018, nga 600 rekorde që përfshin matrica e data bazës së të dhënave, rezulton se:

- 6 subjekte nuk kanë paraqitur asnjë të dhënë.
- 136 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve.
- 154 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve me sigurim jete.
- 6 subjekte edhe pse kanë bërë shitje brenda vendit ose kanë patur eksporte nuk kanë deklaruar pagesën e rentës minerare.

Për vitin 2019, nga 574 rekorde që përfshin matrica e data bazës së të dhënave, rezulton se:

- 58 subjektesubjekte nuk kanë paraqitur asnjë të dhënë.
- 116 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve.
- 138 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve me sigurim jete.

- 2 subjekte edhe pse kanë bërë shitje brenda vendit ose kanë patur eksporte nuk kanë deklaruar pagesën e rentës minerare.

Për vitin 2020, nga 554 rekorde që përfshin matrica e data bazës së të dhënave, rezulton se:

- 62 subjektesubjekte nuk kanë paraqitur asnjë të dhënë.

- 88 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve.

- 100 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve me sigurim jete.

- 2 subjekte edhe pse kanë bërë shitje brenda vendit ose kanë patur eksporte nuk kanë deklaruar pagesën e rentës minerare.

Për vitin 2021, nga 561 rekorde që përfshin matrica e data bazës së të dhënave, rezulton se:

- 69 subjekte nuk kanë paraqitur asnjë të dhënë.

- 139 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve.

- 157 subjekte nuk kanë deklaruar numrin e punëtorëve me sigurim jete.

- 40 subjekte edhe pse kanë bërë shitje brenda vendit ose kanë patur eksporte nuk kanë deklaruar pagesën e rentës minerare.

Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 110 deri 177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

21.1 Rekomandimi: Drejtoria Minerare pranë AKBN-së të marrë masa dhe të informojë operatorët ekonomikë me leje shfrytëzimi së duhet të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse informacionet tremujore mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetorë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

22. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave dokumentare të AKBN, konstatohet së gjatë periudhës objekt auditimi ka një rritje të sasive të kromeve të varfra dhe koncentrateve të kromit, të përpunuara në fabrikat e pasurimit, ku numri i tyre ka rritur në 16, përkatësisht:

- 7 impiante pasurimi për mineralin e kromit në Bashkinë Bulqizë;

- 3 impiante pasurimi për mineralin e kromit në Bashkinë Kukës;

- 2 impiante pasurimi për mineralin e kromit në Bashkinë Has;

- 1 impiant pasurimi për mineralin e kromit në Bashkinë Librazhd;

- 1 impiant pasurimi për mineralin e kromit në Bashkinë Përrenjas;

- 2 impiante pasurimi për mineralin e kakrit në Bashkinë Fushë ó Arrëz.

Nga auditimi konstatohet se, nga ana e AKBN (Drejtoria përkatëse), për periudhën e auditimit por dhe për periudhën e mëparshme nuk janë përfshirë në skemën e inspektimit, monitorimit dhe kontrollit imiantet apo fabrikat e pasurimit të mineraleve, në kundërshtim me ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010 për sektorin minerar në RSHÖ, i ndryshuar, nenit 1 dhe 2.

Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 110 deri 177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

22.1 Rekomandimi: AKBN të marrë masa për përmirësimet e duhura në Statut-Rregulloren e funksionimit të AKBN-së në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 547, datë 09.08.2006, pika 7, për të normuar detyrimin e kontrollit prej strukturës së Drejtorisë Minerare, të fabrikave të pasurimit të mineraleve, duke e shoqëruar këtë veprim me masat për rekrutimin në përbërje të Drejtorisë Minerare të inxhinierëve të pasurimit.

Në vazhdimësi

22.2 Rekomandimi: Të merren masa për planifikimin e kryerjes me përparësi të inspektimeve për impiantet e pasurimit, të cilat janë subjekte të licencuara, në bashkëpunim me strukturat

tatimore vendore, për të konfirmuar nëpërmjet akt-konstatimeve në terren të saktësisë së deklarimeve të këtyre subjekteve, mbi gjendjen e stokut të prodhimit, duke krahasuar dhe rakorduar të dhënat dhe informacionet periodike e raportimet vjetore të subjekteve të licencuar mbi sasi të mineralit të përpunuar dhe pasuruar për qëllim tregtimi.

Në vazhdimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se mungojnë kontrollet, inspektimet dhe vlerësimet e përbashkëta në terren me përfaqësues të AKBN/DM dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, ku ushtrojnë aktivitetin subjektet private të licencuara në shfrytëzimin e këtyre burimeve.

Në mbështetje të VKM nr. 867, datë 10.12.2014 òPër procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetërore midis AKBN dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Taksave është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit nr. 9689, datë 06.11.2015, por në dosjet e monitorimit nuk dokumentacion nëse ka funksionuar ky bashkëpunim me objekt shkëmbimin e informacionit në kohë reale, për të parandaluar dhe luftuar aktivitetet e paligjshme dhe evazionin fiskal në fushën minerale, informacion mbi lëvizjen e rezervave, volumin stokun e prodhimit, diferencat në vite, fuqinë punëtore reale të subjekteve që zotërojnë leje minerare dhe që paguajnë sigurime shoqërore si objekt për të ardhurat tatimore.

Mungesa e rakordimit me Degët Rajonale të Tatim Taksave dhe mungesa e gatishmërisë së këtyre degëve, ku janë të regjistruar subjektet zotëruese të lejeve minerare, kanë sjellë si pasojë që, prodhimi i mineralit të nxjerrë dhe të shitur dhe renta minerare të deklarohet dhe të pranohet në mënyrë të njëanshme nga subjektet që zotërojnë leje shfrytëzimi. Kjo mënyrë veprimi krijon kushte të favorshme për evazion fiskal ndaj të ardhurave tatimore dhe buxhetit të shtetit, pasi edhe ato matje që mund të jenë kryer nuk janë vënë në shërbim të ushtrimit të kompetencave që ka AKBN në funksion të përgjegjësisë që burojnë nga ligji nr. 10304, datë 15.07.2010, neni 1 dhe neni 2.

AKBN ka dërguar disa shkresa në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për të marrë informacion nga këto institucione për prodhimin e shitur brenda vendit dhe të eksportuar, por kjo marrëveshje ka mbetur e pa finalizuar, pasi edhe në rast të konstatohen diferenca në prodhimin e shitur, të ardhurat e realizuara dhe diferenca në llogaritjen e detyrimeve ndaj buxhetit për rentën e padeklaruar (apo të fshehur), AKBN nuk mund të arkëtojë këto detyrime.

Aktmarrëveshjet e lidhura me Drejtorinë e Tatim Taksave dhe Drejtorinë e Doganës nuk kanë shërbyer për të shkëmbyer informacione në kohë reale dhe në periudha tremujore, gjashtë mujore dhe vjetore. Theksojmë se, siç dërgohet informacion në MIE për prodhimin vjetor dhe rentën e deklaruar dhe të paguar, ky informacion duhet të bëhet i ditur dhe DPT dhe DPD, me qëllim rakordimin e të dhënave midis këtyre institucioneve. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me kërkesa e VKM nr. 867, datë 10.12.2014 òPër procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetërore.

Nga ana e AKBN-së (Komisionit të shqyrtimit të planeve vjetore të punës), në vitin 2020, është implementuar në dosjet e planit vjetor të punës për subjektet që kryejnë aktivitet minerar shfrytëzimi edhe formulari FDP (Formular Deklarimit e Pagesës) për renten minerare të paguar nga subjektet. Ky formular lëshohet nga DPT dhe në këtë mënyrë mund të bëhet nga ana e AKBN-së një rakordim ndërmjet shitjeve të deklaruara nga subjektet dhe rentë së paguar për këto shitje.

Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 110 deri 177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

23.1 Rekomandimi: AKBN në zbatim të marrëveshjes dypalëshe të lidhura, me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (respektivisht me nr. 1920 dhe 1922, datë 12.02.2016), të marrë masa për të shkëmbyer informacione periodike dhe në kohë reale për të parandaluar dhe luftuar aktivitetet e paligjshme dhe evazionin fiskal në fushën minerare, duke ndarë informacione mbi lëvizjen e rezervave, stokun e prodhimit dhe diferencat e tij në vite, fuqinë punëtore reale të subjekteve që zotërojnë leje minerare dhe që paguajnë sigurime shoqërore si objekt për të ardhurat tatimore, etj.

Në vazhdimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan mangësi dhe parregullsi në zbatimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv.

Nga shqyrtimi i dosjeve të përzgjedhura në mënyrë rastësore, u vu re së ka mangësi si më poshtë:

-Pasi shqyrtohet dosja në komision dhe konstatohen mangësitë, lihen afatet për plotësimin e dokumentacionit që duhet të përfshihet në dosje. Në komisionin pasardhës edhe pse janë plotësuar këto mangësi, nuk është mbajtur një procesverbal i ri, por është mjaftuar vetëm me shënimet përkatëse në procesverbalin e parë.

-Dokumentacioni i dosjes nuk inventarizohet.

-Në disa raste procesverbali i mbajtur në komision nuk është firmosur nga administratori i subjektit dhe drejtuesi teknik.

Gjatë periudhës mars 2020 deri në qershor 2020, komisioni nuk është mbledhur rregullisht pasi kjo periudhë përkon me gjendjen e fatkeqësisë natyrore, sipas V.K.M nr. 243, datë 24.03.2020. Kjo ka sjellë vonesa në shqyrtimin e dokumentacionit për disa subjekte dhe rrjedhimisht miratimin me vonesë të planit të punës. Në këtë periudhë, ka dosje të cilat nuk janë firmosur nga administratori ose drejtuesi teknik.

Në vitin 2021 është bërë rishikimi dhe përditësimi i rregullores së brendshme të funksionimit të komisionit të shqyrtimit të planeve vjetore të punës, të zotëruesve të lejeve minerare, sipas Urdhrit nr. 162, datë 21.10.2021, ku specifikohen në mënyrë të detajuar detyrimet e çdo specialisti, pjesëmarrës në komision.

Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 110 deri 177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

24.1 Rekomandimi: Drejtoria Minerare pranë AKBN të marrë masa për zbatimin e kërkesave të rregullores për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

24.2 Rekomandimi: Drejtoria Minerare pranë AKBN të marrë masa për zbatimin e kërkesave të rregullores për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit.

Brenda vitit

25. Gjetje nga auditimi: Lidhur me respektimin e ligjshmërisë e rregullshmërisë gjatë kryerjes së procedurave për marrjen në shqyrtim, analizën dhe marrjen e vendimeve përkatëse për miratimin ose jo të planit vjetor të punës së subjekteve të pajisura nga Ministria me lejeve minerare shfrytëzimi, me urdhër të veçantë të Drejtorit Ekzekutiv është ngritur grupi i punës për

shqyrtimin e dokumentacionit të planit vjetor të punës, ku janë përcaktuar qartë detyra dhe mbi atë bazë është operuar.

Nga auditimi konstatohet se:

-Miratimi i programit/planit vjetor të punës nga ana e Komisionit, ishte bërë në shumë raste me vonesë, në tejkalim të afatit 30 ditor të parashikuar në ligjin minerar neni 13, pika 12, duke sjellë si pasojë pengesa në rinovimin e licencës të subjektit zotërues të lejes minerare.

Bazuar në nenin 13, pika 12 sipas të cilit ò Në rast mosmiratimi, struktura përgjegjëse e njofton zotëruesin e lejes minerare për arsyet e këtij mosmiratimi. Nëse ajo nuk kthen përgjigje, pas tejkalimit të këtij afati, plani quhet i miratuarò, subjekti zotërues i lejes minerare vazhdon aktivitetin mbi bazën e miratimit në heshtje të planit vjetor të punës. Në ato raste kur plani vjetor i punës nuk miratohet nga Komisioni për shkak të mungesës së dokumentacionit të kërkuar dhe njoftimi i subjektit bëhet me vonesë, miratimi në heshtje i planit vjetor të punës, sjell pengesa në ushtrimin e aktivitetit të subjektit.

-Për ato raste ku, Komisioni është shprehur për plotësim të dokumentacionit nga subjekti minerar, në dosje nuk ka gjurmë/dokument të administruar nga Komisioni, nëse dokumentacioni është plotësuar nga subjekti dhe është marrë në shqyrtim nga Komisioni brenda afatit të përcaktuar prej tij.

-Nga Grupi i punës (Komisioni) për shqyrtimin e planeve vjetore të punës të subjekteve zotërues të lejeve minerare, për periudhën objekt auditimi, nuk është mbajtur asnjë protokoll për mbledhjet e zhvilluara.

-Mungon një tabelë kontrolli ku të jenë listuar gjithë dokumentet e nevojshme për dorëzim nga subjekti, sipas Udhëzimeve të lëshuara për këtë qëllim nga Ministri MIE.

-Në disa raste të mos miratimit të planit vjetor të punës, u evidentua mungesa e procesverbalit të mbajtur nga Komisioni si dhe mungesa e nënshkrimit të anëtarëve të Komisionit.

-Në disa raste nuk ka gjurmë (në procesverbalin tip të mbledhjes së Komisionit) së subjekti minerar ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni si dhe nëse ai është marrë në shqyrtim prej tij.

Veprimet e mësipërme përbëjnë mos zbatim të kërkesave të Rregullores òPër organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimitò.

Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 110 deri 177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

25.1 Rekomandimi: Drejtoria Minerare pranë AKBN, të marrë masa për shqyrtimin në afat dhe kthimin përgjigje të planeve vjetore që paraqiten nga subjektet e licencuara për miratim.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, nga ana e subjekteve të licencuar për shfrytëzim minerar, nuk likuidohet garancia financiare vjetore për rehabilitimin mjedisor të zonës së lejuar minerare, ose nuk likuidohet në kohë, në kundërshtim me ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerarò, i ndryshuar , si dhe VKM nr. 741, datë 09.09.2015.

Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, duke konstatuar këto vonesa në kryerjen e pagesës së garancisë financiare për rehabilitimin, ka marrë masa duke propozuar revokimin për këto subjekte në zbatim të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin minerarò, neni nr. 47, pika nr.1, germa òçò dhe konkretisht: Për vitin 2019,15 revokime; për vitin 2020,52 revokime dhe për vitin 2021,6 revokime.

Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 110 deri 177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

26.1 Rekomandimi:Drejtoria Minerare pranë AKBN të marrë masa duke u kërkuar subjekteve me leje shfrytëzimi minerar, shlyerjen e detyrimeve për garancitë financiare të rehabilitimit, në të kundërt të aplikohen sanksionet e parashikuara në ligjin përkatës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

26.2 Rekomandimi: Drejtoria Minerare pranë AKBN të mbajë korespondencë të vazhdueshme me ministrinë e linjës (MIE) për revokimin e lejeve të shfrytëzimit për subjektet që nuk kryejnë pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

27. Gjetje nga auditimi: Sektori i Laboratorit Minerar dhe i Pasurimit është pjesë e Drejtorisë Minerare në AKBN. Ky sektor ka si qëllim kryerjen e analizave të mineraleve të ngurta dhe kryerjen analizave fiziko kimike të ujërave, si për interes të institucionit, ashtu dhe për të tretë. Gjate periudhës objekt auditimi janë kryer analiza për të tretët (për subjekte minerare dhe individë) kundrejt pagesave të kryera në bankat e nivelit të dytëpër llogari te institucionit, ku për periudhën e auditimit është me vlerë 1,067,000 lekë. Kjo vlerë është e ulët dhe nuk përballon shpenzimet e vetë laboratorit (paga, preparate, reagjentë, lëndët kimike, etj.). Numri i vogël i analizave lidhet me faktin se ka një numër të lartë të laboratorëve që kryejnë analiza të ngjashme si dhe për faktin se ky laborator nuk është i akredituar.

Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 110 deri 177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

27.1 Rekomandimi:Drejtoria Ekzekutive e AKBN të marrë masa për plotësimin e kritereve dhe aplikimin për akreditim, me qëllim rritjen e numrit dhe cilësisë së analizave, rrjedhimisht rritjen e monitorimit të aktivitetit minerar dhe të ardhurave të institucionit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

27.2 Rekomandimi:AKBN të marrë masa për hartimin e një rregulloreje të funksionimit të Sektorit të Laboratorit që është në përbërje të Drejtorisë Minerare pranë AKBN-së, si dhe përfshirja e këtij sektori në Statut-Rregulloren e funksionimit të AKBN-së.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacioni në dispozicion, konstatohet se:

-Minierat e mbyllura/braktisura shtetërore, janë mbyllur me mënyrën provizore (të përkohshme). Në vite, pothuaj të gjitha punimet e mbyllura të këtyre minierave janë hapur ose dëmtuar, duke qenë, potencialisht, rrezik serioz për jetën e njerëzve.

-Mbyllja e puseve vertikale është kryer me metodën e mbylljes provizore.

-Gjendja e objekteve sipërfaqësore, ndërtesave dhe ndërtimeve në të gjitha sheshet industriale të minierave është shumë e degraduar. Ato janë amortizuar dhe të dëmtuara dhe aktualisht përbejnë rrezik për jetën e banoreve përreth. Vetëm një numër shumë i vogël i këtyre ndërtesave të ish minierave janë privatizuar.

-Konstatohen dalje të hinkave në sipërfaqe në shumë zona si pasojë e hapësirave të krijuara nga shfrytëzimi në vite, kryesisht në Minierën Rehovë dhe Mborje Drenovës, Bashkia Korçë, në Minierën e Kurbneshit Bashkia Mirditë dhe në minierën e Kripës Dhrovjan Bashkia Finiq.

-Konstatohen ndërtime mbi ish minierat kryesisht ato të qarkut të Trianës (Valias, Mëzez, etj.).

-Në përgjithësi, ka mungesë sinjalistike paralajmëruese dhe ndaluese për reziqet minerare, është e dëmtuar ose jo në përputhje me standardet e sinjalistikës përkatëse për minierat e braktisura.

Kjo e bën të vështirë dallimin e zonës të minerarës së mbyllur dhe të objekteve të saj nga banorët e zonës apo të kalimtarëve të rastit.

-Dambat e fabrikave të pasurimit të mineralit të bakrit, që nuk janë rehabilituar, janë në gjendje jo të mirë. Mund të përmendim damba e sterileve të ish fabrikës së pasurimit të bakrit Kurbnesh, në të cilën janë krijuar disa gropa (hinka) me diametër dhe thellësi prej disa metrash dhe janë dëmtuar (erozion nga ujërat) sipërfaqet ballore dhe anësore të dambave, kryesisht nga dëmtimi, apo mungesa, i kanaleve të ujërave të larta dhe, për pasojë, mos kontrolli i ujërave të shiut dhe të dëborës.

-Disa miniera të mbyllura si minierat e kripës Dhrovjan e Mengaj, të fosforiteve Gusmar e Fushëbardhë apo ish miniera e qymyrgurit Gërdec, nuk janë në administrim të asnjë prej tre shoqërive (Am., Ab. dhe Ak.), që administrojnë miniera e mbyllura/braktisura.

Për sa më sipër, nga ana e AKBN nuk janë marrë masat e duhura, sipas parashikimeve ligjore.

Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 110 deri 177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

28.1 Rekomandimi: Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, të hartojë një plan rehabilitimi për këto zona si dhe të përcaktojë listën e minierave që do të kalojnë në mbyllje të përhershme.

Menjëherë

28.2 Rekomandimi: AKBN të marrë masa për përgatitjen e propozimeve për realizimin e rehabilitimit të këtyre zonave dhe të mbylljes së përhershme të minierave të përcaktuara në listë dhe të dërgojë në MIE.

Menjëherë

29. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua që për periudhën objekt auditimi janë kryer 74 aktverifikime për vitin 2018, 42 për vitin 2019, 45 për vitin 2020 dhe 26 për vitin 2021. Për këtë periudhë janë realizuar të ardhura nga të tretët me vlerë 16.7 milionë lekë.

Konstatohet se nga sektori Sektori i Akt Verifikimit dhe Trajtimit të Ankesave ka patur një ulje të ndjeshme të numrit të Akt Verifikimeve të kryera ndër vite dhe si rrjedhojë edhe të ardhurat e përfituara nga të tretët kanë pësuar rënie të ndjeshme. Kjo për faktin së MIE nuk ka publikuar zona të reja për shfrytëzimin minerar.

Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 110 deri 177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

29.1 Rekomandimi: Nga ana e AKBN të bëhet kërkesë në MIE për publikimin e zonave të reja për shfrytëzim minerar.

Menjëherë

30. Gjetje nga auditimi: Në Urdhrin e Përbashkët Nr. 322 datë 13.09.2018 për "Ngritjen e grupit të punës për kontrollin mbi zbatimin e kërkesave të Lejeve të Mjedisit dhe të Lejeve Minerare nga subjektet e shfrytëzimit minerar (gurorët), që preken nga zbatimi i VKM Nr. 468 date 26.07.2018 "Për shpalljen e Peisazhit Natyror të Mbrojtur Krastë - Verjon", të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, më datë 29.05.2019, u propozuan dhe më pas u revokuan nga MIE 16 leje minerare, që ushtronin aktivitet minerar shfrytëzimi në këtë vendburim.

Këto leje zënë një sipërfaqe totale të licencuar prej 5.5025 km² dhe sipërfaqja e prekur është 0.5514 km² kurse sipërfaqja e dëmtuar në vite është 0.95km²

Në kontrollin e ushtruar nga Drejtoria Minerare pranë AKBN në Bashkinë Krujë në muajin dhjetor 2020, u konstatua së nuk ishte bërë evadimi dhe as çmontimi i plotë i materialeve në këtë zonë, por vazhdohej të punohej.

Nisur nga kjo situatë Drejtoria Minerare pranë AKBN-ës i është drejtuar me shkresën Nr. 4627 Prot. datë 24.12.2021, Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Bashkisë Krujë.

Bazuar në monitorimet e realizuara nga Drejtoria Minerare pranë AKBN, rezulton se pavarësisht revokimit të lejeve, aktiviteti vazhdon.

Vazhdimi i këtij aktiviteti, shoqërohet me vazhdim të dëmtimit, punime jashtë kushteve teknike që paraqesin rrezik për jetën e njerëzve, si dhe si pasojë e aktivitetit në informalitet, shmangie të pagesës së rentës minerare dhe evazion fiskal.

Bazuar në VKM Nr. 611, datë 11.09.2019 "Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar ÷ Mali i Tomoritë, dhe në zbatim të Urdhrit të Ministrit nr. 378, datë 07.10.2019 ÷ Për caktimin e grupeve të inspektimit në terren për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vlerësimin e përmbushjes së kërkesave ligjore nga subjektet që ushtrojnë veprimtari për shfrytëzimin mineral, brenda dhe në afërsi të parkut kombëtar të "Malit të Tomoritë, më datë 19.12.2019, u realizua revokimi i 11 lejeve minerare të prodhimtë mineralit gëlqeror pllakorë.

Këto leje zënë një sipërfaqe totale të licencuar prej 1.01 km² dhe sipërfaqja e prekur është 0.3528 km², por jashtë sipërfaqes së licencuar sipërfaqja e prekur rezulton të jete rreth 80 hektarë.

Nga ana e AKBN nuk është ushtruar mbikëqyrje në këtë objekt, për mundësinë e vazhdimit të aktivitetit të këtyre subjekteve edhe pas revokimit të lejes.

Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 110 deri 177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

30.1 Rekomandimi: Drejtoria Minerare pranë AKBN-së të vazhdojë korrespondencën me Ministrinë e linjës, me Organet e pushtetit vendor si dhe me organet ligj zbatuese për ndërprerjen e aktivitetit të subjekteve të cilëve u është revokuar leja, duke marrë masa ligjore për kundërvajtësit, si dhe rehabilitimin e këtyre zonave.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Mbi shfrytëzimin e burimeve hidroenergjitike.

31. Gjetje nga auditimi: Grupi i punës për verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i VKM nr.822, datë 07.10.2015, nga burimet hidrike të energjisë i ngritur me Urdhrit të Ministres së MIE nr.233 datë 06.06.2019 ka evidentuar se 35 % të kontratave koncesionare janë jashtë afatit, me shkelje, si dhe në procese gjyqësore (92 nga 265) gjë që tregon për nivelin e dobët të monitorimit nga të gjitha institucionet përkatëse, përfshirë dhe AKBN.

Më hollësisht trajtuar në pikën 7, në faqet 109-173, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

31.1. Rekomandimi: AKBN të marrë masa për rritjen e monitorimit të aktivitetit të realizimit të veprave hidrike, sipas përcaktimeve në marrëveshjet përkatëse dhe akteve ligjore në fuqi.

Vazhdimisht

32. Gjetje nga auditimi: Mangësia e monitorimeve të njëtrajtshme në planifikim dhe zbatim, për vitin 2019 ka ndikuar në ngarkesën e punonjësve dhe cilësinë e monitorimit për shkak të intensifikimit të punës në periudha të veçanta të vitit. Kjo pasi vetëm nga raportimet e monitorimeve të tremujorit të tretë dhe të katërt 2019 rezultojnë penalitete për mosrespektim të detyrimeve kontraktore për 41 % të kontratave të monitoruara, duke shkaktuar deformim të sipërmarrjes në fushën prodhimit të energjisë elektrike nga burimet ujore, si rezultat veprimeve dhe mosveprimeve të MIE në cilësinë e Autoritetit kontraktor.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, në faqet 177-203, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

32.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masa për të siguruar një shpërndarje të përafërt të monitorimeve gjatë gjithë vitit, si dhe të sigurojë monitorimin e plotë të të gjitha kontratave koncesionare, duke informuar në mënyrë të detajuar MIE mbi problematikat evidentuara dhe inkurajuar bashkëpunimin me institucionet e tjera publike për disiplinimin e fushës së prodhimit të energjisë elektrike.

Në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Si rezultat i mos ndryshimit në rritje të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike nga shqyrtimi i oponencës teknike për projektet e zbatimit në kontratat koncesionare për 25 prej tyre, ka sjellë për pasojë mungesën e përfitimit nga fee koncesionare (energji elektrike pa pagesë) në vlera të konsiderueshme. Gjithashtu, mungesa e reflektimit të ndryshimit të fuqisë (në kw) së hidrocentraleve në 11 prej tyre, sipas projektit të zbatimit të vlerësuar më të ulët së kontrata nga 7 deri në 60%, rrezikon koncesionarët për penalizim në vlera të konsiderueshme për ulje të fuqisë së instaluar.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, në faqet 177-203, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

33.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masa për të evidentuar në mënyrë të hollësishme të gjitha kontratat koncesionare, në të cilat ka rritje të prodhimit të energjisë elektrike nga oponenca teknike por që nuk është ndryshuar sasia e prodhimit në kontratë fuqia e hidrocentraleve, duke njoftuar për këtë qëllim Autoritetin kontraktor (MIE).

Brenda muajit nëntor 2022

34. Gjetje nga auditimi: Ndryshimi i monitorimit të prodhimit vjetor të energjisë elektrike me VKM nr. 332, datë 6.6.2018, pika 1/a duke e kaluar me mesatare për periudha 5-vjeçare, ka sjellë për pasojë heqjen monitorimit vjetor të veprimtarisë hidronergjetike, reduktimin funksionit institucional të sektorit përkatës, si dhe shtyrjen në kohë të sanksioneve për këtë qëllim duke i zbutur deri në shuarje e tyre, krahas përfshirë këtu dhe ndryshimin e çmimit të blerjes të energjisë elektrike përgjatë 5 viteve për efekt penalteti.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, në faqet 177-203, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

34.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të njoftojë me shkrim MIE në mënyrë të detajuar lidhur me problematikat ligjore, funksionale dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore që ka nxjerrë dhe janë evidentuar në praktikë nga zbatimi i VKM dhe Udhëzimit të mësipërm.

Deri në fund të vitit 2022

35. Gjetje nga auditimi: Grupi i oponencës teknike ka në shumicë ekspertë të jashtëm (5) në kundërshtim me VKM nr. 547, pika 3, pasi vendim-marrja del jashtë kompetencës saj institucionale, është kosto financiare për AKBN, duke evidentuar mungesën e rekrutimit të stafit profesional sipas fushave, si dhe shfaq mungesën e përcaktimit të kriterëve që duhet të plotësojnë ekspertët e jashtëm, si dhe e bën procedurën e kryerjes së oponencës teknike subjektive dhe me mangësi potenciale të kësaj veprimtarie etj.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, në faqet 177-203, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

35.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN t'i propozojë Ministrin rregullimin e raporteve midis ekspertëve të jashtëm e të brendshëm, në favor të këtyre të fundit duke përcaktuar kriteret e duhura, si dhe të rekrutojë staf profesional në përputhje me detyrat funksionale institucionale.

36. Gjetje nga auditimi: Grupi i oponencës teknike nuk ka zhvilluar aktivitete të rregullta, pasi në 3 muaj ka vetëm nga një mbledhje; nuk ka funksionuar fare për 9 muaj duke sjellë për pasojë vonesa të pajustificuara, si dhe shpërblim jo eficient për grupin e punës; janë paraqitur për shqyrtim projektet me mbi 300 ditë me vonesë në rreth 19 % të rasteve, duke e bërë procesin e shqyrtimit fakultativ dhe subjektiv; rishqyrtimi është kryer në 12 raste (nga 23 gjithsej) jashtë afatit maksimal të përcaktuar në Rregulloren me nga 30 deri në 200 ditë me vonesë etj.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, në faqet 177-203, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

36.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masa për të siguruar performancë të plotë të grupit të oponencës teknike, duke zhvilluar mbledhjet e nevojshme për shmangien e vonesave dhe disiplinimin e sektorit të prodhimit të energjisë elektrike.

Në vijimësi

37. Gjetje nga auditimi: Gjatë monitorimit të kontratave konesionare për ndërtimin e hidrocentraleve në vitin 2019 deri 2021, Drejtoria përkatëse në AKBN ka evidentuar parregullsi në kundërshtim me kushtet kontraktore, penalitete në vlerën 23,143,439,359 lekë, për të cilat është njoftuar autoriteti kontraktor, MIE për secilën kontratë konesionare. Gjithashtu, mungesa e shoqërimit të ndryshimit të prodhimit të energjisë elektrike nga oponenca teknike në kontratat konesionare sjell për pasojë mungesën e përfitimit buxhetor për 15,590,253 lekë, dhe te dyja së bashku në vlerën 23,159,029,612 lekë.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, në faqet 177-203, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

37.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masat e nevojshme për të rritur frymën e bashkëpunimit me MIE për shkëmbimin e informacionit lidhur me ecurinë e zgjidhjes së problematikave të evidentuara gjatë monitorimit të kontratave konesionare në fushën energjetike.

Në vijimësi

38. Gjetje nga auditimi: Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka treguar kujdesin e duhur lidhur me informacionin e marrë nga monitorimi i kryer nga AKBN për shfrytëzimin e burimeve energjetike, për të zbatuar plotësisht kuadrin rregullator të fushës.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, në faqet 177-203, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

38.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të hartojë një dokument pune të veçantë me propozime konkrete për institucionalizimin e marrëdhënieve me MIE, në zgjidhje të problematikave të evidentuara nëpërmjet informacioneve përkatëse të AKBN.

Brenda vitit 2022

39. Gjetje nga auditimi: Nga 30 oponenca teknike të realizuara për vitin 2020, janë audituar 5 prej tyre, nga ku ka rezultuar së në 3 oponenca ka mangësi. Mangësitë lidhen me faktin se edhe pse kontraktorëve u është kërkuar të përmirësojnë studimet përkatëse, të bashkëngjisin llogaritjet statike, llogaritjet e sistemit të derivacionit, është dhënë miratim në mungesë të këtij dokumentacioni.

Miratimi i oponencës teknike, ndërkohë që projektet paraqiten me mangësi është në kundërshtim me Rregulloren Për Funksionimin e Grupit të Përkryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me konesionë, Neni 2. Mos realizimi i oponencës teknike sipas

përcaktimeve në rregullore, nuk garanton respektimin e kushteve të projektimit, shfrytëzimin optimal të burimeve ujore, si dhe ndikim sa më të ulët në mjedis.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, në faqet 177-203, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

39.1 Rekomandimi: Grupi i oponencës teknike të marrë masa për shqyrtimin me detaje të dokumentacionit teknik të projekteve, me synim garantimin e respektimit të kushteve teknike të projektimit, shfrytëzimin optimalë të burimeve ujore, si dhe realizimin e investimeve me eficiencë të lartë dhe ndikim sa më të ulët në mjedis.

Vazhdimisht

40. Gjetje nga auditimi: Nga monitorimi është konstatuar së disa koncesionarë nuk kanë paraqitur dokumentacionin e lejes së ndërtimit, apo leje të tjera, por nga ana e AKBN, nuk është marrë asnjë masë për sensibilizimin e organeve kompetente. Mungesa e dokumentacionit pengon monitorimin ndikimit në mjedis, nuk mundëson zgjidhjen e problematikave që i krijohen banorëve të zonës në lidhje me përdorimin e burimeve ujore, mungesë pagesë tarifash, mungesë ta trajtimit të problematikave kur projekti shtrihet në më shumë së një bashki etj., problematika të cilat nuk parandalohen, por bëhen objekt për ndërprerje të kontratave në të ardhmen, duke ulur nivelin e investimeve në këtë fushë dhe pasoja për mjedisin etj.

- Nga monitorimi konstatohet së disa koncesionar kanë ndryshuar kapacitetin e prodhimit, megjithatë nga ana e AKBN nuk janë bërë llogaritjet për pasojat e veprimit në lidhje me sasinë e energjisë dhe të ardhurave që do të mungojnë nga prodhimi më i ulët i energjisë për shtetin (për rastet kur kapaciteti është më i ulët), si dhe problematika që krijohet në deformimin e skemave të miratuara dhe pasojat në funksionim.

- Pavarësisht monitorimit kontraktorët paraqesin mangësi të theksuara të plotësimit të dokumentacionit tekniko ligjor, madje në disa raste nuk bëhet njoftim për pjesëmarrje në testim nga ana e AKBN, si proces i detyrueshëm, për evidentimin e saktësisë së realizimit të veprave, krahasuar me parashikimin.

-Devijimet e shumta si në skema, kapacitete, ndryshime gjatë zbatimit të kontratave, mund të shoqërohen me vështirësi për realizimin e këtyre veprave dhe në ndonjë rast dështimin e tyre.

- Vonesat në fillimin, zbatimin apo përfundimin e veprave, vë në diskutim vënien në funksion të tyre, ose në rastin më të mirë, vënie me vonesë në eficiencë të investimeve, rrjedhimisht energji elektrike më pak në rrjet dhe të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

- Nga ana e AKBN janë përlllogaritur penaltete si për mos fillim, fillim të vonuar, apo mos përfundim të punimeve në afat, por nuk rezultojnë asnjë rast i ekzekutuar. Mos ekzekutimi i penalteteve përveç të ardhurave të munguara për buxhetin e shtetit, nuk nxit koncesionarët për të aktivizuar burimet e tyre për realizimin e investimit sipas parashikimeve të miratuara (procesi i aplikimit të penalteteve është kompetencë e MEI).

- Nisur nga numri i lartë i HEC-eve të miratuara, por të pa filluara, edhe për periudha të gjata të konsiderueshme të cilët konsiderohen pa shpresë realizimi, nuk është shoqëruar me njoftimet përkatëse për ndërprerjen e kontratës, për t'ia dhënë mundësinë operatorëve të tjerë për realizimin e mundshëm të këtyre investimeve.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, në faqet 177-203, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

40.1 Rekomandimi: AKBN në bashkëpunim me MIE të marrin masa për analizimin e situatës së koncesionarëve në fushën e HEC-eve, për vështirësitë që paraqiten në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të koncesionarëve, sidomos në marrjen e lejeve përkatëse, angazhimin maksimal për reduktimin e kohës së nevojshme për miratimin e projekteve, lejeve,

oponencës teknike etj., me synim realizimin e afateve të parashikuara në kontrata për realizimin e veprave dhe hyrjen në një kohë sa më të shpejtë në prodhim të tyre.

40.2 Rekomandimi: Për investime të cilat kanë një kohë të konsiderueshme për të cilat nuk ka filluar zbatimin, të merren masa për ndërprerjen e kontratës, në mënyrë që të hapet mundësia për realizimin e këtyre investimeve nga operatorë të tjerë ekonomikë.

Vazhdimisht

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Titulli i gjetjes: Nga auditimi i pagesave të shoqërive koncesionare për kryerjen e oponencës teknike nga ana e AKBN për projektet e ndërtimit të hidrocentraleve rezulton së, në vitin 2019 janë 9 raste ku në faturat e pagesave të shoqërive koncesionare për oponencën teknike, nuk është llogaritur dhe paguar TVSH mbi vlerën e tarifës (por është konsideruar e përfshirë brenda saj), prej **320,000** lekë, (1,600,000 lekë vlera e faturave gjithsej x 20% TVSH), e cila përbën të ardhura të munguara, vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 datë 24.07.2014 *ËPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, neni 39, pika 1, shkronja òaò ku në vlerën e tatueshme përfshihen elementet si tatimet, taksat, detyrimet, tarifatat dhe pagesa të ngjashme, me përjashtim të TVSH-së.

- Në pagesat e shoqërive koncesionare për kryerjen e oponencës teknike nga ana e AKBN për projektet e ndërtimit të hidrocentraleve, nuk është llogaritur dhe paguar TVSH mbi vlerën e tarifës, por është konsideruar e përfshirë brenda saj, ku për 108 subjekte, me një vlerë prej **4,460,000** lekë (22,300,000 lekë vlera e faturave gjithsej x 20% TVSH), nuk është lëshuar fatura përkatëse e TVSH-së dhe nuk janë arkëtuar të ardhurat nga institucioni, (të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për AKBN) duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 datë 24.07.2014 *ËPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, neni 39, pika 1, pika 1, shkronja òaò ku në vlerën e tatueshme përfshihen elementet si tatimet, taksat, detyrimet, tarifatat dhe pagesa të ngjashme, me përjashtim të TVSH-së, Udhëzimin e Ministrit të financave nr.24 datë 02.09.2008 *ËPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 177-203, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masa duke njoftuar subjektet përkatëse për të kryer pagesat mësipërme, duke ngarkuar sektorin e financës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 *òKodi i Punës*, i ndryshuar, nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2, Statut-Rregulloren e Funkcionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, neni 26, si dhe kontratave individuale të punës, për shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Drejtorit Ekzekutiv që të analizojë dhe të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, me qëllim fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT